

ENVER HOXHA

VEPRA

48

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

48

JANAR 1972 – MAJ 1972

SHTËPIA BOTUESE "8 NENTORI-
TIRANË, 1935

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 48-TË

Në vëllimin e 48-të të Vëprave të shokut Enver Hoxha përfshihen materiale të periudhës janar-maj 1972, pjesa më e madhe e të cilave botohen për herë të parë.

Shkrimet e këtij vëllimi përmbajnë një varg problemesh që shtronte para komunistëve dhe mbarë masave punonjëse të vendit tonë stadi i ri i zhvillimit, menjëherë pas Kongresit të 6-të të Partisë. Përpyekjet, puna dhe lufta për zbatimin e vendimeve e të direktivave të këtij Kongresi përbëjnë karakteristikën dalluese të kohës.

Në epilogun e këtij libri është fjala «Socializmin e ndërtojnë masat, Partia i bën këto të ndërgjegjshme», mbajtur në plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit më 26 shkurt 1972. Duke zërthyer idenë leniniste se socializmin «mund ta vendosin dhjetëra miliona njerëz kur ata të mësojnë ta bëjnë vetë këtë punë», udhëheqësi dhe mësuesi i madh i paharruar i Partisë e i popullit tonë, shoku Enver Hoxha, i bën një analizë të thellë marksiste-leniniste problemit të madh parimor të raportit Parti-kuadro-masë. Ky fjalim përmban mësimet të rëndësishme teorike dhe praktike. Në të argumentohet në mënyrë shkencore pse Partia duhet të jetë kurdoherë në pararojë e komunistët të shkojnë

në frontet më të vështira, të jenë shembull në çdo drejtim, pse dhe si duhet ushtruar kontrolli i klasës punëtoare e të jepet llogari para popullit, si duhet punuar për forcimin e demokracisë socialiste, si të ngrihen në luftë masat popullore kundër burokratizmit e burokratëve, për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë, të pushtetit e të krejt jetës së vendit.

Tipar karakteristik i këtij vëllimi është vështrimi me sy kritik i disa problemeve që kanë të bëjnë me politikën ekonomike të Partisë. Shoku Enver Hoxha tërhiqte vëmendjen për mangësi e gabime, për qëndrime burokratike e liberale e për një sërë pikëpamjesh teknokratike, të cilat kishin çuar në mosrealizimin e disa detyrave të planit të vitit 1971. Këto gabime ishin pasojë e moskuptimit dhe e mosthellimit në politikën ekonomike të Partisë, në direktivat e në orientimet e saj. Duke i kritikuar ato, në vëllim theksohet nevoja e përsosjes së drejtimit e të organizimit shkencor të ekonomisë, e forcimit të disiplinës së planit në çdo fushë e sektor, e përmirësimit të kontrollit shtetëror, si dhe e kontrollit të drejtpërdrejtë të klasës, rritja e frymës së përgjegjësisë, e zbatimit me përpikëri të kompetencave dhe të detyrimeve kontraktuale, e propagandimit të përvojës së përparuar, e shtrirjes së normave teknike për shtimin e rendimentit të prodhimit dhe realizimin e planeve etj.

Përmbajtja e këtij vëllimi është një tregues tjetër i preokupacionit dhe i kujdesit të madh të Partisë dhe të shokut Enver Hoxha për zhvillimin e bujqësisë. Problemet e saj janë objekt i disa diskutimeve në udhëheqje të Partisë. Duke nënvizuar rëndësinë e

orientimit të Kongresit të 6-të se bujqësia mbetet bazë e ekonomisë, shoku Enver Hoxha kritikonte të kuptuarit në mënyrë të njëanshme të saj dhe theksonte se të gjithë sektorët e bujqësisë duhen zhvilluar proporcionalisht. Ai këshillonte që problemeve të mekanizimit, hartimit dhe zbatimit me rreptësi të planeve bujqësore, disiplinës shkencore agroteknike, propagandës bujqësore etj., t'u kushtohet vëmendja e duhur nga organet e Partisë, të pushtetit e nga kooperativat bujqësore.

Dokumentet e këtij vëllimi përmbajnë ide dhe porosi të rëndësishme për zbatimin e direktivës së Kongresit të 6-të të Partisë, lidhur me zhvillimin e blegtorisë, duke i dhënë përparësi zhvillimit të lopës, pa lënë pas dore të imëtat. Në diskutimin e tij në mbledhjen e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Dituria dhe shkenca të përhapen gjerësisht në masat dhe të përvehtësohen prej tyre», shoku Enver Hoxha shtronte përpara institucioneve kërkimore e shkencore një varg problemesh e detyrash të lidhura ngushtë me perspektivën e zhvillimit të blegtorisë dhe vënien e saj mbi baza shkencore, për shtimin dhe për përmirësimin racor të bagëtive dhe për forcimin e bazës ushqimore. Në disa materiale si «Plani i grumbullimit të tepricave nuk është detyrim», «Zbatimi i kontratave duhet të mbështetet në realizimin faktik të planit të prodhimit bujqësor e blegtoral» etj., kritikohen kryesisht Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Tregtisë, për shkelje të direktivave të Partisë lidhur me krijimin e kooperativave të tipit të lartë, me oborrin kooperativist në kushtet aktuale, me heqjen e sistemit të grumbullimit të detyrueshëm të drithit dhe mishit. Në të njëjtën kohë

jepen porosi që t'u pritët rruga këtyre shkeljeve dhe të shtohet më tepër kujdesi për fshatin, për një furnizim më të mirë të tij me mallra nga qyteti.

Një pjesë e shkrimeve që botohen në këtë vëllim përshkohen nga ideja e rëndësishme për kualifikimin dhe rritjen e nivelit tekniko-profesional të punonjësve. Në to theksohet se të gjithë, veçanërisht të rinjtë, duhet të mësojnë jo për të siguruar diploma dhe rroga të majme, por për dije, për t'i shërbyer më mirë atdheut. Njerëzit tanë, — mëson shoku Enver Hoxha, — duhet t'i edukojmë me dashurinë për profesionin, bile të fitojnë edhe dy e tri profesione. Lidhur me këtë, Ai shtron një varg detyrash për forcimin dhe harmonizimin e raportit midis kategorizimit dhe pagës, me synim rritjen e rendimentit të punës, për sigurimin e kushteve të punës e të jetesës së klasës punëtore, sidomos në veprat e mëdha të pesëvjeçarit, për të forcuar bindjet politike dhe ndërgjegjen e saj socialiste, për të mbajtur të gjallë patriotizmin dhe frymën subnuese në punë.

Përmes materialeve të këtij vëllimi vihet theksi edhe në probleme të kalitjes ideologjike e të forcimit organizativ të Partisë, sidomos të organizatës-bazë. Në këtë fushë shoku Enver Hoxha shtron me forcë nevojën e kuptimit të drejtë dhe zbatimit si duhet të direktivave të Partisë «pse nga një gjykim i përciptë dhe i pamatur në këtë drejtim mund të lindin rreziqe për Partinë në shkuarjen nga e djathta ose nga e majta». Ai jep këshilla e porosi me vlerë sidomos për forcimin e metodës e të stilit të punës së Partisë, për zbatimin e parimeve e të normave të saj, për zbatimin e vijës

së masave, për zhvillimin e kritikës e të autokritikës, për përmbajtjen e informacionit të Partisë etj.

Në faqet e këtij vëllimi trajtohen edhe probleme të zhvillimit botëror e të luftës kundër imperializmit e revizionizmit. Në disa dokumente afirmohet edhe një herë qëndrimi i palëkundur i Partisë sonë në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, të revolucionit e të socializmit, në mbrojtje të luftës së drejtë të popullit vietnamez e të të gjithë popujve kundër imperializmit me atë amerikan në krye dhe kundër revizionizmit sovjetik e varianteve të tjera të revizionizmit modern. Qëndrimet parimore të Partisë sonë pasqyrohen sidomos në shkriimet «Demagogjisë së revizionistëve i bëhet ballë duke u bazuar në parimet marksiste-leniniste», «Vija e demarkacionit midis marksistë-leninistëve dhe revizionistëve modernë nuk mund të shlyhet», «Larg duart nga Ballkani» etj., në të cilat, ndër të tjera, nënvizohet edhe një herë parimi leninist, se nuk mund të mbash kontakte e të bisedosh me një pjesë të revizionistëve vetëm sepse ata kanë mosmarrëveshje me disa revizionistë të tjerë, ashtu siç nuk mund të mbështetesh te një imperializëm për të kundërshtuar tjetrin. Duke bërë aluzion për revizionistët kinezë, shoku Enver Hoxha vë në dukje se lufta parimore pa kompromis e deri në fund është e vetmja rrugë e drejtë për demaskimin e plotë të revizionizmit të të gjitha ngjyrave.

Ky vëllim, ashtu si gjithë vëllimet e tjera të Veprave të serisë, do të jetë një burim i ri frymëzimi, mobilizimi dhe edukimi revolucionar për komunistët, kuadrot dhe mbarë masat punonjëse të vendit tonë, në

luftën e tyre për të zbatuar vijën dhe direktivat e Partisë, për të vënë në jetë detyrat në sektorët ku punojnë, për lulëzimin dhe mbrojtjen e atdheut tonë socialist.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

NGRITJEN TEKNIKO-PROFESIONALE TË PUNËTORËVE E KËRKON VETË ZHVILLIMI I EKONOMISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 janar 1972

Për një problem kaq të rëndësishëm, siç është kualifikimi i punonjësve, që trajtohet në raportin e Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale, kisha për të shtuar vetëm disa çështje që nuk u ngritën në diskutime.

Kualifikimi i punonjësve është një problem shumë i koklavitur, prandaj ta diskutojmë me kujdes që të mund të japim disa orientime dhe zgjidhje të drejta. Puna në këtë drejtim ka ardhur vazhdimisht duke u rritur dhe, në fakt, nuk shkon keq, por është koha të bëjmë përmirësime të mëtejshme në këtë çështje.

Duke marrë parasysh zhvillimin e pandërprerë të vendit tonë, është e nevojshme që herë pas here ne

1. Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme të ngritjes tekniko-profesionale të punëtorëve.

të rishikojmë në mënyrë serioze punën e bërë për ngritjen e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe tekniko-profesional të punonjësve e ta përmirësojmë atë më tej. Këtë e kërkon edhe zhvillimi në rritje i ekonomisë, i arsimit e i kulturës, si dhe zhvillimi i vetë njerëzve tanë. Disa vendime që kanë dalë për këtë çështje para disa vjetësh, aktualisht mund të jenë vjetruar dhe nuk u përgjigjen kushteve të reja që janë krijuar. Kjo është arsyeja që Partia rekomandon rishikimin e tyre. Megjithatë, sistemi ynë i edukimit të punonjësve, nëpërmjet arsimit të përgjithshëm dhe tekniko-profesional, në themel është i drejtë, prandaj nuk ka përse të bëjmë ndryshime në të, kurse përmirësime të mëtejshme mund dhe duhet të bëjmë.

E kemi ngritur gjithnjë nevojën e mbarimit të shkollës fillore e 8-vjeçare dhe Partia në këtë drejtim ka ngulur këmbë vazhdimisht. Tani është shumë pozitiv fakti që numri i nxënësve i dalë nga shkollat 8-vjeçare, nga shkollat e mesme të arsimit të përgjithshëm ose profesional, me shkëputje nga puna, po na shtohet çdo vit në një masë shumë më të madhe se në të kaluarën. Programet mësimore që zhvillohen në këto shkolla janë rishikuar disa herë dhe po përmirësohen vazhdimisht. Në këtë drejtim, një ndihmë të mirë japin mësuesit dhe specialistët e kategorive të ndryshme, që po punojnë me të gjitha forcat për përgatitjen sistematike të të gjithë këtij kontingjenti të madh kua-dros, të cilët, pas mbarimit të studimeve, shpërndahen kudo në vendin tonë, për të punuar në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, të kulturës etj.

Por, përveç masës së madhe të nxënësve e studen-

tëve që përgatiten në shkollat e niveleve të ndryshme me shkëputje nga puna, një numër tjetër i madh punonjësish vazhdojnë mësimet pa shkëputje nga puna. Me këta të fundit mua më duket se puna na shkon më dobët. Duhet të njohim se dobësitë në këto lloj shkollash vijnë më shumë për një sërë të metash e mungesash objektive dhe subjektive. Megjithatë, ekzistojnë të gjitha kushtet që edukimi pa shkëputje nga puna i dhjetëra mijëra e më shumë punonjësve të na shkojë shumë më mirë se gjer tani. Kjo kërkon një shfrytëzim më racional të mundësive që vë në dispozicion shteti, një kujdes më të madh dhe një drejtim më konkret të punëve nga ana e organeve shtetërore dhe e ndërmarrjeve ekonomike, nga ana e organizatave të Partisë dhe e atyre të masave, si dhe nga drejtuesit e këtyre lloj shkollave. Shkaqet që nuk na shkojnë si duhet shkollat pa shkëputje nga puna, pa folur pastaj për kurset, mendoj se burimin e kanë më shumë të pakujdesitë që vihen re në këtë drejtim. Unë këtu nuk kam ndër mend të hyj në hollësi për të sqaruar se ku konsistojnë konkretisht këto pakujdesi, por dua të theksoj se punonjësit, në masë, pas punës kanë shumë dëshirë të venë në shkolla.

Komiteti Qendror i Partisë prej kohësh ka dhënë direktivën që të gjithë te ne ta zgjerojnë horizontin me kulturë të përgjithshme e profesionale dhe nga kjo direktivë nuk jemi tërhequr dhe nuk do të tërhiqemi asnjë grimë. Pajisjes me kulturë të përgjithshme dhe profesionale, pa shkëputje nga puna, në mënyrë të veçantë të kuadrove që janë në vende kyç të ekonomisë etj., ne duhet t'i kushtojmë më shumë rëndësi. Kjo

nuk do të thotë aspak që të mos tregojmë kujdes për të tjerët. Këtë Partia e ka pasur kurdoherë mirë parasysh. Kështu, para se të fillojë viti i ri shkollor, zhvillohet kudo një propagandë e gjithanshme, regjistrimet bëhen në masë dhe me një entuziazëm të madh. Mirëpo kjo punë nuk kryhet në mënyrë të studiuar dhe në bazë të nevojave e mundësive që kemi, prandaj, kur vjen çështja e zhvillimit konkretisht të kursit sipas programit, në secilën nga këto shkolla, vërehen shumë dobësi në organizim, në kontroll, në përgatitjen e dispensave, vihen re mungesa të mëdha nga ata që caktohen për të dhënë mësim, mungesa të pajustificuara të nxënësve e të studentëve në mësim, në seminare etj. Kjo ndodh se organizatat-bazë të Partisë, organet e pushtetit, organizatat e bashkimeve profesionale, ato të rinisë dhe të gruas, drejtoritë e ndërmarrjeve, si dhe vetë punonjësit që i vazhdojnë këto shkolla, këtë çështje kaq të rëndësishme ia lënë spontancitetit, gjë që tregon se nuk po i kushtojnë akoma edhe sot seriozitetin e duhur.

Atëherë, në këtë situatë, duhet ngritur çështja: Mos vallë ky uniformitet dhe zgjerim i madh i këtyre shkollave tërheq shumë preokupacionin e organizatave të Partisë, organizatave shoqërore, atyre të pushtetit dhe ndërmarrjeve ekonomike, i ngarkon ato me aq shumë punë, sa nuk u lë mundësi të merren si duhet me organizimin dhe me kontrollin e tyre, gjë që ka të bëjë me mbarëvajtjen e punës në to?

Është bërë vallë llogari ndonjëherë nëpër ndërmarrjet, ta zëmë, në një fabrikë çimentoje, ku parashikohet të paraqiten një numër mjeshtrish për të vazh-

duar shkollën ose ndonjë kurs, duke i zgjedhur këta midis disa qindra punëtorëve të saj? Dhe a i është vënë asaj detyra të ndjekë me tërë kujdesin që kërkohet se si punohet në shkollën e natës, në atë me korrespondencë apo në kursin që ndiqet nga punonjësit e saj, të cilëve shteti u bën një varg lehtësirash? (Midis të tjerash, ata gëzojnë edhe lejen e pagueshme për kohën që largohen nga puna, sipas disa kritereve të caktuara.)

Punonjësit që i ndjekin këto shkolla a e kanë të qartë se specialistët e ndryshëm që caktohen për të dhënë mësim në to, inxhinierët, mjeshtrit e kualifikuar e të tjerë, lënë mangët gjumin e natës për t'u bërë atyre leksione ose për të zhvilluar seminare jashtë orëve të punës?

I ndjekin konkretisht këto probleme organizatat-bazë të Partisë dhe të bashkimeve profesionale në qendrat e punës? Në qoftë se i ndjekin, atëherë ky problem do të ecë më mirë. Por, mua më duket se në ndërmarrje, ku drejtuesit dhe punonjësit me fjalë e pranojnë direktivën për ndjekjen e shkollës, dhe specialistët e kategorive të ndryshme tregohen të gatshëm të japin mësim, kur vjen puna për të parë konkretisht frekuentimin ose si bëhet shpjegimi i lëndëve në orët e mësimi, nëse ka dispensa e tekste etj., del se as nxënësit, as pedagogët nuk janë të gjithë në nivelin e detyrës. Shpesh vihet re që nxënësit nuk shkojnë rregullisht në shkollë, kurse pedagogët nuk kujdesen për përgatitjen e mirë dhe në kohë të dispensave ose nuk përgatiten si duhet për mësimin etj. Kështu, ajo pjesë e nxënësve që i frekuentojnë rregullisht mësimet, dalin të çalë, sepse nuk punojnë seriozisht për dije të

qëndrueshme shkencore për të cilat kemi nevojë, por për pesën që shpreh minimumin e dijeve që janë fituar për kalimin e klasës.

Këtyre të metave të punës në këto shkolla u shtohen në disa raste edhe faktorë të tjerë negativë, siç është prirja e dëmshme për t'u dukur, për t'i treguar Partisë se gjoja niveli mesatar i punëtorëve është rritur, bie fjala, nga kategoria 2,5 në 3; se punonjësit janë ngritur në kategori dhe si pasojë edhe pagat e tyre janë ngritur, plani është realizuar, normat janë tejkaluar etj. Mirëpo kur bëhet ndonjë kontroll për verifikimin e këtyre të dhënave, del se në të vërtetë punonjësit mësimin në shkollë nuk e kanë përlypur në nivelin e duhur.

Në këtë rast Partia duhet të arrijë në disa konkluzione dhe të vërë pyetjen: Gjersa planet realizohen dhe tejkalohen, normat vazhdimisht rriten, kostoja e prodhimit ulët etj., atëherë ç'na duhen gjithë këto shkolla? Rezultatet e mira dhe përparimet që vihen re në plotësimin e planit ekonomik tregojnë se shkollat janë më se të mjaftueshme. Pastaj, gjithë këta punonjës kaq të zotë në punë, përse marrin nota të ulëta në shkolla? Kjo duhet të na bëjë të mendojmë se ose shkollat që ndjekin punonjësit i kemi vërtet shumë të kualifikuara dhe e kryejnë mirë detyrën dhe, pse janë të tilla, ne arrijmë këto rezultate të kënaqshme, ose niveli i punës që zhvillohet në to është shumë i ulët. Kjo tregon se puna atje nuk shkon mirë dhe atëherë na duhet të shohim se edhe plani që na realizohet nuk është real, se ai mban shumë rezerva, ndër të cilat përfshihet edhe aftësia e kualifikimi i punëtorëve, të

cilët janë të zotë të bëjnë gjëra akoma më të mëdha, në rast se u japim një arsim dhe kulturë më të gjerë.

Partia duhet të luftojë shumë për t'u dhënë punonjësve një kulturë sa më të gjerë dhe të mos lejojë ngritje pa vend në kategori, gjë kjo me pasoja të rënda. Po çfarë të bëjmë në këtë drejtim? Siç del nga konstatimet e përgjithshme, në qoftë se punëtorët i kemi në gjendje që, edhe pa u dhënë kualifikim, t'i tejkalojnë normat në fuqi, atëherë të punojmë që t'i kualifikojmë më shumë, pse kështu do të japin rendiment më të lartë. Kjo do të shërbejë edhe për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre në tërësi, jo duke u ngritur pagat, po duke ulur çmimet e mallrave të konsumit të gjerë. Dhe në rast se do të punohet më mirë për të rrënjosur në ndërgjegjen e punëtorëve normat e reja morale dhe ideologjine e Partisë, kjo do të bëjë që punëtori i një kategorie të ulët ose mesatare nuk do të priret nga synime për anën materiale në kuptimin mikroborgjez, duke rendur pas rritjes me çdo kusht të kategorisë për të marrë më shumë. I edukuar në këtë mënyrë punëtori do të përpiqet për të kaluar në kategori më të larta me një punë serioze, sepse është i vetëdijshëm që pushteti i tij popullor, shkallët e kualifikimit i cakton në të mirën dhe interesin e klasës së tij dhe të mbarë shoqërisë sonë socialiste.

Pra, për shkollat pa shkëputje nga puna ne duhet të bëjmë kujdes të madh. Partia e ka dhënë ngaherë këtë porosi, prandaj tani nuk po them ndonjë gjë të re, vetëm dëshiroj të theksoj se në këtë drejtim të ngulim këmbë që të gjithë ata, që i ndjekin ato, të cilëve shteti u bën gjithfarë lehtësirash, këtë çështje ta

kuptojnë si një detyrë patriotike, si një detyrë politike, si një detyrë shtetërore dhe ekonomike të rëndësishme, kryerja e së cilës ka rëndësi për shtetin tonë socialist dhe për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve materiale e kulturore të vetë punëtorëve. Me gjithë prioritetin që i japim dhe akoma më shumë duhet t'i japim stimulit moral, siç na mëson Partia, as stimul material të mos e nënvleftësojmë, se edhe ky ka lidhje me zhvillimin e ekonomisë, me tejkalimin e planeve, me rritjen e rendimenteve, me uljen e koston, me kualifikimin dhe ngritjen politike të punëtorëve. Të gjitha këto bëjnë shumë efekt në politikën e Partisë, në propagandën e saj me gojë ose me shkrim, në zbatimin konkretisht dhe në mënyrë të vazhdueshme të të gjitha masave që kanë të bëjnë me arritjen e rezultateve të mira.

Edhe kurset e shumëllojshme, që janë ngritur e ngrihen vazhdimisht kudo, për kualifikimin e punëtorëve, mendoj se janë caktuar mbi baza të drejta. Por, në qoftë se ndjekjes së shkollave pa shkëputje nga puna i kemi kushtuar më pak kujdes nga sa kërkohet, duhet njohur se kurseve u kemi kushtuar akoma më pak vëmendje.

Unë nuk jam në gjendje të flas konkretisht për çdo gjë që ka lidhje me kurset, po mund të them se, ashtu si në shkollat pa shkëputje nga puna, me gjithë sukseset që kemi arritur, edhe në këtë drejtim kemi mjaft të meta, të cilat sa më parë duhet t'i ndreqim. Të kuptohemi drejt, unë nuk i mohoj aspak rezultatet e mira që kemi arritur në kualifikimin e punonjësve tanë, as faktin që format e arsimit shtetëror i

ndjekin shumë njerëz që mësojnë, gjë që ka ndihmuar në gjithë këtë përparim të madh që është arritur në vendin tonë (të mos harrojmë që zhvillimi dhe përparimi i madh nuk vijnë kurrë vetvetiu dhe sidomos nga njerëz që s'kanë kulturë). Po i përmend këto gjëra, pse Partia është kurdoherë ekzigjente dhe dëshiron që kurset e ngritura në të katër anët të japin rezultatet që priten prej tyre.

Natyrisht, punonjësit që i ndjekin këto kurse nuk shkojnë për të kënduar e për të hedhur valle, as rrinë atje duarlidhur. Përkundrazi, shumica e tyre janë plot kureshtje dhe kanë si qëllim dhe objektiv të mësojnë. Por zëlli, kureshtja e tyre për dije, varen shumë edhe nga mënyra se si zhvillohet mësimi prej atyre që janë ngarkuar me këtë detyrë, nga funksionimi i rregullt i kursit, nga drejtimi i mirë i punës së atyre që e kanë organizuar etj. Në qoftë se drejtori i një ndërmarrjeje, institucioni ose organizata angre kurse vetëm sa për t'i treguar komitetit të Partisë të rrethit ose të rajonit që ndërmarrja ose institucioni që drejton gumëzhin nga kurset, atëherë këtë punë e ka marrë lumi. Një gjë e tillë do të ishte fare formale dhe e kotë.

Një fabrikë duhet të ketë aq kurse për kualifikimin e punëtorëve të saj dhe në ato profile, lëndë e procese sa e ndien ajo nevojën të kualifikohen punëtorët e saj. Ngritja pa nevojë e më shumë kurseve, angazhon pa arsye kohën si të punëtorëve që i ndjekin, ashtu edhe të specialistëve e të teknikëve që i drejtojnë, pse, veç lodhjes fizike pas punës së ditës, ata do të lodhen ca më shumë kot e pa veed edhe nga ana intelektuale. Prandaj, nuk është e drejtë që, duke abu-

zuar në dashurinë dhe në autoritetin që gëzon Partia te punëtorët, direktivat e drejta të saj të përdoren për t'i mbajtur njerëzit ditën dhe natën nëpër salla e klasa. Drejtoritë e ndërmarreve dhe të institucioneve dhe organizatat-bazë të Partisë t'i kenë mirë parasysht të gjitha këto që thashë.

Në fillim bëra pyetjen: Në ç'drejtim duhet të ngulim këmbë ne, kur punëtorët s'kanë mbaruar shkollën 7 ose 8-vjeçare: të kërkojmë prej tyre të mbarojnë 8-vjeçaren, apo të perfeksionohen në zanat, duke ndjekur kurset tekniko-profesionale? Apo t'u kërkojmë atyre që t'i ndjekin njëkohësisht të dyja, në mos akoma edhe ndonjë shkollë apo kurs tjetër?

Mendoj se çështjen duhet ta shikojmë kështu: Kush përbën shumicën, ata që kanë mbaruar 7-vjeçaren e mëparshme dhe 8-vjeçaren aktuale, apo ata që i kanë lënë këto shkolla dhe duan të ndjekin shkollën e ulët profesionale? Nuk flas për kohën e mëparshme, kur njerëzit tanë kishin vetëm shkollën fillore, fjalën e kam për tani. Për ta sqaruar këtë çështje, le të marrim kombinatin e tekstileve «Stalin», ku ka punonjës të shumë specialiteleve dhe të të gjitha kategorive, duke filluar që nga e para e deri tek inxhinierët. Në qoftë se shkojmë nga parimi që të organizojmë atje kurse të veçanta për gjithë punëtorët dhe teknikët e të tëra kategorive, duke krijuar nga një kurs për çdo grup prej 10 vetash, siç mendohet, kësaj pune nuk është e mundur t'i dilet. Kemi ne kaq shumë pedagogë, arsimtarë, inxhinierë e të tjerë që të drejtojnë kurse të veçanta për çdo kategori punëtorësh, siç thuhet në material? Nuk do të bezdiseshin ata së tepërmi du-

ke shpjeguar lëndën në gjashtë kategori, nga e para tek e fundit? Kur bëjmë parashikime të tilla, të qëndrojmë mirë me këmbët mbi tokë, të sqarojmë më parë problemin se cilat kategori dhe njerëz janë kyç i prodhimit, kyç i organizimit dhe i drejtimit, që duhet t'i kualifikojmë patjetër. Në radhë të parë, të bëjmë përpjekje që këta t'i kualifikojmë, pse forcat tona pedagogjike s'janë të atilla sa të përballojnë me një punë të cilësisë së lartë dhe të kujdesshme këtë mori kursesh. Ata që kemi nuk janë të mjaftë për t'i dhënë gjithë kësaj mase të gjerë të punonjësve tërë ato njohuri që mendohet se mund t'i jepen.

Pra, duke u zgjeruar kaq shumë në këtë punë, as punëtorët nuk ka si kualifikohen, as kuadrot që do të jepnin mësim në këto kurse nuk do të mjaftonin. Bile, duke qenë kaq shumë të ngarkuar, ata s'do të kenë as mundësi të përgatiten. Duke vepruar kështu, punëtorët që do të vijnë të dëgjojnë në këto kurse apo edhe ata që do të japin mësim në to, nuk do të gjejnë satisfaksion në këtë punë. Prandaj, kombinati i tekstilëve «Stalin», që mora si shembull, para se të veprojë, të studiojë mirë gjendjen e punëve, të shohë se në cilat drejtime ka dobësi në punën e kualifikimit të punëtorëve të tij, që e kanë burimin në mungesën e arsimit të mjaftueshëm; në ç'drejtime këta paraqiten të dobët për mungesë të njohurive speciale profesionale etj., pastaj të vendosë për format që do të organizojë për këtë qëllim, se cilët nga punëtorët duhet të ndjekin shkollën (kur këtë s'e kanë kryer) dhe cilët duhet të ndjekin kurset. Pasi të sqarohet kjo, punohet për t'i bindur vetë punëtorët për nevojën e ndjekjes

së shkollës apo të kursit. Dhe, kur të jenë bërë të gjitha këto, merren masat organizative përkatëse e ndiqet me kujdes e vazhdimisht frekuentimi i rregullt i mësimëve e përvetësimi i thellë i tyre nga ata që janë caktuar të ndjekin shkollën ose kursin.

Në raport thuhet që ministritë t'i bëjnë programet dhe tekstet e kurseve veç e veç, sipas profileve. Tekstet që boton Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, për shkollat e ndryshme të arsimit të përgjithshëm e profesional, hartohen një herë në disa vjet nga mësuesit, pedagogët apo profesorët, kurse në ndërmarrje, për nevojat e kualifikimit të punëtorëve, këto duhet t'i bëjnë vetë inxhinierët e teknikët. Por as kjo nuk është një gjë e lehtë po të kemi parasysh se çfarë pune duhet të bëjë më parë inxhinieri në një ndërmarrje: tekstet apo të drejtojnë prodhimin? Sot, në kurse e shkolla, kërkohet një punë e cilësisë së lartë, prandaj kohën e drejtuesve të prodhimit nuk mund të mos e llogaritim. Është e vërtetë se në ndërmarrjet teknologjinë e njohin mirë kryeinxhinieri, inxhinierët dhe specialistët e tjerë, të cilët dinë më mirë se kushdo nevojat për kualifikimin e punëtorëve dhe mjeshtërve me të cilët kanë të bëjnë në punë. Ata i njohin nga afër një për një dhe janë në gjendje të thonë se cilët punojnë mirë e cilët keq. Duke qenë kështu, atyre u lakon të bëjnë edhe tekstet në format që organizohen për kualifikim në ndërmarrje dhe të përcaktojnë nivelin e dijeve të atyre që do të kërkohen të kualifikohen më tej, duke ua shtrënguar mirë rripat, me qëllim që të dalin me të vërtetë të aftë dhe ta meritojnë kategorinë e re.

Kur organizata-bazë e Partisë dhe drejtoria e këtij kombinati konstaton se ndonjë nga kuadrot me arsim të lartë, fjala vjen, një inxhinier, bën punë me cilësi të dobët, se reparti që drejton çalon në drejtim të prodhimit, e këshillon këtë të punojë individualisht për t'u kualifikuar dhe për ta zhvilluar vazhdimisht intelektin e vet nga ana teknike, duke e bindur se dituritë që ka marrë në shkollë nuk janë të mjaftueshme për punën. Disa të tjerëve, që bëjnë të njëjtën punë dhe kanë po atë profil, kur punët, gjithashtu, nuk u venë mirë në repartet që mbulojnë, u organizon një kurs të përbashkët, të specializuar, që të ecin përpara. Edhe në ato raste kur ndërmarrja konstaton se urdhrat dhe udhëzimet që jep një inxhinier i zoti kapen dhe vihen në zbatim në mënyrë të mrekullueshme nga punëtorët dhe teknikët, ajo as këtë nuk duhet ta lërë pa e mësuar më tej, pse dija dhe perfeksionimi s'kanë fund. Prandaj, organizata e Partisë duhet t'i hapë edhe këtij perspektivën. Për kuadro të tillë atje mund të ngrihet ndonjë kurs më i lartë, po jo për bujë. Në këtë rast duhet parë nëse pret apo nuk pret puna; një gjë e tillë duhet bërë menjëherë apo më vonë; kursi duhet ngritur për njohuri të përgjithshme apo për disa njohuri speciale etj. Unë them se duhet të vëmë kujdes shumë për të gjitha anët e këtij problemi që kanë të bëjnë me kualifikimin e punonjësve, se kjo ndihmon shumë në ngritjen e nivelit profesional të tyre.

Për sa u përket pagave kemi rekomanduar që këto të rishikohen, ndërsa kategorizimi i mjeshtërive dhe i punëtorëve, si dhe kriteret e ndjekjes së shkollave të mbrëmjes dhe atyre me korrespondencë, mendoj të

mbeten ato që janë sot në fuqi. Vetëm të kihet parasysh që, krahas ngritjes së nivelit teknik dhe arsimor të punonjësve, në të njëjtën kohë të rriten akoma më shumë kërkesat në provimet e kurseve dhe të shkollave. Në këtë drejtim të mos bëhen lëshime.

Për kategorizimin e punonjësve thashë që të mbajmë në fuqi këtë që kemi. Por, në dhënien e kategorisë të jemi shumë të shtrënguar. Kategoria të jepet kurdoherë vetëm në bazë të aftësive dhe të rregullave të vendosura, të cilat duhet të zbatohen me rreptësi. Nëse lind nevoja, t'u bëhen korigjime të mëtejshme. Ai që nuk është i zoti, pa mësuar s'ka përse të ngrihet në kategori. Kush nuk bën përpjekje, ta ketë të qartë se do të qëndrojë në kategoritë më të ulëta, në të parën ose shumë-shumë në të dytën, pse, për të ngritur shkallët deri në kategorinë më të lartë, punëtori duhet të luftojë e të djersijë shumë për të mësuar e për t'u kualifikuar.

Ka ikur koha tashmë kur shtetit tonë i mungonin specialistët dhe kuadrot me kulturë. Ishte tjetër situatë pas Çlirimit kur ne, të shtrënguar nga nevoja për kuadro, merrnim njerëz edhe me shkollë fillore e i bëmë mësues. Ajo gjendje e vështirë ka marrë fund, pse sot, siç dihet, mësuesit e shkollës 8-vjeçare synojmë dhe i kemi në shumicë me institut pedagogjik dyvjeçar¹. Ne kemi akoma një pjesë mësuesish me të mes-

1. Me vendim të Byrosë Politike të KQ të PPSH të qershorit të vitit 1982 aktualisht ka institute pedagogjike që përgatitin mësues për shkollat 8-vjeçare dhe të mesme si edhe Universiteti i Tiranës "Enver Hoxha".

men pedagogjike, po me kalimin e kohës numri i tyre sa vjen e zvogëlohet, pse kërkesat për kualifikimin e tyre janë vazhdimisht në rritje edhe se ata vetë bëjnë përpjekje për të rritur nivelin e tyre arsimor.

Patjetër, ai që mbaron një shkollë profesionale, është njeri i kualifikuar në degën që ka ndjekur, ndërsa ai që mbaron të mesmen pedagogjike bëhet mësues i shkollës fillore. Kur mbaron institutin e lartë pedagogjik dyvjeçar ai mund të bëhet mësues i 8-vjeçares dhe, kur kryen një fakultet në universitet, ngrihet në mësues i shkollës së mesme, e kështu me radhë. Prandaj, atij që fillon të ndjekë një shkollë profesionale, t'i themi që, kur ta kryejë këtë, do të dalë purëtor i këtij ose i atij profesioni, ashtu siç do ta vendosim. Kur të punosh e të japësh prova, do të kalosh në një kategori më të lartë, ndërsa po të mbarosh Fakultetin e Inxhinierisë, do të bëhesh inxhinier.

Tekniku i mesëm diplomën mund ta marrë edhe pa kategori, njëlloj si ata që mbarojnë shkollën e mesme të përgjithshme dhe punën ta fillojë nga kategoria e parë. Pastaj, me kohë, sipas përpjekjeve dhe aftësive, të marrë kategorinë e dytë, të tretë... e kështu me radhë. Ai që kryen shkollën e mesme profesionale, në fillim, në punë, mund të marrë kategorinë e vendit ku e vendos ndërmarrja, jo në kategori më të larta se ato ku punojnë njerëz të cilët mund të mos e kenë shkollën e mesme, por kanë një eksperiencë të gjatë shumëvjeçare. Tekniku që mbaron shkollën e mesme, kur i kushtohet profesionit e punon shumë mirë, brenda tre vjetëve është në gjendje të dalë mbi ujë dhe të ngrihet edhe në kategorinë e katërt apo edhe më të lartë.

Në kategori do të ngrihen ata që janë të mësuar dhe të kualifikuar në mjeshtërinë e tyre. Kulturën profesionale me baza punonjësi e merr në shkollë. Në qoftë se një punëtori pa shkollë i janë dashur 15 vjet që të kualifikohet, atij që mbaron shkollën do t'i duhen shumë më pak, tre ose katër vjet.

Unë jam i mendimit të mos barazohet diploma e shkollës me praktikën në prodhim për disa vjet me radhë për ata nxënës që në kohën e duhur nuk kanë treguar kujdes as vetë, as familjet e tyre, për të vazhduar shkollat, kurse në punë pretendojnë dhe luftojnë të marrin të njëjtën kategori si ata që kanë kryer një shkollë profesionale. Një ekuivalencë e tillë e diplomës me disa vjet punë praktike që bëjnë disa punonjës pa shkollë, nuk do të ishte e drejtë. Ai që dëshiron të ketë diplomën e një profesioni, le të marrë mundimin të kryejë shkollën përkatëse. Pastaj, fundi i fundit, shteti ynë socialist nuk ka shumë nevojë për ata nxënës ose nxënëse që, me gjithë kujdesin prindëror të Partisë për të marrë si të gjithë arsim, kanë mbetur nga dy e tre vjet në një klasë për faj të tyre dhe të prindërve që s'i kanë edukuar e nxitur për të mësuar seriozisht, po i kanë lejuar të futen para kohe në punë. Këta, që përbëjnë një pakicë në vendin tonë, nuk duhen barazuar në pagë dhe në kategori me shumicën dërrmuese që bën përpjekje të mëdha për të mësuar. Nuk prishet fort puna në qoftë se 5 për qind e nxënësve ose e nxënësve në të gjithë Shqipërinë nuk e mbarojnë shkollën, kur me qindra mijëra të tjerë e përfundojnë atë me sukses në sajë të një pune serioze, të vazhdueshme e plot zell. Shteti ynë, natyrisht, nuk

do t'i lërë pa punë ata të rinj e të reja që nuk mbarojnë shkollën, pse edhe këta do të punojnë, por, natyrisht, në kategori të ulëta e me pagë më të vogël se të tjerët. Ne tani duhet të luftojmë që të ndjekin e t'i kryejnë shkollat e mesme profesionale ata që kanë mbaruar shkollën 8-vjeçare.

Një çështje tjetër që duhet të kemi parasysh është edhe lufta që duhet bërë kundër prirjes së dëmshme që vihet re në punëtorët e rinj që nuk kanë dashur të mbarojnë shkollën 8-vjeçare. Këta pasi ndjekin kurset e kualifikimit të ngritura pranë ndërmarrjes, përpiqen në mënyrë jo të rregullt të përfitojnë kategori të larta. Mirëpo nuk është aspak e drejtë që, pa pasur as shkollën, as aftësitë, t'u bëjmë qejfin kot, duke i ngritur në kategori dhe, pas pak kohe, atyre që kryejnë këto kurse t'u japim edhe një «dudë tjetër» që të ngrihen në kategorinë e katërt ose të pestë. Nga këto masa të shpejtuara të ruhemi shumë. Tash ne kemi hyrë në një fazë tjetër, nuk jemi më si dikur, kur punonjësit tanë i kishim me arsim shumë të ulët dhe me kualifikim, gjithashtu, akoma më të ulët në zanate. Tani të gjithë i kemi me arsim dhe kualifikim më të lartë që po e përsosim dhe do ta përsosim vazhdimisht.

Unë nuk do të diskutoj këtu në ç'mënyrë t'i rregullojmë kategoritë dhe pagat, por e kam çështjen që të mos ngutemi për të ngritur në kategori ata që nuk e meritojnë, që nuk kanë bërë dhe vazhdojnë të mos bëjnë përpjekje për të mësuar; që lënë shkollat përgjysmë ose, kur përgatiten për provimet, mësojnë sa për të kaluar, duke u kënaqur të marrin ndonjë pesë. Prandaj pedagogët, instruktorët dhe inxhinierët të mos

i mbyllin sytë para elementëve të tillë, duke u lëshuar si pa gjë të keq nota kaluese, në kurset dhe në shkollat profesionale, atyre që nuk e meritojnë, që nuk punojnë me zell e këmbëngulje për t'u kualifikuar. Një qëndrim i tillë liberal do të thotë të inkurajosh dembelët e parazitët, të shtosh radhët e punonjësve me njerëz të pa aftë. Kjo pjesë e vogël e të rinjve punëtorë që lejojnë të përfitojë kategori pa kritere të shëndosha, do të pretendojë duke thënë se vërtet nuk e ka mbaruar shkollën 8-vjeçare, po arsimiti që merret në këtë lloj shkolle, asaj i është njohur me atestim, pas kryerjes së shkollës së ulët profesionale. Prandaj, sipas atyre, kategorinë e tretë ose të katërt që mbajnë, e kanë fituar me «përpjekje», kurse në fakt pa derdhur hiç djersë.

Një qëndrim i tillë nuk do të jetë i drejtë ndaj masës së madhe të atyre të rinjve e të rejave që mbarojnë shkollën e mesme profesionale, të cilët do ta fillojnë punën në kategori më të ulëta se ata që nuk e kanë mbaruar këtë shkollë. Përkundrazi, ndaj atyre që nuk mbarojnë shkollat përkatëse, që nuk dëgjojnë këshillat e Partisë, që nuk punojnë si gjithë shokët, të merren masa që, kur të futen në punë, të ngrihen me shumë ngadalësi në kategori, pas përpjekjesh serioze në mësim dhe në profesion, pra, kur ta meritojnë. Ekonomia socialiste ka me qindra mijëra të tjerë që çajnë përpara. Prandaj, kushdo që i bën bisht mësimi, të mos ia rritim vlerën, të mos ia shtojmë «meritat» pa mbaruar shkollën apo pa pasur kualifikimin e nevojshëm. Kështu, duke u nisur nga këto konsiderata për shkollën, ta shikojmë dhe ta vlerësojmë në këtë çështje, sipas mendimit tim, pse në këtë mënyrë do të ndi-

kojmë që të ngrihet më lart kualifikimi i punëtorëve.

Kur një punëtor që nuk ka mbaruar 8-vjeçaren dhe në punë ka mbetur në vend, në rast se dëshiron të ngrihet në kategori, le të vazhdojë shkollën 8-vjeçare e, pasi të mbarojë atë. po të ketë vullnet, le të mbarojë edhe shkollën e mesme profesionale dhe, si të plotësojë normën, të marrë kategorinë e dytë, të tretë ose të katërt, në bazë të orientimeve që ka dhënë Byroja Politike për këto çështje. Në të ardhmen të kihet kujdes që një i ri ose e re në moshë 15-16 vjeç. që s'ka as 8-vjeçare dhe asnjë kualifikim në punë, të mos marrë përnjëherësh pagë sa ai tjetri që i ka këto. Nuk duhet me qenë zemërgjerë në këto çështje.

Është një gjë shumë e mirë që masa e punëtorëve të rinj ecën në rrugën e drejtë të Partisë. Rinia jonë po bën kudo mrekulli. Por më kanë thënë se ka nga ata (që sigurisht janë të paktë në numër), që bëjnë shumë mungesa në punë. Kjo ndodh më shumë me ata të rinj që kanë në marrëdhënie pune disa pjesëtarë të familjes. Prandaj, ca nga ajo që u paguhet puna më shumë nga sa u takon, ca nga ajo që nuk kanë detyrime familjare, gjykojnë me mendjehetësi se ndërmarrrja nuk ka ndonjë qeder, po të flenë deri në orët e vona të mëngjesit, ose nganjëherë, të mungojnë në punë edhe dy-tri ditë me radhë. Duke vepruar kështu ata bëhen shembull i keq për të tjerët, dëmtojnë edhe prodhimin, prandaj këtë pjesë të vogël të masës së të rinjve të përpiqemi ta edukojmë, ta ndreqim, duke i vënë për detyrë që të ndjekë rregullisht edhe shkollën.

Mjeshtërve të moshës 40 vjeç e më shumë, që i ikemi me fillore ose 8-vjeçare, të mos u kërkojmë de-

tyrimisht të vazhdojnë shkollën. Këtyre t'u këshillojmë më shumë të punojnë individualisht për t'u pajisur me kulturë të përgjithshme e sidomos profesionale. Ndryshe shtrohet çështja me djemtë e vajzat e reja. Këta kanë tërë jetën përpara, prandaj t'i nxitim që të punojnë për të zhvilluar intelektin e tyre, t'u kërkojmë sidomos të ndjekin dhe të mbarojnë shkolla e kurse. Edhe në rast se një vajzë e re s'e mbaron, fundi s'bëhet ndonjë gjë e madhe; do ta bëjë edhe ajo një punë, po nuk do të arrijë dot më shumë se në kategorinë e tretë, kështu që do të marrë më pak të ardhura se shoqet e saj që kanë mësuar dhe punojnë mirë. Po një-rëzit tanë ne duhet t'i edukojmë, në radhë të parë, që problemin të mos e shohin në prizmin e interesit të ngushtë personal, po në interes të popullit, të ndërtimit të socializmit, prandaj t'i nxitim që përpjekjet për të mësuar e për t'u kualifikuar, t'i bëjnë me një ndër-gjegje të lartë politike, pse kështu do t'i japin sho-qërisë më shumë.

Kisha edhe një vërejtje për raportet që i paraqiten Byrosë Politike, Sekretariatit të Komitetit Qendror ose Qeverisë, ku trajtohen çështje të përgjithshme, për të cilat janë të interesuar organet shtetërore të Partisë, si dhe organizatat e masave. Problemet që u shtrohen forumeve të Partisë e të shtetit në këto raporte duhet të paraqiten me konkluzione dhe detyra të përbashkëta. E them këtë për arsye se pas paraqitjes së këtij materiali nga shokët e Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale, nga ana e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë na u dhanë një sërë sugjerimesh të tjera. Të tilla mendime e propozime sigurisht mund të kenë

edhe shokët e rinisë, të gruas etj., po këto është mirë të paraqiten të përbashkëta, sa më të shkurtra dhe me propozime konkrete.

Kur marrim në analizë dhe rishikojmë probleme të tilla kaq të rëndësishme, siç është problemi i kualifikimit në punë, nuk duhet të preokupohen vetëm bashkimet profesionale që kanë përgjegjësi dhe detyrë të merren me edukimin e punonjësve, por edhe organet dhe organizatat e Partisë e të masave, pa përjashtuar ato shtetërore dhe ekonomike.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

KUNDËR SHFAQJEVE TË PSIKOLOGJISË MIKROBORGJEZE TË LUFTOJME FRONTALISHT NË TË GJITHA DREJTIMET

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 janar 1972

*Përpara se të diskutohej për këtë problem, në
rendin e ditës së mbledhjes së Sekretariatit të KQ,
ishin edhe dy pika të tjera; kështu që shokëve të ftuar
me këtë rast, nga rrethet, u duhej të pritnin sa të mba-
ronte diskutimi i tyre. Por, duke hapur mbledhjen,
shoku Enver Hoxha tha:*

Shokët e ftuar për dy pikat e para kanë ardhur në
mbledhje. kurse ata të rinisë që kemi ftuar për pikën

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth raporteve të paraqitura nga Komiteti Qendror i BRPSH dhe komitetet e Partisë të rretheve të Vlorës e të Shkodrës për lëvizjen e rinisë «Të përsosim figurën morale në luftë kundër shfaqjeve të psikologjisë mikroborgjeze», si dhe u dëgjuan informacionet që dhanë sekretarët e organizatave të rinisë të Kantierit Detar të Durrësit, të Shkollës së Mesme të Gjuhëve të Huaja të Tiranës dhe të kooperativës bujqësore të Vashtëmisë të rrethit të Korçës.

e tretë, po presin në një sallë tjetër. Unë mendoj të vij në këtu edhe ata, që të dëgjojnë, të na gjykojnë e të na vënë «notën» për mënyrën si i shqyrtojmë ne problemet. Duke i lënë jashtë këta të rinj e të reja që kemi ftuar, do të kujtojnë se kushedi sa vështirë do ta kenë kur t'u vijë radha që të analizohet çështja e tyre. Prandaj, që të mos «torturohen» duke pritur, propozoj t'i thërresim edhe ata. Jeni dakord shokë të Sekretariatit?

Të gjithë u shprehën dakord me propozimin e shokut Enver.

Pastaj shokët e rinisë, të ftuar për pikën e tretë, u futën në mbledhje. Shoku Enver Hoxha, pasi përshëndetet me ta, u thotë:

Ne, shokët e Sekretariatit të Komitetit Qendror, vendosëm t'ju thërresim edhe ju shokë të rinisë gjatë kësaj mbledhjeje, para se t'ju vinte radha, si zakonisht, sipas rendit të ditës, në mënyrë që gjatë diskutimeve ne të përfitojmë ca nga ju, po edhe ju të përfitoni diçka nga ne. Vendosëm të mos ju linim, gjithashtu, që të pritnit në dhomën tjetër, si të thuash, si para provimit, pse, duke menduar që s'keni ardhur ndonjëherë në raport përpara Sekretariatit të Komitetit Qendror, gjatë pritjes, do të qëndronit të shqetësuar, duke kujtuar se kushedi ç'do të bëhej kur t'ju vinte radha e si do të dilnit nga ky takim. Unë ju them qysh tash se puna juaj do të dalë shumë mirë, veç dëgjoni edhe këto që do të themi ne. Ndonjë mrekulli, sigurisht, nuk do të nxjerrim, po, pasi të informoheni për zhvillimin e mbledhjes, na vini më në fund «notën» që na takon.

Ne, shoqe dhe shokë të rinisë, si çështje të parë në rendin e ditës kemi disa probleme të ngritjes tekni-

ko-profesionale të punëtorëve, domethënë shkollat dhe kurset e ndryshme që organizohen kudo në vendin tonë. Këtë raport për të cilin do të diskutojmë sot se si na shkojnë punët dhe ç'masa duhet të marrim për të ardhmen, na e kanë paraqitur shokët e Bashkimeve Profesionale.

Pasi u diskutuan dy çështjet e tjera, shoku Enver Hoxha tha:

Fillojmë me pikën e tretë të rendit të ditës. Fjalëntani e kanë shoqet dhe shokët e rinisë që marrin pjesë në këtë mbledhje.

Pastaj folën me radhë shokët e ftuar në mbledhje. Kur po fliste shoqja Adriana Fishta, sekretare e komitetit të rinisë të Shkollës së Gjuhëve të Huaja në Tiranë, shoku Enver Hoxha e pyeti:

— Çfarë gjuhe mëson ti?

SHOQJA ADRIANA FISHTA: Unë mësoj anglisht.

SHOKU ENVER HOXHA: Pa na fol një herë anglisht.

SHOQJA ADRIANA FISHTA: Çfarë të them, shoku Enver, lidhur me raportimin apo diçka tjetër?

SHOKU ENVER HOXHA: Diskuto, për shembull, për një problem, lidhur me këto që fole.

SHOQJA ADRIANA FISHTA: Nuk e di nëse do të jetë nevoja ta përkthej pastaj në shqip?

SHOKU ENVER HOXHA: (qesh) Jo nuk është nevoja se ne kuptojmë diçka.

Shoqja Adriana Fishta diskuton anglisht...

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë bukur! Faleminderit. Shumë mirë, shumë korrekt fole!

Pasi diskutuan edhe shokë të tjerë, shoku Enver Hoxha tha:

Dëshiroj t'u them të rinjve e të rejave që kemi ftuar në këtë mbledhje, se çështjen e luftës kundër psikologjisë mikroborgjeze rinia e ka kapur mirë. Ky është një problem me rëndësi të madhe jetike për gjithë vendin tonë, për Partinë, për klasën punëtore, rininë, gruan, me një fjalë, për gjithë njerëzit e Republikës sonë Popullore. Për këtë çështje është folur edhe në kapitullin e katërt të raportit të Kongresit të 6-të, ku bëhet fjalë për formimin e njeriut tonë të ri, për edukimin marksist-leninist, për përsosjen e figurës morale të tij etj. Lufta jonë në këtë drejtim duhet të përqendrohet kundër të gjitha shfaqjeve dhe mbeturinave mikroborgjeze për të përfecuar e për të rrënjosur te njerëzit tanë cilësitë më të mira, normat e moralit tonë proletar.

Çështja që po shqyrtojmë është një problem i madh, për zgjidhjen e të cilit nuk duhet të luftojmë vetëm me parulla, por në një fushë shumë më të gjerë. Parulla¹ që ka zgjedhur rinia, lidhur me luftën kundër psikologjisë mikroborgjeze, është e drejtë, por ne kemi edhe parulla të tjera që duken ca si të përgjithshme, po që në vetvete përmbledhin objektiva të cilët Partia i ka parasysh për edukimin e punonjësve. Si të tillë kemi, për shembull, parullën: «Të mendojmë, të punojmë dhe të jetojmë si revolucionarë», që është dhe duhet të jetë një moto e madhe për të gjithë, pse,

1. Është fjala për parullën: «Të përsosim figurën morale në luftë me shfaqjet e psikologjisë mikroborgjeze».

po ta zbërthejmë e ta thellojmë në përmbajtjen e saj të shumanshme, në të përfshihen të gjitha çështjet.

Iniciativa e marrë nga organizata e rinisë në lidhje me luftën kundër psikologjisë mikroborgjeze të mos kuptohet sikur është një specifikë e punës së saj¹. Kjo është, në radhë të parë, një specifikë e punës së Partisë, e klasës punëtore. Jam i bindur se edhe ju kështu e merrni këtë çështje dhe kështu duhet ta kuptojë edhe vetë Partia. Luftën që po bëni kundër psikologjisë mikroborgjeze, ju e quani lëvizje dhe mendoj se nuk bëni gabim që e quani të tillë, por të keni parasysh që ajo të mos jetë një flakë kashte, po një ortek i madh vazhdimisht në rritje. Ajo të mos shuhet kurrë, pse lidhet me luftën që bën Partia për formimin e njeriut të ri.

Partia, veçanërisht, të mos i konsiderojë lëvizjet e këtij lloji si karakteristika të punës së rinisë. As klasa punëtore nuk duhet ta mendojë kështu këtë çështje. Nuk duhet të ekzistojë pikëpamja se ne, anëtarët e Partisë dhe klasa punëtore, kemi përpara për të zgjidhur probleme të tjera. më të thella e të një niveli më të lartë politik dhe ideologjik, prandaj lëvizje si kjo që po diskutojmë duhet t'i marrë përsipër rinia. Në qoftë se këto probleme të mëdha shoqërore Partia i trajton dhe i redukton si iniciativa që rinia i zhvillon për formimin e vetvetes, ajo bën gabim, bile gabim të madh, pse në fakt ato kanë rëndësi për kalitjen e të gjithëve dhe jo vetëm të rinisë.

1. Lëvizjen «Për një sjellje të kulturuar e vënien e Interesit të përgjithshëm mbi atë personal» e morën të parat organizatat e rinisë të rrethit të Vlorës e të Shkodrës.

Në rast se Partia nuk bëhet iniciatore e këtyre lëvizjeve që merr rinia, do të thotë se ka një të metë të madhe në punën e saj, të cilën duhet ta njohë dhe ta vërë sa më parë në rrugë. Nuk është çështja që Partia vetëm sa ta njohë këtë të metë dhe të mjaftohet duke inkurajuar organizatën e fuqishme të rinisë të ecë përpara në luftën që ka filluar kundër mbeturinave apo psikologjisë mikroborgjeze ose kundër ndikimeve të huaja kapitaliste, revizioniste etj., por të futet edhe vetë dhe ta udhëheqë këtë lëvizje të gjerë që po ndërmerr rinia.

Partia duhet të reflektojë e të vlerësojë nëse është vallë e mjaftueshme në shkallë kombëtare kjo formë pune që po zhvillohet në luftën kundër mbeturinave mikroborgjeze? Është e mjaftueshme kjo metodë pune që po zbaton ajo vetë për shpjegimin politiko-ideologjik të veprimeve dhe lëvizjeve konkrete që po ndërmerr rinia? Është e mjaftueshme puna politiko-ideologjike e organizatave-bazë ose e komiteteve të Partisë për të rrënjosur jo vetëm në anëtarët e Partisë, por në të gjithë anëtarët e organizatave të masave nga ana politike dhe ideologjike parimet që ka shtruar Kongresi? Apo mos ecet me një rutinë në përpunimin e problemeve politiko-teorike të Partisë sonë, duke mos i lidhur këto sa duhet me jetën? Organizata e rinisë neve na jep një shembull të mirë në këtë drejtim. Atëherë si Parti një shembull të tillë ta kapim dhe ta çojmë edhe më përpara. Po në ç'mënyrë? Ta kapim në mënyrë që këtë forcë të madhe të rinisë, këtë shembull pozitiv të saj, ta ndihmojmë që të zhvillohet e të thellohet më tej.

Kur organizata e rinisë bën mbledhje, në të cilat merr në diskutim probleme të veçanta që i ngrenë elementët e saj më të dalluar, si për shembull për disiplinën proletare, qoftë në shkolla, në kantiere etj., atëherë organizata e Partisë të dërgojë atje një nga shokët më të ngritur nga ana teorike, të cilit t'i rekomandojë që, pasi të bëhen debate, pasi të flasim gjerë e gjatë anëtarët më të shquar e më aktivë të organizatës së rinisë, të ngrihet edhe ky anëtar partie i përgatitur mirë teorikisht dhe ta trajtojë nga ana teorike ç'do të thotë disiplinë proletare jo vetëm në lidhje me respektimin e orarit në punë, por të nxjerrë konkluzione të thella për këtë problem.

Po pse t'i nxjerrë këto konkluzione ky shok i Partisë në këto mbledhje kaq të rëndësishme të rinisë për këtë problem preokupant? Në radhë të parë, që këtë ushtri, këtë forcë të madhe të rinisë, Partia ta hedhë në mënyrë të ndërgjegjshme të luftojë edhe jashtë «mureve» të organizatës së vet, jashtë shkollës, kantierit, kooperativës e kudo, kundër shkeljeve të disiplinës, për të cilat shpesh reagohet me zë të ulët.

Lufta kundër mbeturinave mikroborgjeze të bëhet në mënyrë të organizuar në mbledhjen e organizatës së rinisë. Kur të flitet nga ana teorike për disiplinën proletare në punë, ta zëmë në Shkollën e Gjuhëve të Huaja (e mora këtë si shembull meqë kemi këtu sekretaren e organizatës së rinisë të këtij institucioni), në mënyrë të organizuar, ne do të kemi rrënjosur kështu në kokën e të rinjve dhe të të rejave të kësaj organizate se si duhet kuptuar dhe si duhet luftuar nga ana e tyre për këtë çështje, kundër kujt do qoftë. Kur i riu

ose e reja, që merr pjesë në këtë lëvizje, vë re se ndonjëri simulon, i bën bisht punës në ndërmarje, në kooperativë etj., duke qenë i edukuar me frymë revolucionare, në organizatë reagon, mban qëndrim. Sjellja e huaj ndaj punës bie në kundërshtim me ato që ai ka mësuar, prandaj, duke pasur të qartë se për çështjen e Partisë, të popullit dhe të socializmit nuk duhen mbajtur hatëre, pa u druajtur fare, i bën thirrje simulantit të mos gënjejë, po të shkojë menjëherë në punë, se nuk ka gjë. Anëtarët e organizatës së rinisë, të edukuar me mësimet e Partisë, duhet të luftojnë nga të katër anët, në familje, në shkollë, në punë, kudo ku janë të pranishëm, në mbledhje të organizatave të Frontit, të bashkimeve profesionale etj., kudo ku rrihen një mijë e një probleme, ekonomike dhe joekonomike.

Te njerëzit tanë vërehen edhe disa shfaqje të tjera të huaja për shoqërinë tonë socialiste. Ka tipa që gënjejnë, që shtiren si të sëmurë, që mbajnë mëri me njëri-tjetrin, merren me thashetheme, bëjnë hatërellëqe, fshehin mallra nën banak etj. Kundër këtyre duhet luftuar frontalisht, në të gjitha drejtimet. Në këtë luftë që bën rinia, pozitive është se, duke goditur shfaqjet e huaja mikroborgjeze, ajo kalitet për vete dhe përgatitet siç bën ushtria, që e mëson ushtarin të bëhet i aftë për të sulmuar me sukses armikun nga çdo anë që t'i vijë. Edhe rinia kështu vepron. Tani ajo është hedhur në sulm, fjala vjen, për vënien në jetë të disiplinës proletare, nesër, kur në këtë drejtim të jenë bërë hapa përpara. do të marrë iniciativën për të luftuar gënjeshtren ose indiferentizmin, pasnesër për një

problem tjetër e kështu me radhë. Në këtë mënyrë ajo mësohet të luftojë e organizuar.

Gjatë jetës së përditshme, kudo ku paraqitet nevoja, jo vetëm në familje, po edhe në shkollë, në fabrikë, me një fjalë kudo ku njerëzit jetojnë, punojnë, diskutojnë e veprojnë dhe ku duken shfaqje të huaja, qëndrime të padrejta, të dëmshme, të papajtueshme me vijën e Partisë, i riu dhe e reja edhe po të qëllojë që të jenë vetëm në ndonjë rast, të mos thyhen, po të mbajnë qëndrim, të ndërhyjnë, të sqarojnë dhe të kërkojnë me këmbëngulje që të veprohet drejt. Këtu qëndron e gjithë forca dhe kuptimi i këtyre lëvizjeve, këtu synon lufta që bëjnë për formimin e njeriut tonë të ri. Anëtarë i organizatës së rinisë edhe shokut më të ngushtë, kur e sheh që s'është në rregull e nuk vepron drejt, në mënyrë shoqërore dhe hapur t'ia thotë mendimin pikërisht se e ka shok prej kohësh dhe e do e të mos ia mbulojë kurrë ndonjë gabim ose të metë që konstaton tek ai, duke i treguar njëkohësisht rrugën për të ndrequr gabimin apo për të korrigjuar të metën për të mirën e përbashkët dhe të tijën. Në qoftë se ai që ka gabuar, me gjithë këshillat shoqërore nuk ndreqet, atëherë t'ia ngrejë këto pa druajtje para të gjithëve, në mbledhje të kolektivit, të repartit, të brigadës etj.

Të rejat e të rinjtë tanë revolucionarë, që kanë marrë të tilla iniciativa e që janë të gatshëm të marrin të tjera si këto, qëndrojnë në pararojë dhe përbëjnë një forcë të madhe ndihmëse të Partisë. Ata, së bashku me komunistët, kudo nëpër mbledhjet që bëhen, në punë dhe në shoqëri, janë si ajo koka e varesë që rreh me forcë çdo gjë të huaj e dobësi që vërteto-

het. Në çdo rast të tillë rinia duhet të marrë pjesë aktive, të flasë, të luftojë dhe të godasë pa druajtje çdo shfaqje negative. Këtë kërkon Partia prej saj.

Të rinjtë dhe të rejat në kritikën e tyre të mos kufizohen vetëm duke folur me parime e në vija të përgjithshme, por të luftojnë edhe konkretisht, pa frikë, natyrisht, me pjekuri kundër cilitdo që nuk është në rregull me direktivat e Partisë dhe të mos kufizohen vetëm në çështjet e realizimit të planit. Partia kurdoherë duhet të mendojë që të futë si me thënë një maja, një ferment revolucionar atje ku punët nuk shkojnë mirë, dhe të arrijë që, në shembullin e saj, në shembullin e çdo komunisti, të veprojë edhe anëtarin i organizatës së rinisë ose të gruas, për të mos folur për klasën punëtore që duhet të jetë maja e heshtës.

Partia në asnjë rast të mos tregojë mungesë interesi, ose të japë një aprovim thjesht patriarkal, nga pozita prindërore, duke shprehur vetëm pëlqimin ose mospëlqimin për një iniciativë ose diçka tjetër të mirë që ndërmerr rinia. Nuk është aspak e mjaftueshme që Partia t'i thotë rinisë se ka vepruar mirë ose jo për një aksion apo iniciativë që ka marrë, pse ky do të ishte një qëndrim paternalist, ajo të futet edhe vetë brenda në këtë iniciativë dhe jo vetëm kaq, por këto iniciativa Partia t'i përdorë si ferment gjallërues.

Vazhdimisht Partia ka ngritur problemin e futjes së gjakut të ri në gjirin e saj dhe për këtë çështje jetike prej kohësh janë vendosur rregullat që dihen. Por kjo është vetëm njëra anë e problemit. Krahas futjes së elementëve të rinj, në Parti duhet të depërtojnë edhe pikëpamje të reja, të pastra, luftarake, revolu-

cionare, sepse në organizatat e saj bazë ose në komitetet e Partisë ekzistojnë aty-këtu edhe pikëpamje të vjetra, kundër të cilave duhet luftuar me vendosmëri që të spastrohen. Atëherë sa të presim ne që të pranohet në Parti, sipas rregullave të vendosura, një i ri aktiv e me pikëpamje revolucionare, si shoku¹ i rinisë i Vashtëmisë që na foli këtu, bëhet tepër vonë. Mund të ndodhë që ndonjë organizatë-bazë partie të mbajë qëndrime shumë sektare në pranimet, duke frenuar të rejat e të rinjtë të futen në Parti, po, për të depërtuar mendimet e reja revolucionare, ne mund të përdorim të gjitha format, të marrim masat që të zhduket çdo pengesë. Një organizatë-bazë përkohësisht mund ta pengojë një element të ri aktiv, luftarak që të mos futet në Parti, po kur bëhet mbledhja e asamblesë së kooperativës, ajo s'e pengon dot të flasë, se atje kushdo ka të drejtë të hedhë mendime, askush nuk mund ta ndalojë për këtë. Të rinjtë e të rejat që përbëjnë forcën më të gjallë të Partisë, edhe pse janë të paorganizuar në Parti, në fakt ata janë të Partisë, pse bëjnë pjesë në organizatën e rinisë që drejtohet dhe frymëzohet nga Partia. Ata marrin pjesë kudo në aksione të guximshme, bëjnë nga 300 apo 400 ditë-punë në kooperativa etj. Këta, në mbledhjet e gjera që bëhen, kanë plotësisht të drejtë të flasin dhe të zhveshin shpatën e kritikës kundër mbeturinave në punë, në jetë, në shoqëri e në familje nga kushdo që i ka, qoftë ky edhe anëtar partie.

1. Nasibi Agolli, në atë kohë sekretar i komitetit të rinisë të Kooperativës Bujqësore të Bashkuar të Vashtëmisë, Korçë.

Iniciativat tuaja, shokë të rinisë, kanë rëndësi shumë të madhe dhe kontribuojnë për përsosjen e figurës morale, për edukimin e njeriut tonë të ri. Këto iniciativa revolucionare, që keni ndërmarrë ju, janë për t'u lavdëruar, por mos harroni se drurët e këtij pylli të madh jemi të gjithë së bashku, ju dhe ne, prandaj kryesorja në gjithë këtë punë është edukimi jo vetëm i të rinjve, por i të gjithë njerëzve të shoqërisë sonë.

Iniciativat e rëndësishme që keni filluar janë një vazhdim i gjithë punës që ju kanë mësuar të bëni Partia dhe organizata juaj e rinisë. Në këto çështje ju jeni frymëzuar edhe nga mësimet e Kongresit të Partisë. I trajtoni e i zhvillonin më tej, në gjithë larminë e tyre, këto lëvizje të mëdha me qëllim që vetë ju, në radhë të parë, të kaliteni ideologjikisht dhe politikisht, dhe kalitja ideologjike dhe politike do t'ju bëjë luftëtarë të shquar të Partisë, pavarësisht se nuk jeni në Parti dhe këtë e keni të qartë, pasi nuk është e mundur që gjithë masa e rinisë të jetë në Parti.

Në edukimin ideopolitik të njerëzve tanë, në radhë të parë, të të rinjve e të të rejave, janë arritur suksese të mëdha, por na mbetet të bëjmë akoma shumë në këtë drejtim. Ne duhet të luftojmë që punën politike, ideologjike dhe edukative, që ka bërë dhe vazhdon të bëjë Partia, ta ngremë në një nivel akoma më të lartë e shembullor, sepse rreziqet janë të mëdha, rreziqe të jashtme që e kanë burimin te presioni i ideologjisë borgjeze e revizioniste, por edhe rreziqe të brendshme, që e kanë burimin te mbeturinat që ekzistojnë akoma në ndërgjegjen e njerëzve tanë.

Mbeturinat, shokë, asnjëherë të mos i nënvleftësoj-

më, asnjëherë të mos kënaqemi me rezultatet që kemi arritur në luftën kundër tyre, sado të mëdha që të jenë ato. Kjo na vë detyrën të punojmë pa u lodhur për të kalitur më tej ndërgjegjen politiko-ideologjike të njerëzve, pse vërtet shumica e tyre ecën në rrugën e Partisë, por në masë ka edhe elementë jo të kalitur, jo shumë të bindur, kështu që një situatë sadopak e vështirë ata i lëkund. Partia dëshiron të mos lëkundet njeri, prandaj të punohet që edhe ndonjë pakicë që mund të jetë në këto pozita, të futet në rrugë të drejtë.

Partia të jetë kurdoherë modeste, të përpiqet të përfitojë edhe nga lëvizjet revolucionare të rinisë, duke pasur parasysh se anëtarët e kësaj organizate i ka edukuar dhe i edukon vetë, se ata janë të saj.

Partia na këshillon vazhdimisht të mësojmë nga eksperiencia e njerëzve pararojë, të mësojmë sidomos nga eksperiencia e organizatave të rinisë dhe këtë ta kombinojmë, të bëjmë një gërshetim të drejtë të saj me metodën e punës së Partisë për edukimin politiko-ideologjik të masave dhe për realizimet ekonomike.

Të gjithë ne, shokët e Sekretariatit të Komitetit Qendror, jemi të një mendimi se lëvizje të tilla duhet të ndërmerren edhe në të ardhmen nga rinia, të vazhdohen ato në shkallë të gjerë dhe të mbështeten fuqimisht nga Partia.

Është shumë pozitive kur shikojmë rrugën e drejtë të marksiste-leniniste nëpër të cilën ka ecur dhe vazhdon të ecë Partia dhe shteti ynë socialist, në krahasim me tragjedinë që po ngjet sot në vendet revizioniste. Kjo tregon sa e drejtë ka qenë dhe është vija e Partisë sonë.

Në vendin tonë lëvizjet revolucionare rinia i ka kapur drejt, prandaj ta thellojmë më tej këtë punë, se e kemi filluar mirë. Mundësi të mëdha janë krijuar tani te ne për këtë qëllim. Të gjithë i dëgjuam të dyja vajzat dhe të riun e Vashtëmisë, që diskutuan sot para Sekretariatit të Komitetit Qendror, sa lirisht dhe me ç'logjikë të fortë folën. Me tërë mend ata na kënaqën me diskutimet e tyre plot vrull rinor revolucionar. Të themi të drejtën jo të gjithë ne, në kohën kur ishim në moshën e tyre, kemi qenë në gjendje të diskutojmë aq lirshëm si diskutuan këta. Dhe më e bukura është të diskutosh anglisht siç bëri, me kërkesën tonë, shoqja e rinisë e Shkollës së Gjuhëve të Huaja. Një gjë e tillë do të ishte akoma më e vështirë për ne në atë kohë.

Kjo tregon se Partia ka edukuar një rini të mrekullueshme, revolucionare, që ecën në rrugën e drejtë që i tregon ajo. Kjo përbën një garanci të madhe për të ardhmen e atdheut.

Botuar për herë të parë me ndonjë shkurtim në librin Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1972-1973», f. 5, Tiranë 1974

Botohet i plotë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH. që gjendet në AQP

PROPAGANDA E PRODHIMIT TË KETË KARAKTER EDUKUES, MOBILIZUES DHE TË PËRHAPE EKSPERIENCËN E PËRPARUAR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

28 janar 1972

Jam dakord me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që bënë shokët. Me këtë rast desha të theksoj vetëm disa probleme lidhur me propagandën e prodhimit. Shokët e Partisë, duke filluar nga ata të komiteteve të Partisë të rretheve dhe deri në ndërmarrjet ekonomike e kooperativat bujqësore, në mënyrë të veçantë ata të bazës, duhet ta zgjerojnë konceptin mbi propagandën e prodhimit, të mos e ngushtojnë këtë ose t'i japin frymën e reklamës. Propaganda e prodhimit, në kuptimin që i ka dhënë Partia, në asnjë mënyrë nuk duhet të ketë frymë reklame, por të ketë për synim shpjegimin e problemeve që preokupojnë organi-

1. Në këtë mbledhje u diskutua mbi masat e marra për përmirësimin e propagandës së prodhimit dhe të emulacionit socialist për plotësimin dhe tejkalimin e planit të vitit 1972.

zatën e Partisë në ndërmarrje, në kooperativë e kudo, t'ua bëjë punonjësve tanë çështjet të qarta e të kuptueshme për t'i bindur e për t'i edukuar ata dhe për t'i vënë në lëvizje për zbatimin në praktikë të vijës së Partisë. Ajo ka për synim të studiojë dhe të përhapë eksperiencën e përparuar. Propaganda për reklamë nuk është e dobishme për ne, prandaj të largohemi prej saj.

Parullat, ashtu siç nxirren në mjaft raste me fraza të përgjithshme, nuk na mësojnë shumë gjëra, më duket mua. Sot ato nxirren më shumë mekanikisht, ngarkohen dy-tre njerëz për të parë dokumentet e Partisë, vendimet e saj ose raportet tona dhe për të gjetur në to një sërë parullash. Por edhe kjo punë nuk bëhet kurdoherë mirë, bile shpeshherë parullat nxirren shumë keq.

Është thënë edhe herë tjetër se shokët që merren me këtë punë nuk po tregohen të aftë për të përcaktuar drejt se cilat parulla duhen nxjerrë për propagandimin e vijës së Partisë në politikë, në ekonomi, si dhe në edukimin e njeriut tonë të ri të pajisur me virtyte të larta dhe me normat e moralit komunist. Ata herë-herë lëshojnë disa slogane që kthehen në parulla stereotipe, të njëllota, të papërshtatshme me kohën dhe me detyrat që dalin përpara për zbatimin e vendimeve të Kongresit të Partisë. Mendimi im është se një gjë e tillë ndodh për faktin se kjo detyrë me rëndësi u lihet disa njerëzve që janë marrë dhe vazhdojnë të merren me gjetje sloganesh, që i lëshojnë edhe në shtypin tonë. Deri në «Zërin e popullit» gjen parulla të pagoditura, të cilat pastaj merren nga lexue-

sit si direktiva të Partisë dhe përdoren, sepse në pamjen e jashtme të lënë përshtypjen sikur kanë dalë nga sektorët e propagandës të Komitetit Qendror. Nuk jam që të mos nxirren parulla, por nga raportet të merren dhe të nxirren, bile të plota, ato pjesë për të cilat Kongresi vë detyra kyç të caktuara.

Nuk mjafton pastaj që propaganda e Partisë të kufizohet në nxjerrjen e parullave nga raportet. Këto pasqyrojnë orientimet e Kongresit, prandaj për përmbajtjen e tyre duhet të zhvillohet në çdo sektor një propagandë e gjithanshme, të zbërthehen detyrat anekënd ndërmarrjeve, kooperativave, shkollave e kudo ku punohet e luftohet, në mënyrë që çdo punonjës të ketë të qartë ç'kërkon Partia nga ai, ç'duhet të bëjë për ta vënë materialisht në jetë direktivën për të cilën bëhet fjalë në raport. Një gjë e tillë nuk bëhet kurdoherë, prandaj në ndërmarrjet e kooperativat tona shohim më shumë parulla të përgjithshme.

Mos vallë ne duhet të luftojmë për të mbushur muret e qendrave të punës apo gazetatat me çfarëdolloj parullash? Të kemi kujdes që parullat që nxirren, t'u përshtaten objektivave tanë, kohës dhe asaj që synojmë të arrijmë. Prandaj vendosja e një parulle duhet të bëhet e menduar mirë, pse mbi bazën e saj do të mobilizohen punonjësit, teknikët, specialistët, punëtorët e dalluar të prodhimit etj. Mbi bazën e saj do të punojnë, gjithashtu, propagandistët, do të organizohen debate, diskutime, referate etj. lidhur me luftën që duhet bërë për ta vënë atë në jetë.

Çështja tjetër, më duket mua, është ajo që duhet bërë njëfarë dallimi për përgjegjësinë që kanë në këtë

drejtim dikasteret qendrore dhe organet e pushtetit e të ekonomisë në bazë. Sot situatat në vendin tonë kanë ndryshuar shumë me të kaluarën, prandaj nuk mund t'u hidhet i tërë faj ministrive për të gjitha të metat që vihen re në drejtim të propagandës së prodhimit. Natyrisht, edhe dikasteret qendrore, kur të kenë faj, asnjëherë nuk do t'i kursejmë, edhe ato do t'i ngarkojmë me përgjegjësi për moskryerjen e detyrave të ngarkuara, po ama edhe të mos kërkojmë prej tyre diçka që duhet dhe i ka mundësitë t'i bëjë baza. Në vitet e para të Çlirimit, kur bazën e kishim akoma shumë të dobët, kur asaj çdo gjë duhej t'ia jepnim si me «biberon» dhe kuadrot i kishim me nivel të ulët, ministritë i ngarkonim vërtet për çdo gjë dhe u kërkonim shumë edhe për këtë çështje.

Tani s'jemi më si atëherë. Në të katër anët në bazë kemi një mori të madhe kuadrosh e specialistësh me dije të gjera e me eksperiencë, të cilët punojnë e drejtojnë me zotësi në gjithë sektorët e vendit, prandaj, nën drejtimin e organizatave-bazë, ata janë të aftë të punojnë vetë për propagandimin e vijës së Partisë në qendrat e punës. Edhe eksperiencia e njerëzve tanë është rritur, edhe punët tona sot janë zgjeruar së tepërmi, prandaj në kushtet e reja të krijuara s'është më e nevojshme dhe as e mundur që organet qendrore të përqendrojnë në duart e tyre çdo gjë. Si rrjedhim, ministritë tani janë ngarkuar me shumë detyra, bile të mëdha, kështu që s'ka më arsye të merren me ato punë që baza sot është fare mirë në gjendje t'i kryejë vetë. Në qoftë se, për shembull, nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave kërkojmë sot që ajo të formulojë ma-

sat që duhet të marrë fabrika e shkrepes për kursimin e lëndës së drurit, që të dalë me fitim, duke u futur në shpjegime e udhëzime të hollësishme deri edhe si të pritët lënda e drurit për këtë qëllim etj., atëherë vaj halli me një praktikë të tillë! Kjo në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar dhe në këtë drejtim duhet të godasë propaganda jonë.

Këto që thashë janë gjëra të vogla, që duhet dhe është në gjendje t'i kryejë fare mirë vetë baza, po ka edhe gjëra të tjera më të mëdha që ndërmarrjet tona janë në gjendje t'i kryejnë me mundësitë e veta. Në qoftë se punëtorët, inxhinierët, ekonomistët, gjithë specialistët dhe kuadrot e Uzinës së Traktorëve, për shembull, nuk mendojnë vetë për parullat që duhen nxjerrë nga materialet e Partisë për kursimet, atëherë kolektivi i kësaj ndërmarrjeje nuk e ka kryer detyrën e vet. Për të vënë në jetë ligjet e shtetit tonë dhe vendimet e Qeverisë për këtë çështje kaq të rëndësishme, punonjësit e kësaj uzine duhet të mendohen thellë e të organizojnë debate, kontrole, të heqin parullat të cilave u ka kaluar aktualiteti dhe t'i zëvendësojnë ato me të reja të përshtatshme etj., duke hequr dorë nga mbushja e ambienteve me parulla të përgjithshme për mbarë vendin ose edhe për rrethin. Ndërmarrja që mora si shembull i ka fare mirë mundësitë të ngarkojë njerëzit e saj më të përparuar të thellohen e të gjejnë zgjidhjen e këtyre problemeve. Po të veprojnë kështu të gjitha ndërmarrjet industriale, atëherë Ministria e Industrisë dhe e Minierave, duke qenë e lehtësuar, do të ketë kohë të mendojë për të përgjithësuar eksperiencën e ndërmarrjeve më të mira, që është detyra

e saj dhe jo të merret me propagandën konkrete që duhet bërë në çdo ndërmarrje të veçantë.

Ministritë kanë në këtë drejtim edhe detyra të tjera të mëdha. Ato kanë, për shembull, për detyrë të marrin mirë në dorë çështjen e përgatitjes së kuadrove në shkolla. Sigurisht kjo çështje është nën drejtimin e Qeverisë, të Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, të dikasterit përkatës etj., që përgatitin materialet, të cilat janë bazë e gjithë propagandës që zhvillohet në to, sipas programeve të aprovuara. Për probleme të tilla Qeveria dhe ministritë që varen prej saj tregojnë interesim të madh, pse kanë përgjegjësi për to, pavarësisht se përgjegjësi mbajnë edhe drejtoritë e shkollave, seksionet e arsimit, komitetet e Partisë në rrethe etj.

Ministritë kanë pastaj përgjegjësinë tjetër që, duke u mbështetur në vendimet e udhëzimet në fuqi, të shkruajnë në shtyp artikuj përgjithësues, të nxjerrin konkluzione e të bëjnë botime në të gjitha fushat e veprimtarisë së tyre etj., etj., me anë të të cilave i vijnë në ndihmë bazës.

Për të gjitha vendimet e udhëzimet që kanë dalë dhe dalin, të cilat kanë një rëndësi të madhe shkencore e parimore, nuk mund të themi se nuk ekzistojnë te ne botime në një shkallë pak a shumë të mjaftueshme. E keqja është se nuk shfrytëzohet si duhet gjithë kjo mori e madhe botimesh që shpërndajmë. Prandaj na vihet detyrë të bëjmë një kthesë të fortë në këtë drejtim. Çështja është që Partia të punojë me njerëz me qëllim që librat, broshurat, revistat e gazetatat që botohen e shpërndahen në bazë, cilido të mësohet t'i lexojë

me laps në dorë për punën e vet. Kooperativisti ose punëtori, kur del një libër ose broshurë që i intereson, mund të vejë ta blejë atë në librari dhe në qoftë se nuk e gjen se është shitur, atëherë le të vejë ta shfletojë në bibliotekë. Rëndësi ka që gjatë studimit secili të nxjerrë shënimet që i duhen dhe detyra, jo vetëm për vete, po për t'i propaganduar ato edhe në të tjerët. Kështu mund dhe duhet të veprohet për propagandimin e përmbajtjes së librave, broshurave e botimeve të ndryshme që nxjerrim. Dëshirat për të pasur më shumë botime janë të mira dhe mundësitë për të botuar më shumë se gjer tani prapë t'i shikojmë, po veç të shikojmë edhe anën tjetër, bile me kujdes të madh, që ato që botojmë, baza t'i shfrytëzojë mirë, si duhet.

Që propaganda e prodhimit të ketë karakter edukues, mobilizues e kontrollues ajo duhet të bëhet mirë në bazë, prandaj të mobilizohen edhe më tepër për këtë qëllim njerëzit e bazës. Partia t'i shkundë ata që ta kuptojnë drejt këtë çështje, që lidhet absolutisht me realizimin konkret të planeve të shtetit.

Sikurse e kemi thënë herë të tjera, kjo çështje, në radhë të parë, duhet të kuptohet politikisht. Kjo do të thotë që në çdo punë propaganda duhet të paraprijë, prandaj për zgjidhjen e çdo problemi që del, baza të mos presë sa t'i venë njerëz nga dikasteri.

Ministria e Bujqësisë, fjala vjen, ka për detyrë të studiojë hibridet dhe ne jemi dakord që ajo ta bëjë një gjë të tillë, se është detyra e saj, por të mos arrihet në konkluzionin e shpejtuar, siç bënë disa shokë, sikur misri hibrid i gjeneracionit të dytë në vendin tonë pas-ka dështuar. Shoku i Peshkopisë na tha këtu se kalliri

i misrit hibrid nuk u poq në rrethin e tij. Po kush na siguron se në të gjitha kooperativat e këtij rrethi është punuar me një agroteknikë të përsosur, siç e kërkon kultivimi i farës hibride të misrit. Për këtë asnjëri nuk beson, sepse kemi pasur edhe raste të tjera që ndryshe na është raportuar, ndërsa nuk ka dalë ashtu kur çështja është studiuar në vend. Kjo vjen se kudo jo vetëm në rrethe, por edhe te ne, ka të meta.

Detyrat kryesore, që drejt na i cakton Partia, janë të mundshme të realizohen dhe në vija të përgjithshme ato zbatohen. Edhe studimet e bëra dhe përpjekjet që kërkohen për t'i vënë ato në jetë, nuk kanë munguar, vetëm se niveli dhe mënyra e përpjekjeve nga një vend në tjetrin ndryshojnë dhe në këtë drejtim ka shumë boshllëqe e dobësi. Prandaj, ajo që u tha se në rrethin e Peshkopisë ose në një rreth tjetër misri nuk u poq, se u tha etj., duhet studiuar me hollësi për të gjetur nga se erdhi, për të parë nëse janë zbatuar me përpikëri të gjitha metodat agroteknike etj. dhe jo të arrihet kaq shpejt në konkluzionin se fara hibride nuk bën në vendin tonë. As vetëm për një rreth ne nuk mund të dalim me një konkluzion të tillë, pa studiuar në mënyrë të hollësishme shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në mospjekjen e misrit të farës hibride. Prandaj unë jam dakord që të mos heqim dorë nga hibridet, pse nuk mund t'i besojmë përnjëherësh, në mënyrë automatike, pikëpamjes së kundërt që u hodh për këtë farë misri. Një gjë të tillë e kemi pësuar edhe me pambukun dhe me disa bimë të tjera. Për të renë, me dashje ose pa dashje, ekziston fryma e konservatorizmit, për arsye se e reja, sù pari, kërkon për-

pjekje për ta kuptuar, për ta studiuar, pastaj kërkon zbatimin në mënyrë të përsosur të kërkesave të shkencës dhe në rastin konkret, në bujqësi, të rregullave agroteknike, sidomos për hibridet. Konkluzioni për t'i dhënë shpejt, brenda një viti, shkelmin një ndërmarrjeje kaq shumë të vlefshme, siç është ajo e mbjelljes së farërave hibride, me një rëndësi të madhe për të ardhmen e bujqësisë sonë, është shumë i gabuar, nuk mund të pranohet.

Po ju sjell një shembull të freskët që ka lidhje me këtë çështje. Ka disa vjet që ne nuk po realizojmë rendimentin e planifikuar për pambukun. Për këtë na është thënë se nuk bën fara dhe shumë arsye të tjera. Duke u nisur nga këto arsyetime për një moment vumë pyetjen, duhet të vazhdojmë të mbjellim pambuk, gjersa për disa vjet me radhë nuk po marrim rendimentet e parashikuara? Është kaq e lehtë për ne të vendosim që të mos mbjellim pambuk? Në fakt, pas një studimi të kujdesshëm që bëri Ministria e Bujqësisë u zbuluan shumë të meta që provojnë se fajin nuk e kishte as fara e pambukut, as koha, pavarësisht se edhe këto luajnë rolin e tyre në çështjen e rendimentit. Kjo do të thotë se po t'ia bëjmë pambukut të gjitha shërbimet agroteknike dhe po të luftojmë në mënyrë konsekuente në këtë drejtim, rendimenti i planifikuar mund të realizohet në kushtet e vendit tonë, se dihet që ne nuk kemi planifikuar rendimente jashtë mundësive. Kështu është dhe për farën e misrit hibrid. Prandaj të kemi kujdes, të mos shpejtohem në këto çështje. Para se të hedhim një parullë, të kemi verifikuar mirë çdo veprim tonin.

Që t'i zgjidhim mirë këto probleme, propaganda jonë duhet të ketë karakterin që theksova. Është nevoja të heqim dorë nga format e huaja të propagandës që kanë lënë gjurmët e tyre në punën tonë. Ekziston akoma mentaliteti që mjafton të ngjitim shpejt e shpejt parullën në një copë beze të kuqe apo mureve, të lëshojmë slogane dhe me kaq, puna mbaroi. Jo, parullat që nxjerrim janë direktiva për zbatim; ato nuk vihen si diçka për bukuri, po që t'u shërbejnë punonjësve, të cilët të përqendrohen fort në to për realizimin e detyrave. Duhet punuar pastaj që ato të shërbejnë edhe si objekt për konferenca e debate.

Propaganda duhet të merret edhe me popullarizimin e eksperiencës së përparuar. Ministrinë nuk është e mundur të merren me shpërndarjen e eksperiencës së përparuar të të gjithë njerëzve të shquar të vendit që në fakt zhvillohet në një larmi të madhe. Midis tyre ministrinë mund të zgjedhin, të përgjithësojnë dhe të shpërndajnë më të mirat që mund t'u vlejné të gjithëve, natyrisht duke pasur kujdes që as këto të mos i përjetësojnë, pse jeta ecën përpara, zhvillohet, prandaj edhe ato kohë pas kohe duhen zëvendësuar me të tjera, të reja e më përparimtare. As nuk duhet pritur që eksperiencia gjithnjë të merret vetëm jashtë rrethit.

Drejt u tha këtu përse kooperativistët kërkojnë të venë gjetkë për të mësuar, kur shumë herë eksperiencën e përparuar e kanë brenda në kooperativë? Përse nuk e marrin ata eksperiencën e mirë të shokut të kooperativës së tyre? Kjo është e çuditshme! Në këtë çështje të gjithë duhet të reflektojnë, sepse një qën-

drim i tillë nënvleftësues tregon se te punonjësit tanë ekziston pikëpamja sipas proverbit të vjetër «Nuk mund të jesh kurrë profet në vendin tënd». Përse e përçmojnë në fshat eksperiencën e një kooperativisti të dalluar, po këtë kërkojnë ta marrin nga një rreth tjetër? Kjo nuk është gjë tjetër veçse përpjekje për të mos lëvizur nga e vjetra. Shembulli i atij njeriu që merr 40 quintalë misër për hektar e që punon në kooperativë, pra, në derën e shtëpisë, pse të mos përhapet, në radhë të parë, aty brenda, duke mobilizuar kooperativistët që të punojnë të gjithë si ai, që është vëllai i tyre dhe punon me të njëjtat mjete si edhe ata e në atë tokë që punojnë të tërë? Në këtë rast s'është aspak me vend të mbahen sytë për të marrë eksperiencë jashtë kooperativës.

Gjëra të tilla duhet t'i kapë dhe t'i bëjë problem organizata-bazë dhe komiteti i Partisë t'i mbështetë e t'i përhapë në gjithë rrethin. Ministria mund të dërgojë një përgjithësim për një çështje të caktuar që u vlen të gjithëve, po jo të mendojë për të gjitha gjërat. Në këtë drejtim shumë duhet të punojë edhe shtypi.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

LIGJET TË INTERPRETOHEN E TË ZBATOHEN NË MËNYRË REVOLUCIONARE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor¹*

4 shkurt 1972

Raporti që i paraqitet Presidiumit të Kuvendit Popullor ka një qëllim të mirë dhe konstaton të meta që ekzistojnë realisht, por mendoj që, kur merren në analizë probleme të tilla, të përqendrohemi në çështjet më të rëndësishme, sepse në këtë mënyrë mund të nxjerrim konkluzione më të drejta dhe mund të japim një ndihmë konkrete për zbatimin e ligjshmërisë socialiste. Shpërndarja në shumë probleme të zbatimit të ligjshmërisë siç janë: kriminaliteti, marrëdhëniet e punës, trajtimi i invalidëve, vjelja e kredive të shtetit, konfliktet për banesën midis bashkëshortëve të shkurorëzuar, pensionet ushqimore, zbatimi i drejtë i kompetencave, bashkërendimi i punëve midis organeve të pushtetit dhe organeve të tjera etj., etj. më duket se

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth raportit «Mbi disa probleme të ligjshmërisë në rrethin e Tiranës».

nuk ndihmon sa duhet për t'u kapur pas hallkave kryesore të gjendjes së ligjshmërisë në rrethin e Tiranës.

Unë do të isha i mendimit të na raportohej në Presidium jo për zbatimin e ligjshmërisë në tërësi, që është një sferë shumë e gjerë e veprimtarisë së shtetit, por për një ose disa drejtime të caktuara të saj që janë karakteristike për rrethin e Tiranës, siç mund të jenë, ta zëmë, zbatimi i drejtë i kompetencave nga këshillat popullorë dhe komitetet e tyre ekzekutive, ndonjë problem tjetër për fshatin etj. Në raste të tilla, në qoftë se Presidiumi do ta gjykonte me vend, mund të dilte edhe me rekomandime për Partinë ose për Qeverinë lidhur me ndonjë çështje të rëndësishme.

Duhet të njohim se në punën që bëhet për zbatimin e ligjshmërisë socialiste kemi korrur suksese të mëdha, prandaj kur bëjmë një raport ose analizë, sukseset nuk duhet të errësohen dhe të mos qëmtohen vetëm të metat, as të nënvleftësohen gabimet, por situata të paraqitet realisht, ashtu siç është. Me këtë nuk dua të them aspak se të metat që paraqiten në raport nuk ekzistojnë. Përkundrazi, ato ekzistojnë, por dëshiroj të theksoj që në vlerësimin e raportit të sukseseve dhe të të metave të jemi sa më objektivë dhe realistë, me qëllim që të dalim me konkluzione të sakta dhe të përcaktojmë detyra konkrete. Legjislacioni ynë shpreh dhe mbron interesat e diktaturës së proletariatit dhe përshkohet thellësisht nga ideologjia jonë marksiste-leniniste, prandaj ai është i drejtë dhe zbatohet vullnetarisht nga masat punonjëse, mirëpo kjo nuk do të thotë se ligjet, me dashje ose pa dashje, nuk

shkelen nga shtetasit, punonjës apo dhe drejtues të veçantë.

Lufta e klasave, si fenomen objektiv, i domosdoshëm dhe i pashmangshëm, shprehet edhe në fushën e së drejtës, së cilës, në një formë ose në një tjetër, i kundërvihen disa njerëz. Ata që shkelin ligjet, siç e ka thënë vazhdimisht Partia, nuk janë vetëm armiq të e popullit, por edhe njerëzit tanë që, për shumë arsye, kanë mbeturina të huaja në ndërgjegjen e tyre. Arsyet e shkeljes së ligjeve janë të ndryshme. Shpeshherë njerëzit i shkelin ligjet nga mosnjohja e tyre, mbasi nuk është e mundur të jenë të tërë juristë dhe t'i kenë parasysh mirë dispozitat e një urdhërese ose të një ligji. Ngandonjëherë ndodh që edhe drejtorët e ndërmarrjeve shtetërore shkelin disa vendime apo urdhëresa të Qeverisë, si ato për sigurimin dhe për sistemimin e fuqisë punëtore, për riaftësimin dhe për sistemimin në punë të invalidëve etj., duke rënë në këtë mënyrë në kundërshtim joantagonist me shtetin e tyre. Faje dhe gabime do të bëhen. Këto mund të jenë të vogla ose të mëdha të shkaktuara me dashje ose nga pakujdesia. Por varet nga njeriu që shkel ligjin, nga rrethanat ku ai vepron, nga qëndrimi që mban gjatë dhe pas shkeljes së vërtetuar etj. për të gjykuar pastaj sa më drejt me cilin kemi të bëjmë dhe ç'qëndrim duhet të mbajmë ndaj tij. Shkaqet e shkeljes së ligjit, veç të tjerash, duhen kërkuar edhe në vjetrimin në disa raste të tyre, të cilat mbeten pa u ndryshuar vetëm nga rutina e organeve shtetërore, nga ngathtësia e tyre dhe nga mosnjohja si duhet e situatës së re të krijuar.

Në kundërshtim me praktikën e vendeve borgje-

ze, ku vazhdojnë të jenë në fuqi ligje të vjetra si Kodi i Napoleonit etj., ligjet tona revolucionare nuk janë të përhershme e të pandryshueshme. Gjatë procesit të zhvillimit të shoqërisë socialiste disa ligje, dekrete, vendime, urdhëresa etj., që kanë pasqyruar etapa të kapërcyera, vjen koha dhe nuk u përgjigjen më kushteve të reja, ato, si të thuash, vjetrohen, kështu lind nevoja e rishikimit dhe e zëvendësimit të tyre me norma juridike të reja. Në qoftë se ligjet tona nuk do t'i ndryshonim në përshtatje me kushtet e reja që krijohen, ato, në vend që t'i shërbejnë zhvillimit të shoqërisë, pengojnë ecjen e saj përpara dhe shpien në burokratizëm. Jeta jonë shkon vazhdimisht përpara, prandaj edhe ndonjë ligj, ndonjë vendim apo ndonjë urdhëresë që ka hyrë në fuqi, qoftë edhe një ose dy vjet më parë, duhet të ndryshohet në rast se jeta e dikton një gjë të tillë. Por nuk e kanë fajin ligjet, që një kryetar kooperative bujqësore, për shembull, me një nivel të ulët ideopolitik, i infektuar nga mbeturina të dëmshme të së kaluarës, nën ndikimin e tyre sillt si bajraktar, duke mos përfillur as opinionin e mbledhjes së përgjithshme dhe vendimet e saj. Një njeri i tillë mund të arrijë deri edhe sa të shesë bagëti dhe, në rastin më të keq, të hollat e realizuara nga shitja e tyre t'i përvetësojë, duke u përpjekur të shpëtojë nga ndjekja penale me një «autokritikë». Pa u futur në hollësi dhe pa u kënaqur me konstatime, ne duhet të thellohemi, për të gjetur plotësisht shkaqet e shkeljeve të ligjit nga ndërmarret, punonjësit apo shtetasit dhe mbi këtë bazë pastaj të ndërtojmë punën propagandistike apo të marrim masat organizative për

parandalimin e tyre. Te ne, për të gabuar më pak, secili duhet të veprojë në mënyrë revolucionare dhe me frymën e Partisë. Ai që shkel ligjin me dashje dhe nuk i ndreq fajet ose gabimet e tij, edhe sikur të rrjedhë nga klasa në fuqi, bëhet kundërshtar i klasës së vet. Megjithëkëtë mendoj që kur flasim për shkeljen e ligjit të kemi parasysh atë çka është thelbësore dhe atë çka është formale. Ky dallim duhet bërë për të çmuar drejt shkallën e shkeljes së ligjit dhe pasojat e ardhura prej kësaj shkeljeje. Në rast se, për shembull, komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit disa nga kompetencat e veta ua ka kaluar komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të lagjeve, sipas rregullave të vendosura, sepse këtë ia diktojnë nevojat e jetës, zhvillimi e zgjerimi i mëtejshëm i punëve etj., kjo do të thotë se është koha të mendojmë që disa nga këto kompetenca të pushtetit në rreth t'u kalohen instancave më të ulëta, duke përligjur kështu atë praktikë të drejtë që e afirmon jeta.

Çështja e zgjerimit të kompetencave të këshillave popullorë është një problem i vazhdueshëm, që nuk zgjidhet dot me një vit, pse lyp një kohë të gjatë, pasi për zbatimin e drejtë të kompetencave kërkohet me-
doemos, më parë se çdo gjë tjetër, edukimi ideologjik i njerëzve. Sado të jenë përcaktuar mirë me ligj kompetencat e këshillave popullorë, kjo nuk është e mjaftë, po qe se njerëzit në bazë nuk janë edukuar t'i zbatojnë ato me partishmëri. Zbatimi me partishmëri e në mënyrë të ndërgjegjshme i ligjshmërisë socialiste kërkon para së gjithash formimin e njeriut të ri komunist me virtyte të larta, objektiv ky që nuk arrihet

as me një vit, as me pesë vjet, as edhe me pesëdhjetë vjet, po kërkon një luftë të gjatë e përpjekje të vazhdueshme, është, pra, një detyrë e përhershme e Partisë.

Në shkeljet e ligjit mund të ketë dhe shkaqe të tjera, siç janë, për shembull, dhe rastet e interpretimit e zbatimit mekanik, *a la lettre* të tij. Në këto gabime e shkelje bien jo vetëm komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të hallkave të ndryshme dhe organet ekonomike, por edhe vetë gjykatat, si organe të posaçme për dhënien e drejtësisë. Ato ka raste që i shkelin ligjet, duke bërë gabime në cilësimin ligjor të veprës që formon krim, duke zbatuar gabim ligjin për një marrëdhënie juridike civile, ose duke caktuar dënime më të rënda o më të lehta nga ç'duhet. Gjyqtarët janë të ndërgjegjshëm për zbatimin e përpiktë të ligjeve, po ata edhe mund të gabojnë në rast se nuk thellohen kurdoherë sa duhet, sidomos në kuptimin ideopolitik të përmbajtjes së ligjit, pa folur për ndonjë influencim të padrejtë që mund t'u bëhet. Për të gabuar më pak, e përsëris, është e domosdoshme të zbatohet drejt vija e Partisë.

Çfarë thotë Partia? Ajo na mëson që ligjet të interpretohen e të zbatohen me frymë revolucionare, duke pasur parasysh kohën kur kanë hyrë në fuqi, sferën e marrëdhënieve që rregullojnë ato, kushtet e zhvillimit tonë ekonomik, politik, shoqëror, kulturor etj. Të jemi realistë, njerëzit nuk është e mundur të jenë të tërë me një nivel të barabartë politik, ideologjik e kulturor, që t'i kuptojnë e t'i njohin mirë ligjet. Prandaj është nevoja të luftohet dhe të punohet në

shumë drejtime e forma që ligjet më parë të njihen, pastaj të zbatohen drejt sipas mësimëve të Partisë. Kujdesi për zbatimin e përpiktë të ligjeve duhet të bëhet edukatë për gjithë qytetarët tanë. Në këtë drejtim detyra të rëndësishme kanë organet e Partisë, organet shtetërore e të ekonomisë nga qendra në bazë.

Në analizën e gjendjes së ligjshmërisë duhet bërë kujdes që të mos merren pozicione të njëanshme, duke gjykuar se qytetarëve nga ana e organeve të pushtetit, të administratës dhe të ekonomisë në rreth po u shkelen ose po u mohohen të drejtat e njohura me ligj. Të mos mendojmë se individit kurdoherë ka të drejtë, pse jeta provon edhe të kundërtën. Të drejtat duhen parë të lidhura ngushtë edhe me detyrat. Njerëzit, kush më shumë e kush më pak, nuk janë të zhveshur nga mbeturinat mikroborgjeze, prandaj aty-këtu duket prirja e disave për të përfituar atë që nuk u përket, për t'i kundërvënë interesin e ngushtë personal interesit të përgjithshëm, për të fshehur gabimet ose fajet e veta, për të paraqitur si «të drejtë» atë që në të vërtetë është krejt e shtrembër etj. Kështu mund të shpjegohet këmbëngulja e disa punonjësve për t'u kthyer përsëri me punë në Tiranë ose në disa qytete të tjera, ku banonin para se të dënoheshin për krime të rënda në dëm të pasurisë socialiste etj. Këta ankojnë me paturpësi se «u mohohet e drejta e punës» në një kohë që fronte pune ka sa të duash në atdheun tonë, por ata nuk duan të venë. Shoqëria nuk është e detyruar t'u rezervojë punët e mëparshme të tillë njerëzve që me veprime të fajshme ngritën dorën kundër saj. Ky qëndrim i shoqërisë nuk është aspak

i padrejtë, përkundrazi, ai është mjaft i arsyeshëm dhe i matur. I padrejtë është qëndrimi që mbajnë ndaj punës këta persona.

Ka edhe ndonjë rast kur nuk respektohen të drejtat e grave shtatzëna ose të drejta të tjera të ligjshme të qytetarëve. Partia ka luftuar dhe lufton vazhdimisht kundër rrezikut të burokratizimit të aparateve, kundër praktikave për vlerësimin e çështjeve me syrin e zyrtarit apo të profesionistit apolitik, që frenon pjesëmarrjen e gjallë e të drejtpërdrejtë të masave në qeverisjen e vendit dhe nuk përfill të drejtat e punonjësve, prandaj shfaqjet e kësaj natyre nuk duhet të quhen pa rëndësi, por të konstatohen me kohë dhe të merren masa për ndreqjen e të metave.

Qëndrimet dhe veprimet e gabuara në zbatimin e ligjeve, si të individëve të veçantë, ashtu edhe të aparateve, nuk duhen nënvleftësuar, pse çdo pakujdesi në këto drejtime do të ishte tepër e rrezikshme për rendin tonë shtetëror dhe shoqëror.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH, që gjendet në AQP

DEMAGOGJISË SË REVIZIONISTËVE I BËHET BALLË DUKE U BAZUAR NË PARIMET MARKSISTE-LENINISTE

*Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste
Peruane¹*

7 shkurt 1972

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se erdhët shoku Paredes! Si jeni me shëndet? Ne kemi dashuri dhe ushqejmë një mirënjohje të thellë për partitë marksiste-leniniste të vendeve të Amerikës Latine dhe veçanërisht për Partinë Komuniste marksiste-leniniste Peruane, si dhe për ju, shoku Paredes, që jeni një anëtar dhe udhëheqës i shquar i saj. Respekti dhe simpatia jonë për partinë tuaj janë të mëdha, prandaj ardhjen tuaj në Kongresin e 6-të të Partisë sonë e konsiderojmë një ndihmë të madhe. Edhe në të ardhmen ne do të ndjekim me vëmendje të veçantë luftën revolucionare marksiste-leniniste të partisë suaj dhe do të përpiqemi të mësojmë sa më shumë nga ekspe-

1. Ky delegacion kryesohej nga shoku Saturnino Paredes Macedo, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste Peruane.

riencia e saj. Natyrisht, ne kemi përfituar edhe nga lidhjet që kemi pasur gjer tani, por e kemi për detyrë të bëjmë akoma përpjekje që kontaktet me njëritjetrin t'i kemi më të shpeshta. Në këtë drejtim, aktualisht, janë krijuar disa mundësi për të mbajtur lidhje të ngushta me partitë motra të Amerikës Latine, për të qenë më afër njëra-tjetrës.

Duke iu përgjigjur pyetjes që i bëri shoku Enver Hoxha se si e kaloi me udhëtimin në Kinë, fjalën e mori:

SHOKU SATURNINO PAREDES: Mirë. Programi që na u përgatit atje ishte mjaft i ngjeshur. Megjithatë kryesorja është se misionin që më ngarkoi partia, e kreu. Unë bisedova në mënyrë të sigurtë me shokët kinezë dhe nga bisedat që bëmë bashkërisht doli se kemi ndryshim mendimesh për disa probleme. Por kjo nuk na pengon ta vazhdojmë miqësinë e përbashkët revolucionare.

SHOKU ENVER HOXHA: Të gjitha përpjekjet dhe lufta jonë tani drejtohen në ruajtjen fort të parimeve marksiste-leniniste, në demaskimin dhe në mposhtjen e imperializmit botëror, me atë amerikan në krye, dhe të të gjithë atyre që e mbështetin atë. Me të njëjtën forcë luftojmë ne për të demaskuar e për të mposhtur edhe revizionizmin modern, me atë sovjetik në krye.

Siç e shtruan qartë në Kongresin tonë të 6-të dhe siç e pohoni edhe ju vetë në dokumentet e partisë suaj, me të cilat ne jemi plotësisht dakord, revizionizmi modern, me atë sovjetik në krye, përbën sot një rrezik të madh për lëvizjen komuniste botërore.

Për të luftuar marksizëm-leninizmin, për të dobësuar lëvizjen revolucionare, revizionistët modernë kanë krijuar një situatë të mjegullt në botë, po bëjnë kudo demagogji, së cilës mund t'i bëhet ballë vetëm duke u bazuar fort në parimet marksiste-leniniste dhe duke luftuar pa zigzage, në mënyrë revolucionare. Ata që vetë bëjnë lëshime në parime, luftën parimore që bëjmë ne kundër revizionistëve modernë e quajnë «majtizëm», kurse ne na quajnë «majtistë», me qëllim që të heqim dorë nga parimet. Por qëndrimet tona nuk janë aspak «majtizëm». Vija jonë marksiste u duket atyre e tillë, pasi ata e shikojnë atë me gjyslykë revizionistë. Rruga e tyre është oportuniste, liberale e revizioniste e theksuar.

Po të ruajmë fort dhe në mënyrë revolucionare parimet dhe po të luftojmë për zbatimin e tyre në jetë pa bërë lëshime, do të dimë të bëjmë gjithmonë politikë të drejtë. Kjo ka rëndësi të madhe për të gjithë ne, edhe për një parti marksiste-leniniste që është në fuqi, edhe për ato që nuk janë akoma në fuqi.

Partitë marksiste-leniniste që janë në fuqi, siç është, për shembull, Partia jonë, nuk mund të rrëshqasin në batakun e oportunizmit nën maskën e njëfarë politike shtetërore gjoja të nevojshme me shtetet imperialiste apo revizioniste, mbasi politika jonë shtetërore, politika e një shteti socialist, bazohet e duhet të bazohet kurdoherë në parimet marksiste-leniniste.

Partia dhe shteti ynë këtë çështje e kanë pasur kurdoherë parasysh gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së tyre. Ata i kanë qëndruar besnikë miqësisë me shtetet e tjera, me shtetet më të mëdha, bile shumë

më të mëdha se vendi ynë, siç ka qenë Bashkimi Sovjetik, e kanë ruajtur fort këtë miqësi derisa këto shtete kanë qëndruar në pozita të drejta marksiste-leniniste. Por kur këto kanë rrëshqitur nga pozitrat revolucionare dhe kanë kaluar në revizionizëm, Partia dhe shteti ynë i kanë kundërshtuar, pavarësisht se ishin shtete të mëdha dhe pa marrë parasysh se dëmet që do të na shkaktoheshin mund të ishin shumë të mëdha e me rreziqe për Republikën Popullore të Shqipërisë. Po të kishim rënë në batakun revizionist, siç ranë, për shembull, Jugosllavia e Titos ose Bashkimi Sovjetik, atëherë Republika Popullore e Shqipërisë do të kishte mbaruar dhe ajo do të ishte shndërruar prej kohësh në një vend kapitalist. Pikërisht pse jemi mbështetur fort në parimet e marksizëm-leninizmit dhe kemi qëndruar të patundur në pozitrat tona të drejta, ne kemi mundur që qysh më parë të ishim të bindur se armiqve, cilëtdo që të ishin ata, do t'u rezistojmë dhe, në fakt, jeta vërtetoi se u rezistojmë me sukses.

Partia jonë nuk mashtrohet nga koniunkturat. Këto ajo i studion me kujdes dhe përpiqet t'i shfrytëzojë, por kurrë në kurriz të parimeve, të interesave të Republikës Popullore të Shqipërisë, të interesave të komunizmit ndërkombëtar e të revolucionit. Partia jonë mendon se të gjithë këta interesa duhet të mbahen mirë parasysh dhe të balancohen. Në rast të kundërt, për atë që nuk i ka parasysh vihet pyetja: «Ç'rrugë ndjek, rrugën e vërtetë marksiste-leniniste apo rrugën oportuniste e revizioniste?». Kështu e shtroi çështjen Partia jonë kur u zbulua tradhtia jugosllave. Në atë

kohë, në Bashkimin Sovjetik ishte në fuqi Partia Bolshevike, jetonte Stalini dhe të gjithë i dinë qëndrimet tona. Më vonë, kur pushtetin në Bashkimin Sovjetik e uzurpuan revizionistët, ne u vumë në kundërshtim me klikën tradhtare të N. Hrushovit. Natyrisht, ky kundërshtim u zhvillua gradualisht e duke u rritur, ai u theksua akoma më shumë kur Hrushovi dhe pasuesit e tij shkuan në Jugosllavi. Pikërisht që nga ajo kohë ne e rritëm kundërshtimin tonë ndaj Hrushovit dhe hrushovianëve.

Disa thonë sikur në Mbledhjen e Bukureshtit ne na mbrojti Partia Komuniste e Kinës. Historikisht kjo nuk është e vërtetë. Atje ne mbrojtëm marksizëm-leninizmin dhe u gjendëm përkrah Partisë Komuniste të Kinës. Pikërisht në këto momente, në Bukuresht e më vonë në Mbledhjen e Moskës kundërshtimi ynë ndaj revizionistëve modernë sovjetikë arriti kulmin dhe ne u ndamë përfundimisht me ta. Pse e bëmë këtë? Sepse mbronim parimet. Partia jonë e Punës pa se interesat e socializmit e të komunizmit në Shqipëri dhe ata të revolucionit botëror e donin që ne të hidheshim në luftë kundër revizionizmit sovjetik, kundër maskave që ai përpiqej të mbante, prandaj e sulmuam atë pa hezitim, porsa pamë se ai po thellohej në rrugën e tradhtisë ndaj marksizëm-leninizmit.

Partia Komuniste e Kinës, në atë kohë, ishte në një situatë të vështirë, nuk luftonte me të njëjtën forcë si Partia jonë kundër hrushovianëve...

Megjithatë, ndërsa ne ishim angazhuar në një luftë të ashpër parimore, na preçikohej ta pushonim polemikën kundër revizionistëve. Por ne ishim për të

mbrojtur me vendosmëri kauzën tonë të drejtë, ishim për luftë deri në fund me revizionistët. Kjo ndodhte sepse ne ishim në rrugë të drejtë marksiste-leniniste dhe s'kishim lëkundje në vijë.

Një kuadër i kualifikuar i CIA-s, ka botuar një libër të madh ku ai pohon haptazi se si Jugosllavia me Greqinë, në bashkëpunim me Flotën e 6-të amerikane në Mesdhe, të komanduar nga admirali Karnij, kishin punuar që të organizonin një grusht shteti në Shqipëri për të rrëzuar pushtetin tonë popullor. Kështu veproi më vonë edhe Hrushovi. Prandaj t'u buzëqeshësh këtij, titistëve dhe revizionistëve të tjerë modernë, imperialistëve amerikanë e imperialistëve të tjerë dhe të merresh vesh me ta, do të thotë se nuk je në rrugë të drejtë.

Pasi foli për kushtet e vështira të rrethimit në të cilat punon e lufton Shqipëria, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Është e drejtë që kontradiktat e armiqve duhet t'i shfrytëzojmë, por, natyrisht, pa shkelur parimet. Po vallë, pse ka kontradikta partia revizioniste italiane e Longos me partinë revizioniste sovjetike, mos do të thotë kjo që ne të marrim pjesë në kongresin e saj¹ meqenëse na dërgoi ftesë? Jo, në asnjë mënyrë! Prandaj ne menjëherë e hodhëm poshtë këtë ftesë, nuk e pranuan, duke u përgjigjur se nuk mbajmë asnjë lidhje me revizionistët modernë, se ne jemi e do të jemi gjer në fund në luftë me ta. Në rast se biem në po-

1. Është fjala për Kongresin e 13-të të partisë revizioniste italiane që u mbajt në muajin mars 1972.

zitat që predikojnë revizionistët modernë, sipas të cilëve «të bashkohemi në atë që na bashkon», lind çështja: cila është kjo që na bashkon me revizionistët italianë? Ne nuk gjejmë asgjë që të na bashkojë, sepse ata bashkëpunojnë me revizionistët sovjetikë, pranojnë prezencën e NATO-s në Itali, bashkëpunojnë brenda vendit me socialdemokratët, me demokristianët, me djallin e me të birin. Prandaj të bashkohesh me revizionistët italianë, do të thotë të gënjesh veten, të biesh në oportunizëm¹. Ne, nga ana jonë, në asnjë mënyrë nuk mund të bashkëpunojmë me tradhtarët e revolucionit e të socializmit.

Në këto kohë kaq të vështira Partia jonë mendon se lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare, partitë e vërteta marksiste-leniniste duhet t'i qëndrojnë fort besnike ideologjisë së Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, të ndriçohen kurdoherë prej saj dhe ta zbatojnë atë në kushtet dhe në situatat e vendit përkatës. Ato duhet të përfitojnë edhe nga eksperiencia e njëra-tjetrës, sepse kjo është kolosale. Kështu na mësojnë klasikët e marksizëm-leninizmit. Po të bëjmë ndryshe,

1. Këtu bëhet aluzion për Kinën. Një javë më vonë, më 13 shkurt 1972, në Ditarin Politik shoku Enver Hoxha shkruante: «...Kina, duke bërë politikë joparimore edhe gjoja duke shfrytëzuar kontradiktat dhe koniunkturat, nuk mund të konsolidohet si një vend i fuqishëm socialist dhe Partia Komuniste e Kinës si një parti e patundur marksiste-leniniste që mbron parimet. Përkundrazi, politika aktuale e Kinës bëhet nga pozita revizioniste... Kjo ne na shqetëson pa masë dhe shqetësimi më i madh është për njerëzimin mbarë». («Shënime për Kinën», vëll. I, f. 637.)

e kemi shumë gabim. Në qoftë se nuk e konsiderojmë internacionalizmin proletar faktorin më të rëndësishëm pas atij të brendshmit, kemi bërë, gjithashtu, gabimin më të madh.

Ky faktor i rëndësishëm duhet gjykuar e shfrytëzuar me një kuptim të drejtë marksist-leninist nga çdo parti marksiste-leniniste. Por eksperiencia e të tjerëve, veprimtaria e tyre duhen analizuar e gjykuar në përshtatje me secilin vend. Në rast se dikush, si marksist-leninist, ka vërejtje për ne, ai duhet të na i bëjë, por duke qenë marksist edhe unë, gjithashtu, do t'i bëj vërejtje, në rast se kam, për veprimtarinë e tij. Natyrisht, kjo duhet kuptuar drejt, vërejtjet të bëhen në mënyrë shumë shoqërore, por kjo deri në njëfarë kohe, pastaj në qoftë se ecet përsëri në rrugë të gabuar, atëherë nuk pyesim se ç'dëm sjell demaskimi. Në këto çështje ka respekt të plotë të dyanshëm. Dihet se çdo parti gjykon më drejt se kushdo për problemet e brendshme të vendit të vet dhe se për interesin e kësaj partie nuk është aspak e drejtë, as e lejueshme që ndonjë parti tjetër t'i kërkojë asaj të bëjë si do të dëshironte ajo. Kjo nuk është e rekomandueshme. Por shoqërisht mund t'i thuhet një partie se si të veprojë për interesat e revolucionit, pa dëmtuar as interesin e saj dhe as interesin e partisë, së cilës i bën vërejtjen. Në këtë rast, nëse të dyja partitë bien dakord, në rast se asnjëra nuk është në kundërshtim për atë që diskutohet, duke pasur parasysh kushtet e secilës parti, atëherë mund të ecet.

Kushtet e një partie në fuqi nuk janë të njëjlojta me ato të një partie të një vendi tjetër, ku akoma nuk

ka fituar revolucioni proletar. Partia jonë, për shembull, u ka qëndruar të gjitha sulmeve të monarko-fashistëve grekë, të udhëheqjes titiste jugosllave, të revizionistëve sovjetikë dhe të gjithë të tjerëve, sepse në Shqipëri është e fortë diktatura e proletariatit, është e fortë Partia. Mirëpo në botë ka parti të tjera që nuk janë në kushtet tona. Ato po bëjnë përpjekje të mëdha dhe u duhet të kapërcejnë shumë vështirësi që të arrijnë aty ku kemi arritur ne, të vendosin diktaturën e proletariatit. Për kapërcimin e këtyre vështirësive ato vetë e dinë sa do ta hedhin çapin dhe si do ta hedhin.

Çdo parti ka taktikën dhe strategjinë e saj. Por, si strategjia, ashtu edhe taktikat duhet të jenë të bazuara në parimet e marksizëm-leninizmit. Ne qëndrojmë fort në këto pozita, prandaj kemi besim se rruga që ndjekim na çon vazhdimisht nga fitorja në fitore.

Në këtë mënyrë i gjejkojmë ne marrëdhëniet me partitë motra dhe kështu veprojmë, parimet i respektojmë me rreptësi, prandaj jemi të lidhur në miqësi të ngushtë e të sinqertë me ju dhe me të gjitha partitë e tjera motra marksiste-leniniste të botës.

Disa gjëra ne mbase i shikojmë nga një kënd tjetër, mundet që ndonjëri të thotë se qenkemi ca të ngurtë ne shqiptarët, por hallet, vuajtjet, eksperiencia e hidhur historike na kanë mësuar të jemi mjaft të kujdesshëm. Për shembull, populli ynë në të kaluarën ka qenë i vuajtur, ai nuk siguronte as bukën e gojës. Prandaj ndodh që edhe sot, fshatari ynë, megjithëse jeton shumë mirë, ruan një zakon të vjetër shumë karakteristik: kur ulet të hajë bukë, më parë e puth

atë dhe e vë në ballë, ndërsa, kur mbaron së ngrëni, thërrimet i mbledh një nga një në sofër, nuk i hedh poshtë dhe, pavarësisht se e ka të mbushur «qilarin» e barkun me bukë, i fut thërrimet në gojë. Kjo ndodh sepse ai ia di vlerën bukës, ka respekt të madh për të, se e prodhon dhe e fiton me djersë. Populli ynë tërë jetën ka qenë i shtypur, të huajt i kanë rënë vazhdimisht në qafë, kanë intriguar në kurriz të tij pra, siç thotë një fjalë e urtë e popullit tonë, ai është «djegur». Prandaj edhe sot, megjithëse situatat kanë ndryshuar, populli ynë ruan akoma disa cilësi të kalitura gjatë shekujve si atdhedashurinë, vigjilencën ndaj të huajve, besën etj., të cilat i janë futur në gjak. Duke bërë mirë dallimin se cilët janë miqtë e vërtetë, miqtë e rremë dhe armiqtë, sot Partia dhe masat tona punonjëse sytë i bëjnë katër, janë vigjilentë, miqtë i duan me sinjeritet të madh, kurse armiqtë u tregojnë grykën e pushkës.

Ne gëzohemi shumë që te ju dhe në të gjitha partitë marksiste-leniniste ka një zhvillim të madh dhe është duke u rritur një forcë e madhe revolucionare, e cila bën që të zbulohen e të spastrohen elementët që nuk mendojnë si partia, që nuk janë në rrugë të drejtë. Kjo është një gjë e mirë, sepse, natyrisht, është më mirë pa ta, sesa me ta. Megjithatë, ne më parë përpiqemi t'i shpëtojmë njerëzit që gabojnë, t'i këshillojmë, t'i kritikojmë, t'i korrigojmë. Këtë taktikë kemi ndjekur dhe ndjekim ne në Partinë tonë me të gabuarit, por, kur me gjithë këto përpjekje disa mbeten të pandregshëm, Partia s'ka ç'bën, i përjashton ata nga gjiri i vet. Rëndësi për të ka që radhët e saj të jenë të pas-

tra dhe ato janë të këtilla. Sa për ata që, pas të gjitha përpjekjeve që bën Partia për t'i ndihmuar, nuk futen në rrugë të drejtë dhe përjashtohen, të mos kemi frikë, sepse tre ikin, por tre mijë të rinj futen në Parti.

Me pikëpamjet e disave, që thonë se Partia e Punës e Shqipërisë nuk duhej të kishte ftuar për të marrë pjesë në Kongresin e saj të 6-të delegacione të disa partive motra, gjoja për arsye sigurimi, ne nuk jemi dakord, përkundrazi, jemi plotësisht dakord me mendimin që shprehët edhe ju lidhur me ftesën që u bëmë partive marksiste-leniniste motra. Bëmë çmos që të ftonim në Kongresin e Partisë sonë përfaqësuesit e të gjitha partive të vërteta marksiste-leniniste, sepse gjykojmë që kontaktet midis komunistëve të vendeve të ndryshme, duke përfshirë dhe ato të shumanshmet, janë të domosdoshme për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ne nuk jemi vetëm për kontakte bilaterale. Edhe këtë lloj kontakti ne e konsiderojmë të mirë, bile shumë të nevojshëm, sepse edhe në këtë rrugë përfitojmë nga njëri-tjetri, por ne jemi edhe për bisedime e kontakte më të gjera. Ky është një parim marksist-leninist që ndjek Partia jonë, zbatimi i të cilit mbështetet edhe në eksperiencën e madhe të lëvizjes komuniste botërore.

Revolucionarët nuk kanë frikë nga mbledhjet ndërkombëtare. Po të mendojmë se duke bërë të tilla mbledhje do të dëmtohem nga armiku, kjo do të thotë të shuajmë luftën revolucionare si brenda vendit, ashtu edhe jashtë. Po të ishim nisur ne nga të tilla pikëpamje të huaja se «na dëmtohen kuadrot», se «do të rre-

zikhemi», nuk do t'i kishim hyrë luftës revolucionare ilegale brenda vendit kur ishim të okupuar nga fashizmi dhe kur Gestapoja përgjonte e ndiqte komunistët nga të katër anët. Qëndrime të tilla e kanë burimin te teoria e vjetër e trockistëve për «ruajtjen e kuadrove».

Ne e kemi të qartë se kur Partia jonë dërgon një delegacion për të marrë pjesë në një ngjarje të rëndësishme të një partie motër, këtë nuk e bën që shokët tanë të venë atje për të hedhur valle, por për të mësuar e për të shkëmbyer eksperiencë, punë kjo aq shumë e nevojshme për çdo parti, për të bashkuar me njëra-tjetrën forcat e për t'i hedhur në luftë revolucionare.

Vihet pyetja: «Përse luftojmë ne»? Ne luftojmë pikërisht për të zhdukur borgjezinë si klasë, ashtu sikundër lufton ajo për të na goditur dhe për të na shpartalluar. Atëherë, çfarë të bëjmë ne, të ruhemi, të mos hyjmë në luftë? Jo, në asnjë mënyrë! Kjo nuk do të ishte e drejtë dhe marksiste. Ne duhet të hidhemi në luftë, pa frikë se «do të vritemi», sepse vetëm me luftë, me revolucion do të arrijmë në fitore. Populli ynë ka një shprehje që thotë: «Dasmë pa mish nuk bëhet».

Borgjezia ka një eksperiencë të gjatë në luftën kundër komunistëve, por edhe komunistët kanë eksperiencë në luftë kundër borgjezisë. Kjo bile neve komunistëve na e ka shumë frikën, kurse ne nuk kemi frikë prej saj. Pikërisht këtu qëndron epërsia e komunistëve mbi të. Prandaj «teoria» sipas së cilës t'u shmangemi kontakteve për shkak të vështirësive e

sakrificave, nuk është marksiste, ajo nuk mund të pranohet nga Partia jonë dhe nga partitë e vërteta marksiste-leniniste.

Ju faleminderit shumë, shoku Paredes, për të gjitha ato që thatë në adresë të Partisë sonë. Ne ju jemi mirënjohës për ndjenjat tuaja të pastra dhe dëshirojmë t'ju themi se Partia jonë marksiste-leniniste, megjithëse ç' një vendi të vogël, edhe në të ardhmen do të vazhdojë të përpiqet akoma më shumë, kurdoherë në rrugën e marksizëm-leninizmit, të bëjë më tepër se gjer më sot për çështjen e përbashkët të socializmit dhe të komunizmit. Ne i sigurojmë partitë motra marksiste-leniniste se Partia e Punës e Shqipërisë do të vazhdojë të luftojë me këmbëngulje dhe pa lëkundjen më të vogël në vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste të përcaktuar në Kongresin e saj të 6-të dhe jemi të bindur se kjo është e vetmja rrugë e drejtë për mbrojtjen e interesave të socializmit në Shqipëri dhe të revolucionit në botë.

Ju sigurojmë se Partia jonë do ta ketë dhe do ta konsiderojë kurdoherë partinë tuaj si një parti motër dhe do t'i qëndrojë asaj besnike, sepse qëllimet tona janë të përbashkëta dhe vija jonë është e njëjtë, marksiste-leniniste. Nga ana tjetër, ne kemi respekt të madh për luftën revolucionare që zhvillon ju, për sukseset e mëdha që keni arritur.

Ne dimë, natyrisht, jo sa duhet, por e marrim me mend dhe jemi të bindur, sa vështirësi të mëdha keni ju në vendin tuaj. Përpara këtyre vështirësive, përpara egërsisë së imperialistëve janki që sundojnë në vendin tuaj dhe në vendet e tjera të Amerikës La-

tine, përpara shtypjes së qeveritarëve, borgjezisë dhe reaksionit vendës, të lidhur me imperializmin amerikan, komunistët marksistë-leninistë të partisë suaj dhe partia juaj luftojnë heroikisht. Duke i njohur këto vështirësi, ne i vëmë vetes pyetjen dhe themi: Si parti në fuqi, si vend socialist, me punën, me luftën dhe me mundësitë tona a ia japim ne partisë suaj atë ndihmë internacionaliste që duhet t'i japim? E themi sinqerisht se ne duhet t'ju ndihmojmë edhe më tepër. Prandaj kujdesi i Partisë sonë në të ardhmen do të rritet akoma më shumë në këtë drejtim. Partia jonë është një parti në fuqi dhe, megjithëse në një vend të vogël, ka për detyrë të ndihmojë edhe të tjerët.

Ky është një qëndrim internacionalist. Kështu na mësojnë për këto çështje Marks, Engels, Lenini, Stalini, kështu na mëson Partia jonë.

Unë jam shumë i gëzuar që u takuam së bashku dhe shkëmbyem mendime, të cilat do të na shërbejnë për punën tonë në të ardhmen. Për këtë ju jam shumë mirënjohës dhe ju faleminderit. Më vjen shumë keq që po largoheni shpejt, por e kuptojmë se në atdheun tuaj ju pret një punë e madhe, detyra e shenjtë e forcimit të partisë.

Rrugë të mbarë! Ju uroj shëndet! Të rroni sa malet! Të rrojë partia juaj dhe Komiteti i saj Qendror!

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 176

Botohet sipas librit: Enver Hoxha «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 176

VIJA E DEMARKACIONIT MIDIS MARKSISTË- -LENINISTËVE DHE REVIZIONISTËVE MODERNË NUK MUND TË SHLYHET

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

13 shkurt 1972

Nuk ka shumë ditë që partia revizioniste italiane i drejtoi Partisë së Punës të Shqipërisë një ftesë për të marrë pjesë në Kongresin e saj të 13-të, që do të mbahet së afërmi. Partia jonë e refuzoi dhe nuk pranoi as të merrte fare njoftim për të.

Komunistët shqiptarë nuk kanë pasur, nuk kanë dhe as duan të kenë kurrfarë lidhjesh e kontaktesh me revizionistët italianë, në asnjë formë dhe në asnjë nivel. Partia e Punës e Shqipërisë ka zhvilluar një luftë të ashpër dhe një polemikë të hapët e parimore me partinë revizioniste italiane, ka demaskuar pa u lëkundur vijën e saj antimarksiste dhe ka kritikuar fort veprimtarinë e saj praktike. Refuzimi për të pranuar ftesën italiane është në përputhje të plotë me vijën revolucionare të Partisë sonë, e cila ka vënë një kufi të qartë dhe të pandryshueshëm me të gjithë revizionistët modernë.

Artikujt e «Zërit të popullit»: «Mbi tezat për Kongresin e 10-të të PK Italiane», ««Testamenti» i P. Toliatit, kriza e revizionizmit modern dhe lufta e marksistë-leninistëve», «Me çfarë shkojnë revizionistët italianë në Kongresin e tyre të 11-të», «Integrimi me borgjezinë — kurs i ri i Kongresit të 12-të të revizionistëve italianë» e mjaft të tjerë kanë vënë në pah se cila është fizionomia e vërtetë politike e ideologjike e revizionistëve italianë, kanë paraqitur me saktësi thelbin e oportunitizmit revizionist italian, duke treguar njëkohësisht dëmet e rënda që tradhtia e krerëve të Partisë Komuniste Italiane u ka shkaktuar klasës punëtore dhe lëvizjes revolucionare në Itali.

Partia e Punës e Shqipërisë, dhe partitë e tjera marksiste-leniniste e kanë kritikuar dhe e kanë demaskuar partinë e revizionistëve italianë, sepse ajo ka pushuar së qeni një parti revolucionare, besnike e marksizëm-leninizmit dhe e interesave të klasës punëtore, pasi prej kohësh është shndërruar në një parti parlamentare borgjeze, misioni i së cilës është të mashtrrojë punonjësit, t'i futë në qorrsovak dhe të lehtësojë sundimin e borgjezisë. E zhytur thellë në batakun e oportunitizmit, partia revizioniste italiane tanimë është integruar kokë e këmbë në sistemin borgjez, duke u bërë pjesë përbërëse dhe instrument i tij. Në parlament, në këshillat regjionalë, në bashkitë e qyteteve e të komunave dhe në forma të tjera të pushtetit ajo merr pjesë aktive në qeverisjen e vendit, në mbajtjen e rregullit dhe në sigurimin e rendit borgjez. Në Itali, në mënyrë më të dukshme se në çdo vend tjetër kapitalist, partia revizioniste ka zënë plotësisht vendin

e socialdemokracisë. Ajo, duke u spostuar nga e djath-ta, ka kaluar hapur në kampin borgjez.

Partitë marksiste-leniniste i kanë demaskuar revizionistët italianë, pasi ata jo vetëm u bënë përkrahës të Hrushovit e të hrushovizmit në Bashkimin Sovjetik, por bashkë me ta u hodhën në luftën kundër marksizëm-leninizmit dhe u bënë ideologë të zellshëm të oportunizmit politik kontemporan, predikues të papërmbajtur të shuarjes së luftës klasore e të bashkëpunimit me borgjezinë në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, përhapës të zjarrit të çndrrave pacifiste e të iluzioneve për imperializmin. Tezat dhe idetë e së ashtuquajturës «rrugë italiane të socializmit», të mbrojtura me këmbëngulje këta njëzet vjetët e fundit nga revizionistët italianë, përbëjnë kodin më reformist të mbarë revizionizmit modern dhe përfaqësojnë një sulm të përgjithshëm kundër bazave themelore të marksizëm-leninizmit dhe praktikës së gjatë revolucionare të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Toliatistët italianë dhe pasuesit e tyre në vendet e tjera ishin ndër të parët që ngritën flamurin e luftës kundër Stalinit dhe marksizëm-leninizmit, që mohuan socializmin dhe luftën e tërë brezave të komunistëve për triumfin e ideologjisë së klasës punëtore e të komunizmit. Ata ishin ndër të parët që u bashkuan me sulmin hrushovian të shpifjeve e të sharjeve kundër Partisë Komuniste të Kinës, kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe partive të tjera që mbrojnë marksizëm-leninizmin. Roli që ata kanë luajtur në përçarjen e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe në degjenerimin revizionist të mjaft partive komu-

niste mund të krahasohet plotësisht me atë të hrushovianëve sovjetikë.

A kanë ndryshuar tani revizionistët italianë, a janë bërë ata më të mirë nga ç'ishin dhjetë ose pesëmbëdhjetë vjet më parë, në kohën e Kongresit të 20-të të PK të BS, ose në Mbledhjen e Moskës të partive komuniste e punëtore më 1960? Aspak. Përkundrazi, ata sot i kanë shkuar deri në fund procesit të degjenerimit revizionist të partisë, duke krijuar një organizatë kualitativisht të re, që është e kundërta e partisë komuniste.

I vetmi preokupim i partisë revizioniste italiane sot është ta futë klasën punëtore në rrugën e reformizmit, të ngjallë në të frymën e pasivitetit, të deziluzioneve e të nënshtrimit kristian. Për sa i përket luftës së saj të përditshme, ajo është shndërruar në një luftë të zakonshme për pjesëmarrje në pushtet dhe për ndarjen e pushtetit ekzistues kapitalist me partitë e tjera të krahut borgjez.

Revizionistët italianë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë aleatë të ngushtë të socialimperialistëve sovjetikë. Në çështjet kryesore, siç janë lufta kundër marksizëm-leninizmit dhe shuarja e revolucionit, vija e afrimit dhe e bashkëpunimit sovjeto-amerikan, planet sovjetike në Mesdhe e në Lindjen e Mesme, qëndrimi ndaj luftës në Vietnam etj., krerët e Moskës kanë pasur dhe kanë kurdoherë përkrahjen e plotë të miqve të tyre italianë.

Është e vërtetë se midis revizionistëve italianë e atyre sovjetikë ka edhe kontradikta, edhe mosmarrëveshje për këtë ose atë çështje të veçantë, që lind në

fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Por këto divergjenca nuk kanë qenë dhe nuk janë të karakterit ideologjik e parimor. Ato janë zhvilluar dhe zhvillohen brenda kuadrit të antikomunizmit, mbi bazën e tradhtisë ndaj marksizëm-leninizmit, revolucionit e lirisë së popujve, kundër forcave revolucionare.

Divergjenca me udhëheqësit revizionistë sovjetikë kanë jo vetëm revizionistët italianë, jo vetëm grupe udhëheqëse të disa partive që nuk janë në pushtet, por mosmarrëveshje e kontradikta me sovjetikët kanë edhe partitë revizioniste që janë në pushtet. Kjo është e natyrshme. Kontradiktat dhe përçarja në gjirin e revizionistëve janë të pashmangshme, pasi burojnë nga vetë natyra klasore e ideologjike e revizionizmit. S'ka asnjë dyshim se në të ardhmen grindjet e përleshjet në kampin revizionist do të bëhen më të ashpra dhe më të thella. Midis revizionistëve sovjetikë dhe atyre italianë, ashtu si dhe midis të tjerëve, ekzistojnë interesa të kundërt, që nuk mund të pajtohen.

Klikat revizioniste në vendet perëndimore, duke qenë tanimë të lidhura me interesat e borgjezive të veta nacionale e të grupimeve imperialiste evropiano-amerikane, nuk mund të mos vijnë në ndeshje e në konflikte me sunduesit moskovitë, me të cilët ato rivalizojnë dhe janë në garë për shtrirjen e ekspansionit ekonomik, politik e ushtarak. Marrja e një pozite të pavarur dhe qëndrimi kritik ndaj disa veprimeve të Bashkimit Sovjetik për partitë revizioniste të Evropës Perëndimore janë një veprim i obliguar. Në qoftë se do të vepronin ndryshe, ato do t'ia lidhnin krejtësisht duart vetes dhe do t'i lejonin kundërshtarët t'i shfry-

tëzonin në dëm të tyre të gjitha gafat dhe disfatat e brendshme e të jashtme të udhëheqësve sovjetikë. Çështja e Çekosllovakisë ishte një goditje e rëndë për të gjithë krahun e ashtuquajtur liberal të revizionizmit modern dhe revizionistët e Perëndimit qenë të detyruar nga situata të shfaqin haptazi dëshpërimin e tyre ndaj aventurave ushtarake të Kremlinit.

Nacionalizmi borgjez po shfaqet gjithnjë e më me forcë edhe në kryet e partive revizioniste sunduese të shteteve të Evropës Lindore, ku konflikteve të vjëtara me sovjetikët u shtohen gjithnjë të reja.

Ekzistencën e dy vijave kryesore ndërluftuese në kampin revizionist, që të dyja antimarksiste e kundërrevolucionare, tanimë e vëren kushdo. Ato kanë lindur dhe po zhvillohen mbi bazën e kontradiktave midis politikës shoviniste e ekspansioniste rusomadhe të socialimperializmit dhe nacionalizmit të ngushtë borgjez të forcave të ndryshme revizioniste, nga kontradiktat e rivalitetit midis imperializmit të ri sovjetik dhe borgjezisë së vjetër e të re të vendeve ku janë në fuqi revizionistët.

Këtë situatë të krijuar në kampin revizionist e shohin edhe sundimtarët e Bashkimit Sovjetik, të cilët e ndiejnë se po e humbasin hegjemoninë që kishin deri para pak kohëve mbi repartet e ndryshme revizioniste. Tani udhëheqësit sovjetikë, me të gjitha mjetet që kanë në dispozicion, po përpiqen t'i përdorin për interesat e tyre të gjitha forcat revizioniste, edhe opozitarët, në luftën kundër çështjes së revolucionit e të socializmit, kundër partive të vërteta marksiste-leniniste. Qëllimi i revizionistëve të Moskës është që të

gjithëve t'u caktojnë një rol: besnikëve e lakenjve të frikshëm u kërkohet të luajnë rolin e altoparlantit të propagandës së vijës së sovjetikëve; atyre që kanë disa kundërshtime e kontradikta ta përdorin këtë pozitë për të kryer disa misione kundërrevolucionare, të cilat sovjetikët, të demaskuar e të diskredituar, nuk janë në gjendje t'i çojnë deri në fund.

Dhe për t'i bashkuar në këtë drejtim, revizionistët sovjetikë përdorin si grushtin, ashtu edhe lajkat, si armët, ashtu edhe rublat. Në vendet ku në fuqi janë revizionistët, udhëheqësit sovjetikë e shoqërojnë diktatin e tyre edhe me frikën e tankeve, ose me shtrëngimin e vidhave nëpërmjet organizmave të tillë si Traktati i Varshavës, KNER-i etj. Për t'i «bindur» partitë revizioniste që nuk janë në fuqi, puna paraqet disa vështirësi. Ndaj tyre ata përdorin lloj-lloj presionesh, intrigash e makinacionesh, që nga prerja e subvencioneve e deri te krijimi i fraksioneve të brendshme, që nga presioni ideologjik e deri te komprometimi politik, publik etj.

Duke qenë se të gjithë revizionistët, që nga ata hrushovianë e gjer tek ata toliatistë, me gjithë grindjet e kontradiktat që kanë midis tyre, i bashkojnë në një front të vetëm kundërrevolucionar armiqësia dhe lufta e përbashkët kundër marksizëm-leninizmit dhe forcave revolucionare që e mbrojnë atë, aktualisht revizionistët opozitarë paraqiten si ekuilibristë, që luajnë në dy drejtime. Nga njëra anë, dizidencën me Moskën ata përpiqen ta shfrytëzojnë për të zhvatur sa më shumë nga ajo, dhe, nga ana tjetër, duke u paraqitur sikur

gjoja kundërshtojnë revizionistët e Moskës, luajnë rolin e diversantit dhe nën pretendimin e famshëm revizionist që «të bisedojmë e të bashkëpunojmë për ato që na bashkojnë dhe të lëmë mënjanë e të harrojmë ato që na ndajnë», orvaten t'i degjenerojnë, sadopak, partitë që qëndrojnë në pozita të drejta marksiste-leniniste.

Në këtë rrugë toliatistët dhe revizionistët e tjerë të kësaj marke dëshirojnë që, duke futur krimbin në forcat e shëndosha marksiste-leniniste, t'u bëjnë shërbimet e tyre të mira si revizionistëve sovjetikë, si borgjezisë së tyre kombëtare, ashtu edhe imperializmit.

Por me Partinë e Punës të Shqipërisë këto manovra e pëhlivanllëqe nuk shkojnë. Orvatjet e revizionistëve opozitarë për të spekuluar me divergjencat e tyre aspak parimore me sovjetikët dhe për të përfituar në dëm të marksizëm-leninizmit, ne i hedhim poshtë me përbuzje dhe i demaskojmë pa mëshirë. E ndriçuar nga marksizëm-leninizmi dhe nga eksperiencia e luftës së saj të gjatë kundër revizionistëve të të gjitha kallëpeve, Partia e Punës e Shqipërisë nuk do të shkelë kurrë në dërrasa të kalbura dhe nuk do të bjerë kurrë në pozita oportuniste, ku do të donin ta shihnin armiqtë revizionistë.

Komunistët shqiptarë nuk mashtrohen nga antisocialimperializmi fals i toliatistëve e i miqve të tyre, ashtu siç nuk janë gënjyer nga antiimperializmi demagogjik i revizionistëve të tjerë.

«Uniteti i veprimit» kundër imperializmit, ose edhe kundër socialimperializmit, për të cilin herë pas

here bëjnë fjalë disa lloj revizionistësh, në realitet nuk synon as imperializmin amerikan, as atë sovjetik. Të bashkohesh me ta do të thotë të bashkohesh me revizionizmin kundër marksizëm-leninizmit, me kundërrevolucionarët kundër forcave revolucionare. Përpjekjet që toliatistët e revizionistët e tjerë bëjnë gjoja për të rivendosur një «unitet të ri» në lëvizjen revolucionare e punëtore botërore, nën parullën e famshme të «unitetit në diversitet», kanë për qëllim të shuajnë luftën parimore revolucionare që marksistë-leninistët bëjnë për demaskimin e revizionistëve, të vendosin një paqe klasore të përgjithshme dhe të eliminojnë vijën e thellë të demarkacionit që ndan tani kampin marksist-leninist nga ai revizionist. Ata synojnë që marksistë-leninistët t'i bëjnë shokë në kapitullimin e tyre përpara imperializmit, socialimperializmit e reaksionit.

Situata sot në botë zhvillohet në favor të revolucionit e të socializmit dhe në dëm të imperializmit e të socialimperializmit, të cilët ndodhen në një krizë të gjithanshme. Veçanërisht fronti revizionist po kalbet e po degjenerohet gjithnjë e më shumë, grindjet midis reparteve të tij po shtohen e po acarohen. Kjo gjendje, sigurisht, është rezultat i tradhtisë së revizionistëve modernë, i vijës së tyre borgjeze antimarksiste, i veprimtarive të tyre kundërrevolucionare.

Por kjo krizë është shkaktuar edhe si rezultat i pozitive të drejta marksiste-leniniste dhe i luftës së vendosur të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të forcave të tjera marksiste-leniniste. Është po kjo luftë që duhet të zhvillohet me ngulm edhe në të ardhmen për

të zhdukur çdo iluzion, që, në situata e koniunktura të veçanta, mund të krijohet për ndonjë repart të veçantë revizionist, për t'u hapur sytë forcave të shëndosha brenda e jashtë partive revizioniste, në mënyrë që t'i ndajnë përfundimisht llogaritë me to jo vetëm nga ana ideologjike e politike, por edhe nga ana organizative.

Rruga për shkatërrimin e plotë të revizionizmit modern nuk mund të kalojë kurrë nëpërmjet kontakteve e bisedimeve me opozitarët revizionistë për gjoja luftë të përbashkët kundër imperializmit e socialimperializmit sovjetik. Revizionistët gjithnjë kanë dashur pushimin e polemikës dhe vendosjen e kontakteve, qoftë edhe formale, me marksistë-leninistët. Kjo do t'i zbukuronte ata në sytë e masave, do t'u rriste autoritetin dhe do t'i paraqiste sikur qëndrojnë në anën e revolucionit.

Por marksistë-leninistët dhe të gjithë revolucionarët nuk bien në këto kurthe. Pozita e Partisë së Punës të Shqipërisë në këtë çështje ka qenë dhe është e qartë: luftë parimore, pa kompromis e deri në fund kundër imperializmit, revizionizmit të të gjitha ngjyrave, kundër borgjezisë e reaksionit. Ajo i është përmbajtur me rigorozitet parimit marksist-leninist dhe të sprovuar nga jeta se nuk mund të mbash kontakte e të bisedosh me një pjesë të revizionistëve, vetëm pse këta kanë mosmarrëveshje e kontradikta me disa revizionistë të tjerë. Ashtu si nuk mund të mbështetesh te njëri imperializëm për të kundërshtuar tjetrin, po ashtu nuk mund të mbështetesh te një palë revizionistë

për të kundërshtuar një palë tjetër¹. Revizionistët tanimë e kanë vënë veten përfundimisht jashtë frontit antiimperialist dhe lëvizjes revolucionare proletare botërore. Si në politikë, ashtu edhe në ideologji e në të gjitha frontet e tjera revizionistët dhe marksistë-leninistët qëndrojnë në anët e kundërta të barrikadës.

Marksistë-leninistët janë të ndërgjegjshëm se fitorja përfundimtare mbi oportunizmin e ri revizionist do të kërkojë akoma më shumë përpjekje, një kurajë dhe një vendosmëri gjithnjë e më të madhe, do të kërkojë aksione gjithnjë më të fuqishme e më të guximshme. Por ata janë gjithashtu plotësisht të vetëdijshëm se taktikat e shkathëta të luftës kundër revizionizmit duhet të zgjidhen në atë mënyrë që t'i ndihmojnë me siguri arritjes së objektivave të strategjisë sonë revolucionare, shkatërrimit të imperializmit e të revizionizmit, triumfit të komunizmit.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 37 (7329), 13 shkurt 1972

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 188

1. Këtu bëhet aluzion për Partinë Komuniste të Kinës, e cila në atë kohë u lidh me parti revizioniste. Lidhur me këtë në Ditarin e tij Politik, më 12 shkurt 1972, shoku Enver Hoxha shkruan: «Është i nevojshëm ky artikull, se Partia Komuniste e Kinës po vepron në drejtim të gabuar me Partinë Komuniste të Spanjës (revizioniste), Partinë Komuniste të Rumanisë etj.».

UDHËHEQJA E PARTISË KA NEVOJË PËR MENDIMET E MASËS

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

18 shkurt 1972

Në këtë mbledhje të Sekretariatit kemi ftuar shumë shokë, të cilëve dëshirojmë t'u dëgjojmë mendimet e tyre për çështjet kryesore që do të diskutojmë, vetëm se këto të na i paraqitin në mënyrë të përmbledhur, të shkurtër e të qartë.

Për pikën e parë të rendit të ditës janë thirrur në raport shokë nga byrotë e komiteteve të Partisë të Minierës së Kurbneshit dhe të Ndërmarrjes së Ndërtimeve të Laçit. Mendoj se të vjetërve u takon të flasin më përpara, prandaj, meqenëse Miniera e Kurbneshit është më e vjetër se Ndërmarrja e Laçit, ta fillojmë punën nga miniera.

Mendoj se ka edhe një arsye tjetër që e justifikon

1. Në këtë mbledhje u diskutua për punën e bërë dhe detyrat që dalin për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 6-të të Partisë për forcimin e disiplinës proletare në punë.

prioritetin e minierës: fakti që atje punojnë minatorë. Këtë nuk e them kot, sa për të kaluar radhën, por për arsye se minatorët janë nga punëtorët më të regjur, që punojnë në një front të vështirë pune dhe, sido që nuk bëjmë shkallëzime e dallime ndërmjet punëtorëve, ata përbëjnë radhën e parë të klasës. Minatorët e Mirditës janë punëtorë të vjetër, ata kanë kohë që punojnë për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, prandaj për punën e tyre Partia kurdoherë ka pasur dhe ka respekt të madh. Megjithatë, kjo, natyrisht, nuk do të thotë se ata s'kanë të meta.

Kur të flitni, mundësisht na vini në dukje më shumë të metat e drejtuesve të ndërmarrjes e të punonjësve të administratës. Partia kërkon të dijë si reagon klasa punëtore ndaj të metave të udhëheqjes së Partisë dhe asaj shtetërore në ndërmarrje; si e nxitni ju klasën punëtore që t'ju korrigojë kur bëni gabime ose, kur është rasti, t'ju kërcasë edhe dhëmbët.

Me ato që thatë ju, se «thirrja në raport në Sekretariatit e Komitetit Qendror është një nder dhe ndihmë e madhe», më duket se po e mburrni Sekretariatit e Komitetit Qendror të Partisë. Ne ju falënderojmë për fjalët e mira, por mendoj se nuk është nevoja dhe nuk duhet të na lavdëroni. Ne na ka zgjedhur këtu Partia për të bërë një detyrë të caktuar, ashtu siç ju ka caktuar edhe ju atje ku punoni. Detyrat, me gjithë përpjekjet që bëjmë, ne nuk i kryejmë aq mirë, sa të meritojmë shumë lëvdata, prandaj është e domosdoshme të na bëni edhe kritika dhe këtë e them me plot sinqeritet. Nuk është mirë, shokë, të na thurni lëvdata dhe të mësohemi të na vini kurora prej

dafine. Edhe ne, shokët e udhëheqjes, si të gjithë, kemi të meta, të cilat na i konstatojnë ju, prandaj mos u rezervoni aspak, po na i vini në dukje. Pra, jo vetëm ne t'ju kritikojmë ju, por edhe ju të na kritikoni ne, pse as ju, as ne nuk jemi pa të meta. Prandaj ju lutem mos na mburrni.

Pasi diskutuan shokët e tjerë të pranishëm në mbledhje, shoku Enver Hoxha tha:

Këtu u fol se ata që vijnë nga fshati në minierë konsiderohen si njerëz të privilegjuar, sepse realizojnë të ardhura më shumë se në kooperativë.

Është metodë «e bukur» shumë kjo që praktikojnë këto rrethe, duke dërguar kooperativistë kohë pas kohe në ndërmarrje! Pse nuk dërgohen disa punëtorë të përhershëm, po çojnë shumë veta me radhë për pak kohë?

SHOKU RAMIZ ALIA: Duke vepruar kështu, te punëtori ynë nuk mund të formohet ndërgjegjja e klasës punëtore. Ai vjen në punë me një prirje për të fituar sa më shumë, se mendon që shpejt do të vijë dita që të ikë.

SHOKU ENVER HOXHA: I keni pyetur ndonjëherë punëtorët dhe komunistët nëse është e drejtë të vijnë në këtë mënyrë kooperativistët, domethënë, të punojnë në minierë disa muaj dhe pastaj të kërcasin e të ikin? Është e drejtë që kooperativistët të punojnë te ju motmot, t'i edukoni, t'i kualifikoni, pastaj t'ju ikin? Është parim i drejtë ky që kooperativisti të vijë përkohësisht në minierë sa për të fituar disa para, në një kohë kur kooperativistët e tjerë që rrinë në fshat marrin më pak? Si mendoni ju, janë të mira këto rregulla që janë vendosur para tetë vjetësh për sigu-

rimin dhe sistemimin e fuqisë punëtore, apo duhen «fshirë» për t'i zëvendësuar me të tjera, të ndërtuara në bazë kriteresh më të drejta? E përsëris, i keni bërë këto probleme objekt diskutimesh me komunistët dhe punëtorët, apo është menduar se, meqë për to kanë vendosur Komiteti Qendror i Partisë apo Qeveria, s'ka nevojë të rishikohen? Ju, me sa duket, nuk i keni shtruar këto probleme para masës së punonjësve të ndërmarrjes suaj. Si mendoni, duhen shtruar këto apo të vazhdohet me praktikën e vjetra që pengojnë ccjen përpara të punëve?

Minierat, ashtu si dhe ndërmarrjet e tjera të vendit, kanë nevojë për fuqi punëtorë. Mirëpo nga do të merren punëtorët? Si do të binden dhe do të nxiten ata për të punuar? Ky problem nuk mund të zgjidhet me një të rënë të shkëpit, por me punë bindëse politike, me stimuj moralë, po edhe me stimuj materialë. Të gjithë e dimë mirë se minatori punon nën tokë, në kushte më të vështira se gjithë të tjerët, prandaj është e arsyeshme që ai të shpërblehet më shumë. Këto veçori të punës duhet t'u shpjegohen mirë kooperativistëve, të kuptojnë drejt edhe trajtimin e diferencuar që u bëhet minatorëve në krahasim me punëtorët e tjerë dhe të mos i sorollatin poshtë e lart njerëzit.

Në caktimin e kooperativistëve që do të punojnë në minierë të vendosen dhe të zbatohen kritere të shëndosha socialiste e jo mikroborgjeze, duke vepruar sipas qejfit të disave. Nuk është aspak i drejtë kriteri sipas të cilit kooperativisti duhet të punojë në ndërmarrje vetëm 6 muaj, pastaj të zëvendësohet me një tjetër, për arsye se «duhet të punojnë edhe të tjerët

për të fituar diçka më tepër». Të edukohet kooperativisti që t'i shtrohet mirë punës në bujqësi apo blegtori e jo të vështrojë anembanë se kush iku nga kooperativa për të punuar në ndërmarrrje, kush u kthye dhe kujt i erdhi radha të vejë prapë. Në qoftë se në caktimin e kooperativistëve që duhet të punojnë në miniera vihet re se këshilli popullor dhe kryesia e kooperativës bëjnë favore, këto të goditen me forcë, por parimet duhen mbrojtur e respektuar, pa bërë asnjë lëshim. Shfaqje të kësaj natyre, shokë, nuk janë probleme të vogla për Partinë; ato kanë të bëjnë me parime të rëndësishme, prandaj lypset të zbatohen medoemos orientimet e Partisë për sigurimin dhe sistemimin e fuqisë punëtore.

Në qoftë se duam të zgjidhim drejt shumë probleme, siç janë ai i forcimit të disiplinës proletare në punë, i kualifikimit të punëtorëve, i edukimit të tyre me botëkuptimin e klasës e të tjera, e të tjera, këto çështje duhet të kuptohen dhe të zbatohen mirë që në bazë. Atij që do të dëshirojë të vijë në minierë si minator, para se të aprovohet nga organet kompetente, t'i shpjegohen qartë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës. Ashtu siç është i detyruar minatori të plotësojë detyrat e tij me përpikëri, edhe miniera është e detyruar të plotësojë detyrimet e saj për të siguruar mensën, fjetoren, dushin dhe të gjitha nevojat e tjera social-kulturore që kanë punëtorët. Në të njëjtën kohë, duhet të krijohen kushtet për ngritjen e nivelit ideopolitik dhe profesional të punëtorëve, prandaj të ngrihen kurset e kualifikimit etj., pse kështu edhe minatori i thjeshtë do të bëhet

specialist i punës së vet dhe do të jetë në gjendje të thotë fjalën e tij prej punëtori.

Edhe në kooperativën bujqësore bëhen përpjekje për edukimin e kooperativistëve, por puna për edukimin politik edhe profesional atje ka dallimet e veta që rrjedhin nga niveli i ndryshëm i forcave prodhuese dhe i marrëdhënieve në prodhim e të tjera. Kooperativisti ka detyrë të punojë mirë tokat dhe të lidhet ngushtë me to; të mësojë agroteknikën e të tjera sende që nevojiten, prandaj të mos nënvlerësohet aspak edukimi sistematik i punëtorëve të rinj që shkojnë nga fshati në ndërmarrje.

Janë të drejta këto që themi apo jo? Në qoftë se janë me vend, atëherë duhen zbatuar, në qoftë se s'janë të drejta, të na thuhet që s'e kemi mirë, për të gjetur rrugën nëpër të cilën duhet ecur. Duke na thënë gjykimin tuaj për mendimet tona, ne do të kuptojmë nëse i kemi drejt apo jo këto që po flasim. Po i gjykuat të drejta këto që themi, atëherë do të kërkojmë llogari për zbatimin e tyre dhe kjo është e natyrshme, pse kur bisedojmë për diçka dhe bëmë dakord, porositë e dhëna nuk duhet t'i marrë era dhe pastaj të na vini në Sekretariatit e Komitetit Qendror të Partisë, në Byronë Politike, në Qeveri ose në ndonjë forum tjetër e të mburrni ndihmën e madhe të udhëheqjes! Janë fare pa kuptim dhe krijojnë situata të papëlqyeshme rastet, kur direktivat e udhëheqjes nuk zbatohen plotësisht dhe pastaj flitet se ndihma e saj genka e madhe! Ju shokë që punoni në rrethe e në bazë, thuajeni haplas, në qoftë se unë ose cilido tjetër nga shokët e udhëheqjes s'ka të drejtë për ato që tho-

të. Udhëheqja ka nevojë dhe kërkon të dijë mendimin tuaj për direktivat, prandaj ju lutemi na i thoni haptas çka mendoni, se ju jeni në kontakt të përditshëm me klasën punëtore dhe me fshatarësinë kooperativiste; ju ndesheni direkt me vështirësitë e punës në bazë, prandaj ndihmën dhe vërejtjet tuaja për punën, ne i çmojmë të nevojshme dhe të domosdoshme.

Sigurisht, këto veprime për të cilat po diskutojmë, lidhur me fuqinë punëtore janë sanksionuar me akte juridike, ndryshe nuk do të bëheshin. Por kjo gjë nuk do të thotë që ato, edhe kur nuk u përgjigjen kërkesave të kohës, nuk mund të rishikohen.

Kjo çështje vërtet nuk është aq e thjeshtë, por mund dhe duhet t'i gjendet zgjidhje. Ky problem nuk del vetëm për minierat, por edhe për disa ndërmarrje të tjera si sharrat etj. Minierat, siç është edhe ajo e bakrit në Kurbnesh, janë ndërmarrje shtetërore me perspektivë të gjatë, prandaj problemi duhet studiuar mirë se si do të ecet më tej, pse ashtu si është, s'mund të ecet, sepse rruga që po ndiqet tani, nuk është normale. Në këto rrethana duhet bërë llogari për të dalë në disa përfundime të sakta që, me një mekanizim më të madh të proceseve të punës, mjaftojnë vetëm punëtorët që mund t'i nxjerrë vetë rrethi, në juridiksionin e të cilit ndodhet miniera, apo duhet të vijnë punëtorë edhe nga rrethet e tjera. Po që se nevojiten punëtorë nga rrethet e tjera duhet studiuar se nga cilat do të merren konkretisht dhe sa do të merren, jo përkohësisht për tre-katër muaj, po të përhershëm, për arsye se Miniera e Kurbneshit, për shembull, siç thashë, është me perspektivë të madhe. Ajo është në ba-

Ilë të industrisë sonë minerale, prandaj, si kudo, lypset dhe aty të krijojmë, të edukojmë, të kualifikojmë dhe të kalitim elementët e klasës punëtore dhe jo t'i mbajmë në një gjendje të tillë që s'mund t'i quajmë as kooperativistë, as punëtorë. Kooperativistët që do të vijjnë aty, duhet të stabilizohen me banesa, me familje dhe me çdo gjë që kanë, që vetë ata të shndërrohen në punëtorë. Po kështu edhe familjet e tyre do të shndërrohen në familje punëtorësh. Matit, për shembull, pas studimit për të nxjerrë disponibilitetin e forcave të punës dhe nevojat që ka rrethi për to, pasi të shihet niveli i mekanizimit që do të kenë ndërmarrjet e të tjera, vendoset t'i merren, fjala vjen, 50 familje. Por, në studimin e nevojave të çdo rrethi duhet të kihet parasysh edhe nevojat që ka ky rreth jo vetëm për industrinë e ndërtimit, por veçanërisht edhe për bujqësinë, pastaj të arrihet në përfundimin nëse ka mundësi të marrim fuqi punëtore prej këtij rrethi apo jo.

Kështu si po veprohet, kooperativa bujqësore është katandisur si vend tregu për «furnizimin» me fuqi punëtore. Në këtë drejtim ndikon së tepërmi stimuli material, sepse, ata që lejohen të punojnë në ndërmarrjet shtetërore, paguhen më shumë. Në këto kushte, kur ka shumë kërkesa për caktimin e kooperativistëve që do të punojnë në ndërmarrjet shtetërore, ndërhyjnë kryetari i kooperativës, sekretari i organizatës-bazë të Partisë të kooperativës dhe kryetari i këshillit popullor. Mirëpo, nuk përjashtohet që këta të bëjnë edhe hatëre, duke caktuar miqtë e të njohurit e tyre. Në këtë mënyrë në fshat krijohet një situatë jo e kënaqshme, njerëzit veçohen, shkëputen nga detyrat

që kanë ose edhe armiqësohen me njëri-tjetrin, për arsye të mbeturinave në ndërgjegjen e atyre që drejtojnë dhe të rregullave të padrejta që zbatohen. Kështu, more shokë, krijohet një gjendje e rrezikshme që mund të sjellë shkëputjen e Partisë nga masat. Partinë këto e gjykojnë nga veprimet që kryejnë anëtarët e saj dhe nga drejtësia e urdhëresave që lëshohen. Në qoftë se vazhdojnë të zbatohen akoma disa vendime e urdhëresa që dikur kanë qenë me vend, po sot nuk janë më të përshtatshme, njeriu i thjeshtë mendon: «Ç'janë këto që po bëhen?». Sigurisht njerëzit e thjeshtë e duan Partinë e tyre, por shpeshherë këtë e identifikojnë me kryetarin e kooperativës apo me sekretarin e organizatës-bazë. Po të futesh thellë në ndërgjegjen e njerëzve të thjeshtë, kuptohet se ka prej tyre që mendojnë se në këto drejtime nuk jemi në rregull, por gjykimin e tyre ata nuk e shprehin me zë të lartë, pse druhen. Kjo, shokë, tregon se nuk kemi punuar mirë, prandaj t'i shikojmë një çikë më me mend këto punë, dhe në bazë të vijës së drejtë të Partisë, të dalim me propozime e të marrim masa për përmirësimin e gjendjes.

Shpesh themi e përsëritim se në punën tonë ka rutinë. Po ç'është rutina? Rutinë kemi edhe atëherë kur ecet me një vendim të vjetër, që ka dalë para shumë vjetësh, ndërsa sot ai nuk u përgjigjet kushteve të reja që janë krijuar. Mirëpo tjetri, edhe pse e sheh që ai është bërë pengesë, nuk e ngre zërin për shfuqizimin e tij, sepse rezervohet duke menduar që atë vendim e ka marrë udhëheqja e Partisë ose Qeveria. Ne kërkojmë që vendimet dhe direktivat tona, kur pas-

qyrojnë periudha kohe dhe situata të kapërcyera, me-
doemos të korrigojohen ose të zëvendësohen me të
tjera.

Disa herë kam lexuar në gazeta njoftime të tilla si:
«Depot janë mbushur me makina që s'punojnë» ose
«janë hedhur mënjanë, në një kohë kur baza kërkon të
tjera». Përse ndodhin këto gjëra? Ndodhin se s'ka
kontroll të fortë, se ndaj atyre që shkelin direktivat e
dhëna mbahen qëndrime liberale, bëhen lëshime pa
vend. Po sikur t'u mblidhen rripat atyre që kanë për-
gjegjësi për këto punë, t'u hiqen makinat që kanë
dhe fuqia punëtore e tepërt dhe të kërkohet me rrep-
tësi që, brenda javës, të futen në punë makinat e brak-
tisura, ç'do të ndodhë? Shumë probleme do të zgji-
dhen. Por, megjithëse dëmtohet puna e Partisë, dëmto-
het ekonomia, kjo gjë nuk bëhet kudo e kurdoherë,
sepse pengon një vendim, një urdhëresë, e shumë «ar-
sye»! Ku po shkojmë kështu, shokë, me metoda pune
si këto që përmenda? Këto që po them nuk janë hipo-
teza, por fakte të nxjerra nga puna dhe jeta.

Kontrolloni një çikë gatishmërinë teknike të sta-
cioneve të makinave dhe të traktorëve nëpër rrethet
tuaja, se nga kontrolli që është bërë në Lushnjë janë
gjetur shumë traktorë që nuk punojnë fare. Nuk është
fjala vetëm për traktorët e mëdhenj e që mund të jenë
vjetruar, por edhe për traktorët e tjerë më të rinj.

Megjithëse në Lushnjë ka një oficinë mekanike
mjaft të mirë dhe janë mundësitë të bëjnë edhe ri-
morkio sa të duash për veten e tyre, shoku Rrapi Gjer-
meni më erdhi vjet një ditë në zyrë dhe më kërkoi të
ndërhyj për t'i siguruar disa kamionë për transport,

pse «po kalbej gruri e misri në fushë». Unë porosita shokët e Ministrisë së Mbrojtjes që t'i jepnin Lushnjës disa mjete nga ato të ushtrisë, se s'kisha ç'bëja ndryshe. Ne kemi përshtypjen se shoku Rrapi Gjermani është nga sekretarët e parë më të mirë të Partisë në rrethe, por kjo nuk i nderon shokët e Partisë në Lushnjë që të mos marrin masat me kohë për të siguruar transportimin e prodhimeve. Një gjë e tillë nuk është aspak e drejtë dhe nuk duhet lejuar. Në qoftë se dikush nuk e kryen mirë detyrën që i është besuar, atëherë t'i ngarkohet atij që e bën më mirë. Kështu mendoj unë t'i shohim këto çështje, jo me llafe, po me rreptësinë më të madhe. Po të mos bëjmë punën që na ka ngarkuar Partia, atëherë përse qëndrojmë në zyra? Që të vijmë vërdallë? Prandaj, në punë e sipër të kontrollojmë veten, por të kontrollojmë dhe të tjerët.

U tha këtu se gjatë kohës së punës ka sorollatje nga punëtorët, pirje cigaresh e gjëra të tjera, dhe për t'u prerë rrugën këtyre, qenka ndaluar pirja e cigareve gjatë kohës së punës. Në qoftë se bëhen gjëra të tilla, këto më duket nuk janë aspak të mira. Pse, shokë, kalohet në masa kaq të tepruara në trajtimin e punëtorëve? Unë them se në disa profesione nuk humbet koha e punës kur njeriu pi cigare, si, për shembull, muratori mund të punojë edhe me cigare në gojë. Unë nuk them të ulen e të bëjnë muhabet kokë më kokë, por, duke punuar, mund të lejohen ta ndezin një cigare, ashtu si bën edhe shoferi që, duke ngarë makinën pi edhe një duhan. Cigarja nuk i pengon duart, sepse, gjatë punës, shoferi apo edhe çdo punëtor tjetër e mban cigaren në gojë derisa t'i mbarohet. Pra, shokë, mendoj

se s'ka pse të vini «rregulla» të tilla të forta. Sigurisht, duhani duhet të ndalohej, bile rreptësisht, në ato procese pune ku ka rrezik zjarri ose në raste të tjera të parashikuara në rregullore etj., por jo kudo.

Dua të diskutoj këtu edhe diçka: Një inxhinier që vjen me punë për të parën herë, sa ka dalë nga universiteti, është më i zoti, në praktikë, nga një punëtor i kategorisë së gjashtë apo jo? Si e gjykoni ju këtë? Sipas mendimit tuaj, sa kohë i duhen inxhinierit të ri që të kapërcejë vështirësitë e fillimit, derisa t'ia kalojë një mjeshtri nga ana praktike? Në fillim, punëtori i kualifikuar duhet ta ketë nën drejtim inxhinierin apo ky i fundit, vetëm për faktin se ka marrë diplomën, duhet t'i qëndrojë mbi kokë punëtorit? Më thoni, si mendoni ju si punëtorë¹ për këtë çështje, kur inxhinierit për të fituar shprehinë praktike të punës në mënyrë të mjaftueshme, i duhen tre ose katër vjet? Është e drejtë që inxhinieri dhe punëtori të kenë një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet tyre dhe të mësojnë nga njëri-tjetri, por a duhet të marrë inxhinieri më shumë rrogë-bazë se punëtori i kategorisë së gjashtë dhe ta drejtojë këtë, kur vetë ka fare pak haber nga praktika? A nuk do të ishte më me vend që punëtori i kualifikuar ta mësojë inxhinierin për t'u njohur më shpejt e më lehtë me praktikën e punës? Specialisti i lartë, kur vjen fillimisht në punë, është i zoti nga ana teorike, se në shkollë ka marrë shumë njohuri të për-

1. U drejtohet sekretarëve të organizatave-bazë të Partisë, të disa ndërmarrjeve të prodhimit, të pranishëm në këtë mbledhje.

gjithshme, por nga ana praktike ai nuk mund të krahasohet me mjeshtrin. Si e ndieni ju, në ndërgjegjen tuaj: në fillim, duhet ta mësojë më shumë inxhinieri i ri punëtorin apo ky inxhinierin?

Pasi shokët e thirrur në raport iu përgjigjën pyetjeve të mësipërme, shoku Enver Hoxha, vazhdoi:

Në qoftë se një punëtor i kategorisë së pestë ka përkrah një punëtor tjetër që ka marrë kategorinë e gjashtë, megjithëse nuk i ka aftësitë në prodhim për shkallën e kualifikimit që i është njohur, duhet ta ngrejë zërin kundër vlerësimit të pamërituar që i është bërë atij dhe jo ta mburrë për «zotësinë» në të gjeturit e «miqve». Në një rast të tillë, punëtori, që e shikon padrejtësinë dhe hesht, nuk është njeri i mirë; një punëtor i këtillë nuk i vlen klasës së tij. Kështu duhet të veprojë punëtori edhe për inxhinierin, kur shikon se ky nuk punon mirë dhe nuk është i zoti të çojë përpara punët në prodhim. Punëtori që mbyll gojën para neglizhencave që vë re në punë e në prodhim, dobëson regjimin e klasës dhe, me ndërgjegje ose jo, i hap rrugën shtimit të elementëve teknokratë. Atë që ka mbaruar shkollën dhe di shumë teori, punëtorët do ta çmojnë jo nga llafet që flet, po nga fakti se sa e zbaton ai teorinë në dobi të shoqërisë. Në qoftë se kuadri specialist e zbaton mirë teorinë në praktikë, duke i shërbyer prodhimit dhe, në të njëjtën kohë, zbaton me përpikëri normat dhe moralin e Partisë e të klasës, atëherë ne i ngremë kapelën, ndryshe klasa punëtore e kritikon që të ecë në rrugë të drejtë.

Me këtë rast desha të bëj disa pyetje: Janë vënë ndonjëherë drejtuesit e ndërmarrjes përpara kritikave

të forta të punëtorëve? E hapin gojën punëtorët kur shohin të meta? I kërkojnë llogari ata drejtorit, kryeinxhinierit apo sekretarit të organizatës-bazë për punët që janë lënë mangët, për detyrat e pazbatuara etj.? Pra, a flet klasa punëtore me gjuhën e kërkesës së rreptë të llogarisë? Pse problemet i ka ngritur shumë herë vetëm organizata-bazë e Partisë? Pse nuk janë ngritur edhe punëtorët për t'i kërkuar llogari drejtorisë së ndërmarrjes për çështjet që janë diskutuar disa herë dhe s'kanë gjetur rrugën e zgjidhjes?

Pasi shokët e thirrur në raport iu përgjigjën pyetjeve të mësipërme, shoku Enver Hoxha tha:

Ju na thatë se organizata-bazë e ka shtruar problemin e furnizimit të materialeve në drejtori. Kjo e shtruar, duke pëshpëritur vesh më vesh me njëri-tjetrin dhe duke gjetur gjithmonë fjalën e përbashkët me drejtorinë, nuk e zgjidh problemin. Unë e kam çështjen që klasa punëtore duhet ta thotë si duhet fjalën e vet për problemet që e preokupojnë dhe të gjykojë bile edhe për veprimtarinë e pararojës së saj. Klasa punëtore duhet të shprehet nëse e prin apo s'e prin pararoja. Ca më shumë akoma ajo duhet të gjykojë nëse është apo nuk është në rregull administrata e ndërmarrjes. Unë mendoj se ju mund të ngriheshit vetë në mbledhjen e punëtorëve e t'u thoshit atyre se «disa herë ua kemi bërë problem këtë çështje shokëve të drejtorisë që janë në presidiumin e mbledhjes, po ata kanë neglizhuar. Prandaj ju, shokë punëtorë, u kërkon tani llogari dhe i vini para përgjegjësisë, sepse këta nuk po e kryejnë mirë detyrën!».

Unë jam dakord që ju mund t'i keni kritikuar në

mbledhje të organizatës, po a mund të na thoni se çfarë masash ka marrë organizata-bazë kundër atyre që nuk i kanë plotësuar detyrat? Janë shkundur ata që kanë neglizhuar dhe si kanë reflektuar për vërejtjet që u janë bërë?

Organizata-bazë duhet ta analizojë doemos punën e drejtorisë dhe të administratës së ndërmarrjes, por nuk mjafton vetëm kaq. Partia dhe administrata duhet të japin llogari periodikisht para klasës punëtore për të vënë në jetë mësimin e Leninit, sipas të cilit, të paktën një herë në muaj, Partia dhe administratat duhet të japin llogari përpara klasës dhe masës. E bëni ju këtë gjë apo jo? Këtu e kam fjalën unë.

Po të veprohet kështu është shumë mirë, veç do pasur kujdes që të mos bëhen mbledhje ku të imponohet vullneti i drejtuesve të ndërmarrjes. Përkundrazi, të nxitet klasa që t'i kritikojë njerëzit, me qëllim që të pastrojnë të metat që kanë. Masa e punëtorëve t'u kërkojë drejtuesve të kryejnë deri në një detyrën. Po të veprohet kështu, njerëzit nuk do të kenë më guximin t'i lënë punët zvarrë, por do t'i kryejnë deri në fund. Kështu, organizata-bazë e Partisë do të bëhet me të vërtetë pararoja e klasës. Kur të bëhet mbledhja e organizatës, të ndizet një luftë e ashpër, një debat i fortë, ku të mos ketë vend familjariteti, por të ndihet që organizata është pararoja e klasës dhe drejtori i ndërmarrjes, kryeinxhinieri apo cilido tjetër, ta kuptojnë mirë se po nuk iu bindën vendimeve të saj, ajo t'i nxjerrë për të dhënë llogari përpara klasës. Drejtori, si njeri i zgjedhur i Partisë, duhet ta dijë se Partia ka caktuar disa norma dhe kompetenca, që ai e ka për

detyrë t'i zbatojë drejt dhe në mënyrë të përpiktë. Ne duhet të zbatojmë doemos frymën e Komunës së Parisit, sipas së cilës kuadrot të zgjidhen nga pararoja e klasës jo në mënyrë burokratike, por revolucionare, duke vlerësuar punën e tyre sipas fakteve. Ne duhet të ecim pikërisht në këtë rrugë.

I kemi drejt këto apo i kemi gabim? Partia kërkon nga punëtorët, në radhë të parë, që ta kryejnë këtë detyrë me lavdi, sepse vërtet fati i Partisë, i atdheut dhe i socializmit varet nga të gjitha masat punonjëse, por punëtorët duhet të jenë ata që t'i vënë në pozita luftarake drejtuesit kur s'punojnë mirë ose zvarritin kërkesat që parashtrajnë. Prandaj Partia ju ka çuar ju, punëtorët e prodhimit, si sekretarë partie, që të mos trembeni nga metodat burokratike dhe nga burokratizmi, por ta ruani frymën e klasës ashtu siç bënit kur ishit në prodhim. Kështu, duke qenë sekretarë partie, të punoni me gjallëri dhe të fortë tamam si të ishit punëtorë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

NDAJ MASAVE PUNONJËSE NUK LEJOHET ASNJË QËNDRIM MOSPËRFILLËS

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

18 shkurt 1972

Planet për sigurimin e fuqisë punëtore më duket se janë hartuar ca në mënyrë të nxituar. Është planifikuar, bie fjala, që të merren një numër punëtorësh nga Korça, por nuk është gjykuar hollë si do të vijnë ata, çfarë masash organizative duhen marrë etj. Është fare lehtë të caktohet në letër numri i punëtorëve që do të vijnë nga rrethi, po duhet menduar gjerë e gjatë si do të vijnë ata kur duhet të lënë atje familjet dhe të jetojnë larg tyre etj., etj. Ju, shokë, duhet të dini se për dërgimin e punëtorëve nga një rreth në tjetrin, ka mjaft vështirësi, veç të tjerash edhe nga ana psikologjike. Nuk është aq lehtë t'u mbushet mendja njerëzve për të punuar larg familjeve. Megjithatë,

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për sigurimin e fuqisë punëtore, përgatitjen në kohë të specialistëve dhe për krijimin e kushteve të punës dhe të jetesës në veprat e mëdha.

Partia, duke i sqaruar ata për nevojat e atdheut, të zhvillimit të ekonomisë etj. më në fund i bind dhe punëtorët, që e kuptojnë thellë në ndërgjegje detyrën patriotike, shkojnë e punojnë me vull revolucionar atje ku dërgohen.

Por, ka ndodhur që atje ku venë, nuk u krijohen kushtet e përshtatshme për jetesë, si për fjetje, ngrënie, dëfrim e të tjera, ndonëse fondet e shtetit për këto qëllime janë caktuar me kohë. Edhe planet, gjithashtu, janë përgatitur me kohë, por nuk zbatohen për faj të disa njerëzve që nuk kryejnë detyrën e ngarkuar. Këto çështje nuk kanë si kalohen pa u përgjigjur dikush, prandaj të keni shumë kujdes.

Këtu u fol, për shembull, për gjendjen e pakënaqshme në mensat e kantierit të Hidrocentralit të Fierzës. Po përse Kiço Ngjela, si ministër i Tregtisë, nuk i mori që më përpara masat e nevojshme në këtë drejtim? Mendoj që kjo pakujdesi e theksuar ka ardhur sepse drejtuesit e Ministrisë së Tregtisë e përçmojnë klasën punëtore; ata kujtojnë që punëtorëve duhet t'u jepen vetëm urdhra për t'u ngritur nga ana e anës dhe për të vajtur në Fierzë, pa s'prish asnjë punë, sipas tyre, se nuk u sigurohen kushtet e jetesës e sidomos të ushqimit! Klasa punëtore ngrihet me një vullnet dhe patriotizëm të madh dhe i përgjigjet thirrjes së Partisë e nevojave të ndërtimit socialist të vendit, prandaj nuk lejohet asnjë qëndrim mospërfilles ndaj saj! Kuzhinierët, që janë dërguar në Fierzë për të gatuar ushqimin për punonjësit nuk kanë haber ç'është kuzhina! Kjo është për të vënë duart në kokë. Ky është realiteti i «interesimit» të Ministrisë së

Tregtisë për punëtorët?! Shokët e kësaj ministrie mund të thonë sa të duan se nuk e nënvleftësojnë klasën punëtore, por qëndrimi i tyre vërteton pikërisht këtë konkluzion të hidhur. Ka mjaft kuzhinierë të aftë në restorantet e Tiranës e gjetkë ku kanë shumë mirë zyrtarët, kurse për punëtorët në Fierzë, që i ngrin të ftohtit e dëbora dhe mund të marrin plevitin në çdo orë, qenka vështirë të gjenden disa kuzhinierë të kualifikuar!

Kam marrë vesh që disa prej të rinjve kur po ktheheshin nga aksioni për ndërtimin e hekurudhës apo edhe një pjesë e studentëve nga stërvitja ushtarake, u ankuan po për pakujdesi të tilla. Është e qartë se këto ankesa të tyre natyrisht nuk drejtoheshin kundër Partisë e pushtetit, po kundër disa personave të administratës, që tregohen të pakujdesshëm në kryerjen e detyrave për sigurimin e ushqimit të nevojshëm dhe me cilësi, sipas normave që ka caktuar shteti dhe Partia. Pse ju, shokë, që ju takon të merreni me këto probleme nuk bëni kujdesin e duhur për të siguruar kuzhinierë të kualifikuar, por lejoni që të rinjtë e lodhur dhe të djersitur nga puna e stërvitja, duke kryer një detyrë patriotike, revolucionare, të mos kanë ushqimin e gatuar siç duhet?! Po për ndërtimin e kapano-neve në afatin e caktuar, pse nuk morët masat që më parë, kur janë të gjitha mundësitë?

Në ushtri, Hito, vazhdimisht gatohen vetëm pak asortimente, për të mos përmendur këtu faktin që ushtarëve ndonjëherë nuk u jepet as racioni i caktuar, sepse bëhen shpërdorime dhe vjedhje. Ky qëndrim nuk është i drejtë. Shfaqje të tilla në asnjë mënyrë nuk

mund të lejohen nga Partia. Përse e lejoni këtë gjendje dhe pastaj vini e na «justifikoheni» duke thënë që «çështja është kështu ose ashtu»? Në këtë mënyrë të mos veprohet më!

Në raportin që na keni paraqitur na ngrini ankesa të tilla që «filan rreth nuk ka dërguar pesë kuadro sa janë parashikuar, po ka dërguar vetëm dy; një tjetër nuk ka dërguar tre, po ka dërguar një» etj. dhe, sipas gjendjes së paraqitur, del sikur ne duhet t'i marrim tani në telefon ose t'u bëjmë një qarkore rretheve për të dërguar sa më parë edhe ata kuadro që nuk i kanë dërguar akoma, ndryshe bëhet «katastrofë», në një kohë kur edhe ata që janë dërguar kanë mbetur pa punë. Ç'janë këto kërkesa shokë të Ministrisë së Ndërtimit? Duke menduar e vepruar kështu do të thotë se ju që në krye nuk e keni filluar mirë punën.

Pse, nuk keni ju eksperiencë nga e gjithë puna që është bërë deri tani për ngritjen e veprave të përfunduara? Kam mendimin se gjatë kësaj periudhe për të cilën po na flitni, mund të bëhej puna edhe me më pak kuadro me arsim të lartë. E them këtë se megjithëse kemi hequr shumë specialistë të tepërt nga ndërmarrjet, prapëseprapë ato janë të mbufatura me inxhinierë. A na shërben dhe a na udhëheq eksperienca që kemi fituar në këto punë apo jo? Mbajeni parasysh këtë eksperiencë, pse kështu siç po veproni ju, më duket se ajo as na shërben, as na udhëheq, sepse punën e ndërtimit e fillojmë me shumë kuadro, kur, në fakt, një pjesë e tyre nuk duhen dhe «tundin derën». Një qëndrim i tillë në shpërndarjen dhe shfrytëzimin e punës së kuadrove, ndikon për keq, veç të tjerave, se

i mësojmë ata të rrinë pa punë dhe të bëhen dembelë. Përderisa keni filluar shpërndarjen e kuadrove specialistë të udhëhequr nga pikëpamje të tilla, ka rrezik të vazhdoni përsëri deri në fund me po këto mendime.

Duke arsyetuar në këtë drejtim, shtroj edhe pyetjen: na duhen neve medocemos kaq inxhinierë ndërtime ose inxhinierë mekanikë sa po mësojnë tani në universitet? Në qoftë se numri i studentëve për këto degë është caktuar pa kriter, duke menduar: «oburra, të kemi sa më shumë inxhinierë!», nuk mund të kemi një përputhje të numrit të kuadrove që përgatiten me nevojat tona në perspektivë. Këtë e them jo vetëm për kuadrot me arsim të lartë, po edhe për ata me arsim të mesëm, për mjeshtrit etj. Dhe ndodh pastaj, siç u tha këtu, që inxhinieri të bëjë punën e brigadierit apo të teknikut.

Është detyra jonë të gjejmë shkakun përse ka shfaqje të tilla. Sipas mendimit tim, këto vijnë ngaqë u jepet rëndësi e madhe inxhinierëve e jo teknikëve, sepse është krijuar një mentalitet i padrejtë që të luftohet për diplomën dhe jo për profesionin.

Më kanë raportuar se kemi disa teknikë të mesëm që kanë fituar një eksperiencë aq të pasur në shkollën e madhe të punës, sa ia kalojnë, në praktikë, edhe ndonjë inxhinieri që ka mbaruar fakultetin. Dhe, këtyre teknikëve kaq të zotë në punë, u vihet mbi kokë një inxhinier që ka mbaruar vjet shkollën.

Ne duhet të vendosim rregulla në rrogën e inxhinierëve. Inxhinieri që porsa del nga universiteti dhe është i ri në zanaat, mund të paguhet më pak jo vetëm nga inxhinierët më të vjetër, po edhe nga një

teknik i kategorisë së lartë. Vetëm, pasi të ketë fituar një praktikë disavjeçare e të ketë arritur në një nivel të mirë teknik në punë, mund t'i jepet një rrogë më e lartë. Pra, ai shkallët t'i ngjitë dalngadalë. Inxhinieri i ri sot s'ka ato detyrime familjare si dikur. Ishte ndryshe puna në vitet e para pas Çlirimit. Atëherë inxhinierët, si gjithë punonjësit, kishin shumë detyrime, pse në familjet e tyre s'kishin njeri tjetër në punë. Prindërit e atyre që mbarojnë shkollën tani punojnë vetë ose marrin pensionin; e fejuara ose gruaje e kuadrit të ri gjithashtu është ose do të jetë në marrëdhënie pune. Kështu që, as nga ana ekonomike, ky trajtim në pagë nuk u krijon njerëzve tanë ndonjë vështirësi, prandaj specialisti i ri mund të jetojë edhe me një pagë më të vogël.

Këto janë probleme të mëdha parimore dhe kanë të bëjnë shumë me luftën kundër shfaqjeve të intelektualizmit e të teknokratizmit. Ngaherë flasim për teknokratizmin, por nuk kuptohet kurdoherë mirë thelbi dhe rreziku që vjen prej tij. Një shprehje e teknokratizmit është edhe grumbullimi në byronë teknike i shumë inxhinierëve me diplomë, të cilët nuk e përfillin si duhet mendimin e teknikëve dhe të punëtorëve të vjetër me eksperiencë të madhe. Ndothë nganjëherë që, për të rrëzuar disa mendime të drejta të punëtorëve, ndonjë intelektual mburret me diplomën. Kjo është krejt e padrejtë dhe në kundërshtim me mësimet e Partisë. Le të jetë inxhinieri me diplomë, por, ashtu siç ka nevojë dhe mëson punëtori prej tij, duhet të mësojë edhe ai nga një punëtor që ka disa vjet eksperiencë pune. Punëtorët e respektojnë

diplomën e inxhinierit, por ata me të drejtë shikojnë edhe punën që bën ai konkretisht. Për inxhinierët që janë me të vërtetë të zotë dhe përpiqen të kualifikohen e të mësojnë pas mbarimit të shkollës, punëtorët kanë respekt më shumë se për ata që duan të jetojnë në sajë të diplomës, pa bërë shumë përpjekje në punë. Prandaj, këto probleme duhet t'i shikojmë.

Duke u nisur nga këto që thashë, mendoj se nuk është e rekomandueshme që një inxhinier i ri, me të mbaruar fakultetin, të marrë rrogë që është gati e barabartë me atë të një inxhinieri tjetër, i cili ka punuar tërë jetën dhe jep rendiment të lartë në punë.

Të kuptohemi drejt, ne nuk i nënvleftësojmë kuadrot e rinj dhe nuk vëmë aspak në dyshim diplomat që marrin. Përkundrazi, ata i çmojmë si njerëz me perspektivë, por, në fillim, të përpiqemi t'i mësojmë për ato gjëra që kanë nevojë dhe u lypsen më shumë në jetë.

Për sa i përket shpërblimit të punonjësve për «vështirësi shërbimi», unë propozoj të studiohet kjo çështje, se nuk është e drejtë që nëpunësit dhe teknikët, të cilët kanë pagë më të madhe, ta përfitojnë këtë të drejtë, kurse punëtorët jo, pse i pengoka puna me normë. Është shumë e drejtë ajo që tha shoku Manush [Myftiu], që, në qoftë se nëpunësi ka në ngarkim familjen që duhet ta ushqejë, edhe punëtori ka gruan dhe kalamanët e tij. Kjo duhet rregulluar sidomos për ata që punojnë larg familjeve. Mua më duket se rregullimi i gjertanishëm i këtij shpërblimi është një favor që u bëhet vetëm punonjësve të administratës dhe një disfavor që i bëhet klasës punë-

tore. Marrin nëpunësit dhe teknikët pse, sipas koncepteve intelektualiste, ata «duhet të rrojnë më mirë se punëtorët»!

Po e përsëris që këtë gjë duhet ta shikojmë mirë, se kështu si është nuk vete fare. Mësova se drejtori i ndërmarrjes komunale në Lezhë merrte dietë të plotë edhe kur shkonte në Shëngjin, që është një çerek ore larg qytetit të Lezhës. Ai, jashtë çdo rregulli, përfitonte kështu pa të drejtë atë që nuk i takonte. Ka dhe të tillë njerëz të pandërgjegjshëm, prandaj këto akte të paligjshme nuk duhen nënvleftësuar.

Shokë, parimet e Partisë duhet t'i zbatojmë në mënyrë revolucionare dhe për këtë qëllim të përpiqemi të gjejmë forma e metoda sa më të mira. Të më falni se për një çast ndoshta po shkëputem nga tema, por dua t'ju vë në dijeni se para disa ditësh më erdhi një letër anonime nga Shirgjani i Elbasanit. Shokët atje paskan dhënë urdhër të shiten ose të theren bagëtitë e oborreve kooperativiste! Nga kush dhe përse është bërë ky akt arbitrar? Asnjëri nga shokët e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit nuk i del zot fajit. Si kooperativistët që i kanë shitur, edhe ata që i kanë therrur bagëtitë, kanë mbetur të pakënaqur nga ky urdhër, prandaj pyesin: «ç'është kjo direktivë që u dha dhe kush e ka fajin?». Ai që m'u drejtua mua, shkruante: «Po na marrin në qafë, po na lënë fëmijët pa qumësht e pa mish! Është e mundur të vazhdojë kështu kjo gjendje?». Kur kryhen akte të tilla, ndodh shpesh që personat fajtorë bëjnë një «autokritikë» andej-këtej, sa për të hedhur hendekun. Unë mendoj se personi që dha këtë urdhër në Shir-

gjan të vejë menjëherë atje dhe të japë llogari. Besoj se e kuptoni, shoku Jashar [Menzelxhiu]¹? Këto janë forma revolucionare të punës që duhen praktikuar. Komiteti Qendror nuk ka thënë të hiqen bagëtitë e oborreve, bile as në kooperativat e tipit të lartë, për sa kohë që nuk sigurojmë dot qumështin për nevojat e gjithë kooperativistëve. Aktualisht ne nuk sigurojmë dot as qumështin për të plotësuar siç duhet nevojat e punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore, pale më për kooperativistët. Atëherë, me ç'mend u thuhet atyre që të shesin bagëtitë e oborreve dhe në vend të tyre të blejnë lopë? Pastaj, ku t'i gjejnë ata lopët? Këto punë nuk bëhen kështu. Ju mund të na thoni se nuk dini gjë për këto punë, por edhe kjo në asnjë mënyrë nuk ju lejohet që të mos e dini.

Po ju, shoku Jashar, kryetarin e komitetit ekzekutiv të rrethit ose shefat e furnizimit të ndërmarrjeve, ju kanë vënë ndonjëherë me shpatulla për muri punëtorët, duke ju kritikuar për të metat që vërtetohen? E kanë bërë ndonjëherë ata këtë? Nuk e kanë bërë. Unë mendoj se kjo vjen se disa herë kuadrot i shmangen ballafaqimit me punëtorët dhe këta, gjithashtu, nuk i kritikojnë kuadrot. Këtë ta themi shqip. Në këto raste nuk ekziston besimi reciprok midis kuadrove dhe punëtorëve, për të cilin flet Lenini. Kuadrot vërtet u thonë punëtorëve të kenë besim tek ata, po ama edhe ata vetë nuk kanë gjithmonë besim te punëtorët.

1. Në atë kohë, sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit.

U fol këtu për atë rastin kur në një brigadë u caktua një komunist, por punëtorët protestuan, duke thënë: «Është njeri ngatërrestar», «Nuk është në rolin pararojë që të na frymëzojë edhe ne me punën e tij». Shumë drejt e kishin ata dhe shumë gabim u bë që u ndërhy. Në krye të kësaj brigade duhej të vihej një punëtor tjetër, qoftë edhe i paorganizuar në Parti. Çfarë do të bëjë ai «komunist» atje, kur punëtorët nuk e duan dhe nuk i besojnë? Ai që nuk gëzon besimin dhe dashurinë e punëtorëve dhe të masave, nuk mund të quhet komunist. Përrjashtohet ose jo, kjo është një çështje që duhet ta gjykojë organizata-bazë lidhur me tërë veprimtarinë e tij, me të mirat dhe anët negative që ka ai në punë e në jetë, por, fakti që punëtorët nuk e duan, shpreh një dobësi të madhe të këtij njeriu që mban taserën e Partisë.

Kritika që i bënë punëtorët këtij komunisti i adresohet edhe organizatës së Partisë atje, si dhe atyre që e mbështetën këtë ngatërrestar. Shikoni sa thellë duhen gjykuar punët?! Atje është analizuar vetëm puna e atij ngatërrestari, por duhet shikuar edhe tërë puna e atyre që e kanë mbrojtur atë e të jepet përgjigjja se përse e kanë lënë atë njeri të veprojë kështu?

Pa dilni njëherë para punëtorëve dhe u thoni: «More, shokë punëtorë, çfarë keni për të thënë për punën tonë?».

Po sikur, sipas tezave të Leninit, të ngrihet një punëtor dhe t'ju thotë: «Të gjitha këto që themi ne për punën tuaj, bashkë me zotimet që morët, ju lutemi ia dërgoni Komitetit Qendror të Partisë», nuk do

të jetë kjo një gjë shumë e drejtë dhe e bukur? Kjo do të ishte tamam siç thoshte Lenini. Atëherë do t'i shohim më mirë e më seriozisht të metat që ekzistojnë. Ne, Komiteti Qendror, në një rast të tillë, do t'u përgjigjeshim punëtorëve: «Shokë punëtorë, të gjitha vërejtjet tuaja duhet t'i ketë parasysh dhe t'i zbatojë Partia në rreth. Shokët e udhëheqjes në rreth kanë bërë mirë që kanë marrë zotime por, në qoftë se nuk i zbatojnë ato në kohën e duhur, çështja e tyre duhet parë». Pas kësaj të shikoni se si do të bëhen njerëzit «lule», e puna do të kryhet më mirë. Kështu do të forcohen më shumë Partia dhe disiplina, do të ngrihen në një shkallë më të lartë ndërgjegjja dhe besimi reciprok i kuadrove dhe i punëtorëve. Pse të mos veprojmë kështu, kur një gjë e tillë është e drejtë? Derisa Partia është e punëtorëve dhe ka besim të madh në ta, derisa punëtorët kanë besim të madh te Partia e tyre, atëherë ata kanë plotësisht të drejtë të ngrenë zërin e klasës në fuqi. Të kuptohemi, unë flas këtu për klasën punëtore në përgjithësi, jo për disa individë të veçantë që mund të jenë punëtorë, por që kanë degjeneruar, nuk zbatojnë vijën e Partisë e tërheqin këmbët zvarrë, duke kërkuar të zhvatin nga shoqëria atë që nuk u përket.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

DITURIA DHE SHKENCA TË PËRHAPEN GJERËSISHT NË MASAT DHE TË PËRVETËSOHEN PREJ TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

19 shkurt 1972

Para se të fillonte diskutimi i kësaj pike të rendit të ditës së mbledhjes, shoku Enver Hoxha bëri disa pyetje, lidhur me raportet e paraqitura:

Këtu në material thuhet që «...fusha të tilla si ato të teknikës, të mbarështimit të kafshëve e të organizimit të prodhimit blegtoral, nuk janë prekur gati fare nga kërkimet shkencore...».

Çfarë duhet të bëjmë dhe ç'masa duhet të marrim, sipas mendimit tuaj², që të preken këto fusha?

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit për punën e kryer nga Instituti i Kërkimeve Zooteknike, Instituti i Kërkimeve Veterinare dhe Instituti i Kërkimeve Bujqësore i Lushnjës në veprimtarinë kërkimore shkencore dhe perspektivat e saj në blegtori, si dhe për prodhimin e foragjereve.

2. U drejtohet kuadrove drejtues të institucioneve shkencore, të thirrur në këtë mbledhje.

Si mendoni ju të zgjeroheni në këtë çështje kaq të rëndësishme?

Më poshtë, në raport është shkruar: «... do të hedhim hapat e parë në drejtim të studimeve ekonomike të problemeve të blegtorisë që kanë të bëjnë me përqendrimin dhe specializimin e këtij sektori në ekonominë e mëdha...». Mund të na i thoni më konkretisht hapat e parë që do të hidhen, ku qëndrojnë rreziqet që duhet të parashikojmë dhe masat që duhet të marrim për të arritur suksese në fushën e specializimit?

Kisha edhe një pyetje tjetër lidhur me shpërndarjen e rreth një milion e dyqindmijë zogjve të pulave të racës për vezë që përmendet në raport. Këta zogj janë shpërndarë në mënyrë të pakontrolluar e të çrregullt, sa i «ka marrë era»; apo keni vepruar me kujdes që të shtohen në mënyrë të organizuar dhe të kontrolluar. Duam të dimë që, në qoftë se kjo punë gjer tani s'është bërë mirë, atëherë çfarë masash duhen marrë në të ardhmen, sipas mendimit tuaj, nga Ministria e Bujqësisë për shtimin e racës së pulave për vezë?

A vërtetohet nga ana shkencore cikli i përmirësimit në vend, për shembull, në rastin e racës «Cigaja»? Në sa breza duhet punuar për të arritur në një racë konstante të përmirësuar? Në qoftë se nuk gabohe, këtë punë ne e kemi filluar në vitin 1958, në mos më parë. Prej asaj kohe e deri në vitin 1971 kanë kaluar vite. Çfarë konstatimesh keni ju për këto brezni?

Deri tani është vërtetuar se masat konkrete për përmirësimin e ushqimit ndikojnë për rendimentet në lesh, në mish etj. Po për sa i përket përmirësimit të

kafshëve si racë, në baza shkencore, është vërtetuar?

Natyrisht, ndërmarrjet bujqësore dhe disa kooperative bujqësore të tipit të lartë në zonat fushore mund t'i mbajnë kafshët në ato nivele që ka bota sot. Por, duke marrë parasysh kërkesat që kemi ne për lesh, qoftë për të plotësuar nevojat e vendit, qoftë për eksport, a është i leverdishëm krijimi i tufave të përshatshme të këtyre kafshëve që kanë arritur, për shembull, në një stad të vërtetë shkencor, duke na dhënë lesh si «Maliqi»? E vlen barra qiranë t'u rezervojmë këtyre njëfarë hapësire, sigurisht, jo fort të madhe, por pak më shumë se sot? Direktivat e Komitetit Qendror për këto probleme janë të qarta e të kuptueshme, në përgjithësi, por unë e ngre këtë çështje se mos në zbatimin e tyre bëhen teprime dhe veprime të pathëlluara si, bie fjala, mos mendohet aty-këtu se duhet zhdukur delja te ne «meqë po zhvillojmë lopën e të tjera»?!

Për një sërë sëmundjesh që shkaktohen tani nga regjimi stallor janë dhënë orientime të vlefshme, por puna duhet vazhduar pa ndërprerje. Keni organizuar ju kurse të veçanta me veterinerët e bazës për t'u mësuar atyre se si ta vënë në rrugë të mbarë këtë problem? Keni mbajtur konferenca, referate e të tjera, që ata të kualifikohen më tej?

Organizohet nga ju një propagandë veterinare për mbarështimin e kafshëve sikundër bëhet rregullisht, çdo javë, në radio për shëndetin e njerëzve në emisionin «Këshilla mjekësore»? Zhvilloni ju leksione të veçanta, të thjeshta, konkrete dhe të kuptueshme për rritësit e viçave, si, bie fjala, për mënyrat e paranda-

limit të ngordhjeve, mënyrat e të ushqyerit etj., etj.? Nuk e kam fjalën këtu për të bërë në radio «teori të madhe» për llojin dhe përbërjen e lëndëve ushqyese, për kaloritë që jep secila prej tyre etj., etj. (që, gjithashtu, kanë shumë rëndësi), por pyes sidomos për këshillat e domosdoshme praktike që nuk njihen mirë dhe duhen zbatuar për mirërritjen dhe trajtimin e kafshëve. Po kështu, mund të hapeshin dhe kurse ku të theksoheshin rreziqet që sjellin sëmundjet e ndryshme për ngordhjen e kafshëve, duke folur konkretisht për secilën prej tyre e të tjera.

Në materialin e paraqitur thuhet se numri i lopëve të prekura nga sëmundja e tuberkulozit ka rënë. Po në viçat si paraqitet gjendja e kësaj sëmundjeje? Ka në këtë drejtim ndonjë gjë shqetësuese? I mbani të veçuara lopët e prekura nga tuberkulozi? Jo vetëm kaq, por dhe viçat duhet përnjëherësh të veçohen e të mbahen në një regjim të përshtatshëm nga ana sanitare.

Në Lushnjë, ku është qendra e Institutit të Kërkimeve Bujqësore, ruajtjen dhe përtëritjen e farërave e bëjnë në rregull. Po në ekonomitë e tjera interesohen për farën si për një nga komponentët më të rëndësishëm të konvejerit të gjelbër dhe të ushqimit të bagëtive?

Për shembull, Ndërmarrja Bujqësore e Lushnjës është fare pranë institutit, prandaj komunikimi me të është i lehtë. Po në ndërmarrjet e tjera bujqësore si shkon kjo punë? A ka hyrë edhe në to konvejeri i gjelbërt? Zbatohet atje eksperiencia e përparuar dhe rezultatet shkencore që ka arritur Instituti i Kërki-

meve Bujqësore apo jo? Si e mendoni ju dhe si e argumentoni propozimin që të krijohet një institut i ri për foragjeret? Me fjalë të tjera, si duhet të organizohet ky institut, në ç'baza, çfarë rezultatesh pritet që të japë? Pra, të na shpjegohet pse është i nevojshëm e çfarë ndihme mund të kërkojë në fillim.

Ku mendoni se duhet ta ketë bazën instituti i foragjereve, në cilin vend? Si mendoni të jetë stacion apo institut?

Pasi shokët e thirrur në raport iu përgjigjën pyetjeve dhe pasi diskutuan edhe shokë të tjerë, në fund e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Edhe unë jam dakord me materialet e paraqitura nga institutet kërkimore shkencore të bujqësisë, si për përmbajtjen shkencore të këtyre materialeve, ashtu dhe për punën që bëhet për zbatimin praktik të kërkimeve nga këto institute. Prandaj në këtë drejtim nuk kam shumë gjëra për të shtuar.

Mendimi im është se institutet tona të kërkimeve bujqësore, zooteknike e veterinare punojnë mirë, pavarësisht se në veprimtarinë e tyre ka edhe të meta. Megjithatë, për problemet që këto institute kanë përpara për të zgjidhur, ose për ato që janë studiuar e duhen thelluar më tej, ashtu edhe për problemet e tjera të reja, të cilat akoma nuk janë atakuar, por që duhet të atakohen e të zgjidhen sipas kushteve tona, zgjerimi i njohjes dhe thellimi në këto probleme janë në rendin e ditës. Sidoqoftë, orientimet kryesore e të përgjithshme të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë, shokët e këtyre institucioneve, më duket, i kanë për-gafuar dhe jo vetëm bëjnë përpjekje inkurajuese për

njohjen e përhapjen e tyre, por tregojnë një interesim të madh edhe për zbatimin e tyre në jetë.

Sot ne po marrim në studim aplikimin e rezultateve shkencore të arritura në punën e këtyre institucioneve. Në këtë çështje të jemi të kujdesshëm e objektivë dhe të mos përpiqemi që gabimet në moszbatimin e detyrave nga hallkat e tjera t'ua hedhim në kurriz këtyre instituteve. Nga kjo pikëpamje është e domosdoshme të jemi realistë, të mos kërkojmë që këto institucione të kryejnë edhe funksionet, ta zëmë, të Ministrisë së Bujqësisë, të seksioneve të bujqësisë pranë komiteteve ekzekutive, të kryesive të kooperativave bujqësore, të stacioneve eksperimentale, deri edhe të atyre të Partisë në bazë. Po ta kërkonim një gjë të tillë nga ana e tyre, do të gabonim.

Po kështu ne do të gabonim në rast se ngarkojmë me faj Institutin e Zooteknisë se nuk paska përcaktuar sasinë e ushqimeve që duhet të hanë bagëtitë ose qysh do t'i hanë ato. Pa hyrë në hollësi të këtij problemi, mund të themi se këto sasi janë të caktuara dhe të njohura. Prandaj rëndësi ka që ne t'i sigurojmë ato. Pra, ushqimet për blegtorinë, së pari, duhen prodhuar. Për këtë qëllim është e domosdoshme të thyejmë mentalitetin e vjetër për trajtimin jo si duhet të blegtorisë, mentalitet që ekziston akoma i fortë jo vetëm në kooperativat bujqësore, po edhe në ndërmarrjet bujqësore dhe në vetë organizatat e Partisë të këtyre. Ky është një problem i madh partie. Në këtë çështje nuk mund të veprohet si në të kaluarën, por as të kënaqemi me njëfarë përmirësimi që është arritur gjermë sot. Mentalitetet e vjetra e prapanike për blegto-

rinë duhet të luftohen, pra, të punohet vazhdimisht që ato të thyhen e të zhduken.

Del, pra, nevoja që njerëzve tanë t'u bëhet mirë e qartë se që të ushqehet bagëtia gjatë gjithë vitit, kryesorja është që ushqimet e parashikuara për këtë qëllim t'i sigurojmë, sepse fakt është që megjithëse merren zotime për këtë problem, këto nuk vihen në jetë. Sa herë është thënë e është planifikuar për të mbjellë lakër apo të tjera foragjere për blegtorinë, por, kur vjen koha të veprohet realisht që të mbillet kjo ose ajo bimë, me qëllim që bagëtive t'u sigurohen ushqimet sipas normave të caktuara, shifrat nuk realizohen. Atëherë, kush e ka fajin në këtë rast? Mos vallë Instituti i Kërkimeve Bujqësore apo ato të kërkimeve zooveterinere? Jo, shokë, fajin nuk e kanë aspak institutet, po e ka, në radhë të parë, Partia në bazë. Këtë problem parimor politiko-ekonomik me rëndësi të madhe është e domosdoshme ta ketë mirë të qartë, në radhë të parë, çdo anëtar i Partisë, po ka rëndësi ta kenë, gjithashtu, të qartë edhe të gjithë ata që janë të interesuar për zgjidhjen e plotë të tij. Për realizimin e kësaj detyre është, pra, e domosdoshme të kryhet një punë e madhe organizative, politike dhe ekonomike.

Institutet tona kërkimore kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin orientime shkencore, në bazë të të cilave, në përgjithësi, punohet mirë dhe kemi rezultate. Në sektorin e blegtorisë kemi suksese, këto janë të dukshme për të gjithë, pavarësisht se akoma ka edhe të meta e dobësi. Megjithatë, duhet ta konsiderojnë pozitiv faktin që në sektorin e blegtorisë sot kemi arri-

tur t'i pakësojmë në minimum disa lloj sëmundjesh të rrezikshme, si tuberkulozin, brucelozën etj. dhe që jemi në gjendje të prodhojmë në vend vaksina të llojeve të ndryshme për të luftuar ato sëmundje, nga të cilat preken më shumë bagëtitë tona. Masat kundër sëmundjeve të metabolizmit duhet të jenë të vazhdueshme mbasi rreziku i tyre ekziston gjithmonë. E them këtë se ato janë dukur kurdoherë te kafshët, ndaj nuk duhet të nënvleftësohen. Ne mund t'i kritikojmë shokët e Institutit të Veterinarisë se janë ca vonë në prodhimin e vaksinave për mbrojtjen e shpendëve nga sëmundjet që na i shfarosin në masë, por kam besim se ata do të arrijnë ta bëjnë edhe këtë. Duhet njohur, pra, se sukseset e arritura në këtë fushë janë të mëdha, gjë që i detyrohet edhe punës që ka bërë në këtë drejtim për një kohë të gjatë Instituti i Veterinarisë.

Një propagandë e gjerë bëhet dhe mjaft suksese janë arritur edhe në ndërzimet artificiale të bagëtisë. Pushteti ka akorduar për këtë qëllim fonde të mëdha, janë ngritur shumë stacione ndërzimi dhe puna vazhdon. Në këtë drejtim ne nuk mund të injorojmë punën që ka bërë Instituti i Zooteknisë. Megjithatë, në këtë fushë vërchet se ka mjaft lëshime. Po kush i bën këto lëshime? Në këtë çështje duhet ta përqendrojmë seriozisht vëmendjen. Lëshimet, më duket mua, bëhen më shumë në bazë, ku ka raste që organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit i thjeshtojnë gjërat, nuk bëjnë përpjekje të mëdha për t'i kuptuar thellë e në mënyrë të gjithanshme orientimet e drejta dhe direktivat e Komitetit Qendror të Partisë e të Qeverisë, si dhe udhë-

zimet e këtyre instituteve dhe të Ministrisë së Bujqësisë për zhvillimin e blegtorisë.

Kur flasim për specializimin e llojeve të kafshëve në blegtori, për shembull, për specializim lopësh, derrash ose shpendësh, duhet të kuptojmë lopë për qumësht ose për qumësht e mish, derra për dhjamë ose për mish, shpendë për mish ose për vezë etj. Si mund të flasim në se në bazë ka interes të madh për zhvillimin e blegtorisë dhe ca më tepër në mënyrë shkencore, kur nuk zbatohet si duhet orientimi i dhënë që të luftohet për përmirësimin e racës së bagëtive, kur nuk punohet kudo ashtu si duhet që të ketë lopë edhe për qumësht, edhe për mish, kur nuk luftohet në mënyrë konsekuente për dele të racës, duke bërë përpjekje që të ketë edhe nga këto për mish dhe për llesh, që të tilla lloje të mira bagëtish të ketë edhe në kooperativat e tipit të lartë etj.?

Pakujdesia në bazë është një fakt që pranohet edhe në materialin e paraqitur ku thuhet që «...veterinerët e bazës nuk interesohen sa duhet...».

Ç'ndodh në praktikë? Sipas statutit të këtyre kooperativave kërkohet që këto të mbajnë lopë si për qumësht, ashtu edhe për mish e për plch, sepse lopa është më rentabël. Mirëpo, kjo direktivë e drejtë e Komitetit Qendror, në bazë është shtrembëruar. Tani që statuti i kooperativave të tipit të lartë nuk është aprovuar akoma, seksioni i bujqësisë i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Elbasanit (ku janë grumbulluar për të punuar rreth 20 specialistë), jep një direktivë që është në kundërshtim me udhëzimet e dhëna. Në bazë të kësaj të ashtuquajture

direktivë, kooperativistëve u kërkohet që t'i therin të gjitha bagëtitë e imëta të oborreve dhe ato t'i zëvendësojnë me lopë. Këtë gjë e mora vesh nga një letër që më erdhi nga Shirgjani, para disa ditësh (e cila, megjithëse anonime, tregon atë që ky orientim është dhënë). Mirëpo kjo ka bërë që jo vetëm në këtë kooperativë, por edhe në të tjera të shkohet drejt likuidimit të bagëtive të imëta.

Si është e mundur të ngjasin shtrembërime të tilla, shokë? Përgjigjja del vetvetiu: jo kudo njerëzit tanë thellohen në kuptimin e drejtë të direktivave. Në mënyrë të veçantë punonjësit e seksionit të bujqësisë së komitetit ekzekutiv, që ka në vartësi një numër jo të vogël specialistësh, është e domosdoshme t'i studiojnë me themel udhëzimet e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë dhe pastaj të mendojnë se si t'i zbatojnë ato sa më drejt në jetë. Nuk janë në dijeni punonjësit e këtij seksioni që, para se të jepet urdhër për të therur delet e oborreve, është e domosdoshme të sigurohet qumështi për nevojat e familjeve kooperativiste, të cilat, tani që bagëtitë, sipas urdhrin, i kanë likuiduar, me të drejtë janë ngritur dhe kërkojnë të furnizohen? Ato kanë shumë të drejtë të kërkojnë qumësht nga kooperativa. Prandaj, as në kooperativat e tipit të lartë nuk mund të theren bagëtitë e imëta, pa siguruar më parë lopët që do t'i zëvendësojnë ato e, si rrjedhim, edhe qumësht për anëtarët.

Vihet pyetja: Për ç'qëllim e bëjmë ne këtë organizim, mos vallë për administratën? Jo, kjo administratë në këto kooperativa krijohet që të ndihmojë

rritjen e prodhimit dhe sigurimin e mirëqenies së masës së anëtarëve të kooperativës, ndryshe nuk ka asnjë kuptim hapi që po bëjmë. Ne e dimë fare mirë se për të ngritur një blegtori të përparuar me bazë lopën, duhet njëfarë kohe, mirëpo, gjersa t'ia arrijmë këtij objektivi, jemi të detyruar të mbajmë atje me domosdo edhe një sasi dhensh apo bagëtish të tjera, sipas orientimit që ka dhënë Komiteti Qendror. Kup-tohet që në Elbasan nuk e kanë pasur parasysh si duhet këtë punë, dhe, kur pyesim kush e ka dhënë këtë orientim dhe ku është bazuar ai, asnjëri nuk i del për zot. Sigurisht ai ka dalë nga aparati i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, por nuk del konkretisht se kush janë ata që kanë urdhëruar.

Unë jam dakord që puna e instituteve të mos zhvillohet në një kuadër të mbyllur, pse kjo nuk përputhet me vijën e Partisë. Në socializëm asnjëri nuk mund të mbyllet në «kullën e fildishtë». Gjithçka që bëhet e prodhohet te ne, duhet t'u shërbejë vetëm masave të popullit, lumturisë së punonjësve, pra, interesit të përgjithshëm. Socializmi nuk mund të ndërtohet nga një pakicë, as vetëm nga Partia, as vetëm nga njerëzit e mësuar të instituteve, po me pjesëmarrjen e masave të gjera të popullit. Kjo vë detyrën që dituria, shkenca, të përhapen edhe në to, të përvetësohen gjerësisht prej tyre. Për këtë qëllim Partia përgatit njerëzit e mësuar, specialistët, që me intelektin e tyre, ta zhvillojnë shkencën më tej, njëkohësisht ta çojnë edhe në bazë, ta bëjnë sa më të kuptueshme për masat e gjera të punonjësve. Barrën e madhe të përvetësimit dhe të përhapjes në shkallë të gjerë të

shkencës dhe të zbatimit të saj në jetë në socializëm nuk mund t'ua ngarkojmë vetëm profesorëve, doktorëve, inxhinierëve, veterinerëve, ekonomistëve etj. Këta, si njerëz të mësuar, duhet të sqarojnë e të mobilizojnë masat dhe, së bashku me to, të punojnë për t'i vënë në jetë të rehat e shkencës. Unë jam plotësisht dakord me atë që u tha këtu se po të jetë që ata nuk e kanë bërë si duhet këtë punë, këtë e tutje të përpiqen ta bëjnë edhe më mirë.

Në qoftë se Partia dhe pushteti në bazë, udhëheqja ekonomike e çdo kooperative bujqësore nuk i thihnin dhe nuk i zbatojnë si duhet në jetë këto gjëra, natyrisht, jo me urdhra, po në mënyrë të ndërgjegjshme, duke i konsideruar si nevojë jetike dhe në interes të masave të popullit dhe të ndërtimit të socializmit, punët nuk do të na ecin përpara. Në qoftë se për zgjidhjen e këtyre problemeve të rëndësishme pritet që çdo gjë të kryhet vetëm nga institutet kërkimore shkencore dhe stacionet eksperimentale, atëherë e kemi komprometuar direktivën. Ne duhet të punojmë që orientimet të zbatohen drejt në jetë, që në këtë drejtim të zhvillohen sa më shumë iniciativat e masave të gjera të fshatarësisë. Edhe këto të nxiten që të punojnë për të gjetur rrugë të tjera të mëtejshme zhvillimi, ashtu sikurse ngjet në një shkallë më të gjerë në sektorët e tjerë të ekonomisë e të kulturës së vendit tonë. Të mos kufizohemi dhe as të mos kënaqemi me kërkesën për të aplikuar vetëm udhëzimet e dërguara nga lart. Duhet bërë përpjekje që këto të zbatohen medoemos dhe gjer në fund, po ato duhen zbërthyer në detaje, sepse plot gjëra të tjera të papa-

rashikuara dalin në praktikë, prandaj t'u lëmë iniciativë njerëzve që t'i zhvillojnë e t'i zbërthejnë më tej udhëzimet, nga të cilat do të dalin probleme të reja që duhen zgjidhur. Që tani mund të lindë nevoja për të ndryshuar shumë nga udhëzimet që dikur kanë qenë me vend, por që aktualisht u ka kaluar koha, se nuk janë të përshtatshme për situatën që po kalojmë etj.

Mua më duket se Partia në bazë duhet të shkundet absolutisht shumë në këtë drejtim dhe të mos mbëshetet qorrazi në udhëzimet e deritanishme. Kjo do të thotë që zgjidhjen e problemeve shkencore ta vëmë nën kontrollin e rreptë të masave të Partisë dhe të popullit dhe të kërkojmë nga secili që ta kryejë detyrën si duhet.

Kjo është e domosdoshme. Rëndësi ka edhe çështja që shokët e këtyre instituteve ne t'i ndihmojmë në punën e tyre, por kërkojmë që edhe këta të na ndihmojnë ne.

Botuar për herë të parë me ndonjë shkurtim në librin: Enver Hoxha. «Për Shkencën (Përmbledhje vep-rash)», vëll. I. f. 454

Botohet i plotë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, që gjendet në AQP

PUNONJESI DUHET TË MËSOJË MIRË DHE ME KËMBËNGULJE PËR PROFESIONIN QË USHITRON

*Nga biseda me anëtarë të plenumit të Komitetit
të Partisë të Rrethit të Matit¹*

25 shkurt 1972

*Në pushimin midis seancave të plenumit shoku Enver Hoxha iu afrova një grupi pjesëmarrësish të mbledhjes dhe, pasi u takua e i përshëndeti me për-
zemërsi, nisi një bisedë të ngrohtë me ta:*

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni, shokë, me shëndet? Në vend të bukur e keni ndërtuar shtëpinë tuaj të kulturës ku jemi mbledhur sot. Edhe si ndërtesë e mirë është. Siç më thanë, këtë objekt të bukur e ngritët në vend të xhamisë që ishte pikërisht në këtë vend. Sigurisht, këtu zhvillohen vazhdimisht aktivitete kulturore e artistike, se populli i Matit e do kulturën, ai i do këngët e vallet dhe, nga sa jam në dijeni, në rrethin tuaj, si kudo, ka këngëtarë e valltarë me talent.

Me punë si ia çoni? Si po zgjidhen problemet e rrethit sidomos në bujqësi e blegtori?

1. Ky plenum i zhvilloi punimet më 25-26 shkurt 1972.

Ti, shoqe,¹ çfarë pune bën?

SHOQJA LUTFIE GJONI: Unë jam brigadiere.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë! Si brigadiere, a të mbetet kohë të punosh në brigadë bashkë me shoqet, siç punoje kur ishe anëtare e thjeshtë e kooperativës? Sa ditë punon në prodhim tani?

SHOQJA LUTFIE GJONI: Tani në prodhim bëj vetëm 70 ditë-punë në vit.

SHOKU ENVER HOXHA: Pra, tani bën më pak se më përpara. Kjo është e natyrshme dhe ndodh jo se të mungon dëshira për të punuar, por sepse, për ta kryer si duhet detyrën e brigadies dhe duke marrë parasysh se sektori që ke në përgjegjësi është i hapur, të duhet mjaft kohë. Me se merresh zakonisht gjatë ditës në sektorin ku punon?

SHOQJA LUTFIE GJONI: Kontrollon punën e gjithë shokëve dhe shoqeve të brigadës, duke kaluar nga skuadra në skuadër, shikoj si e kanë kryer ata punën.

SHOKU ENVER HOXHA: Çfarë kupton ti konkretisht me fjalën kontroll?

SHOQJA LUTFIE GJONI: Kontrollon kryesisht cilësinë e punës.

SHOKU ENVER HOXHA: Duke kontrolluar cilësinë e punës, ti me siguri ke parasysh jo vetëm t'u kërkosh llogari shokëve dhe shoqeve që nuk kanë punuar mirë, por në të njëjtën kohë t'u tregosh edhe konkretisht si të punojnë për ta kryer punën me cilësi të lartë.

Cilësia e dobët në prodhim mund të shkaktohet për dy arsye: nga paaftësia ose nga qëndrimi jo i ndër-

1. I drejtohet shoqes Lutfie Gjoni.

gjegjshëm në punë. Për këtë, ty si brigadiere të dalin dy detyra: të mësosh vetë si duhet punuar, njëkohësisht t'i edukosh shoqet dhe shokët e brigadës me qëndrimin socialist ndaj punës.

Po për ngritjen tënde profesionale a bën përpjekje? E shfrytëzon një pjesë të kohës së lirë për këtë qëllim?

SHOQJA LUTFIE GJONI: Si urdhëron. Unë jam e interesuar për këtë çështje dhe përpiqem të gjej kohë të lirë për të mësuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Çfarë të intereson më shumë të mësosh?

SHOQJA LUTFIE GJONI: Kam dëshirë të mësoj kryesisht për bujqësinë, ajo më intereson më tepër.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë bukur! Kjo është përgjigjja më e mirë që mund t'i jepej pyetjes që të bëra. Të kesh dëshirë dhe të mësosh për bujqësinë është gjëja më e mirë që mund të bëhet dhe që mund të kërkohet nga një kooperativist. Ka njerëz që pretendojnë të mësojnë për të marrë më shumë kulturë të përgjithshme. Në fakt edhe kultura e përgjithshme i duhet njeriut tonë dhe Partia prandaj i ka hapur shkollat, por më parë punonjësi duhet të mësojë mirë dhe me këmbëngulje për profesionin që ushtron, në mënyrë që të jetë në gjendje të prodhojë sa më shumë të mira materiale dhe me cilësi të mirë, për rritjen e mirëqenies së tij dhe të të gjithë shoqërisë. Për këtë qëllim të madh, kur të jetë nevoja, ai të mësojë edhe të tjerët dhe t'i udhëheqë ata. Te ju, për shembull, mbillet misër, grurë, nganjëherë dhe patate, po a gjen ti literaturë për këto bimë?

SHOQJA LUTFIE GJONI: Po, shoku Enver, ka libra të tillë edhe te ne.

SHOKU ENVER HOXHA: Çfarë kursi apo shkolle ke kryer ti?

SHOQJA LUTFIE GJONI: Kam mbaruar shkollën 7-vjeçare.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë ti the se ka libra të veçantë ku flitet për pataten, dhe kështu duhet, por e rëndësishme është sa i lexon dhe sa i studion ti ato.

SHOQJA LUTFIE GJONI: Unë bëj përpjekjet e mia për t'i lexuar dhe për t'i studiuar, po sa u hyj thellë, është çështje tjetër.

SHOKU ENVER HOXHA: Natyrisht, ka edhe raste që disa gjëra që studiohen të mos kuptohen menjëherë nga të gjithë, por njerëzit që i kuptojnë ato më lehtë e më mirë e kanë detyrë t'ua mësojnë edhe të tjerëve. Agronomi, për shembull, a ju zhvillon juve në kooperativë ndonjë temë për çështjet profesionale? Nëse bëhen takime të tilla, a gjallërohen me pyetje dhe me diskutime nga pjesëmarrësit? Ju ndihmon agronomi për problemet që ju dalin në kooperativë?

SHOQJA LUTFIE GJONI: Po, na ndihmon.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa kuintalë patate për hektar morët sivjet në kooperativën tuaj?

SHOQJA LUTFIE GJONI: Brigada e tretë mori 103 kuintalë për hektar, kurse brigada ku punoj unë mori më pak, sepse tokat ku e mbollëm ne janë më të vogla.

SHOKU ENVER HOXHA: Po sa metra më lart janë tokat e brigadës suaj nga të asaj tjetrës? Me sa

di unë, sa më lart të jenë tokat, aq më mirë është për pataten, aq më shumë rendiment jep ajo, prandaj ka të ngjarë që prodhimi i ulët i patates në brigadën tuaj të jetë rezultat i një pune jo të mirë. Sa kuintalë patate u morën në brigadën tuaj?

SHOQJA LUTFIE GJONI: 63 kuintalë për hektar.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë pak paskeni marrë. Në kooperativat e rrethit të Korçës marrin nga 200 kuintalë për hektar, bile ka kooperativa, si ajo e Pojanit e të tjera, që kanë marrë deri edhe 300 kuintalë për hektar. Kuptohet që me rendiment 63 kuintalë për hektar mbjellja e patates nuk ka leverdi, prandaj përpjekjet në brigadën tuaj për të rritur prodhimin duhet të jenë të mëdha, aq më tepër kur atë e drejton një brigadiere siç je ti, e zgjuar, e shkathët. Unë pres të më shkruash një letër, me anën e së cilës të më njoftosh që brigada jote mori 120 kuintalë për hektar. Si thua, do t'ia arrini dot këtij objektivi apo jo?

SHOQJA LUTFIE GJONI: Po, shoku Enver, bashkë me shoqet dhe shokët do të përpiqemi ta realizojmë këtë detyrë.

Pastaj shoku Enver Hoxha iu drejtua shokut Dan Shema:

Ti je kryetar i kooperativës së Shoshajt, apo jo?

SHOKU DAN SHEMA: Po, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Me sa dëgjova nga shokët, ju keni arritur të merrni më shumë të ardhura për ditë-punë se të gjitha kooperativat e tjera të rrethit të Matit. Megjithatë, nuk duhet të deheni nga ky sukses, sepse janë mundësitë për më shumë, prandaj punoni të tejkaloni detyrat, të merrni më tepër dhe të bëheni

shembull për kooperativat e tjera, që janë më prapa dhe kanë ndarë më pak se ju për ditë-punë. Duhet pasur parasysh se kooperativa juaj shtrihet nga Burreli deri në fshatin Vinjoll, prandaj bëni përpjekje që secili fshat i kooperativës të arrijë rendimente të mira dhe të ardhura të përafërta, duke kultivuar rreth territorit të vet bimët bujqësore më të përshtatshme. Kështu nuk do të ketë diferencim në rendimente, këto do të vijnë vazhdimisht duke u ngritur dhe të ardhurat e anëtarëve do të shtohen vazhdimisht, sepse kur gjendja ekonomike e anëtarëve të kooperativave nuk është e mirë, krijohen situata jo të shëndosha. Në këtë mënyrë ne do të luftojmë edhe mendimet e gabuara që mund të krijohen te disa njerëz, lidhur me bashkimin e disa fshatrave në një kooperativë.

Ka njerëz që thonë: «Ç'na duhej bashkimi i fshatit tonë, që ka të ardhura të mira, me fshatrat e tjera, që marrin më pak të ardhura, apo që ne të punojmë për të tjerët?». Ne duhet ta thyejmë me punë këtë pikëpamje. Nga bashkimi në kooperativa ne duhet të arrijmë dhe, në të ardhmen me siguri do të arrijmë, rezultate të mëdha. Vetëm duhet të përpiqemi që kooperativistët ta kuptojnë drejt qëllimin e bashkimit, prandaj të shfrytëzojmë në maksimum të gjitha mundësitë që na japin toka, blegtoria, pemëtaria dhe gjithë të tjerat në të gjitha zonat e veçanta të kooperativës suaj të bashkuar. Në këtë mënyrë edhe të ardhurat do të shkojnë medoemos në rritje. Sot, në kooperativën tuaj nga misri merret rendiment i mirë, por, nesër Vinjollit mund të arrijë të marrë, për shembull, 150 kuintalë patate për hektar. Kështu do të ndodhë

edhe me zhvillimin e blegtorisë në fshatrat e tjera.

Ju merrni sot 70 litra qumësht nga një dhi, kurse Lezan Pislë merr 144 litra dhe, po të ishte në Vinjoll, ai do të merrte mbase edhe 200 litra¹. Por Lezani nuk lëviz nga fshati i tij, ku nuk ka kushte më të mira se fshati juaj, megjithatë prodhimi që merrni ju është sa gjysma e atij të Lezanit. Po si i ka arritur rezultate të tilla Lezani? Mos vallë ai është njeri i jashtëzakonshëm? Jo, është si gjithë të tjerët, prandaj përpjekjet e tij duhet t'i bëjnë të gjithë. Lezani është i thjeshtë, i ndërgjegjshëm, punëtor, i ndershëm. Ajo që e dallon atë është puna e tij. Prandaj, duke marrë shembull nga ai të punohet që delet e kooperativës suaj të japin më shumë qumësht dhe të paktën deri 3 kilogramë lesh për kokë. Ja, pra, cili është qëllimi i bashkimit, jo të marrim 1,7-1,8 kilogramë lesh, por t'i vëmë detyrë vetes që të marrim edhe 5 kilogramë. Kështu duhet ecur edhe në prodhimin e mishit dhe në të gjitha drejtimit e tjera me bashkimin e kooperativave. Çdo sektor të ketë vazhdimisht rritje të prodhimit, përparim.

Në kohën e luftës kam qenë në Martaneshin tënd Lutfië, në fshatin Peshk, bashkë me Baba Fajën. Ai ka qenë njeri shumë i mirë. I biri i është bërë mjek, kirurg shumë i mirë.

Me sa po shikoj asnjë nga shokët nuk e pi cigaren këtu. Po të jetë që nuk e pini, bëni shumë mirë. Sidomos shoqet në këtë drejtim janë për t'u marrë

1. Në vitin 1972 Lezan Pislë arriti të marrë 240 litra qumësht për dhi nga tufa e tij.

shembull. Ne, burrat, përveç cigares, kemi edhe ndonjë ves tjetër, prandaj juve grave, ju bie detyrë të na korrigjoni pa frikë, se Partinë e keni kurdoherë me vete. Frika te njerëzit tanë duhet të zhduket, nuk duhet të ekzistojë.

Po ti shoqe nga je?

SHOQJA ZILE GJOKA: Jam nga Kombësia.

SHOKU ENVER HOXHA: Di ti kur i është vënë ky emër fshatit tuaj?

SHOQJA ZILE GJOKA: Nuk e di të them kur i është vënë, po më duket kështu është quajtur shekuj më parë vendi ku shtrihet fshati ynë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Mos je sekretare e organizatës-bazë të Partisë në fshat ti?

SHOQJA ZILE GJOKA: Jo, jam kooperativiste e thjeshtë.

SHOQJA NIKA TRESKA: Në konferencën e fundit të Partisë është zgjedhur kandidatet e plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë! Po ti, shoku Llambi si je? Si janë shokët punëtorë në minierën ku punon ti?

*SHOKU LLAMBI GEGPRIFTI*¹: Ju faleminderit, mirë janë të gjithë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Ka perspektiva të mëdha miniera juaj dhe gjithë ajo zonë.

SHOKU LLAMBI GEGPRIFTI: Kështu është, se aty afër kemi Gurin e Kuq.

1. Në atë kohë kandidat i KQ të Partisë. Ishte i deleguar i Komitetit Qendror të Partisë në këtë plenum.

SHOKU ENVER HOXHA: Kanë kaluar më se 10 vjet, që kur është hapur Miniera e Alarupit. Kjo do të thotë se atje tani duhet të ketë shumë punëtorë të vjetër që njohin karakteristikat e minierës, që kanë fituar një përvojë të madhe në punë dhe si minatorë janë bërë specialistë, prandaj mendoj se tani mbase nuk është aq shumë e nevojshme të keni aty shumë kadro të lartë.

Ti, shoku Vaso¹, referatin e kishe përgatitur mirë. Puna mbetet tani të mobilizoheni të gjithë, me Partinë në krye, për realizimin e detyrave.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

1. Vaso Pano, në atë kohë anëtar i byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit dhe kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të këtij rrethi.

TA GËZONI KËTË SHTEPI KULTURE

Nga biseda me anëtarë të plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit

26 shkurt 1972

Ditën e dytë të punimeve të plenumit, në pushimin midis seancave të mbledhjes, shoku Enver Hoxha vizitoi shtëpinë e kulturës të Burrelit. Duke shprehur përshtypjet e veta, ndër të tjera, ai tha:

Shtëpia e kulturës qenka e bukur, të gjitha anekset e saj më duken të mira. Salla e shfaqjeve me 450 vende është e mjaftueshme për nevojat tuaja. Ta gëzoni! Ka sistem ngrohjeje këtu?

*SHOKU MUSTAFA PAJENGA*¹. Së shpejti do ta vendosim kaldajën, se instalimet e tjera janë bërë të tëra.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe salla e leximit është e mirë, e madhe dhe me dritë. Kush e ka projektuar këtë ndërtesë?

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit.

SHOKU MUSTAFA PAJENGA: Projekti është bërë në Tiranë, kurse zbatuesi i saj është matjan, punon kryeinxhinier në ndërmarrjen e ndërtimit të rrethit tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ai ka punuar shumë mirë. Matjanët janë të njohur për pushkë, por edhe për ndërtimin e shtëpive, ka matjanë që janë ndërtues të mirë. E pse të mos jenë edhe ata si ndërtuesit e Peshkopisë?

Shtëpitë, në rrethin tuaj, i kanë të mira fshatarët dhe, shumë prej tyre kam dëgjuar që mbajnë pastërti shembullore. Kjo tregon përparim, tregon kulturë. Të jesh i pastër do të thotë të jesh njeri me kulturë; kjo vlen edhe për burrin, edhe për gruan. Gruaja shqip-tare, megjithëse me pozita më të dobëta, në të kaluarën i ka vënë disa rregulla burrit brenda në familje dhe matjani, si kudo në vendin tonë, edhe pse një çikë konservator ndaj gruas, e ka dëgjuar atë kurdoherë në disa drejtime.

Shtëpitë njëkatëshe që janë ndërtuar si gjetkë edhe në qytetin tuaj, mendoj se mund t'i bëni edhe me dy kate, sepse kështu ekonomikisht do të fitojmë themelet dhe çatinë e, ajo që ka shumë rëndësi, do të fitojmë tokën. Tani ka shumë mundësi t'i bëjmë shtëpitë me katër-pesë kate. Qyteti i Burrelit është shumë i hapur, prandaj kini parasysh që në ndërtimet e ardhshme në këtë drejtim të përqendrohemi.

Pastaj shoku Enver i drejtohet kryetarit të këshillit popullor të fshatit Derjan.

Si jeni, shokë të fshatit të Shkurte Skurës, si venë punët andej nga ju?

*SHOKU HASAN BATA*¹: Mirë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Po me ujitjen si dukeni?

SHOKU HASAN BATA: Ne arrijmë të ujitim vetëm një pjesë të tokës se ujë ka pak. Kemi hapur disa hauze, jemi përpjekur të nxjerrim ujë edhe në disa vende të tjera të kooperativës, po nuk na del, është vend i thatë.

SHOKU ENVER HOXHA: Si shkoni me realizimin e planit?

SHOKU HASAN BATA: Mirë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Po nëna e Shkurtes si është, mirë?

SHOKU HASAN BATA: Mirë ka qenë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kam kohë që nuk kam ardhur andej, i bëni shumë të fala nga unë nënë Hanes².

SHOKU MUSTAFA PAJENGA: Mund të rifillojmë tani shoku Enver?

SHOKU ENVER HOXHA: Dakord jam.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

-
1. Në atë kohë kryetar i këshillit popullor të fshatit Derjan.
 2. Nëna e Heroinës së Popullit, Shkurte Skura.

SOCIALIZMIN E NDËRTOJNË MASAT, PARTIA I BËN KËTO TË NDËRGJEGJSIHE

*Fjala në plenumin e Komitetit të Partisë
të Rrethit të Matit¹*

26 shkurt 1972

Të dashur shokë dhe shoqe,

Ndicj një kënaqësi të madhe që erdha këtu, në Burrel, mes jush, shokëve të plenumit të Komitetit të Partisë, për t'ju dëgjuar nga afër për problemet që preokupojnë organizatën e Partisë të rrethit tuaj. Është e natyrshme që problemet të kenë anët e tyre të përbashkëta për gjithë vendin, por ato kanë edhe veçoritë dalluese për çdo rreth. Të tilla veçori paraqitin problemet edhe në rrethin e Matit. Si në gjithë vendin tonë, ku Partia udhëheq ndërtimin e socializmit, edhe në rrethin tuaj janë arritur suksese të më-

1. Ky plenum, përcaktoi detyrat dhe objektivat që dilnin para organizatës së Partisë të rrethit për zbatimin e direktivave e të vendimeve të Kongresit të 6-të të PPSH.

Shoku Enver Hoxha asistoi në të gjitha seancat e mbledhjes dhe e mori fjalën në mbarim të punimeve të plenumit.

dha në çdo drejtim, megjithatë edhe te ju vërehen dobësi e vështirësi të ndryshme. Detyra e organizatës së Partisë është të mobilizojë të gjitha masat e popullit për të realizuar e për të tejkaluar detyrat që i janë caktuar, sepse një gjë të tillë e lyp interesi i madh i popullit dhe i socializmit.

Rrethin tuaj e karakterizon një patriotizëm i shquar. Ky duket në të gjitha fushat e jetës, në radhë të parë, në qëndrimet politike dhe ideologjike, si dhe në politikën ekonomike të Partisë. Në të tria këto drejtime të mëdha të politikës së Partisë edhe në përgjithësi, edhe në detaje, populli i rrethit të Matit e ka përqafuar jo vetëm në parim vijën e Partisë, por përpqet ta zbërthejë e ta zbatojë atë në jetë, në praktikë e, kur del nevoja, edhe ta korrigojë. Kjo ka një rëndësi të madhe. Këto cilësi të mira nuk janë fjalë, as jua vë në dukje, meqenëse këto ditë ndodhem këtu, pra, për t'ju bërë qejfin. Jo, shokë, Partia nuk flet kurrë me këtë gjuhë, ajo bazohet kurdoherë në realitetin, ndryshe populli nuk na fal.

Ndoqa me kujdes e me vëmendje të madhe raportet dhe diskutimet që bënë shokët e këtij plenumi dhe të tëra më pëlqyen, mbasi ishin realiste dhe konkrete. Nga diskutimet e anëtarëve të plenumit për mua u bë e qartë se ju e keni kuptuar drejt vijën e Partisë. Preokupacioni i madh i të gjithë juve, shokëve të udhëheqjes së Partisë të këtij rrethi, është që vija e Partisë të zbatohet dhe për këtë po bëni përpjekje për të gjetur format dhe metodat më të përshtatshme të punës. Këto forma dhe metoda ju nuk i kërkon vetëm nëpër libra, por edhe në jetën prakti-

ke. S'ka dyshim se ne mësojmë edhe nga librat e duhet gjithnjë më shumë të mësojmë prej tyre, por shumë gjëra na i mëson edhe jeta, praktika, lufta e përditshme për zbatimin e vijës së Partisë. Këtë e vura re te ju që, me mundësitë, me pjekurinë dhe me zotësinë që keni fituar nga librat dhe nga eksperiencia e jetës, luftoni për të zgjidhur mjaft probleme dhe për të kapërcyer vështirësitë që ju dalin përpara.

Nga të gjitha këto që mësova gjatë dy ditëve krijova përshtypjen e përgjithshme se në rrethin e Matit kemi një organizatë partie të mirë, në udhëheqje të së cilës ka shokë që preokupohen, që vrasin mendjen dhe nuk i zë gjumi për çështjen e Partisë dhe të popullit. Kjo është shumë inkurajuese.

Rrethi juaj prodhimin e përgjithshëm industrial të pesëvjeçarit të katërt e realizoi në 4 vjet e gjysmë. Ky është një sukses. Bile në disa tregues plani u realizua me arritje edhe më të mira. Për shembull, në krom 164 për qind, në blloqet e mermerit 161 për qind, në trupat 106 për qind, në rrobat e pambukta 133 për qind, në mobilie 131 për qind. Gjithashtu u realizuan qarkullimi i mallrave 134 për qind, vëllimi i investimeve 141 për qind, ndërsa ai i ndërtimeve u tejkalua me 28 për qind. Pra, ju keni tejkaluar edhe afatin, edhe përqindjet e realizimit.

Edhe prodhimi i drithërave si pesëvjeçar u plotësua. Kështu, dorëzimet u realizuan 206 për qind, ndërsa rendimenti i drithërave të bukës më 1970 u rrit 69,2 për qind në krahasim me vitin e parë të pesëvjeçarit të katërt. Në drithërat e bukës ju arritët në këtë mënyrë një sukses të madh. Mirëpo, siç thashë,

ka edhe anë të dobëta, për arsye se nuk janë realizuar mjaft zëra, si qumështi, patatet, fasulet, vezët etj.

Suksese të konsiderueshme janë arritur në rrethin tuaj edhe në sektorët e arsimit, të kulturës e të shëndetësisë. Shkollat këtu u shumuan, nga 85 që ishin më 1965, më 1970, u bënë 110, ndërsa numri i nxënësve nga 7 000 e ca u rrit në afro 13 000 dhe ai i institucioneve shëndetësore nga 170 u bë 207. Gjatë pesëvjeçarit u ndërtuan edhe shumë objekte social-kulturore etj., etj.

Problemet që lidhen me realizimin e pesëvjeçarit të kaluar ju i keni analizuar me kohë dhe keni bërë vërejtje, keni nxjerrë konkluzione e detyra të cilat do t'ju shërbejnë patjetër për realizimin më mirë të detyrave të planit të ri të pestë pesëvjeçar.

Le t'i hedhim tani një sy realizimit të detyrave të vitit 1971 si viti i parë i pesëvjeçarit të ri. Prodhimin e përgjithshëm industrial vitin e kaluar ju e realizuat 102 për qind. Kështu, krom prodhuat më shumë se më 1970, patët një rritje prej 22 për qind; punimet gjeologjike i plotësuat 102 për qind, mermerin 110 për qind, ndërtimet 101,3 për qind, qarkullimin e mallrave 103 për qind. Me përjashtim të ndërmarrjes bujqësore, të gjithë kolektivat punonjës e plotësuan planin e vitit 1971. Por, siç e shtruat vetë këtu, mos u kënaqni me rezultatet e arritura, pasi akoma ka shumë rezerva dhe mundësi, të cilat është e nevojshme t'i shfrytëzoni për realizime të mëtejshme gjatë vitit në vazhdim. Në këtë drejtim ju mbetet shumë për të bërë.

Pse ç'ngjet? Gjatë vitit 1971 ju nuk keni dalë

aspak mirë me drithërat e bukës, planin e tyre nuk e realizuat veçse 67 për qind. Edhe në fasulet dolët me deficit të madh, kështu edhe me patatet e me qumështin. Prandaj, për realizimin e planit të vitit të dytë të pesëvjeçarit të ri kërkohet një mobilizim serioz i të gjitha forcave të rrethit.

Ju e keni studiuar Letrën e Komitetit Qendror të Partisë të janarit 1971 për bujqësinë¹. E them këtë që të keni parasysh se vërtet minierat e kromit kanë një rëndësi të veçantë për rrethin tuaj dhe për mbarë ekonominë e vendit, por Mati është kryesisht një krahinë bujqësore-blegtorale, prandaj po aq kujdes sa tregoni për industrinë, të tregoni edhe për bimët e drithërave, për blegtorinë, si dhe për perimet e pemëtarinë. Këto janë drejtimet kryesore të zhvillimit të ekonomisë në rrethin tuaj, që ju jeni në gjendje dhe të zotë t'i çoni më përpara, pse këtë zotësi e keni treguar në lidhje me hopin e madh që bëtë në drithërat pesëvjeçarit e kaluar.

Më falni të ndalem tani ca në këtë çështje. Ndërsa prodhimi i përgjithshëm bujqësor në pesëvjeçarit që shkoi në rrethin tuaj pati një rritje prej 20,2 për qind, kurse si republikë 27,7 për qind, në drithëra ju e rritët prodhimin 65 për qind, nga 60 për qind që u rrit në gjithë vendin. Ju e tejkaluat kështu mesataren e republikës në drithëra, bëtë një hop të madh. Kjo do të thotë se jeni në gjendje të arrini rezultate shumë të mira.

1. «Mbi nevojën e një kthese rrënjësore në përsosjen e organizimit dhe forcimin e disiplinës së punës në bujqësi». Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. VI, f. 9.

Rendimenti që arritët në drithërat e bukës në pesëvjeçarin e kaluar duhet të vlejë si shembull për të gjithë. Nga 11,7 kuintalë për hektar që morët më 1965, rendimenti për hektar më 1970 u rrit në 19,2 kuintalë. Mati më 1970 zuri vendin e shtatë në shkallë republike për prodhimin e drithërave, nga i dhjeti që zinte më 1965, duke lënë prapa shumë rrethe të tjera. Në këtë drejtim, më duket mua, ju jeni të aftë, keni shkathtësi mendimi, ju punon mendja për zhvillimin e bujqësisë. Fshatari, kooperativisti matjan është në gjendje t'i përvetësojë e t'i zbatojë si duhet kërkesat e kodit agroteknik, në qoftë se bëni kujdes dhe durim t'ia mësoni dhe të merrni njëkohësisht masat organizative për zbatimin e tyre, që të mos përsëritet më te ju ajo që ndodhi në vitin 1971 me drithërat e bukës. Mirëpo vihet pyetja: përse e latë veten të binit vitin e kaluar? Shkaqet për këtë problem ju i keni analizuar dhe keni nxjerrë konkluzionet përkatëse, prandaj nuk po zgjatem në këtë çështje. Puna është që pësimet të bëhen mësim dhe këtë vit e tutje t'i realizoni e t'i tejkalonit detyrat që ju janë ngarkuar.

Me gjithë rendimentet që keni marrë më 1970, plus shtesat që janë parashikuar dhe duhet të bëni përpjekje për t'i realizuar gjatë këtij pesëvjeçari, ta kemi të qartë, shokë, se sado tejkalime, sado shtesa që të realizojmë në drithë, ky nuk është kurrë i tepërt për ne. Kurdoherë, po veçanërisht në kohët e turbullta që kalojmë, drithi është flori për popullin dhe për republikën. Prandaj t'i vëmë vazhdimisht rëndësi prodhimit të tij, askush të mos bjerë më në gabimin tuaj

që, pasi arritët disa suksese në drithëra, u shkujdesët, lëre pastaj në prodhimet e tjera, si në patate, në perime, në qumësht dhe në mish, që dolët gjithashtu me humbje.

Ç'tregon kjo? Kjo tregon se bujqësinë e keni kuptuar në mënyrë të njëanshme. Kështu ajo nuk mund të ecë. Ju jeni një rreth shumë i përshtatshëm për rritjen e të gjitha llojeve të bagëtisë, që nga lopa e deri te dhia, jeni një rreth ku duhen zhvilluar shumë frutat, perimet dhe patatet, po ama seriozisht, ashtu siç e ka shtruar Komiteti Qendror i Partisë në një Plenum¹ të veçantë të tij. Në këto drejtime ju nuk keni punuar si duhet, prandaj ju bie të reflektoni shumë dhe ta kuptoni thellë këtë mungesë, ta keni të qartë si një të metë shumë serioze tuajën, si një gabim të madh që duhet ta ndreqni sa më parë për të mirën dhe interesin e popullit.

Detyra e organizatës së Partisë e rrethit tuaj është të mobilizojë të gjitha forcat që të dalë faqebardhë në këto drejtime para popullit, sepse realizimi i planit të drithërave dhe i të gjitha prodhimeve të tjera bujqësore e blegtorale do ta ngrejë akoma më shumë prestigjin e saj në popull, do ta shtojë akoma më tepër dashurinë e popullit ndaj Partisë, ndaj vijës së saj të drejtë, do të ndihmojë që të konsolidohet më tej uniteti Parti-popull.

1. Është fjala për Plenumin e 8-të të Komitetit Qendror të PPSH që u mbledh më 26 deri 28 tetor 1962, i cili shqyrtoi masat për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë për sigurimin e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor. Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. IV, f. 202.

Të gjithë e dimë tani se ashtu si nuk rron dot njeriu vetëm me bukë, edhe bagëtia, që të na japë atë që kërkojmë prej saj, nuk mund të ushqehet si dikur vetëm me kashtë misri. Prandaj duhet të punojmë që të përgatitim ushqime të pasura me të gjitha lëndët e domosdoshme që i duhen organizmit të bagëtisë për metabolizmin dhe për zhvillimin trupor të saj, për të prodhuar atë sasi qumështi e mishi që duhet të na japë. Pikërisht kjo është arsyeja që luftojmë për të krijuar konvejerin e gjelbër, në qoftë se duam të marrim prodhime të bollshme, në qoftë se duam të marrim viça të shëndoshë etj., etj. Ushqimet që përgatitim për bagëtinë të mos jenë të njëlojta, po të shumëlojta, të përshtatshme me nevojat e zhvillimit të saj, t'i përgatitim asaj, si të thuash, «gjellë», siç vepron për njerëzit. Natyrisht këtë e bëjmë për të mirën e popullit, pse kafshët që ushqejmë dhe çdo punë tjetër që bëjmë ka për qëllim të përmirësojë jetën e njerëzve tanë.

Edhe prodhimi i frutave e i perimeve këtë qëllim ka. Në vendin tonë nuk duhet të ketë njeri që të mos kuptojë nevojën e madhe që kemi për perime, prandaj duhet shpjeguar vazhdimisht rëndësia që kanë ato për organizmin. Mund të ketë disa që sot nuk e hanë këtë ose atë lloj perimeje, por duke e provuar, duke e përdorur, do të mësohen të hanë jo një, por shumë lloje perimesh, sepse edhe shijet krijohen. Por, sepse nuk i pëlqejnë sot një pjesë njerëzish dhe ne të vazhdojmë të mos mbjellim një ose disa lloje perimesh? Kjo nuk është e drejtë. Prandaj të punojmë që të prodhojmë sa më shumë lloje prej tyre dhe t'i pro-

pagandojmë që populli t'i njohë të tëra, të kuptojë vlerën e tyre të madhe ushqimore dhe t'i përdorë. Edhe ju duhet të mbillni këtu nga këto, jo për t'i ngrënë Tirana apo rrethet e tjera, po që t'i hajë më parë populli i rrethit që i prodhon. Nga ato lloje perimesh që rriten mirë në rrethin tuaj, prodhoni në sasi të mëdha jo vetëm për nevojat e ditës, por një pjesë edhe për ta përpunuar e rezervuar, që popullit t'i shitet më vonë, ndërsa tepricat t'i jepen grumbullimit për nevojat e rretheve të tjera. Në qoftë se grumbullimi nuk i merr, i hidhni në rrjetin e tregtisë të rrethit dhe plotësoni më mirë nevojat e masave me to. Duke prodhuar me bollëk fruta e perime zgjidhen shumë probleme, prandaj me përpjekje të shumëfishuara vihuni punës që t'i prodhoni ato.

Edhe për sa u përket frutave, më duket se fare pak keni bërë, prandaj mos e nënvleftësoni këtë sektor, se ka rëndësi, shokë. Vërtet pemëtaria kërkon ca investime dhe nuk ia sheh dot shpejt përfitimin, por populli ka nevojë për fruta, të cilat kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut. Pa fruta mund të rrohej përpara me mentalitetin e vjetër dhe me varfërinë e madhe që kishte mbuluar fshatarësinë dhe popullin tonë në përgjithësi, po aktualisht në kushtet e reja dhe kur Partia e pushteti luftojnë për ngritjen e mirëqenies dhe për forcimin e shëndetit të njerëzve, pa fruta nuk mund të bëjmë, ato janë bërë një nevojë e domosdoshme. Veç kësaj, frutat sigurojnë edhe të ardhura të mira për kooperativat dhe për mbarë vendin. Në Mat toka është shumë e përshtatshme për një sërë frutash, si qershi, mollë, rrush, fiq etj., të cilat do t'ia ndry-

shojnë pamjen ekonomisë suaj. Që të zhvillohet pemëtaria, natyrisht duhet të merren edhe masa për krijimin e fidanishteve, prandaj mbillni lloje të zgjedhura dhe jo ç't'ju dalë përpara. Çdo gjë duhet bërë e studiuar, me baza. Prandaj mos pranoni ç't'ju japin, siguroni lloje nga më të mirat të fidanëve frutorë, që japin prodhim të shpejtë, të bollshëm dhe që u rezistojnë sëmundjeve e kushteve klimatiko-tokësore të rrethit tuaj.

Si në raport, edhe në diskutime, ju vutë në dukje shumë çështje. Unë nuk do të zgjatem mbi ato që nuk u realizuan nga ju më 1971, po dua të vë në dukje se shkak kryesor i këtij mosrealizimi duhet kërkuar në disiplinën e dobët të planit. Mjafton të përmend faktin se vitin e kaluar ju mbollët qindra hektarë me drithëra buke më pak se plani.

Lidhur me këtë problem më lejoni të prek disa çështje që kanë lidhje me Letrën që ju ka dërguar Komiteti Qendror «Mbi nevojën e një kthese rrënjësore në përsosjen e organizimit dhe forcimin e disiplinës së punës në bujqësi».

Ju folët në përgjithësi për disiplinën e planit, por unë dëshiroj të theksoj që në të ardhmen ta shikonim akoma më me kujdes këtë problem, në mënyrë të veçantë në bujqësi. Le të marrim respektimin e afateve të mbjelljeve, të shërbimeve të bimëve, të korrjes-shirjeve etj., kryerja ose moskryerja në kohë e të cilave ka rrjedhime të mira ose të këqija. Në bujqësi, në qoftë se u përmbahesh afateve, atëherë ke siguri në realizimin e prodhimit, në qoftë se nuk u përmbahesh, prodhimi rrezikohet. Drejtuesit e kooperativës

duhet të dinë mirë kur duhet kryer çdo proces pune, duke filluar që nga lërimi i tokës, mbjellja, prashitja, rrallimi, ujitja e bimëve etj., etj. dhe këto t'ua mësojnë mirë kooperativistëve, dhe jo vetëm sa për t'i ditur, por që të respektohen me rigorozitet, sidomos nga shtabi i kooperativës. Nga të gjitha këto mua më duket se vështirësitë në bujqësi nuk janë kryesisht objektive, ato janë më tepër subjektive dhe kanë të bëjnë më shumë me çështje organizimi e mobilizimi. Natyrisht, në bujqësi ka edhe pengesa natyrore të paparashikuara, fjala vjen nga shirat, që nuk lejojnë ta mbjellësh bimën në kohën e duhur, sidomos atë lloj që kërkon një cikël rigoroz. Këto ngjasin, por për çdo rast konkret duhet gjykuar me kujdes ç'duhet bërë. Prandaj, kur pengesa është e atillë që nuk mbjell dot në afat, s'duhet ecur symbyllur. Hibridin, fjala vjen, nuk lejohet ta mbjellësh me një muaj ose me 40 ditë vonesë, duke u justifikuar se e ke në plan, sepse, kur të vijë koha e pjekjes fillojnë ngricat dhe nuk merr asnjë kilogram, prandaj të rroftë mundimi. Në rast se kushtet e këqija atmosferike vazhdojnë deri sa kalon afati optimal i mbjelljes, po mbolle hibridin, ke bërë gabim të madh, prandaj duhet menduar për të mbjellë një farë tjetër me cikël më të shkurtër pjekjeje. Të veprësh qorrazi, do të thotë ta zbatosh planin në mënyrë automatike, pa kurrfarë interesi për kooperativën, përkundrazi, në dëm të saj.

Po kështu shtrohet edhe çështja e shërbimeve që u duhen bërë bimëve. Hibridi, për shembull, kërkon disa shërbime të posaçme që duhet t'i kryhen me domosdoshmëri në afate të caktuara. Ka disa momente që atij du-

het t'ia bësh medoemos prashitjen ose ujitjen, ndryshe ato s'bëjnë asnjë efekt. Këto kërkesa të domosdoshme janë të provuara shkencërisht, prandaj t'i njohin mirë kooperativisti, brigadieri, t'i dinë mirë, në radhë të parë, kryetari i kooperativës dhe shokët e organizatës-bazë të Partisë. Nuk mund ta lëmë kryerjen e shërbimeve kur t'i teket brigadierit, kur ky ta ketë brigadën të lirë, por ato të kryhen medoemos në afat, siç rekomandon agroteknika.

Planifikimi, si kudo, edhe në kooperativat bujqësore ka rëndësi të jashtëzakonshme, prandaj kjo punë të mos u lihet ta bëjnë një apo dy njerëz, kryetari me sekretarin e organizatës së Partisë ose kryetari me zëvendësit etj. Për një punë serioze në këtë drejtim është e domosdoshme të mblidhet shtabi kryesor i kooperativës me gjithë specialistët për të marrë në studim bimët që do të mbillen, sasinë që duhet prodhuar, rendimentet, sipërfaqet e tokave, cilësinë e tyre, etj., etj.

Është e domosdoshme gjithashtu të përcaktohet përparësia e bimëve. Kjo nuk do të thotë se bimëve që do t'u jepet përparësi duhet t'u caktohen absolutisht tokat më të mira. Kjo gjë duhet balancuar, duke studiuar në hollësi çdo gjë, cilësitë e tokës, disponibilitetin e krahëve të punës, nevojat për pleh dhe mundësitë që ka kooperativa etj.

Kur flasim për përparësi të një bime që ka rëndësi për një kooperativë, për rrethin ose edhe për republikën, kësaj duhet t'i japim diçka, nga ato që thashë, më shumë se bimëve të tjera, që ta sigurojmë plotësisht prodhimin. Në qoftë se i japim përparësi si

bimë kryesore, fjala vjen, grurit ose misrit në një kooperativë, atëherë duhet të zgjedhim për të tokat pak a shumë më të mira e më të përshtatshme, të marrim të gjitha masat që t'i bëjmë shërbimet që parashikon kodi agroteknik, t'i plotësojmë me kohë bimës çdo nevojë që rekomandon ai. Kjo është fare e lehtë të bëhet, mund të thoni ju. Ndoshta, mund të jetë fare e lehtë, por ky kujdes për bimën së cilës i japim përparësi të mos na bëjë të biem në gabimin që ratë ju në vitin 1971 dhe më përpara që, duke i vënë tërë rëndësinë drithit, nuk jeni kujdesur sa duhet për bimët e tjera. Shtabi që vendos për këto probleme duhet të ketë parasysh që edhe patatja ka rëndësi të madhe, natyrisht jo sa drithërat, po prapë ka rëndësi për ushqimin e popullit, foragjeret gjithashtu kanë rëndësi shumë të madhe etj., prandaj asgjë të mos lihet pas dore.

Zbatimi me rreptësi i planit në bujqësi luan një rol të madh në këtë drejtim. Të tërë, duke filluar, nga kryetari e deri te brigadieri e kooperativisti i thjeshtë ta rrënjosin mirë në kokë se gjithçka është vendosur të mbillet, diku ta zëmë grurë, diku misër, në një sipërfaqe tjetër sojë, foragjere, rrepa, kokëlakër ose trifil «Aleksandrin» e të tjera, duhet të mbillet me domosdo e të mos lejohen ndryshime, duke thënë «dha urdhër ky ose ai». Pas aprovimit të planit shtabi i kooperativës dhe askush tjetër nuk ka më të drejtë të lëvizë me shifrat, përkundrazi, të tërë t'i vihen menjëherë punës dhe të mobilizohen për të realizuar detyrat. Po të veprohet ndryshe, pasojat do të jenë të rënda. Disiplina e planit në bujqësi është jetike,

prandaj duhet të zbatohet me rreptësi, ndryshe s'kemi gjë në torbë.

Në bujqësi e blegtori nuk ke të bësh si me ndërtimin e një objekti, fabrike apo shkolle, ku, pasi ke filluar punën, domethënë, si ke hedhur themelitë, po të të dalë përpara një vështirësi ose nevojë tjetër më e madhe, fundi i fundit mund ta pezullosh përkohësisht punën. Natyrisht as kjo nuk është e mirë, por krahët e punës dhe makineritë nuk shkojnë kot, pse i hedh në frontin e ri ku lind nevoja e paparashikuar, ndërsa në bujqësi po kaloi afati, mbarove. Bimët bujqësore janë sezonale, ato s'presin, kështu që po u vonove disa ditë, prodhimi dëmtohet në mënyrë të pandreqshme. Si shembull mund të vlejë dështimi që pësuar vetë ju me misrin hibrid, për të cilin folën dje disa nga shokët. Prandaj kur vjen koha dhe jepet urdhri për të mbjellë një bimë në afatin e caktuar, duhet të jeni shumë rigorozë. Kjo është një çështje organizative e dorës së parë.

Letra për bujqësinë që ju ka dërguar vjet Komiteti Qendror i nxit punonjësit tanë, punëtorët, kooperativistët, specialistët, organizatorët e bujqësisë, që të mendojnë thellë për shfrytëzimin në maksimum e me intensivitet të madh të fondit të tokave, të cilat duhen ngritur në një nivel të lartë agroteknik. Kjo do të thotë që ato t'i studiojmë, t'i përpunojmë, t'i gjejmë secilës bimët më të përshtatshme, t'u bëjmë rotacionin e të gjitha shërbimet e tjera me radhë. Letra udhëzon, gjithashtu, si të ngrihet puna organizuese në bujqësi në një nivel më të lartë se gjer tani.

Në kooperativat tona bujqësore ne kemi kudo

njerëz të zotë, që edhe pse mund të mos kenë shumë shkollë, edhe pa qenë specialistë të mëdhenj të bujqësisë, apo të blegtorisë, duke pasur mjaft eksperiencë, janë në gjendje të përcaktojnë ç'duhet mbjellë në një sipërfaqe toke dhe ç'duhet kultivuar në një tjetër, ku duhen hedhur forcat më parë në një periudhë të caktuar dhe sa duhen hedhur për këtë ose për atë bimë. Kësaj i thonë të organizosh. Praktika nxjerr vazhdimisht të tillë njerëz të zotë.

Le të marrim njërin nga këta, Heroin e Punës Socialiste, Lezan Pisliri, që të gjithë ju e njihni më mirë. Ka shkollë ai? Jo, nuk ka. Po sa rëndësi të madhe ka çështja që ai në 115 dhi të tufës që i kanë dhënë, merr nga 144 litra qumësht në vit. Rëndësi të madhe ka çështja se Lezan Pisliri me forcën e tij të mendimit, me energjinë e tij, me zotësinë, zgjuarsinë dhe eksperiencën e tij shembullore, ka arritur që nga një dhi, nga e cila të tjerët nuk marrin dot as 50 litra qumësht, të marrë afër trefish dhe, këtë vit, siç doli këtu, do të marrë edhe më tepër. Atë që realizon, Lezan Pisliri nuk e ka mësuar nga librat, po e ka mësuar vetë, në jetë. Në të kundërtën, jo rrallë kemi ndonjë agronom e zooteknik me shkollë që nuk ngrenë dot qimen nga qulli, sepse nuk i ha merakun për punën dhe janë të shkëputur nga jeta. Ata kanë dhe arsimin e lartë, ndërsa Lezani, ndonëse pa shkollë, transformon racën. Këtu qëndron zotësia e njerëzve si Lezani, prandaj Partia të punojë për t'i bërë shembull, për ta përhapur sa më gjerë eksperiencën e tyre. Letra e Komitetit Qendror për bujqësinë i nxit kështu punonjësit e ndërmarreve e të kooperativave bujqësore si ta rregullojnë

e ta organizojnë më mirë punën, si ta administrojnë tokën, këtë pasuri të pallogaritshme, si ta zhvillojnë më tej ekonominë bujqësore, për të marrë prej saj prodhime sa më të mëdha në interes të popullit.

Rëndësi të madhe ka në bujqësi edhe sigurimi i numrit të bimëve për hektar. Ne kemi vuajtur shumë dhe po vuajmë për realizimin e rendimenteve në prodhimet bujqësore, po veçanërisht për pambukun. Kjo vjen jo se fara e pambukut që kultivojmë është e keqe ose se nuk mund të marrim atë rendiment prodhimi që kemi caktuar në përshtatje me klimën dhe tokën tonë. Mundësitë janë, natyrisht jo për rendimente të mëdha nga 25 e 30 kuintalë për hektar, si në disa vende të tjera, po 14-15 kuintalë për hektar ne mund t'i marrim fare mirë¹, prandaj në qoftë se këtë nuk e kemi arritur gjer tani në gjithë sipërfaqen, fajin nuk e ka bima, po e kemi vetë që nuk i kemi bërë asaj si duhet të gjitha shërbimet agroteknike. Në një moment u arrit gati të krijohej bindja e gabuar se e pas-kemi kot që merremi me pambukun, pasi na bëheshin shumë presione nga shokët e rretheve e të bazës. Mirëpo nuk na lanë të vazhdonim në këtë gabim.

Kush nuk na la? Nuk na lanë punonjësit e përparuar të atyre brigadave, të cilët në vitet bujqësore më të këqija kur si kooperativë merreshin mesatarisht deri në 7 kuintalë pambuk për hektar, ata merrnin nga 16-17 kuintalë pambuk për hektar në parcele me kushte të njëjta me të tjerat. Këta na këshilluan

1. Në vitin 1984 në shkallë republike u mor 14,1 kuintalë pambuk për hektar.

të mos heqim dorë nga pambuku, pse s'është e vërtetë që s'bëhet. Ata e kanë këtë rendiment sepse e kanë mbjellë në kohën e duhur, ia kanë bërë në kohë të gjitha shërbimet, kanë siguruar sasinë e duhur të bimëve për hektar etj. Këta punonjës të përparuar e kanë provuar praktikisht këtë mundësi. Prandaj udhëheqjet e rretheve që mbjellin pambuk, si Lushnja, Fieri, Durrësi etj., i thirrëm në raport në Sekretariatit e Komitetit Qendror, pasi dërguam në bazë komisione të posaçme për të parë e studiuar në vend këtë problem dhe realiteti doli krejt ndryshe.

Është fare lehtë, shokë, të them që të mos e mbjellim pambukun, po me se ta blejmë? Pambuku do valutë! Dikush mendon të heqim nga plani edhe lulediellin, po me se ta blejmë vajin që na duhet për të ngrënë? Po kështu edhe për orizin «ç'e duam», thonë disa të tjerë. Por ata që i lëshojnë të tilla pikëpamje nuk mendojnë me se do t'i blejmë gjithë këto prodhime ushqimore të dorës së parë për popullin. Gjëra të kësaj natyre ka dhe e keqja është se ka edhe ndonjë kuadër drejtues që bie në këto pozita dhe mendon shumë ngushtë, vetëm për rrethin e vet, për të lehtësuar punën. Këta janë të prirë për një punë rutinë, burokratike, prandaj i pranojnë pa menduar thellë pikëpamjet që u serviren, në vend që t'u vënë këmbët në një këpucë atyre që i shprehin, pse jeta vërteton që s'është si thonë ata. Mirëpo në qoftë se një drejtues s'është në gjendje t'i vërë në vend këto gjëra dhe t'u japë rrugëzgjidhje problemeve që i janë ngarkuar, le t'ia lërë vendin të tjerëve që luftojnë dhe e bëjnë më mirë punën. Këta të fundit e meritojnë të drejtojnë,

dhe jo ata që për vite me radhë flasin nga zyra dhe nuk luftojnë ta çojnë punën përpara.

Jo vetëm për pambukun, por edhe për misrin etj., duhet siguruar fara, duhet siguruar, pra, numri i domosdoshëm i bimëve për hektar. Tashti është duke u thyer kjo situatë, por te fshatarësia ruhet akoma mentaliteti për t'i hedhur sa më pak farë tokës, pse i duket sikur bën ekonomi etj. Ne nuk duhet të bëjmë një «ekonomi» të tillë me farën, ndryshe dëmtohem, siç jemi dëmtuar. Po i hodhëm tokës sasinë e duhur të farës, do të kemi me siguri prodhime më shumë.

Ju kritikuat në plenum, dhe shumë mirë bëtë, mungesat në shfrytëzimin e kohës së punës. Ky fenomen negativ nuk është vetëm këtu, bile në mos gabohem, mund të them se te ju mungesat në punë janë më të pakta se në disa rrethe të tjera. Megjithatë më tërhoqi vëmendjen fakti që edhe në disa nga kooperativat bujqësore të rrethit tuaj ka njerëz që nuk dalin rregullisht në punë, që bëjnë shumë pak ditë-punë. Porosia e Letrës së Komitetit Qendror që çdo krah i aftë për punë të bëjë jo më pak se 300 ditë-punë në vit, të bazuara në normat më të përparuara, të zbatohet me kujdesin më të madh. Duhet pasur parasysh se përveç anës subjektive të njerëzve, ka faktorë të tjerë që luajnë rol negativ në këtë çështje. Për shkaqe objektive në krahinën tuaj dhe në përgjithësi në gjithë rrethet malore, oborri kooperativist është i madh relativisht, megjithatë ai do të qëndrojë në këtë madhësi edhe për ca kohë akoma, prandaj kini kujdes të mos bëni gabime. Oborrit kooperativistëve

ua kemi lënë, sepse kanë nevojë për të. Por parcela e caktuar për oborrin kooperativist është e domosdoshme të punohet. Edhe bagëtitë e oborreve që kanë kooperativistët duhet të ushqehen, të prodhojnë e t'u vijnë në ndihmë familjeve të tyre. Prodhimet e oborrit janë, kështu, një plus në të ardhurat që siguron anëtari nga puna që bën në pronën e përbashkët. Megjithatë, kooperativisti ynë merret më shumë nga sa duhet me oborrin. Prandaj Partia e ka për detyrë të zhvillojë një veprimtari të gjerë politike, që kooperativisti të bëhet i ndërgjegjshëm dhe të bindet që punën në oborrin e vet ta konsiderojë si të dorës së dytë e bile të tretë. Ne duhet ta bindim e ta sqarojmë atë jo vetëm politikisht, po edhe materialisht, se prona e përbashkët i sjell të ardhurat më të shumta, prandaj aty të bëjë ai sa më shumë ditë-punë. Megjithatë kooperativistit do t'i themi që edhe oborrin ta punojë, të kujdeset edhe për bagëtitë personale, por të mos harrojë që përparësi t'i japë punës në kooperativë. Ta bëjmë fshatarin të kuptojë se socializmi në fshat ndërtohet dhe përparon vetëm me përpjekje, me punë të palodhur duke kombinuar punën fizike me punën mendore nëpërmjet makinave, teknikës, organizimit etj., etj. Këtë duhet t'ua rrënjosim mirë në mendje kooperativistëve jo vetëm në Mat, po kudo, në mbarë vendin tonë dhe, kur të arrijmë t'i bëjmë plotësisht të ndërgjegjshëm për këtë, do të shikojmë se do të kemi më shumë suksese.

Këto çështje kërkojnë që të shpjegohet më mirë në Parti dhe në masat, teorikisht dhe praktikisht, edhe ç'është prona socialiste dhe në se konsiston prona

personale në socializëm, ç'është interesi i përgjithshëm dhe interesi personal dhe përse duhet të vihet interesi i përgjithshëm mbi atë personal. Lidhur me këto të shpjegohen pastaj disa probleme teorike dhe praktike të përditshme, siç janë puna me cilësi të mirë, largimi pa asnjë arsye nga puna, shfrytëzimi i plotë i tetorëshit, normat progresive e teknike, disiplina proletare në punë, lufta kundër vjedhësve, shfrytëzimi i rezervave të brendshme etj., etj. Është nevoja të shpjegohet gjithashtu prona e oborrit personal dhe prona e grupit në kooperativën bujqësore, nevoja e luftës kundër tendencave e qëndrimeve pa përgjegjësi e të shpërdorimeve të pronës së përbashkët kooperativiste nga udhëheqja e kooperativës, të përdorimit të saj pa pyetur asamblenë etj.

Investimet në kooperativë, për të cilat duhet të kihet një nomenklaturë, nuk është e lejueshme të bëhen vetëm me pëlqimin e kryesisë dhe pa marrë parasysh mirë nevojat e grupit. Duhet të vendosen proporcione të drejta ndërmjet investimeve dhe konsumit. Nuk duhet lejuar që, nën pretekstin e ndihmës, të ngrihen shtëpitë private me kredi të kooperativës. Anëtarët e kooperativës duhet të paguajnë vetë deri në një dhe me të holla në dorë shpenzimet për shtëpitë që ndërtojnë. Të mos shpërdorohet në asnjë mënyrë dhe në asnjë rast ndjenja e solidaritetit në kooperativë në kurriz të punës së përbashkët dhe të pronës socialiste. Solidariteti duhet të tregohet në raste fatkeqësie të një personi ose të një nëne me shumë fëmijë për nevoja të domosdoshme jetike. Çdo solidaritet tjetër është abuzim dhe do të thotë të shfry-

tëzosh krahun e të tjerëve për interesa të personave të veçantë.

Kujdesuni, shokë, për të vënë në jetë çështjen që u shtrua këtu në diskutime lidhur me përdorimin e mekanizmave të thjeshtë në punimet bujqësore. Shoku Llambi Gegprifti në diskutimin e tij të bazuar vuri në dukje ç'rendimente të mëdha kanë dhënë disa nga mekanizmat që kanë prodhuar në minierën ku punon ai. Në bujqësi mekanizmat e vegjël, si kultivatorët, karrot, slitat etj., do t'ju japin dorë shumë në zhvillimin e mëtejshëm të prodhimeve bujqësore, prandaj mos i neglizhoni. Rrethi juaj ka mjaft lëndë druri, kjo do të thotë se te ju ekzistojnë mundësi të shumta për të krijuar të tilla mjete, prandaj po ta vritni më shumë mendjen, do të prodhoni me siguri nga këto jo vetëm për të punuar tokën, por edhe nga ato që lehtësojnë punën e krahut të kooperativistëve, si për tharjen e misrit, për shkoqjen e tij etj., etj. Partia dhe shteti mendojnë dhe bëjnë përpjekje për t'i siguruar bujqësisë makineritë e nevojshme nga importi, por, sidoqoftë, me ato që do të sjellim nga jashtë është e pamundur të plotësojmë të gjitha nevojat, prandaj të mendojmë që një pjesë të mirë të tyre ta prodhojmë në vend.

Më tërhoqi vëmendjen për këtë problem edhe njëri nga diskutimet që u bënë këtu, ku u ngrit çështja e kujdesit që duhet treguar nga të gjithë për problemin e mekanizimeve, si dhe për shpërndarjen e tyre. Diskutanti tërhoqi vëmendjen se në kooperativën ku është ai më parë kishin 3 traktorë, kurse tani, megjithëse i janë vënë kooperativës detyra të reja për

rritjen e rendimenteve, i kanë lënë vetëm një traktor. Siç shihet, këtu ka një kontradiktë, — tha ai, — nga një anë detyrat u rriten, nga ana tjetër u pakësohen mjetet mekanike. Kjo kontradiktë duhet të zgjidhet dhe, që të mos pengohen në realizimin e detyrave të mëdha që u vihen, ai kërkoi të dërgohen disa traktorë më tepër.

Shumë traktorë ne nuk disponojmë, por, me gjithë nevojat që kemi për ta, më duket sikur ndërmarrjet bujqësore i kemi fryrë ca me mekanizma, prandaj mendoj se duhet bërë një shpërndarje më e drejtë e tyre. Në ndërmarrjet bujqësore ka ndonjë punonjës të pandërgjegjshëm që, porsa vijnë traktorë të rinj, mendon se, ata duke qenë të shtetit, pra, sipas tij, janë «të nënës» dhe kooperativat «të njerks», shumica e traktorëve të rinj t'u jepet atyre, ndërsa të vjetrit t'u kalojnë kooperativave, në mos i futshin ca më keq akoma, rrëzave. Ky është një qëndrim antisocialist. Të gjesh të përhapura andej-këtej në tokat e një ndërmarrjeje bujqësore mjete e vegla bujqësore në një sasi të madhe dhe që nuk përdoren, është një qëndrim antisocialist që duhet dënuar rëndë, ca më shumë kur ka kooperativa bujqësore, siç u tha këtu, që kanë nevojë të madhe për mjete të mekanizuara.

Ministria e Bujqësisë ka marrë porosi t'i shtrëngojë fort rripat në këtë drejtim. sepse «behari», socializmi, nuk ndërtohet vetëm me ndërmarrjet bujqësore. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor sigurohet kryesisht nga kooperativat, prandaj atyre duhet t'u japim më shumë mjete se gjer tani, dhe punonjësit e SMT-së, si të dërguarit e klasës punëtore në fshat,

duhet ta përmirësojnë më shumë punën e tyre në kooperativa. Por rëndësi ka çështja që mjetet e mekanizuara që disponojmë aktualisht e që do të kemi edhe më shumë në të ardhmen, të shpërndahen në mënyrë më racionale, më të drejtë, të shfrytëzohen në maksimum e të mbahen mirë, pasi nuk i prodhojmë vetë. Në vend ne prodhojmë vetëm një pjesë të mirë të veglave të ndërrimit për to.

Dega tjetër me rëndësi që duhet të zhvillojë bujqësia jonë socialiste është blegtoria. Kjo ka rëndësi shumë të madhe, po në blegtori ne jemi akoma prapa, për arsye se nuk sigurohet baza ushqimore.

Në foragjere jeni akoma shumë prapa edhe ju në Mat, prandaj në këtë drejtim duhet bërë një kthesë serioze. Shtabi i kooperativës, pas zhvillimit të një diskutimi të gjallë që duhet bërë si për të gjitha çështjet, duhet të përcaktojë cilat lloje foragjeresh do të mbillen. Gjatë diskutimit duhet pasur parasysh se, gjersa caktohen tokat më të mira për drithërat, një pjese të sipërfaqes së destinuar për to mund t'i vihen gërshërët në favor të bazës ushqimore për blegtorinë. Duhet pasur gjithashtu parasysh që në tokën e caktuar për foragjere, meqenëse merret nga sipërfaqet e grurit dhe të misrit, të punohet mirë që të korret prej tyre një sasi sa më e madhe foragjeresh. Në këto toka nën ujë, ku po të mbillej misër, mund të merreshin dhjetëra kuintalë për hektar, kooperativistët të çajnë qiejt që të marrin medoemos 6 e 7 korrje jonxhë në vit, të marrin bile edhe një sasi të bollshme farë jonxhe, e cila të mos blihet në Gjirokastër ose në Peshkopi, po të prodhohet në vend, në rrethin tuaj.

Në qoftë se për të prodhuar sojën, e cila është e domosdoshme si foragjere për ushqimin e bagëtive, bile për të siguruar edhe vaj për njerëzit, nevojiten toka të shëndosha, atëherë të bëjmë gjithashtu një sakrificë, duke shkurtuar ca sipërfaqe toke nga të drithëra-ve, por veç të merren masa që në to të punohet me një agroteknikë shumë të lartë për të garantuar rendimente të mëdha e të kapërcehet kështu minusi që do të rrjedhë nga ulja e sipërfaqes për drithëra.

Të njëjtat përpjekje duhen bërë edhe në tokat që jepen në favor të bimëve të tjera, si të patateve etj. Në qoftë se do të kuptojmë mirë rëndësinë e drithëra-ve dhe këto do t'i çojmë përpara, atëherë do të bëjmë kthesë patjetër edhe në foragjerc. Kjo do të thotë që në tokat e mbjella me drithëra të marrim rendimente të larta. Përfitimi këtu nuk qëndron vetëm në atë që vetë drithërat përbëjnë një bazë materiale për ushqimin e bagëtive, por sidomos në çështjen e ekonomizimit të tokave. Pra, po të arrijmë rendimente të larta në drithërat e bukës, nga përdorimi i një agroteknike të lartë, do të krijojmë situata të favorshme edhe për foragjeret. Kjo na vë detyra që tokat t'i përmirësojmë e njëkohësisht të studiojmë përbërjen dhe se cilat bimë mund të rriten në to, sa pleh ka nevojë t'i hidhet secilës parcelë për këtë apo atë bimë etj.

E gjithë kjo është një punë shkencore me rëndësi, e cila, natyrisht, në një ditë nuk kryhet, por përpjekje duhen bërë. Pa një punë të tillë nuk mund të merren rendimente të larta dhe nga dy e tri prodhime në vit në të njëjtën sipërfaqe. Në tokat ku mbjellim hasëlle të mos e futim bagëtinë të hajë bimën ako-

ma pa mbirë, po ta lëmë të rritet gjer në maksimumin e zhvillimit, që të marrim një masë të madhe ushqimi të gjelbër dhe jo sa marrim sot, që një pjesë ta vëmë rezervë. Pastaj të përpiqemi të mbjellim bimën tjetër menjëherë pas hasëllit. Kur të sigurojmë rendimente të larta drithi, ne do të çlirohemi nga shqetësimi për sigurimin e tërë sasisë së drithërave në vend dhe do të krijohen mundësi të na teprojnë ca sipërfaqe toke, që mund t'i shfrytëzojmë për foragjere, pa të cilat nuk mund të kemi një blegtori të përparuar.

Ne kemi ngritur për këtë qëllim institute të larta që kanë studiuar dhe kanë vendosur çfarë bimësh duhen mbjellë, që kafsha të ketë të hajë gjithë vitin ushqim të njomë, të kombinuar me të thatë, të sigurojmë kështu konvejerin e gjelbër për gjithë vitin. Në disa ndërmarrje dhe kooperativa bujqësore kemi arritur ta krijojmë këtë konvejer, por sasi të e bazës ushqimore që marrim nuk janë të mjaftueshme. Synimi ynë duhet të jetë që këtë ta krijojmë në të gjitha ekonomitë e vendit. Por edhe të mos ndodhë si me Dibrën, që të gjithë e dinë se është specializuar për jonxhën, kurse tani ajo ka zbritur në fund të shkallës, pse gati e ka braktisur, kurse Gjirokastra ka dalë në krye, mbasi dropullitët, sidomos në dy kooperativa, duke parë ç'rëndësi ka kjo bimë, iu futën, e kanë zhvilluar dhe janë duke siguruar të ardhura të konsiderueshme, sidomos nga fara e saj, duke marrë gjer në 1 500 kuintalë farë jonxhë çdo vit.

Pse e humbi vendin e parë, që zinte në republikë, rrethi i Dibrës? Se jonxhën e kishte kultivuar vetëm në oborrin kooperativist dhe nuk u bënë përpjekje që

kjo bimë të zhvillohej edhe në ekonomitë kooperativiste, ku nga koha në kohë u morën më shumë me grurin, pastaj me misrin hibrid dhe i dhanë bërrylin jonxhës. Kjo natyrisht, s'është e mirë dhe s'duhet përsëritur.

Ju në rrethin e Matit keni provuar më parë nga të gjitha rrethet kolzën dhe keni dalë mirë me të. Edhe kjo është një bimë foragjere me rëndësi, prandaj e kultivoni. Si kudo, ju duhet të mendoni cilat janë foragjeret që absolutisht duhen zhvilluar në një shkallë më të gjerë, si lakra foragjere, jonxha etj. Në tokat me ujë jonxha ka leverdi të madhe, po jo duke zënë me të tokën e misrit hibrid ku mund të sigurohet 70 e 80 kuintalë për hektar. Aty s'na leverdis të kultivojmë jonxhën. Ne duhet të luftojmë për të mbjellë edhe të tjera foragjere dhe të marrim prej tyre prodhime më të mëdha se gjer tani, që të hedhim kështu bazat e një fondi sa më të bollshëm ushqimesh për bagëtinë, të hedhim bazat e konvejerit të gjelbër. Këtu në Mat, meqë jeni të zotë dhe e keni provuar se në drithërat e bukës mund të bëni hope të mëdha, mos iu ndani atyre, pse kjo krijon siguri edhe për foragjeret.

Tani është puna se cilat kafshë do të ushqejmë me këto foragjere? Direktiva e Partisë është të rritim në radhë të parë lopën, se ka rëndësi. Këtë të gjithë e dinë, por ama veç jo ja lopa, ja bjer e vdis dhe të mos u vihet veshi bagëtive të tjera. Edhe delja është me rëndësi të madhe, bile për rrethin tuaj edhe dhia. Por direktiva duhet kuptuar drejt dhe jo pse ju thashë unë, me të dalë këtej dhe, oburra, se tha Enveri e të rriten dhinë jashtë mundësive, në dëm të bagëtive të

tjera dhe të pyjeve. Dhia ka rëndësi të mbahet atje ku ka kullotë të përshtatshme për të, që nuk e shfrytëzojmë dot në asnjë mënyrë tjetër dhe ku nuk na dëmton.

Lopa ka rëndësi mbi bagëtitë e tjera, por, që ta rritim si duhet, është e domosdoshme të sigurojmë ushqim të bollshëm për të, pse pa ngrënë, ajo s'jep. Por as të mos themi të prodhojmë një herë ushqime, pastaj të mbajmë lopë. Jo, ne duhet të jemi të guximshëm, të fillojmë menjëherë të rritim lopë ose të blejmë, në qoftë se nuk kemi, po njëkohësisht të kujdese mi për prodhimin e ushqimeve që do të hanë, sepse ato do të na japin 2 000, 1 500 dhe jo më pak se 1 000 litra qumësht në vit. Po që të na e japin këtë prodhim, duhen siguruar medoemos ushqime për to dhe këto nga viti në vit t'i shtojmë.

Nga bagëtitë e tjera na intereson të mbajmë edhe delen, po jo me pikëpamjen e vjetër. Ne duhet të rritim dele për mish dhe për lesh, prandaj të punohet që të shtohet pesha e tyre. Kjo do të thotë ta ushqejmë delen, pse po e ushqyem shtohet edhe leshi i saj. Kështu që edhe për këtë del nevoja e sigurimit të ushqimit, sepse delja e racës ka nevojë të ushqehet me foragjere, njëkohësisht edhe në kullota të përshtatshme. Në malësitë tuaja nuk mund të hidhet parulla për ta zhdukur delen, përkundrazi, në masën sa do ta lejojnë kushtet, të punohet për ta përmirësuar racën me atë kujdes të madh që përmirëson dhinë Lezani, që të marrim nga çdo dele të paktën 2-3 kilogramë lesh për kokë dhe mish sa më shumë, si në Korçë që kanë arritur të marrin deri 80 kilogram mish për çdo kokë

deleje të racës. Kështu duhet ta zbatojmë ne orientimin e drejtë që ka dhënë Partia për bagëtinë dhe për foragjeret, nga e cila varet në një shkallë të madhe mbarëvajtja e blegtorisë.

Në blegtori ne jemi prapa, kemi rënie sidomos në bagëtinë e imët, vetëm në lopët kemi rritje. Kjo është e mirë, po rritja e lopëve vjen se kemi importuar një numër të konsiderueshëm nga racat më të mira. Prandaj, kur ju dërgojnë këtu lopë të këtyre racave, bëni kujdes të madh për to, i mbani mirë, pse nuk është çështja vetëm për qumështin që marrim, po sidomos për përtëritjen e racës së tyre, që synojmë ta përmirësojmë. Kjo është kryesorja dhe në këtë drejtim kemi arritur rezultate të mira me «Xhersejn» dhe me «Laramanen».

Në blegtori ne kemi arritur suksese në disa drejtime të tjera. Me punën që është bërë kemi mundur gati të zhdukim një numër sëmundjesh, sidomos tuberkulozin. Në vendin tonë tani nuk ka shumë lopë me këtë sëmundje, që përpara ishte plagë e madhe për blegtorinë tonë. Edhe bruceloza është shumë e rrallë te ne. Kështu mund të themi për gjithë sëmundjet e tjera, që po luftohen me sukses nga institutet dhe specialistët tanë të zotë. Bile disa specialistë që kanë ardhur nga vendet e Perëndimit, shkencëtarë, veterinerë, zooteknikë, për të parë bagëtitë tona, janë çuditur me gjendjen e mirë shëndetësore të tyre. Ata kurrë nuk mendonin të gjenin këtë përparim që kemi arritur ne në fushën e blegtorisë.

Një numër të konsiderueshëm lopësh të racës kemi blerë ne në Holandë. Përpara se të na i nisin ho-

landezët na thanë se i kishin kontrolluar, se s'kishin tuberkuloz etj. Mirëpo disa mëshqerra të tyre, porsa erdhën, i kontrolluan veterinerët tanë dhe konstatuan se ishin të prekura nga tuberkulozi. Ne i njoftuam holandezët, por ata mohuan të kishin në tufat e tyre lopë me këtë sëmundje. Atëherë specialistët tanë i ftuan në Shqipëri dhe në prezencë të tyre bënë ekzaminimet, ua provuan këtë, dhe ata, më së fundi, u detyruan të pranojnë që s'kishin të drejtë në këmbënguljen e tyre. Është e çuditshme për ne, thanë ata, dhe ju themi seriozisht, sado që po i ndjekim me kujdes të madh, nuk kishim diktuar një sëmundje të tillë në lopët tona. Kjo që thoni, del se është e vërtetë dhe nxjerr në shesh se ju keni veterinerë të zotë.

Dëshiroj tani të prek edhe disa çështje të tjera, megjithëse edhe ju i ngritët në raportet dhe në diskutimet tuaja.

Kualifikimi i pandërprerë i punonjësve të vendit tonë është një problem i rëndësishëm që duhet ta shikojmë vazhdimisht e me seriozitetin më të madh. Atij duhet t'i vëmë shumë rëndësi, dhe në fakt i është vënë rëndësi, pse shohim që kudo mësohet, në fshat dhe në qytet. Shkolla janë hapur në të katër anët dhe ky është një sukses i madh, është një gjë shumë e mirë, pse pa mësim, pa shkencë, nuk mund të ecet përpara. Këtë e ka kuptuar shumë drejt populli ynë, prandaj ka një prirje të përgjithshme për të mësuar. Por, tani janë krijuar mundësi të mëdha që të luftojmë më shumë për cilësinë në mësim dhe jo vetëm për sasinë. Kur them të luftojmë për cilësi, kam parasysh punën që duhet bërë për të rrënjësuar disa shprehje të

drejta dhe të reja në njerëzit tanë me prirje për të mësuar.

Vija e Partisë është të luftojmë kurdoherë për masivitetin e kulturës dhe të arsimit. Arsimi 8-vjeçar në vendin tonë është i detyrueshëm dhe ky tashmë përbën një sukses të madh. Është një kënaqësi e madhe kur sheh vajzën nga Martaneshi që ka kryer shkollën 8-vjeçare dhe ka njohuri të gjera për bimët, kupton ç'është botanika dhe përse flet, sepse këtë, së bashku me shumë njohuri të tjera, ajo i ka mësuar në shkollë. Është e qartë se me përvetësimin e njohurive që jepen në shkollën 8-vjeçare nuk mund të pretendojmë që njeriu u bë shkencëtar, po një kulturë të përgjithshme aty ai e merr. Këtë kulturë i riu dhe e reja, që e ka jetën përpara, ka mundësi ta zhvillojë më tej, sepse shteti ynë u ka hapur të gjitha portat për këtë qëllim. Por është e domosdoshme që secili dhe të gjithë të dinë se punojmë dhe duhet të mësojmë jo për diplomë, jo për poste dhe për rroga. Me këtë aspak nuk dua të them që çështja e stimulit ekonomik apo material të mos mbahet parasysht. Jo, në asnjë mënyrë, po nuk mund të mos vë në dukje se ka disa njerëz, që kur vendosin të ndjekin shkollën e lartë, nuk mësojnë me këmbëngulje, që të pajisen me shkencë e dituri, për t'i shërbyer popullit si duhet, për të kryer mirë detyrën që do t'i caktojë shteti dhe Partia, kudo që ta dërgojnë.

Këtu dua të ndalem ca, shokë, pse po na ngjasin disa shfaqje jo të mira. Ka kohë që ne kemi ngritur universitetin dhe një sërë institutesh të larta, puna e të cilave ka marrë një rrugë të mirë. Më vonë ha-

pëm edhe filialet e shkollave të larta në mjaft rrethe e deri në disa ndërmarrje, gjë që është edhe kjo një punë gjithashtu e mirë. Universitetin, institutet e larta dhe filialet e tyre ua kemi rekomanduar t'i ndjekin njerëzve tanë edhe me shkëputje nga puna, edhe pa shkëputje nga puna. Ata që i ndjekin ato me shkëputje nga puna, në përgjithësi, më duket tregohen më të zellshëm, më të aplikuar, mësojnë më shumë, kurse një pjesë e atyre që i ndjekin pa shkëputje nga puna luftojnë për diplomën, me qëllim që të sigurojnë një rrogë më të madhe. Kjo shprehet me rezultatet e dobëta të punës së tyre mësimore, reflektohet në atë që diplomën e marrin me nota shumë të dobëta, si të thash, me të shtyrë, duke u orvatur nganjëherë të kalojnë në provime edhe me ndonjë miqësi. Jo, kjo nuk është e mirë, është e palejueshme, pse na dëmton shumë. Partia i ka ngritur me qëllime të mira shkollat e larta, që njerëzit tanë të mësojnë, të bëhen kuadro me të vërtetë të zotë për t'i shërbyer vendit, popullit dhe jo të nisen nga interesa të ngushtë që, me të mbaruar shkollën e lartë, të kërkojnë përnjëherësh nga 800 lekë në muaj vetëm për faktin se shtien në dorë një diplomë, pa dhënë prova dhe pa pasur akoma eksperiencë dhe zotësi në punë, që ta meritojnë një shpërblym të tillë.

Edhe kur e merr me meritë diplomën e universitetit një i ri, e udhës, dhe për të mirën e tij dhe të punës, është që atë nuk duhet ta caktojme të komandojë përnjëherë teknikë të mesëm që kanë të themi 20 vjet eksperiencë dhe janë mjeshtër në profesion. Të tillë mjeshtër të shquar ne kemi sot me mijëra, që

një projekt janë në gjendje ta zbatojnë më mirë se një inxhinier fillestar. Zotësinë e tyre në praktikë e njo-hin vetë kuadrot e rinj të lartë, të cilët duhet të punojnë disa vjet për të arritur në nivelin e aftësive prak-tike të teknikut të mesëm. Megjithatë inxhinierit të ri, me të mbaruar shkollën, ne i japim 700-800 lekë rrogë menjëherë dhe e bëjmë komandues. S'ka dyshim se duhen vlerësuar studimet e tyre, por mendimi im personal është se kjo çështje mund edhe të studiohet, bile kuadri i ri në fillim mund të marrë jo më shumë se një teknik i mesëm, pavarësisht se është kuadër i ardhshëm e të tjera arsye, sepse në realitet ekspe-riencë ai nuk ka. Që të bëhet i aftë, kuadrit me arsim të lartë do t'i duhet të bëjë përpjekje në punë, në të njëjtën kohë të vazhdojë të mësojë akoma, shumë e se-riozisht, edhe pas shkollës, që të arrijë ta luajë si du-het rolin e tij. Atëherë t'i rritet edhe shpërblimi.

Në universitet e në shkollat e tjera të larta duhet punuar seriozisht nga studentët jo për të marrë diplo-ma dhe për të fituar poste. Partia të jetë shumë e vë-mendshme e të punojë që t'u vërë fre prirjeve të tilla të rrezikshme për socializmin.

Së pari, fre do t'u vihet, mendoj unë, duke marrë masa të rrepta për kontrollin e dijeve. Kështu kur vjen koha për të kaluar në provime, të tërë të shkoj-në, si i thonë, në vrimë të gjilpërës, ta meritojnë vle-rësimin.

Së dyti, pas mbarimit të studimeve, gjithnjë sipas mendimit tim, sepse këto çështje s'janë shqyrtuar e vendosur akoma nga udhëheqja, të mos kemi një kate-gori për të tërë kuadrot me arsim të lartë, por të pak-

tën tri kategori. Kështu kuadri i ri të futet në kategorinë e tretë dhe të shpërblehet më ulët se kuadrot me eksperiencë. Në kategorinë e dytë kuadri me arsim të lartë të futet pas disa vjetësh pune dhe si të dallohet e të japë disa provime plotësuese. Dhe që të cilësohet i kategorisë së parë, domethënë që të barazohet me mjeshtrat që kanë më shumë stazh e përvojë në punë, t'i shtrohen të tjera kërkësa, më të larta. Nuk është aspak e drejtë që kuadri që porsa ka mbaruar shkollën e lartë për inxhinier të marrë gati të njëjtën rrogë sa ai që ka 20-25 vjet stazh. Prirjeve për diplomë, për poste t'u vëmë, pra, fre, shokë, duke i bërë të ndërgegjshëm njerëzit që kudo të mësojnë mirë, pse vetëm kështu i shërbehet si duhet socializmit.

Pastaj vërehen edhe tendenca të tjera jo të shëndosha. Ka një mani që të bëhen të gjithë me shkollë të larta. Është vallë e domosdoshme që të gjithë ata që kryejnë shkollën e mesme të ndjekin universitetin dhe institutet ose filialet e tyre? Të tërë në universitet nuk është e mundur të venë, prandaj shumica e atyre që mbarojnë tetëvjeçaren ose të mesmen, mund të mësojnë fare mirë në zanate të ndryshme, disa mund të bëhen tornitorë të mbaruar, që është nga zanatet më të nderuara, të tjerë mund të bëhen bujq, agronomë, edhe ky është një zanat gjithashtu i nderuar, dikush të mësojë për minator, për derdhës të çelikut, për murator, shofer etj., etj. Me këtë dua të them se për ndërtimin e socializmit nuk na duhen vetëm ekonomistë, inxhinierë, agronomë, mjekë, pedagogë etj., por më shumë se këta si numër na duhen mjeshtër e teknikë të mesëm.

Duhet punuar për t'u futur në kokë njerëzve se shteti ynë socialist nuk ia mbyll askujt dyert e universitetit dhe të shkollave të larta, por, në radhë të parë, të gjithë ata të kuptojnë se puna është nder, kudo që të jetë njeriu, në uzina e fabrika, në kantiere ndërtimi, në ara, si kuadër apo si specialist i mesëm etj.

Dua të flas pak lidhur me dashurinë për profesionin. Të jesh punëtor i kategorisë së katërt dhe të bësh përpjekje për t'u ngjitur në të pestën e të gjashtën ose për të ndjekur shkollën e lartë është një gjë e mirë, por ka rëndësi që njerëzit tanë t'i edukojmë ta duan zanatin dhe të lidhen ngushtë me të, duke u nisur nga synimi që sa më të aftë të bëhen në profesionin që ushtrojnë, aq më mirë do t'i shërbejnë popullit. Duke u nisur nga ky objektiv, kujtdo i del detyrë, në radhë të parë, të përsosë vazhdimisht zanatin, prandaj të ngulim shumë këmbë që njerëzit tanë të lidhen fort pas tij. E theksoj këtë se në jetë nxjerr veshin edhe një tendencë tjetër e dëmshme mikroborgjeze. Ka raste që tjetra mbaron për mami ose për farmacistë, dikush kryen shkollën e mesme të ndërtimit ose për mekanik dhe, pa filluar fare nga puna për të cilën është përgatitur, dëgjon që njëra kërkon të ndjekë universitetin për gjeografi, tjetri për histori, dikush për gjuhë të huaja etj., me një fjalë përpiqen për të gjetur ndonjë qoshe. Edhe ky mentalitet ekziston prandaj Partia ta luftojë, sepse është në dëmin e shoqërisë sonë socialiste. Vendi ynë ka nevojë për njerëz të kualifikuar në industri, në miniera, në bujqësi, në ndërtim, në arsim, në kulturë etj. Prandaj ata që e nisin punën në një sektor, edhe në

rast se pranohen të ndjekin shkollën e lartë, të ruajnë profilet, të jenë të pasionuar për profesionin dhe jo për diplomën.

Që të venë njerëzit tanë në universitet dhe të marrin diploma, asnjëri nuk i ndalon, por kjo kërkon punë dhe pasion dhe të mos lejohet si pa gjë të keq ndërrimi i profilit për të kënaqur te ndonjëri shije që janë të huaja për socializmin. Këtej e tutje ne duhet të vëmë kushte të atilla në shkollat dhe kurset që njerëzit të nxiten të punojnë e të mësojnë seriozisht, ndryshe nuk i shërbehet atdheut. Në këtë drejtim Partia të bëjë kujdes të madh.

Lidhur me këtë të kemi parasysh edhe një tjetër problem të rëndësishëm që po na del përpara, disproporcionin që ekziston midis teknikëve të mesëm dhe atyre me arsim të lartë. Siç e thashë, ekziston një prirje e fortë për ndjekjen e shkollave të larta për t'u bërë inxhinierë, mjekë, agronomë, zooveterinerë etj. Mirëpo kjo na ka lënë pas me teknikët e mesëm, në shumë sektorë na mungojnë mjeshtrit e prodhimit. Këtë problem ta shohim me kujdes dhe ta zgjidhim. Hekurudhën Tiranë-Durrës, shokë, megjithëse ishte rreth 38 kilometra e gjatë, me një inxhinier e ndërnuam, pse vetëm një kishim. Tani vetëm në pjesën e hekurudhës Elbasan-Përrenjas, që është duke u ndërtuar, kemi me dhjetëra kuadro me arsim të lartë, pra, gati për çdo kilometër një inxhinier, pse kërko e dërgo me shumicë, aq sa ka raste që i përdorin si brigadierë të thjeshtë. Kështu nuk mund të ecet!

Kur bëjmë listat për të llogaritur nevojat për kuadro në veprat e pesëvjeçarit, na thuhet se në ob-

jektet e mëdha, sidomos, duhen nga 100 e 200 inxhinierë. Mirëpo kur vjen puna, ato i ndërtojmë edhe me 30 kuadro me arsim të lartë. Por ama, gjersa kërko-hen nga 100 e nga 200 të tillë, kjo tregon se prirja për më shumë sesa nevojiten është e madhe. Dhe ç'ndodh atëherë? Bëhet njëfarë gare, si të thuash, për të dërguar çdo vit gati nga 200 veta në universitet vetëm për inxhinierë mekanikë.

Po pse të dërgojmë kaq shumë studentë çdo vit në degën mekanike, kur zooveterinerë pothuaj s'kemi fare dhe zooteknikë kemi shumë pak? Sepse na është mbushur mendja t'i japim prioritet industrisë. Dakord jemi që industria ka rëndësi të madhe, po ama të ecim një çikë me llogari.

Është dhënë direktiva që gjithë anëtarët e Partisë të mbarojnë shkollën 8-vjeçare dhe të mesme. Kjo është shumë e drejtë, mbasi pa kulturë të përgjithshme punëtori nuk do t'i kuptojë qartë e t'i zbatojë si duhet detyrat që i ngarkohen, kooperativisti gjithash-tu nuk do të kuptojë si duhet nevojën e shërbimeve që duhen kryer në kohë e me cilësi të lartë për zhvillimin e misrit e të grurit, për rritjen e përmirësimin e racës së lopës apo të deles, për shtimin e frutave e të perimeve etj. Shkollën secilit ia kërkon nevoja. Por anëtarët e Partisë duhet të mos lënë pas dore në asnjë mënyrë kurset. Në qoftë se komunisti punon, ta zëmë në torno, t'i vihet detyra të mbarojë më parë kursin e kualifikimit për tornitor dhe të bëhet specialist i dalluar në këtë profesion. Komunistët në ndërmarrje dhe në kooperativat bujqësore Partia i këshillo-n të bëhen specialistë të dalluar të zanatit, fjala

vjen brigadierë e drejtues të mirë të bujqësisë, kultivues të shquar të drithërave, të mësojnë për rritjen e viçave, për pemëtarinë, për perimet dhe në të gjitha këto drejtime të kryejnë nga një, dy e, po të jetë nevoja, edhe nga tri e më shumë kurse.

Në rrethin tuaj ekziston problemi i fluktuacionit të krahut të punës, problem ky që ekziston edhe në rrethet e tjera. Orientimi i Partisë duhet të jetë që punëtorët, në radhë të parë, punëtorët e kualifikuar, t'i fiksojmë, të bëjmë përpjekje që ta ndalim këtë fenomen. Të luftojmë sidomos tendencën që ekziston në ndonjë rreth e në disa kooperativa për të dërguar nëpër ndërmarrje një numër njerëzish që të punojnë përkohësisht për disa muaj e jo më gjatë, me qëllim që këta, pasi të marrin nga një shumë të mirë të ardhurash, të largohen dhe pas tyre të dërgohen grupe të tjera kooperativistësh që të përfitojnë edhe ata nga ky «favor». Prandaj, sa të jetë e mundur, të marrim masa që t'i fiksojmë punëtorët, pse kështu si po veprohet nuk mund t'i dilet.

Po a mund ta zgjidhim këtë problem me një urdhër, ose brenda një viti? Mua më duket se do të jetë e zorshme, prandaj si te ju, edhe në rrethet e tjera ku ka industri dhe miniera, të mendojmë e ta zgjidhim seriozisht dhe drejt këtë problem. Kryetari i kooperativës së bashkuar «1 Maji» i rrethit tuaj na tha se i janë kërkuar të dërgojë 40 veta në miniera. Po sikur t'i thuhet atij të japë vetëm 10 veta, po, ama, për ngahera, jam i mendimit që duke i thënë se nuk do t'i kërkohen të tjerë, kooperativa do të jetë plotësisht dakord që shteti t'i marrë më mirë 10 veta e t'i fiksojë,

sesa të dërgojë 40 herë pas here. Natyrisht, këta 10 veta të jenë të rinj ose të martuar rishtas, që të stabilizohen atje me gjithë familje. Po të dojë vetë kooperative, le të dërgojë të tjerë, minierat s'do të kenë kundërshtim, veç të dihet se, po u vendosën, nuk do t'u kthehen më. Për këtë është e domosdoshme që atyre t'u ndërtohen shtëpi që të vendosen familjarisht, pse kështu do të lidhen ngushtë me ndërmarrjen, do të mësojnë zanate, do të kalojnë nëpër kurse kualifikimi dhe do të bëhen minatorë të shquar. Është më mirë kështu dhe jo si veprohet tani që fshatarët venë në minierë, kalojnë në kurse dhe pas 6 muajsh largohen për në fshat dhe në vend të tyre venë të tjerë që s'kanë haber fare nga puna në minierë, kështu ndërmarrja detyrohet të fillojë nga e para çdo gjë. Mirëpo kjo dëmton rëndë prodhimin. Minierat tona, shokë, nuk janë as për një ditë, as për një vit, as për 3 dhe as për 10 vjet. Ato do të punojnë me dhjetëra vjet derisa të shfrytëzohet edhe kilogrami i fundit i mineralit. Me mënyrën si po veprohet nuk mund t'i rritim, t'i kualifikojmë e t'i fiksojmë punëtorët. Prandaj të rinjtë pa detyrime familjare, natyrisht, jo me shumicë, po me llogari, t'u merren kooperativave dhe të fiksohen në miniera e në fabrika dhe atje ta kalojnë jetën e tyre, duke u krijuar për këtë qëllim edhe kushtet e nevojshme për jetesë.

Në miniera duhet të kujdesemi edhe për problemin e shtimit të mekanizimeve. Kjo është vija e Partisë sonë, ndryshe do të vazhdojmë t'u marrim kooperativave bujqësore shumë krahë pune. Në të gjitha këto drejtime të bëjmë shumë kujdes.

Këto ishin disa çështje të cilat i përmenda shkurtimisht, pse ju i keni shtruar vetë, keni bërë analiza, keni punuar edhe dokumentet kryesore të Kongresit të 6-të të Partisë. Edhe në këtë plenum ju shtruat edhe një herë planin e vitit 1972, prapë do t'i punoni këto materiale dhe do të përpiqeni të gjeni mundësi të reja për të mënjanuar dobësitë, gabimet e të metat që ekzistojnë akoma etj.

Nga sa dëgjova këtu, krijova bindjen se ky vit ka për të shënuar me siguri një kthesë në bujqësinë kooperativiste të rrethit tuaj, sepse viti 1971 që ju ka sjellë humbje në sektorin e bujqësisë, është bërë mësim. Prandaj ju bie detyrë të mobilizoni mirë Partinë, politikisht dhe organizativisht, të luftoni mbeturinat e çfarëdo natyre që ekzistojnë në njerëzit, të punoni edhe më shumë për forcimin e unitetit të Partisë me popullin, të punoni në radhë të parë që organizatën e Partisë ta keni të shëndoshë.

Shokë,

Disa çështje partie që dëshiroj të shtroj nuk janë të panjohura nga ju. Është fjala për disa shfaqje që, megjithëse nuk janë bërë vijë, duhen kritikuar, duhen luftuar dhe duhen zhdukur. Vija e Partisë sonë është e drejtë, marksiste-leniniste. Mirëpo gjatë zbatimit të saj jo vetëm njerëz të thjeshtë, po edhe disa kuadro që nuk e kuptojnë si duhet atë, gjatë konkretizimit dhe zbatimit të saj, bëjnë gabime. Prandaj të punojmë që t'i evitojmë gabimet, qofshin këto të vogla, qofshin

të mëdha ose, në rast se bëhen, t'i korrigojmë menjëherë, që kur janë të vogla, të mos i lëmë të trashen e të bëhen të mëdha. Kjo është një nga karakteristikat e mira të Partisë sonë, e cila, kur bën gabime, i njeh ato dhe merr masa për t'i ndrequr.

Ne, para së gjithash, duhet të kuptojmë mirë kush e ndërton socializmin. Kjo, siç na mëson Lenini, është një çështje e madhe parimore, që duhet ta ketë të qartë i madh e i vogël në vendin tonë. Po as kjo nuk mjafton, rëndësi ka që edhe ta zbatojmë mirë në jetë. Kush e ndërton socializmin? — vë pyetjen Lenini:

«...socializmin nuk mund ta vendosë një pakicë — partia. Atë mund ta vendosin dhjetëra miliona njerëz, kur ata të mësojnë ta bëjnë vetë këtë punë. Meritën tonë ne e shohim në faktin se ne përpiqemi ta ndihmojmë masën që t'i përvishet vetë kësaj pune menjëherë dhe këtë gjë të mos e mësojë nga librat, nga leksionet»¹.

Kështu na mëson Lenini dhe kjo thënie e tij është e qartë, veç duhet të përpiqemi ta zbatojmë mirë në jetë. Socializmin, pra, nuk mund ta ndërtojë vetëm një pakicë, qoftë kjo edhe partia, atë e ndërtojnë masat milionëshe të popullit të udhëhequra nga partia, misioni i së cilës është që masat t'i bëjë të ndërgjegjshme.

Ecën në këtë rrugë Partia jonë, apo nuk ecën? Partia jonë ka ecur dhe vazhdon të ecë me tërë kupti-

1. V. I. Lenin. Veprat, vëll. 27, f. 141.

min e fjalës në këtë rrugë. Luftën Nacionalçlirimtare Partia jonë e kuptoi drejt, prandaj nuk e zhvilloi vetëm, por me popullin. Edhe pas Çlirimit, kur shtrohej çështja për ndërtimin e socializmit, Partia Komuniste e Shqipërisë, duke i kuptuar drejt tezat e Leninit, punës për ndërtimin e socializmit nuk iu përvesh vetëm me komunistët, por deklaroi se shoqërinë e re do ta ndërtonte populli shqiptar, prandaj mobilizoi e udhëhoqi masat për zbatimin e programit të vet.

Këtë vijë të drejtë të Partisë ne e shikojmë në çdo fushë të veprimtarisë së saj. Të marrim qoftë edhe vetëm punën e kryer për zbatimin e planeve tonë pesëvjeçare. Të gjithë e dimë që njëri pas tjetrit këto plane u hartuan dhe u diskutuan gjerësisht me masat e popullit, ndërsa udhëheqja e Partisë në çdo rast bëri sintezën e veprimtarisë së madhe të komunistëve dhe të popullit, që i ishin përveshur punës plot vështirësi, me suksese e të meta për ndërtimin e socializmit në kushtet e vendit tonë.

Çdo vit e çdo pesëvjeçar gjatë përpjekjeve për ndërtimin e socializmit, udhëheqja dhe mbarë Partia kanë nxjerrë konkluzione nga e gjithë kjo veprimtari, nga e gjithë kjo luftë, kanë parë ku ishte eksperiencia e mirë, ku ishin gabimet dhe të metat, ku do të mbështeteshim pasi mbaruam njërin pesëvjeçar, ku do të mbështeteshim për të hartuar e realizuar pesëvjeçarin tjetër, deri në çështjen se çfarë hapi do të bëjmë gjatë pesëvjeçarit të pestë që kemi filluar të zbatojmë. Udhëheqja në çdo rast ka dhënë disa orientime dhe kështu ka vepruar kurdoherë. Këto orientime janë diskutuar me masat e tërë popullit, duke analizuar të

mirat dhe të këqijat, masat janë edukuar e nxitur të propozojnë, të sugjerojnë, të japin mendime se ç'gjë duhet të bëhet më parë e ç'gjë më pas, cila bëhet e cila s'bëhet, sa duhet shtuar apo pakësuar prodhimi në këtë ose në atë sektor etj., etj. Mbi bazën e kësaj pune të madhe janë bërë kurdoherë me mijëra e dhjetëra mijëra propozime, pyetje, diskutime, janë bërë mbledhje të punëtorëve, të asambleve të kooperativave bujqësore, të këshillave popullorë e të komiteteve ekzekutive, të plenumeve të komiteteve të Partisë dhe deri mbledhje të posaçme të Qeverisë e të Komitetit Qendror të Partisë. Kështu ka ngjarë në të kaluarën dhe kështu u veprua edhe gjatë hartimit të planit të pestë pesëvjeçar, kështu do të ndodhë edhe gjatë zbatimit të tij. Si rrjedhim i kësaj pune të gjerë u arrit në konkluzionet që ndihmuan për formulimin e tezave të Kongresit të 6-të dhe të projektdirektivave të pesëvjeçarit të ri, të cilat morën më në fund formën e ligjit me aprovimin e tyre në Kuvendin Popullor.

Por lufta për ndërtimin socialist gjatë pesëvjeçarit të ri nuk kufizohet thjesht në frontin e ndërtimit ekonomik të vendit. Kjo është pleksur edhe me një punë të madhe për zhvillimin e gjithanshëm politik, shoqëror, arsimor e kulturor dhe për forcimin e mbrojtjes së atdheut. Dhe tërë kjo veprimtari është bërë në baza leniniste, me pjesëmarrjen aktive, luftarake të të gjitha masave të popullit.

Direktivat e Kongresit të 6-të të Partisë tashmë janë shtruar kudo me komunistët dhe me masat e gjera pa Parti. Tani puna është që ato të zbatohen në jetë në mënyrë revolucionare me pjesëmarrjen aktive të

popullit, të klasës punëtore, të fshatarësisë, të inteligjencies sonë popullore, ndryshe nuk ka kuptim dhe nuk mund të realizohen.

Lufta për zbatimin e këtyre direktivave do të thotë në të njëjtën kohë edhe kontroll në praktikë i drejtësisë së tyre. Kjo ka rëndësi të veçantë. Ne nuk mund të shkojmë nga parimi që direktivat e Partisë, meqenëse janë fryt i një pune të gjithanshme të bërë me pjesëmarrjen e gjerë të masave të popullit, mund të jenë që të gjitha, pa përjashtim, pa asnjë të metë dhe lehtë të realizueshme e të drejta për zbatim. Gjatë përpjekjeve për të vënë në jetë direktivat e pesëvjeçarit, ne do të hasim edhe në vështirësi të shumëllojta, materiale dhe jomateriale, për arsye se ekzistojnë gjithfarë mungesash, do të hasim në pengesa të ndryshme, sepse ekziston lufta e klasave, ndeshet vazhdimisht e reja që ecën përpara me të vjetrën, që mundohet ta pengojë, prandaj e reja, e forta e godit atë, derisa e likuidon. Në këtë ndeshje duhen gjetur edhe format më të përshtatshme të punës për zbatimin e plotë të direktivës. Prandaj në asnjë mënyrë nuk mund të thuhet se, meqë këto janë direktiva të Partisë, çdo gjë do të zbatohet symbyllur, pa përpjekje, pa luftë. Do të ishte një gabim i madh të mendohet se ato nuk ka kush i pengon, ndryshe mohohet lufta e klasave, mohohen kontradiktat, mohohen vështirësitë, pengesat dhe çdo gjë tjetër që nuk na lë të ecim përpara. Në jetë ka e do të ketë faktorë të ndryshëm dhe njerëz që, me dashje ose pa dashje, do të na pengojnë në rrugën tonë. Kjo e bën të domosdoshëm organizimin e punës për kontrollin e zbatimit të direktivave.

Kur themi të kontrollohet zbatimi, nënkuptojmë edhe kontrollin e drejtësisë së vetë direktivës. Në përgjithësi direktivat e Partisë sonë kurdoherë kanë qenë dhe janë të drejta, për arsye se vija e përgjithshme e saj ka qenë dhe është e drejtë. Siguria e drejtësisë së vijës qëndron në kalitjen e saj në të kaluarën, në luftën revolucionare të tashme dhe në të ardhmen, duke i qëndruar besnike marksizëm-leninizmit.

Partisë sonë në të kaluarën i kanë ndodhur shumë ngjarje, por ajo ka mbajtur në çdo rast qëndrim të drejtë marksist-leninist, ka luftuar në mënyrë revolucionare, ka fituar kurdoherë me vendosmëri mbi kundërrevolucionarët dhe ka punuar me këmbëngulje për kapërcimin e çdo lloj vështirësie që i ka dalë përpara. Partia jonë që në fillim ka qenë Parti revolucionare, e përbërë prej revolucionarësh, prandaj ka njohur e do të njohë vetëm fitore. Ajo edhe tash është një Parti revolucionarësh, edhe në të ardhmen kështu do të jetë.

Megjithatë, gjatë kohës, në direktivat, në vendimet dhe në urdhëresat e ndryshme të Partisë e të shtetit, ka pasur edhe të meta e gabime, edhe gjëra që nuk kanë qenë të drejta, jo në kuptimin që ato të kenë ndryshuar vijën e përgjithshme të drejtë të Partisë, por për këtë ose për atë çështje të veçantë që nuk është gjetur zgjidhja e drejtë. Në këto raste, porsa është konstatuar gabimi, janë marrë masa për ta korigjuar. Prandaj themi se gjatë kontrollit në praktikë të vijës së Partisë që është përpunuar për t'u zbatuar edhe në këtë pesëvjeçar, duhet parë në jetë, si kurdoherë, drejtësia e çdo direktive.

Çështja duhet parë nën prizmin e raportit midis pakicës e shumicës, Partisë dhe popullit. Është Partia ajo që jep direktivat, por në sajë të luftës e të punës së palodhur të popullit, nën udhëheqjen e Partisë, janë krijuar gjithë këto të mira, janë hedhur themelet e socializmit në vendin tonë. Në rast se themi që të gjitha këto realizime i bëri vetëm Partia dhe popullin e injorojmë, atëherë u shmangëm nga vija e drejtë, gabuam. Siç na mëson Lenini, pakica pa shumicën nuk bën dot gjë, jo vetëm nga pikëpamja që nuk mund të ndërtohet shoqëria socialiste vetëm nga komunistët, por edhe nga pikëpamja tjetër që vetëm mbi bazën e eksperiencës së gjallë të masave mund të përpunohet një vijë e drejtë dhe një udhëheqje e drejtë e ndërtimit socialist, mund të kontrollohet nëse direktivat janë të drejta dhe të shmangen gabimet. Në qoftë se themi që këtë kontroll do ta bëjnë vetëm Partia dhe pushteti, gabuam, por në qoftë se themi që atë do ta bëjë populli, edhe sikur të harrojmë të përhëndim në ndonjë rast Partinë, nuk gabojmë, sepse roli udhëheqës aktiv e vendimtar i Partisë në shoqërinë tonë nënkuptohet, mbasi populli ynë është i lidhur ngushtë me Partinë, duke qenë njëkohësisht gjykatësi më i mirë i veprës së saj.

Por Partia jonë nuk ka gabuar dhe as nuk do të gabojë në këtë drejtim. Megjithatë ka njerëz që, për të fshehur gabimet e tyre, thonë gjëra dhe kryejnë veprime që nuk përpunohen me vijën e Partisë. Ka rëndësi të madhe çështja si e kupton Partia ndërtimin e socializmit. Socializmi ndërtohet nga masat e popullit, zbatimi i direktivës realizohet nga masat e popullit,

drejtësia e Partisë sigurohet me pjesëmarrjen e popullit, edhe puna për korigjimin e gabimeve bëhet gjithashtu me popullin. Pa këtë asgjë nuk mund të bëhet. Këtu qëndron një nga parimet e mëdha leniniste, nga të cilat te ne nuk është lëvizur e nuk do të lëvizet kurrë. Le të flasim hrushovianët, toliatistët dhe gjithë plehrat revizioniste, le të kritikojnë ata parimet e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit mbi partinë, mbi pararojën e klasës punëtore. Këto parime qëndrojnë të patundura si mali i Tomorit, ato nuk lëvizin, por qëndrojnë fort si shkëmb graniti. Partia është në pararojë, ajo është pararoja e klasës punëtore dhe pikërisht këtë përpiqen ta hedhin poshtë «teoricienët» revizionistë. Megjithatë teoria leniniste mbi partinë nuk lëviz, ajo nuk mund të errësohet nga «teoritë» e plehrave revizioniste.

Ne themi që Partia është pararoja e klasës punëtore. Po ç'do të thotë kjo? Të gjithë e dimë dhe e shohim përditë si e ku punon klasa punëtore. Ajo është vazhdimisht në luftë, ajo punon në miniera, në fabrika, në bujqësi, në kantiere, në kanale e kudo, ndeshet me vështirësi e privacione të shumëllojshme dhe lufton për t'i kapërcyer ato. Po pararoja e saj, Partia, ku duhet të jetë atëherë? Kjo duhet të jetë medoemos në ballë të luftës, të punës, në prodhim. Këtu është vendi i nderit për komunistët, ndryshe Partia nuk mund ta luajë rolin e pararojës. Prandaj Partia ka porositur e porosit vazhdimisht që shumica dërrmuese e komunistëve të shkojë në prodhim dhe atje ata të jenë në ballë të punës e të sakrificave, shembull në çdo drejtim. Këtë të mos e harrojmë kurrë, ndryshe

u larguam nga vija leniniste, u bëmë «zotërinj», u bëmë «komandues». Komunistët e kanë për detyrë të qëndrojnë si kurdoherë në pararojë të asaj klase që punon dhe ndeshet me vështirësi e mundime. Kjo kërkon që udhëheqja e Partisë, e pararojës së klasës punëtore, të sigurohet atje ku janë frontet më të vështira të luftës dhe të punës.

Vihet pyetja: Përse pikërisht në këto fronte duhet të sigurohet udhëheqja e Partisë? Që të sigurohet deri në fund zbatimi i përpiktë i direktivave të saj, domethënë zbatimi i dëshirave, i qëllimeve, i aspiratave të klasës punëtore dhe të fshatarësisë. A mund të realizohet ky synim fisnik kur shumica e komunistëve bëhen «zyrtarë», grumbullohen nëpër zyra? Në asnjë mënyrë jo! Të mendosh e të veprosh kështu, do të thotë të mendosh e të veprosh me mentalitetin e vjetër mikro-borgjez, sipas të cilit të sigurosh udhëheqjen e Partisë do të thotë gjoja që shumica e komunistëve të zërë kyçet e komandës dhe të japë urdhra, që anëtarët e Partisë të komandojnë, ndërsa njerëzit pa Parti të jenë të komanduar. Jo, në këtë mënyrë nuk sigurohet udhëheqja. Udhëheqja e Partisë e kupton drejt nevojën e aparateve, por kjo s'ka asgjë të përbashkët me fryrjen e aparateve të pushtetit popullor, të organizatave ekonomike apo të organizatave të masave me komunistë. Nuk duhet menduar e vepruar, pra, siç e kuptojnë disa këtë çështje, duke grumbulluar sa më shumë komunistë nëpër zyra, pse kështu gjoja sigurojmë udhëheqjen e Partisë e të pushtetit etj. Në goftë se në pushtet sjellim vetëm komunistë, në organizatat e masave sjellim gjithashtu vetëm komunistë,

në qoftë se veprojme po kështu edhe në sektorët e tregtisë, të ndërtimit, të kulturës, në të gjitha hallkat e ndërtimit socialist, atëherë është e qartë se nuk u përmbahemi si duhet këtyre mësimeve të Leninit.

Ja ç'thotë Lenini në një vend tjetër për këtë problem të madh parimor:

«Duhet që punëtorët të hyjnë në të gjitha institucionet shtetërore, që ata të kontrollojnë gjithë aparatin shtetëror, dhe këtë duhet ta bëjnë punëtorët pa parti, të cilët duhet të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në konferencat e punëtorëve dhe të fshatarëve pa parti... Ne duhet të vëmë në këtë aparat sa të jetë e mundur më shumë punëtorë dhe fshatarë... dhe kështu do të flakim burokratizmin nga institucionet tona. Është e domosdoshme që masat e gjera pa parti të kontrollojnë të gjitha punët e shtetit dhe të mësohen të qeverisin vetë»¹.

Në këtë çështje ne duhet të mbajmë parasysh edhe të ardhmen, kur të vemi në komunizëm. Atëherë nuk do të ketë më parti dhe shtet, sepse njerëzit do të vetëqeverisen. Për këtë qëllim Partia, masat pa Parti të popullit, nga të cilët ka dalë edhe vetë ajo, pra klasën punëtore, fshatarësinë, gjithë punonjësit, duhet t'i mësojë qysh tani të vetëqeverisin.

Duke e parë kështu çështjen, atëherë mund të themi se e kuptojmë drejt idenë se është shumica që e ndërton socializmin, se pa shumicën pakica nuk mund

1. V. I. Lenin. Veprat, vëll. 30, f. 400.

të bëjë dot gjë. Këtë duhet ta kuptojmë mirë, ashtu siç duhet të kuptojmë se udhëheqja e partisë është e domosdoshme, siç na mëson Lenini, gjë që e trajtova pak më parë.

Si qëndron tani kjo çështje në vendin tonë? Kemi kudo një raport të drejtë midis komunistëve dhe kuadrove pa Parti? Në aparatet tona shtetërore ose në aparatet administrative, në aparatet ekonomike apo të organizatave të masave, është e domosdoshme të jenë pothuaj të gjithë komunistë? Natyrisht, në aparatet e Partisë është pak më ndryshe, në përgjithësi ata që punojnë këtu kërkohet të jenë komunistë. Punëtorë të paorganizuar në Parti nuk mund të merren aty veç në një masë më të kufizuar. Megjithatë ka detyra që edhe në një aparat partie mund të vendosen punonjës të paorganizuar në Parti, pse nuk është e thënë që shoferi, fjala vjen, portieri, bibliotekari e disa punonjës të tjerë të jenë anëtarë partie.

Por le t'i përgjigjemi pyetjes që bëra: si qëndron kjo punë te ne? Në përgjithësi nuk qëndron keq, por duhet ta njohim se nuk qëndron sa duhet mirë. Prandaj na vihet detyrë t'i rishikojmë disa çështje në këtë drejtim. Ky problem nuk e ka preokupuar vetëm sot Partinë. Partia jonë vazhdimisht u ka dhënë direktivën komunistëve të hidhen në radhët e para të luftës, kurse pas Çlirimit atje ku janë vështirësitë më të mëdha për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e fitoreve të arritura. Këto vitet e fundit, sidomos me masat që janë marrë për revolucionarizimin e kuadrove, është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe në këtë drejtim dhe kjo përbën një nga meritat më të mëdha

të Partisë sonë. Marksistë-leninistët, partitë motra komuniste në vende të ndryshme, i konsiderojnë si një gjë të re për marksizëm-leninizmin masat që ka marrë aktualisht Partia jonë për t'u mbyllur shtigjet ndikimeve të rrezikshme të revizionizmit modern, të oportunitizmit të djathtë.

Një regres të madh i ka sjellë revizionizmi modern lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Cili është ky regres, kush e shkaktoi dhe si duhet ta përballojmë? Partia e Punës e Shqipërisë qëndroi e patundur në parimet marksiste-leniniste të Partisë, në teorinë e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit, kur këto u sulmuan nga tradhtarët, revizionistët modernë. Në kushtet e vështira që u krijuan për lëvizjen komuniste botërore Partia jonë gjeti rrugët e format se si t'u bënte ballë sulmeve të tërbuara të armiqve jo vetëm me propagandë, por edhe me forma pune konkrete. Gjithë këto lëvizje të fuqishme revolucionare që u ndërmorën në vendin tonë, ku përfshihet edhe lëvizja përdërgimin e kuadrove në prodhim etj., etj., përbëjnë pikërisht atë kontribut për të cilin po flitet dhe që po jep sot Partia. Partia jonë kurdoherë e ka shikuar dhe duhet akoma më me kujdes ta shikojë këtë çështje, sepse në praktikë, në jetë nuk kuptohen dhe nuk zbatohen kurdoherë e në çdo rast si duhet mësimet marksiste-leniniste. Kjo do të arrihet plotësisht kur ne të jemi zhveshur nga çdo ndjenjë mikroborgjeze, nga mbeturinat e ideologjive armiqësore, kur të mendojmë e të veprojmë kurdoherë si revolucionarë, siç do Partia. Në qoftë se vajtja e komunistit në prodhim në çdo kohë është e drejtë, është në interes të Partisë dhe të

popullit dhe kur shihet se ai tregohet i gatshëm dhe shkon pa hezitim atje ku i kërkohet, i përgjigjet thirrjes së Partisë, atëherë mund të themi se një komunist si ky është në pararojë. Po të shihet çështja kështu nga çdo anëtar partie, kjo është shumë pozitive dhe tregon se Partia dhe komunistët që e përbëjnë atë janë në rrugë të drejtë.

Por do të jenë akoma në rrugë më të drejtë Partia dhe anëtarët e saj, kur komunisti që punon në administratë, pa iu thënë, del vetë e i propozon udhëheqjes: «Ore, ç'më mbani këtu mua? S'mund të rri këtu ku më keni vënë, në administratë! Do të shkoj të punoj në kooperativën bujqësore». Këtij njeriu t'i shtrëngojmë dorën, pse tregon që jo vetëm e ka kuptuar drejt parimin, por edhe është i vendosur ta zbatojë atë me iniciativë, pa i thënë kush nga lart. Shumë mirë bën edhe ai inxhinier që i drejtohet kështu Partisë: «Këtu në dikaster jemi të tepërt ose u mbyta në kartëra, shokë, s'dua të rri më në zyrë, s'dua të rri në administratë, vendi im është në bazë, prandaj do të vete në hekurudhë ose në hidrocentral që të punoj si inxhinier ose si mjeshtër» etj. Kjo është një gjë shumë pozitive për atë dhe për Partinë. Shembuj të tillë gatishmërie nuk mungojnë te ne, por në këtë drejtim, duhet njohur, kemi shumë për të bërë.

Lidhur me këto që ju thashë, dëshiroj t'ju jap disa shifra. Në totalin e kuadrove të aparateve qendrore të ministrive komunistët zënë 45,5 për qind, pra gati gjysmë për gjysmë. Megjithatë duke i parë shifrat një nga një për çdo dikaster, ka diferenca. Për shembull, në Ministrinë e Shëndetësisë kemi rreth 56,9 për qind

të kuadrove komunistë. Ç'duhën gjithë këta komunistë atje, sidomos doktorë? Nuk do të ishte mirë që komunistin mjek ta dërgosh, fjala vjen, në Macukull t'i shërbejë popullit, në vend që të struket në një zyrë ministrie në Tiranë? Ose në aparatin e Komisionit të Planit të Shtetit 50,5 për qind e kuadrove janë komunistë, në Ministrinë e Tregtisë komunistët zënë gjithashtu 52,2 për qind.

Përse vallë duhen kaq shumë komunistë, të themi, në aparatin e Ministrisë së Tregtisë? A nuk do të ishte më mirë që shumë nga këta komunistë, që punojnë këtu, të shkojnë sa më parë në bazë, atje ku zhvillohet lufta praktike për të furnizuar si duhet popullin e për t'i shërbyer atij sa më mirë, për të likuiduar shumë të meta që kemi në këtë sektor apo për të ruajtur pasurinë e popullit nga shpërdorimet, ndërsa në vendin e tyre në aparatin e këtij dikasteri të vendosen më shumë patriotë, njerëz të paorganizuar në Parti? Në bazë, këta komunistë do të ishin me të vërtetë në frontin e parë të luftës për socializëm, atje ku lindin problemet e mprehta që kërkojnë zgjidhje dhe ku hasen vështirësitë më të mëdha që duhen kapërcyer.

Pra, kur nuk është e domosdoshme të caktosh me punë në një vend një komunist, ky të dërgohet të punojë më mirë në bazë, në prodhim, për arsye se puna është nder për të gjithë, si për komunistin, ashtu edhe për çdo patriot të paorganizuar në Parti. Derisa është kështu, atëherë le të shkojë më parë anëtari i Partisë atje ku nevojitet dhe ku ekzistojnë më shumë vështirësi, ndërsa në aparatet administrative të sillen aq komunistë sa është e domosdoshme, jo më tepër,

vendet e tjera të zihen me njerëz të paorganizuar në Parti. Kështu kur del nevoja për të pasur një shef në dikaster, ta zëmë në Ministrinë e Arsimit, një tjetër në Ministrinë e Tregtisë e kështu me radhë, gjenden fare mirë njerëz të përshtatshëm, patriotë edhe të paorganizuar në Parti.

Ne, komunistët nuk jemi pranuar në Parti për të siguruar përfitime, përkundrazi, duke pasur nderin e madh të bëjmë pjesë në radhët e Partisë, na vihen detyra më të rënda e më të mëdha përpara Partisë dhe përpara popullit për të gjitha çështjet, duke filluar nga kërkesat për zbatimin me rreptësi të ligjeve të Partisë, të normave të saj etj., etj. e deri në zbatimin në mënyrë të përpiktë të detyrave si qytetarë, duke dhënë shembullin përpara punonjësve të paorganizuar në Parti.

Të mos kemi frikë se duke vepruar kështu do të na mbeten studimet pa bërë në qendër. Edhe studime do të bëjmë, por me këtë punë mund të merren fare mirë jo vetëm komunistët, po së bashku me ta edhe punonjës të paorganizuar në Parti, si Naum Stralla¹, që ishte një nga njerëzit më të mësuar të ekonomisë sonë, i ndershëm, patriot, i zoti, prandaj e kishim nga këshilltarët më të mirë të Partisë dhe të Qeverisë. Të tillë tani kemi shumë. Atëherë le të mbahen në dikaster më tepër njerëz të zotë të paorganizuar në Parti e patriotë si këta, kurse komunistët të dërgohen më shumë në bazë, ku edhe studime mund të bëjnë. Mos vallë s'ka nevojë, të themi, rrethi i Burrelit për

1. Ish-kryetar i Sektorit të Çmimeve pranë aparatit të Këshillit të Ministrave, Hero i Punës Socialiste.

shokë komunistë me eksperiencë që të bëjnë edhe studime? Sigurisht ka nevojë. Po si bëhen këto studime? Shpeshherë nga ministria me shkresë i kërkojnë formularë seksionit përkatës të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit për të siguruar të dhëna konkrete, në bazë të të cilave do të bëhen studimet. Kjo do të thotë se këto studime nuk mund të bëhen pa bazën. Derisa është kështu, atëherë pse të mos punojë në bazë edhe ai që merret me studime? Kështu studimet do të jenë edhe më të mira, sepse nuk do të bëhen nëpërmjet shkresave, por duke njohur nga afër jetën e gjallë të popullit.

Po ka edhe diçka tjetër akoma më «të bukur» në grumbullimin e komunistëve nëpër aparatet dhe pikërisht atje ku flitet për vijën e masave. Në totalin e kuadrove të aparateve qendrore dhe të organizatave të masave në qendër komunistët zënë 55 për qind, kurse vetëm në aparatet e organizatave të masave në rrethe 63,1 për qind e kuadrove janë komunistë. Por edhe midis organizatave të masave ka diferenca. Kështu, në aparatet e organizatës së rinisë në qendër e në rrethe komunistët zënë 51,2 për qind, në ato të bashkimeve profesionale 67,2 për qind, në ato të gruas 65,8 për qind. Në organizatat e masave pra, atje ku ditë e natë, ngreu e bjerë, lodhemi vazhdimisht duke folur e bërë propagandë «të mbështetemi në masat, të mbështetemi në masat», pikërisht në ato që i quajmë organizata masash, në çdo 100 punonjës të aparateve të tyre shumica janë anëtarë partie. Përse të mos sillen në to elementë të paorganizuar në Parti? Është e domosdoshme të jenë në aparatet e tyre gjithë këta

komunistë? Ç'duan të gjithë këta nëpër aparate? Pse s'dërgohen të punojnë gjatë dhe në vend të tyre të vihen punonjës të paorganizuar në Parti?

Le të shikojmë tani si qëndron çështja me këshillat popullorë, në ata të Frontit dhe në gjykatat popullore të rretheve. Edhe këtu komunistët zënë: në këshillat popullorë të rretheve e të bazës 34,65 për qind, ndërsa në këshillat e Frontit 31,73 për qind. Gjyqtarët e ndihmësgjyqtarët të zgjedhur në 24 rrethe, 51,9 për qind janë komunistë. Shikoni sa shumë komunistë kemi edhe në këta organizma.

Këto ditët e fundit kërkova të më sillnin listat e deputetëve të zgjedhur në Kuvendin Popullor dhe vura re se një përqindje e lartë e tyre janë komunistë. Përse të jenë në një përqindje të tillë komunistët në këtë organ? Ne kemi pasur në Kuvend edhe përpara njerëz që nuk ishin në Parti. Bile që në kohë të luftës në Këshillin e Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar kanë qenë zgjedhur patriotë të shquar të paorganizuar në Parti, që pas Çlirimit vazhduan të ishin deputetë gjatë shumë legjislativave. Vetëm në këtë të fundit disa prej tyre nuk u zgjodhën, ashtu siç nuk u zgjodhën edhe shumë komunistë, jo për arsye mosbesimi, por sepse u mendua që në këtë organ të lartë të pushtetit të vijnë edhe elementë të rinj. Mirëpo na rezultoi se gati të tërë të zgjedhurit e rinj janë anëtarë partie. Mos vallë është kurdoherë e domosdoshme që, për të zgjedhur deputet ose këshilltar një punëtor të dalluar apo një kooperativist të shquar, ky duhet të jetë me doemos në Parti, kur ne kemi sa të duash punëtorë e kooperativistë të dalluar, bile edhe heronj të punës

socialiste që janë të paorganizuar në Parti dhe që e meritojnë plotësisht këtë besim?

Vihet pyetja: Pse na ka ngjarë një gjë e tillë? Na ka ngjarë për disa arsye. Njerëzit më të mirë ne i pranojmë në Parti. Duke qenë nga më të mirët, komunisti i ri, kur është ndodhur edhe në një funksion me rëndësi në kohën që është pranuar anëtar partie, është menduar që ai të mbetet atje. Kjo na ka ngjarë, pra, duke u nisur nga synimi që edhe kuadrot t'i ngremë nga radhët e njerëzve më të mirë dhe si kriter është e drejtë të zgjidhen kështu, por e kemi tepruar shumë në këtë drejtim, duke u përpjekur të kemi sa më tepër komunistë.

Ka pastaj edhe një shkak tjetër që na ka çuar në këtë gjendje. Shpeshherë shokët drejtues, organet dhe organizatat e Partisë, për të caktuar një kuadër në një vend të rëndësishëm, e kanë më lehtë të vendosin për këtë punë nga zyra. Disa herë defterin me listën e kuadrit komunist ata e kanë gati, prandaj kur u lind një nevojë, për t'u shpëtuar telasheve, thonë ç'më duhet mua të vë në këtë përgjegjësi një punonjës të paorganizuar në Parti, kur kam një listë të tërë me anëtarë partie, biografinë e të cilëve e njoh, di, gjithashtu, se kudo që kanë qenë kanë punuar mirë, janë të ndershëm etj. Kështu ai i vë shenjën ndonjërit prej komunistëve dhe e merr, ta zëmë, nga rrjeti i tregtisë së Burrelit e ta sjell në atë të Tiranës. Në këtë mënyrë janë vendosur shumë komunistë në vende me përgjegjësi, kurse të tjerët, ata të paorganizuar në Parti, megjithëse ka prej tyre sa të duash njerëz të mirë, si njohin sa duhet. Edhe kjo ka bërë të vendosen nëpër

aparartet administrative komunistë më shumë nga sa është e nevojshme.

Pastaj ka edhe nga ata komunistë, dhe kjo është akoma më e rrezikshme, që përpiqen të zënë qoshe të ngrohta, që luftojnë të zënë ndonjë kolltuk, ndonjë pozitë. Njerëz si këta, që mendojnë dhe dallohen për të tilla prirje, dinë kujt i duhet fërkuar zverku dhe krahët, ata mundohen të shfrytëzojnë rastin për të thënë ndonjë fjalë të mirë dhe të krijojnë me këtë mënyrë opinionin në favor të tyre të shokët përgjegjës, të drejtorët, shefat etj. për të siguruar vendin që synojnë të zënë. Edhe kjo është një arsye që ka bërë të kemi shumë komunistë në aparatet tona.

Ka, më së fundi, edhe një arsye tjetër në mosngritjen e kuadrove nga radhët e njerëzve të paorganizuar në Parti: mosbesimi ndaj tyre. Mirëpo kjo merr një rëndësi të madhe nga ana parimore. Partinë ne duhet ta mbajmë kurdoherë revolucionare, ta ruajmë vazhdimisht si një parti pararojë, që të zbatojë me të vërtetë në jetë parimin marksist-leninist të lidhjes së ngushtë me popullin, parim që jo vetëm ta deklarojë, por edhe ta zbatojë konkretisht dhe plotësisht në jetë.

Si duhet trajtuar elementi i paorganizuar në Parti? Marksizëm-leninizmi na mëson që elementin e paorganizuar në parti komunisti duhet ta trajtojë si të barabartë me veten, të sillet ndaj tij me besim si ndaj vëllait. Në rast se një komunist nuk ka besim tek elementi i paorganizuar në parti, edhe ky nuk do të ketë besim te komunisti. Kjo është reciproke.

Lenini këshillon që marrëdhëniet midis anëtarëve të partisë dhe elementëve të paorganizuar në parti du-

het të karakterizohen nga besimi reciprok. Besimi i komunistëve ndaj njerëzve të paorganizuar në parti krijon besim nga ana e këtyre të fundit për komunistët. Ky besim krijohet nëpërmjet ndihmës e kontrollit reciprok midis anëtarëve të partisë dhe elementëve të paorganizuar në parti gjatë punës praktike të përditshme. Kjo ka rëndësi të madhe, shokë, për ne dhe për çdo parti.

Partia jonë, në përgjithësi, ka besim të madh në masat e popullit dhe pikërisht pse ka një besim të tillë, jo me fjalë, por me punë, prandaj është e lidhur ngushtë me to. Populli ka parë se komunistët kanë dërdhur gjak, kanë bërë sakrifica të mëdha, të panumërta, kanë luftuar me vetëmohim në çdo moment për interesat e tij, prandaj besimi që ai ushqen ndaj Partisë dhe komunistëve është shumë i madh. Por është e domosdoshme që këtë besim të madh që kanë masat te Partia ta ruajmë si sytë e ballit, pse kjo përbën forcën më të madhe të Partisë. Ky parim leninist është pasur kurdoherë parasysh dhe respektohet në Partinë dhe në vendin tonë, prandaj Parti dhe popull përgjërohen për njëri-tjetrin, kanë besim të plotë te njëri-tjetri. Kjo është e qartë për të gjithë dhe as që diskutohet. Çështja qëndron tani që në raportet e përditshme, në raporte individuale dhe në marrëdhënie pune, këtë parim të madh, që tashmë ka triumfuar në vendin tonë, Partia ta ruajë e ta zhvillojë akoma më tej.

Besimin e komunistëve ndaj njerëzve të paorganizuar në Parti duhet ta shohim konkretisht në punë. Vërtet ti je anëtar partie dhe mban në xhep taserën e anëtarësisë në Parti, por që ta meritosh këtë taserë,

duhet të kesh besim edhe tek ai që është i paorganizuar në Parti, që s'ka tesër, kur është njeri i mirë, punëtor i dalluar, i ndershëm, me gjithë cilësitë e mira. Kur është puna kështu, të marrim prapë rastin e zgjedhjeve, përse të kesh besim vetëm tek ai që është anëtar partie e jo edhe tek tjetri që është i paorganizuar në Parti dhe po aq besnik ndaj popullit e Partisë të cilit po t'i thuhet: «Shko, hidhu në zjarr» për Partinë është i gatshëm në çdo kohë të bëjë çfarëdo sakrifice? Mundet që një njeri i tillë të mos jetë futur në Parti, se i mungojnë disa cilësi si komunist, por edhe ai është i vendosur, edhe ai e zbaton me besnikëri vijën, është si të thuash një «bolshevik pa parti». Një patriot i paorganizuar në Parti është gati të shkojë kudo ku t'i thuhet, të kryejë çdo detyrë që t'i ngarkohet, sado e vështirë që të jetë, jo pse ai komunikon me atë ose këtë komunist, po pse është i bindur se e tillë është vija e Partisë, ai e kryen porosinë për hir të dashurisë që ka për Partinë.

Mund të ndodhë që ndonjëri të thotë: «Më fal, po kam një nevojë, nuk largohem dot nga qyteti, sepse kam gruan ca të sëmurë». Në këtë rast, për atë që është pa Parti do mbyllur njëri sy dhe kërkesa i duhet marrë parasysh, pa humbur aspak besimin ndaj tij. Ndryshe mund të veprohet me komunistin. Kur ky thotë «nuk iki dot nga qyteti për në fshat, se kam gruan sëmurë», t'i thuhet: «Hajde, nisu menjëherë në krye të detyrës, pse edhe në fshat ka gra të sëmura, edhe atje lindin ato, edhe atje, si kudo, ka njëloj një-rëz me reumatizëm apo me sëmundje të tjera, pastaj pse është spitali, kur të jetë nevoja, çojë atje. Mos

vallë vetëm në Tiranë e në qytetet e mëdha ka të sëmurë të kësaj kategorie? Po në malësi a nuk kemi ne të tillë? Ç'bëjnë ata atje?». Ndaj këtyre justifikimeve të ndonjë komunisti duhet të jemi të rreptë, sepse komunisti, siç na mëson Partia, duhet të jetë i pari në sakrificë dhe i fundit në pretendime.

E kam çështjen, pra, që besimi në masat e popullit duhet të vërtetohet e të forcohet në jetë, në praktikë. Kjo është një karakteristikë e madhe e Partisë sonë që duhet të ruhet, të zhvillohet më tej, të bëhen përpjekje që besimi të fitohet deri edhe te një individ i vetëm, sepse pika-pika bëhet lumi. Gjithë kjo dashuri e madhe në mes të Partisë dhe popullit është krijuar në sajë të gjakut të derdhur. Komunistët u vranë e u sakrifikuan për popullin, i cili e pa se ata janë bijtë e bijat e tij, janë njerëzit e tij më të mirë, prandaj ky besim të ruhet e të zhvillohet reciprokisht.

Çështja pastaj nuk qëndron vetëm në problemin se sa njerëz të paorganizuar në Parti kemi zgjedhur në këshillat e instancave të të gjitha niveleve, por edhe si i përdorim këta, si i aktivizojmë për të kryer detyrat që u ka ngarkuar populli. Sepse jo vetëm që më pak njerëz pa Parti zgjedhim në këto organe, por edhe kur i zgjedhim, jo kurdoherë i aktivizojmë sa duhet.

Mua më pëlqeu diskutimi i shoqes Nika Treska, kryetares së Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Qytetit të Burrelit, kur foli për kontaktet e mira që kanë këtu këshilltarët me masat e zgjedhësve të tyre, për zgjidhjen e problemeve nga ana e tyre së bashku me popullin. Kjo është pikërisht ajo rrugë e drejtë që kërkon Partia të ndiqet, kështu duhet të veprohet nga-

herë në këtë drejtim. Megjithatë është e ditur se ne nuk i aktivizojmë si duhet e sa duhet as deputetët, as anëtarët e këshillave popullorë të rretheve dhe as anëtarët e këshillave popullorë të fshatrave. Dhe bëjmë gabim të madh që nuk i aktivizojmë këta në punët e drejtimit të shtetit e të kontrollit të ekonomisë. Këta janë qindra e mijëra nga njerëzit më të mirë të popullit, prandaj, në radhë të parë, këta duhet të mësojnë si drejtohen shteti dhe ekonomia, t'i mësojmë të mbajnë lidhje të ngushta me masat që i kanë zgjedhur e të sjellin në këshilla zërin, vërejtjet e propozimet e tyre, të sjellin të vërtetën ashtu si ekziston, pa mbulesë, pa oportunitizëm. Ka me siguri nëpunës të administratës që janë të ndershëm, sepse nuk mund të themi se të tërë punonjësit e aparateve administrative janë njëlloj. Por është fakt se mes tyre ka edhe oportunistë, ka të tjerë që duan të ruajnë vendin, që u bëjnë qejfin eprore dhe kur s'e kryejnë detyrën mundohen ta fshehin, ta mbulojnë. Kurse këshilltari, si i zgjedhur i popullit, kur lidhet ngushtë me masat, sjell në këshill zërin e tyre.

Po a kanë kompetenca këshilltarët? Kanë, bile dhe shumë. Atëherë përse s'ua japim këto atyre praktikisht? Ne shumë herë kemi thënë se si duhet të veprojnë këshillat, po duhet njohur haptazi se nuk i aktivizojmë sa duhet, pse kemi besim më shumë te njerëzit e aparateve, sesa te këshilltarët që zgjidhen nga masat e popullit. Kjo ka sjellë si pasojë që aparatet e komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë në rrethe t'i fryjmë jashtë nevojave me njerëz të emëruar, sidomos tani nën pretekstin e zgjerimit të kompetencave.

Kjo ka bërë që aparatet e komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të kenë aktualisht nga 120-130 veta sa ç'ishin ministritë në kohën kur bëmë «qethjen» në fund të vitit 1965, ndërsa vetëm seksioni i bujqësisë në rreth ka 15-20 veta, ai i arsimit, gjithashtu, rreth 20 veta e kështu me radhë seksioni i tregtisë etj., etj. Derisa i kemi fryrë me kaq njerëz këto aparate, atëherë ç'na duhen këta këshilltarë neve, mendon kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor, nënkryetari i komitetit ekzekutiv, shefi i seksionit apo edhe sekretari i komitetit të Partisë të rrethit? E po mirë, ata janë zgjedhur, prandaj mjafton të vijmë një herë në tre muaj në këshill, aty u japim gjoja nga një llogari, bëjmë ndonjë mbledhje solemne me ta, ku, po të doni, japim një raport dhe puna mbaron me kaq.

Vallë jemi në rrugë të drejtë duke vepruar kështu, shokë? Aktivizimin e njerëzve të zgjedhur Partia nuk e ka ngritur tani. Ajo këtë na e ka theksuar shumë kohë përpara dhe na ka këshilluar se si të veprojmë me ta. Këshilltarët janë përfaqësuesit e drejtpërdrejtë të popullit, janë të zgjedhurit e tij. Partia, pushteti dhe populli i japin të drejtë një deputeti që kur konstaton një çrregullim në rrjetin e tregtisë, fjala vjen, ose kur zgjedhësit i ankohen se atje bëhen hatëre etj. pavarësisht se mund të jetë punëtor në një uzinë apo fabrikë, ai vetëm sa e lajmëron drejtorin e ndërmarrjes ku punon duke i thënë se atë ditë do të vejë të kontrollojë disa nga njësitë e tregtisë. E mëson Partia atë të veprojë kështu, kurse drejtori i tij e ka për detyrë të mos i sjellë asnjë pengesë, përkundrazi ta lejojë të shkojë për të kryer si duhet funksionin e tij si deputet. Po

kështu dy-tre deputetë, nuk flas këtu vetëm për deputetët e Kuvendit Popullor, por edhe për ata të këshillave popullorë në rrethe, janë shumë mirë në gjendje të zëvendësojnë 20-30 nëpunës të mbledhur në aparat-in e komitetit ekzekutiv. Po ku punojnë këta deputetë? Njëri mund të punojë në këpucari, tjetri në zdrukthëtari, një në fabrikë, tjetri në ndërtim etj., etj. Të gjithë këta janë përfaqësues të popullit, janë njerëz të prodhimit, njerëz të klasës, prandaj, po të aktivizohen, mund të bëjnë shumë punë.

Ne kemi folur shumë për kontrollin e klasës, po më duket sikur kjo çështje tani është lënë ca në hesh-tje, ka rënë. Mirëpo kontroll i klasës do të thotë që klasa punëtore të ngrihet dhe të ndihmojë Partinë e saj në zbatimin e një direktive që ka lëshuar. Partia pa klasën nuk mund të rrojë dot, ashtu sikurse vetë klasa nuk mund të sigurojë fitore dhe të ecë shpejt përpara pa Partinë. Atëherë të dyja së toku bashkë-punojnë ngushtë me njëra-tjetrën.

Klasa punëtore, kur sheh se Partia i ka mufatur aparatet, i tërheq vëmendjen, i tregon se këtu është duke bërë gabim, e njofton se nuk ka ç'i duhen këto aparate, prandaj t'i spastrojë, t'i lehtësojë, për arsye se gjithë këta njerëz në to hanë mbi kurrizin e klasës që prodhon. Dhe kontrolli punëtor, pasi e studion gjendjen, jep mendimin se aty ku janë, fjala vjen, 22 nëpunës, mjafton të mbeten për punë, pa e penguar fare këtë, vetëm 5, nga të cilët 2 mund të jenë komunistë dhe 3 të paorganizuar në Parti. Këtyre ajo u kërkon ta bëjnë mirë detyrën, njëkohësisht klasa merr vetë përsipër që pas pak kohe të bëjë përsëri një kontroll

në atë vend, çka do të thotë t'i mësojë e t'i udhëzojë këta si të punojnë dhe po të jetë se bëjnë gabime, edhe t'i ndëshkojë. Dhe të jetë e qartë se kur flet klasa, nuk flet burokratizmi, përkundrazi, kur s'flet klasa, burokratizmi ngre krye.

Kontrolli i klasës shpie në vend direktivën e Partisë, siguron zbatimin e drejtë të saj. Përpara këtij kontrolli bëhen copë e thërrime justifikimet, pretekstet pa vend të disave që e kanë në majë të gjuhës të mos venë nga qendra në rrethe, nga qyteti në fshat, se u prishet shtëpia, se kanë djalin apo vajzën në shkollë etj., etj. Po populli? Po Partia? Po puna? Këto prirje mikroborgjeze do t'i vërë si duhet në shenjë kontrolli punëtor, që më duket është marrë ca si lehtë dhe organizohet me të meta në praktikë.

Ne duhet t'i japim pushtetin që i takon klasës punëtore. Kështu na mëson Partia. Kush është te ne në pushtet? Është klasa punëtore. Prandaj Lenini na mëson që të sjellim në pushtet sa më shumë elementë të klasës punëtore, me parti dhe të paorganizuar në parti. Edhe kjo është një formë e kontrollit punëtor. Ky kontroll ka lindur nga nevojat, nga lufta për zbatimin e vijës së Partisë. Kur s'ecin punët, fjala vjen në tregti, përse duhet të dënojmë vetëm një shitëse të thjeshtë? Po drejtori që kemi atje në krye, çfarë bën? Sa organizon, sa kontrollon dhe sa ndihmon ai vartësit e tij që t'i kryejnë mirë detyrat? Apo është ndonjë nga ata që, kur vete kontrolli punëtor, thotë: «Si urdhëroni, shokë punëtorë, keni të drejtë për kritikën që na bëni». Jo, nuk mjafton me kaq. Nuk mjafton që ai të pranojë me fjalë ato që i thonë punëtorët, por edhe të veprojë

pikërisht si i thonë ata, që i shikojnë shumë mirë të metat e dobësitë, që janë vigjilentë dhe të papajtuëshëm me të metat, me qëndrimet burokratike. Kontrollit punëtor ky drejtor t'i thotë «të faleminderit shumë», të zbatojë porositë që i jep ai dhe të mos lejohet më që pas kontrollit të venë të kontrollojnë edhe një herë zyrtarët, të cilët t'i zbutin gjërat ose t'i rregullojnë midis tyre vetëm me ndonjë vërejtje me shënim në kartën e regjistrimit. Përkundrazi, duhet vënë në vend çdo gjë që, kur të vejë përsëri kontrolli punëtor në tregti, të mos gjejë më të njëjtën situatë, çdo e metë të jetë zhdukur, gjendja të jetë përmirësuar. Ndryshe punëtorët duhet të venë në Parti e të kërkojnë të pushohet nga puna një drejtor i tillë, për arsye se është shkaktar që nuk po merren masa për të forcuar situatën në sektorin e vet ose të dënohet me vërejtje, të transferohet etj. Fjala e punëtorëve duhet të vejë në vend brenda një afati sa më të shkurtër, sepse është kontrolli i klasës, ndryshe s'ka kontroll të klasës, po vetëm fjalë.

Dhënien e llogarisë përpara masave të popullit duhet ta kemi parasysh vazhdimisht. Unë ju fola për kontrollin punëtor si shkon te ne, por le të shohim tani ç'na thotë Lenini dhe të bëjmë ashtu si na mëson ai. Lenini thotë:

«Të organizohen rregullisht jo vetëm mbledhje të përgjithshme për masat e punëtorëve e të fshatarëve, por edhe mbledhje, ku kuadrot me përgjegjësi të japin llogari për punën e tyre përpara masave të punëtorëve dhe fshata-

rëve. Të tilla mbledhje duhet të organizohen medoemos jo më rrallë se një herë në muaj, në mënyrë që masës pa parti të punëtorëve dhe fshatarëve t'i krijohet mundësia të kritikojnë organet sovjetike dhe punën e tyre. Llogari duhet të japin jo vetëm komunistët, po gjithë kuadrot, në të gjitha vendet me përgjegjësi, në radhë të parë ata të organeve të tregtisë dhe të ekonomisë popullore»¹.

Por a veprojmë ne si porosit Lenini? Jo, s'veprojmë plotësisht kështu! Përkundrazi, «që të mos humbasim kohë», kemi krijuar disa forma pune, duke menduar se është më mirë me to dhe puna bëhet. Kështu mbledhjen e përgjithshme të kooperativës e kemi katandisur kokoshi një thellë dhe kënaqemi se në vend të saj kemi përfaqësinë dhe mbledhjen e kryesisë. Por s'duhet të harrojmë se përfaqësia mund të bjerë në rrugë të gabuar, të jetë dakord me kryetarin, psc në të mund të caktohen disa herë njerëz që i vijnë atij ose sekretarit të Partisë fare lehtë pas qejfit, mund të ketë ndërmjet tyre tri-katër veta nga të sektorit që bien në familjaritet me ata të udhëheqjes etj. Prandaj është më mirë të jepet llogari përpara gjithë masës kooperativiste dhe ta mësojmë këtë, — si na porosit Lenini, — që të hapë gojën. Çdo gjë që bën udhëheqja, ta gjykojë masa nëse është e drejtë apo jo dhe përpara saj të përgjigjet.

Me disa forma që ekzistojnë, krijohen shtigje që përgjegjësi ta rregullojë punën, bile ndonjëri me men-

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 20, Bot. rus, 1932, f. 329.

djelehtësi kujton se mund ta rregullojë edhe me sekretarin e parë të rrethit. Kjo bën të domosdoshme që nga çdo komunist, qoftë ky përgjegjës i furnizimit, shitës, punonjës i shërbimeve komunale apo çfarëdo tjetër, të kërkohet që të japë llogari për punën, ta zëmë një herë në muaj, përpara masës së popullit. Këtu t'i krijohet masës mundësia të japë mendimin si i shërbejnë, si e furnizojnë, si sillen, ç'mendon për njërin, ç'mendon për tjetrin, t'i gjykojë përgjegjësit kur kanë fajë deri edhe atje sa të mbahen apo të mos mbahen më në punë dhe t'u japë drunë, kur vazhdojnë të bëjnë gabime dhe të mos ndreqen. Kur ndonjë punonjës ose drejtues bën një gabim në marrëdhëniet me popullin, të kritikohet dhe të paralajmërohet të mos e përsëritë më atë. Në rast se një gjë e tillë praktikohet periodikisht, kur të vijë herën tjetër të raportojë përpara masës se ç'përmirësime ka bërë, të shohësh ti se si do të jetë bërë «lule». Prandaj kryetari i kooperativës, drejtori i komunales apo çdo punonjës tjetër përgjegjës, ta rregullojmë që të vijnë të raportojnë herë pas here përpara masave të interesuara direkt për punën e tyre, t'u flasin atyre e t'u raportojnë si kanë punuar, se pas atyre do të flasin edhe ato për secilin. Kur të bëhet kjo në mënyrë periodike, në rast se do të konstatohet se gabimet nuk janë ndrequr nga ndonjë, populli ka të drejtë t'i thotë: «Të këshillova një herë, dy, prandaj tani putu me Milon». Kushdo qoftë, po ta dijë se do të vejë pas një muaji të japë prapë llogari përpara masës, do ta mbledhë veten, do të përpiqet të punojë më mirë. Atëherë mund të themi se kontrolli i klasës punëtore bëhet efektivisht dhe sjell rezultate.

Ka raste kur për disa gjëra, edhe pse i bëjmë merrë, nga disa gjejmë belanë. Këtu u fol se si vendosi vetë populli për caktimin e bursave. Kur veprohet këshu, çdo gjë zgjidhet drejt dhe askush s'ka ç'të thotë gjë. Megjithatë del ndonjë i pakënaqur që edhe në të tilla raste thotë: «bëhen hatëre». Ai kujton se Partia nuk e di si është vepruar, prandaj mendon ta hedhë një gur një herë, se mos përfitojë gjëkafshë në rrugë jo të drejtë, pse demokraci është sipas tij, pa edhe po s'i doli. nuk humbet gjë. Këto forma si keni punuar ju për bursat janë demokratike, prandaj forma të tilla të gjenden sa të jetë e mundur për çdo problem e të mos vendosin vetëm aparatet administrative, ta zëmë shefi i seksionit të tregtisë, pse këtij mund t'i bëjë lajka ai që është i interesuar për të fshehur të palarat që t'ia mbyllë gojën. mund t'i dërgojë fundi edhe ca domate në shtëpi nga prodhimet e para, edhe ca pjeshkë apo ndonjë shportë rrush, kështu shefi, në rast se ia pranon, nuk ka si të mos e përkrahë dhe t'ia fshehë të palarat këtij njeriu. Kurse para popullit nuk mund të veprohet kështu, populli s'do të dijë nga këto gjëra dhe kur shoh se nuk veprohet drejt, të heq veshin.

Po për çështjen e kuadrit ç'ka thënë Partia? Partia ka porositur që për çdo njeri që emërohet, të pyetet masa. Në qoftë se del nevoja të emërohet një drejtor, më parë t'i drejtohem kolektivit e t'i themi: «E doni ju, shokë, këtë drejtor?». Edhe tani ka raste që bëhet një pyetje e tillë, po shumë herë formale, sepse në të vërtetë mendimi i kolektivit «merret parasysht» në fund. Më parë i merret mendimi personit nëse është dakord me lëvizjen, vendoset nga organi që e ka

në nomenklaturë, pastaj i komunikohet përfundimisht kuadrit dhe fare në fund, kur ka mbaruar çdo gjë, shkojmë bisedojmë me punëtorët nëse e duan apo jo këtë njeri për drejtor. Mirëpo nuk duhet vepruar kë-shtu, vendimi duhet marrë pasi të jenë pyetur më parë punëtorët, pasi t'u jetë marrë atyre pëlqimi për kandidatin, të nxiten që të ngrihen e të thonë fjalën përpara të gjithëve mbi të tëra ç'dinë, të japin deri edhe mendimin nëse duhet apo s'duhet të jetë drejtor ky kandidat. Me një fjalë, gjatë kësaj mbledhjeje të bëhen debate, të rrihen mendime. Kur shihet se shumica dërrmuese ka dhënë mendimin për këtë njeri, atëherë vendoset me votim. Kjo mënyrë e zgjedhjes dhe e vendosjes së kuadrit është më demokratike. Dhe vetëm pas kësaj pune ta shqyrtojë propozimin, në bazë të karakteristikës që i paraqitet, organi që e ka në nomenklaturë, por në këtë karakteristikë të pasqyrohen për kandidatin të gjitha ato që kanë thënë punëtorët. Fjalët e tyre nuk duhet t'i marrë era si tani, që në karakteristikë shënohet ç'thotë zyrtari, shefi i kuadrit. Kjo praktikë duhet ndryshuar. Njeriun e njohin më mirë ata që punojnë e jetojnë me të ditë e natë. Sado i zoti që të jetë nëpunësi i kuadrit, nuk mund ta njohë çdo njeri nga zyra.

Mund të dalë ndonjë e të thotë: «Po dale, ore shokë, se nuk bëhen kështu këto gjëra. Kemi rregulla këtu apo jo?». Po, l'i përgjigjemi këtij, kemi rregulla, po këto që themi janë rregullat më të mira, janë më revolucionare, më të drejta, më demokratike dhe aspak burokratike. Prandaj, kur diskutohet për emërimin e një kuadri në kolektiv, sekretari i organizatës-bazë, që

është i pranishëm, duhet absolutisht t'i shkruajë Partisë çfarë u tha për të, të mos i fshehë asgjë komitetit, me qëllim që karakteristika të pasqyrojë realitetin dhe vendimi që merret të jetë i drejtë, objektiv.

Edhe kur vjen çështja për të zgjedhur një këshilltar, duhen rrahur mendimet në masë për atë që propozohet. Në këtë rast ka të drejtë të ngrihet kushdo e të propozojë kandidatin që i duket i përshtatshëm, duke ia numëruar para të gjithëve anët e mira dhe anët e dobëta. Pas tij mund të ngrihet një tjetër që plotëson kuadrin e cilësive, po vë në dukje edhe disa të meta të të propozuarit që nuk i përmendi fare i pari, duke theksuar se këto nuk përbëjnë ndonjë pengesë që ky njeri të mos zgjidhet, por që të dihen dhe ai t'i përmirësojë. Një i tretë gjykon se një kandidat tjetër i duket më i mirë se ky që u diskutua e kështu me radhë. Pasi mbledhja diskuton gjerësisht se kush duhet të zgjidhet, kandidaturat votohen.

Kjo është një procedurë e rregullt dhe demokratike, nga e cila kemi fitim të madh, pse kështu shoshiten njerëzit, nuk lejohet që në udhëheqje të vijë ndonjë që s'e meriton. Meqenëse çdo qytetar i vendit tonë ka të drejtën e fjalës, mund të ndodhë që dikush të propozojë edhe një element jo të pastër. Në këtë rast, cilido, komunist qoftë ose patriot i paorganizuar në Parti, kur e njeh të propozuarin, e ka për detyrë të ngrihet e të sqarojë mbledhjen kush është ai, të tregojë njollat e tij në jetë, se vetë personalisht i propozuari nuk është njeri i ndershëm etj., prandaj u bën thirrje pjesëmarrësve të mos pranohet kandidatura e tij për ta zgjedhur këshilltar, ndërsa atij që bëri pro-

pozimin i drejton një kritikë të rreptë për faktin se nuk është në rregull që përpiqet të sjellë në këshill një njeri të tillë. Kjo është luftë klase, luftë që nuk lejon të përfitojnë nga demokracia jonë e vërtetë ata që nuk janë në rregull, luftë për të mbrojtur vazhdimisht interesat e lartë të popullit e të Partisë.

Demokracinë, si në Parti ashtu dhe jashtë saj, ta kuptojmë drejt. Në radhë të parë duhet kuptuar se mbi të gjitha është e nevojshme të luftohet për t'i bindur njerëzit politikisht. Bindja politike nuk lind vetvetiu, nga qielli, ajo është një proces i tërë, formohet me një punë të pareshtur politike me njerëzit në vijën e drejtë të Partisë, arrihet duke u shpjeguar atyre çdo gjë me durim, me urtësi, me sjellje të mira, me dashamirësi në mënyrë marksiste, një herë, dy herë, tri herë, pastaj kur tjetri s'do të marrë vesh, edhe me rreptësi. Po rreptësinë më të madhe ta përdorim kundër armikut të klasës. Çështja e bindjeve politike ka lidhje të ngushtë me demokracinë. Në qoftë se kërkojmë me të vërtetë demokraci, të bëjmë përpjekje që t'i bindim njerëzit politikisht, ndryshe do të përdorësh drunë, gjë që Partia nuk e lejon, pse ajo ndjek rrugën e bindjes së njerëzve, rrugën e demokracisë.

Ka ndonjë që në këtë drejtim përpiqet të spekulojë në demokracinë tonë të vërtetë dhe mundohet të përfitojë prej saj për interesa të ngushtë ose për të plotësuar kapriçot e tij personale. Ndodh që ndonjëri, megjithëse është punëtor, më shkruan mua «për të marrë masa kundër brigadierit të repartit, pse kur ky kishte shkuar një ditë në punë, nuk i paska thënë mirëmëngjesi dhe për këtë i bëri një fletërrufe». Ky s'kë-

naqet me kaq, po më ankohet mua se nuk janë marrë masa kundër brigadierit. Kuptohet që ky njeri s'është fare në të. Edhe në rast se brigadieri s'e përshëndeti, ç'u prish fundi i fundit? Brigadieri kushedi ku mund ta ketë pasur mendjen në atë kohë, prandaj si mund ta ndëshkojmë ne njeriun tonë për një gjë kaq të vogël? Mirëpo ja që ka në radhët tona njerëz si ky, me mbeturina të theksuara mikroborgjeze, që e kalojnë kufirin. Një njeri si ky do të hakmerret, në vend që t'i drejtohet brigadierit si shok, t'i kërkojë me dashamirësi arsyet përse nuk i foli, të sqarohet me të, të zhdukë çdo pakënaqësi dhe të forcojë miqësinë. Ai s'lë gjë pa bërë derisa më drejtohet edhe mua me letër. Kjo do të thotë, shokë, të abuzosh me format e drejta demokratike të rendit tonë shoqëror.

Në këtë drejtim shumë të vëmendshëm duhet të jemi edhe në mbrojtje të ligjshmërisë sonë, e cila është një ligjshmëri e drejtë marksiste-leniniste. Por edhe kjo, natyrisht, duhet të kuptohet e të zbatohet mirë. Në vendin tonë ligjshmëria është vënë në rrugë të drejtë, ligjet tona janë në interes të popullit dhe përpunohen me pjesëmarrjen e popullit. Gjatë luftës që bëjmë për zbatimin e ligjeve tona ne përpiqemi t'i edukojmë njerëzit, t'i ruajmë ata nga gabimet, nga të këqijat e së kaluarës, nga mbeturinat e vjetra.

Megjithëkëtë në vendin tonë vëmë re se kryhen një sërë krimesh, sidomos në dëm të pasurisë socialiste. Prandaj në këtë drejtim duhet bërë një punë e madhe ideopolitike nga ana e Partisë, nga ana e rinisë, nga ana e prindërve etj. Të kemi kujdes veçanërisht për të rinjtë, sidomos në qytetet e mëdha, ku na

ngjasin disa fenomene të papëlqyera, siç janë vjedhjet nëpër xhepa etj., ndërsa në fshat është më ndryshe. Sidoqoftë, kudo duhet të bëjmë përpjekje që të rrënjosim sidomos në rininë tonë një disiplinë të ndërgjegjshme, pa lejuar në asnjë rast liberalizmin dhe anarkinë, të cilat duhet t'i luftojmë.

Këto që përmenda kështu duhet t'i bëjmë, por, siç thashë, aparatet s'duhet të pengojnë, por të ndihmojnë. Të luftojmë ata njerëz në aparate që krijojnë burokraci, që nuk lejojnë popullin të flasë lirisht, të bëjë kritika kundër atyre që gabojnë e kryejnë faje.

Burokratizmi pengon e deformon edhe informacionin e vërtetë. Edhe në Komitetin Qendror nuk na vijin shpesh ato informacione reale për të cilat ka nevojë udhëheqja. Për çfarë informacioni kemi ne nevojë të na vijë në qendër? Mos vallë ana burokratike e formale e çështjes, që s'të thotë gjë? Jo, ne s'e duam as burokracinë, as formalizmin, përkundrazi ato i luftojmë, po e keqja është se as komitetit të Partisë nuk i vijin kurdoherë nga poshtë ato probleme që shqetësojnë organizatat-bazë.

Komiteti i Partisë ka nevojë dhe është shumë i interesuar të dijë se si reagon, për shembull, organizata e Partisë e kooperativës së Shoshajt për këtë apo atë problem, si lufton brenda, ka apo s'ka diskutime, ka kritikë dhe autokritikë apo jo etj. Kur shqyrtohet një problem, njëri atje është dakord për një çështje, tjetri mund të mos jetë dakord etj., njëri bën vërejtjen pse u bë kështu, sepse do të ishte më mirë të veprohej sipas një rruge më të leverdishme, dikush thotë pse u bë ashtu etj., etj. Nga gjithë ky debat komitetit të

Partisë të rrethit ç'i vete? Ai shpesh informohet vetëm formalisht se «u bë mbledhja e organizatës së Partisë të Shoshajt në kohën e parashikuar, u morën në shqyrtim ky dhe ai problem dhe u arrit në këto rezultate: një, dy, tre, pesë», por asgjë s'i thuhet si u zhvillua mbledhja, ç'mendime e pikëpamje dolën etj. Jo, shokë. Komitetit të Partisë, mendoj unë, do t'i interesonte më shumë të dijë si u zhvilluan konkretisht diskutimet në këtë mbledhje të organizatës së Shoshajt për problemin që u shqyrtua, ku njëri ngriti këtë çështje, tjetri kritikoi filanin, për arsye se nuk ka vepruar kështu ose ashtu, pastaj u ngritën dy të tjerë që e kundërshtuan atë dhe i tërhoqën vëmendjen se nuk u nis nga pozita të drejta partie në kritikën që bëri, përkundrazi, atë që kritikoi duhet ta kishte kritikuar për këtë problem dhe jo për atë, të cilit i vuri theksin. Nga një informacion i tillë mbi zhvillimin e mbledhjes, komiteti i Partisë do të shohë se kjo është me të vërtetë një organizatë luftarake partie, e gjallë, ku nuk ka qetësi, dhe krijon bindjen se, duke qenë kështu, duke u rrahur problemet drejt, punët aty do të shkojnë mirë. Komiteti do të jetë i informuar si luftojnë e reagojnë komunistët atje, sa të zotë dhe energjikë janë, si e kuptojnë marksizëm-leninizmin, demokracinë, kritikën etj.

Kjo është, shokë, e tërë lufta e Partisë sonë për mbrojtjen e vijës së saj të drejtë dhe në këtë luftë të zhvilluar gjatë veprimtarisë së saj duhet të bazohet organizata edhe kur vjen koha të bëhen zgjedhjet në Parti. Nga kjo luftë duhet të dalë edhe kush duhet të jetë sekretar i ardhshëm i organizatës në zgjedhjet e

reja, kur tjetri që ka qenë deri tani s'e ka kryer mirë detyrën, që ky duhet të jetë kryetar dhe jo ai etj., etj. Këto janë disa gjëra të rëndësishme të jetës së brendshme të Partisë, që kanë rëndësi jetike edhe për udhëheqjen, të cilën e gjallëron baza. Duke vepruar në këtë mënyrë ju, shokë të bazës, gjallëroni kështu udhëheqjen. Pikërisht këto anë të jetës së brendshme të organizatës është e domosdoshme t'i vihen udhëheqjes në dukje, se për to ka nevojë ajo dhe jo për anën formale.

Mirëpo ç'ndodh? Shumë kanë frikë të informojnë udhëheqjen për këto aspekte të rëndësishme të jetës së brendshme të organizatave të Partisë, se mos ajo -shqetësohet- dhe thotë ç'po na ngjet kështu në Shoshaj. Jo, shokë, duke u informuar komiteti i Partisë për atë që thashë, ai do të ndihmohet dhe do të kuptojë se asgjëkafshë shqetësuese nuk ngjet në Shoshaj, përkundrazi, atje zhvillohet një jetë partie shumë e gjallë, plot rrahje mendimesh, ku komunistët më së iundi marrin vendime dhe i zbatojnë ato në unitet, si një trup i vetëm, pavarësisht se gjatë diskutimeve janë hedhur në shesh gjithfarë mendimesh. Kjo është normale, përkundrazi, të veprhet ndryshe nuk është normale, nuk është në rrugën marksiste-leniniste të Partisë. Në qoftë se konstatohet që në Shoshaj nuk ka përpjekje mendimesh, në qoftë se atje për një kohë të gjatë vihet re një qetësi false, atëherë komiteti i Partisë i rrethit duhet të shqetësohet me të vërtetë, të mendojë seriozisht përse ndodh kështu e të arrijë në konkluzionin se gjendja atje nuk është në rregull, prandaj t'i kushtojë vëmendjen për ta ndihmuar e për ta gjallëruar këtë organizatë. Kurse disa shokë men-

dojnë ndryshe dhe thonë: derisa ka qetësi, kjo tregon se ka unitet, pra gjendja atje është normale. Jo, shokë, në organizatat e Partisë gjendja është në rregull vetëm kur ka rrahje mendimesh, kur ka kritikë e autokritikë nga pozita të drejta partie, kur hidhen mendime për punën, bëhen propozime, sugjerime etj., me një fjalë kur jeta atje zien, jo kur ka «qetësi».

Po duhet ta kuptojmë drejt, çfarë të ziejë? Çdo gjë le të ziejë brenda organizatës. Edhe po të dalë ndonjë që të kundërshtojë vijën e Partisë, le ta kundërshtojë, le t'i hedhë pikëpamjet e tij përpara komunistëve. Kjo është më mirë për Partinë, pse do të dijë me kë ka të bëjë. Atë që ka njeriu në kokë, është më mirë ta thotë, sesa ta mbajë brenda. Në një rast të tillë, kur nga ndonjëri kundërshtohet vija e Partisë, do t'i vërsulen të tjerët që janë të vendosur ta mbrojnë këtë vijë dhe do ta sqarojnë ose do t'i tregojnë vendin. Kjo varet nga rasti konkret. Prandaj lufta në Parti është jetike. Këtë të mos e harrojmë, shokë, se ka rëndësi të jashtëzakonshme.

Përse i them këto? I them pse Partinë duhet ta bëjmë kurdoherë e më luftarake, jo të fjetur, jo të bindur pas disa personave, por të bindur në direktivat e përgjithshme të saj, të bindur në teorinë e marksizëm-leninizmit, të cilat t'i kuptojë, t'i asimilojë dhe të luftojë deri në vdekje për zbatimin e tyre në jetë, pse janë themeli i Partisë. Kjo do të thotë që Partia duhet të jetë luftarake, mbasi, po të mos jetë e tillë, mund të na ndodhin ngjarje të këqija, deri atje sa ajo të vihet përballë klasës.

Shikoni lidhur me këtë ç'thotë Stalini:

«Si i bëhet hallit në qoftë se vetë partia fillon me një mënyrë ose me një tjetër ta vërë veten përballë klasës, duke shkelur bazat e marrëdhënieve të drejta me klasën, duke shkelur bazat e «besimit reciprok»?

A janë të mundshme përgjithësisht të tilla raste?

Po, janë të mundshme.

Ato janë të mundshme:

1) Kur partia fillon ta mbështetë autoritetin që ka në masat jo në punën e vet dhe në besimin e masave, por në të drejtat e veta «të pakufizuara».

2) Kur politika e partisë është haptas e gabuar dhe ajo nuk don ta rishikojë e ta ndreqë gabimin e vet.

3) Kur politika e partisë është e drejtë në përgjithësi, por masat akoma s'janë gati për ta përvetësuar atë dhe partia nuk don ose nuk di ta presë, për t'u dhënë kështu masave mundësinë që të binden nga vetë eksperiencia e tyre për drejtësinë e politikës së partisë, dhe përpiqet t'ua imponojë atë masave»¹.

Më lejoni t'i bëj tani një koment të vogël këtij citati. Partia ka të drejta, por nuk ka të drejta të pakufizuara për çdo gjë, ajo nuk mund të bëjë si të dojë.

1. J. V. Stalin. Veprat. vëll. 3. f. 48-49.

Partia ka të drejtë të bëjë atë që do populli, që do klasa, atë që e lejojnë ligjet, që pranon vija e saj marksiste-leniniste. Jashtë këtyre ajo s'ka të drejtë të veprtojë. Po i kapërceu këto caqe, atëherë Partia, komunistët, hyjnë në rrugë të gabuar.

Partia Bolshevike, sa ishte gjallë Lenini, nuk ra në gabime. Në kohën që në krye të Komitetit Qendror ishte Stalini, disa gjëra u shtrembëruan nga burokratët, por parimet themelore të vijës së përgjithshme të partisë nuk u prekën. Ato u shkelën pas vdekjes së tij, kur udhëheqja e partisë dhe pushteti u uzurpuan nga revizionistët hrushovianë.

Ndryshe është zhvilluar situata te ne. Partia jonë ka qenë kurdoherë prudente dhe e drejtë në rrugën e saj. Megjithatë njerëz të veçantë bëjnë gabime, po këto s'janë të Partisë, të vijës së saj.

Kështu, për shembull, në një kooperativë të bashkuar bujqësore të Tiranës sekretari i organizatës-bazë të Partisë jep urdhër për të bërë kontroll pa përjashtim në të gjitha shtëpitë e fshatarëve, për të gjetur se kush kishte vjedhur një sasi ullinjsh të kooperativës. Kush ia jep këtë të drejtë këtij sekretari, që urdhëron të bëhet kontroll shtëpi më shtëpi? Asnjëri! Ky veprim është një fyerje e madhe që i bëhet popullit, duke spekuluar me emrin e Partisë. Në bazë të ligjeve të shtetit tonë asnjëri s'mund të hyjë në shtëpinë e tjetrit pa lejen e tij. Kontrollin në shtëpinë e tjetërkujt, jashtë rregullave të caktuara, nuk e lejon as Partia, as ligji. Për të hyrë në shtëpinë e një qytetari të drejtën të japë autorizimin e ka vetëm prokurori, po edhe ky duhet të mendohet mirë, para se të bëhet

kontroll, të ketë fakte se është vjedhur ose është bërë krim dhe vetëm atëherë i jep urdhër policisë që të futet për kontroll. Kurse disa shokë komunistë, pa u thelluar fare, duke u nisur nga mendimi i gabuar se «Partia mund të bëjë çdo gjë», kontrollojnë të gjitha shtëpitë e fshatit, pse një a dy persona na paskan vjedhur disa kilogram ullinj! Të lejosh veprime të tilla të gabuara, arbitrare, të nisura nga pikëpamja e shtrembër se «Partia mund të bëjë çdo gjë», kjo të çon në rrugën që thotë Stalini, kur partia përpiqet të mbështetë autoritetin e saj jo në punën e vet, jo në besimin e masave, por në të drejtat e saj «të pakufizuara».

Duhet ta kemi mirë të qartë se ka një kufi edhe në të drejtat e Partisë. Partia jonë, duke qenë në fuqi, ka bërë ligje, ka vendosur rregulla, të cilat askush nuk i shkel dot. Po i shkeli vetë Partia, ky është një gabim i rëndë, pse krijon një situatë të atillë që të mbështetë mbi autoritetin e saj «të pakufizuar», pa baza në popull. Vënia e popullit kundër Partisë është një rrugë e gabuar. Prandaj, shkelje të tilla Partia jonë s'i ka lejuar dhe nuk do t'i lejojë kurrë, ajo do të marrë masa të rrepta kundër të gjithë atyre që i bëjnë, cilëtdo qofshin ata.

Një kooperativist më shkruan një letër nga Elbasani, përmbajtja e së cilës është me të vërtetë shumë e hidhur, jashtëzakonisht e hidhur. Midis të tjerash, ai kërkon të dijë se deri kur do të gabojë organizata e Partisë në kooperativën e Shirgjanit, e cila ka dhënë urdhër që bagëtitë e oborreve të shiten ose të theren? Çuditet letërshkruesi se si është e mundur të bëhet

një gjë e tillë. Në fillim, sikur s'na besohej as neve të ishte dhënë një urdhër i tillë, prandaj dërguam njerëz në vend për verifikim. Ç'doli nga kontrolli? Doli që ky urdhër ishte dhënë nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit, nga burokratët e seksionit të bujqësisë. Kur u pyetën atje këta «myteberë» pse është dhënë ky urdhër në këtë kooperativë, u përgjigjën se qe menduar që në të ardhmen ajo do të bëhej kooperativë e tipit të lartë, prandaj bagëtitë e oborrit, sipas mendjes së tyre të çoroditur, duhet të thereshin ose të shiteshin. Për këtë veprim, në kundërshtim të hapët me vijën e Partisë, këtij kooperativisti i kishte ardhur në majë të hundës dhe më shkroi mua letër. Por, në bazë të këtij urdhri ndodhi që nga oborret e anëtarëve, që përpara kishin pasur mbi 2 400 kokë bagëti të imëta, deri në kohën që u bë verifikimi, qenë shitur mbi 800 krerë. Kur populli e kuptoi se ky ishte një urdhër i padrejtë, u ngrit dhe i kërkoi llogari komitetit ekzekutiv që kishte vendosur në kundërshtim me vijën e Partisë. Drejt e kishte populli.

Urdhra të tillë, që jepen në emër të Partisë, por që në fakt i kundërvihen vijës së saj, janë armiqësorë. Prandaj, a mund t'i lejojmë ne këta njerëz të bëjnë gjëra të tilla të shëmtuara? Jo, kurrë nuk mund t'i lejojmë, ndryshe vëmë Partinë kundër masës. Prandaj, kush vepron kundër direktivave të Partisë, kundër masës, ai duhet dërguar pa hezitim në popull, t'i thotë se këtë gabim s'e ka bërë Partia, por e kemi bërë ne, burokratët, të kërkojë falje dhe t'i lutet t'i japë një strehë për të futur kokën, një rreckë për të fjetur, punë në arë dhe po të këtë kooperativa qumësht e mish,

le të hajë edhe ai, po të mos ketë, le të rrijë të presë derisa të prodhohet.

Del pyetja: Nga lindin këta urdhra dhe direktiva të padrejta? Këto i lind burokratizmi, prandaj që të mos ndodhin gjëra të tilla, duhet luftuar me ashpërsi kundër burokratizmit dhe burokratëve që i bëjnë këto gabime në emër të Partisë. Njerëz të tillë dëmtojnë interesat e popullit, dëmtojnë vijën e Partisë, aq sa e bëjnë njeriun e popullit të shtrojë pyetjen se deri kur do të gabojë Partia. Jo, shokë, s'ka bërë gabim Partia, në asnjë mënyrë ajo nuk ka thënë që bagëtitë e oborreve të shiten as kur kooperativat të bëhen të tipit të lartë.

Është dhënë një direktivë që të shkurtohet numri i dhive, por edhe kjo duhet bërë me mend në kokë. Dhitë do t'i shkurtojmë vetëm për arsye se na dëmtojnë pyjet dhe na japin të ardhura të pakta, megjithatë, derisa ato të mos jenë zëvendësuar me kafshë më prodhuese, pakësimi i tyre të mos bëhet, ky pakësim duhet të bëhet gradualisht me kujdes, që të mos mbeten kalamanët pa ushqim. Kështu do të veprohet edhe me dhentë, megjithëse, siç dihet, asnjëherë nuk do të shkojmë drejt zhdukjes së tyre, pse edhe një sasi bagëtitish të imëta, sidomos dele, ne do t'i mbajmë edhe në të ardhmen, për të përballuar nevojat që kemi e do të kemi vazhdimisht, sidomos për lesh, por edhe për mish, pastaj edhe për arsye se kjo kafshë e dobishme shfrytëzon një pjesë ushqimesh që nuk konsumohen nga bagëtitë e tjera dhe i kthen ato në të mira materiale.

Ja, kështu këshillon Partia të bëhet. Atëherë, për-

se të kuptohen shtrembër direktivat e saj? Në qoftë se vete në bazë një instruktor dhe e shpjegon keq direktivën, komunisti t'i thotë: «S'jam dakord me këtë që më thua ti, pse unë direktivën e Partisë e kam të qartë. Unë kam statutin, i cili më lejon si anëtar i një kooperative malore të mbaj në oborrin tim 1 lopë dhe 10 dele, kurse ti vjen e më thua t'i ther ato, prandaj atë s'e zbatoj!». Po t'i bëhet ndonjë ndryshim statutit, kjo nuk do të ngjasë pa marrë më parë mendimin e kooperativistëve të malësisë së Matit dhe të gjithë Shqipërisë. Në të tilla raste Partia, si kurdoherë, do të marrë mendimin e masës. Kur të gjykohet se ka ardhur koha për të zvogëluar më tej numrin e bagëtive, do të pyetet patjetër fshatarësia kooperativiste. Në qoftë se kjo do të thotë se koha s'ka ardhur akoma, se kooperativa ende s'është në gjendje t'i furnizojë anëtarët rregullisht me qumësht, asnjë zvogëlim nuk mund të bëhet.

Partia nuk mund të vejë kundër dëshirës së popullit. Kur vija e saj e drejtë s'kuptohet mirë, zbatimi i saj nuk duhet imponuar. Partia duhet të vazhdojë të sqarojë masat me durim, të mos ngutet, të mos vihet kundër popullit.

Stalini për këtë na mëson:

«Edhe partia më e madhe mund të zihet në befasi, edhe partia më e madhe mund të mbarojë, në qoftë se ajo nuk nxjerr mësim nga historia, në qoftë se ajo nuk farkëton përditë e më shumë gatishmërinë luftarake të klasës së saj. Të zihesh në befasi është një gjë

tepër e rrezikshme, shokë. Të zihesh në befasi, do të thotë të biesh viktimë e «të papriturave», viktimë e panikut përballë armikut. Mirëpo paniku shpie në shpartallim, në disfatë, në greminë»¹.

Këto mësimë të Stalinit duhet t'i kemi kurdoherë parasysh në punën tonë të Partisë. Mund të ngjasë që partia të vihet kundër klasës dhe të kapet në befasi. Kjo mund të ndodhë jo vetëm në një parti të madhe, por edhe në një parti të vogël. Mundësia e katastrofës që kishte parashikuar Stalini edhe për një parti të madhe, kur ajo zihet në befasi, nuk nxjerr mësimë nga historia etj., u vërtetua për fat të keq në Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së tij. Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit nuk ishte në gatishmëri luftarake. Kjo gatishmëri, sipas mendimit të Partisë sonë, sigurohet kur u kushtojmë rëndësi edhe disa gjërave që mund të duken të vogla. Në këtë drejtim ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë. Kur Partia e humbet gatishmërinë luftarake në një moment të caktuar, ajo zihet në befasi nga armiku i klasës. Kështu doli në Bashkimin Sovjetik revizionizmi modern, që përfaqësonte elementin burokrat, të korrumpuar, armik të marksizëm-leninizmit, të normave revolucionare leniniste të partisë, që ishte futur brenda në parti e qëndronte atje si gërthëla.

Ekspierencën historike që na mëson Stalini ta kemi parasysh, le ta shohim atë te Partia Bolshevike, e cila

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 11, f. 68.

u gjend e çarmatosur përpara revizionizmit modern, pikërisht pse ajo në punën e saj neglizhoi të mbështetjet në masat. Stalini kishte parashikuar ç'mund të pësojë një parti, e cila nën presionin e aparateve të burokratizuara mbështetet më shumë në të drejtat e saj «të pakufizuara». Kjo shkarje mos mendoni se ndodhi përnjëherë. Jo! Këtu ka një proces të tërë, një proces regresiv; ku, nën mbulesën e autoritetit të madh të saj, normat revolucionare të partisë deformohen, burokratizohen e sklerozohen, ashtu si ndodh me enët e gjakut të pleqve, të cilëve përveç që skleroza u shkakton perturbacione të rënda, mund t'u sjellë papritur edhe damblla. Tragjedia që ndodhi në Bashkimin Sovjetik vërteton se Partia Bolshevike brehej si molla, që nga jashtë duket e kuqe, ndërsa brenda i ka hyrë krimbi dhe s'e ka të gjatë. «Krimbi» që hëngri nga brenda Partinë Bolshevike ishte burokratizmi, skleroza, shkelja e normave leniniste, të mbuluara të gjitha këto me emrin dhe autoritetin e Partisë së madhe të Lenin-Stalinit.

Njerëzit që fillojnë të futen në këtë proces regresiv, degjencruet, përpiqen të shfrytëzojnë për interesat e tyre prestigjin e Partisë, të ngrenë lart me hipokrizi emrin e saj. Po duket ai që e ka me gjithë shpirt, kur përpiqet të ngrejë lart emrin e Partisë, duken ata që me këtë maskë, s'bëjnë tjetër veçse mundohen të fetishizojnë personin e tyre, egon e tyre. Ka aty-këtu edhe nga këta njerëz që janë të ngarkuar me punë partie dhe flasin shumë për Partinë. Përse e bëjnë këtë? E bëjnë për t'i vënë rëndësi personit të vet, ata i bien fort gjoksit, duke treguar se janë «të dërguar të Partisë» dhe lënë të kuptohet se duhet të matesh mirë kur

flet me ta, t'i dëgjosh dhe të bësh si thonë ata! Këto janë qëndrime të këqija, antirevolucionare dhe bëhen nga burokratët. Këta njerëz kanë prirje t'i minimizojnë, në përgjithësi, të metat e gabimet e tyre, t'i bëjnë këto sa më të vogla, mundësisht edhe t'i fshehin, që të mos bëhen çështje. Po nga kush t'i fshehin? Nga ata që luftojnë të mos ndodhin gabime, që përpiqen t'i shohin e t'i denoncojnë, t'i kritikojnë dhe të marrin masa që të ndreqen pa vonesë. Pikërisht nga këta njerëz kanë shumë frikë të tillë burokratë.

Vija e Partisë është vija e klasës punëtore. Ajo pasqyron aspiratat dhe përpjekjet e saj për të realizuar detyrat me luftë e me punë të përbashkët. Në jetë kjo vijë kuptohet edhe më mirë, mbruhet, gatuhet, piqet nga vetë Partia, nga klasa, nga masa. Kush i shkëput këta faktorë nga njëri-tjetri, ai rrëshqet, largohet nga vija. Njerëzit që rrëshqasin kanë prirje pikërisht t'i shkëputin këta faktorë, ata përpiqen t'i fshihen kontrollit të Partisë, normave e rregullave të saj, synojnë të fshihen prapa autoritetit të Partisë, duke u fryrë me mburrje: «Unë» jam autoriteti. Këta njerëz në vend që të reflektojnë përpara vërejtjeve të masës, përpiqen t'i mbulojnë të metat e tyre, të diskutojnë në hava, duke kërkuar të dëgjohen se gjoja paskan të drejtë. Ata për të fshehur gabimet e tyre, për të shmangur kritikën që u drejtohen, mundohen të identifikojnë veten me Partinë për të ruajtur personin e tyre, për t'i shpëtuar kritikës. Kur e shohin keq se do të kritikohen, theksojnë me të madhe se «nuk duhet kritikuar Partia», se «Partia është e pagabueshme» etj.

Ky qëndrim ka një të keqe të madhe, lind frikën

për kritika. Në një fshat të rrethit të Krujës, anëtarët e këshillit popullor shkuan në shtëpinë e një fshatareje dhe i therën dhinë në oborr, duke u mbështetur në faktin se kjo ishte mbi normën që u lejon anëtarëve statuti i kooperativës. E vërteta është se kjo nuk ishte fare anëtare e kooperativës, po në oborrin që i kishte lënë kooperativa mbante më shumë bagëti nga sa kishin të drejtë anëtarët. Veprimi i kësaj fshatareje natyrisht s'ishte aspak i drejtë, por në vend të bindjes «të dërguarit» e Partisë, shkuan me kapadaillëk në shtëpinë e saj, ia morën plakës së shtëpisë dhinë dhe përpara syve të saj e therën, duke i thënë se ky është urdhër i Partisë! E kur ka thënë Partia të veprohet në këtë mënyrë? Asnjëherë! Ky është një gabim i bërë nga disa njerëz të veshur me pushtet, po jo nga Partia. Nga këto veprime arbitrare, sikurse thashë, lind frika për kritikë. Këto veprime e kanë burimin te koncepti jo i drejtë që kanë disa, e që e vë në dukje Stalini, se partia mbështetet në të drejtat e saj «të pakufizuara». Në këtë mënyrë, ndonjëri mund të mendojë: «Derisa Partia ka të drejtë të bëjë çdo gjë, atëherë ç'të kritikoj unë? Partia ka fuqinë në dorë, po të them një fjalë, ajo më bën gjëmën».

Gabimet e disa individëve janë kundër vijës së Partisë. Po të lejohen e të shtohen raste të tilla, shokë, po të lejohen të veprojnë lirisht ata që mendojnë se Partia ka të drejta «të pakufizuara», ngjet ajo që ndodhi në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, fillojnë arbitraritetet, goditjet me vend e pa vend, nën pretekstin se gjoja «mbrojmë partinë», «ruajmë autoritetin» e saj. Në të vërtetë veprimet arbitrare shpjen në

shkëputjen e Partisë nga klasa, nga masa, në çarmatosjen e dobësimin dhe, më së fundi, në likuidimin e saj. Atë që parashikoi Stalini për një parti që zihet në befasi, Partia jonë nuk duhet ta harrojë kurrë, por ta ketë parasysh kurdoherë. Partia jonë është një parti e fortë, një parti që i ruan normat si sytë e ballit, që lufton për to dhe do të luftojë vazhdimisht. Megjithatë, shfaqje negative aty-këtu ekzistojnë, tendenca të ndonjë burokrati apo njeriu të papjekur ekzistojnë dhe pikërisht këto duhet t'i luftojmë në kohë, porsa nxjerrin kokë dhe t'i ndreqim medoemos e sa më shpejt.

Si konkluzion dëshiroj të theksoj që ne të vazhdojmë të ecim pa u lëkundur në rrugën tonë të drejtë marksiste-leniniste, ashtu siç na e përcaktoi Kongresi i 6-të i Partisë, në radhë të parë për konsolidimin e forcimin e mëtejshëm të Partisë. Direktivat e këtij Kongresi t'i studiojmë me kujdes, të thellohem vazhdimisht në to, në punën tonë të përditshme të udhëhijëmi prej tyre dhe prej materialeve të tjera të Partisë, që përbëjnë një thesar të madh eksperience. Këto materiale do të na ndihmojnë të kuptojmë edhe më mirë teorinë leniniste mbi partinë dhe teorinë false «komuniste» të revizionistëve modernë mbi partinë, që s'është gjë tjetër veçse teoria e likuidimit të saj dhe të diktaturës së proletariatit.

Siç e dini, pas tradhtisë së revizionistëve sovjetikë dhe të pasuesve të tyre, lëvizja komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare ka hyrë në një luftë të ashpër për jetë a vdekje me ta. Partia jonë është në ballë të kësaj lufte, të cilën duhet ta çojmë deri në fund, prandaj në vendin tonë ushtri dhe popull është

e domosdoshme të jenë të armatosur me armë, po edhe me artin luftarak. Por, ne, anëtarët e Partisë dhe mbarë populli ynë, krahas armatosjes nga ana ushtarake, të armatosemi në radhë të parë me armën tonë të pathyeshme, me teorinë e marksizëm-leninizmit. Këtë teori do ta gjejmë në klasikët, do ta gjejmë edhe në eksperiencën e gjallë, të gjatë e luftarake të Partisë sonë. Për këtë arsye jeta e gjallë revolucionare e organizatave-bazë, e komiteteve të Partisë të të gjitha hallkave, duhet të konsiderohet një detyrë e rëndësishme, e përhershme, jona. Duke i kushtuar kujdes të dorës së parë përgatitjes ideologjike luftarake të Partisë, duke qenë të qartë dhe të armatosur, ne nuk do të gjendemi kurrë në befasi, përkundrazi, do të jemi kurdoherë në pararojë në vendin e nderit në luftën kundër armiqve të klasës, qofshin këta të brendshëm, ashtu edhe të jashtëm, kundër imperializmit e revizionizmit, deri në fitoren tonë përfundimtare.

Jeta e gjallë dhe luftarake në organizatat-bazë dhe në komitetet e Partisë, lufta e përbashkët revolucionare e zgjedhësve dhe të zgjedhurve, puna e aparateve të Partisë, lufta e përbashkët e tërë Partisë brenda normave revolucionare, demokracisë dhe centralizmit demokratik, të gjitha këto kanë rëndësi jetike dhe duhen zbatuar pa hezitim me luftë, pa asnjë druajtje, pa servilizëm.

Servilizmi është i papajtueshëm me natyrën e komunistit, kudo që ky të punojë, në qendër apo në bazë. Të zgjedhurit janë sjellë në udhëheqje të të gjitha instancave nga zgjedhësit, por që të dyja palët, zgjedhës e të zgjedhur, të bashkëpunojnë e të luftojnë për

zbatimin e vijës së Partisë, pa hezitime, pa servilizëm ndaj njëri-tjetrit. Një bashkëpunim i tillë revolucionar nuk pranon druajtje, servilizëm apo frikë nga ana e cilitdo. Vetëm kështu mbrohet Partia, vija e saj marksiste-leniniste. Një qëndrim i tillë është një grusht i fuqishëm që u jep Partia jonë ideologjive reaksionare, borgjeze, imperialiste, antimarksiste dhe revizioniste.

Normat e Partisë leniniste i luftojnë në mënyrë të stërholluar revizionistët e ngjyrave të ndryshme, synimi i të cilëve është likuidimi i partive të tipit marksist-leninist, me qëllim që të fitojë kapitalizmi e imperializmi dhe të pësojë disfatë klasa punëtore. Revizionistët e sulmojnë me të gjitha mënyrat leninizmin në parimet e ndërtimit të partisë dhe të normave të saj, që e bëjnë atë luftarake, të gjallë, pararojë të klasës punëtore. Bile revizionistët italianë arrijnë deri atje sa të gënjejnë pa pikë turpi, kur thonë se Marks i nuk paska qenë për krijimin e një partie të klasës punëtore, pra, sipas tyre, Lenini i paska shtrembëruar idetë e Marksit. Në këtë mënyrë revizionistët dalin kundër Leninit, por me kujdes, duke e maskuar luftën e tyre antileniniste.

Por faktet tregojnë të kundërtën. Lidhja e Komunistëve që organizuan Marks i dhe Engels i ka qenë një parti e proletariatit. Ata në shumë shkrime të tyre kanë folur në mënyrë të veçantë për nevojën e organizimit të partisë komuniste për të udhëhequr klasën punëtore. Këtë revizionistët nuk mund ta mohojnë, ajo është e qartë si dielli kur lind. Nga ana tjetër, revizionistët thonë se Lenini jo vetëm paska shkarë nga idetë e Marksit, por edhe i ka deformuar ato, duke i lënë

shteg krijimit të burokracisë etj., etj., pikërisht ashtu siç akuzojnë këta edhe Stalinin.

Të gjithë e dimë historikun e Partisë Bolshevike dhe teorinë leniniste për partinë, për parimet e saj, për centralizmin demokratik në parti, për disiplinën dhe të gjitha normat e tjera, pa të cilat nuk mund të ekzistojë një parti e vërtetë marksiste-leniniste, nuk mund të zhvillohet e të udhëhiqet revolucioni dhe proletariati të vendosë diktaturën e vet. Të gjitha këto i ka vërtetuar historia.

Çfarë kërkojnë në analizë të fundit revizionistët e sotëm? Ata kërkojnë dhe propagandojnë disa teori, të cilat Lenini i ka luftuar pa mëshirë në kohën e tij. Sipas tyre, klasa punëtore në Perëndim ka arritur gjoja në një shkallë të lartë zhvillimi, prandaj nuk është e domosdoshme të jetë e inkuadruar, e organizuar, me një disiplinë të fortë. Sipas tyre, vija e partisë, roli i saj udhëheqës, katandiset, në kundërshtim nga sa ka thënë Lenini, në asgjë. Sipas revizionistëve, komitetet e partisë në fabrikat e kapitalistëve mund të luajnë sot njëfarë roli në ngritjen e punëtorëve vetëm për kërkesa ekonomike, por jo edhe për kërkesa politike. Të tilla teori e të tjera si këto i ka dënuar e shpartalluar në kohën e vet Lenini. Prandaj propaganda e revizionistëve modernë dhe e gjithë armiqve të tjerë të socializmit, që drejtohet me kaq egërsi kundër marksizëm-leninizmit, ka për qëllim të largojë nga rruga e revolucionit dhe e socializmit klasën punëtore dhe masat punonjëse të udhëhequra prej saj.

Në vendin tonë, pavarësisht nga të metat në punë, vija e Partisë bazohet në parimet leniniste. Direktivat

e saj ndërtohen, zbatohen, verifikohen nëpërmjet shkrijës parti-klasë, parti-popull, në përputhje me tezat dhe teorinë leniniste mbi partinë. Partia jonë është në zhvillim revolucionar të pandërprerë dhe lufton vazhdimisht për të gjetur forma e metoda të reja, stil çdo ditë më të mirë e më revolucionar. Kjo përbën sigurinë në vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë edhe në të ardhmen.

Duke i hedhur një sy gjendjes ndërkombëtare, shohim se situata zhvillohet vazhdimisht në favor të revolucionit. Imperializmi botëror, me atë amerikan në krye, dhe revizionizmi modern, me atë sovjetik në krye, janë në një krizë të rëndë ideologjike, politike dhe ekonomike, ashtu siç e përcaktoi Partia jonë në Kongresin e saj të 6-të. Analiza që u bëri Kongresi ynë situatave kombëtare dhe ndërkombëtare bazohet në fakte reale, objektive. Popujve të globit tokësor nuk mund t'u fshihet ajo që sot bota kapitaliste po kalon në një krizë të thellë. Imperializmi amerikan dhe ai botëror përpiqen t'i shpëtojnë darës së fortë të kësaj krize që i ka mbërthyer keq e s'po i lëshon, prandaj që ta zgjatin edhe ca jetën, përpiqen të gjejnë aleatë.

Po cilët janë aleatët e tyre? Këta janë revizionistët modernë, gjithë elementët e lëkundshëm që janë kundër revolucionit botëror. Imperializmi në përgjithësi dhe ai amerikan në mënyrë të veçantë, për arsye të krizës së madhe që i ka kapur dhe të përhapjes gjithnjë më të gjerë në masat e popujve të ideve ngadhënjimtare të socializmit, mundohen t'i forcojnë ma-

rrëdhëniet me revizionistët modernë e në mënyrë të veçantë me revizionistët sovjetikë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë duke kaluar tani krizën e dollarit, krizë që ka prekur edhe aleatët e tyre, shtetet e ndryshme kapitaliste. Të tërë këta janë në kontradikta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët mundohen t'u ngarkojnë të tjerëve pasojat e rënda të krizës monetare. Ato kërkojnë që aleatët e tyre, kapitalistët e Azisë me ata të Japonisë në radhë të parë, ata të Evropës, siç janë vendet e «Tregut të Përbashkët» t'i paguajnë imperializmit amerikan humbjet që po pëson ky nga zhvleftësimi i dollarit. Por imperializmi amerikan po gjen kundërshtime në të katër anët, ai ndeshet kudo me rezistencën e vendeve të tjera kapitaliste.

Nga kriza e rëndë monetare po pëson dëme të mëdha tërë ekonomia kapitaliste. Kudo në këto vende ka papunësi, shtrenjtësim të pandërprerë të jetesës, ka një hutim të madh të përgjithshëm. Të gjitha këto tregojnë se shoqëria kapitaliste botërore është në kalbëzim të vazhdueshëm, siç e shohim në vendet fqinjë, si në Itali, në Jugosllavi me regjimin e saj të degjeneruar etj., etj. Është krijuar një gjendje e vështirë dhe pasigurie në botë, se kapitalistët kanë frikë dhe nuk dinë ku t'i investojnë kapitalet, nga të katër anët ata përpiqen të gjejnë tregje. Kjo i detyron të lënë aleatët e mëparshëm dhe të përpiqen për të krijuar e për të forcuar aleanca të reja, me një fjalë gjithkush mundohet të gjejë rrugëdalje për të forcuar pozitën e veta ekonomike. Në këtë luftë çdo vend kapitalist kërkon të sundojë sa më gjerë jo vetëm ekono-

mikisht, por, në radhë të parë, edhe politikisht e ushtarakisht.

Në këto koniunktura, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë gjetur aleatët e tyre të revizionistëve modernë sovjetikë. Kjo aleancë nga viti në vit ka ardhur duke u zgjeruar, pavarësisht se ndërmjet tyre ekzistojnë kontradikta, të cilat shkaktohen, në radhë të parë, nga luftërat revolucionare që po zgjerohen, nga veprimtaria revolucionare e klasës punëtore dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve. Aleanca sovjetiko-amerikane pikërisht këtë synon, të godasë, të dobësojë dhe të shuajë këto lëvizje. Midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Revizionist Sovjetik ka interesa që përputhen. Këta konsistojnë në luftën që synojnë dhe bëjnë të dyja palët kundër popujve. Në këtë drejtim të dyja palët ecin në të njëjtën rrugë. Megjithatë, sikurse thashë, ndërmjet tyre ekzistojnë edhe kontradikta, ka interesa të kundërt, pse si shtete imperialiste që janë, duke vepruar njëri si socialimperialist, tjetri si imperialist grabitqar, secili përpiqet t'ia hedhë tjetrit.

Kontradiktat që ekzistojnë në gjirin e imperialistëve e të revizionistëve modernë, për shkak të forcës dhe të rezistencës së popujve, Partia e Punës e Shqipërisë përpiqet t'i shfrytëzojë në favor të revolucionit dhe të socializmit. Ajo mendon se nuk duhen bërë lëshime as ndaj imperialistëve, as ndaj revizionistëve, se është e domosdoshme të luftohet me konsekuencë në të dy krahët. Partia jonë ka luftuar vazhdimisht në të dy këto drejtime, bile edhe në momente shumë më pak të favorshme se sot dhe kurdoherë ka fituar.

Nga një analizë reale që i ka bërë gjendjes ndër-kombëtare, Partia jonë nxjerr konkluzionin se pozitat e imperialistëve dhe të revizionistëve modernë vijnë duke u dobësuar. Këtej lind nevoja e intensifikimit të vazhdueshëm të luftës revolucionare në të dy drejtimet duke mos i bërë asnjë lëshim asnjërës palë. Kontradiktat që ekzistojnë ndërmjet imperialistëve me njëri-tjetrin, ndërmjet imperialistëve dhe revizionistëve sovjetikë dhe ndërmjet vetë revizionistëve, janë të pamohueshme, prandaj si marksistë, pa bërë lëshime në parime, ne duhet t'i shfrytëzojmë e t'i thellojmë ato dhe të nxjerrim përfitime në favor të revolucionit e të socializmit.

Mund të thotë dikush: Mund të arrihet në ndonjë rezultat për ne pa bërë lëshime? Po, mund të arrihet. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare kanë prova të pakundërshueshme që e vërtetojnë këtë pohim realist. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Republika Popullore e Shqipërisë, që kur lindën, kanë deklaruar se me popullin grek jemi vëllezër, prandaj dëshirojmë të rrojmë në paqe me të. Në armiqësi të plotë ne jemi me monarko-fashistët, sepse ata janë armiq të popullit grek dhe të popullit tonë. Atyre prej kohësh ua kemi bërë të qartë dhe në mënyrë të prerë që të hiqnin dorë një herë e mirë nga pretendimi i tyre absurd për «Vorio-Epirin», të hiqnin dorë nga absurditeti tjetër, sipas të cilit ishin «në gjendje lufte me Shqipërinë», sikur gjoja e paskemi sulmuar edhe ne Greqinë, kur ajo u sulmua nga Italia fashiste.

Kjo histori me monarko-fashistët grekë vazhdoi

e vazhdon me vite të tëra. Por populli shqiptar qëndroi e qëndron i patundur. Vëllezërit tanë të pandarë, minoritarët grekë në Shqipëri, qëndruan gjithashtu të patundur dhe në unitet të plotë me popullin shqiptar, me pushtetin e tij popullor dhe me Partinë. Kur na vritnin monarko-fashistët njerëzit tanë në kufi, edhe ne u vritnim të tyre, kur propagandonte radioja e tyre e Silogut voriocpirot kundër Shqipërisë, përgjigjej prerë edhe radioja jonë, kur monarko-fashistët sulmonin kundër nesh në kufi, ne u përgjigjeshim duke u mbrojtur dhe i hidhnim përtej kufirit. Megjithatë, gjatë gjithë kësaj periudhe, ne u kemi bërë shpeshherë thirrje monarko-fashistëve që të hiqnin dorë nga provokacionet dhe nga pretendimet e tyre pa baza e në të njëjtën kohë u propozonim se ishim gati të lidhnim edhe marrëdhënie, pse dëshironim të rronim në fqinjësi të mirë me njëri-tjetrin, po ata na përgjigjeshin se nuk donin të kishin marrëdhënie me Shqipërinë. Edhe ne u përgjigjeshim: «Ne rrojmë edhe pa ju, por në qoftë se do të na prekni kufijtë, ta keni të qartë ç'ju pret, lufta jonë s'do të njohë kufi!».

Dhe cili ishte përfundimi i gjithë këtij qëndrimi të tyre? Qenë ata vetë, më së fundi, që na bënë propozimin për të lidhur marrëdhënie diplomatike. Kjo natyrisht duhet t'i japë fund edhe pretendimit të tyre pa baza për gjendjen e luftës me vendin tonë. Ne i njoftuam qeveritarët e Athinës se nuk kishim kundërshtim për propozimin e tyre, përkundrazi, kemi qenë kurdoherë për marrëdhënie normale. Këto, më së fundi, u vendosën: të dyja palët shkëmbyem ambasada-

dorë, po asnjë lëshim nuk u bëmë monarko-fashistëve grekë, pavarësisht se qemë të rrethuar e «në gjendje lufte» me ta. Po të donin, pavarësisht pastaj se si do të vente puna për ta dhe cili do të ishte fundi i luftës, monarko-fashistët mund edhe të na sulmonin, po ata s'e ndienin veten të sigurt, e dinin forcën e popullit dhe të Partisë sonë.

Nga pala greke na u tha se ato që fliste propaganda greke përpara lidhjes së marrëdhënieve diplomatike qenë pa baza, se në të vërtetë ata nuk mund të ishin në gjendje lufte me Shqipërinë. Dhe ne u shprehëm grekëve se «gëzohemi» që keni arritur në «arsyetime realiste». Në fakt udhëheqësit e sotëm të Greqisë po tregohen më realistë nga paraardhësit e tyre. Me këto që përmenda doja të përforcoja atë që thashë se Qeveria Shqiptare nuk u ka bërë monarko-fashistëve grekë asnjë lëshim.

Ambasadori i Greqisë që ka ardhur në vendin tonë shikon me çudi ç'ndodh në Shqipëri, ç'ndryshime të mëdha janë bërë këtu. Po të dëshirojë ky ambasador le të urdhërojë të vejë në Gjirokastër, s'e ndalon njeri, bile edhe në Dropull, ku të bisedojë me popullin, po atje do të shikojë si flasin minoritarët. Ai do të konstatojë vetë sa të lidhur ngushtë janë minoritarët grekë me atdheun e tyre, Shqipërinë socialiste, me këtë pushtet për të cilin kanë luftuar e kanë derdhur gjak edhe vetë, me popullin vëlla shqiptar dhe me Partinë që i çliroi nga çdo lloj shfrytëzimi. Gjithë këtë realitet le ta krahasojë pastaj ai me gjendjen e fshatrave të Greqisë që ndodhen në kufi me vendin tonë. Minoritarët grekë në Shqipëri gëzojnë të gjitha

të drejtat barabar si gjithë shtetasit e tjerë të republikës. Vëllezërit tanë minoritarë e kanë parë vetë se, kur fshatrat e tjera të vendit tonë nuk kishin akoma dritë elektrike, pushteti popullor ua dha atyre më parë, ashtu si dhe ujët e pijshëm që ua siguroi menjëherë pas Çlirimit etj., etj.

Tani edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë vënë të tjerë të na nxitin që të kërkojmë lidhjen e marrëdhënieve diplomatike me ta. Kush të lidhë marrëdhënie me ta, Shqipëria? Në vitin 1946 pushteti ynë popullor u kërkoi të dërguarve të qeverisë amerikane të largoheshin nga vendi ynë, pasi ata donin të lidhnin marrëdhënie diplomatike me vendin tonë, me kusht që ne të njohim të gjitha traktatet e vjetra skllavëruese që kishin nënshkruar përpara me ta qeveritë antipopullore shqiptare. Po të duan mund të na propozojnë Shtetet e Bashkuara të lidhim marrëdhënie diplomatike, po vetëm mbi bazat që ua kemi bërë të qarta që atëherë, pa njohjen e asnjërit prej traktateve të vjetra që kanë pasë lidhur regjimet e vjetra të vendit tonë me ta, sepse asnjë prej tyre nuk njohim ne. Ne u kërkojmë atyre të mohojnë një herë ato, pastaj shohim e bëjmë. Dhe në qoftë se nuk lidhim marrëdhënie me ta, kjo neve nuk na prish asnjë punë, përkundrazi, ne rrojmë edhe pa lidhje diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që e heqin veten si përfaqësuesit e «demokracisë» dhe të «botës së lirë», ambasadorin tonë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara nuk e lejojnë të udhëtojë më tepër se 25 milje rreth selisë së kësaj organizate, ai, pra, nuk vete dot as në Nju-Jork.

Por, kur vijnë për të vizituar Shqipërinë vëllezërit tanë të mërguar prej kohësh, që mbajnë nënshtetësinë amerikane dhe shëtitin me pasaportë amerikane, ne i lejojmë, prandaj prapë superiorë jemi mbi amerikanët.

Edhe Anglia, kjo dhëlpër e vjetër imperialiste, e njohur nga të gjithë për politikën e saj dinake, kërkon, gjithashtu, të lidhë marrëdhënie diplomatike me vendin tonë. Mirëpo Anglia, le të dërgojë më parë në Bankën e Shtetit Shqiptar floririn që na ka rrëmbyer, pastaj shikojmë e bëjmë për çështjen e marrëdhënieve diplomatike. Në qoftë se nuk dëshiron të veprojë kështu, kurrë mos dashtë, neve nuk na priset puna, bëjmë fare mirë, siç kemi bërë edhe pa Anglinë. Shqipëria ka me vete simpatinë e gjithë popujve të botës.

Kështu i gjykojmë ne marrëdhëniet me shtetet e tjera, qofshin edhe më të mëdha, në këto situata...

Le të marrim çështjen e «sigurimit evropian». Për këtë problem ne kemi qëndrimin tonë të pandryshuar që kur ka lindur dielli, ndërsa të tjerët, flas për vendet revizioniste e kapitaliste, ecin me dallgë, lëkunden. Fjalën e kam këtu që shumë qeveri lëkunden, një herë thonë do të vemi në konferencën e «sigurimit evropian», një herë thonë nuk do të vemi, kurse Shqipëria, duke e pasur të qartë ç'është «sigurimi evropian», e ka thënë prej kohësh fjalën e saj, e ka argumentuar përse nuk merr pjesë dhe nuk lëviz nga pozita e saj e drejtë. Përfaqësues të vendeve kapitaliste u thonë ambasadorëve tanë: «Duam të dimë si e keni punën që nuk doni të merrni pjesë në këtë mbledhje, se politika juaj është referencë për ne». Shihni, pra, ata i referohen politikës sonë. Për këtë unë asgjë nuk

shtoj, pse është tekstualisht siç e thonë të huajt. Dhe shokët tanë, që kemi në përfaqësitë jashtë shtetit, ua shpjegojnë arsyet e qëndrimeve tona, aq sa disa nga ata pastaj thonë: «Sikur nuk e keni keq ju shqiptarët, prandaj duhet ta shikojmë edhe ne pozicionin tonë ndaj kësaj çështjeje».

Për sa u përket vendeve revizioniste, Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve të tij, është e qartë se asnjë unitet nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë ndërmjet tyre. Partia jonë, për shembull, në bazë të teorisë marksiste-leniniste, ka parashikuar drejt se në gjirin e revizionistëve nuk mund të ekzistojë unitet pikëpamjesh, se nuk ka e nuk do të ketë kurrë unitet në radhët e tyre, përkundrazi, do të ketë kurdoherë kundërshtime të mëdha, të cilat do të vijnë duke u thelluar vazhdimisht. Dhe në fakt, kontradiktat janë thelluar jo vetëm ndërmjet Rumanisë dhe Bashkimit Sovjetik, por edhe ndërmjet këtij dhe Polonisë, Hungarisë, Republikës Demokratike Gjermane etj. Lidhjet midis këtyre vendeve i mban vetëm doktrina e Brezhnjevit, i mban Traktati i Varshavës, i mbajnë marrëveshjet ekonomike që kanë lidhur këto vende me Bashkimin Sovjetik. të cilat në disa sektorë e drejtime kapitale varen gati krejtësisht nga ekonomia sovjetike. Shtetet e tjera revizioniste, duke qenë sate-lite të Bashkimit Sovjetik, duan t'i shpëtojnë në njëfarë mënyre darës së Moskës. prandaj përpiqen të bëjnë tregti edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose me vendet kapitaliste të Perëndimit. Për shembull, Rumania deri tani ka marrë vetëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Republika Federale e

Gjermanisë rreth 2,5 miliard dollarë, pra, është shitur kokë e këmbë tek ata. Është e tepërt të flasim pastaj për Jugosllavinë, të cilën e ka marrë lumi fare, pse Titoja e ka shitur me kohë dhe e ka kthyer në një arenë investimesh për kapitalin e huaj, e ka kthyer në një vend kapitalist anarkik.

Imperialistët amerikanë, imperializmi gjerman e të tjerë bëjnë investime kapitale në vendet revizioniste, por deri në njëfarë shkalle, pasi nuk duan të acarojnë situatën me sovjetikët, ata i ruhen ndonjë provokacioni që t'i nxitë revizionistët e Kremlinit të shkojnë deri atje, siç bënë, për shembull, katër vjet më parë në Çekoslovakia. Fuqitë imperialiste nuk duan të hyjnë në një konflikt të armatosur me Bashkimin Sovjetik, prandaj kur japin kredi dhe investojnë në vendet e tjera revizioniste, këtë e bëjnë me masë.

Sidoqoftë, kontradiktat ndërmjet vendeve revizioniste nuk mund të shuhen, ato do të vijnë vazhdimisht duke u rritur, njëlloj siç ndodh edhe ndërmjet vendeve kapitaliste. Ku janë më të mëdha këto kontradikta? Këto kanë ekzistuar dhe ekzistojnë më shumë ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Rumanisë, por udhëheqësit rumunë, siç e dimë nga ndjekja e situatës, nuk janë njerëz të fortë e të qëndrueshëm. Kurdoherë që kemi parë se i kanë kundërshtuar sovjetikët, duke i njohur, ne nuk kemi pasur besim në rezistencën e tyre. Edhe tani rumunët vazhdojnë të rezistojnë deri diku, por rezistenca e tyre pak a shumë është neutralizuar. Kjo vjen ose ngaqë ata duhet të kenë rënë në disa ujdi me Bashkimin Sovjetik, ose për shkak të organizimit të kompleteve të fshehta,

që mund të jenë kurdisur kundër udhëheqësve rumunë nga ana e revizionistëve të Moskës etj. Konkretisht nuk dimë gjë, dimë vetëm atë që «trimëria» e rumunëve është neutralizuar ca.

Ndryshe qëndrojnë hungarezët. Këta janë më dinamikë, nuk tregohen shumë «trima» si rumunët, punojnë nën rrogos për t'u shkëputur nga sovjetikët. Mirëpo plagët i kanë akoma të freskëta, pse tanket sovjetike ua kanë hipur një herë në kurriz, prandaj Kadari përpiqet të tërhiqet pa gjak nga aleanca me revizionistët sovjetikë, siç thoshte Koço Tashkoja gjatë kohës së Luftës Nacionalçlirimtare për qëndrimin që duhej mbajtur ndaj armiqve. Mirëpo, kur Koços iu mblodh në Labinot dhe iu tha se revolucioni s'bëhet pa gjak, atëherë ai tha: «Ë po mirë atëherë, me pak gjak». Kështu mendon të veprojë edhe Kadari, të tërhiqet «pa gjak» ose «me pak gjak». Këtë qëndrim nuk mund të mos e vënë re sovjetikët, prandaj i vijnë rrotull. Kohët e fundit bile ata «e ftuan» në Moskë, ku, më duket, «i lanë kokën», me një fjalë ia mblodhën rripat. Kështu të paktën flasin agjencitë e huaja të lajmeve. Sidoqoftë, Kadari përpiqet të krijojë kuadrot e tij në vend, pastaj të përgatitet për shkëputje nga Bashkimi Sovjetik. Ai punon për të krijuar në Hungari një situatë të kundërt me atë të Bashkimit Sovjetik, ku aktualisht ka vështirësi të mëdha ekonomike, ndërsa revizionistët sovjetikë, siç thonë, përpiqen të mos ketë në vendin e tyre ndonjë ndryshim të madh në krahasim me vendet e tjera revizioniste, të mos bjerë në sy diferenca ndërmjet tyre.

Në Gjermaninë Lindore, siç dihet, sovjetikët e

eliminuan Ulbrihtin dhe grupin e tij, që i kundërsh-tonin, dhe sollën në fuqi një grup tjetër, me Honekerin në krye, i cili paraqitet prosovjetik. Megjithatë, edhe atje vazhdon të ketë kontradikta, mbasi zgjidhja e çështjes gjermane ka mbetur pezull. Nënshkrimi i traktateve nga sovjetikët dhe nga polakët me Gjermaninë Perëndimore ka mbetur, gjithashtu, varur, pse kjo e fundit, përderisa iu dha gishti, kërkon të gllabërojë edhe dorën. Sovjetikët, nga ana e tyre, janë të kënaqur vetëm me nënshkrimin e këtyre traktateve nga Gjermania Federale, po kjo pretendon më shumë, synon që të rrëzohet muri. Mirëpo në qoftë se bie muri, mbaroi Gjermania Lindore, bashkimi i të dy shteteve gjermane do të bëhet kështu fare pa traktat, pa çak, pa bam. Me këtë plekset edhe çështja e traktatit të «sigurimit evropian», që sovjetikët duan aq shumë të përfundojnë sa më shpejt. Ky traktat, thonë ata, duhet firmosur, por kapitalistët e Perëndimit kërkojnë për këtë si kompensim avantazhe të tjera të reja. E tillë është natyra e kapitalizmit, e tillë është edhe ajo e revizionizmit!

Në Jugosllavi, siç e keni dëgjuar, ekziston një anarki e madhe. Titoja është gjendur në një situatë shumë të vështirë, jashtëzakonisht të vështirë. Në Kroaci u shkel shumë gazi. Megjithëse Tripalloya me shokë, në udhëheqje të kësaj republike, ishin njerëz të Titos, ata ranë në kontradikta me të, duke kujtuar se kishte ardhur koha të shkonin më tutje nga vetadmi-nistrimi, të shkëputeshin fare nga Federata, Kroacia të veçohej.

Natyrisht, ky ishte një rrezik i madh për Titon,

për sistemin e tij të vetadministrimit, prandaj ai mori masa dhe e likuidoi udhëheqjen kroate. Duke ndjekur këtë zgjidhje, se nuk kishte si bënte ndryshe, Titoja u detyrua të nxirrte në shesh të gjitha ndyrësitë që ekzistonin në të ashtuquajturën parti të tij. Në rast se dëshironi të dini cilat janë këto ndyrësi, merrni materialet e Partisë sonë, i rikëndoni dhe do t'ju kujtohen. Në to do të shikoni sesi Partia jonë nuk ka gabuar asnjë presje.

Titoja u detyrua të pohojë me gojën e vet se partia e tij nuk është më parti punëtorë, se dyert e saj kanë qenë të hapura për largimin e punëtorëve, por të mbyllura për t'u futur ata në radhët e saj. Kjo tregon qartë se brenda në Partinë e Titos është rrasur borgjezia. Partia jonë, — vazhdon Titoja, — nuk ka asgjë në dorë, ajo nuk është më proletare, ajo është e mbushur me elementë intelektualë, që mendojnë vetëm për veten e tyre, për të bërë vila, për të blerë automobila, për të ndërtuar hotele; në parti janë grumbulluar gënjeshtarët, hajdutët e ç'nuk thotë tjetër. Ai pranon se një njeri fundja mund të ketë tri shtëpi, po jo një vapor të tërë. Pastaj justifikohet se këto dobësi i ka vënë në dukje në këtë ose në atë vit, po nuk e paskan dëgjuar. Po ne, vazhdon ai, nuk duhet të jemi si Stalini. Titoja, si kurdoherë, si armik i pandreqshëm i socializmit që është, nuk mund të mos jetë e të shprehet edhe në këtë rast kundër Stalinit, pavarësisht se lllomotit për një parti të klasës, për një parti të fortë, me disiplinë, me centralizëm demokratik etj.

Për ne, situata në Jugosllavi është e qartë. Partia

jonë e ka parashikuar drejt zhvillimin e ngjarjeve në këtë vend, me të cilin kemi marrëdhënie diplomatike, tregtare etj. në rrugë shtetërore, po kurrë marrëdhënie partie. Asnjë zotim nuk marrim ne për hir të këtyre marrëdhënieve, prandaj as dorën lidhim, as gojën mbyllim kundër titistëve. Kur i kritikojmë, titistëve s'u vjen mirë, po nuk na priset puna, bile kritikata, siç e dini, atyre ua themi haptazi. Mos vallë duan ata që ne të pushojmë polemikën kundër tyre? Jo, ne nuk e pushojmë kurrë polemikën në adresë të revizionistëve jugosllavë, ashtu sikundër nuk do ta pushojmë edhe kundër gjithë tradhtarëve të tjerë revizionistë, ne jemi e do të jemi në luftë të vazhdueshme tërë jetën me ta. Për këtë, askush të mos ketë më të voglin iluzion.

Cili do të jetë qëndrimi ynë, në rast se Jugosllavia kërcënohet nga ndonjë rrezik i jashtëm? Në një rast të tillë, siç kemi deklaruar, ne do të dalim në mbrojtje të popujve të Jugosllavisë. Ky është një qëndrim i drejtë që nuk krijon asgjë negative për ne. Popujve të Jugosllavisë, bile edhe udhëheqjes jugosllave, u ka ardhur mirë nga deklarata jonë. Natyrisht, ne jemi që Federata Jugosllave të ekzistojë, pse është edhe në interesin e mbrojtjes së vendit tonë. Po të mos, ekzistojë kjo Federatë, atëherë në Jugosllavi do të ketë ndikime të shumta nga ana e imperialistëve të ndryshëm, Jugosllavia do të bëhet copa-copa, atje do të ndërhyjnë sovjetikët, po kështu anglezët, amerikanët, gjermanët e të tjerë. Në një eventualitet të tillë, rreziku në drejtim të vendit tonë do të shtohet. Prandaj për ne është më mirë të ekzistojë Jugosllavia si

Federatë, sepse dimë që kemi të bëjmë me titistët. Edhe popujt e Jugosllavisë, pavarësisht nga degjenerimi i madh që ekziston në vendin e tyre, luftojnë që Federata të mos shkatërrohet.

E tillë është me pak fjalë situata ndërkombëtare.

Më falni, shokë, se ju mora shumë kohë. Ju uroj suksese në punë dhe dëshiroj të përsëris edhe një herë e t'ju them sinqerisht që diskutimet tuaja në këtë mbledhje të plenumit të Komitetit të Partisë më lanë përshtypje shumë të mira për organizatën e Partisë në rreth. Në diskutimet dhe në qëndrimet e shokëve unë pashë një optimizëm real, fytyra të çelura, vendosmëri, pashë se ju jeni armatosur mirë me direktivat e Partisë, të cilat duhet t'i zbatojmë me besnikëri të madhe. Kam bindjen e plotë, dhe këtë do t'ua referoj shokëve të Komitetit Qendror kur të kthehem, që planin pesëvjeçar dhe veçanërisht planin e vitit 1972, populli i rrethit të Matit, me organizatën e Partisë në krye, do ta realizojë me sukses. Për këtë, juve, anëtarëve të plenumit, ju bie detyrë të jeni në pararojë, ashtu siç thashë, bashkë me gjithë komunistët, të jeni në ballë të luftës, kurdoherë tok me popullin. Me popullin të silleni kurdoherë mirë, të jeni të hapur, të sinqertë, të ushqeni për të dashuri e besnikëri të madhe, sepse aq më shumë do të na dojë dhe do të kuptojë se vija e Partisë është vija e tij, prandaj do të mobilizohet për ta zbatuar atë gjer në fund. Këto mësimë të Partisë sonë janë shpëtimtare për gjithë vendin tonë. Si kudo në Shqipëri, edhe këtu në Mat, ne kemi një popull shumë të mirë, shumë patriot, prandaj Komiteti Qendror i Partisë dhe Byroja

Politike kanë bindjen se ju do t'i realizoni planin dhe të gjitha detyrat që ju ka caktuar Kongresi i 6-të i Partisë.

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë me
shkurtime në broshurën:
«Socializmin e ndërtojnë
masat, Partia i bën këto
të ndërgjegjshme»,
Tiranë, 1972*

*Botohet me ndonjë shkurtim
sipas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

NË PUNËN PËR EDUKIMIN IDEOPOLITIK TË NJERËZVE NUK KA VEND PËR VETËKËNAQËSI

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit
Popullor të RPSH¹*

10 mars 1972

Nga përgjigjet e pyetjeve që dhanë në këtë mbledhje të Presidiumit shokët Aranit Çela² dhe Dhori Panariti³, si dhe nga shpjegimet që bënë ata për disa çështje, vihet re prirja për ta zbutur ca situatën që paraqitet aktualisht në lidhje me dinamikën e krimeve. Që të luftohet më me efikasitet kundër shfaqjeve të kriminalitetit dhe shkaqeve që kanë sjellë si pasojë kryerjen e krimeve, është e domosdoshme të shikohet situata realisht, me sy kritik dhe të preokupohe mi fort për përmirësimin e saj.

Siç rezulton nga materiali në të cilin specifikohen

1. Në këtë mbledhje u diskutua për gjendjen e kriminalitetit gjatë vitit 1971.

2. Kryetar i Gjykatës së Lartë të RPSH.

3. Në atë kohë Prokuror i Përgjithshëm i RPSH.

llojet e krimeve dhe njerëzit që i kanë kryer ato, të ndarë sipas grup-moshave, seksit, arsimit etj., është fakt se edhe te ne bëhen vjedhje, dëmtime dhe shpërdorime të pasurisë socialiste dhe të pasurisë së qytetarëve, kryhen dhe lloje të tjera krimesh. Kjo situatë duhet të na shqetësojë, sepse, siç dihet, të gjitha krimet paraqitin rrezikshmëri shoqërore.

Nga tërësia e krimeve që janë kryer prej personash të ndryshëm, sipas mendimit tim, aktualisht, duhet të na tërheqin vëmendjen më shumë ato kundër pasurisë shtetërore e shoqërore. Në këtë drejtim del se puna politike që bëhet me njerëzit nuk është në lartësinë e duhur, prandaj vjedhësve dhe dëmtuesve të tjerë të pasurisë socialiste nuk u është krijuar kudo e kurdoherë një atmosferë e padurueshme, ata nuk janë vënë gjithmonë, siç kërkon Partia, para një presioni të fortë moralo-politik për t'i detyruar të heqin dorë nga veprimtaria e tyre shoqërisht e rrezikshme. Me sa duket, këto vitet e fundit, në punën e organizatave të masave për edukimin e njerëzve ka një rënie, sepse këto shfaqje të shëmtuara nuk po bëhen probleme të popullit me atë forcë që ngriheshin më parë. Kam përshtypjen që, disa herë, është arritur në konkluzionin e gabuar se, meqë kemi kaq suksese në zhvillimin e ekonomisë, dëmtimet nga vjedhjet janë «të vogla» dhe «të parëndësishme». Veprimtaria keqbërëse nuk duhet të nënvleftësohet me sukseset tona të mëdha në fushën ekonomike, politike, shoqërore dhe kulturore, pse në këtë veprimtari pasqyrohet tërësia e veçorive psikike e morale që përbëjnë individualitetin e keqbërësit, pra, manifestohet karakteri

i tij i dobët, për ndreqjen e të cilit shoqëria është thellësisht e interesuar.

Vjedhjet në dëm të pasurisë shtetërore kryhen më tepër në ndërmarrjet ekonomike shtetërore, ku manipulohen vlerat e mëdha materiale, sepse atje, duke nxjerrë kokën fryma e dehjes nga sukseset, ka mungesë kontrolli e vigjilence ndaj veprimeve të njerëzve të pandërgjegjshëm. Në ndërmarrjet bujqësore dhe në stacionet e makinave dhe të traktorëve si, për shembull, në SMT-në e Lushnjës, ka pakujdesi të theksuara në këto drejtime, ajo është e mbushur me vegla bujqësore të prishura e të lëna andej-këtej pa kujdes. Kjo situatë ndodh në një kohë kur në një kooperativë bujqësore të rrethit të Matit, që është krijuar në vitin 1966 dhe ka 750 hektarë tokë dhe së cilës i kërkojnë të marrë 35 kuintalë grurë për hektar, i kanë lënë vetëm një traktor për të punuar tokat. Në Lushnjë, ku ne, shteti i diktaturës së proletariatit, kemi investuar miliarda lekë për të mekanizuar sa më shumë bujqësinë, përdoren vlera të mëdha materiale, megjithatë mbahet një qëndrim shumë i pakujdesshëm, nuk ushtrohet kontroll dhe ka mungesë vigjilence. Kjo gjendje serioze duhet të na preokupojë të gjithë. Përse nuk janë mirëmbajtur e nuk janë riparuar makinat bujqësore në këtë rreth, por janë lënë mënjanë si të prishura? Pse nuk i kanë çuar në gjyq të gjithë personat fajtorë për dëmtimin e kësaj pasurie të shtetit? Po të dërgoheshin në gjyq edhe personat që kryejnë faje të tilla, numri i të dënuarve, shoku Aranit dhe shoku Dhori, do të ngjitej më shumë, prandaj në nxjerrjen e konkluzioneve t'i shikojmë edhe

këto anë të problemit e jo të kapemi vetëm pas personave të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Pa mohuar rrezikshmëritë e ndryshme që paraqitin në vetvete personat që vjedhin në grup të organizuar ose si individë të veçantë, tërë vjedhësit, objektivist, dëmtojnë rëndë pasurinë socialiste, ata në cilëndo formë që të përvetësojnë, në analizë të fundit, prekin pasurinë e vënë me djersën e popullit dhe janë njerëz të komprometuar. E theksoj këtë anë të çështjes që të mos nënvlerësohen vjedhësit e veçantë, duke menduar se meqenëse vjedhësit në grupe të organizuara i kemi më të paktë, përvetësimet nuk përbëjnë ndonjë problem të mpërtë për ne. Ky mendim i gabuar do të ndikonte për keq në luftën parandaluese kundër vjedhjeve nga individë të veçantë, të cilët, po të mos kapen e goditen me kohë, mund të gjejnë njëri-tjetrin e të komprometohen reciprokisht. Kështu, magazinieri i pandërgjegjshëm, për të vjedhur më lehtë, mund të lidhet e të bashkëpunojë me shitësin, pastaj të dy bashkë të lidhen me inventarizuesit e kështu me radhë do të formojnë, si të thuash, një lidhje zinxhir. Si ata që vjedhin të veçuar, ashtu edhe ata që bashkëpunojnë në grup të organizuar, janë vjedhës të pasurisë socialiste, prandaj kjo gjë duhet të na bëjë të vrasim mendjen shumë.

Ne duhet të na shqetësojnë edhe vjedhjet që kryhen në dëm të pasurisë së qytetarëve, të cilat, gjithashtu, janë krime me rrezikshmëri të theksuar. Ka raste që njerëzit druhen se vjedhësi mund t'u hyjë brenda në shtëpi. Ne duhet të na preokupojnë ankesat e qytetarëve.

Vjedhjet, pra, qofshin kundër pasurisë socialiste, qofshin kundër pasurisë së qytetarëve, duhen parë me kujdes e vëmendje të madhe. Të bëhet ç'është e mundur për të pasur sa më pak krime të tilla kaq të ulëta, të punohet në mënyrë që të mos na ndodhin të tilla fenomene të rrezikshme për shoqërinë tonë.

Këtu u bë pyetja se mos krimet e përvetësimit kundër pasurisë kryhen si pasojë e pamundësisë ekonomike të disa njerëzve për të plotësuar disa nevoja të përditshme. Unë mendoj se nuk është ky shkaku i vjedhjeve. Në vendin tonë nuk ka bazë ekonomike dhe politike për vjedhjet. Cilido e gëzon jo me fjalë, por efektivisht, të drejtën e punës. Edhe ata që janë të paaftë, përgjithmonë ose përkohësisht, përfitojnë ndihmë nga fondi i sigurimeve shoqërore shtetërore, u kryhet shërbimi mjekësor falas etj., prandaj shkaku i këtyre krimeve nuk ka përse të shikohet nga kjo pikëpamje. Përse vjedhësi në një autobus e fut dorën në xhep të tjetrit dhe merr prej tij çfarë të gjejë aty: çakmakun, paqetën, paratë etj.? Sepse nuk dëshiron të punojë, mbasi i pëlqen të jetojë si parazit në kurriz të shoqërisë, prandaj, në raste të tilla, duhet të mendojmë për të gjetur shkakun e vërtetë të vjedhjes, si dhe personin që eventualisht mund ta ketë shtytur vjedhësin në krim, sidomos kur ky i fundit është në moshë fare të re, të shikojmë si ka punuar shoqëria për ta edukuar këtë njeri, a e ka dënuar ashpër veprën e tij e të tjera, e të tjera. Këto duhet të na tërheqin vëmendjen më shumë sesa fakti që autori i krimit e kreu veprën shoqërisht të rrezikshme për të blerë një pastë, një biletë sporti, apo ndonjë

send tjetër. I rëndësishëm është akti i kryer dhe masat që duhen marrë për mospërsëritjen e tij, pse ai që sot fut dorën në xhepin e tjetrit, po nuk u edukua seriozisht, nesër mund të thyejë xhamat e dritareve për të grabitur vlera më të mëdha.

Me gjithë punën e madhe revolucionarizuese që është bërë nga Partia, pushteti dhe nga organizatat e masave për edukimin ideopolitik të njeriut të ri dhe me gjithë sukseset që janë arritur në uljen e numrit të krimeve, nuk ka vend për vetëkënaqësi. Neve na del si detyrë me rëndësi të mos i nënvlerësojmë disa shfaqje negative që vihen re në gjirin e shoqërisë sonë, por të bëjmë një luftë akoma më të vendosur kundër vjedhësve dhe dëmtuesve të tjerë të pasurisë socialiste dhe asaj të qytetarëve, të zbulojmë dhe të godasim që në rrënjë burimin e krimeve. Kjo luftë, siç na mëson Partia, duhet të bëhet nga të gjithë së bashku: nga Partia, nga organet shtetërore të të gjitha shkallëve, nga organizatat e masave, nga familja dhe nga gjithë qytetarët. Këto çështje mund të zgjidhen me shumë sukses në qoftë se bëhen, dhe në të vërtetë duhet të bëhen, probleme të të gjithë popullit. Duke luftuar kështu, do të arrijmë në atë që krimet dhe autorët e tyre të mos kenë mundësi të fshihen, por të zbulohen me kohë dhe të goditen sipas ligjit. Këtu duhet të synojmë ne, kjo është detyra jonë, sepse kështu zvogëlojmë në një shkallë të konsiderueshme veprimtarinë e vjedhësve dhe të dëmtuesve të tjerë të pasurisë socialiste. Nuk e zgjidhim plotësisht problemin vetëm duke zbatuar porositë që jepen për të siguruar objektet ekonomike, për të mby-

llur shtëpitë me kujdes etj. Zgjidhjen e plotë ne do ta realizojmë kur të kemi punuar e luftuar vazhdimisht për edukimin e mirë të njerëzve dhe këtë punë do ta bëjnë prindërit dhe mbarë shoqëria qysh kur njeriu është në moshë të mitur.

Nga materiali që paraqit Gjykata e Lartë shikohet se akoma numri i grave që kanë kryer krime është i rritur. Pse ndodh kjo? Unë ngul këmbë në mendimin tim se gratë, përgjithësisht në punë janë më të ndershme e më të ndërgjegjshme se burrat, por ato i komprometojnë njerëzit e këqij, që dinë të bëjnë hile, si, bie fjala, disa magazinierë, furnizues e të tjerë. Gratë nuk bëjnë dredhi në punë, por ato, sidomos në krimet e qëndrimeve të pakujdesshme në detyrë, më shumë bien në gabime për arsye se nuk ndihmohen sa duhet që të kualifikohen nga ana tekniko-profesionale në sektorët ku punojnë. Shpeshherë drejtuesit e qendrave të punës e të prodhimit mjaftohen me një ose dy muaj kurs që organizojnë për gratë dhe i futin menjëherë në punë të ndryshme me përgjegjësi materiale ose në detyra të tjera dhe më tej nuk kujdesohen t'i ndihmojnë ato edhe në punë e sipër. Kështu nuk duhet të veprohet. Gratë në çdo punë që të jenë është e domosdoshme të ndihmohen për t'u kualifikuar, në mënyrë që të mos bien në gabime të rrjedhura nga mungesa e përvojës në punë.

Në qëndrimin që mbahet ndaj pasurisë socialiste në tërësi dhe asaj shtetërore në veçanti duken qartë rutina, burokratizmi, shpeshherë mungesa e disiplinës dhe e kontrollit të shumanshëm e të shumëllojtë, si dhe shumë shfaqje të tjera të kësaj natyre, që sje-

llin pasoja të rënda fort të dëmshme për shoqërinë tonë, siç janë: vjedhjet, shpërdorimet dhe dëmtimet e tjera të pasurisë.

Lenini porositi që gjithë komunistët dhe kuadrot, herë pas here, të japin llogari para popullit. Këto mësimet të Leninit janë shumë aktuale për sot dhe për të ardhmen, jo vetëm për komunistët dhe kuadrot, por edhe për punonjës të tjerë. Veçanërisht duhet të japin llogari para popullit punonjësit e tregtisë, të komunales e të tjerë, që kanë të bëjnë çdo ditë dhe çdo orë me shërbimet ndaj qytetarëve. Këta të dalin para masës jo vetëm një apo dy herë në vit, por gjithmonë, sa herë të jetë e nevojshme. Dhënia e llogarisë të mos kufizohet vetëm në raportet para organeve të kontrollit shtetëror, por të zgjerohet shumë sidomos para masës. Ndonjë punonjës i aparatit shtetëror edhe mund të komprometohet, kurse populli kurrë jo. Drejtori i ndërmarrjes tregtare të rrethit... , për shembull, ishte korruptuar, por jam i bindur se ai nuk do të arrinte në atë faj në rast se dilte për të dhënë llogari herë pas here para popullit dhe sikur ish-sekretari i parë i komitetit të Partisë atje, të ishte vigjilent dhe t'i dënonte këto akte të kundërligjshme të këtij nëpunësi. Po të dalë shitësi për të raportuar para popullit, dhe blerësit t'i provojnë se e kanë parë duke shitur disa mallra nën banak, kurse punonjësin e komunales ta kritikojnë ashpër se disa lloje shërbimesh ua kryen më mirë njerëzve të njohur ose miqve, ata nuk do të guxojnë më të prishin ndërgjegjen dhe t'i përsëritin të tilla faje të dënueshme. Pa të shkojë shitësi në popull një herë për të dhënë llogari deri më

një, sa «t'i duket vrima e miut 500 grosh», siç thotë populli, atëherë do të shohim nëse ka për t'i përsëritur më veprimet e paligjshme! Le ta bëjë populli këtë kontroll, të kërkojë llogari dhe t'i thotë shitësit: «Vepra po deshe dhe një herë tjetër siç ke vepruar gjer tani!». Në qoftë se me gjithë vërejtjet e bëra punonjësi i tregtisë nuk korrigohet, populli t'i thotë kryetarit të komitetit ekzekutiv: «Ky njeri të hiqet nga ajo punë». Po të mos marrë masa kryetari i komitetit, populli t'i thotë edhe atij: «Ne, shoku kryetar, do të ankohe mi në Presidiumin e Kuvendit Popullor që të marrë masa edhe kundër teje që s'ua vë veshin fjalëve tona». Kështu duhet të veprohet në të tilla raste.

Nuk thoshte më kot Lenini i madh se çdo gjë dhe cilido duhet t'i nënshtrohet kontrollit të masave. Është detyra jonë, shokë, që ta kuptojmë drejt popullin, ta nxitim atë të flasë, sepse populli di të flasë shumë mirë dhe nuk gabon kurrë. Prandaj të luftojmë burokratizmin dhe burokratët që çojnë në shkëputjen e lidhjeve të partisë e të shtetit me masat dhe ndrydhin iniciativën e masave, të shtojmë vigjilencën revolucionare, të luftojmë kundër mungesës së kontrollit mbi njerëzit që vjedhin, që shpërdorojnë dhe dëmtojnë pasurinë shtetërore dhe atë të qytetarëve.

Sigurisht të tërë e kuptojmë se shfaqjet antisocialiste të atyre që shkelin ligjet e shtetit nuk janë karakteristikë e shoqërisë në vendin tonë. Në krahasim me të gjitha vendet kapitaliste dhe revizioniste ne dallohem për numrin më të paktë të krimeve. Kjo ndodh pse shoqëria jonë është me të vërtetë socialis-

te, e shëndoshë, që vjen gjithmonë e më shumë duke u forcuar, por Partia na mëson që sado suksese të arrijmë, të mos vihemi në gjumë. Të mos harrojmë për asnjë çast se në shoqërinë tonë vazhdon lufta e klasave, që zhvillohet në forma mjaft të rrepta edhe në fushën e kriminalitetit, të cilin, veç të tjerave, e ushqejnë, nga njëra anë, mbeturinat mikroborgjeze e shumë «njolla» të tjera që trashëgojnë njerëzit nga e kaluara dhe, nga ana tjetër, ndikimet e sotme të ideologjisë borgjeze e revizioniste.

Për të zhvilluar me sukses luftën kundër këtyre shfaqjeve duhet të punojmë politikisht, në rrugë partie dhe shtetërore, në radhë të parë për edukimin e njerëzve me ndjenjën e respektimit të ndërgjegjshëm të normave të moralit dhe të së drejtës sonë socialiste. Shteti ynë i diktaturës së proletariatit, nevojërisht, do të përdorë edhe dhunën kundër asaj pakice njerëzish të shoqërisë sonë që guxon të kryejë akte kriminale, sepse nuk kanë dashur të korrigjohen e të edukohen nga puna politike e Partisë, nga edukata dhe presioni i masave. Kombinimi i drejtë i metodës së bindjes me atë të shtrëngimit shtetëror ka rëndësi të madhe dhe i shërben një qëllimi të vetëm: edukimit të njeriut. Edhe ndëshkimi penal, edhe vuajtja e dënimit, siç dihet, janë mjete që synojnë edukimin e jo hakmarrjen ndaj atyre që shkelin ligjet e shtetit dhe normat e moralit të shoqërisë sonë socialiste.

Ndërmjet personave të dënuar për kryerje krimesh, siç del nga raporti që na është paraqitur, ka edhe ndonjë «komunist». Ky fakt duhet të na tërheqë vëmendjen për të kuptuar thellë atë mësim të vlef-

shëm të Partisë sonë se lufta e klasave është një fenomen objektiv që zhvillohet jo vetëm ndërmjet nesh dhe armiqve, jo vetëm në gjirin e popullit, por pasqyrohet edhe brenda radhëve të Partisë. Komunistët që shkelin ligjet dhe normat e Partisë dhe të shtetit, gjersa përfundojnë në veprimtari kriminale, kuptohet që s'janë komunistë, po kanë qenë futur kontrabandë në radhët e Partisë. Duke u spastruar prej tyre, Partia nuk dobësohet aspak, përkundrazi, bëhet akoma më e fortë dhe mbetet kurdoherë e kulluar dhe e pastër.

Unë mendoj të shikojmë me një kujdes të posaçëm çështjen e përsëritësve të krimeve, të recidivistëve. Ne do të vazhdojmë të ushtrojmë të drejtën e faljes në konformitet me urdhërimet e ligjit, por, sipas mendimit tim, për faljen e përsëritësve duhet të jemi shumë të rezervuar, sepse ata, përgjithësisht, paraqitin rrezikshmëri shoqërore më të theksuar. Përsëritësit, vërtet mund të kenë kryer krime të vogla, por fakti që as puna edukative e Partisë dhe e shtetit, as vuajtja e dënimit penal të mëparshëm nuk i ka korrigjuar, flet për një rrezikshmëri më të madhe të tyre. T'u falësh dënimin njerëzve që kanë shkelur disa herë ligjet e shtetit dhe normat e marrëdhënieve socialiste të shoqërisë sonë, jo vetëm nuk ndikon për edukimin, por, në të kundërtën, shumica e tyre do të inkurajohej në vazhdimin e rrugës kriminale, duke shpresuar se, edhe po të kapen e të dënohen, dënimi mund t'u falet një ditë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Partia na ka mësuar dhe na mëson vazhdimisht

t'i kushtojmë kujdes të madh edukimit komunist të rinisë. Ne nuk themi kot dhe sa për t'i bërë qejfin vetes, se kemi një rini revolucionare, heroike, të pastër, të zgjuar, shumë të ndershme, punëtore dhe të lidhur ngushtë me Partinë. Realiteti kështu është, rinia jonë ka dhënë prova të shumta se e meriton plotësisht këtë vlerësim të lartë, por në qoftë se Partia, pushteti, organizatat e masave, familja, shkolla dhe gjithë shoqëria nuk kujdesen vazhdimisht për edukimin e saj, atëherë një pjesë e të rinjve, në ndikimin e presionit të ideologjisë borgjeze e revizioniste, si dhe të mbeturinave mikroborgjeze që trashëgon nga brezat më të vjetër, do të shkëputet nga rruga e mirë dhe e drejtë e Partisë dhe do të futet në rrugën antiligjore, siç ka ndodhur me disa që janë dënuar për përvetësim të pasurisë socialiste, sjellje të padenja në shoqëri e veprime të tjera të paligjshme. Prandaj të luftojmë me këmbëngulje dhe vazhdimisht që të rinjtë t'i mbajmë gjithmonë afër dhe të kemi kujdes për edukimin e tyre në mënyrë sa më konkrete e të dobishme, që ata të mos futen në rrugën e kriminalitetit.

Nga studimi i raportit bie në sy se të dënuarit janë më shumë banorë të qytetit sesa të fshatit. Kjo vjen për arsye se në qytet ndikimi i ideologjisë së huaj borgjeze dhe revizioniste nëpërmjet televizionit, filmit, turistëve të huaj etj., etj. është më i madh se në fshat, keqbërësit e kanë më lehtë t'u fshihen organeve të ndjekjes, pse popullata këtu është e madhe, njerëzit të gjithë nuk njihen me njëri-tjetrin etj. Për këto dhe shumë arsye, kudo, por veçanërisht në qy-

tetet e mëdha, si në Tiranë, në Shkodër, në Durrës, në Vlorë, në Fier, kujdesi i Partisë dhe i pushtetit në drejtim të edukimit të njerëzve, zbulimit të krimeve dhe të personave që i kryejnë këto duhet të jetë më i madh.

Në fshat, ndryshe nga qyteti, njerëzit njihen të tërë me njëri-tjetrin, ai që vjedh ose bën një krim tjetër bie shpejt në sy dhe njihet me gisht. Veç kësaj, duhet të kemi parasysh edhe disa veçori e tradita të mira të popullit tonë që janë ruajtur më shumë në fshat dhe ndikojnë pozitivisht në mospërhapjen e krimeve. Në shumë nga fshatrat tona malore, për shembull, e kanë për turp të vjedhin, të rrahin ose të vrasin gruan etj. Me disa nga traditat e mira që ruhen në mjaft zona fshatare të vendit tonë, duhet të edukojmë edhe qytetarët.

Duke përmendur disa prej shkaqeve të përhapjes relativisht më të madhe të krimeve në qytetet më të mëdha të vendit tonë dhe duke vënë në dukje disa anë pozitive që kanë në këtë drejtim fshatrat tona, nuk dua të them aspak se lufta kundër kriminalitetit në fshat duhet lënë pas dore, as nuk kam ndër mend të mohoj luftën që bëhet në qytete, si dhe traditat e mira të qytetit në luftën kundër krimeve, sepse ka edhe qytete të tilla, si Gjirokastra e të tjera, ku, po të bëhet një vjedhje ose çfarëdo krimi tjetër, me t'u zbuluar keqbërësi demaskohet menjëherë para popullit. Opinioni shoqëror atje i dënon ata, i mban në presion të vazhdueshëm, ai ndihmon kështu të mos shkojnë më tej. Unë i vura në dukje disa shkaqe të përhapjes së krimeve më shumë në qytet se në fshat,

për të dhënë idenë se ku duhet ta përqendrojmë më tepër vëmendjen në luftën kundër kriminalitetit dhe elementëve që shkelin ligjshmërinë tonë revolucionare.

Divorcet paraqitin rëndësi dhe interes të veçantë shoqëror. Për të pasur sa më pak raste të tilla, puna nuk duhet të kufizohet vetëm në pajtimin e bashkëshortëve pas lindjes së mosmarrëveshjes dhe pasi konflikti arrin deri në gjyq, por shumë kohë më parë se të lidhet martesë. Për ta studiuar këtë çështje dhe për të nxjerrë konkluzione të drejta, nuk duhet të gjykojmë duke u nisur vetëm nga numri i padive që i drejtohen gjykatës për të zgjidhur martesën, problemin ta shikojmë në tërë kompleksitetin e tij. Që të udhëhiqet familja nga normat e moralit komunist, ajo duhet të ngrihet mbi bazën e një martese të shëndoshë, bashkëshortët e ardhshëm ta kuptojnë martesën si një moment dhe veprim shumë të rëndësishëm në jetën e tyre, para se të lidhen ligjërisht me martesë. Puna për edukimin e të rinjve me ndjenjën e seriozitetit ndaj martesës dhe krijimit të familjes duhet të fillojë qysh më parë. Kjo edukatë duhet të jetë e gjithanshme; sistematike, politike dhe morale dhe të bëhet nga shoqëria. Është me vend të pranohet se kjo punë të ne nuk po bëhet me plan dhe në formë të organizuar.

I riu ose e reja jetojnë e punojnë në ambientin shoqëror, ku njihen me njëri-tjetrin. Ata, përveç problemeve të tjera, i preokupojnë edhe çështjet e shoqërisë, të miqësisë, të dashurisë, të martesës dhe të familjes, për të cilat bisedojnë, interesohen, njihen, miqësohen, e pastaj, më vonë, mund të dashurohen e të

martohen. Ky është procesi normal i jetës, por shoqëria është e interesuar në mënyrë jetike që këta hapa të rëndësishëm, që hedhin të rinjtë në jetë, të jenë në përputhje me normat e moralit të lartë proletar, pa cenuar aspak nderin dhe ndjenjën e dinjitetit personal, ndryshe pasojat do të jenë të rënda, familja e krijuar nuk do të ketë jetë të gjatë dhe ata që martohen sot pa u njohur mirë dhe pa e vlerësuar seriozisht aktin që kryejnë, nesër do të gjenden në sallën e gjyqit. Divorce, natyrisht, do të ketë edhe në të ardhmen, pse, kur martesë mbetet formale, kur vendin e dashurisë reciproke të bashkëshortëve e zë një atmosferë e zymtë dhe e akullt, atëherë s'ka kuptim që shoqëria të ngulë këmbë në vazhdimin e mëtejshëm të kësaj martesë «të vdekur». Çështja është që të ketë sa më pak divorce dhe kjo, sipas mendimit tim, arrihet kur familja dhe shoqëria e fillojnë punën edukative në këtë drejtim qysh në kohën kur fillon mosha e pubertetit.

E vërteta është se në krijimin e martesës dhe të familjes ne kemi bërë një përparim të madhe dhe të pakrahasueshëm me vendet kapitaliste e revizioniste, ku pavarësisht nga deklaratat false që bëjnë se gjoja mbrojnë martesën, në të vërtetë e trajtojnë atë thjesht si kontratë civile. Sukseset tona në këtë fushë të marrëdhënieve shoqërore nuk duhet të na pengojnë për të parë se edhe në shoqërinë tonë ka njerëz të prapambetur që raportet djalë-vajzë ose burrë-grua i shikojnë me syrin e patriarkalit të urryer dhe pastaj kalojnë në veprime të paligjshme, siç ka ndodhur në ndonjë rast. Këto nuk duhet të ndodhin dhe, për t'i parandaluar, është e domosdoshme të bëjmë një punë

akoma më të madhe edukative, moralo-politike, të shumanshme dhe jo me hope.

Gjatë vitit 1971 shumicën e padive për zgjidhje martesë i kanë ngritur gratë, gjë që tregon se tani ato po i ushtrojnë më lirisht të drejtat që u ishin mohuar nga regjimet antipopullore. Në shumicën e rasteve tronditja e marrëdhënieve martesore rrjedh për faj të burrave. Natyrisht, ky fakt duhet të na preokupojë në ndërtimin e punës sonë për edukimin e njerëzve. Unë mendoj se duhet të shqetësohemi më shumë kur konstatojmë se janë zgjidhur mjaft martesë të reja. Mjaft martesë nuk kanë zgjatur më shumë se një vit, disa të tjera nuk kanë vazhduar më shumë se dy vjet, apo që janë zgjidhur pasi bashkëshortët kanë jetuar së bashku deri 5 vjet etj. Në shumë raste zgjidhjeje të martesave bashkëshortët kanë pasur edhe fëmijë. Çfarë vërteton kjo gjendje? Kjo vërteton mungesën e një pune të mjaftueshme politike për edukimin e njerëzve, për të cilën fola pak më parë. Në qoftë se duam të na ndodhin sa më pak raste të tilla, le të bëjmë një punë akoma më të madhe edukuese për spastrimin e njerëzve nga ndikimet dhe mbeturinat mikroborgjeze etj.

Në lidhjen e martesave me mendjëlehtësi, si dhe për zgjidhjen e tyre ka faj disa herë edhe opinioni i paformuar dhe negativ i njerëzve. Ndodh që llafazanët i «fejajnë» të rinjtë që nga kontaktet më të thjeshta shoqërore të tyre. Ata, të mbytur nga ky opinion, kur nuk gjejnë mbështetjen dhe përkrahjen e duhur nga shoqëria, detyrohen të zgjedhin njërin nga këto dy rrugë: ose të mos shoqërohen më, ose, për të mbyllur

gojët e liga, të fejohen pa e njohur mirë njëri-tjetrin. Është e qartë se martesë si në këtë rastin e fundit i ka ditët të numëruara.

Vendi ynë është i vogël dhe po të shoqërohet vajza me një djalë, duket menjëherë, se ata njihen që janë të dy beqarë dhe mendohet se janë fejuar ose shpejt do të fejohen. Po të fejohen dhe të martohen me të vërtetë, mirë, por në qoftë se shoqëria ose miqësia e tyre nuk përfundon me dashuri dhe martesë, gjë që ndodh dhe kjo është e natyrshme, e shpjegueshme, nga frika e opinionit edhe vajza që s'ka faj mendon pak a shumë kështu: «Tani mua nuk më merr njeri dhe do të plakem pa u martuar». E njëjta gjë ndodh shpeshherë edhe me gratë e divorcuara. Sigurisht, kjo është mjaft e rëndë, njerëzit e pafajshëm bien viktima të opinionit jo të shëndoshë. Prandaj, në këtë drejtim, na dalin shumë probleme dhe detyra shoqërore. Me gjithë orientimet e drejta që janë dhënë për këto probleme, me gjithë përparimet e mëdha që kemi arritur, përsëri nga ana e Partisë, e organizatave të masave dhe nga organet gjyqësore duhet bërë një kujdes më i madh, t'i kushtohet një vëmendje e posaçme kësaj çështjeje.

Të kemi parasysh se shumë probleme që na dalin përpara për edukimin e individit dhe për formimin e opinionit të shëndoshë shoqëror kërkojnë zgjidhje të reja, për arsye se zhvillimi progresiv i jetës sonë ka bërë që të kapërcehen shumë zgjidhje të praktikuar më parë. Çdo moshë e çdo brez, që ecën përpara në ndërtimin e shoqërisë sonë socialiste, në progreset që bën, kurdoherë ruan në ndërgjegjen e vet mbeturina,

që, në një masë apo në një tjetër, e pengojnë gjatë rrugës së ngjitjes më lart. Këto mbeturina mund ta kenë rrjedhën nga thellësitë e shekujve, pra, mund të jenë nga më të ndryshmet e jo vetëm mikroborgjeze. Ka edhe mbeturina të një natyre tjetër që, megjithëse gjatë një periudhe të caktuar kohe kanë qenë të përparuara, më vonë ato e kanë humbur vlerën që kanë pasur. Kështu, disa nga zgjidhjet që kemi pranuar gjer më sot për një problem të caktuar mund të kenë qenë të drejta dhe përparimtare për një kohë, mirëpo zhvillimi i vrullshëm i shoqërisë i ka lënë pas, duke i bërë të papërshtatshme për aktualitetin. Kjo bën të nevojshme e të domosdoshme gjetjen e formave e të metodave më të përparuara të zgjidhjes për problemet që dalin përpara në momentin e dhënë.

Në të gjitha këto çështje duhet të jemi realistë, ta shikojmë çdo problem me kujdes, të mos nënvlerësojmë punën që duhet bërë për edukimin e njerëzve tanë dhe të marrim masa më konkrete për të ulur sa të jetë e mundur më shumë numrin e krimeve.

Këto ishin disa mendime që kisha për luftën kundër krimeve, gjë për të cilën kam folur më gjatë edhe herë tjetër.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH, që gjendet në AQP

KONCEPTET ARTIZANALE NË PRODHIM JANË TË PASHKËPUTURA NGA MBETURINAT E TJERA MIKROBORGJEZE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

23 mars 1972

Nuk kam për të thënë shumë gjëra për konceptet artizanale në prodhim, pse shokët i shtruan dhe i argumentuan drejt e gjerë mënyrat e shfaqjes dhe masat që duhen marrë për çrrënjosjen e tyre.

Këto probleme s'është hera e parë që i shtrojmë në udhëheqje, megjithatë, përsëri e vazhdimisht, ne do të merremi me to, për arsye se, krahas sukseseve të pamohueshme që kemi arritur, në punë e sipër, vërtetohen edhe mjaft të meta serioze.

Konceptet artizanale në prodhim nuk janë të shkëputura nga gjithë konceptet e mbeturinat e tjera mikroborgjeze. Ato janë të lidhura edhe me konceptet

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth luftës për çrrënjosjen e koncepteve artizanale në prodhim dhe masave që duheshin marrë.

e konservatorizmit, me qëndrimet burokratike, me shfaqjet e komandimit, të mendjemadhësisë, të arrogancës e shfaqjeve të tjera shumë të dëmshme që vihen re te njerëzit e papërgatitur mirë politikisht dhe ideologjikisht, të cilët në shumë drejtime nuk ecin si duhet me frymën revolucionare të Partisë.

Për të thyer pengesat që e kanë burimin te këto koncepte, si dhe në të tjerat, në radhë të parë, duhet të luftohet që problemet të kuptohen politikisht, të merren masa organizative të drejta dhe të përshtatshme në sektorët e punës, në përputhje me kushtet konkrete, me situatat që krijohen dhe me kërkesat që shtrohen për sasinë e cilësinë e prodhimeve.

Konceptet frenuese dhe pengesat që lindin prej tyre, është e domosdoshme të thyhen me vendosmëri në rrugë revolucionare dhe pa oportunizëm. Ç'do të thotë të thyhen pengesat në rrugë revolucionare? Kjo nuk do të thotë që t'u bihet «me sëpatë» bartësve të koncepteve artizanale, se këta janë njerëzit tanë. Partia kurrë nuk ka rekomanduar që mbeturinat në ndërjegjen e njerëzve të luftohen në këtë rrugë.

Megjithatë, duhet kuptuar se edhe në punën edukative ka një kufi. Partia dhe pushteti, përpara interesit të përgjithshëm të popullit, për mbarëvajtjen e punëve, të progresit shoqëror e të tjera, nuk mund të tororisen tërë jetën me disa njerëz që nxjerrin pengesa, pavarësisht cilët janë ata.

Ato që u thanë këtu nga shokët e Drejtorisë së Përgjithshme të Ekonomisë Komunale, se edukimi i punëtorëve të këtij sektori, për zhdukjen e koncepteve artizanale, bëhet më mirë tash se më parë kur kishim

kooperativat e artizanatit, janë slogane apo realitet? Punëtorët e ndërmarrjeve komunale nuk e kanë zhdukur konceptin e zvarritjes së kërkesave të qytetarëve. Atëherë, të mos na hidhen slogane këtu, se po na dalin flokët e bardhë dhe e njohim punën që bëhet. Për një punë që duhet të mbarojë në një ditë, ndërmarrjet komunale e çojnë edhe 12 ditë! Prandaj, duhet menduar, e kemi apo s'e kemi mirë organizimin e punës në këtë sektor? Bëmë mirë që i kthyem kooperativat e artizanatit në ndërmarrje shtetërore, apo nuk bëmë mirë? A është në gjendje ndërmarrja e shërbimeve komunale t'u lyejë bancosat tërë qytetarëve dhe t'u kryejë çdo shërbim tjetër në kohë, sa herë që ata kanë nevojë? Mendoj se me këtë mënyrë organizimi të punës nuk është në gjendje. Ata kanë me dhjetëra, qindra e mijëra objekte ku duhet të bëhen riparime e shërbime. Në këto kushte, ka punëtorë të pandërgjegjshëm, që, duke shfrytëzuar në kërkesat e mëdha të qytetarëve, punojnë në mënyrë private, brenda dhe jashtë orarit zyrtar, bile edhe me materialet e shtetit dhe marrin deri në trefishin e shpërblimit që u takon, kurse këtu na thuhet se shërbimet kryhen, por me vonesë!

Nuk do të jetë më mirë të caktohet një listë me llojet e shërbimeve që mund t'u kryejë ndërmarrja komunale qytetarëve dhe, për këtë, të marrin dijeni të gjithë? Po nuk u studiuua zgjidhja e këtij problemi që ka të bëjë me nevojat e popullit, ndërmarrjet nuk do t'i përballojnë dot punët që dalin.

Ju, shokë drejtues të Komunales, duhet të mendoni pak për këto probleme e jo, «t'i marrë era». Mos

ngulni këmbë sikur problemet që ju kanë dalë dhe vazhdojnë t'ju dalin vazhdimisht, i keni organizuar mirë. Për mendimin tim nuk janë organizuar siç duhet dhe puna nuk ju ecën mirë as nga ana materiale, as nga anët e tjera. Përkundrazi, me këto forma pune që praktikoni ju, shumë nga punëtorët e ndërmarrjeve komunale gjejnë fushë veprimi për të prishur ndërgjegjen, prandaj duhet reflektuar në këto gjëra dhe duhen ndjekur forma të reja pune.

Konceptet artizanale mund të kapërcehen me një kuptim të drejtë, marksist-leninist, mbi luftën pa lëkundje për çrrënjosjen e tyre, ndryshe nuk mund të ketë përparim e zhvillim. Në qoftë se nuk kuptohet drejt dhe nuk do të bëhet kjo luftë pa ndërprerje, mendimet e mykura, konservatore dhe prapanike do të bëhen një pengesë serioze dhe shkak për një prapambetje. Në këto kushte, nuk do të mund të flitej për një parti revolucionare që udhëheq një sistem shoqëror me marrëdhënie të përparuara në prodhim as edhe për një pushtet, si organ efektiv i diktaturës së proletariatit dhe, për rrjedhim, normat e Partisë dhe ligjet e shtetit do të bëheshin «ujë».

Sado ligje, vendime apo urdhëresa të drejta, sado forma organizimi që të vendosë Partia dhe shteti, po të lejohet që këto të mos vihen në jetë në mënyrë revolucionare, po u trajtuan ato jo shkencërisht, por, si të thuash, në mënyrë artizanale, po të shkelen ose të zbuten nga disa njerëz, nuk mund të realizohen detyrat e mëdha që kemi përpara në fushën e shndërrimit të bazës materiale të prodhimit artizanal, të zbatimit të metodave të reja shkencore për rritjen e rendimen-

tit të punës, të revolucionarizimit të vazhdueshëm të ndërgjegjes së njerëzve e të prodhimit e të tjera.

Por, a ndeshemi me vështirësi që rrjedhin nga konceptet artizanale? Shumë bile! Partia; asnjëherë nuk ka thënë se nuk ka për të pasur vështirësi në këtë drejtim. Por, vështirësitë më të mëdha neve na dalin në procesin e edukimit dhe të formimit të bindjeve të njerëzve tanë. Këtë të mos e harrojmë kurrë, shokë. Pengesat e vështirësitë materiale, siç na e ka vërtetuar eksperiencia, sado të mëdha që të jenë, kapërcehen më lehtë. Edhe në fushën e edukimit të njerëzve Partia jonë ka pasur dhe ka suksese. Megjithatë, duhet njohur se vështirësi ka e do të ketë, prandaj ne duhet ta rrahim më fort çëkanin për çrrënjosjen e koncepteve artizanale.

Lidhur me problemin që po trajtojmë vihet re se, në përgjithësi, pengesat për vendosjen e prodhimit në baza shkencore, për mekanizimin e proceseve të punës, për normimin etj., vijnë më shumë nga punonjësit e administratës. Kjo nuk përjashton që koncepte artizanale të kenë edhe një numër punëtorësh, por e vërteta është se kjo ndodh më shumë me njerëzit e administratës. Veç, nuk është e drejtë të arrihet në konkluzionin që tërë njerëzit e administratës janë bartës të pikëpamjeve artizanale; nuk do të ishte aspak me vend që t'i futnim të gjithë këta në një thes. Duhet pasur kujdes gjithashtu që, për të metat ekzistuese, për mbeturinat e koncepteve artizanale etj. në ndërgjegjen e njerëzve, të mos dënohen e të «mbyten» funksionet administrative të nevojshme. Shteti socialist, për të kryer funksionet dhe shërbimet që i ta-

kojnë, ka nevojë për administratat, prandaj bëhen përpjekje që atje të venë njerëz nga më të mirët e klasës dhe të edukohen vazhdimisht me frymën e Partisë. Dhe në të vërtetë shumica e tyre janë njerëz të mirë. Megjithatë, është fakt se mbeturinat që përmenda më lart ekzistojnë.

Genia jo vetëm në aparatet e pushtetit, po edhe në ato të Partisë, disa punonjësve të kësaj kategorie u ka rritur mendjen, i ka bërë arrogantë, i ka shkëputur nga masat e popullit dhe i ka çuar gjer atje sa të mendojnë sikur ata ditkan çdo gjë dhe s'kanë nevojë të pyesin njeri, se ata mund të zgjidhin problemet më mirë se kushdo tjetër, se ata njohkan në mënyrë të përsosur format e organizimit etj., etj. Disa prej tyre kujtojnë se pikëpamja që kanë ata për këtë ose atë problem është e pagabueshme, duke u bërë kështu frenues e konservatorë dhe, me qëndrimet që mbajnë, s'lejojnë të ecë përpara mendimi krijues i masave. Një gjendje e tillë duhet të marrë fund! Po kur? Të mos gënjehemi, shokë, duke kujtuar se konceptet artizanale në prodhim mund të çrrënjosen brenda pak kohe. Ato nuk do të zhduken as me një vit, as me dy, as me pesë apo brenda dhjetë vjetëve. Çështja është që vazhdimisht të shkojmë përpara në edukimin e njerëzve dhe drejt përmirësimit të organizimit e të drejtimit të punëve.

Në materialet e paraqitura, lidhur me konceptet artizanale në fushën e prodhimit, është shtruar drejt mënyra e luftës për çrrënjosjen e tyre. Komiteti i Partisë i Rrethit të Korçës e ka ngritur mirë problemin nga ana politike dhe ideologjike, kurse ai i rrethit

të Tiranës e ka shtruar në një drejtim tjetër, në aspektin e normave teknike, të zhvillimit të teknikës dhe të teknologjisë, të forcimit të disiplinës shkencore etj.

Puna e bërë gjer më sot na ka dhënë rezultate, po shqetësimin e kemi tani në fenomenet negative që vihen re në punë, në disa shfaqje jo të drejta që duken në praktikë. Prandaj ta organizojmë punën dhe luftën kundër këtyre koncepteve në mënyrë të tillë që Partia t'u bëhet barrikadë bartësve të këtyre koncepteve dhe jo këta t'i bëhen barrikadë Partisë.

Tu merremi vesh, unë nuk jam kundër artizanatit, sepse prodhimi artizan do të ekzistojë. Populli ynë ka tradita të shkëlqyera në këtë drejtim dhe do të duhej t'i zhvillonim në një shkallë akoma më të lartë. Por, këtu, në këtë mbledhje, ne flasim për punën që duhet bërë për të shkukur nga rrënjët konceptet dhe metodat artizanale që vihen re në drejtimin e ekonomisë dhe në prodhimin industrial. Në qoftë se ndonjë kuadër, për shembull, me pikëpamjet e tij artizanale, bëhet pengesë për progresin teknik etj., atëherë, pavarësisht se mund të jetë komunist i vjetër dhe drejtor në një ndërmarrje, nuk është mirë të lihet më në drejtimin e punëve. Në krye të punëve në ndërmarrje të vëmë në këtë rast punëtorin më të dalluar, po me frymë përparimtare, revolucionare. Përse u dashka ta lëmë medoemos një njeri që ta drejtojë ndërmarrjen, vetëm për faktin që ka një të kaluar 20 apo 25-vjeçare si komunist, kur nuk është në gjendje të drejtojë si duhet në kushtet e reja dhe, për shkak të koncepteve që ka, padashur, bëhet kështu pengesë?! Një person

që nuk e kryen dot më detyrën, nuk është aspak e drejtë të lihet në krye të punëve vetëm për faktin se është «shok i vjetër», se «ka qenë partizan» etj., etj. Shokët e vjetër do t'i respektojmë vazhdimisht për meritat e tyre në shërbim të Partisë dhe të popullit, por do t'i ngarkojmë me ato punë që janë në gjendje dhe kanë aftësi t'i kryejnë. Unë mendoj se ka shumë nga këta që, duke qenë revolucionarë, po të ngarkohen me detyra që u përshtaten aftësive të tyre, do ta çojnë punën përpara. Por, edhe në qoftë se ndonjëri nuk çan dot, ai duhet të ketë kurajën komuniste e t'i thotë Partisë: «Në vendin tim le të vijë ky ose ai shok më i zoti!» dhe të mos bëhet pengesë, pse ky nuk është një qëndrim revolucionar.

Deri kur do të vazhdojmë ne t'i fërkojmë krahët një njeriu që me pikëpamjet e qëndrimet e tij bëhet pengesë për modernizimin e ndërmarrjes dhe për realizimin e detyrave, duke nxjerrë gjithfarë «arsyesh»? Një njeri të tillë, derisa për shumë kohë bisedohet me të nga afër për ta edukuar dhe për ta bindur me koncepte të drejta revolucionare, derisa puna politike me të ezaurohet, Partia nuk e hedh nga shkëmbi, por i thotë: «Pa shko ca më poshtë-ti, shok, se mjaft u lodhëm të të edukojmë. Derisa nuk shohim të bësh përpjekjet e duhura për t'i kuptuar e për t'i zgjidhur problemet e reja që ngrenë jeta dhe nevojat e zhvillimit tonë, atëherë s'mund të qëndrosh më në këtë detyrë!». Kështu duhet të veprojë doemos Partia.

Për të pasur suksese, si për shumë probleme, edhe në këtë drejtim, ne duhet të ngremë në këmbë masat. Këtë Partia na e ka këshilluar ngaherë, por e

vërteta është se pak si me zor po i ngremë punëtorët në luftën kundër mbeturinave, të ndryshme që nxjerrin kokën në jetën tonë të përditshme. Disa herë, për nevojat e punës, u bëhet thirrje punëtorëve të punojnë me orar të zgjatur, në ndonjë rast edhe të dielave, për punë vullnetare etj. dhe ata janë gati të punojnë pa u kursyer, se e kuptojnë që çdo thirrje e Partisë është për të mirën e tyre dhe të atdheut. Megjithatë, kur vjen puna për t'i pyetur ata se ç'mendojnë, të themi, për drejtorin punon a s'punon mirë, është apo jo i drejtë në punë etj., kjo nuk bëhet. Bile, ka raste që kur ndonjëri merr guxim të flasë, ndonjë drejtues i jep të shtyrën. Kështu, shokë, nuk mund të ecet. Siç e kemi thënë vazhdimisht, kjo nuk është një metodë pune partie ndaj klasës. Ç'na pengon atëherë që nuk e zbatojmë në jetë këtë mësim të Partisë? Na pengojnë pikërisht disa njerëz që janë bartës të pikëpamjeve jo të shëndosha. Prandaj, po të mos punojmë për t'i thyer e për t'i zhdukur këto pikëpamje, kurrë nuk mund të shkojmë përpara me ritmet që dëshirojmë.

Kodi i Punës, ligjet e tjera, vendimet dhe urdhëresat e Qeverisë, kur është fjala për të marrë masa disiplinore, zhdëmtimi material ose për të bërë ndjekje penale, duhet të zbatohen njësoj për të gjithë, si për punëtorët, ashtu edhe për nëpunësit, duke përfshirë këtu edhe kuadrot drejtues në bazë e në qendër. E them këtë sepse ka raste, për shembull, që ndërpritet puna se mungon lënda e parë me të cilën do të punojë punëtori. Po kush e ka fajin për mosfurnizimin e materialeve? Punëtori? Jo! Fajin e ka drejtori i ndërmarrjes, e ka furnitori, të cilët nuk marrin masa

me kohë. Prandaj kushdo që ka faj, të vihet para përgjegjësisë, «t'i vihen këmbët në një këpucë», jo me llafe, por me zbatimin e sanksioneve ligjore. Në mosfurnizimin e materialeve me kohë dhe, për këtë shkak, në ndërprerjen e punës, komprometohen edhe drejtues e kuadro, deri shokë të organeve qendrore, që nuk zbatojnë me seriozitetin më të madh detyrat e planit. Për shembull, Ministria e Komunikacioneve, ta zëmë, nuk merr masa për transportimin me kohë të materialeve, sepse nuk e kujtoi Ministria e Industrisë dhe e Minierave; Ministria e Tregtisë nuk bën kur duhet porosinë për mallrat e importit, se nuk i kishte parashikuar me kohë në plan Komisioni i Planit të Shtetit; uzina «Traktori», jo për faj të saj, akoma nuk ka përfunduar për sivjet kontratat me ndërmarrjet e tjera etj., etj. Problemet lidhen kështu zinxhir njëri pas tjetrit. Për këto pengesa sillen arsyetime nga më të ndryshmet. Punëtorit këto «justifikime» nuk i hyjnë në punë; ai do qysh në mëngjes lëndën e parë sipas grafikut të parashikuar, për të plotësuar detyrën e caktuar të ditës. Në këto raste punëtorët kanë të drejtë të thonë: «Shokë, ne ankohe mi ndaj përgjegjësve, mbasi nuk mund të rrimë kot pa punë». Konkretisht këtë mund ta thonë punëtorët e Kombinatit të Drurit në Laç për ndërprerjen e punës, jo për fajin e tyre, por sepse Ministria e Industrisë dhe Ministria e Komunikacioneve nuk e kanë disiplinuar mirë prodhimin dhe transportimin e lëndës së drurit.

Shpesh, nga pakujdesitë e shokëve drejtues në qendër, në rrethe e në bazë, pengohen në punë duke u dëmtuar edhe ekonomikisht punëtorët, të cilët s'ka-

në asnjë faj. Vallë, a është e drejtë që të heshtet para kësaj gjendjeje? Jo, nuk është e drejtë! Në raste si këto, që mora vetëm si shembull, punëtorët me të drejtë ngrenë zërin. Ata, sigurisht, nuk flasin kundër Partisë, mbasi e dinë vijën e saj të drejtë, por qahen kundër personave që nuk i kryejnë detyrat. Kjo, shokë, nuk pajtohet aspak me vijën e Partisë. Si mund të vazhdojmë të flasim ngaherë për të meta që vërte-tohen në mënyrë të përsëritur? Masat tona punonjëse i shohin këto dobësi, por nuk inkurajohen sa duhet për të ngritur zërin kundër tyre. Po të mos kishin dalë punëtorët kundër zvarritjeve burokratike nga ana e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor dhe nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Korçës, për propozimet e bëra nga punonjësit e NISH-Tullës, asnjëri nuk do të kujtohej për hezitimet pa vend në marrjen e masave kundër disa burokratëve. Me sa duket, Mihallaq Ziqishti¹ nuk paska ardhur sot në mbledhje, se mund të mendonte që do ta kritikonim për atë që bëri duke vajtur në kundërshtim me punëtorët. Asnjëri s'duhet të vejë në kundërshtim me punëtorët kur ata kanë të drejtë, dhe, kur nuk kanë të drejtë, t'ua shpjegojmë situatën me durim, pa bërë lëshime të paarsyeshme.

Po, edhe komiteti ekzekutiv ka faj, ashtu siç thatë ju² e për këtë të mbajë përgjegjësinë që i takon. Por,

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës. Më vonë dënuar nga gjyqi i popullit për veprimtari armiqësore.

2. I drejtohet shokut Jani Samara, në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës.

në radhë të parë, shikoni punën tuaj në komitetin e Partisë, ndreqni njëherë të metat tuaja, pastaj kthehuni nga komiteti ekzekutiv për të parë nëse e ka fajin kryetari apo ndonjë tjetër. Mblidhni popullin dhe i thoni kush është fajtori. Në qoftë se ka faj edhe Mihallaqi, këtë gjë ia raportoni edhe plenumit të komitetit të Partisë. Të mos e shpërndajmë përgjegjësinë si vaji në lakra, duke ngarkuar me faj 100 veta, pse në këtë mënyrë nuk e gjejmë dot hiçgjëkundi fajtorin e vërtetë.

Këto të meta do të vihen në vend kur njerëzve t'u jepen të gjitha kompetencat që u takojnë dhe kur vllido qoftë të vihet para përgjegjësisë e të kontrollohet me rreptësi për punën që bën. Kush do ta kontrollojë këtë punë? Do ta kontrollojë Partia, klasa. Këtë ta kemi të qartë të tërë. Nuk mund t'i kontrollojnë dhe nuk mund t'i mbulojnë si duhet të tërë sektorët e punës vetëm disa persona të kontrollit shtetëror. Edhe ky lloj kontrolli duhet të ekzistojë, se është një formë e kontrollit të shtetit të diktaturës së proletariatit, por, përveç tij, është e domosdoshme të ekzistojë edhe kontrolli punëtor.

Për disa shkelje që sjellin ndërprerjen e punës, dy veta të kontrollit shtetëror mund të bien fare mirë në ujdi, për shembull, me një drejtor ndërmarrjeje ose ndonjë drejtues tjetër, dhe këto t'i konsiderojnë «pa shumë rëndësi». Kurse ata, të cilëve u rëndon më tepër në kurriz ndërprerja e punës, dua të them punëtorët, nuk mund të bien kurrë dakord me fajtorët, s'kanë si pajtohen me të metat në punë.

Si mund të binin dakord punëtorët e Grecallisë,

që shteti i ka tërhequr nga fshati për të punuar në ndërmarrjet, me qëndrimin arbitrar të kryetarit të kooperativës bujqësore, i cili arriti deri atje sa t'u presë pemët frutore disa punonjësve dhe pastaj t'u thotë: «hajde, qërohuni nga tokat, prishni dhe shtëpitë!». Para kësaj situatë të padrejtë u ngritën punëtorët dhe thanë: «Ta dërgojmë menjëherë në gjyq kryetarin e kooperativës!». Dhe kishin shumë të drejtë, se denbabaden, me shekuj, ata kanë jetuar në atë tokë ku kanë derdhur edhe gjak, ku prindërit, gjyshërit e stërgjyshërit e tyre kanë ndërtuar shtëpitë, kanë lindur vetë e kanë rritur kalamanët, ku kanë varret e njerëzve të tyre të dashur etj. E dini ju, shokë, si na thuhet për këtë? «Po fundi i fundit ajo tokë është e kooperativës»: Jo, me tokën dhe me pemët e oborreve nuk mund të vepohet si t'i dojë qejfi kryetarin të kooperativës; ato u janë lënë në përdorim familjeve të anëtarëve, edhe pse mund të ketë ndonjë pjesëtar të tyre në marrëdhënie pune me shtetin. Këto pikëpamje e qëndrime kaq flagrante, shokë, janë të huaja për Partinë, prandaj nuk mund të lihen pa u ndëshkuar.

Shoku Manush Myftiu ngriti mjaft çështje të rëndësishme në diskutimin e tij, midis të tjerash edhe atë që organizimi ekonomik i disa ndërmarrjeve është i dobët. Atëherë përse i kemi gjithë ata njerëz që punojnë në administratat e ndërmarrjeve, sa për t'u paguar rrogat? Ata janë ngarkuar pikërisht për drejtimin ekonomik të ndërmarrjeve.

Në qoftë se nuk i mobilizojmë siç duhet komunistët dhe klasën punëtore në vijën e Partisë, për t'u

prerë rrugën mendimeve anarkike, punët nuk do të na shkojnë mirë. Mobilizimi dhe edukimi sipas mësimëve të Partisë do të arrihen kur secili të thotë mendimin e tij të pjekur, jo vetëm nëpërmjet kritikës, po edhe me sugjerime, me vërejtje e me propozime në fushën e organizimit, të drejtimit e të tjera. Shoqëria jonë nuk lejon asnjëri të mendojë se, meqenëse është drejtor, mund të bëjë si të dojë. Askush s'ka të drejtë të pretendojë se meqë e ka vulosur ai një gjë, të tjerët nuk mund të kundërshtojnë. Ne kemi vendosur, për shembull, për organikat; i kemi aprovuar si na është dukur më e arsyeshme. Por drejtësia dhe saktësia e tyre duhen provuar në jetë. Kur në praktikë nuk dalin si kemi gjykuar ne, atëherë klasa punëtore ka të drejtë të thotë: «Organikat, more shokë, nuk i keni në rregull, prandaj i rishikoni më mirë, për këto ose ato arsye». Ndonjë njeri, i pafornuar si duhet, mund t'i flasë me zemërim atij që bën vërejtje: «Si thua ti që nuk i ka parë mirë Komiteti Qendror i Partisë? E di se me këto që po flet, po del kundër Partisë dhe Qeverisë?!».

Jo, shokë, ai që jep një mendim për të rishikuar diçka të gabuar, nuk flet aspak kundër Partisë. Përkundrazi, me vërejtjen që bën, ai e ndihmon shumë Partinë.

Drejtesit e kombinatit të tekstileve «Stalin» bënë një riorganizim. Ne kishim bërë një organizim më parë, ndërsa ata, duke u mbështetur në kushtet e reja, bënë disa ndryshime të nevojshme në të mirën e punës. Mos do të thotë kjo se, duke ndryshuar një mënyrë organizimi që ishte aprovuar shumë kohë më parë nga

lart, ata nuk e duan Partinë ose u vunë me këtë në kundërshtim me vijën e saj? Jo, ata bënë shumë mirë që e riorganizuan kombinatin, pse organizimi i vjetër në kushtet e krijuara prishte punë. Kështu duhen parë këto probleme.

Këtu u tha se riorganizimi po ecën ngadalë. Po përse ecën kaq ngadalë? Sepse shpeshherë duam t'i bëjmë të tëra punët vetë. Në qoftë se ministri, të themi, do të presë që t'i bëjë vetë tërë këto punë ose në bashkëpunim vetëm me tre-katër kuadro që ka pranë tij, problemet nuk mund të zgjidhen si duhet dhe në kohë. Ne kemi tash me dhjetëra veta edhe në ndërmarrjet ekonomike që mund të merren me studime. Secilit prej tyre mund t'i thuhet: «Studioje këtë ose atë problem, pyet edhe punëtorët. Pasi të japësh mendimet e tua, sille çështjen për të parë së bashku përfundimet që ke arritur». Dhe të shikosh se si brenda pak ditëve ai do ta mbarojë atë punë, duke dhënë mendime shumë të mira. Përse nuk bëhen kështu këto punë, po zvarriten për shkak të tendencës për t'i bërë të tëra vetë? Për këtë Partia lypset të jetë vazhdimisht në luftë dhe të kërkojë llogari. Në këto drejtime nuk mund të durohet ngathtësi, po të veprohet gjallërisht.

Unë jam dakord me të gjitha mendimet e shokëve. Të metat që përmenda, të cilat duhet t'i luftojmë me vendosmëri, nuk janë e tërë pasqyra e punës sonë, po vetëm një pjesë e saj, sepse Partia dhe populli ynë kanë arritur realizime shumë të mëdha. Pa energjitë e pashtershme të njerëzve tanë, nuk mund të arriheshin të gjitha ato. Punëtorët tanë, bashkë me teknikët dhe inxhinierët, me drejtoritë dhe administratat e

ndërmarrjeve, atje ku këto të fundit qëndrojnë me të vërtetë në krye të detyrave, kanë bërë një punë shumë të madhe që sa vjen e shkon më përpara; planet realizohen dhe tejkalohen; po bëhen mjaft rikonstrukcione e të tjera sende shumë të mira. Megjithatë, në punë e sipër, siç thashë, ka edhe mungesa e vështirësi. Të tilla do të ketë edhe në të ardhmen. Të mos na shkojë mendja që mund të planifikojmë çdo gjë dhe punët të na shkojnë si sahati, pse edhe për gjërat e planifikuara vështirësitë nuk evitohen. Gjithë puna është që të përqendrojmë vëmendjen në përpjekjet e shumta që duhen bërë për edukimin e çdo njeriu, sepse nuk janë të tërë njëloj; nuk është e mundur «të priten të tërë me një gërshtë». Në punë dhe në luftë disa vonohen se janë të ngadalshëm, ca të tjerë pengohen nga rutina etj.

Që të kemi edhe më tepër suksese, këto vështirësi duhet t'i kapërcejmë me kurajë dhe kurdoherë në rrugë revolucionare.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

KOMPETENCAT TË USHTROHEN NË PAJTIM ME INTERESIN E PËRGJITHSHËM

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

23 mars 1972

Unë çuditem me dhënien e akteve dhe me rezultatet e këtyre afateve për kuptimin e kompetencave. Pse pak ishte gjithë viti 1971 për kuptimin dhe zbatimin e kompetencave? Për njerëzit që kanë kaq vjet që po punojnë e po luftojnë, që kanë një përvojë të gjatë në punë etj., një vit nuk është pak. Dua të them se nuk duhen dhënë këto afate prej 6 ose 8 muajsh «për t'u njohur me kompetencat e reja». Kaq vështirë e paskan rrethet dhe baza për të njohur kompetencat, sa t'u japim 6 muaj e 8 muaj kohë?! Pse «histori» e madhe është kjo? Na thuhet që ka kompetenca drejtori, ka kompetenca dega, ka zëvendëshefi etj., etj.,

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për eksperiencën e fituar në forcimin e përgjegjësisë, iniciativës e vetëveprimit, mbi bazën e kompetencave të reja që u qenë dhënë ndërmarrjeve shtetërore.

kurse të gjithë e dimë se personat zyrtarë kanë pasur detyra e përgjegjësi të caktuara që kur është krijuar pushteti popullor. Këto afate që jepen kështu si u fol këtu, janë shfaqje të burokratizmit, prandaj mos krijoni një pyll dispozitash e stërhollimesh të panevojshme «për kuptimin dhe zërthimin e kompetencave». Ç'është ky burokratizëm?

Iu dha kaq shumë afat Ministrisë së Bujqësisë për shpjegimin e qëllimeve, të detyrave dhe të organizimit të kooperativave bujqësore të tipit të lartë sa ajo, «në vend që të vërë vetulla, nxori sytë» dhe komprometoi vetë idenë e vijës së masave. Të venë punonjësit e ministrisë katër muaj me radhë për të shpjeguar idenë e krijimit të 10 kooperativave bujqësore të tipit të lartë dhe të ngjallin një shqetësim të madh në gjirin e kooperativistëve, duke u thënë të tjera gjëra nga ato që vendosëm ne, kjo është e palejueshme. Mirëpo duhet gjetur ilaçi që t'i shërojmë këta njerëz.

Si është e mundur që komiteti ekzekutiv të kërkojë fonde nga ministria për ato raste që mund të vendosë vetë?! Mua nuk ma merr mendja të jetë kështu, ndryshe ai kryetar komiteti ekzekutiv rrethi s'është për atë vend. Logjika e do që, para se të kërkojë diçka nga lart, organi lokal i pushtetit ose i ekonomisë të shikojë më parë ligjin, se mos e ka vetë në kompetencë zgjidhjen dhe vendosjen përfundimisht të një çështjeje. Kjo është një punë më e lehtë për të, sesa t'i drejtohet ministrisë. Pra, kur rrethet kërkojnë ndihma për gjërat që i kanë në kompetencat e tyre, dikasteri t'u thotë: «lexo rregulloren dhe zbato kompetencat!».

U fol këtu për rastet kur Ministria e Ndërtimit

jep urdhër për të kaluar makineritë e një ndërmarrjeje në dispozicion të një ndërmarrjeje tjetër, pa e pyetur fare ndërmarrjen që i ka në administrim këto makineri. Po ku e ka gjetur ministria këtë të drejtë? Ka gjë të shkruar që makineritë e dhëna një ndërmarrjeje, t'ia marrë ministria kur të dojë? Kjo, siç u tha këtu, nuk ekziston. Por, e kundërta, domethënë që dikasteri nuk ka të drejtë t'i lëvizë makineritë sa herë të dojë e si të dojë. Ndërmarrja ka një plan të caktuar, që do të realizojë. Për këtë qëllim asaj i janë aprovuar numri i punëtorëve, fondi i pagave, makineritë, duke llogaritur edhe rendimentin e tyre. Makineritë ndërmarrjes i janë caktuar për punën që i ngarkohet të bëjë. Kjo do të thotë se dikasteri nuk ka të drejtë t'i marrë, ndryshe do të pengojë punën dhe do të bëhet shkak për mosrealizimin e planit të shtetit nga ana e kësaj ndërmarrjeje. Ja, pra, pse është e ndaluar marrja e makinerive, që janë shkruar dhe vulosur në plan. Në qoftë se ndërmarrjes nuk i duhet një makinë, sepse ka bërë përpjekje të lavdërueshme për rritjen e rendimentit e, për pasojë, edhe planin e realizon me më pak makina, atëherë drejtuesi i saj, si komunist i mirë, njofton ministrinë ta marrë atë makinë për ta përdorur gjetkë. Kjo ndodh kur jep pëlqimin ndërmarrja dhe kur nuk pengohet plani, ndryshe jo. Por, për rastin që u përmend këtu, siç e thonë shokët, ndërmarrja e ndërtimit «21 Dhjetori» nuk i ka pasur të tepërt buldozerët që iu morën dhe as që është pyetur para se t'ia merrnin.

Por, edhe kjo çështje duhet kuptuar drejt e jo në mënyrë shablone. E kam fjalën që kompetencat du-

hen ushtruar gjithmonë në pajtim me interesat e përgjithshëm. Fjala vjen, kur na ngjau katastrofa e Dibrës, bëmë shumë mirë që i morëm të gjithë kamionët e Shqipërisë dhe i dërguam atje për të zhdukur sa më shpejt pasojat e tërmetit. Të gjitha ndërmarrjet u ngritën në këmbë dhe realizuan planin. Ky vendim ishte i domosdoshëm, prandaj i gjithë populli na duartrokoi. Kështu duhet t'i kuptojmë problemet, pra, dhe mjetet t'i lëvizim kur është e domosdoshme.

U fol këtu edhe për kryesinë e komiteve ekzekutive, që të funksionojë si organizëm dhe se kjo «lehtëson» edhe punën e këshillit popullor! Por unë pyes: A është progresive kjo formë pune e kryesisë?

Ajo, për mendimin tim, është kthyer në hallkë të tepërt, duke arsyetuar se «i lehtësoi punën» komitetit ekzekutiv, siç u tha këtu. Kryesia i thërret të gjithë kur bën mbledhje për punët e arsimit, të bujqësisë, të kësaj dhe të asaj. Pra, janë gjithë ata veta që marrin pjesë në çdo mbledhje të kryesisë së komitetit ekzekutiv. Kështu, kjo kryesi jo vetëm komitetin, por edhe këshillin popullor «e lehtësoi» fare nga detyrat!

Ja, më thoni dhe ju, se si e kuptoni këtë gjë që kryesia e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit thërret shefin e seksionit të bujqësisë, të arsimit etj., nuk merr asnjë mendim prej tyre, por i pyet si vajti, për shembull, fushata e mbjelljeve, si u paraqit gatishmëria teknike e traktorëve, si filloi viti shkollor, si paraqitet gjendja e shkollave etj. Pastaj u jep porositë shefave përkatës «traktorët i kini një çikë më shumë kujdes», «hapni sytë për seleksionimin e farës», «meremetoni më mirë shkollat» etj., etj.

Është e qartë, pra, se me këto kryesi u krijua një hallkë e tepërt në rreth që u merr kompetencat organeve të tjera. Ju, drejtuesit e Këshillit të Ministrave, i kontrolloni apo jo këto punë? Shokët që dërgoni ju për kontroll thonë që: «është shumë mirë ky organizim», prandaj mos na thoni këtu që nuk i dini. Ky është organizimi juaj.

Zëvendëskryetari i komitetit ekzekutiv ka disa kompetenca. Ai, në bazë të funksioneve që i ka ngarkuar komiteti ekzekutiv, zëvendëson kryetarin, ndihmon dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të komitetit për seksionet që ka në vartësi dhe nuk është hallkë, siç u tha këtu. Por çështja është tek organizimi i punës së tyre. Zëvendëskryetari përgjigjet për punën e seksioneve para komitetit ekzekutiv, ai i raporton komitetit ekzekutiv dhe këshillit popullor për seksionet që drejton. Shefat e seksioneve, në kohën kur komiteti nuk është i mbledhur, duhet të përgjigjen para zëvendëskryetarit që i ka në vartësi. Pra, këtu nuk ka ndonjë hallkë të tepërt. Është tjetër punë nëse ndonjë zëvendëskryetar «ia hipën në zverk» edhe kryetarit, kur ky i fundit s'është i zoti të kryejë detyrat e tij. Po kështu mund të thuhet edhe për raportet e zëvendësministrit me ministrin. Këto mund të ishin disa të meta në organizimin e punës, por s'kanë të bëjnë aspak me hallkat e panevojshme.

Unë them që po të merret drejtori në ministri me problemet që ka drejtorja ku punon, nuk ka kohë të pyesë zëvendësministrin për çdo gjë. Po të merret edhe zëvendësministri me problemet që i takojnë, atëherë ai do t'i thotë drejtorit: «zgjidhi vetë, punët që të për-

kasin ty, se as unë s'kam kohë të merrem me ato». E keqja këtu është se ka kuadro që merren me çikërrima, me një punë të vogël, të ngushtë, me punën e kartave. Drejtorin e industrisë mekanike, për shembull, nuk duhet ta zërë gjumi për çështjet që i takojnë të zgjidhë. Dhe, po të jetë kështu, ai s'duhet të ketë kohë që as fytyrën t'ia shikojë zëvendësministrit, tek i cili do të paraqitej rrallë sa për t'i raportuar. Kjo do të ndodhë kur drejtori të zbatojë deri në fund kompetencat e tij dhe të mbajë përgjegjësi për punët që i dalin, pa qenë nevoja të marrë pëlqimin e eprorit për çështje që duhet t'u japë rrugë vetë. Kur mbyllemi në zyrë dhe pyesim njëri-tjetrin si thua ti e si them unë, punët zvarriten.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

PROBLEMET E ARKITEKTURËS E TË URBANISTIKËS MUND TË ZGJIDHEN DREJT NËSE TRAJTOHEN NË MËNYRË SHKENCORE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

23 mars 1972

Sic duket, materiali «Mbi disa probleme aktuale të arkitekturës sonë», na paraqitet nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve, kryesisht, për arsye se në radhët e saj bëjnë pjesë edhe arkitektët. Sigurisht, kjo çështje nuk është vetëm e arkitektëve, por edhe e inxhinierëve, e teknikëve të zbatimit, e punëtorëve të ndërtimit, bile ajo është e gjithë masave të popullit. Arkitektët, duke u futur në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve, nuk duhet ta konsiderojnë veten, në asnjë rast, të shkëputur nga punonjësit e ndërtimit e punonjësit e tjerë.

1. Në këtë mbledhje u diskutua, ndër të tjera, edhe për disa probleme aktuale të arkitekturës sonë.

Mua më duket se materiali që kemi përpara, ku, përveç të tjerash, vihet theksi shumë për «të bukurën», për «kënaqësinë estetike», për «shijen estetike», për «vlerat estetike», për «aspektet estetike» etj., të lë të nënkuptosh se ekziston edhe një tendencë e tillë shkëputjeje. Kompetent për këtë problem unë nuk jam, por kam mendimin se çështjet e arkitekturës në këtë raport nuk janë shtruar drejt, ato janë trajtuar në mënyrë të njëanshme. Mendoj që elementet e së bukurës në arkitekturë duhet t'i mbajmë parasysh medoemos, por ato nuk janë të vetmet. Natyrisht, ne nuk mund të lejojmë që të nxjerrim vepra arkitekturore të përçmuara, përkundrazi, të luftojmë që ato të jenë patjetër të bukura, por kjo s'do të thotë që e bukura, ana estetike, të shikohet e shkëputur nga faktorët dhe elementet e tjera të shumta, që këto të mos mbahen parasysh.

Në ndërtimet tona nuk kemi të bëjmë vetëm me të bukurën. Bukuria në këtë çështje është vërtet një faktor, por asaj nuk mund t'i nënshtrohen gjithë faktorët e tjerë të rëndësishëm, siç janë faktorët ekonomikë, rritja e popullsisë së vendit tonë, dëshirat e punonjësve etj. Prandaj, unë jam dakord me mendimin që u shpreh këtu, se, përveç faktorit estetik, ka edhe shumë të tjerë, të cilët, të gjithë së bashku, duhen parë në kompleks me seriozitet të madh.

Në materialin e paraqitur jepen mendime jo vetëm për çështje estetike, por për problemet më themelore aktuale të arkitekturës e gjer në njëfarë shkalle edhe të urbanistikës. Natyrisht, theksohen edhe aspektet e mprehta e kontradiktat që ekzistojnë në këto fusha,

për të cilat edhe më parë janë shfaqur mendime, janë bërë kritika, janë marrë vendime, për zbatimin e të cilave është punuar dhe janë arritur suksese.

Unë nuk jam dakord të krijohet përshtypja se arkitektura te ne ka mbetur prapa nivelit të zhvillimit të përgjithshëm, mbasi kjo nuk është e vërtetë. Arkitektura jonë, me gjithë të metat e vështirësitë e rritjes, nuk ka mbetur prapa këtij zhvillimi, përkundrazi është zhvilluar e ka përparuar mjaft. Natyrisht, ne kemi akoma shumë për të bërë në fushën e arkitekturës, por është fakt se kemi ecur përpara në krahasim me gjendjen e vendit menjëherë pas Çlirimit. Njerëzit tanë në asnjë skaj të Shqipërisë nuk jetojnë sot nëpër kasolle¹, se kemi ndërtuar qytete dhe fshatra të tëra dhe të bukura. Prandaj nuk duhet ta nënvleftësojmë atë që është bërë gjer tani në vendin tonë në lëmin e ndërtimeve. Ne duhet t'i respektojmë arkitektët, ndërtuesit dhe punëtorët tanë, mendja dhe duart e të cilëve na kanë dhënë, në përgjithësi, vepra të mira dhe të bukura. Megjithatë, s'do të thotë që të mos u bëjmë atyre ndonjë sugjerim, vërejtje e kritika.

Në fillim të diskutimit të këtij problemi, jo pa qëllim, unë bëra pyetjen: A ka në këtë mbledhje ndonjë inxhinier ndërtimi, inxhinier zbatimi, urbanist, sociolog, ekonomist etj.? Unë mendoj se problemet e arkitekturës dhe sidomos të urbanistikës janë shumë komplekse dhe duhet të diskutohen në të gjitha pa-

1. Në vitin 1984 mbi 80 për qind e popullsisë së vendit tonë banonte në shtëpi dhe në apartamente të reja të ndërtuara gjatë 40 vjetëve të pasçlirimit.

mjet e veta, nga një rreth i gjerë specialistësh. Përse e them këtë, për ç'arsye? Le të ndalemi të shohim disa çështje, pa pretenduar se do t'i sqarojmë ato plotësisht dhe menjëherë.

Po e filloj më parë nga çështja që u ngrit këtu, nga ndërtimi i shtëpive me shumë kate. Kush e dikton këtë kërkesë? Këtë e diktojnë nevojat e zhvillimit ekonomik dhe demografik të vendit, nevojat e zhvillimit dhe të shtimit të popullsisë. Me sa kate do të ndërtojmë ne, me pesë, dhjetë, pesëmbëdhjetë apo më shumë kate? Ne nuk duhet të ndërtojmë shtëpi kaq të larta. Për ç'arsye? Sepse jemi vend i diellit, i ajrit, i freskisë e i luleve. Edhe po të na imponohet një gjë e tillë, se na është bërë koka «tokë e punueshme», «tokë e bukës», po t'i hedhim një sy sado të shpejtë shtrirjes së kryeqytetit brenda vijës që është caktuar, në të gjitha rrugët ka mundësi të ngrihen ndërtesa, ku të jetojnë akoma edhe disa qindra mijë njerëz. Tirana mund të mbante edhe më shumë njerëz në truallin që përfshin sot, sikur të mos kishte masa kufizuese.

Për të thyer monotoninë, unë nuk jam kundër që të ngrihet ndonjë ndërtesë edhe me shtatë, tetë ose dhjetë kate, por arsyet që parashtroi këtu shoku Spiro Koleka¹ në lidhje me këtë problem, mendoj se duhen pasur parasysh. Drejt ngrihet çështja që të shikojmë perspektivën, por ne duhet të kemi parasysh më parë të sotmen dhe të ardhmen e afërt. Në këtë drejtim veprojnë një tog faktorësh kompleksë: sot ujët me

1. Në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH.

zor na ngjitet verës gjer në katin e tretë, ngrohjen akoma e bëjmë me dru, të cilat dihet se është vështirë t'i ngjitesh në katet e larta, problem është dhe siguri-mi i ashensorëve. Po të bëhen ndërtesa të larta me 7, 8 deri edhe 10 kate, atëherë do të na duhet, ndoshta, të bëjmë miliarda lekë shpenzime, në një kohë kur kemi edhe nevoja të tjera e të ngutshme.

Nuk them se të gjitha këto probleme janë të pagjidhshme, puna është që ekonomistët tanë t'i studiojnë mirë e t'i llogaritin si duhet të tëra. A na lejo-het neve të ndërtojmë çfarëdo godinash në sheshin kryesor të Tiranës? Sigurisht që jo, mbasi atje duhen bërë ndërtime të mëdha e të larta dhe objekte të tilla që mendoj se do të përdoren, kryesisht, për nevoja administrative e social-kulturore. Është më mirë të preferojmë që sheshi «Skënderbej», akoma edhe për ca kohë të duket jo i bukur, sesa të nxitohemi ta mbushim me ndërtesa, në një kohë që mundësitë materia-lo-financiare të shtetit janë akoma të kufizuara dhe përgatitja tekniko-profesionale e kuadrove është në nivel jo aq të lartë. Po të ngremë që sot ndërtesa të mëdha për institucione administrative, do të na mbeten pa shfrytëzuar. Administratat ekzistuese le të qëndrojnë, hëpërhë, siç janë e ku janë sot.

Ideja e shfrytëzimit të vendeve bosh, që ekzistojnë nëpër qytetet tona, ka rëndësi të madhe, vetëm se vendet bosh duhen sistemuar. Kalova një ditë në rru-gën «Bardhyl»¹, duke u ngjitur përpjetë rrugës «Qemal Stafa». Në një vend pushë diçka që s'më pëlqeu: se

1. Sot rruga «Gogo Nushi».

kujt i ka hipur në kokë dhe ka ndërtuar atje një diçka si haur me tulla të bardha, një ndërtesë jashtë çdo kriteri. Ne nuk duhet t'i lejojmë, në asnjë mënyrë, ndërtimet spontane që janë bërë, vazhdojnë të bëhen e mund të bëhen edhe paskëtaj, se një gjë e tillë nuk është e mirë. Është detyrë të luftohet me këmbëngulje kundër ndërtimeve të tilla spontane, për harmonizimin e ndërtimeve, për krijimin e ansambleve, për koordinimin e kërkesave të përgjithshme e të veçanta, të çastit dhe të perspektivës, duke luftuar kundër interesave të përkohshëm të një ndërmarrjeje ose të një dikasteri. Vetëm të kemi parasysh e të mos harrojmë se për ndërtimin e një fabrike, të një instituti ose një depoje të parashikuar në plan, vendi duhet caktuar me kohë. Nuk mund të lejohet të ceket me ëndërrime, puna nuk pret, interesi i zhvillimit të prodhimit socialist të vendit nuk lejon zvarritje. Por në praktikë ndodh që bëhet edhe ndonjë vendosje e pagoditur. Natyrisht, po të lihen të lira ndërtimet, që të vendosë kushdo e ku të mundet, gjë që nuk është aspak e mirë, do të ndodhin gjëra të tilla. Por, në qoftë se do të kemi një institut të arkitekturës e të urbanistikës, i cili do të studiojë dhe do të përcaktojë kriteret se ku duhet prishur dhe ku duhet ndërtuar, shumë nga vendet bosh, që kemi në qytetet tona, do të bëhen në të ardhmen kantiere, ku do të ndërtohen komplekse aq të bukura nga arkitektët dhe ndërtuesit tanë. Për të tilla probleme mos vallë është në gjendje dhe duhet të vendosë vetëm arkitekti? Jo, shokë, nuk është e mundur dhe nuk duhet të vendosë vetëm ai.

Është gabim të mendohet se të vetmit njerëz kom-

pententë që mund të gjykojnë për çështjet e arkitekturës e të urbanistikës janë vetëm disa specialistë të këtyre fushave. Për to mund e duhet të gjykojnë edhe masat punonjëse, sepse janë këto që do të rrojnë në qytetet që ndërtohen, do të ecin në rrugët e tyre, do të çlodhen në parqet e gjelbëruara, do të shijojnë rrezet e diellit, të cilat do të depërtojnë kudo, në qoftë se ndërtimet do të kombinohen e do të harmonizohen si duhet. Arkitektura dhe urbanistika moderne duhet të na japin mundësi të shfrytëzojmë sa më shumë diellin, blerimin, ajrin e pastër etj. dhe t'i harmonizojmë këta faktorë me banesat dhe me ndërtimet e tjera. Me problemet e arkitekturës e të urbanistikës, krahas arkitektëve e sociologëve, duhet të merren edhe ekonomistë, inxhinierë të zbatimit e të tjerë.

Kur flasim për sociologët, këta duhet të njohin mirë psikologjinë dhe dëshirat e qytetarëve dhe ta thonë me kompetencë fjalën nëse populli ynë dëshiron apo nuk dëshiron të jetojë në pallate me shumë kate. Këtë nuk e them kot, se, nga sa di unë, edhe gjatë, kur kanë filluar të ndërtojnë «grataciele», shumë njerëz në fillim nuk kanë dashur të banojnë në to.

Si për çdo gjë tjetër, edhe për çdo lloj ndërtimi, është e domosdoshme të kemi parasysh disa caqe. Nuk është e mjaftueshme të themi që kjo ose ajo ndërtesë është për tërë jetën. Kur ndërtohet, për shembull, një teatër, në fillim mund të mendohet se ai do të jetë për një kohë të gjatë, por pas 25 vjetësh, me zgjerimin e qytetit, mund të lindë nevoja të ndërtohet edhe një teatër tjetër i dytë. Atëherë, mos do të themi më vonë përse u ndërtua teatri i parë me kubaturë të vogël?

Natyrisht jo, sepse për kohën kur ai u ndërtua kishte kapacitet të mjaftueshëm, me të cilin shërbeu për 25 vjet me radhë, bile ai do të shërbejë edhe paskëtaj.

Por është e domosdoshme që në punën tonë të kemi gjithnjë e më mirë parasysh që ndërtimet të mos bëhen për sot, po t'u përgjigjen kërkesave edhe për vitet që do të vijnë. Prandaj llogaritë të bëhen me laps në dorë, të studiohen me kujdes të madh jo vetëm për periudha të shkurtra 10-15-vjeçare, por edhe për periudha më të gjata.

Qyteti i Tiranës ka sot rreth 170 mijë banorë¹. Kjo rritje e shpejtë ndodhi për arsye të transformimeve të vrullshme që u bënë pas Çlirimit. Këto transformime po vazhdojnë. Prandaj këtë duhet ta kemi parasysh, bile të parashikojmë sa mund të arrijë brenda 50 vjetëve jo vetëm Tirana, por edhe qytetet e tjera të vendit tonë. Është e domosdoshme të parashikohet, gjithashtu, me baza, në mënyrë të studiuar, se ata njerëz që do të shtohen në Tiranë, do të jetojnë këtu, brenda në qytet, apo gjetkë. Ky problem duhet parë me kujdes, pse gjithë këta njerëz që do të shtohen, nuk mund të qëndrojnë të tërë në Tiranë, se Partia dhe shteti ynë ndjekin edhe një politikë të zhvillimit të qendrave industriale edhe jashtë qyteteve të mëdha, një politikë të zhvillimit të bujqësisë, të fshatrave. Prandaj këto çështje duhen parë në kompleks, duke u mbështetur edhe në eksperiencën e vendeve të tjera.

Në këtë fushë, siç shihet, ekzistojnë një varg pro-

1. Në vitin 1984 numri i banorëve të qytetit të Tiranës arriti në 211 000.

blemesh. Për këtë qëllim nevojiten të përgatiten, siç thashë, njerëz që të studiojnë çështjet e urbanistikës, zhvillimin e popullsisë, demografinë, duke pasur përpara grafikët orientues të zhvillimit perspektiv të industrisë, të bujqësisë, të qyteteve dhe të fshatrave, të mendojnë mbi këtë bazë se si do të bëhet shpërndarja e popullsisë sonë brenda 50 vjetëve. Nga ky studim ne do të nxjerrim konkluzione se ku mund të zhvillohet më shumë industria, si rrjedhim ku do të ketë një rritje më të dendur të popullsisë, brenda kësaj periudhe, dhe deri sa. Nga ky studim do të na dalë edhe se me sa kate do t'i ndërtojmë shtëpitë, nëse në Tiranë do të vazhdojmë t'i ndërtojmë ato brenda vijës së verdhë, që është caktuar para disa dhjetëra vjetësh, apo do ta zgjerojmë ose do ta ngushtojmë më tej këtë vijë. Në këtë mes edhe eksperiencën e vendeve të tjera, që tani luftojnë dhe përpigën të sigurojnë në qytetet e tyre sa më shumë diell, ajër, sa më shumë gjelbërime etj. ta kemi mirë parasysh.

Ekziston një pikëpamje që ndërtimet në Tiranë të bëhen të grumbulluara në qytet. A është e drejtë kjo? Unë mendoj se jo. Dihet se në vendet kapitaliste pranë qendrave të mëdha janë ndërtuar qytete «satelite» me qëllime të caktuara politike, sociale dhe ekonomike. Po ne si do të bëjmë? Do të ndërtojmë qendra të tilla? Edhe kjo kërkon një studim për zhvillimin demografik, zhvillimin e industrisë, të bujqësisë. Po le të vijmë përsëri në Tiranë. Ja ku është Vora, fare afër Tiranës, vetëm 10-15 kilometra i ndajnë. Por Vorës ne nuk i vëmë rëndësi, bile as shumë fshatrave rrotull kryeqytetit jo më larg se 5 minuta, si për shembull, Mëzezit,

ku po bëhen ndërtime të dobëta, kurse në gjithë këto fshatra afër mund të vendoset një pjesë e mirë e popullsisë së kryeqytetit, bile në të ardhmen do të ketë njerëz që do të dëshirojnë të kenë banesat e tyre në periferi. Prandaj, si mund të pranojmë ne pikëpamjen se janë vetëm arkitektët ata që mund të vendosin për këto gjëra?

Në raport theksohet, gjithashtu, ideja që të mos u ndërhyhet arkitektëve në punën e tyre. Po si është e mundur të mos u ndërhyhet, kur vjen puna për t'u vendosur ndërtimi i një objekti të rëndësishëm, apo i një blloku ndërtesash? Në raste të tilla projektet e ndërtimeve urbanistike është e domosdoshme t'u jepen jo vetëm arkitektëve, por edhe specialistëve të tjerë, bile edhe punonjësve që janë të interesuar për to, të cilëve t'u kërkohet të japin mendimet e tyre. Dhe pikërisht këto mendime të përbashkëta e të drejta do t'i realizojnë arkitektët dhe inxhinierët e tjerë. Sigurisht, në punët e arkitektëve dhe të zbatuesve nuk duhet të lejohen ndërhyrjet e paarsyeshme dhe jashtë kompetencave që bëhen nga disa administratorë dhe drejtues, kur vepra ka ndjekur një rrugë normale, kur ajo u përgjigjet kushteve ekonomiko-shoqërore dhe kur kanë dhënë aprovimin për të jo vetëm investitorët, por edhe masat punonjëse të qytetit ku do të ndërtohet ose që do të punojnë në të. Dhënia e urdhrave *ex cathedra*, që të prishet kjo apo ajo pjesë e veprës dhe në vend të tyre të shtohen gjëra të tjera, në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar. Kush ka vërejtje, këto t'i bëjë me kohë, më përpara.

Gjithashtu mendoj se nuk është aspak korrekte

të akuzohet dikush si «konservator» pse shpreh pikëpamjen që të vazhdojmë t'i ngremë ndërtesat e banimit në Tiranë me pesë ose gjashtë kate. Mund të kenë tendenca konservatore në arkitekturë e urbanistikë ata që, nën pretekstin e ruajtjes së monumenteve të vjetra arkitekturore, bëjnë çmos që të ruhen jo vetëm monumentet e vjetra me vlerë, por edhe ndonjë ndërtesë karakteristike e pa vlerë, që s'është nevoja të ruhet. Pra, tendenca e konservatorit është të ruajë çdo gjë të vjetër, duke u nisur nga pikëpamja se me kalimin e kohës ajo bëhet «një antikë», prandaj nuk u dashka prishur, mbasi, sipas tij, brezat e ardhshëm do të shohin në to se si kanë jetuar paraardhësit e tyre.

Prandaj problemet e arkitekturës e të urbanistikës mund të zgjidhen drejt vetëm po të trajtohen në mënyrë shkencore, mbi bazën e studimeve të thelluara e komplekse, aktuale e perspektive, me pjesëmarrjen e gjerë të specialistëve të të gjitha fushave përkatëse, si dhe të punonjësve. Sipas mendimit tim, urbanistika është një shkencë e veçantë, që merret me probleme shumë të gjera, në mes të të cilave arkitektura zë vendin kryesor. Të ndërtosh qytete do të thotë të bësh shkencë dhe shkencë nga më të rëndësishmet. Gjersa për zgjidhjen e çështjeve të urbanistikës, të ndërtimit të qyteteve e fshatrave tona aktivizojmë gjithë këtë masë njerëzish me dituri e kulturë e bashkë me ta edhe popullin, që të kontribuojnë me mendimin e tyre krijues, atëherë urbanistika nuk ka si të mos jetë shkencë.

Desha të theksoj dhe faktin se urbanistika më duket se është edhe ajo si kirurgjia në shkencën mje-

kësore që pastron organizmin nga sëmundjet. Duke i parë në këtë aspekt qytetet, këto ne mund t'i konsiderojmë si njerëzit. Ashtu si bën kirurgjia që pastron e shëron plagët e të sëmurëve, edhe urbanistika shëron «plagët» apo «sëmundjet» e qyteteve, pse edhe këto kanë të këqijat, kanë sëmundjet e tyre, sëmundje të rritjes, të pjekurisë, të pleqërisë. Në to vihen re me kohë gabime e të meta të shumëllojta, të bëra nga ndërtuesit e mëparshëm, që duhen korigjuar. Të gjitha këto në kompleksin e tyre e ka për barrë t'i shërojë urbanistika dhe shërimi në këtë rast bëhet me masa «kirurgjikale». Kuptohet, pra, se kur flasim për urbanistikë, nuk mendojmë vetëm të ndërtojmë një bllok të bukur ndërtesash, po edhe në ç'vend do të ngrihet ai bllok, si do ta rregullojmë ambientin rreth e rrrotull tij, rrugët, objektet social-kulturore, gjelbërimet etj., etj.

Në vendin tonë socialist kemi një avantazh shumë të madh për zhvillimin e një urbanistike moderne, që i përshtatet rendit tonë shoqëror. Ky avantazh është shpronësimi. Në vendet kapitaliste prona private është një pengesë e madhe, pse toka mbi të cilën bëhen ndërtimet është në duar të privatëve, kurse te ne, jo. Prandaj ne i prishim shtëpitë e vjetra që janë amortizuar dhe nuk vlejnë më për banesë dhe në vend të tyre ngremë pallate. Këto shtëpi ne ua vlerësojmë për aq sa çmohen pronarëve, por ka shumë prej këtyre që janë të gatshëm t'i shkëmbejnë ato me apartamentet e reja komode që po ndërtojmë. Kjo ndihmon shumë që urbanistika të zhvillohet te ne në rrugë të drejtë e të përshtatshme.

Dëshiroj të shfaq edhe një mendim, i cili të shikohet me kujdes, se mund të jetë edhe subjektiv, ashtu siç ngjet jo rrallë me shijet tona për të bukurën, në bazë të të cilave dikujt një vepër artistike i pëlqen, kurse një tjetri jo. Po e shpjegoj pak atë që dua të them. A duhen bërë ndërtesat njëlloj, ta zëmë, nga ngjyra, nga forma? Natyrisht, ne duhet ta luftojmë monotoninë dhe uniformitetin në ndërtimet tona, jo vetëm për pamjen e jashtme, por bile edhe në ndarjet e brendshme të tyre. Kjo duhet pasur parasysh në arkitekturë, por këtë të mos e kuptojmë si estetë të sëmurë dhe të kërkujmë që çdo bllok ndërtesash e ca më pak akoma çdo ndërtesë të ketë arkitekturën e vet të veçantë, me rafinime të posaçme dhe me ndarje të brendshme të veçanta. Një prirje e tillë nuk është aspak e përshtatshme për vendin tonë socialist. Unë nuk jam për atë që rrugët e qyteteve tona të mbushen me një tip ndërtesash dhe më duket se edhe te ne janë bërë e po bëhen përpjekje për ta shmangur këtë. Edhe në qoftë se në ndonjë rrugë konstatohet se ka një, dy, tre, apo katër blloqe ndërtesash të njëlllojta, me të njëjtën fytyrë, kjo e ka burimin në arsyet e rritjes, në disa mungesa të përkohshme materiale dhe njerëzore. Kur ne të kemi më vonë forca të tilla ekonomike dhe njerëzore që të mundim të bëjmë diçka më tepër nga sa është bërë deri më sot në këtë drejtim, me siguri nuk do të mungojmë të luftojmë akoma më shumë kundër monotonisë dhe uniformitetit.

A ka të meta në ndërtimet tona? Natyrisht ka, si nga pikëpamja arkitektonike, ashtu dhe nga pikëpamja e ndërtimit. Në ndërtimet duhet të ruhen e të krijo-

hen variacione karakteristike pozitive. Karakteristikat pozitive që ekzistojnë në rrugët e vendit tonë, bashkë me bukurinë e ndërtimeve, në mjaft vende ne duhet e mund t'i ruajmë pa frenuar sigurisht edhe kompleksët e reja të ndërtimeve. Po përse, cilat janë arsytet që duhet t'i ruajmë? Prapë këtu hyjnë faktorët ekonomikë, socialë, të zhvillimit të industrisë etj. Do të kemi ne në vendin tonë atë trafik kaq të madh si në disa vende të botës, ku nga automobilat e shumtë, në vend që të ecet më shpejt, pengohet qarkullimi? Po t'u futemi llogarive, do të na dalë se ne nuk do të kemi një trafik të tillë. Për të lehtësuar transportin e njerëzve në të ardhmen do të shtojmë numrin e autobusëve e të mjeteve të tjera. Tani ne në disa qytete kemi ndërtuar unaza për qarkullimin e mjeteve të transportit, që patjetër nuk janë ideale, prandaj në të ardhmen do të studiohen e do të ndërtohen unaza të reja të dyfishuara për një periudhë të gjatë shumëvjeçare, nëpër të cilat do të kalojnë autobusë, kurse ata që do t'i kenë shtëpitë më afër, do të ecin në këmbë ose me biçikleta, sipas rastit. Bile ecja në këmbë do të bëhet nevojë për njeriun, i cili, kur të mbarojë punën në fabrikë, në uzinë, në shkollë etj., do të dëshirojë të marrë ca ajër të pastër, të kalojë larg tymit të automobilave, të dëgjojë sa më pak zhurmë, të shëtisë nëpër parqe e vende të gjelbëruara, të marrë sa më shumë diell dhe të mos kalojë nëpër hijet e ndërtesave të mëdha.

Edhe komoditeti është një problem studimi sociologjik. Si do të jemi ne pas disa vjetësh në këtë fushë? Ne ndërtojmë tani shtëpi me apartamente, duke

llogaritur disi edhe nevojat e familjeve relativisht të mëdha, me më shumë se një kurorë. Po si do të jetë familja jonë në të ardhmen, do të qëndrojë kaq e madhe? Unë mendoj se jo. Prindërit nuk do t'i thonë si dikur djalit, kur ky detyrohej t'i mbante ekonomikisht, që të qëndrojë me ta, pse si babai, ashtu edhe nëna janë të pavarur, ata e kanë të siguruar pleqërinë, prandaj djali do të kërkojë shtëpi më vete. Po për çfarë shtëpie ka nevojë ai? Ai do të dëshirojë një dhomë për të fjetur, një kuzhinë sa për të gatuar dhe një sallon.

Edhe aktualisht në ndërtimet tona ka vend për përmirësime për të punuar më mirë. Unë jam i mendimit se po të ketë ca fonde të veçanta në dispozicion ndërmarrja komunale, natyrisht jo fonde të mëdha, të cilat të administrohen me ndërgjegje e me plan, mund të bëhet shumë në këtë fushë. Në rast, për shembull, se disa nga ndërtimet e mëdha që kemi bërë me tulla silikate dhe që duken të bardha, lyhen me nga një bojë të përshtatshme të ndryshme, po të spastrohen mirë terrenet rrotull tyre, po të ndërtohen trotualet e të rregullohen vendet boshe, që ekzistojnë akoma, duke u sistemuar me lulishte, megjithëse ky mendim që po hedh mund të jetë edhe subjektiv, kam bindjen se Tirana do të bëhet një qytet akoma më i bukur. Përmirësime të tilla mund të mendohen edhe për ndërtime që janë bërë kohë më parë, ndoshta me më shumë të meta.

Është e domosdoshme të ndjekim me kujdes e hap pas hapi dinamizmin në zhvillimin e vendit tonë. Këtë të mos e harrojmë për asnjë çast. Në tërë punën e

madhe që është bërë te ne, natyrisht, ka edhe ndërtime jo të bukura. Ju e mbani mend, shokë, se në vitet e para pas Çlirimit ne nuk kemi pasur fabrika tullash. Kur shtriheshim atëherë gjer atje ku është sot stadiumi «Dinamo», e konsideronim një sukses të madh që gjetëm mundësinë dhe vendosëm që shtëpitë ku banon sot një pjesë e popullit t'i bënim me baltë të shtypur. Ato shtëpi që u bënë atëherë me atë baltë janë edhe sot, por nga ajo kohë kanë kaluar vite. Gjatë kësaj kohe ndërtesat tona të banimit filluan të ngrihen gjithnjë e më të mira, kurse sot ndërtohen gjithnjë e më komode, më higjienike, më të bukura. S'ka dyshim që nesër ato do të ndërtohen akoma më të bukura, sepse sa kalon koha, ne fitojmë eksperiencë, pastaj shteti ynë disponon e do të disponojë mundësi gjithnjë e më të mëdha materiale. Po vallë, do të prishim ne disa nga ato shtëpi që kemi ndërtuar vetë? Patjetër do të ketë edhe nga ato që do të prishen. Po kur, pas sa vjetësh? Natyrisht, këtë nuk e caktojmë dot. Tani ne vazhdojmë të prishim njëherë të gjitha ato vjetërsira, karakatina, plagët e qytetit të vjetër të Tiranës dhe të qyteteve të tjera. Kjo është absolutisht e domosdoshme të bëhet. Po të mohojmë këtë, do të thotë se nuk e kuptojmë si duhet urbanistikën, nuk e konsiderojmë atë edhe si «kirurgji».

Të vijmë tani te çështja: kush merret me studimin e planimetrisë, për shembull, të Tiranës ose edhe të qyteteve të tjera? Kush qëndron ditë e natë mbi këtë plan që të studiojë me kujdes ndërtimet në çdo rrugë dhe të propozojë ato të cilave u vjen radha të prishen, vjetërsirat që duhen zhdukur më parë, sipër-

faqen që përfitohet prej tyre, çfarë lloj shtëpish janë të përshtatshme të ngrihen në këtë ose në atë rrugë dhe me sa kate, katër, pesë apo me shtatë kate etj.? Mua më duket që sot nuk ka një organ që e bën me kompetencë këtë punë, nuk ka një organizëm të domosdoshëm që të punojë për këtë qëllim. Kur vjen fjala për një organizëm të tillë, duhet menduar drejt si ta krijojmë, por jo me ndonjë organikë të fryrë. Po të mendojmë e të veprojmë në këtë mënyrë, do të thotë nuk jemi në rregull. Siç tha edhe shoku Manush Myftiu, krijimi i këtij organi është absolutisht i domosdoshëm. Ky organ mund të ishte instituti i urbanistikës për gjithë Shqipërinë, ndërsa Tirana apo çdo qytet tjetër mund të ketë nga një zyrë të vet të urbanistikës. Ata që do të punojnë në këtë institut, është e domosdoshme të kenë të qarta parimet, ku do të ndërtojnë, përse do të ndërtojnë dhe si duhet të ndërtojnë. Të ndërtojnë pastër, mirë, me ajër, që kudo të kemi ndërtime të lehta, të bukura, komode dhe me kosto sa më të lirë. Të gjitha këto që përmenda na shtyjnë që në ndërtime të ecim me plan dhe jo kuturu.

Këto kisha unë rreth problemit që na është paraqitur. Thashë disa mendime, të cilat janë më shumë disa vërejtje shoqërore, prandaj shokët le t'i shikojnë në mënyrë kritike, t'i diskutojmë dhe të gjejnë rrugët më të përshtatshme për t'i zgjidhur.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për shkencën (Përmbledhje vepërash)», vëll. I, f. 460

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Për shkencën (Përmbledhje vepërash)», vëll. I, f. 460

NË PUNË DUHET TË KETË KËRKESË TË FORTE LLOGARIE DHE SHPËRBLIM TË MERITUAR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

27 mars 1972

Jam dakord me mendimet që shprehën shokët në diskutimet e tyre, për të forcuar punën tonë, në mënyrë që dispozitat në fuqi të zbatohen me rigorozitet. Në fakt, në ligjet tona parashikohen masa ndëshkimore kundër atyre që thyejnë disiplinën, por ato përgjithësisht nuk po zbatohen, veçanërisht për punonjësit e administratës. Jo vetëm kaq, por ka punonjës të administratës që disiplinën e thyejnë më tepër se disa punëtorë, kur dihet se dëmi që shkaktohet prej tyre është me pasoja më të rënda sesa ai që vjen nga punëtorët. Mirëpo, për drejtuesit e ndërmarrjeve, të institucioneve dhe të organizatave, si dhe për punonjësit e administratës, nuk zbatohen kurdoherë sanksionet

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth relacionit lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit në fuqi për forcimin e mëtejshëm të disiplinës.

e parashikuara nga ligjet në fuqi. Kjo nuk është e drejtë.

Tani, në rast se vendosen sanksione të tjera përveç atyre që kemi, punëtorët kanë të drejtë të na tërheqin vëmendjen: «Përse nuk po zbatohen mirë ligjet në fuqi?». Përse nuk zbatohen masat disiplinore për ata punonjës të administratës që, ta zëmë, nuk u sigurojnë atyre materialet e duhura për të punuar normalisht etj., ndërsa kundër punëtorëve forcohen në mënyrë të njëanshme akoma më tej? Ne nuk jemi në gjendje t'u argumentojmë punëtorëve se ligjin e kemi zbatuar me të njëjtën rreptësi edhe ndaj nëpunësve. Kjo tregon se nuk jemi aspak në rregull me zbatimin e legjislacionit ekzistues. Pikërisht këto anë të çështjes nuk janë parë mirë.

Ligjet tona socialiste janë njëlloj të detyrueshme për të gjithë; zbatimi i tyre është kusht i domosdoshëm për forcimin e disiplinës në të tëra aspektet e saj. Mund të themi se kjo çështje parimore nuk është parë si duhet që nga baza e deri në qendër. Edhe në studimin e bërë për përgatitjen e këtij relacioni, problemi nuk është analizuar nga të tëra anët. Që duhet vënë rregull, që duhet vendosur disiplinë kudo, shokë, për këtë s'ka e s'duhet të ketë asnjë ngurrim. Nuk mund t'i hidhet ujë verës, duke thënë se «rregulli e disiplina janë futur thellë në ndërgjegjen e çdo punonjësi». Sipas mendimit tim, në të gjitha drejtimet e jetës sonë janë realizuar suksese të mëdha; ka përpjekje, bëhen edhe sakrifica. Por, çështja është që nga këto përpjekje e sakrifica, nga kjo punë e palodhur e punonjësve tanë, ne mund dhe duhet të kishim re-

zultate akoma më të mëdha, në rast se do të merrnim masa me kohë për të shmangur disa të meta në punë.

Kur shqyrtojmë të metat që duken në fushën e disiplinës dhe të ndërjegjes në punë, duhet të jemi shumë të saktë në konkluzionet që japim. Për shembull, përse llogaritet në humbjen e kohës së punës leja që merr gruaja për barrën, lindjen ose për fëmijën e sëmurë? Derisa kjo e drejtë i është njohur nga ligji për sigurimet shoqërore e shtetërore dhe nga Kodi i Punës, në asnjë mënyrë nuk duhet të futet në llogari ky pushim, duke e konsideruar kohë të humbur nga puna. Po të ishte kështu atëherë duhej llogaritur edhe leja e zakonshme e punëtorëve. Leja e barrës dhe e lindjes nuk duhet zënë në gojë fare, ashtu sikundër nuk përmendim lejën që u jepet për pushim punëtorëve. Nuk kam dëgjuar ndonjëherë të bëhet fjalë se kemi humbje nga lejet që u jepen për pushim punëtorëve, të themi, një milion orë, prandaj çuditëmi pse na del tani leja e lindjes që marrin gratë punëtore. Përveç kësaj, çështjen, më duket mua, nuk duhet ta fillojmë nga klasa punëtore. Nuk e kam fjalën këtu vetëm për mbrojtjen e parimit, sepse të tërë ne jemi komunistë dhe qëndrojmë në pararojë të klasës, prandaj nuk kemi frikë t'i shohim gjërat ashtu siç janë. Por, e vërteta është se janë disa nëpunës që të parët thyejnë disiplinën. Drejtoria dhe administrata e ndërmarrjes marrin masa kundër punëtorëve, kur nga ana e këtyre vërtetohen thyerje të disiplinës; kur nxjerrin prodhime të cilësisë së dobët etj. Në raste të tilla punëtorëve u bëhen ndalesa në pagë. Po zëvendësministrat, drejtorët qendrorë dhe drejtorët e ndërmarrjeve kush

i ndëshkon për moszbatimin e detyrave? Qeveria do të mblidhet orë e çast për këtë punë? Natyrisht, Qeveria nuk ka mundësi ta bëjë një gjë të tillë. As drejtuesi nuk mund ta detyrojë veten të paguajë dëmin e shkaktuar nga pakujdesitë apo veprimet e tij të paligjshme, ai mund të kufizohet me një autokritikë, sa për të kaluar radhën, po veten nuk e ndëshkon. Atëherë, duhet gjetur rruga si të veprohet.

Arbitrazhin që kishim pranë Këshillit të Ministrave e hoqën, duke menduar se konfliktet për çështjet civile që shqyrtoheshin më parë prej tij do të ishte më mirë t'ua kalonin në kompetencë gjykatave¹. Këto do të ndikonin më tepër për forcimin e disiplinës në zbatimin e përpiktë dhe në kohën e duhur të të gjitha akteve të planifikimit të ekonomisë popullore nga ana e organizatave ekonomike. Mirëpo, në praktikë, vërehet se institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat shtetërore ose shoqërore nuk i përcaktojnë kurdoherë mirë dhe qartë detyrimet reciproke kontraktuale, sepse nuk e vlerësojnë kontratën si mjet që harmonizon parimin e planifikimit me parimin e hozrashotit dhe nuk e njohin sa duhet legjislacionin në fuqi. Por, edhe kur kontratat lidhen me kujdes, vërehet se palët nuk i respektojnë gjithmonë detyrimet e tyre, gjë që është tepër serioze, sepse ndikon për keq në zbatimin e planit ekonomik të shtetit. Në këto rrethana, gjykatat, kur shqyrtojnë paditë për pagimin e gjobës ose të kushtit penal etj., të mos e kufizojnë detyrën e tyre

1. Arbitrazhi Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave funksionon përsëri duke filluar nga data 10 nëntor 1972.

vetëm në zgjidhjen e një konflikti thjesht pasuror, ose në pajtimin me çdo kusht të palëve në grindje, por, kur është rasti, të vënë para përgjegjësisë ligjore ata persona zyrtarë që bëhen pengesë në zbatimin e detyrave të planit.

Për të gjykuar drejt dhe shpejt konfliktet civile dhe për të nxitur ndërmarrjet për respektimin rigoroz të ligjeve, është e nevojshme dhe e domosdoshme që gjykatat e rretheve të bëjnë më tepër përpjekje për t'u njohur më mirë ata vetë me ligjet, dekretet, vendimet, urdhëresat dhe aktet e tjera që rregullojnë marrëdhëniet e shumta në fushën ekonomike. Në qoftë se nuk i njohim këto të meta dhe nuk marrim masa për t'i mënjanuar ato, s'kemi të drejtë të akuzojmë klasën punëtore. Lëshimet nga ana e disa drejtuesve nuk duhen parë me tjetër sy, duke u përpjekur të ngarkohen më shumë me faj punëtorët.

Forcimin e mëtejshëm të disiplinës në anëtarët e Byrosë Politike dhe anëtarët e Qeverisë, ta kërkojmë, në radhë të parë, te vetja jonë. Mos vallë bëjmë edhe ne me dashje lëshime në zbatimin e rregullave? Jo. Ne jemi plotësisht të ndërgjegjshëm dhe luftojmë me të gjitha forcat që të mos na vërtetohen në asnjë rast thyerje të disiplinës. Por fakt është që të tilla shfaqje vërehen edhe në punën tonë. Megjithëse përsëritim vazhdimisht që «disiplina e planit është ligj» nganjëherë ka raste që ne vetë nuk e zbatojmë planin. Ju, anëtarët e Komitetit Qendror, Pirro Dodbiba, Koço Theodhosi, Kiço Ngjela e të tjerë, nesër në mbledhjen e Qeverisë do të kritikoheni pikërisht për thyerje të disiplinës së planit. Për ç'arsye disa

shokë të Qeverisë, një tog çështjesh, që mbase nuk janë parashikuar drejt në plan, «i rregullojnë» me një të rënë të kalemit, siç ka ndodhur duke dhënë 30 apo 40 milionë lekë më tepër nga sa janë caktuar në plan për Hidrocentralin e Fierzës? Ku e gjetën këta shokë gjithë këtë fond kaq të madh? Kur pyeta për këtë çështje, ma paraqitën si diçka fare të thjeshtë dhe m'u përgjigjën se këtë çështje e paskan zgjidhur duke bërë krehje në disa objekte që, sipas tyre, paska mundësi të mos ndërtohen. Po kush e tha fjalën e fundit që të mos ndërtohen këto objekte, të cilat ne i kemi vendosur kolegjisht në plan? «Po, ja, — më thanë ata, — parashikohet që ato të mos ngrihen se nuk ka materiale» etj. E shikoni, shokë, si fillon të thyhet plani që këtej, nga ne, pavarësisht se parullën: «Plani është ligj» e përsëritim çdo ditë!

Ne kemi dhënë një orientim të drejtë, që të mos shpërndahemi në shumë ndërtime dhe investime, të cilat, me mundësitë e tanishme, nuk jemi në gjendje t'i kryejmë dot. Prandaj, dëshirës së madhe të rrethëve dhe të bazës për më tepër ndërtime e investime, i ramë me kosë, duke bërë mjaft shkurtime në këtë drejtim. Më shumë nuk mundëm të shkurtojmë. Mirëpo shoku Spiro [Koleka] më tregoi se, me rastin e përcaktimit të kompetencave të dikastereve, qenka marrë një vendim në Qeveri, sipas të cilit fondet mund të kalojnë nga një vepër në një tjetër. Unë nuk jam kundër dhe nuk them që të mos bëhen transferime fondesh, gjersa në parim kemi qenë dakord që në investime e në ndërtime, për arsytet që thamë, të punojmë në mënyrë të përqendruar. Mundet, fjala vjen,

të qëllojë, për një arsye a për një tjetër, që një studim të mos jetë bërë i saktë ose, më vonë, të na dalë një vështirësi për kapërcimin e së cilës duhet të marrim medocemos masa. Këtë e kuptoj fare mirë, sepse si të gjithë edhe unë rroj me vështirësitë e mëdha që kemi. Gjëra të tilla ka mundësi të ndodhin. Atëherë ç'do të bëjmë ne para këtyre rasteve? Patjetër që duhet të bëjmë diçka; punën nuk mund ta lëmë në mes të rrugës. As do të mbahemi vetëm pas arsyes se «kështu qenka vendosur të veprohet, prandaj nuk lejohet të bëhen ndryshime». Natyrisht, kur jeta, nevojat dhe zhvillimi ynë diktojnë probleme të reja, ne nuk mund të mos e shqyrtojmë gjendjen e krijuar. Vetëm të mos harrojmë që para se të vendosim për të ndryshuar diçka, duhet të na paraqiten mirë të gjitha arsyet dhe nevojat që na diktojnë rishqyrtimin e një problemi. Në këtë drejtim lypset një rigorozitet i madh. Si mund të lejohet, me kaq lehtësi, t'i vihen gërshërët, fjala vjen, jo pak, po 40 milionë lekëve në disa objekte, për t'ia dhënë këto një tjetri?! Po të shkohet në këtë rrugë, atëherë, fare lehtë dhe pavarësisht nga ajo që themi e që duhet respektuar plotësisht se «plani është ligj», edhe drejtori i naftës ka rrezik të vendosë me mendjen e tij që të harxhojë përtej planit një mijë apo dhjetë mijë litra karburant.

Tani dëshiroj të them mendimin tim përse ndodhin këto gjëra. Këto kanë lidhje me përcaktimin e kompetencave, për të cilat po flasim ngaherë. Është me vend masa që morëm për t'u dhënë organeve varëse sa më shumë kompetenca, jo vetëm në letër, por në fakt. Sado që e përsëritim vazhdimisht nevojën e

dhënies të sa më shumë kompetencave, nga qendra në rrethe e nga rrethet në bazë, në të vërtetë në këtë drejtim kemi mjaft të meta. Nuk mjafton vetëm t'u japim kompetencat organeve vartëse por, krahas atyre, t'u japim edhe përgjegjësitë. Megjithatë, as dhënia e kompetencave dhe e përgjegjësisive nuk mjafton, po të mos u kërkohet llogari gjer më një atyre që u jepen kompetencat e të mos ndiqet si i zbatojnë detyrat e ngarkuara. Pikërisht këtë ne nuk e bëjmë mirë, gjë që vjen, sipas mendimit tim, se në marrëdhëniet midis eprorëve dhe vartësve ka familjaritet.

Para 5-6 vjetësh ne bëmë një riorganizim nëpër dikastere. Në krye të çdo ministrie dihet se qëndron ministri. Pastaj, pranuar të ketë 1-2 zëvendësministra dhe drejtorët, kurse shefat dhe një varg postesh në organikat, duke i quajtur si hallka të tepërta, i shkurtoam për të luftuar kështu një nga shfaqjet e burokratizmit, siç është fryrja e aparateve. Mirëpo, konstatojmë se aparatet tani përsëri janë rritur. Siç tha shoku Haki Toska, vetëm në 6 dikastere (të Industrisë, Bujqësisë, Ndërtimit, Komunikacionit, Tregtisë dhe Komunales) nga viti 1966 në vitin 1972 numri i punonjësve është rritur afro 50 për qind. Kjo është katastrofike! Direktiva ishte që dikasteret të shkurtohen, ndërsa këtu, me sa po marrim vesh, është vepruar në të kundërtën. Po përse të na ndodhë kjo, derisa për këtë problem ekziston një vendim, i cili s'ka shumë kohë që është marrë? Sepse në vetë organet qendrore disiplina merret si një slogan, thyhet si pa gjë të keq dhe bëhen përpjekje që mosrealizimi i detyrave të mbulohet me mungesën e njerëzve nëpër aparatet, në

vend që të ngulet këmbë për kërkimin me rreptësi të llogarisë ndaj vartësve, që, sipas mendimit tim, nuk bëhet në shkallën e duhur, për arsye se nëpër ministritë tona, siç thashë, ka shfaqje të familjaritetit.

Ministri i Bujqësisë, edhe pse nuk ka drejtpërdrejt përgjegjësi për një sërë ndërmarrjesh bujqësore që dalin vazhdimisht me humbje, prapëseprapë ai ka katër zëvendësministra në vartësi, të cilët duhet të përgjigjen për këtë. Megjithatë, as ata nuk mund të jenë përgjegjës për të gjitha të metat në sektorët e punës që mbulojnë, por ata prapë duhet të përgjigjen. Dihet se cilido prej zëvendësministrave ka në vartësi dy-tri drejtori: njëri, ta zëmë, drejtorinë e bujqësisë dhe drejtorinë mekanike, tjetri të planit, të ujërave, të blegtorisë etj. Edhe këta drejtorë duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë dhe të drejtpërdrejtë për çdo mosrealizim që vërtetohet në sektorët ku punojnë. Drejtori i drejtorisë mekanike duhet të mbajë përgjegjësinë për mekanikën bujqësore të të gjithë Shqipërisë; atij i takon të japë llogari për tërë gamën e detyrave që i janë ngarkuar, prandaj duhet të jetë një nga organizatorët më të zotë për punën e tij, saqë asgjë të mos i shpëtojë nga syri. Dhe, kur ndodh diçka, të marrë masa dhe të përgjigjet me seriozitet për çdo gjë që ka të bëjë me sektorin e tij. Mirëpo ç'ndodh? Kur pyet njërin apo tjetrin punonjës të dikasterit, për një problem të caktuar, shpeshherë të thotë: «Nuk e di këtë, nuk e di atë». Sigurisht ministri nuk është e mundur të dijë çdo gjë dhe t'i përgjigjet çdo pyetjeje, por, disa herë qëllon që edhe personi që e ka për detyrë të njohë gjendjen e sektorit të tij, bile deri në hollësi (si

zëvendësministri dhe sidomos drejtori, specialisti etj.), nuk është në gjendje të japë shpjegime për çështjen që pyetet.

U fol këtu se janë prodhuar traversa jashtë standardit, dhe se ato nuk janë prerë e staxhionuar me kohë. Disa shokë thanë se «fajin për këtë e kemi ne, që nuk i planifikuam me kohë» e të tjera. Nuk duhet thënë gjithnjë «ne», «ne». Gabimi që u ndahet të gjithëve nga pak është si puna e vajit që bie në lakra dhe përhapet nga një çikë kudo. Prandaj, duhen përcaktuar qartë cilët kanë faj. Ndryshe nuk do të jemi në gjendje të gjejmë pengesat, njerëzit që pengojnë dhe do të mbetemi në vend. Shoku Jashar Menzelxhiu tha se kjo ndodh ndonjëherë ngaqë nuk njihet teknologjia dhe, për pasojë nuk bëhet një planifikim i saktë i prodhimit. Po kush nuk e njeh teknologjinë? Ç'bën teknologu atje, apo qëndron në punë sa për të marrë rrogën?! Konkretisht, e dini mirë ju që sektorët e planifikimit të ministrive nuk e kanë bërë me kohë planifikimin për prerjen e traversave? Në qoftë se na flitet me kompetencë, ne jemi gati «t'i kapim për veshi» personat zyrtarë që kanë neglizhuar.

Vihet re se kur drejtuesve të bazës punët në ndërmarrje nuk u venë mirë, ka prej tyre që venë para ministrit si në dasmë dhe nuk u «dridhen aspak këmbët» për përgjegjësinë e madhe që mbajnë. Kjo tregon se ka raste që midis tyre është krijuar një familjaritet i sëmurë dhe është zbutur kërkesa e llogarisë. Unë nuk them se vartësit nuk vihen fare përpara përgjegjësisë, por fakt është që kjo nuk bëhet në shkallën e duhur. Prandaj, kur pyetet, ta zëmë, drejtori i

drejtorisë mekanike, se si shkojnë SMT-të, ai është gati të raportojë me formula të përgjithshme se «çdo gjë shkon mirë», se «punohet kështu», «punohet ashtu», kur, në fakt, nëpër SMT-të na ndodhin ngjarje të padëshirueshme, që provon se ai nuk e njeh si duhet gjendjen. Kështu, pa përgjegjësi dhe me «urtë e butë», nuk duhet lejuar të ecet. Në punë duhet të ketë kërkesë të fortë llogarie.

Çdo vit, për ndërmarrjet bujqësore, ne sjellim mekanizma të ndryshëm, për të cilët bëjmë investime e ndërtime që na kushtojnë miliona lekë. Megjithatë, ka nga ato që dalin me deficite. Prandaj, në qoftë se gjatë këtij pesëvjeçari, nuk e sigurojmë vetë bukën, në qoftë se nuk e zhvillojmë bujqësinë sipas parashikimeve të Partisë, në qoftë se njerëzit, që nga dikasteri e deri në bazë, nuk organizojnë punën si duhet dhe nuk vihen para përgjegjësisë për detyrat e ngarkuara, atëherë mund të themi me të drejtë se në këtë degë me rëndësi të ekonomisë bëjmë punë pak e llafe shumë. Duhet të vlerësohen drejt këto çështje, secili t'i kuptojë e t'i kryejë me përgjegjësi detyrat e ngarkuara, marrëdhëniet shoqërore të mos konfondohen aspak me marrëdhëniet e rregullta në punë.

Përse të mos ngrihet të flasë në mbledhjen e një kooperative bujqësore, ta zëmë drejtori i bujqësisë ose i blegtorisë të ministrisë, i cili, me këtë rast, të japë atje llogari për zbatimin e detyrave që i janë ngarkuar? Kur bëhet mbledhja e punonjësve të një stacioni makinash e traktorësh punëtorët të ngrihen e t'u kërkojnë shpjegime jo vetëm përgjegjësve të ndërmarrjes së tyre, po edhe drejtorit të drejtorisë mekanike të mi-

nistrisë, i cili të japë llogari para tyre. Dhe, çfarë llogarie se?! Edhe ministri t'i kërkojë këtij drejtori të vejë e të përgjigjet para masës, si i ka kryer detyrat. Po të veprohet në këtë mënyrë, atëherë tjetri, kur sheh se përgjegjësi u bën lëshime vartësve me të cilët bashkëpunon, nuk inkurajohet për të folur dhe kështu kritika, edhe kur bëhet, nuk gjen jehonë.

Shumë vazhdojmë të flasim për kompetenca, për përgjegjësi, për kërkesë llogarie etj., etj. Diskutime për këto çështje mund të bëjmë sa të duam. Por, në qoftë se kooperativistët nuk paraqiten rregullisht e në kohë në punë, ato që themi nuk vlejné asgjë. «Arsyetimi» se ata që nuk dalin në punë janë disa kooperativistë të rinj, nuk mund të justifikojë mungesat e disiplinës dhe të organizimit.

Punës t'i qëndrojmë mirë në krye, qysh këtu te ne, në organet qendrore. Të marrim, për shembull, Ministrinë e Industrisë e të Minierave. Një nga zëvendësministrat e saj, ta zëmë, ka në vartësi drejtoritë e industrisë së lehtë. Mirëpo, kur nuk ecën si duhet ndonjë nga problemet e këtij sektori, fjala vjen, shfrytëzimi i makinerive të atyre linjave e fabrikave që qëndrojnë kot me vite, çështja serviret deri në udhëheqje për t'u zgjidhur. Puna arrin deri atje sa «t'i kërciten dhëmbët» ministrisë për një neglizhencë të tillë. Për këto çështje përgjigjet jo vetëm ministri, por edhe bashkëpunëtorët e tij të afërt, që nuk kryejné si duhet detyrat. Për dobësitë në punë duhet të përgjigjet kryesisht personi që drejton një sektor të caktuar në dikaster, zëvendësministri, drejtori e kështu me radhë. Prandaj, është e domosdoshme që në çdo hallkë të

vëmë disiplinë të fortë e t'u jepet fund lëshimeve e familjaritetit. Njerëzit të marrin përsipër kompetencat e përgjegjësitë që u takojnë dhe të punohet për zbatimin e tyre të përpiktë.

Mua më duket që s'ka mbledhje të Byrosë Politike e të Qeverisë ku nuk bëjmë kritika, bile shumë të rrepta dhe të ashpra. Unë jam i bindur që këto bëjnë shumë efekt, pasi shokët e udhëheqjes së Partisë e të shtetit, drejtuesit në dikastere, zëvendësministrat, drejtorët në ministri dhe drejtuesit në bazë, në ndërmarrje e kudo, i kuptojnë drejt kritikën, pse janë njerëz partie, me stazh të vjetër në punë, të ngritur politikisht e ideologjikisht dhe i vlerësojnë siç duhet detyrat e ngarkuara. Por, kuadrove dhe organeve, zëvendësministrave, drejtorëve dhe gjithë të tjerëve me radhë pas tyre, siç vura në dukje, ne nuk u japim të gjitha kompetencat që u takojnë dhe, krahas kësaj, nuk i vëmë mirë para përgjegjësisë. Në këtë drejtim shembulli pozitiv duhet të jepet nga lart poshtë. Nuk është çështja t'i zgjidhim problemet vetëm duke i ndëshkuar kuadrot me masa disiplinore apo materialisht, megjithëse, në bazë të ligjit, këta, kur është rasti, duhet të përgjigjen edhe në këto drejtime. Por, më parë, të bëhen përpjekje për përmirësimin e metodës së punës, për t'i ngarkuar me përgjegjësi, pastaj t'u kërkohet llogari seriozisht. Me vendosjen kudo të një discipline të fortë, me rritjen e frymës së përgjegjësisë e të dhënies së llogarisë deri në bazë, ne do të kemi një përmirësim rrënjësor në tërë këtë gamë të madhe problemesh që na vihen përpara për të zgjidhur, ndryshe lind shthurja. Këtë ta kuptojmë mirë të gjithë.

Le të marrim, për shembull, cilësinë e studimeve që bëhen herë pas here. Përse disa herë na dalin të cekëta këto studime? Sepse nuk vihen sa duhet në lëvizje njerëzit që merren me to dhe prandaj zgjidhjet që jepen janë të çala e me të meta serioze. Kush na siguron se edhe studimi që do të na sjellë Ministria e Financave pas një muaji, për çështjen e pagave të punëtorëve, nuk do të jetë i cekët? Këtë e them, pse, siç doli këtu, kjo ministri nuk e ka vënë si duhet në lëvizje një drejtori me peshë aq të madhe, siç është ajo e pagave, nuk i ka vënë para përgjegjësisë këta kuadro për këtë problem shumë të rëndësishëm. Jo vetëm kjo, po unë vë edhe pyetjen: Çfarë bëjnë gjithë këta financierë në ndërmarrjet ku janë caktuar të kontrollojnë lekun, të kontrollojnë financat dhe t'u vënë kufi të gjitha atyre veprimeve të parregullta që bëhen andej-këtej? Në këto kushte çfarë «luleje»¹ do të na sjellë kjo ministri në maj? Unë uroj që ajo «lule» të jetë e shëndetshme. Por, në qoftë se financierët nuk do të jenë vazhdimisht, ditë e natë, të preokupuar për problemet e financave, në qoftë se atyre nuk u bëhet e ditur se do të japin llogari përpara Partisë dhe eprorëve të tyre, detyrën e ngarkuar, studimin që do të bëjnë, do ta nxjerrin të çalë e me të meta serioze.

Në qoftë se ne do të rregullojmë mbi baza të studiuara kategorizimet dhe pjesën më të madhe të

1. Është fjala për studimin lidhur me shpërblimet sipas kategorisë dhe vendit të punës, që do të bëhej nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Ekonomike dhe që ishte caktuar të paraqitej për shqyrtim në muajin maj të atij viti.

normave, masa që do të marrim, do të luajë një rol të rëndësishëm në rritjen e sasisë dhe të cilësisë së prodhimit. Këtu duhet të kemi parasysh edhe çështjen që u ngrit se përderisa normat janë të ulëta, punëtori, edhe po të thyejë rregullat, duke munguar nga puna pa arsye me një sforcim jo të madh gjatë ditëve të ardhshme, mund ta vërë lehtë në vend pagën e humbur. Prandaj problemi do parë në kompleks.

Nuk them se s'kemi bërë ndryshime në drejtim të normimit të punës, po pyes: Përse nuk na kanë dhënë një zgjidhje të drejtë këto ndryshime që kemi bërë vazhdimisht herë pas here? Në këtë drejtim, më duket se specialistët tanë, që merren me studimin dhe përpunimin e këtyre çështjeve, i konsiderojnë ato si jashtë sferës së veprimtarisë së tyre, domethënë, këto probleme nuk i shohin si duhet me një ndërgjegje të lartë dhe me përgjegjësi të madhe shtetërore.

Siç e kam thënë edhe herë tjetër, ne duhet të mbarojmë një herë e mirë punë me normat eksperimentale-statistikore. S'ka asnjë arsye përse të ketë më norma të tilla, që 27 vjet me radhë të vazhdohet të quhen «eksperimentale». As normat progresive që ekzistojnë nuk mund të vendosen një herë e përgjithnjë; edhe atyre nuk mund të mos u bëjmë ndryshime e të biem, si të thuash, në gjumë, sikundër kemi bërë gjer tani. Ndryshe, përse i kemi normistët? Vallë për t'u bërë qejfin disa punëtorëve jo shumë të ndërgjegjshëm që kërkojnë të futim disa lekë më shumë në xhep? Jo, ata janë vënë për t'i shërbyer pushtetit të punëtorëve, pra, vetë klasës punëtore, pse kështu do të sigurojmë më shumë e më shpejt banaşa, ushqime dhe vesh-

mbathje për të gjitha masat punonjëse. Prandaj, ata që merren me studimin e me zbatimin e normave, duhet të jenë njerëz të klasës, ta mbështetin klasën, por në rrugën e klasës dhe jo sipas pikëpamjeve mikroborgjeze, duke mbyllur sytë para realitetit me zbatimin e disa normave që s'janë më të kohës.

Pse them që s'janë të kohës? Sepse aktualisht, niveli ynë teknik, në çdo sektor, është ngritur dhe në procesin e punës janë futur pajisje e makina të reja. Në këto rrethana, si mund të qëndrojmë ne përsëri në normat progresive, duke mënjanuar pa asnjë arsye zbatimin e normave teknike? Ne do t'i vendosim normat teknike dhe do t'i përcaktojmë mirë proceset e punës ku do t'i zbatohet ato. Pastaj, do të vemi e t'u themi punëtorëve: «Këtë e bëme, pse kështu e lypin kushtet e punës, interesat e përgjithshëm dhe interesi juaj. Ne, drejtuesit dhe tërë nëpunësit e administratës, po të thoni ju, jemi gati t'i ulim akoma pagat tona, por normat teknike duhen vendosur, se ato janë për interesat e klasës, të punonjësve». Kjo është rruga e drejtë që njerëzit të përmirësojnë më tej kushtet ekonomike e materiale, që t'i blejnë sendet e jetesës më lirë, më të mira etj. Ndryshe, po t'i lëmë normat siç janë, do të futemi në një rrugë tjetër shumë të keqe: në ngritjen e çmimeve, në inflacionin e mone-dhës e të tjera, por këto ne nuk i lejojmë në asnjë mënyrë.

Nuk është e drejtë të mendohet se po të vihen në fuqi normat teknike, do të zemërojmë klasën punëtore. Pse do të zemërohet klasa, kur këto punë i bëjmë për të mirën e saj? Natyrisht, veprimet tona lidhur me

normat duhet t'i bëjmë drejt, me afate dhe të studiuara.

Pra, punën e normave duhet ta rregullojmë. Edhe kategorizimet duhet të ndreqen absolutisht brenda afatit që është caktuar. Ne nuk duhet të japim asnjë afat tjetër për këto çështje. Unë mendoj që pagesa e secilit të caktohet sipas kualifikimit personal e jo sipas kategorisë së vendit të punës. Punëtori që është i kategorisë së parë, ai i kategorisë së dytë, e kështu gjithë të tjerët me radhë, duhet të paguhet për kategorinë që mbajnë. Kështu, punëtori i kategorisë së dytë, në rast se caktohet të punojë në një vend ku kërkohet të jetë i një kategorie më të lartë, duhet të paguhet sipas kategorisë personale dhe jo sipas asaj të vendit. Kur ndonjëri shihet se nuk bën përpjekje ta fitojë me djersë kategorinë e vendit të punës, të zëvendësohet sa më parë me një tjetër që ka kategorinë përkatëse. Po të ketë vend për kategorinë e dytë, mirë; ndryshe, gjersa nuk ka bërë përpjekje për kualifikimin e tij profesional, të vejë sipas aftësisë atje ku të ketë punë republika. Ne duhet ta zbatojmë kudo parimin socialist të shpërblimit sipas punës. Secili të paguhet për aq sa i jep shoqërisë, jo më tepër. Kushdo që dëshiron më shumë, le të punojë e të mësojë më tepër, askush s'e pengon. Për këtë të tëra portat janë hapur nga Partia.

Duhet të vëmë rregull e disiplinë e të rritim kërkesat edhe ndaj njerëzve që përgatitin e kualifikojnë punonjësit tanë. Në këtë çështje të mos lejohet të bëhet një punë formale, duke kaluar njerëzit në kategori më të lartë pa kurrfarë perfeksionimi, pa e merituar.

A janë vallë në interes të klasës këto qëndrime? Është fare e natyrshme që, po të vazhdohet me këtë

metodë pune, punëtori i kategorisë më të lartë do të thotë: «E përse të vete unë në shkollë, kur s'më rritet rroga?». Duke u nisur nga ky mendim, ai që ka 20 vjet në punë, nuk do të bëjë më një punë të kualifikuar, kur të shikojë që punëtorë fare të rinj i janë afruar në pagë. Këto situata çojnë në një çrregullim të madh, në një qëndrim jo të ndërgjegjshëm ndaj punës.

Nuk i tërheq vëmendjen Ministrisë së Financave ose atij financierit të ndërmarrjes, që po ha bukën e shtetit, fakti se në këtë ose në atë ndërmarrje po bëhen gjithë këto shkelje të rregullave dhe orientimeve të dhëna? Financa duhet të ngrejë zërin e të thotë: «Këtu normat duhet të ngrihen 20 për qind ose 25 për qind». Çfarë kontrolli bëjnë tërë këta financierë ndaj atyre që e hanë bukën kot? Do të lejojmë ne që të veprohet në këtë mënyrë? Jo, nuk duhet të lejojmë më gjëra të tilla! Prandaj, çështjen e normave, të kategorive, të njerëzve me diplomë e pa diplomë, çështjen e shpërblimit të punës me turne e të tjera si këto, duhet t'i rishikojmë me kujdes e të vendosim kritere më të drejta, se vetëm me propagandë nuk zgjidhen këto probleme.

Partia kërkon të ndreqen këto çrregullime, të forcohet disiplina e planit e të tjera. Pasi t'i përcaktojmë drejt rregullat, të marrim masa për të kontrolluar me rreptësi zbatimin e tyre. Nuk e zgjidh problemin shprehja që na thuhet se «e kemi konstatuar me kohë që këto ndryshime midis degëve janë ruajtur», kur në fakt nuk ruhen. Dhe, meqenëse u futëm në këtë çështje, pyes: Përse nuk shikohen këto? Pse nuk merren masa që t'i korrigojmë sa më parë, po vë-

rehet tendenca e kënaqjes vetëm me konstatime? Vetëm duke kërkuar çdo gjashtë muaj para nga banka zgjidhen problemet?

U rregullua sistemi i pagave të punëtorëve të minierave, po'është ngritur pa asnjë bazë paga e atyre që bëjnë llokume. Kësaj i thonë «roftë ai që bën llokume». Ju keni shikuar më parë pagat e punëtorëve të minierave, sikur ata paskan marrë më shumë nga ç'u takon dhe s'keni parë pagat e tjera që merren pa të drejtë nga disa që nuk punojnë sa duhet dhe tundin derën.

Kryesorja është që secili ta ndiejë thellë përgjegjësinë për punën e vet. Edhe kërkesa e llogarisë të ndihmojë që çështjet të çohen deri në fund. Por, kur me gjithë këto, ndodh që ndonjëri e ka mbushur kupën dhe gjykohet se duhet pushuar nga puna, të veprohet sipas rregullave në fuqi.

Si përfundim, unë mendoj që tash për tash të mbajmë kodin e punës që kemi në fuqi dhe ta zbatojmë mirë. Pastaj, më vonë, këto çështje do t'i rishikojë në kompleksitetin e tyre Këshilli i Ministrave dhe do t'ia paraqesë Byrosë Politike me propozimet përkatëse¹. Si thoni ju, shokë, jemi dakord kështu?

Të gjithë shokët u shfaqën dakord me propozimin e shokut Enver.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, që gjendet në AQP

1. Kodi i ri i Punës hyri në fuqi më 1 tetor 1935.

TË FORCOHET MË TEJ BASHKËPUNIMI USHTRI—TERREN

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

27 mars 1972

Problemi që po shqyrtojmë është i qartë për ne të gjithë, ndërsa ju, shokë të ushtrisë, mendoj se është e nevojshme t'i kuptoni më drejt ato. Funkcionet dhe detyrat tuaja janë të mëdha, në përgjithësi ato janë kryesoret për ju, prandaj askush të mos orvatet për të ndarë përgjegjësinë me të tjerët. Natyrisht, edhe të tjerët, dhe me këtë dua të them shokët e terrenit, kanë përgjegjësi, veç duhet pasur parasysh se terreni ka edhe shumë probleme të tjera. Prandaj, kur themi se një nga problemet që duhet të preokupojë rrethet është edhe ai i mbrojtjes, megjithëse kjo nuk është një çështje e vogël, nuk do të thotë aspak që

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për punën që bëhej për zbatimin e detyrave të Kongresit të 6-të të PPSH për bashkëveprimin midis komiteteve të Partisë të rretheve dhe të ushtrisë për një përgatitje të lartë luftarake të rezervistëve dhe të forcave vullnetare të vetëmbrojtjes popullore.

shokët e terrenit të kthehen në shtab të ushtrisë, siç jeni ju, as të specializohen në atë nivel siç jeni specializuar e po specializoheni ju, pasi detyrat e ngarkuara për secilin janë të përcaktuara qartë.

E kam fjalën këtu që në qoftë se ju, shokët e ushtrisë, hartoni plane për të bërë me dhjetëra mbledhje mësimore në vit me ata të terrenit, nuk e keni drejt. Stërvitjet ushtarake të punonjësve dhe të kuadrove duhet të bëhen brenda caqeve që kemi caktuar; asnjë ditë më shumë të mos bëhet. Këtë ta keni mirë të qartë ju. Mos u nisni nga mendimi i gabuar se, meqë çdo qytetar thirrjen në shërbim si rezervist duhet ta kuptojë si një çështje që ka të bëjë me mbrojtjen, duhet të vijë në stërvitje sa herë ta thirrni ju për t'i plotësuar të gjitha ditët e stërvitjes një herë e mirë. Kur themi të punohet me kujdes me rezervistët e vullnetarët në këtë drejtim, kjo duhet bërë me doemos dhe shumë mirë bile, me qëllim që ditët e stërvitjes të shpërndahen në muaj të ndryshëm gjatë vitit. Prandaj listat e atyre që vijnë në stërvitje të mos bëhen pa studiuar mirë gjendjen. Njerëzit që do të marrin pjesë në stërvitje të mos caktohen pa kriter për disa javë me radhë dhe pastaj kur s'ju vijnë në kohë, thonë se «nuk janë të gatshëm t'i përgjigjen thirrjes për mbrojtjen e atdheut», ose «preferojnë më mirë të jenë ushtarë sesa komandantë.» etj. Para se ta tërheqim për ta përgatitur si kuadër një njeri të tillë që na nevojitet, duhet të punojmë me të, ta bindim dhe të ndërhyhet që kooperativa bujqësore apo ndërmarrja ku ai punon të marrë bile edhe disa masa, që ai të mos dëmtohet ekonomikisht.

Pastaj ka rëndësi çështja që koha gjatë së cilës punonjësit tanë shkojnë për t'u stërvitur në ushtri, të jetë me të vërtetë shkollë e jo vend muhabetesh. Kjo u vë detyrën oficerëve të përgatiten mirë, të mos venë si në dasmë përpara rezervistëve. Për oficerin të bëhet e qartë sakrifica e atyre që lënë punën e shkojnë të kryejnë detyrën ushtarake, prandaj oficerët brenda kohës që është caktuar t'u japin rezervistëve plotësisht mësimet dhe instruksionet e parashikuara. Këtë problem është e nevojshme ta merrni seriozisht ju, shokë të ushtrisë, dhe të mos e konfondoni këtë me punën politike që duhet të bëjë Partia me njerëzit e terrenit. Punë politike Partia ka bërë dhe vazhdon të bëjë, si për çdo problem edhe për këtë çështje, por këtu është fjala që stërvitjet ushtarake të jenë të organizuara jashtëzakonisht mirë, në mënyrë që brenda atyre ditëve që janë llogaritur të bëjnë rezervistët, të përfitojnë maksimumin dhe të largohen me diçka të qartë e të re në kokë. Oficerët për këtë qëllim të jenë të gatshëm në çdo drejtim që të punojnë si duhet me ata që nga terreni vijnë për t'u stërvitur në ushtri. Kjo është puna juaj kryesore, të tjera gjëra nuk ju kërkohen.

Natyrisht, këto stërvitje duhet të bëhen duke marrë parasysh edhe nevojat e ekonomisë, të terrenit. Ju duhet të jeni në dispozicion të terrenit dhe jo terreni në dispozicionin tuaj. Çështja është që edhe stërvitjet ushtarake të bëhen, por edhe bimët bujqësore të mbillen, të prashiten e të ujiten në kohën e duhur. Në qoftë se ushtria planifikon t'i bëjë stërvitjet pikërisht kur kooperativat bujqësore janë në va-

lën e punëve, atëherë me këtë punë të pamenduar ne dobësojmë bujqësinë. Shoku Mustafa Pajenga, më duket, e ka drejt sugjerimin kur thekson që njerëzit të planifikohen në kohët më të përshtatshme për stërvitje ushtarake dhe jo kur kooperativat janë të preokupuara me punë intensive. Prandaj programin e stërvitjes së rezervistëve ushtria ta bëjë në konsultim e në bashkëpunim të ngushtë me shokët e terrenit dhe kur të caktohet koha, ata të paraqiten dhe të përgatiten mirë. Këto çështje të shikohen me kujdes dhe jo të ndodhë që nën mbulesën e nevojave të mbrojtjes, të mos merren parasysh kërkesat e arsyeshme të ekonomisë. Në asnjë rast s'duhet të veprohet kështu me stërvitjet.

Forcat vullnetare t'i konsiderojmë, gjithashtu, me rëndësi të madhe, prandaj të punohet me kujdes që edhe këto të stërviten sa më mirë. Për to janë krijuar shtabe ndër të cilat një rol të veçantë luan shtabi i rrethit, që i ka në drejtim të vet këto forca. Megjithatë, përgjegjësia bie më shumë mbi ju, shokët e ushtrisë, që i keni në drejtim shtabet e forcave vullnetare, prandaj punoni që ato të aktivizohen. Në shtabet e forcave vullnetare në rrethe ju duhet të dërgoni oficerë të mirë, me dijeni të plotë ushtarake, politikisht dhe teknikisht të përgatitur me të gjitha njohuritë dhe eksperiencën që u duhen. Fjalën e kam këtu për shtabe e jo për komanda. Për plotësimin e shtabeve kryesore ne kemi tani njerëz me eksperiencë, jo vetëm nga ata ushtarakë që kanë dalë në pension, por edhe shumë prej atyre që keni në aparatën e Ministrisë së Mbrojtjes. Në vend që këta të japin

urdhra e të merren me letra, i dërgoni më mirë për këtë qëllim nëpër rrethe, jo 20-30 veta, por edhe më shumë. Për t'i fryrë aparatet është e kollajshme, puna është t'i lehtësojmë këto sa më shumë. Këtë punë ta shikojmë me vëmendje, shokë, se kemi të bëjmë me një numër të madh kuadrosh.

Në ushtri ka përparime ashtu si kudo. Por lidhur me punimet mbrojtëse ka rrethe që janë më përpara, ka të tjera që kanë mbetur më prapa. Natyrisht, këto të fundit duhet të mobilizohen më shumë, po të gjithë e kanë për detyrë të realizojnë punimet ushtarake, duke mobilizuar masat e popullit.

Lidhur me rajonizimin është e domosdoshme që ky të bëhet e sa më shpejt, me qëllim që stërvitjet të jenë sa më efektive dhe që repartet të zënë në kohën më të shkurtër rajonet e mbrojtjes, ashtu siç u është caktuar detyra, duke kërkuar që të zbatohen normat e gatishmërisë. Por ju duhet të merrni mirë në konsideratë kushtet e faktorët që lidhen me çështjen e shpejtësisë, që varet edhe nga pozicionet, nga detyrat që i janë caktuar të kryejë secilit etj. Në përputhje me këto detyra duhet bërë dhe rajonizimi e duhet caktuar afati i paraqitjes së secilit në vendin e duhur. Çdo rast, pra, duhet parë konkretisht sipas vendit, situatës dhe detyrës që vihet. Një herë e përgjithmonë këto gjëra nuk mund të caktohen. Nuk mund të themi se i caktuam një herë këto tani dhe nuk ka më vend t'i rishikojmë e t'i përsosim më tej.

Këto çështje të studiohen mirë e të zgjidhen drejt. Sidoqoftë, në këtë mbledhje ne morëm një ide për këto probleme të rëndësishme, prandaj ta ndjekim e të for-

cojmë më tej bashkëpunimin ushtri—terren, sepse, sikurse thashë, kështu do t'i kryejmë si duhet e më mirë detyrat që na vihen për të ardhmen.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

LARG DUART NGA BALLKANI!

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

29 mars 1972

Vizitat e ministrave të luftës të fuqive të mëdha imperialiste në vende të tjera nuk kanë gëzuar kurrë simpatinë e opinionit publik. Misionet e tyre jashtë nuk kanë frymëzuar kurrë siguri e qetësi në popujt dhe, përgjithësisht, nuk kanë qenë kurrë ogurmbara për paqen e sigurinë ndërkombëtare. Praktika ka treguar se këta përfaqësues të shtabeve të larta ushtarake janë përçuesit më fanatikë dhe më të papërmbyjtur të politikës ekspansioniste e aventureske, nxitësit dhe ekzekutuesit më të zellshëm të agresioneve e të push-timeve imperialiste.

Një famë të tillë të keqe ka edhe mareshali i Bashkimit Sovjetik, Greçko, i cili tani po viziton Jugosllavinë. Emri i tij është i lidhur ngushtë me përmbysjen kundërrevolucionare që ka ndodhur në Bashkimin Sovjetik, me ringjalljen dhe vënien në zbatim të politikës shoviniste imperiale të Rusisë me nxitjen e frymës militariste cariste brenda, të neokolonializmit dhe shantazhit ushtarak jashtë.

Vizita e tij e tanishme në Jugosllavi mund të ketë arsye të shumta dhe të jetë nxitur nga motive të ndryshme. Por fakti që ajo bëhet fill pasi ministri sovjetik i Mbrojtjes asistoi në manovrat e flotës sovjetike në Mesdhe dhe vizitoi mjaft vende të Lindjes së Mesme, pa përmendur vajtjet e ardhjet e shpeshta në vendet pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës, dëshmon për interesimin e madh që shtabet ushtarake sovjetike kanë për Ballkanin dhe Mesdheun. Këto vizita kanë marrë tanimë pamjen e një kontrolli ose inspektimi të zonave, që Greçkoja dhe gjeneralët e tij i konsiderojnë si të përfshira brenda kuadrit të planeve të tyre të mbrojtjes, ose të sulmeve të ardhshme aneksioniste.

Kohët e fundit ushtritë sovjetike në kufijtë jugorë të Hungarisë dhe në Bullgari janë shtuar. Përveç flotës detare, që i bie kryq e tërthor Mesdheut krahas për krahas me flotën e 6-të amerikane, mbi qiellin e tij kanë filluar të duken edhe aeroplanë që mbajnë sheqerë sovjetike. Se çfarë synojnë presionet e flotave të këtyre dy superfuqive e kuptojnë të gjithë.

Nuk është sekret se, që kur revizionistët e Kremilit u vendosën në Lindjen e Mesme, Moska ka filluar ta shikojë me zili Ballkanin, si një rrugë kalimi, ose si një urë ndërlidhjeje territoriale me forcat e saj në Mesdhe, si një bazë të dëshirueshme për planet e saj ekspansioniste në Evropë dhe në kontinente të tjera. Kjo politikë mori një formë konkrete dhe mjaft të ashpër me kërcënimet e vazhdueshme vitet e fundit karshi disa vendeve ballkanike. Mirëpo kërcënimet e tankeve të Greçkos nuk i trembin popujt e këtyre vendeve.

Për të gjithë është e ditur se masat urgjente të mbrojtjes që u morën këto dy-tre vjetët e fundit në Beograd, ashtu si dhe ndryshimet që u bënë në konceptet, në taktikat dhe në mënyrat e mbrojtjes popullore dhe qëndrimi i vendosur i popujve të Jugosllavisë për të mbrojtur lirinë e pavarësinë e tyre, u mbajtën parasysh në Moskë.

Është fakt se revizionistët sovjetikë kanë treguar një interesim të posaçëm për të shfrytëzuar çdo rast vështirësie që mund të nxirrte zhvillimi i jetës së brendshme në Jugosllavi për t'u bërë arbitra, për të ndërhyrë dhe, po t'u ecte mbarë, edhe për ta nënshtruar gjithë vendin.

Anijet sovjetike të luftës, ashtu si edhe ato amerikane, shkojnë shpesh në portet e bregdetit jugosllav. Vizitat e këtyre flotave quhen miqësore, por ato përmbajnë në vetvete farën e rrezikut jo vetëm për popujt e Jugosllavisë, por për të gjitha vendet e rajonit të Adriatikut. Është e kuptueshme se, në qoftë se për jugosllavët këto quhen miqësore, për vendet e tjera të Adriatikut nuk mund të konsiderohen të tilla. Bashkë me vizitat, këto anije mësojnë edhe rrugën dhe, në raste të tjera, «vizita» të tilla nuk do të jenë aspak miqësore.

Për të vënë në jetë planet e tyre ekspansioniste e aneksioniste, revizionistët sovjetikë kanë përdorur kurdoherë frikësimet dhe përkëdheljet, tanket dhe rublat. Koha ka treguar se kur flasin për paqen, ata përgatitin luftën; kur betohen për miqësinë, gatitin thikën për të ta futur pas krahëve; kur të ofrojnë ndihmën, atëherë mendojnë si të të mbytin.

Krerët e Kremlinit tani kanë zënë e thërresin andej-këndej dhe me sa fuqi kanë se kushdo që kërkon të mbrohet nga imperializmi ose nga çdo armik tjetër, le të vrapojë të futet shpejt në togën e tyre. Por kjo togë të zë frymën, ashtu siç ua ka zënë çekëve dhe hungarezëve, polakëve dhe mongolëve etj.

Një spekulim të madh udhëheqësit sovjetikë bëjnë edhe me armët. Bashkimi Sovjetik është bërë edhe tregtar i madh i armëve, bile në ndonjë rast nuk kursehet që ato t'i shesë edhe lirë. Por këtë ai nuk e bën nga zemërgjerësia, por nga siguria se vendi që merr armë nga Bashkimi Sovjetik mbetet rob tek ai për pjesë ndërrimi, për predha, për pajisje plotësuese etj. Tanimë është provuar se varësia për armë nga fuqitë e mëdha imperialiste do të thotë edhe varësi politike e ekonomike. Për këtë arsye popujt e urrejnë dhe e luftojnë monopolin imperialisto-revizionist të armëve dhe përpiqen të armatosen me forcat e veta dhe në rrugë të tjera.

Faktet tregojnë se kudo që revizionistët sovjetikë kanë mundur të hedhin këmbë, qoftë me intriga ose duke shfrytëzuar ndonjë situatë të turbullt, ata nuk shkulen lehtë prej andej. Do të ishte një gabim shumë i rëndë dhe me pasoja të paimagjinueshme në qoftë se mendohet se mund të shfrytëzohet pa asnjë dëm për pavarësinë dhe sovranitetin kombëtar interesimi sovjetik për ta pasur mirë me këtë ose me atë vend. Ky interesim zhduket shpejt, ashtu siç zhduken edhe koniunkturat tranzitore që e krijojnë. Ajo që mbetet është synimi i përhershëm dhe i pandryshueshëm i atyre që sundojnë sot në Kremlin për të nënshtruar çdo

vend dhe të gjithë botën. Të hysh në lojën e sovjetikëve është fare e lehtë, por të dalësh nga ajo është shumë e vështirë. Po kështu, të shikosh në marrëdhëniet me revizionistët sovjetikë interesat ekonomikë të çastit, ose të politikës së ditës, do të thotë të vësh në një ipotekë të rëndë të ardhmen e vendit.

Por planet shoviniste dhe ekspansioniste të social-imperialistëve sovjetikë ndaj Ballkanit nuk pinë ujë dhe ato do të dështojnë me siguri. Për sa i përket popullit shqiptar, ai ka qenë dhe është kurdoherë vigjilent ndaj qëllimeve dhe veprimeve të armiqve të lirisë e të pavarësisë së tij. As imperialistët amerikanë, as socialimperialistët sovjetikë nuk do ta gjejnë kurrë të papërgatitur dhe të çarmatosur. Ne kemi bindjen se edhe popujt e Jugosllavisë do të dinë t'i kundërshtojnë qëllimet armiqësore të dy superfuqive imperialiste dhe nuk do të mashtrohen nga manovrat e tyre djallëzore.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 75 (7367), 29 mars 1972

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 240*

TE GJITHË JEMI BIJ TË PARTISË. T'I SHËRBEJMË ASAJ TËRË JETËN

*Nga biseda në familjen e shokut Sulo Gradeci
me rastin e 50-vjetorit të lindjes së tij*

11 prill 1972

Në hyrje të shtëpisë kishin dalë pjesëtarët e familjes për të pritur me gëzim udhëheqësin dhe mësuesin e dashur të Partisë e të popullit. Pasi u përshëndetën dhe hynë në dhomë, në mes tyre dhe shokut Enver Hoxha u zhvillua një bisedë e përzemërt.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se ju gjetëm. Si je, nënë e Sulos? Gëzuar 50-vjetorin e lindjes së djalit! E ke djalin të mirë, kudo dhe kurdoherë ka luftuar me besnikëri të madhe për popullin dhe për Partinë. Të të rrojë, t'i rrojë Partisë, se të gjithë jemi edhe bij të Partisë dhe duhet t'i shërbejmë asaj tërë jetën.

SHERINA GRADECI¹: Faleminderit shumë, shoku Enver, të na rroni Ju, të na rrojë Partia!

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk të erdhëm dot atë ditë që kishe ditëlindjen, Sulo, sepse bashkë me Nexh-

1. Nëna e shokut Sulo Gradeci.

mijen menduam se do të kishe shumë njerëz e thamë më mirë të vemi një ditë tjetër, që të bëjmë një çikë muhabet.

SHOKU SULO GRADECI: Ardhja Juaj në familjen tonë, shoku Enver, na gëzon së tepërmi. Faleminderit shumë, do t'i jemi mirënjohës përjetë Partisë!

SHOKU ENVER HOXHA: Po zotrote, kush je?

SAFIGJE HASANTARI: Jam vjehrra e Sulos, nëna e Lirisë. Erdha të gëzoj edhe unë, në këtë takim të bukur me Ju. Nuk m'u nda edhe një vajzë e djalit, plasi të shohë xhaxhin Enver. E kishin caktuar në Kongresin e 6-të për të përshëndetur dhe për t'ju dhënë Juve një buqetë me lule, por duke qenë e shëndoshë, i thanë se «ty nuk të ngre dot xhaxhi Enver», prandaj e hoqën dhe caktuan një tjetër.

Në këtë kohë hyjnë në dhomë mbesa, Engjëllushja dhe Dhurata, vajza e Sulos, të cilat i hidhen në qafë shokut Enver dhe përshëndeten përzemërsisht me të.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa vajza të mira që jeni! Edhe emrat i keni të bukur, nga ato që i pëlqejnë aq shumë xhaxhit Enver.

Sa djem ke, nënë e Lirisë?

SAFIGJE HASANTARI: Kam tre djem, një, është ky këtu, një në universitet dhe një ndodhet me shërbina.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë, të të rrojnë!

Gëzuar ditëlindjen, Sulo, gëzuar nënë, gëzuar Liri, gëzuar Dhurata — të të rrojë babai! Gëzuar të gjithëve!

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Shkuam në Skra-

par të dy me Enverin për festat e Nëntorit¹ dhe u kënaqëm shumë atje. Unë kisha që në kohën e luftës që nuk kisha vajtur.

SHOKU ENVER HOXHA: U kënaqëm shumë ato ditë, kaluam shumë mirë bashkë me popullin e Skraparit. Unë kisha qenë dhe herë të tjera, por ato ditë u poqëm me të gjithë ata që kishin ardhur nga të tëra fshatrat. Është mirë tani në Skrapar, njerëzit punojnë të tërë. Megjithëse vend malor, punojnë skraparllinjë. Tani po merren disa masa për zhvillimin më tej të bujqësisë, kooperativat do të rregullohen edhe me ujitje.

Ulu ti, Liri, se mos na ndodhë si te filmi «Kapedani». Besoj se e ka parë edhe nëna. Është film i bukur! Që thoni ju, ky «Kapedani», nusen e djalit na e kishte balerinë, po çështjen e emancipimit të gruas nuk e hante. Ç'bënë me të të rinjtë një mëngjes? Nusja i çoi kafënë edhe plakut, edhe burrit; «Kapedanit» i shpuri bile legenin të lante duart, por ai i tha se do të vente në çezmë t'i lante vetë. «Jo, jo, i tha djali, përse e kemi «këtë», të të sjellë të lash duart, posi! Silli dhe bukën babait këtu!». «Jo more djalë ç'janë këto, vemi në kuzhinë të hamë», ia priti plakut. «Jo, baba, vazhdoi i biri, të na i sjellë këtu të tëra, se jemi burra apo nuk jemi». Sa ishte në shtëpi, plakut megjithëse e kuptoi lodrën, s'bëri gëk përpara nuses, po kur dolën nga shtëpia, meqenëse e nuhati gjithë këtë qëndrim, i tha djalit: «Ore qerrata, më thuaj të drejtën, kujt i shkoj në mendje kjo që më bëtë në shtëpi, ty apo asaj?». Edhe pleqve u punon mendja tani, thyhen ato mendi-

1. Nëntor 1971. .:

met e vjetra që kanë trashëguar nga e kaluara njerëzit.

Gruaja ka luajtur një rol të madh në luftë, rol të madh luan ajo edhe sot që po ndërtojmë socializmin. Pa gratë ne nuk mund të bënim një luftë kaq të madhe. Pastaj ajo ka edhe funksionin e lartë të përtëritjes së jetës. Pa gruan nuk mund të ketë jetë, nuk mund të ekzistojë njeriu, shoqëria. Prandaj gruaja duhet të zërë vend në shoqëri njëlloj si edhe burri. Kjo në vendin tonë është vënë në rrugë, por ka akoma shumë për të bërë, sepse ekzistojnë mbeturina të ngulitura në shekuj në kokën e njerëzve të shoqërisë sonë, sidomos të burrave.

Besoj se ti, Sulo, e ke lehtësuar ca Lirinë në punët e shtëpisë, apo jo?

SHOKU SULO GRADECI: Po përpiqemi të aktivizohemi, shoku Enver, por kemi shumë për të bërë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ka shumë burra që kuletën ua kanë dorëzuar grave, por kjo s'do të thotë që pazarin, për shembull, të mos e bëjnë burrat. Qumësht nëpër dyqane këtë vit ka, zarzavatet e kohës kanë dalë, me vezët s'para kemi qenë mirë. Në bujqësi kemi bërë hapa përpara, por duhet të bëjmë akoma më shumë përpjekje, që të kemi më shumë mish, bukë, gjalpë, vezë etj. Ne duhet të luftojmë shumë se jemi prapa në këtë sektor të rëndësishëm jetik të ekonomisë, duhet të punojmë se vetëm puna i bën të gjitha. Me punë dhe me mësim bujqësinë duhet të arrijmë ta bëjmë të tillë që të mos ndihet asnjë vështirësi në popull. Çështja e sigurimit të ushqimit për popullin është nga kryesoret, po nuk pate ushqime, krijohen vështirësi

në jetesë, kështu që edhe politikisht mungesat sjellin vështirësi. Prandaj po i vëmë rëndësi të madhe bujqësisë, që jeta e njerëzve tanë të bëhet më e mirë.

Do t'i japim rëndësi më të madhe mekanizimit të bujqësisë, pse një punim të thellë t'i futësh tokës me traktor, po t'i bëhen mirë edhe gjithë proceset e tjera të punës me mekanizma të domosdoshëm për rritjen e kulturave bujqësore me rendiment të lartë, do të mund të zëvendësojmë kështu mungesat e krahëve të punës, pse ka raste që mungojnë, sidomos në kohën e punimeve të shumta intensive. Po të kesh mekanizma, në Skrapar, fjala vjen, i fut këta dhe kryen punë më shumë e më shpejt sesa mund të bëjnë njerëzit me krahë, aq më shumë ku këto forca janë të pakta.

Juve, nënë, ju binte bretku duke mbjellë e duke u bërë shërbime bimëve. Tani po bëhet çmos që të lehtësohet puna në bujqësi e sidomos puna e grave. Ja, më kanë thënë se afër Radiostacionit të Shijakut është ndërtuar një serrë e madhe e mbyllur, në të cilën prodhohen domate, speca, kastraveca, që rriten me dritë, me korrent elektrik. Atje është një vajzë që punon, sa shtyp ajo një sustë dhe e lë pesë minuta të ndezur, kur të shikosh që uji bie mbi bimët në formën e shiut dhe i ujit për bukuri, pastaj ajo shtyp një sustë tjetër që vë në lëvizje lëngun me insekticide, me të cilin spërkatën bimët, në këtë formë bëhen me rradhë të tëra proceset e tjera të punës. Drejt këtyre mënyrave të punës duhet të ecim, që e rritin shumëfish prodhimin, se nuk mbahen qytetet e mëdha me pesë kunguj që prodhoheshin përpara, tani duhen me dhje-

tëra mijë kuintalë prodhime në vit dhe, për t'ia arritur kësaj, duhet të punojmë më mirë e më shumë.

Koha sivjet na ka mbajtur mirë, po mungesa e shirave na ka krijuar ca vështirësi për hidrocentralet, se ka fare pak rezerva uji prandaj na duhet të bëjmë një çikë kursim për energjinë elektrike. Edhe për bujqësinë thatësira është e rrezikshme. Hidrocentrali «Frederik Engels» ka muaj që nuk punon, edhe «Karl Marksi» është nën nivel. Në përgjithësi rezervat e ujit këtë vit janë pakësuar si asnjëherë.

Tani që zura në gojë hidrocentralet, m'u kujtua diçka. Isha një ditë nga hidrocentrali «Lenin», atje më doli përpara një grua e më tregoi se ishte nga Skrapari, ishte ama «brisk» nga goja. E pyeta për fëmijët që kishte. Një djalë e kam në uzinën «Enver», tha ajo. «E ke të martuar?», — e pyeta. «Po, të martuar e kam», — më tha. «Ja ku e kam edhe nusen». «Shumë mirë, po ti nuse nga je, nga Tirana?», — i thashë unë. «Jo, tha e reja, jam nga Skrapari». «Ashtu është», — ndërhyri plaka, «E kam nga Skrapari nusen, kur janë nga një vend merren vesh më mirë».

Po unë, që e kam gruan nga Dibra, pse ne të dy nuk merremi vesh? — i thashë për të bërë shaka. Fakti është se po bëhet punë e madhe nga Partia, që të zhduken mbeturinat e vjetra te njerëzit tanë, të rinjtë e të rejtat tani shkojnë në punë, punojnë bashkë, bisedojnë, njihen dhe dashurohen, pavarësisht se mund të jenë nga krahina të ndryshme, larg njëra-tjetrës.

Meqë ra fjala për martesën, më ra ndër mend edhe diçka tjetër. Një njeri në Paris ka shkruar se Enver Hoxha e ka bërë martesën me politikë, për arsye

se në Shqipëri ka pasur përçarje, gegë e toskë, për këtë arsye ai mori një vajzë nga «Gegëria» që të zhdukej ky dallim krahinor! Por ai ka bërë edhe gjëra të tjera, vazhdon autori. Tre fëmijët që ka, nga të cilët dy djem dhe një vajzë, u ka vënë emra karakteristikë. Djalit të madh ia ka vënë emrin Ilir dhe këtë e ka bërë për të kujtuar origjinën e vendit; djalit të dytë ia ka vënë emrin Sokol, titulli i luftëtarit të mesjetës; kurse vajzës ia ka vënë emrin Pranvera, që do të thotë socializëm, kjo simbolizon kohën e tanishme. Kështu i ka lidhur ky francez këto gjëra, po ama i ka lidhur.

SHOKU SULO GRADECI: Merrni ndonjë gjë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Ja, po marr një mollë, ëmbëlsirat po ua lë këtyre vajzave. Hajde ti, Dhurata, hajde dhe ti Engjëllushe, merrni nga këto ëmbëlsirat.

Për ne të moshuarit është i domosdoshëm regjimi. Edhe ti nënë, të mbash regjim, bëj si të thonë djemtë, se është për të mirën tënde, që të kesh shëndet të mirë dhe të rrosh sa më shumë.

Ti Dhuratë, në ç'klasë je? .

DHURATA GRADECI: Në klasë të pestë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ti, Jeta, në ç'klasë e ke atë djalin, që kam dalë në fotografi kur ishte i vogël?

*SHOQJA JETA MITRUSHI*¹: Në klasën e pestë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nënë, Suloja është bërë një zanatçi i mirë për të marrë në fotografi e në film, ka krijuar një arkivë të tërë, albume etj.

1. Stenografe.

· *SHOQJA LIRI GRADECI*: Partia ua ka krijuar të gjitha kushtet për këto, Sulos dhe gjithë shokëve.

SHOKU SULO GRADECI: Ja, kjo është fotografia e parë që kam bërë në Dhërmi (*tregon fotografinë e shokut Enver në Dhërmi*).

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Në ç'vit ka dalë këtu Enveri?

SHOKU SULO GRADECI: Në vitin 1962.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Domethënë 10 vjet më parë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ka plot kujtime Suloja, po vetë humbet, nuk del dot, ai merr vetëm të tjerët. Ua ka marrë dorën edhe filmave dhe bën dokumentarë e filma të bukur, që na i shfaq ne kohë pas kohe. Ne kemi qenë prapa edhe me filmin. Në vitet e para pas Çlirimit, erdhi në Shqipëri një kineast sovjetik, që bëri një film të bukur për Shqipërinë, u bë edhe mik i vendit tonë, mësoi edhe disa nga djemtë tanë, bile më kërkoi dhe mori një nga shoferët e mi, të cilin e bëri kinooperator. Tani ne përgatitim vetë dokumentarë e filma të bukur, më shumë do të prodhojmë në të ardhmen.

Mbrëmë pashë tre dokumentarë të bukur: «Koleksioni i Etlevës», që bënte fjalë për pulla, një ishte me pejsazhe nga vendi ynë, një tjetër quhej «Lajmëtari i festivalit». Ishin shumë të bukur; një kishte të bënte me të vegjlit në Tiranë. Sa bukur i kishin marrë! Vajza kishte një kukull, «e lante», «e pastronte», «e vishte», i këndonte kur e «vinte në gjumë». Kukulla ishte e madhe dhe vajza «i fliste», «i bënte muhabet». «Po kukulla një herë u sëmur». Atëherë vajza thirri «dok-

torin». Një djalë i vogël që erdhi bënte tamam si «doktor», ai vuri stetoskopin e doktorit në vesh, rrinte shumë serioz dhe i thoshte kukullës «merr frymë!», «kollu!» etj. Ishte me të vërtetë një gjë shumë e bukur! Të tilla ishin edhe lodrat e fëmijëve, edhe pejsazhet.

Tjetri ishte «Lajmëtari i festivalit». Këtë dokumentar e kishin lidhur me legjendën e Skënderbeut, kur kishte luftuar në fushën e Domosdovës. Ngjarjen e kishin lidhur me shpellën e Pishkashit, me hekurin, me vallet e Librazhdit, me gratë e veshura rëndë, me panorama shumë piktoreske të këtyre anëve. Gratë kishin në kokë edhe nga një feste prej argjendi, duke-shin si shqiponja. I kishte lidhur shumë bukur regjisori edhe vallet, edhe këngët. Nga ana teknike dokumentari më duket se ishte realizuar shumë mirë.

Apartamentin e paskeni shumë të bukur. Ka disa shtëpi që kanë kuzhinat shumë të mira, të mëdha. Te një vajzë e xhaxhait tim kështu e kanë apartamentin, të mirë e të madh. Ajo e ka shtruar edhe bukur, sa që kuzhina nuk dallohet fare si e tillë, as lavapjati nuk dukej atje, e kanë mbuluar me dollap, rregulluar shumë bukur, bile aq mirë ishte atje, sa nuk të rrihet në sallonin e pritjes. Tani kanë mësuar punonjësit tanë të ndërtimit, s'janë si përpara që s'kishin eksperiencë, pastaj tani kemi edhe arkitektë, edhe materiale më shumë. Më kujtohet atëherë ishte aq keq për materiale, vetëm themelet e shtëpive i bënim me gurë, kurse pjesën mbi themelet e bënim me tulla prej balte që i linim të thaheshin. Vajtëm një herë dhe inauguruam disa shtëpi përdhese, aty afër stadiumit «Dinamo». Janë akoma edhe sot ato shtëpi. Shumë mund të shkru-

het edhe për historinë e ndërtimeve tona. Sa kohë shkon, ndërtimet e para kanë rëndësinë e tyre. Prandaj të mos prishen, thotë Gani Strazimiri¹, edhe kur të ngrihen shtëpi më të bukura pranë tyre, t'i ruajmë disa në mënyrë që të shkojnë fëmijët për t'i parë, se si kanë jetuar paraardhësit e tyre.

Tani na lejoni të ikim. Qofshi të lumtur e të gëzuar. Të rrosh sa malet, Sulo, pleqëri të bardhë, nënë e Sulos! Mbetshi me shëndet, gëzuar të gjithëve!

SHOKU SULO GRADECI: Ju faleminderit shumë për këtë vizitë. Jemi tepër të emocionuar, por edhe shumë të lumtur e të gëzuar.

*Botohet për herë të parë me
shkurtime sipas shënimeve të
mbajtura në këtë takim,
që gjenden në AQP*

1. Arkitekt. Në atë kohë drejtor i Institutit të Monumenteve të Kulturës.

PLANI I GRUMBULLIMIT TË TEPRICAVE NUK ËSITË DETYRIM

Nga biseda me ministrin e Tregtisë

12 prill 1972

Pasi e pyeti ministrin si venë punët në sektorin e tregtisë, a bëhen nga ana e blerësve kritika për të metat që konstatojnë, a i pranojnë ato punonjësit e tregtisë dhe a punojnë këta të fundit për t'i ndrequr këto të meta, shoku Enver Hoxha, duke u ndalur në punën që bën sektori i tregtisë për grumbullimin e produkteve bujqësore e blegtorale nga fshati, tha:

Orientimet e Partisë për këtë problem janë të drejta, por ndodh që disa prej tyre shtrembërohen kur zbatohen në bazë. Ju dërgoni në rrethe ekipet e ministrisë, por këto ekipe nuk i shohin shtrembërimet që bëhen. Ne kemi marrë vendim dhe u kemi thënë fshatarëve që detyrime drithi nuk ka më, por ka vetëm teprica. Duke llogaritur të heqim farën, bukën për kooperativistët dhe për ushqimin e kafshëve, ato që mbeten konsiderohen teprica. Këtë llogaritje ne e bëjmë vetëm për drithin, se shteti ka nevojë për të, pasi, në të vërtetë, kur themi teprica, s'ka pse të bëj-

më llogaritje, s'ka pse të llogaritim ne sa bukë do të hajë fshatari që e prodhon. Pra, kemi marrë vendim që kooperativave t'ua marrim tepricat, por kur e detyrojmë prodhuesin të hajë jo aq sa dëshiron, ose kafshëve t'u japë jo sa kanë nevojë, po më pak, kur i themi që, pasi të hiqet edhe sasia e cila i duhet për farën, gjithë pjesën tjetër që mbetet t'ia shesë shtetit, «tepricë» e quan ti këtë? Ky veprim në realitet është detyrim, pavarësisht nga emri që i vëmë.

Nuk duhet bërë kështu siç keni vepruar ju. Ti, si ministër i Tregtisë, duhet të kesh përpara planin e grumbullimit të tepricave, sepse pa këtë nuk mund të ketë mobilizim as nga njerëzit e tu, as nga Partia dhe pushteti në rreth e në bazë. Çështja është si do të hartohet ky plan. Plani i Ministrisë së Tregtisë për këtë problem nuk mund të jetë në asnjë mënyrë si ai i Ministrisë së Bujqësisë, plani juaj është, si të thuash, teorik. Në planin e tregtisë është fjala vetëm për tepricat dhe këtë ju nuk mund ta parashikoni shumë kohë përpara sa do të jetë. Për shembull, sipas planit të Ministrisë së Bujqësisë i është vënë detyrë një rrethi që në drithërat e bukës të realizohet një rendiment, ta zëmë, prej 50 kuintalë për hektar. Mirëpo, me gjithë përpjekjet, rrethi realizon një rendiment më të ulët. Mbi këtë bazë ne llogaritim sa do të hajë fshatari, sa drithë duhet për farën etj. Mirëpo kur rendimenti nuk realizohet sa parashikon plani, a mund të realizohen tepricat e llogaritura sipas parashikimit? Prandaj unë them që plani juaj është teorik në krahasim me planin e bujqësisë.

Nga del plani i grumbullimeve të shtetit? Për har-

timin e tij janë dhënë orientime që ai të caktohet, të diskutohet dhe të aprovohet në bazë. Në këtë plan parashikohen edhe prodhimi global, edhe tepricat që kooperativat do t'i japin shtetit. Këto Ministria e Tregtisë duhet t'i futë në plan, mirëpo plani i tepricave nuk është detyrim. Ai që mban ti në xhep si ministër i Tregtisë duhet të jetë vetëm plan orientues, që orienton grumbullimin e drithërave. Aty parashikohet sa do të jenë rendimentet e drithërave, sa duhet të pjellin lopët, sa prej tyre do të skartohen e kështu me radhë për gjithë të tjerat. Mbi këtë bazë lidhet edhe kontrata. Pastaj tregtia duhet ta ndjekë zbatimin e planit të bujqësisë në rreth, të ndjekë prodhimin e drithërave, pjellshmërinë e bagëtive, shtimin e tyre, ushqimin etj. Punonjësit e grumbullimit duhet t'u rrinë këtyre çështjeve mbi kokë, të luftojnë me shokët e Partisë dhe të komitetit ekzekutiv të rrethit që ky prodhim të arrihet dhe, kur vjen pastaj koha e pjekjes së prodhimeve bujqësore, së bashku me drejtuesit e kooperativave caktohet plani i tepricave në bazë të gjendjes reale të prodhimit dhe ky, mund të themi, është një plan i vërtetë, real.

Si do të caktohet ky plan? Do të shkohet kooperativë më kooperativë për të përcaktuar tepricat që do të japë secila për planin e drithit (flasim këtu më shumë për drithin, se kjo është çështje më konkrete) ose për planin e mishit që do të realizohet kaq apo aq. Kooperativa, lidhur me këto, bën planin konkret të saj. Por i ngarkuari nga organet e rrethit shkon në vend, interesohet për tepricat që ekonomia bujqësore parashikon të japë dhe diskuton së bashku me drej-

tuesit e ekonomisë. Këta thonë, për shembull, se kishin në plan të merrnin 45 kuintalë misër për hektar. Por ky rendiment nuk u arrit, u mor vetëm 30 kuintalë për hektar. Në këtë rast, po t'i marrim tepricat sipas parashikimit që është bërë në fillim, kjo do të thotë që kooperativës t'i lihet drithë për të ngrënë më pak nga sa ka nevojë. Në asnjë mënyrë nuk duhet ta bëjmë këtë, sepse pastaj do të detyrohemi ta furnizojmë përsëri kooperativën me drithë e të bëjmë kështu edhe ca shpenzime të tepërta për transport një herë duke ia marrë drithin, pastaj duke ia kthyer përsëri. Prandaj, punonjësi i grumbullimit, pasi merr përgjigjen për realizimin e planit të prodhimit, bën krahasimin e planit, që i është dërguar nga Ministria e Tregtisë, me gjendjen reale të prodhimit dhe llogarit se plani i tepricave në rreth po realizohet, ta zëmë, gjysmë përgjysmë. Atëherë vë në dijeni për këtë ministrinë se grumbullimi i parashikuar i tepricave për filan rreth nuk mund të realizohet dhe i tregon konkretisht sa mund të arrihet ai në bazë të gjendjes që ekziston në fakt.

Pasi sqaron çështjen e grumbullimit të tepricave të drithit, kalohet pastaj në diskutim për mishin. U kërkohet, gjithashtu, drejtuesve të kooperativës sa mish do t'i shesin shtetit, sa bagëti do të skartohen etj. As kjo punë nuk mund të bëhet në fillim të vitit, se në atë kohë kooperativa, pa një bazë konkrete reale, mund të thotë që do t'i japë shtetit kaq apo aq teprica, por kjo nuk mund të jetë e saktë. Shifër e saktë për tepricat e prodhimeve blegtorale do të jepet në kohën kur të bëhen pak a shumë të qarta frytet e

punës vjetore, siç do të veprohet për drithërat, në momentin e korrjeve. Pas kësaj bëhet, gjithashtu, krahasimi i planit orientativ të grumbullimit dhe lajmërohet Ministria e Tregtisë për ndryshimet. Pra, plani real i grumbullimeve bëhet në bazë dhe jo në fillim të vitit, por kur arrihet të njihet gjendja se sa do të jetë prodhimi. Plan i Ministrisë së Tregtisë i përgatitur që në fillim, siç thashë, është vetëm për orientim.

Në realitet çfarë ndodh? Shokët e grumbullimit u thonë kooperativave t'u dorëzojnë sasinë e mishit që u është caktuar. Kooperativa kundërshton se nuk e ka siguruar sasinë e planifikuar, mirëpo ata të grumbullimit përgjigjen se «ne nuk duam të dimë nga kjo», «plani është ligj» ngulin këmbë ata, prandaj «duhet zbatuar me domosdo». Atëherë kooperativa, që të jetë në rregull me këtë plan dhe që të marrë flamurin, skarton deri edhe bagëtitë e mira dhe e plotëson planin, po ama se pakësohet numri i bagëtisë, për këtë nga Ministria e Tregtisë as që mendohet. Kështu kanë vepruar shokët e rrethit të Dibrës. Për të qenë në rregull me Qeverinë dhe me Komitetin Qendror të Partisë, ata plotësuan planin e mishit duke urdhëruar skartimin deri edhe të bagëtive të mira. Mirëpo nuk duhet të veprohet në asnjë mënyrë kësisoj, se tepricat kthehen në detyrim dhe numri i bagëtive na ulët. Tregtia mund të ketë vetë në plan sa mish, qumësht, lesh etj. do të grumbullojë, por ky nuk është detyrim. Ne mund t'u marrim kooperativave deri në 75 për qind të mishit ose të qumështit të prodhuar, mund të marrim drithëra dhe lesh vetëm në bazë të kritereve që kemi caktuar, këto nuk mund të lejojmë që të

shtrembërohen, siç ka ndodhur në ndonjë rast. Të kuptohet mirë, e theksoj, se grumbullimi i tepricave nuk është detyrim.

Për sa i përket problemit tjetër, nëse do të grumbullojmë nga oborret kooperativiste ose jo, unë mendoj që edhe andej mund të marrim, por të marrim mbi baza vullnetare e të mos veprohet siç është vepruar në ndonjë kooperativë, që kryetari i kooperativës bashkë me sekretarin e organizatës së Partisë caktojnë sasinë nga sa mish do të japë çdo oborr kooperativist, japin urdhër sa kilogram mish do të japë njëra dhe sa tjetra familje kooperativiste. Bile ca më keq akoma shkohet edhe më tej në ndonjë rast, kur kooperativisti deklaron se nuk ka të japë dhe ata e urdhërojnë të shkojë të blejë ku të dojë. Dhe kooperativisti, që të jetë në rregull me Partinë dhe me shtetin, vete blen bagëti me çmimin e tregut dhe ia jep grumbullimit me gjysmë çmimi, gjë që e dëmton atë ekonomikisht. Pastaj ku e blen ky kooperativist këtë bagëti? E blen në pazar dhe këtë e bën se nuk ka si ta sigurojë ndryshe planin që i ka imponuar kryesia e kooperativës. Edhe sikur kooperativisti të realizojë teprica mishi, të kemi parasysh se ai duhet të mbajë medoemos për të plotësuar nevojat e familjes për ushqim dhe jo t'i merret i gjithë prodhimi.

Organet e tregtisë duhet të mendojnë edhe për diçka tjetër. Për të mbuluar të hollat që realizojnë kooperativat nga tepricat, shteti duhet të mendojë t'i sigurojë fshatarësisë mallra në dyqan, duke u nisur nga parimi «më jep, të të jap». Por në realitet nuk veprohet kështu. Ne jemi shtet socialist, prandaj kër-

kesave të kooperativistëve medoemos t'u përgjigjemi, ata duhet të gjejnë në dyqan ato mallra industriale për të cilat kanë nevojë. Janë të lidhur ngushtë këto probleme me njëri-tjetrin. Në qoftë se fshatari i jep shtetit teprica të prodhimeve bujqësore e blegtorale, edhe shteti duhet t'i përgjigjet me mallra industriale.

Nuk mund të shtrohet problemi që kooperativat t'i japin shtetit aq teprica sa ka nevojë ai, po sa janë mundësitë reale. Sigurisht, Partia duhet të punojë që prodhimet të rriten për të mirën e vetë fshatarësisë dhe të të gjithë shoqërisë. Kjo kërkon një punë bindëse dhe sqaruese të vazhdueshme e të gjithanshme që kooperativat t'i japin qytetit drithë, mish etj., ash-tu sikurse qyteti prodhon dhe çdo send tjetër për të plotësuar nevojat e kooperativistëve. Por që t'ia imponosh fshatarësisë, t'ia kërkosh tepricat me detyrim, kjo nuk duhet të ndodhë më në asnjë rast.

Për realizimin e planit të prodhimit bujqësor e blegtoral duhet të mobilizohen të gjithë, Ministria e Bujqësisë, Partia në rreth e në bazë, kooperativistët. Kjo është detyra themelore e tyre dhe të gjitha këto duhet të bëhen në bazë të një plani. Por planin e bujqësisë duhet ta ndjekë edhe Ministria e Tregtisë e ta koordinojë me të vetin, gjatë vitit, duke u bazuar me realitetin konkret. Kur të shihet gjatë ndjekjes se plani i grumbullimit, ta zëmë, të mishit, nuk do të mund të realizohet, atëherë duhet të njoftohet Qeveria për këtë gjë, sepse ajo do të marrë masat për furnizimin e tregut me mish. Edhe për drithërat kështu duhet vepruar, të shihet më parë prodhimi, pastaj të vepronet për planin real të tepricave, pse kur nuk ka, ku do të

grumbullosh? Në rast se plani i prodhimit të drithit, fjala vjen, nuk realizohet, atëherë bazës, duke i bërë të qartë situatën, duhet t'i dërgohet urdhër që të mbajë në mënyrë rigorozë drithin që i nevojitet për vete për bukë, për farë dhe për kafshët dhe pastaj atë që do t'i mbetet, ta shesë tepricë. Vetëm pasi të bëhen këto llogari, do të jemi të qartë sa do të jenë tepricat. Në qoftë se kryetari i kooperativës, pasi i ka vajtur ky urdhër, për të marrë flamurin mashtron dhe njofton grumbullimin se do të japë teprica më tepër nga sa janë mundësitë, duke mos lënë sasinë e nevojshme për bukën e anëtarëve, për farën dhe për ushqim për kafshët, atëherë një kryetar si ky duhet menjëherë të pushohet. Teprica nuk ka, në rast se nuk sigurohet fara, buka e popullit dhe baza ushqimore për bagëtinë. Pse nuk realizohet plani i parashikuar, kjo është tjetër punë që duhet parë në mënyrë të veçantë nga ata të bujqësisë, por çështja është që për tepricat gjendja duhet treguar ashtu siç është, pavarësisht kush ka faj që rendimenti s'u realizua. Këtë realitet udhëheqja e kooperativës e ka për detyrë ta tregojë me kohë, ndryshe nuk dilet.

Lidhur me këto probleme duhet parë që kooperativat medoemos të sigurojnë drithin për bukë, farën dhe rezervën për ushqimin e blegtorisë në dimër. Sigurisht, kujdes më të madh të kemi për të siguruar njerëzit më parë, pastaj kafshët.

Në qoftë se Ndërmarrja Bujqësore e Kamzës nuk ka siguruar ushqim për kafshët, shteti duhet t'ia sigurojë asaj medoemos këtë ushqim për lopët nga rezervat, sepse ato na japin qumësht, mish etj. Vetë ndër-

marrja, sigurisht, duhet të bëjë përpjekje që ta realizojë medoemos planin, po kur nuk e realizon dot, të kërkojë, prandaj t'i jepen menjëherë nga rezervat, pastaj të analizohen shkaqet e këtij mosrealizimi.

Organet e pushtetit e të ekonomisë në rreth duhet të ndjekin në proces prodhimet bujqësore e blegtorale dhe kur shohin që punët nuk janë mirë, raportojnë mbi gjendjen, me qëllim që të merren masa në kohë dhe që të mos ndodhin më vonë të papritura. Punonjësit e grumbullimit nuk duhet të rrinë duarlidhur në zyrat e tregtisë, por të venë herë pas here në kooperativa për të parë si punohet, si zbatohen planet e detyrat, si bëhet majmëria, a u jepet në rregull ushqimi bagëtive e të tjera probleme dhe jo vetëm në fund kur vjen koha e dorëzimit të tepricave. Po nuk u veprua kështu, që njerëzit të jenë vazhdimisht nën kontroll për realizimin e detyrave, prodhimi nuk do të realizohet e pastaj bëj analiza sa të duash. Prandaj, në çdo tremujor, punonjësi i tregtisë duhet t'i vejë kooperativës e t'i thotë ku është me realizimin e detyrave sipas kontratës dhe t'i kërkojë llogari, kur ato nuk janë realizuar. Kjo duhet të bëhet edhe për arsyen që kooperativat të marrin masa për tremujorët e tjerë, që të realizojnë njërin pas tjetrit dhe në kohë zotimet e marra. Këto çështje duhet të ndiqen, pra, në proces e të mos lihen për në fund, kur kooperativa të mos ketë përmbushur dot zotimet dhe t'i krijohen deficite të mëdha, duke i justifikuar pastaj me «vështirësitë» në bujqësi dhe me arsye të tjera të qena e të paqena. Punonjësit e tregtisë e të grumbullimit kanë në këtë drejtim edhe ata një rol me

rëndësi, të jenë kurdoherë në luftë për zbatimin dhe mbrojtjen e vijës së Partisë, si të gjithë. Në qoftë se kryetari i kooperativës jep urdhër të shkelet direktiva, punonjësit tuaj duhet të njoftojnë se në filan kooperativë ose rreth ajo po shkelet, ata nuk duhet të shikojnë vetëm anën që të jenë në rregull me planin, por edhe të luftojnë që të mos lejohet shkelja e vijës dhe e direktivave të Partisë.

Po me qumështin është kudo mirë gjendja? Lidhur me rrjetin e tregtisë në fshat, mos kemi ndonjë ekzagjerim në shtrirjen e dyqaneve? Mos u entuziazmuam pa vend me çeljen e tyre në çdo fshat?

Unë mendoj se mund të mos kemi dyqan në çdo fshat. Kur dy ose tri fshatra janë afër, për shembull, gjysmë ose një orë larg njëri-tjetrit, një dyqan mund të shërbejë fare mirë për ta. Ngritja e dyqanit në çdo fshat është ideale, po duhet parë mundësia dhe leverdia ekonomike. Nuk ka pse të ketë dyqan në çdo fshat. Në një fshat të madh mund të ketë një dyqan, por kur fare pranë tij janë dy fshatra të vogla, këto mund të furnizohen atje. Në këtë rast, pse të ngremë dyqane edhe në këto dy fshatra? T'i shohim mirë këto gjëra, jo vetëm për këtë çështje, por edhe në fusha të tjera të ekonomisë, se na kostojnë.

Ja, për shembull, lexova një relacion me firmën e Koço Theodhosit dhe katër të tjerëve lidhur me pastrimin e ujërave të fabrikave nga kimikatet. Çfarë të shikoje atje? Për çdo vepër që ndërtohet thuhetse 25-30 për qind e vleftës nevojitet për pajisjet e pastrimit të ujërave. Sipas tij, u dashkan miliona lekë valutë vetëm për importimin e këtyre pajisjeve. Kështu do të

ecet? Të shohim nëse në këtë drejtim mund të bëjmë ndonjë gjë vetë. Ja, për shembull, në fabrikën e sodës janë bërë hauze dhe është dekantuar ujët. Kjo do të thotë se nuk i kemi si duhet këto gjëra. Natyrisht, është vështirë t'i zgjidhim të gjitha këto probleme në vend, por duhet të mendojmë edhe vetë për këto pajisje, nuk duhet të presim që çdo gjë të na vijë nga importi, sidomos për veprat e vogla. Nuk mund të barazohet fabrika e kartonit, për shembull, me pajisjet që duhen për një vepër tjetër të madhe sa një qytet i tërë, ku duhet të sjellim patjetër diçka nga jashtë për këtë qëllim, po jo ama të mbajmë sytë nga importi edhe për pajisjet për pastrimin e ujërave në disa fabrika të vogla. Duhet të bëjmë më shumë ekonomi në këto drejtime.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

ORGANIZATA E FRONTIT ËSHTË ABSOLUTISHT NË FAVOR TË REVOLUCIONIT, TË SOCIALIZMIT, TË EDUKIMIT REVOLUCIONAR TË MASAVE

*Fjala e mbylljes në mbledhjen e Këshillit
të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë¹*

19 prill 1972

Referati që mbajti në këtë mbledhje të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë shoku Ramiz², ishte shumë i rëndësishëm. Edhe diskutimet e shokëve, sipas mendimit të të gjithëve dhe mendimit tim personal, qenë shumë të mira, të zjarrta. Kjo tregon se udhëheqja e organizatës së Frontit

1. Në këtë mbledhje, në të cilën përveç anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm, morën pjesë edhe sekretarët e këshillave të Frontit Demokratik të rretheve të vendit, u diskutua dhe u miratua projektrezoluta «Mbi detyrat e Frontit Demokratik të Shqipërisë për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 6-të të PPSH».

2. Shoku Ramiz Alia, në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, mbajti referatin «Mbi detyrat e Frontit Demokratik të Shqipërisë për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 6-të të PPSH».

qëndron në një nivel të lartë politik dhe ideologjik, gjë që i detyrohet punës së madhe të palodhur të Partisë sonë të lavdishme, e cila vazhdimisht na mëson e na edukon si t'i shohim problemet, si t'u fute mi thellë, si t'i kuptojmë dhe të luftojmë për t'i zgjidhur ato drejt dhe, në punë e sipër për zbatimin e tyre, të zbulojmë edhe boshllëqet e anët e dobëta dhe të luftojmë për t'i zhdukur. Prandaj, e gjej të tepërt të përsërit edhe një herë ato probleme që prekën shokët në diskutimet e tyre.

Por, problemet e Partisë e të popullit tonë, që janë njëkohësisht probleme të Frontit, sado që të flasim në një mbledhje kaq të shkurtër si kjo e sotmja, janë të shumta. Populli ynë ecën vazhdimisht përpara në rrugë revolucionare, ai përmbys të vjetrën dhe krijon të renë, kurdoherë më të bukur, kurdoherë më të begatshme, në luftë me vështirësitë e me pengesat që ndesh dhe gjithmonë triumfon mbi to. Në këtë rrugë dalin vazhdimisht probleme të reja që kërkojnë zgjidhje dhe ne, si militantë të Frontit, përpiqemi, ashtu si na mëson Partia, t'i kryejmë me nder e me të gjitha forcat detyrat e mëdha që na ngarkohen, për interesat e socializmit, të atdheut, të popullit.

Faktet dhe jeta kanë treguar se ekzistenca e organizatës së Frontit Demokratik ka qenë dhe është e domosdoshme. Krijimi i saj në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare ishte një ngjarje me rëndësi të madhe historike për mbarë popullin shqiptar. Eksperienca e kësaj organizate të gjerë të masave pati dhe ka një rëndësi të madhe edhe për ndërtimin e socializmit në atdheun tonë. E ndërtuar mbi bazën e pari-

meve të drejta marksiste-leniniste dhe e udhëhequr nga Partia, organizata e Frontit Demokratik të Shqipërisë është absolutisht në favor të revolucionit, të socializmit, të edukimit revolucionar të masave. Ekspierienca e Partisë sonë në punën me Frontin dhe në udhëheqje të tij hedh poshtë tezat e revizionistëve modernë sovjetikë, bullgarë, polakë e të tjerë, të cilët kanë qenë prej kohësh kundër ekzistencës së kësaj organizate. Ata na thoshin neve se, përderisa kemi organizata të tjera, siç është ajo e Bashkimeve Profesionale, e Gruas, e Rinisë etj., s'ka nevojë të ekzistojë edhe një organizatë si Fronti.

Është e vërtetë që ne kemi edhe organizata të tjera, të cilat, ashtu si edhe Fronti, janë të masave, luftojnë në vijën e Partisë dhe kanë veçoritë e tyre, por edhe Fronti ka specifikën e tij, është organizata më e gjerë e masave të popullit, ku të gjithë punonjësit, duke përfshirë anëtarët e Partisë, anëtarët e organizatave të tjera të masave, punëtorë, kooperativistë, nëpunës, intelektualë etj., bëjnë pjesë aktive në radhët e tij, konfirmojnë vullnetin e tyre, drejtësinë e vijës së Partisë, sjellin eksperiencën e pasur që kanë grumbulluar. Kështu, komunisti sjell në Front eksperiencën e tij, gruaja të sajën, po kështu dhe i riu etj. Në këtë mënyrë, në një organizatë Fronti, ta zëmë në një lagje qyteti, sillet eksperienca e fabrikës, e shkollës etj., rrihen problemet e shumta nga më të ndryshmet e të larmishmet. Për këto arsye Partia jonë jo vetëm e mbajti Frontin, por e zhvilloi, e forcoi dhe i hapi atij perspektiva të gjera lufte dhe pune. Nuk duhet të mendohet që s'ka rëndësi kur ndonjëri,

meqenëse ka folur në një organizatë masash, ku bën pjesë, të mos flasë e të mos diskutojë edhe në organizatën e Frontit. Jo, meqë ka diskutuar, ta zëmë, në organizatën e bashkimeve profesionale, ka rëndësi që problemet, kur aty janë rrahur e janë zgjidhur mirë, të diskutohen edhe në organizatën e Frontit. Anëtari i organizatës së bashkimeve profesionale të një fabrike, për shembull, që ka diskutuar në kolektivin e tij për një problem shumë të rëndësishëm të karakterit ekonomik, politik, ideologjik dhe, si rezultat i shtrimit të drejtë të çështjes, ka ndihmuar në mobilizimin e gjithë anëtarëve të kësaj organizate me një frymë revolucionare, duke diskutuar edhe në organizatën e Frontit, ndihmon që problemi të trajtohet në të njëjtën frymë e të zgjidhet drejt dhe në kolektivat e tjerë. Kur diskutohet në organizatën e Frontit ajo që është ngritur me forcë dhe në nivelin e duhur në një organizatë profesionale ndërmarrjeje ose institucioni, shumë anëtarë të tjerë të Frontit, që punojnë në qendra të ndryshme pune, eksperiencën e fituar e çojnë në kolektivat e tyre, ku bëjnë ballafaqimin dhe rrahjen e mendimeve, shkëmbejnë përvojën e përparuar, kritikojnë më mirë shfaqjet e huaja në ndërgjegjen e punonjësve të tyre; krijohet kështu kudo një situatë e shëndoshë revolucionare. Ja, pra, se si në organizatën e Frontit ka vend për të diskutuar në mënyrën më masive për esencën e një ideje ose iniciative të madhe që është marrë në një fabrikë, kooperativë bujqësore ose institucion etj. për të edukuar njerëzit, për t'i mobilizuar ata më mirë në kryerjen e detyrave.

Misioni i Frontit Demokratik është historik, si për qytetin, ashtu dhe për fshatin veçanërisht, ku ai ka luajtur, luan dhe do të luajë një rol shumë të madh. Organizata e Frontit ka rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm për edukimin politik e ideologjik të njerëzve, por edhe për t'i hedhur ata në mënyrë masive në aksion, në prodhim, në punë. Të gjithë, duke qenë anëtarë të Frontit Demokratik, punojnë diku, në fshat, në qytet, në zyrë, në shkollë etj., prandaj pjesëmarrja në veprimtarinë e Frontit i hap cilitdo horizonte të gjera. Kjo kërkon që veprimtarinë e Frontit të mos e mbyllim në kuadrate, që drejtuesit e kësaj organizate në fshat, në lagje ose në rreth të kenë kujdes që të mos bien në sektarizëm. Partia e ka luftuar kurdoherë sektarizmin në organizatën e Frontit. Kur kemi për të organizuar ndonjë mbledhje të Frontit për një çështje të caktuar, qoftë kjo edhe e shkurtër, atëherë të bëhet kujdes që të përgatitet mirë dhe të krijohen mundësitë që të marrin pjesë të gjithë anëtarët, të cilët të flasim lirisht, të rrahin me njëri-tjetrin mendimet që kanë, me qëllim që të ngrihet ndërgjegjja politike dhe ideologjike e tyre. Është e qartë se në këtë mënyrë i shërbehet më mirë edukimit të masave të popullit.

Në të gjitha dokumentet e saj, Partia ka shtruar vazhdimisht detyra të rëndësishme për të kryer. Ajo na ka mësuar e na mëson se çështja e unitetit të popullit ka një rëndësi të madhe jetike për të ardhmen e vendit tonë. Unë nuk do të flas për këtë problem, pse shoku Ramiz e trajtoi bukur në referatin e tij, vetëm

dëshiroj të theksoj e të rekomandoj nevojën e thellimit në një çështje, të cilën Partia na e ka shtruar kurdoherë me forcë të madhe, në atë të forcimit të mëtejshëm të demokracisë proletare, të ngritjes së të gjithë popullit në luftën për zbatimin dhe për mbrojtjen e vijës së Partisë.

Partia na mëson të mos kemi asnjë druajtje për të kritikuar dhe korigjuar gabimet dhe të metat e kujtdoqoftë në punë, në jetë, në shoqëri, me qëllim që të kuptohet e të zbatohet drejt vija e saj, të mbrohet ajo në të gjitha aspektet. Dhe vija e Partisë mbrohet e fiton kur luftohet nga të gjithë për zhdukjen e të metave e gabimeve, kur u tregohet vendi njerëzve të këqij, kur zhduket frika që kanë disa për të kritikuar, kur në mendjen e secilit rrënjohet koncepti se autokritika, njohja ndershmërisht dhe hapur e gabimeve nuk janë poshtëruese, përkundrazi të lartësojnë përpara masës, të ngrenë autoritetin, pavarësisht se ke bërë gabim. Kjo është marksiste. Në qoftë se ndonjë që gabon, nuk bën autokritikë, po, përkundrazi, përpigjet të fshihet apo të mburret, masa e urren, ndërsa për atë që i pranon haptazi gabimet, thotë: «Ky flet drejt, vërtet për një moment u qorrua, iu zunë këmbët dhe ra, po është i singertë».

Partia, shokë, na mëson ta themi fjalën për çdo gjë, se kështu ndreqen njerëzit, kështu bëhemi më të fortë, mbrohet vija e Partisë, ndërtohet me sukses socializmi dhe punët na ecin përpara. Në fakt e tillë ka genë, është dhe do të jetë kurdoherë vija e Partisë sonë. Për këtë arsye jemi të fortë. Shqipëria ka sot pozita të shëndosha brenda e jashtë dhe kjo u detyrohet

vijës së drejtë të Partisë, parimeve marksiste-leniniste, ku ajo mbështetet, kuptimit dhe zbatimit me ndërjegje nga ana e masave të popullit të vijës revolucionare që ndjekin komunistët. Natyrisht, ka edhe disa njerëz, komunistë dhe jekomunistë, që nuk i kuptojnë si duhet këto çështje, por Partia që e di se njerëzit kur punojnë, edhe mund të gabojnë, nuk mungon të na i vërë në dukje gabimet përpara syve, që të mësojmë vazhdimisht e të mos i përsëritim. Ajo punon pa u lodhur për edukimin e punonjësve. Prandaj, atyre që vazhdojnë të gabojnë e të mos bëjnë përpjekje që të ndreqen, kurrkush nuk ua ka fajin, fajin e kanë vetë e masa që merret kundër tyre, është e merituar dhe ka për synim drejtpërdrejt edukimin e tyre, në radhë të parë, po dhe të gjithë punonjësve.

Pa u zgjatur, dua të theksoj se roli i Frontit është shumë i madh. Partia na mëson që këtë rol ta forcojmë kurdoherë e më shumë. Varet nga ne, militantët e Frontit Demokratik, që ta bëjmë më të fortë e të pashyeshme organizatën tonë. Kjo arrihet duke u aktivizuar të gjithë akoma më shumë, dhe jo vetëm në organizatat e tjera të masave ku bëjmë pjesë, por edhe në organizatën e Frontit, kurdoherë nën drejtimin e Partisë dhe të direktivave të saj.

Duke përfunduar ju uroj shëndet dhe punë të frytshme revolucionare në të gjithë sektorët dhe në realizimin e detyrave të mëdha të organizatës së Frontit që ju kanë besuar populli dhe Partia. Komiteti Qendror i Partisë është i bindur se Fronti Demokratik i Shqipërisë dhe udhëheqja e tij do t'i kryejnë si gjithmonë me nder të gjitha detyrat që u janë ngarkuar,

ashtu siç na mëson Partia jonë e lavdishme e Punës
që na udhëheq.

Rroftë Partia!

Rroftë Fronti Demokratik!

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**FORCIMI I LIDHJEVE TË SHËNDOSHA
TË POPULLIT ME USHTRINË — GARANCI
PËR MBROJTJEN E ATDHEUT**

*Përschëndetje drejtuar Komitetit të Partisë
të Rrethit të Pogradecit*

20 prill 1972

Të dashur shokë,

Komiteti Qendror i Partisë u informua me hollësi për stërvitjen treguese mësimore që u zhvillua me sukses të plotë në rrethin tuaj me kuadrot e Partisë, të pushtetit dhe të ushtrisë më 3 dhe 4 prill 1972.

Në këtë stërvitje populli trim e punëtor i rrethit tuaj, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, tregoi edhe një herë se ka kuptuar e vlerësuar drejt mësimet dhe direktivat e Partisë për forcimin e mbrojtjes. Në stërvitje u vu re një pjekuri e lartë ideologjike e politike, një frymë e shëndoshë patriotike e revolucionare, një përgatitje e mirë luftarake e një disiplinë shembullore nga masat punonjëse, si dhe një organizim e drejtim i shëndoshë e një bashkëveprim i ngushtë nga ana e të gjitha organeve të Partisë, të pu-

shtetit e të ekonomisë në terren dhe e organeve të Partisë e komandave në ushtri.

Në mënyrë të veçantë vlen të vihet në dukje puna juaj e madhe këmbëngulëse dhe rezultatet e arritura në veprat xheniere fortifikuese, sidomos në përgatitjen dhe në sigurimin e strehimeve me të gjitha pajisjet e domosdoshme për mbrojtjen qind për qind të popullsisë së qytetit nga goditjet ajrore.

Mjetet rrethanore për mbrojtjen e popullsisë nga lëndët kimike, radioaktive e biologjike, mjetet e tjera për likuidimin e pasojave të goditjeve ajrore, si dhe ato të luftës me mina etj., të përgatitura nga vetë populli dhe ndërmarrjet ekonomike, jashtë kohës prodhuese, të cilat i keni demonstruar aq bukur në ekspozitën e çelur për këtë qëllim, tregojnë se në rrethin e Pogradecit bëhet një punë krijuese, e gjithanshme, e lavdërueshme.

Për të gjitha këto, Komiteti Qendror i Partisë përgëzon nxehtësisht klasën punëtore, fshatarësinë kooperativiste, komunistët, të rinjtë dhe të rejat, gratë, pionierët e pensionistët, gjithë punonjësit, Komitetin e Partisë të Rrethit, kuadrot e pushtetit, të ekonomisë dhe të organizatave të masave, repartet ushtarake dhe forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore të rrethit të Pogradecit dhe u uron atyre suksese gjithnjë e më të mëdha si në të gjitha fushat e tjera, ashtu dhe në zbatimin e të gjitha detyrave që ka shtruar Partia për forcimin e mbrojtjen e atdheut.

Sukseset tuaja janë një shembull frymëzues për të gjithë punonjësit, për organet e Partisë, të pushte-

tit dhe komandat e forcave vullnetare të vetëmbrojtjes popullore në të gjitha rrethet e vendit.

Të dashur shokë,

Stërvitja treguese mësimore që ju zhvilluat ishte një shkollë e madhe për gjithë pjesëmarrësit. Ju tani keni fituar një përvojë më të madhe, keni krijuar një bazë materiale më të gjerë, të cilat duhet t'i zhvilloni e t'i përsosni vazhdimisht po me atë vullnet, këmbëngulje e disiplinë që treguat në përgatitjen dhe në zhvillimin e stërvitjes.

I kushtoni gjithnjë kujdes të madh përvetësimit në teori dhe zbatimit në praktikë të mësimëve të Partisë për përgatitjen e popullit dhe të vendit për mbrojtje, njohjes së artit ushtarak të luftës popullore si nga kuadrot, ashtu edhe nga masat punonjëse. Vëmendje e posaçme të tregohet për stërvitjen dhe kompaktësimin e vazhdueshëm të forcave vullnetare të vetëmbrojtjes popullore, për rritjen e aftësive dhe mjeshhtërisë luftarake të tyre, për forcimin e bashkëveprimt të tyre me repartet e ushtrisë, për përvetësimin e mirë nga ana e tyre të llojeve të ndryshme të luftimeve, sidomos të luftës me mina, si dhe të mënyrave për likuidimin e pasojave dhe për shpëtimin e popullatës nga goditjet ajrore. Repartet vullnetare të vetëmbrojtjes përbëjnë një forcë kolosale, masive të mbrojtjes sonë.

Vazhdoni të stërvitni rregullisht gjithë popullatën

për të ditur se si duhet mbrojtur në rast lufte, për të njohur e zbatuar me përpikëri rregullat në rast alarmi, për të përvetësuar përdorimin e mjeteve mbrojtëse nga lëndët helmuese, për ndihmën e shpejtë vetjake dhe reciproke etj.

Përvojën e madhe dhe shumë të vlefshme që ju keni fituar në ndërtimin e strehimeve për mbrojtjen e popullatës së qytetit, ta shtrini edhe për tunelizimin e objekteve ekonomike dhe të vlerave kulturore të rrethit tuaj. Përhapeni atë edhe në fshat për të shpejtuar e zgjeruar punimet xhieniere mbrojtëse-fortifikuese.

Bashkëpunimi i ngushtë midis organeve të Partisë, të pushtetit dhe organeve të Partisë e komandave në ushtri dhe forcimi i lidhjeve të shëndosha të popullit me ushtrinë janë garanci për suksese të mëtejshme në përgatitjen e masave punonjëse për mbrojtjen e atdheut. I forconi dhe i çelikosni këto lidhje përherë e më shumë. Komandat e reparteve të Ushtrisë Popullore, si kurdoherë, të japin të gjithë ndihmën e nevojshme për propagandimin dhe përvetësimin e njohurive të Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore nga të gjitha masat punonjëse.

Në vendin tonë sot ka shpërthyer kudo një hov i paparë revolucionar dhe një atmosferë e shëndoshë pune për të vënë në jetë programin madhështor të Kongresit të 6-të të Partisë dhe detyrat e planit të pestë pesëvjeçar. I gjithë populli, krahas punës vetëmohuese për ndërtimin e socializmit, qëndron si një trup i vetëm në roje të fitoreve të socializmit. Ai nuk do të lejojë kurrë që të preken sadopak kufijtë e

shtrenjtë të atdheut tonë socialist. Kush do të orvatet të ndërmarrë një aventurë të tillë, ai do të gjejë vdekjen e sigurt.

Nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës, të ndriçuar nga vija e saj e drejtë marksiste-leniniste, me radhë të shtrënguara, të ecim me guxim përpara, për ta bërë atdheun tonë më të fortë, më të bukur e më të begatshëm.

Përshëndetje komuniste

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DISA PROBLEME TË KUPTIMIT DHE TË ZBATIMIT NË PRAKTIKË TË DIREKTIVAVE PËR PUNËN E PARTISË ME MASAT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

24 prill 1972

Të më falni që do të përmend diçka që nuk ka lidhje direkte me problemin që do të shqyrtojmë. Mbrëmë dhe parmbremë, rastësisht, i hodha një sy librit të fizikës që është hartuar për klasën e fundit të shkollës së mesme të arsimit të përgjithshëm. Pasi e pashë tekstin, pyeta vajzën, që është në klasën e 12-të të kësaj shkolle: «Si vete me fizikën moj vajzë?». «Nuk para e kuptoj, baba», m'u përgjigj ajo. Ky libër që pashë unë, m'u duk me të vërtetë i pakuptueshëm. Atje çdo radhë ishte mbushur me formula; kishte vizatime aq të ndërlikuara, sa u habita dhe thashë me vete: si është e mundur kjo?! Katër veta kishin pu-

1. Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme lidhur me kuptimin dhe me zbatimin në praktikë të direktivave për udhëheqjen e Partisë në organizatat e masave.

nuar për ta përgatitur atë libër, por, si duket, autorët nuk kanë pasur parasysh sa duhet mundësitë e asimilimit të lëndës nga nxënësit. Mendoj se specialistët e arsimit duhet ta shikojnë medoemos këtë anë të çështjes.

Sido që kanë kaluar 40 vjet nga koha kur e kemi bërë ne shkollën e mesme, në përgjithësi, nuk mund të themi se atëherë programi ka qenë i keq. Nuk kanë qenë kurrë kështu si ky që po ju them tekstet e fizikës në të cilat mësonim ne në ato kohë. Është e vërtetë që sot shkenca e fizikës ka ecur më përpara, por shpejtësia e zërit, e dritës etj., nuk kanë ndryshuar. Në qoftë se në tekstin e fizikës është futur një kapitull i ri, për shembull, për energjinë bërthamore, ky duhej paraqitur në përshtatje me nivelin, moshën dhe mundësitë e asimilimit të nxënësve të shkollës së mesme, që ta kuptojnë shumica e tyre, me një nivel mesatar zhvillimi dhe jo vetëm 3-4 nxënës të shkëlqyer. As shkolllat, as tekstet nuk i bëjmë për disa, por për masën e nxënësve.

Në qoftë se këto tekste i hartojnë pedagogë të shkollave të larta, këta nuk duhet të futin në tekstet e shkollave të mesme përmbajtjen e kursit të fizikës që japin ata në leksionet e tyre, ndryshe e mbushin librin e klasës së 12-të me formula, pa dhënë aty ato shpjegime që janë të domosdoshme për nxënësit. Ata që janë pedagogë të shkollave të larta, si fizikanë e të tjerë, janë më të zotë, prandaj janë në gjendje të bëjnë libra më të përshtatshëm për nxënësit e shkollave të mesme. Por, me sa duket, disa prej tyre, nuk marrin mundimin që të zbresin në nivelin e nxënësit

dhe të programit. Këta, mendoj unë, nuk e vrasin shumë mendjen se çfarë njohurish duhen dhe si u duhen paraqitur ato nxënësve. Nuk kërkohet të futet në tekstet e shkollave të mesme gjithçka që di vetë specialisti i përgatitur posaçërisht në një fushë të caktuar të dijes, si, bie fjala, në fizikë, në kimi etj.

Në qoftë se shkohet nga parimi që nxënësit e shkollave të mesme t'i pajisim me njohuritë e fizikës, kimisë etj., në nivelin e studentëve të universitetit, kjo do të ishte një punë krejt e kotë. Ne synojmë t'u japim nxënësve të shkollës së mesme një kulturë të përgjithshme, që ata të dinë nocionet bazë të fizikës, të historisë, të gjeografisë etj., që të mundin kështu të kuptojnë e të studiojnë në jetë në mënyrë të pavarur e ta zgjerojnë atë kulturë që marrin në shkollë. Nuk është me vend të mendohet se tërë ata që mbarojnë shkollat e mesme duhet të venë doemos në universitet dhe, në funksion të këtij qëllimi, të përgatiten edhe tekstet shkollore.

Pastaj filloi diskutimi i pikës së parë të rendit të ditës. Pasi diskutuan shokët e tjerë, në fund, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Jam dakord me vërejtjet dhe diskutimet që bënë shokët lidhur me kuptimin dhe zbatimin në praktikë të direktivave për udhëheqjen e Partisë në organizatat e masave, prandaj nuk mendoj të hyj në hollësira për këtë çështje. Dëshiroj vetëm të vë në dukje se problemet që po diskutojmë nuk ngrihen për herë të parë. Nëse Partia i rithekson ato herë pas here, këtë e bën për të korrigjuar gabimet që mund të jenë vërtetuar, për të përmirësuar më tej punën, «për të shkundur

pluhurin». Qëllimi është që direktivat të kuptohen e të zbatohen sa më mirë nga komunistët dhe nga masat, që ato të mos merren në asnjë rast të shkëputura nga problemet dhe nga nevojat e zhvillimit të vendit. I parë në këtë prizëm, edhe fjalimi që mbajta kohët e fundit në Burrel, nuk ishte diçka e shkëputur nga këto nevoja të kohës.

Ngul këmbë në domosdoshmërinë e kuptimit drejt dhe të zbatimit si duhet të direktivave, pse nga një gjykim i përciptë dhe i pamatur në këtë drejtim mund të lindin rreziqe për Partinë, në shkuarjen nga e djathta ose nga e majta. Tani që diskutohet për fjalimin e Matit, ndonjë që nuk e kupton vijën e Partisë mund të mendojë se iu hap shtegu liberalizmit dhe krijimit të pikëpamjeve të shtrembra: «Oburra të kritikojmë me vend e pa vend». Liberalizmi do të ishte një nga rreziqet e mëdha, ashtu siç mund të ishte nga ana tjetër edhe sektarizmi, që e bën Partinë të mbyllet në guaskën e saj dhe ndaj atyre komunistëve që bien në gabime, që shkelin vendimet e direktivat e saj, të diskutohet dhe të merren masa vetëm në mbledhjet e Partisë e jo edhe para kolektivave ku ata punojnë. Të dyja këto shfaqje, si liberalizmi edhe sektarizmi, janë shumë të rrezikshme dhe duhen luftuar në çdo formë që të shfaqen. Prandaj, për kuptimin e thellë dhe për zbatimin praktik në jetë të direktivës, duhet ndjekur vazhdimisht rruga e drejtë marksiste-leniniste. Për këtë është e domosdoshme të mbahen kurdoherë parasysh mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e të Stalinit dhe eksperiencia e fituar nga Partia jonë gjatë gjithë jetës dhe luftës së saj revolucionare.

Partia duhet të jetë gjithnjë në ballë të masave punonjëse dhe, së bashku me to, të zbatojë me luftë e me përpjekje, direktivat, udhëzimet, normat dhe vendimet që merr. Por në jetë, në punë e sipër, Partia dhe masat që ajo udhëheq duhet të mendojnë e të veprojnë për të korigjuar e për të plotësuar të metat e boshllëqet që mund të kenë direktivat dhe udhëzimet e lëshuara dhe, në këtë proces, të korigjojnë edhe gabimet që bëjnë komunistë e punonjës të veçantë pa Parti. Kjo punë duhet të bëhet ca më shumë sot, në krahasim me të kaluarën, për arsye se situatat janë krejt të ndryshme nga koha e luftës.

Tani nuk jemi më si gjatë kohës së Luftës Nacionalçlirimtare, kur kushtet na impononin t'i kryenim shumë punë në mënyrë të mbyllur e rreptësisht konspirative, për arsye se shumë nga direktivat e vendimet e Partisë nuk duhej t'i mësonte armiku, i cili bënte të gjitha përpjekjet që të vihej sa më parë në dijeni të tyre, me qëllim që të përpunonte pastaj plane për ta goditur Partinë. Në qoftë se armiku, gjatë pushtimit fashist, do të mësonte me kohë një direktivë të Partisë për të sulmuar një objekt ose cilët ishin komunistët që bënin pjesë në një celulë, cilët pranoheshin dhe cilët nuk pranoheshin në radhët e saj, si dhe arsyet pse nuk pranohej ndonjë në Parti ose pse kritikohesh ky ose ai komunist, pra, në rast se informohej mbi vendimet që merreshin, atëherë e kishte më lehtë ta godiste rëndë celulën dhe gjithë Partinë. Prandaj ruajtja e konspiracionit në ato kushte ishte një armë e fortë në duart e Partisë në luftën që ajo bënte kundër pushtuesve dhe tradhtarëve për çlirimin e atdheut, për lirinë e popullit.

Edhe tani ne jemi në luftë me armiqtë e klasës, prandaj duhet ta ruajmë si sytë e ballit Partinë dhe unitetin e saj, duhet të ruajmë sekretet shtetërore dhe normat e rregullat organizative e ideologjike të Partisë. Por, duke qenë kurdoherë vigjilentë për këto çështje, nuk duhet të harrojmë se gjendja është krejt ndryshe në krahasim me atë periudhë të vështirë që kemi kaluar. Sot Partia është në krye të masave, ajo është në pushtet. Me luftë e me përpjekje janë zhdukur klasat antagoniste në vendin tonë. Partia ka forcuar aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë kooperativiste. Partia aktualisht drejton gjithë jetën e vendit, drejton ekonominë me anë planesh pesëvjeçare, të cilat nuk mund të realizohen pa pjesëmarrjen aktive të gjithanshme të ndërgjegjshme dhe me një kuptim të lartë politik dhe ideologjik nga masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit.

Në kohën e luftës Partia u bënte thirrje komunistëve të ishin kurdoherë sypatrembur, në ballë të çdo beteje, të sakrifikonin edhe jetën po të ishte nevoja, të vriteshin si trima për interesat e lartë të atdheut dhe të popullit, të ishin shembull në çdo drejtim para masave. Zbatimi me heroizëm nga komunistët i këtyre direktivave të Partisë solli ditët e shënuara të çlirimit.

Tani Partia u ka bërë dhe vazhdon t'u bëjë thirrje komunistëve të jenë në ballë të luftës për realizimin e planeve dhe për mbrojtjen e fitoreve të arritura. Dhe komunistët janë në pararojë për zbatimin e direktivave të Partisë. Në kushtet e reja është e domosdoshme që ata të mendojnë dhe të luftojnë me një stil të ri pune dhe të zhdukin mbeturinat e metodës së

vjetër të punës së mbyllur të celulave dhe të komiteve të Partisë, që ishin të përshtatshme për periudhën e luftës, por jo më për sot. Mua më duket se tani s'ka arsye ta mbajmë të mbyllur si atëherë direktivën e Partisë. Ne duhet t'i ruajmë dhe t'i zbatojmë si duhet nenet e Statutit të Partisë dhe rregullat e saj organizative. Por, derisa në parim pranojmë si të drejtë që, për gabimet e kryera, të kritikojmë çdo komunist, qoftë ai sekretar organizate-bazë, sekretar komiteti partie në rreth ose anëtar i Komitetit Qendror apo i Qeverisë, derisa pranojmë që jo vetëm ta kritikojmë, po, kur është rasti, edhe ta shkarkojmë atë, bile të kritikojmë edhe një forum të tërë partie për këtë apo atë faj, atëherë ç'arsye organizative na pengojnë që këto çështje t'i mbajmë të mbyllura kur kanë cenuar interesat e Partisë dhe të popullit? Pse të mos ua bëjmë të ditur punonjësve të kolektivit të caktuar arsyet e këtyre masave? Pse të mos u themi atyre për ç'shkaqe u kritikua apo u shkarkua një komunist nga detyra apo edhe shkakun kur kritikohet një forum i tërë? Mua më duket se arsye të tilla për një punë të mbyllur, sot nuk qëndrojnë.

Le të vijmë tani te çështja e mbledhjeve të organizatave-bazë dhe të komiteteve të Partisë. A i kemi bërë dhe a vazhdojmë t'i bëjmë këto në nivelin e duhur, në bazë të direktivave të Partisë? Konkluzioni është se këto mbledhje dhe këto direktiva nuk zbatohen gjithnjë në lartësinë që kërkohet. Vihet pyetja: Pse nuk zbatohen? Siç theksoi edhe shoku Ramiz, konkluzionet e mbledhjeve të Byrosë Politike e të Sekretariatit të Komitetit Qendror botohen dhe, në formën

e buletineve, i dërgohen gjithë Partisë për t'i studiuar dhe për të përfituar prej tyre. Por, siç na thonë, ka nga këto materiale që disa sekretarë organizatash-bazë, sa i marrin, i lexojnë vetë, pastaj i futin në sirtare, në vend që përmbajtjen e tyre t'ua bëjnë të njohur komunistëve, pa lëre pastaj masave punonjëse. Këta shokë e kuptojnë gabim shënimin që vihet mbi këto materiale: «Për përdorim të brendshëm».

Çfarë tregon kjo? Kjo tregon se disa nga këta shokë nuk e kanë të qartë akoma në ç'situata rrojmë. Ata nuk e kanë kuptuar si duhet që për një vendim të udhëheqjes është e nevojshme të vihen në dijeni të gjitha masat e Partisë dhe të popullit. Materiale të tilla që dërgohen për gjithë Partinë nuk ka pse të mbyllen në sirtarin e sekretarit të organizatës-bazë, derisa nuk ka asgjë të veçantë për t'i mbajtur sekret. Këtë çështje këta udhëheqës partie më duket se nuk po e kuptojnë sa duhet, prandaj në bazë të situatave që po kalojmë, të reflektojnë më mirë dhe në asnjë mënyrë të mos lejojnë më qëndrime të tilla. Këto qëndrime mbahen sepse ai sekretar organizate ose komunist rron akoma me mentalitetin e vjetër të punës së mbyllur, ose kërkon të mbajë për vete «monopolin» e mendimeve që përmbajnë materialet e këtij organi, duke synuar që të lërë përshtypjen e rreme të shokët, sikur vetëm ai ka horizont të gjerë! Është e dënueshme të mos bësh ç'është e mundur që të gjithë shokët të marrin njohuri mbi materialet e Komitetit Qendror.

Asnjëherë Partia dhe Komiteti Qendror i saj nuk kanë dhënë direktivën që materialet e hapëta të mbahen fshchur. Të gjithë ne, dhe në mënyrë të veçantë

shoku Hysni [Kapo], që merr vazhdimisht takim me sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve, ua kemi shpjeguar shokëve të rretheve këtë gjë, por disa vuajnë akoma nga ai mentalitet i vjetër që vura në dukje, nga i cili duhet të shkunden sa më parë.

Nga ana e Komitetit Qendror të Partisë, nga ana e Byrosë Politike dhe e Sekretariatit, si dhe nga Qeveria, sipas nevojës dhe problemeve, shpeshherë në rrethe dhe në bazë dërgohen vendime e direktiva nga më të ndryshmet. Shpesh ne kemi kërkuar që shokët e rretheve dhe të bazës të na dërgojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për to. Këtë e theksojmë se jemi të ndërgjegjshëm që të gjitha ato që diskutojmë e vendosim nuk janë kurdoherë të përsosura, të plota e të pakorrigjueshme. Prandaj vazhdimisht kërkojmë nga Partia të na flitet për ndonjë të metë e boshllëk që konstatohet në to ose për ndonjë çështje të vendimeve apo direktivave që praktika vërteton se nuk mund të gjejë zbatim e duhet ndryshuar. Një kërkesë të tillë gjithnjë e kemi bërë e përsëritur, por në këtë drejtim shumë rrallë kemi pasur vërejtje nga ana e komiteteve të Partisë, pa lëre pastaj nga ana e shokëve të bazës. Kurse jeta ka provuar se janë marrë vendime, janë dhënë edhe direktiva që s'kanë qenë të plota dhe pa gabime.

Në goftë se qendra bën diçka për informimin e Partisë e të masave për problemet që ajo shqyrton dhe për vendimet që merr, kjo punë në rreth bëhet me dobësi të mëdha. Problemet që shqyrton dhe vendimet që merr komiteti i Partisë i rrethit mbeten gati të panjohura, për ato kanë dijeni vetëm një numër i kufi-

zuar kuadrosh, ata që bëjnë pjesë në forum dhe disa të tjerë që, sipas nevojës, thirren në mbledhje për të raportuar, për të dhënë sqarime ose që janë më të interesuar për problemet që shqyrtohen. Çështjen nuk e kam vetëm që të na dërgohen edhe neve këtu, në aparat të Komitetit Qendror, tematika dhe mënyra e shqyrtimit të problemeve nga ana e komiteteve të Partisë, megjithëse dihet që dërgimi i tyre për Komitetin Qendror ka rëndësinë e vet, por rëndësi të madhe ka gjithashtu dërgimi dhe zbërthimi i tyre në bazë dhe në masa, kontrolli i zbatimit deri në fund i këtyre vendimeve dhe verifikimi i drejtësisë së tyre në jetë. Kjo është një nga format e domosdoshme të punës që do t'i ndihmonte shumë komitetet e Partisë për të qenë në ballë, në udhëheqje të masave të gjera punonjëse të rrethit për zbatimin e vendimeve që merren nga ana e tyre.

Në qoftë se ju, shokë drejtues të rretheve, dëshironi të jeni në krye të punëve, në krye të udhëheqjes së masave, atëherë është e domosdoshme të punoni që problemet që shqyrtohen të gjejnë jehonë të gjerë e të shpejtë në masat e gjera të popullit në rreth, të inkuadruara në organizatat e masave, ku ato bëjnë pjesë. Prandaj këto probleme nëpërmjet këtyre organizatave t'u bëhen atyre të njohura, t'u shpjegohen e t'u qartësohen, pastaj të punohet për t'i mobilizuar në zgjidhjen me sukses të tyre. Masat duhet të shohin kështu se Partia nuk qëndron në krye vetëm për arsye se ajo udhëheq organet e diktaturës së proletariatit, porse merr vendime të drejta e të rëndësishme dhe jep direktiva për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që

preokupojnë vendin, i sqaron masat e i bën të ndër-gjegjshme për vlerën e këtyre vendimeve e direktivave dhe i mobilizon për t'i zbatuar ato në praktikë, gjë që ndihmon për të revolucionarizuar e çuar më përpara jetën e njerëzve dhe mirëqenien e tyre. Kjo kontribuon për të forcuar çdo ditë e më shumë unitetin në popull, për të çimentuar dashurinë dhe solidaritetin socialist mes punonjësve, ndihmon për të zgjidhur çdo gjë në rrugë të drejtë dhe me një dashamirësi të madhe. Të gjitha këto komiteti i Partisë me punën e vet ua bën të qarta masave. Prandaj tërë veprimtaria e tij në rreth, duke u mbështetur në vendimet e Kongresit të Partisë, në direktivat e Komitetit Qendror, në vendimet e Byrosë Politike, të Sekretariatit të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë, është e domosdoshme që të pasqyrojë gjendjen, nevojat dhe aspiratat e masave.

Këtej del nevoja që masat të dinë përse u mblodh, për shembull, në këtë ose në atë rast, komiteti i Partisë i rrethit të tyre apo organizata-bazë dhe çfarë vendosën. E kanë ato një të drejtë të tillë apo nuk e kanë? Sigurisht që e kanë, sepse Partia ndërton socializmin së bashku me masat, të cilat duhet të dinë mbi ato që diskuton dhe vendos Partia, ndryshe nuk do të mobilizohen me të gjitha forcat dhe në mënyrë të ndër-gjegjshme për zbatimin e vendimeve që merren. Mund të ketë dhe ka vendime të brendshme organizative që marrin komitetet e Partisë, ka çështje që duhen mbajtur sekret nga armiku i klasës, i brendshëm dhe i jashtëm, por shumica e vendimeve të komitetit të Partisë të një rrethi, nuk janë të kësaj natyre, prandaj është e nevojshme dhe e domosdoshme t'u komunikohen

masave. Pra, kur komiteti i Partisë në rreth shqyrton probleme ekonomike ose nevojën e marrjes së masave për forcimin e disiplinës në punë, për edukimin e rinisë ose për mbarëvajtjen e shkollave etj., atëherë pse të mos u komunikohen punonjësve këto probleme, pse të mos u shpjegohet përmbajtja e vendimeve që merren? Vendimet e Partisë u interesojnë të gjithëve dhe ato nuk mund të zbatohen vetëm nga komunistët, po nga të gjithë punonjësit, me komunistët në ballë të luftës.

Ne nuk e kemi aq mirë praktikën e deritanishme, lidhur me informimin e masave për punët e vendimet e Partisë, praktikë e cila reflektohet edhe në metodën e punës së organizatave-bazë. Sekretari i organizatës-bazë të Partisë në një ndërmarrje, kooperativë bujqësore, institucion etj., qysh në përgatitjen e planit të punës dhe të rendit të ditës të mbledhjeve, në mjaft raste nuk vepron drejt. Prandaj ndodh shpesh që ky rend dite atje është i zbehtë dhe nuk i bëhet i njohur kolektivit punonjës. Kolektivi punonjës jo vetëm të dijë me kohë çfarë do të shqyrtojë organizata-bazë, por edhe pas mbledhjes të vihet në dijeni ç'vendosi organizata-bazë e Partisë, që të dijë pastaj pse të mobilizohet konkretisht në punën që i është ngarkuar, në bazë të direktivave të forumeve më të larta dhe të vetë organizatës-bazë që ka në dorë direktivat dhe vendimet e Partisë, të Kongresit, të Komitetit Qendror, të cilat i merr nëpërmjet shtypit të përditshëm dhe nëpërmjet buletineve të Komitetit Qendror. Për këtë qëllim Partia ka theksuar vazhdimisht që rendi i ditës i mbledhjes së organizatës-bazë, në shumë raste, mund

të afishohet për të vënë në dijeni komunistët dhe punonjësit pa Parti. Por, kur të mbarojë mbledhja, sekretari i organizatës-bazë duhet ta mbledhë sa më parë kolektivin për ta informuar për problemet që u diskutuan, çfarë u vendos etj. Kur ndodh që në mbledhje diskutohet edhe për ndonjë komunist që nuk ka kryer detyrën ose nuk ka pasur sjellje të mira në kolektiv, në shoqëri apo në familje dhe organizata-bazë e ka kritikuar, kolektivi, gjithashtu, jo vetëm të informohet për masën që është marrë ndaj tij, por të njoftohet edhe për qëndrimin që ka mbajtur ai ndaj kritikës, si dhe për zotimin që ka marrë se nuk do ta përsëritë më gabimin.

Duke vepruar kështu, atëherë do të shikojmë sa mirë do të revolucionarizohet jeta në organizatën-bazë, sa mirë do t'i kryejnë detyrat komunistët, sa përpara do të shkojnë punët. Me një praktikë të tillë vetë masat e paorganizuara në Parti do të interesohen për problemet e organizatës, do ta ndihmojnë atë me mendime e propozime, do të nxiten të zbulojnë dobësitë e të metat në punë si të organizatës, ashtu edhe të njerëzve që s'punojnë mirë do ta ndihmojnë organizatën të njohë më në hollësi problemet që preokupojnë kolektivin. Gjallërimi i jetës në kolektiv e në organizatë do ta ndihmojë shumë këtë të fundit edhe për të zgjedhur çfarë problemesh të shtrojë në mbledhjet e saj.

Sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës tha në diskutimin e tij këtu se komunistët nuk vënë fletërrufe në kolektivin ku punojnë. Në kuadrin e një pune të mbyllur, me ruajtjen e një tradite jo të përshtatshme pune për situatat aktuale të zhvillimit

tonë, është e kuptueshme pse komunistët nuk vënë fletërrufe në qendrat e punës. Komunisti në këto rrethana mendon: «Përse të vë fletërrufe për këtë ose atë çështje, përderisa problemën e kam ngritur në organizatën-bazë, ku kam diskutuar, kam bërë kritikë dhe autokritikë etj.?». Vërtet komunisti këtë mund ta ketë bërë, po fjala e tij mbeti vetëm në organizatë, derisa nuk u bëhet e njohur edhe masave. Një praktikë pune si kjo nuk ndikon për mirë, nuk e inkurajon kritikën e masave ndaj nesh, komunistëve, përkundrazi, ajo e dobëson efektivitetin e kritikës, si dhe të autokritikës nga ana e tyre. Prandaj është e domosdoshme që ne ta ndryshojmë këtë situatë.

Një komunist që ka gabuar mundet dhe duhet kritikuar medoemos në mbledhjen e organizatës-bazë ku ai bën pjesë, po kjo nuk është e mjaftueshme. Partia asgjë nuk fiton kur masave u mbahet fshehur gabimi që ka bërë ndonjë komunist. Kjo bën që shumë nga ata që nuk janë në Parti, të mos kenë dijeni për këtë. Por ndonjë punonjës pa Parti që i ka vënë re sjelljet jokorrekte apo qëndrimet e gabuara në punë të një komunisti që ka në repart, në brigadë, në shkollë e kudo, duke marrë parasysh se Partia i mëson masat të kritikojnë pa druajtje, mund të ngrihet e të thotë: «Ti, shok, që je kuadër dhe komunist, ke mbajtur këtë qëndrim të gabuar, prandaj nuk na shpjegon pak, pse e ke bërë këtë dhe si mendon të mos e përsëritësh më?». Në një rast të tillë komunistët jo vetëm nuk duhet t'ia fshehin gabimin shokut, por përkundrazi, t'i japin të drejtë kritikuesit dhe, në qoftë se këtë çështje e kanë parë edhe në organizatën-bazë, t'ia bëjnë të ditur ko-

lektivit se edhe në mbledhjen e saj «ia kanë larë kokën» atij që gaboi.

Partia del para masave me kritikë të hapët dhe me program për çdo gjë. Ajo nuk ka arsye pse të mos thotë që ky ose ai komunist ka gabuar në këtë apo në atë drejtim, s'ka pse të mos u thotë masave edhe kur ka gabuar një organizatë e tërë dhe t'u tregojë atyre se si duhet të veprohet për të korigjuar drejt dhe rrënjësisht gabimet. Bile për këtë ajo duhet të kërkojë patjetër ndihmën dhe mendimin e njerëzve të paorganizuar në Parti, që përbëjnë shumicën dërrmuese të punonjësve. Duke ecur në këtë rrugë, ne do të jemi në rregull me masat, të cilat, me siguri do të thonë: «Rroftë Partia, pse, kështu si po vepron ajo, është rruga më e drejtë!». Kështu mendon dhe shprehet njëzëri mbarë populli edhe tani që diskuton për fjalinë që mbajta unë në Plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit, ku s'bëra gjë tjetër veçse shpreha pikëpamjen e Partisë para masave, të cilave iu bë edhe një herë tjetër thirrje të kritikojnë pa druajtje cilindo që bën faje dhe gabime.

Ata që nuk respektojnë normat e demokracisë socialiste kanë frikë nga masat, nga fjala e drejtë e tyre, nga ballafaqimi me to, se nuk është formuar akoma koncepti i drejtë për t'i qëndruar përballë së vërtetës. Ky qëndrim është shumë i rrezikshëm për Partinë, prandaj duhet kuptuar thellë. Në qoftë se demokracia socialiste kuptohet si mjeti që siguron pjesëmarrjen dhe ndikimin e masave të gjera punonjëse në të gjitha punët e qeverisjes së vendit, po që se krijohen kushte efektive që për një çështje ose problem të cak-

tuar, për të cilin u drejtohem i masës ose Partisë, ata të përgjigjen lirisht, duke dhënë mendimin e vet, atëherë nuk do të duken as cektësia, as burokratizmi, as frika.

Mos vallë ky qëndrim që mban Partia e ka ulur sadopak autoritetin e saj? Jo, në asnjë mënyrë nuk e ka ulur këtë autoritet. Në të kundërtën, ky qëndrim e ka ngritur autoritetin e Partisë në një shkallë akoma më të lartë përpara punonjësve të paorganizuar në Parti. Në qoftë se këto çështje i thellojmë më tej e deri në fund, natyrisht, s'ka dyshim që akoma më tepër do të forcohet autoriteti i Partisë. Prandaj nuk na lejohet të shkëputemi nga masat, të kufizohemi duke i diskutuar problemet në rreth të mbyllur, vetëm në mbledhjet e organizatës-bazë.

Mund të ndodhë, në ndonjë rast që të dalin elementë të veçantë, kritizërë të sëmurë e ngatërrestarë, pa folur për ndonjë armik, të cilët, nën parullën e «demokracisë» e të thirrjes së Partisë për të kritikuar me guxim të metat e dobësitë, përpiqen të përfitojnë për të intriguar, për të sulmuar padrejtësisht kuadro, komunistë e njerëz të ndershëm, për të nxirë punët, e njerëzit. Këtyre njerëzve t'u tregojmë vendin. Por edhe në këto raste nuk humbet Partia. Përkundrazi, ajo fiton, sepse, nga njëra anë, kolektivi do t'i njohë më mirë këta elementë, ndërsa, nga ana tjetër, vetë masat do të dinë të kundërshtojnë pikëpamjet e gabuara dhe t'u tregojnë vendin intrigantëve.

Kritikat e punonjësve jo vetëm duhen dëgjuar me vëmendje e duhen realizuar, duke mbajtur qëndrim serioz e të drejtë para tyre, por duhen marrë edhe ma-

sá të menjëhershme rrënjësore për ndreqjen e gabimeve. Partia nuk lejon që kritika e masave të pranohet formalisht, sa për të shkuar radhën, pse njerëzit e paorganizuar në Parti kanë plotësisht të drejtë të thonë: «Ju kritikua një herë, dy dhe tri herë, mirëpo shohim që ju nuk po lëvizni, atëherë çfarë bëni kështu, ju, shokë komunistë? Sa herë do të vazhdojmë t'ju kritikojmë dhe ju të mos e ndreqni situatën?». Prandaj, në qoftë se organizata-bazë nuk vepron në rrugën revolucionare të Partisë për të ndrequr sa më parë një gjendje jo të kënaqshme, një situatë të sëmurë, atëherë jo vetëm që ajo e lë veten të bjerë në bisht të masave, por kritika për faj të një komunisti të veçantë kalon nga ky tek organizata-bazë. Në rast se edhe kjo nuk merr masa, nuk shkundet, kritika i drejtohet forumit dhe kështu me radhë. Prandaj ndaj komunistëve që gabojnë është e domosdoshme të përdoren këto forma pune që vura në dukje; të gjithë, kur gabojnë, të kritikohen haptas para masave, ndryshe do të shkaktoheshin situata të rënda dhe Partia do të shkëputej nga masat.

Po të kuptohen dhe të zbatohen drejt direktivat e Partisë, atëherë, si të gjithë, do të bëjnë fletërrufe edhe komunistët, bile edhe për anëtarët e Partisë, dhe një gjë e tillë nuk e prek aspak organizatën-bazë. Pse të mos vërë fletërrufe një komunist, kur shikon se ky ose ai anëtar partie, me gjithë vendimin që është marrë në organizatën-bazë, me gjithë kritikën e rreptë që mund t'i jetë bërë atje, vazhdon të gabojë? Bashkë me fletërrufenë, ai ka të drejtë bile të kërkojë që ky anëtar partie, i cili po e përsërit fajin, të japë llogari

edhe një herë përpara organizatës-bazë ose kolektivit. Në qoftë se këtë kërkesë të drejtë të tij nuk e përfill, ta zëmë, sekretari i organizatës-bazë, edhe në adresë të këtij të vihen fletërrufe.

Tani le të vijmë te një çështje tjetër që na preokupon të gjithë, te çështja e caktimit të rendit të ditës në bazë të njohjes së jetës.

Pa munguar të bëjmë autokritikë për vete, pse në këtë drejtim kemi edhe ne të metat tona, nuk mund të mos vëmë në dukje se përgjegjësi keni edhe ju shokë të rretheve. Parullat dhe vijën e Partisë që «baza dhe takimet me punonjësit të japin gjallëri», «të japin shpirt», «të japin kurajë», «të hapin perspektiva» etj., ju nuk i keni pasur gjithnjë parasysh, prandaj nuk na e keni dhënë kurdoherë ndihmën e duhur në këtë drejtim.

Komitetet e Partisë janë ngarkuar të jenë në krye të të gjithë punës së organizatës së Partisë në rreth dhe për këtë mbajnë përgjegjësi të madhe. Për zhvillimin e veprimtarisë së tyre ata bëjnë plane, caktojnë mbledhjet që duhet të zhvillohen në periudha të caktuara e me rend dite të aprovuar. Po sa të goditura janë këto rende dite që hartojnë, sa u përgjigjen ato nevojave të kohës, problemeve konkrete që shqetësojnë rrethin, si zgjidhen nga komitetet e Partisë problemet që shqyrtohen në këtë ose në atë kohë, sipas rëndësisë dhe aktualitetit që kanë, duke u bazuar në direktivat e përgjithshme të Kongresit të Partisë, të Komitetit Qendror të Partisë dhe në vendimet e Qeverisë?

Unë nuk dyshoj se problemet që marrin në shqyr-

tim organet drejtuese të Partisë në rrethe nuk janë thelbësore dhe të drejta, por, duke e parë dhe duke e krahasuar këtë çështje me punën jo të mjaftueshme që bëjmë edhe ne këtu, në qendër, për të cilën bëjmë autokritikë, mendoj se në këtë drejtim komitetet e Partisë duhet të kenë mjaft dobësi. Nga këto dobësi nuk përjashtohen edhe organizatat-bazë të Partisë, megjithëse ato jetojnë më afër masave dhe punojnë në gjirin e tyre. Organizatat-bazë të Partisë do të arrijnë t'i kenë të qarta problemet që duhet të shqyrtojnë në mbledhjet e tyre, në qoftë se vazhdojnë t'i thellojnë në rrugë revolucionare parimet dhe direktivat e Partisë, duke parashikuar të gjitha dëmet që mund të sjellë një shmangie sado e vogël nga vija e drejtë dhe parimet organizative marksiste-leniniste të saj dhe në qoftë se zbatojnë me konsekuencë vijën e masave. Atëherë nuk do të ngjasë që ndonjë sekretar organizate ose dy komunistë të tjerë të kërkojnë që të mblidhet pa vend organizata, fjala vjen, për të kritikuar vetëm një anëtar partie për një çështje që nuk është aq e rëndësishme në momentin e dhënë, kur në atë kohë ajo duhet të shohë më përpara, për shembull, problemin e normave, çështje kjo shumë e rëndësishme parimore politike dhe ekonomike ose, bic fjala, kur në kolektiv vërehen disa fenomene negative. Njohja, pra, sa më shumë e jetës së kolektivit ku militon kjo organizatë-bazë, do të ndihmojë që kjo, në mes të problemeve të shumta, të zgjedhë atë me të cilin e vlen të merret me të vërtetë.

Si mund të arrijë më konkretisht organizata-bazë në konkluzione sa më të drejta për të përcaktuar në

rendin e ditës atë problem që preokupon më shumë kolektivin dhe atë vetë? Në këto konkluzione ajo mund të arrijë kur komunistët të futen në gjirin e masave, të jenë të lidhur ngushtë me to, kur të njohin mendimet, dëshirat dhe shqetësimet e tyre, kur të punojnë së bashku në prodhim, kur komunistët me ndërgjegje të pastër dhe me vullnet të hekurt të vënë të parët interesin e përgjithshëm mbi atë personal. Në këtë rast do të zgjidhet drejt edhe çështja që një punëtor, për shembull, i cili punon e djersin më shumë në asnjë rast të mos shpërblehet më pak, po, përkundrazi, më shumë nga ai që nuk djersin. Në këtë rast komunistët do të lëvizin vetë dhe do të vënë në lëvizje edhe gjithë shokët e punës për korrigjimin e gabimeve. Ja, pra, si mund të dalin çështjet më të rëndësishme që duhen vënë në rendin e ditës të organizatës-bazë.

Kur të gjithë komunistët të jetojnë në lidhje të ngushtë me masat e paorganizuara në Parti, kur ata të marrin vetë pjesë drejtpërdrejt në prodhim, nuk ka si të mos jenë në gjendje t'i propozojnë sekretarit të organizatës-bazë problemin më të mprehtë që duhet të analizohet në mbledhje, pse këtë e dikton jeta, e diktojnë nevojat e prodhimit, e dikton vullneti i zbatimit të vijës së Partisë, vullneti i kolektivit punonjës dhe i komunistëve që luftojnë në pararojë të masave e djersijnë, punojnë pa u lodhur për plotësimin e detyrave që nxjerr koha, jeta. Një gjë të tillë nuk mund ta bëjë kurrë vullneti i një personi qoftë ky edhe sekretari i organizatës, kur është i shkëputur nga jeta dhe nga masat. Sekretari është i detyruar të konsultohet

patjetër me komunistët për problemet që do të shqyrtojnë organizata-bazë. Komunistët, pra, në tërësi dhe jo një ose dy njerëz, duhet të diskutojnë dhe të vendosin nëse duhet të vihet apo jo në rendin e ditës një çështje. Atëherë të shikoni, shokë, sa mirë dhe qartë do të dalë rendi i ditës, sa të përshtatshme do të jenë problemet që do të merren në shqyrtim dhe ç' rezultate të mira do të kemi në punë.

Kur Partia merr në analizë problemet më të rëndësishme që preokupojnë njerëzit, masat punonjëse gëzohen dhe presin me padurim vendimet që do të merren. Pas mbledhjes është e domosdoshme që këto vendime t'u bëhen menjëherë të njohura masave, që të mobilizohen për t'i zbatuar.

Duke vepruar kështu në çdo kolektiv, do të krijohet kudo një gjallëri e madhe revolucionare në masat dhe organizata-bazë e Partisë do të nxitet ta ndiejë më shumë përgjegjësinë që ka e do të veprojë më me drejtësi, guxim e iniciativë, nuk do të qëndrojë në bisht të masave. Kur kritikata të bëhen me vend dhe të godasin në shenjë, do të edukohen e do të revolucionarizohen më mirë njerëzit. Në këto kushte nuk ka shumë rëndësi nëse përfaqësuesja e organizatës së gruas do të marrë pjesë ose jo në mbledhjen e organizatës së Partisë për të shqyrtuar një problem të gruas, kur këtë problem e kanë ngritur dhe e kanë kërkuar vetë gratë e kolektivit, të cilat ankohen se po pengohen, se u nxirren vështirësi në veprintarinë e tyre nga burrat dhe nga vëllezërit e tyre të organizuar ose të paorganizuar në Parti. Duke vepruar në këtë mënyrë, problemi do të shqyrtohet dhe do të zgjidhet më mi-

rë e më drejt. Nuk ka, pra, shumë rëndësi nëse shkon ose nuk shkon përfaqësuesi i një organizate të masave në një mbledhje që organizon Partia, derisa jo vetëm komunistët, por gjithë punonjësit marrin pjesë në këtë mbledhje ku shqyrtohen e diskutohen në mënyrë revolucionare probleme që vihen re se nuk ecin. Prandaj, komiteti ose organizata-bazë duhet ta dëgjojnë me vëmendje propozimin që bëhet nga punonjësit dhe të marrin menjëherë masa që kërkesa e tyre për shqyrtimin e problemit që i shqetëson të realizohet dhe të analizohet thellë sa të shkundet i madh e i vogël dhe komiteti i Partisë të marrë pastaj shpejt masa për të dhënë direktivën e përshtatshme për ndreqjen e gjendjes dhe të ndjekë me kujdes hap pas hapi rezultatet e kësaj pune.

Është e qartë se Partia duhet t'i thërresë medoemos herë pas here edhe në mbledhje shokët dhe shoqet e zgjedhura në udhëheqje të organizatave të masave dhe pakujdesitë në këtë drejtim duhet të marrin fund. Në asnjë mënyrë nuk lejohet që forumet e këtyre organizatave të mos aktivizohen nëpërmjet formave të vendosura, që duhen përdorur më mirë e duhen bërë vazhdimisht më të përsosura. Por, konceptet e ngushta që ekzistojnë, sipas të cilave vija e Partisë me masat mendohet se zbatohet vetëm me thirrjen e përfaqësuesve të organizatave të masave në këtë ose atë mbledhje partie, ndërsa vendimet e marra në këto mbledhje partie mbahen të mbyllura, nuk zgjidhin shumë gjëra.

Nga ana tjetër, duhet parë se mos udhëheqjet e organizatave të masave i orientojnë keq organizatat e

prodhimit e të bazës, duke i mësuar ato të presin nga lart zbërthimin e direktivës për specifikat e problemeve që u përkasin. Ato mund të presin udhëzime për specifikat, por, para së gjithash, çdo direktivë të Partisë duhet ta kuptojnë si direktivën e tyre. Edhe komiteti i Partisë i rrethit mund t'i thërresë, t'i orientojë dhe t'u thotë drejtuesve të këtyre organizatave se ky apo ai problem është edhe për këtë apo atë organizatë masash. Ai duhet ta bëjë këtë gjë sepse ai është koka drejtuese në rreth. Por, detyra e udhëheqjeve të organizatave të masave nuk është vetëm sa t'u rekomandojë organizatave që drejton specifikën e problemeve që u përkasin dhe pastaj ato të punojnë në bazë të saj. Kjo do të ishte një metodë pune rutinë që nuk do të sillte shumë dobi.

Unë këto çështje kisha për të theksuar, se për të gjitha të tjerat jam dakord me materialin dhe me sa vunë në dukje shokët në diskutimet e tyre. Të kuptohemi drejt, si në çdo fushë edhe në atë të udhëheqjes së organizatave të masave nga ana e Partisë, kemi përparime, prandaj me këto që ngrita, nuk dua të them se komitetet e Partisë të rretheve punojnë në mënyrë burokratike. Fakt është se shokët e Partisë në rrethe venë në masat, janë në kontakt të përditshëm me to, konsultohen dhe marrin parasysh mendimet e tyre etj. Çështja tani është të punojmë më mirë dhe të thellohemi më shumë në direktivat e Partisë për këtë problem, jo vetëm në ato aktualet, po edhe në direktivat e mëparshme. Ky është një lëmsh, fijet e të cilit janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe,

po fillove nga e fundit dhe harrove të parën, direktiva nuk mund të zbatohet e plotë.

Kisha për të shtuar edhe diçka lidhur me aktivin e Partisë. Partia aktivin e ka praktikuar dhe mendoj se kjo formë pune ka qenë e nevojshme kur numri i komunistëve ishte më i vogël se tani dhe organizatat e masave nuk qenë të ngritura sa duhet ideologjikisht, politikisht dhe organizativisht, siç janë sot. Nuk ishin në nivelin e tanishëm, natyrisht, as pjesëmarrësit e aktivitetit rreth Partisë. Këta në njëfarë mënyre kryenin disa detyra që u takonin t'i bënin komunistët, ishin njerëz që Partia i ngarkonte të çonin fjalën e saj në masa, ishin propagandistë, instruktueshin në mënyrë të veçantë, duke ua bërë të njohur masave problemet e kohës. Kur Partia mendoi për aktivistët, jo vetëm kishim më pak anëtarë partie, por edhe niveli i tyre ideopolitik e kulturor ishte i ulët. Më vonë, me zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të Partisë, ky aktivitet mori një kuptim tjetër, në të u futën më shumë nga ata punonjës që dallohen në punë, me synimin që, duke i aktivizuar, të përgatiten për t'u pranuar në Parti.

Sidoqoftë, ndonjë gabim parimor nuk është bërë me krijimin e aktivitetit të Partisë, pjesëtarët e të cilit mblidheshin herë pas here dhe dërgoheshin për të punuar disa direktiva që u jepeshin. Tani gjendja ka ndryshuar. Por mendimi i vjetër për aktivin dhe metoda e punës e përdorur me të, është e zorshme të shkulen, pse këto janë rrënjësor e janë bërë shprehje në praktikën e punës së Partisë. Mirëpo sot ne kemi

jashtë aktivitet me mijëra punonjës të tjerë që i aktivizojmë, shumë nga të cilët janë po aq të zotë sa edhe pjesëtarët e aktivitet. Prandaj, sipas mendimit tim, jo vetëm s'ka arsye ta mbajmë më tej aktivitetin për qëllimin që e patëm krijuar në fillim, por as për përgatitjen e punonjësve më të mirë për të hyrë në Parti. Kjo formë pune sot mund të jetë e dëmshme, për arsye se mund të lërë të kuptohet sikur punonjësit e tjerë, që s'bëjnë pjesë në aktivitet, nuk mund të hyjnë në Parti, sikur dyert e Partisë janë të hapura vetëm për pjesëtarët e aktivitet. Prandaj drejt u tha këtu që këtë problem të mos e vendosim sot, po ta shikojmë e ta vendosim përfundimisht mbasi të konsultohemi edhe me shokët e komiteteve të Partisë të rretheve.

*Botuar për herë të parë
me shkurtime në librin:
Enver Hoxha, «Raporte e
fjalime 1972-1973», f. 68-88*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH, që gjendet
në AQP*

METODAT E PUNËS E TË DREJTIMIT JO NË FRYMË PARTIE CENOJNË RËNDË LIDHJET ME MASAT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

24 prill 1972

Unë nuk e kuptoj se ç'punë bëjnë financieri dhe planoviku, me çfarë operacionesh merren ata, që nga fillimi i vitit dhe gjer në mbarim të tij, kur nuk janë në gjendje të paraqitin një bilanc ose orientim të përafërt mujor, dymujor apo tremujor, nga i cili të mund të nxirreshin disa konkluzione paraprake, disa sinjalizime për gjendjen e punëve në kooperativë. A është e mjaftueshme që puna e tyre të reduktohet vetëm në evidencimin e pengesave për ditë-punë, që llogariten në bazë të të dhënave të normistëve? I mbajnë apo nuk i mbajnë punonjësit e llogarisë dhe të planit evi-

1. Në këtë mbledhje komitetet e Partisë të rretheve Korçë e Dibër raportuan mbi masat që ishin marrë nga ana e tyre dhe e organizatave-bazë për zbatimin e Letrës së Komitetit Qendror të PPSH për bujqësinë, në fushën e përsosjes së organizimit dhe të drejtimit të kooperativave bujqësore.

dencat dhe treguesit e realizimit të planit ekonomik-financiar? Për shembull, si bëhet kjo punë për qumështin, për pendët e qeve, për zogjtë, për hyrjet dhe daljet, jo vetëm për mishin e qumështin, por edhe për konsumimin e benzines, të gomave, shpenzimet për blerjen e veglave të punës, për prashitjen etj., etj., me qëllim që të dalin me të dhëna të përafërta, me njëfarë bilanci orientues? Dua të di, me një fjalë, i dalin apo jo punës përpara. Për këtë qëllim e bëra edhe pyetjen nëse ndeshet ndonjëherë zyra e llogarisë me kryesinë e kooperativës gjatë administrimit ekonomik vjetor dhe nëse ka konflikte midis tyre apo jo?

Në qoftë se janë në një ekonomi, për shembull, 10 lopë të racës «Laramanc», 50 «Xhersej» etj., a bën llogari financieri i kooperativës që njërës do t'i japim kaq ushqim, tjetrës aq etj. Kështu, nga këto përlllogaritje do të dalë nëse ka leverdi të mbahet «Laramania» ose një racë tjetër apo s'ka. Globali i realizimeve është tjetër punë, por llogaritë e veçanta duhen parë. Po qe se nuk del leverdia edhe në specifikat, llogaritari duhet të hyjë në diskutim me kryetarin e t'i thotë: «Kjo mbajtje e lopëve nuk na intereson. Nuk mund të lejohet që nga «Laramanet» të merren 1800 litra qumësht në vit, se me ushqimin që u japim duhet të marrim 3 000 litra». Llogaria, sipas rezultateve që nxjerr, ngre problemin, fjala vjen, që lopët e racës «Xhersej» nuk po e japin as 5, as 4.5 për qind gjalpin, por vetëm 3 për qind, prandaj të ngrejë zërin se kjo nuk është e leverdishme. Nga kjo gjë pastaj do të gjendet edhe arsyeja, se gjalpi i duhur nuk merret, ta zëmë, ngaqë barishtet e mbjella për ushqimin e lo-

pëve nuk janë shumë të vlefshme. Kështu, pra, ky debat i shërben shtimit të prodhimit.

Siç e thanë edhe shokët, këto gjëra nuk bëhen në të gjitha kooperativat bujqësore. Por, a nuk mund t'i mblidhni ndonjëherë ekonomistët dhe financierët e kooperativave për t'i pyetur se si veprojnë kooperativat bujqësore e t'i sqaroni se Partia kërkon nga ata që diturinë e fituar ta vënë në praktikë? A i keni ngarkuar të bëjnë studime se si duhet të veprojnë financa dhe plani në kooperativat dhe, mbi këtë bazë, të këmbehet eksperiencia pozitive? Edhe udhëzimet që vijnë për këto punë nga Ministria e Financave dhe ajo e Bujqësisë, si dhe kërkesat për mbushjen e formularëve të vjetër, që disa herë janë të gjatë e të gjerë si çarçafë, duhet t'i diskutoni me punonjësit e planit e të financës, se ç'mendime kanë për to, duhen apo jo të tëra dhe si mund të jepen udhëzime më të drejta. Nuk është e mjaftueshme t'u thuhet punonjësve: «Merrni këto udhëzime, djema, dhe veproni sipas tyre!».

Por të kemi kujdes se mos i trembim kuadrot e rinj me këto punëra shkencore, duke i mbingarkuar me shumë gjëra, si në disa tekste të shkollave. Njerëzit e rinj kanë shumë vullnet dhe dëshirë për të mësuar, po mos ua karfosni trutë me gjëra të vështira e të ngatërruara. Puna për mësimin e tyre le të fillohet nga më të thjeshtat, pastaj, dalngadalë, të kaloht në gjërat kryesore. Kështu të rinjtë do të mësohen me punën shkencore. Natyrisht, këto nuk bëhen në një ditë, por duhet të vazhdohet puna me këmbëngulje të madhe, ndryshe nuk ka ekonomi të për-

paruar, nuk ka zbatim ritmik të planit, nuk ka frenim të spontaneitetit.

Në qoftë se puna organizohet mirë, me disiplinë shkencore, secili do të mbledhë rripat për të mbjellë atë që është planifikuar. Që të priset plani duhet të mblihet tërë shtabi i kooperativës dhe të bëhet çështje. Edhe kur për këtë gjë mund të vendosë shtabi, prapëseprapë, në qoftë se nuk del llogaria, punonjësit e saj kanë të drejtë të kundërshtojnë dhe të ngrenë zërin se nuk del mirë rentabiliteti etj., etj. Kështu duhen kuptuar këto çështje që të ecet me hesap e jo kuturu.

Po për sa i përket zbatimit të agroteknikës në bazë të pedologjisë, duke i përshtatur për afërsisht me mundësitë tona bimët që mbillen, pra, a po arrihet që t'u përmbahemi pak a shumë shkencërisht nevojave të përbërjes së tokës, plehërave kimike e organike që disponojnë e të tjera? Unë mendoj se për të tëra këto duhet të vihen në dijeni jo vetëm brigadierët, por edhe kooperativistët që: «Në parcelat që kenë në dispozicion, përbërja e tokës është kjo; kërkesat e saj për këtë ose atë bimë që do të mbillet, janë këto; për të rregulluar prodhimin duhet të mbjellin një bimë tjetër, në mënyrë që të bëhet qarkullimi i tyre e toka që tash na jep kaq quintalë për hektar, do të na japë më shumë e të tjera». Kështu duhet të instruktohen kooperativistët për pedologjinë e tokës, lidhur konkretisht me bimët, me agroteknikën, me punimin e tyre. E kam fjalën që të dhënat shkencore t'i lidhim me praktikën e jo t'u mësojmë tabelat me formula. sa për të thënë se po i mësojmë. Në qoftë se nuk e kemi

parasysh plotësimin e këtyre kërkesave, që, natyrisht, është zor t'i përmbushim qysh sivjet, punët nuk mund të ecin si dëshirojmë. Vitin që vjen duhet të hedhim një hap tjetër përpara.

Kjo punë nuk mund të bëhet duke u thënë punonjësve të bujqësisë: «Merrni tash këto harta dhe i studioni!». Ata janë njerëz të thjeshtë dhe, pavarësisht sa kulturë mund të kenë, duhet të futen në këtë proces. Duhet punuar në mënyrë sistematike që ata të dinë përse hyjnë në punë këto njohuri rreth tokës dhe sa prodhime mund të merren për hektar. Pra, të njohin agroteknikën e bimës. Po nuk u bënë të tëra këto, mund të vijë një kohë kur toka të varfërohet dhe nuk do të japë më prodhimet që pritnim.

Pra, ka rëndësi të madhe që shtabi i planifikimit të merret vazhdimisht me çështjet e pedologjisë, të planifikimit të bimëve sipas llojit të tokave dhe të përpiqet të gjejë mundësitë për rritjen e prodhimit. Të mos punohet më kot dhe në tym për të mbjellë, ta zëmë, pataten, megjithëse toka nuk është e përshtatshme për këtë bimë. Kooperativistët të jenë të ndërgjegjshëm që, brenda pesëvjeçarit, nuk kanë mundësi t'i hedhin tokës aq plehëra kimike sa të arrijnë një planifikim më të madh, prandaj ata të mbjellin ato bimë që japin mundësi për të arritur rendimente më të larta me plehërim më të reduktuar. Ata të jenë të ndërgjegjshëm, gjithashtu, se në perspektivë e sipas planit, nga viti në vit, do të rritin rendimentet akoma më shumë. Kjo do të arrihet, siç thamë, kur pedologjisë së parcelave do t'u përshtaten bimët që mbillen.

Pra, puna e njerëzve që planifikojnë nuk është

një çështje e lehtë e që mund të bëhet në këmbë, sipas disa grafikëve që kemi trashëguar. Kurdoherë duhet mbajtur parasysh evolucioni, zhvillimi. Shumë mirë u tha këtu se situatat tani kanë ndryshuar, prandaj komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit duhet të rrojë me ndryshimet e situatave në fushën e ujitjes, mekanizimeve etj. dhe, mbi bazën e tyre, të planifikojë rendimentet për të cilat të ngulë këmbë, që të realizohen me doemos. Veçse të mos jemi shabllonë në zbatimin e propozimeve dhe të eksperiencave. Në qoftë se diçka u gjend e drejtë për rrethin e Korçës, të shikohet leverdia e saj edhe në ato rrethe ku kemi mbjellë bimë industriale, pra të mos veprohet kudo njëlloj. Ose, përse duhet të sjellim, për shembull, 10 traktorë, siç na u tha këtu, kur mund të sjellim në vend të tyre gjithë tubat që nevojiten për të ujitur 3 000 ose 4 000 hektarë tokë? Kjo gjë mund të na interesonte më tepër, prandaj të ishte bërë llogaria që më parë. Sigurimi i tubave mund të mos na kushtojë shumë, por, fundi i fundit, edhe po të na kushtojë, mund t'i merrnim, po të na leverdiste.

Është e qartë se kudo duhet të ecet sipas kushteve e me llogari. Fjala vjen, për grumbullimin e plehut dhe shpërndarjen e tij, përveç masave që kemi marrë, duke krijuar brigada të veçanta, duhet menduar si mund ta lidhim këtë çështje me ditët e punës, me rritjen e interesit në këtë drejtim. Plehun do ta prodhojë kafsha që do të hajë. Por kafshët kanë njerëz që i ushqejnë. Tani, konkretisht, si mund ta nxitim punën për të siguruar sa më shumë pleh, në kuptimin që të përgjigjet si ai që merret me prodhimin e ush-

qimit të kafshëve, ashtu dhe ai që merret me manipulimin e plehut. Kështu, në qoftë se plehu mbas grumbullimit nuk del në sasinë e planifikuar, lind pyetja: «Pse kafshët nuk e kanë ngrënë sasinë e duhur të ushqimit? Po ai që merret me përpunimin e plehut, pse lejoi të ikë urina?» etj. Sipas fajit që kanë, të përgjigjen të dy, si ai që ushqen kafshët, ashtu edhe ai që përdor dhe shpërndan plehun. Pra, të mendohet se si mund të lidhen këto shërbime me ditët e punës, vlera e së cilës, sipas rastit, të shtohet ose të pakësohet. Vërtet se plehu kimik tërhiqet me llogari, por ca më shumë duhet grumbulluar e përdorur me llogari edhe plehu organik, e jo t'i lihet spontaneitetit e të mblidhet rrugëve.

Për çështjen që shqyrtuam nuk ka përse të zgjatem më tej, pse nga pyetjet dhe nga diskutimet që u bënë, doli që ka përpjekje dhe punohet.

Nga shokët e të dy rretheve që kemi thirrur të na raportojnë, shihet se rrethi i Korçës ka bërë një luftë më të madhe dhe është në rrugën e përparimit në këtë drejtim. Kjo tregon se organizata e Partisë atje është në krye të punëve. Edhe masat kooperativiste të këtij rrethi janë, gjithashtu, në pararojë dhe, pavarësisht nga të metat e vështirësitë që ekzistojnë, tek të gjithë vihet re një kujdes i veçantë për ta përmirësuar gjithnjë e më shumë gjendjen, për të ecur në rrugën e Partisë.

Ndryshe ka ndodhur në rrethin e Dibrës. Në materialin e paraqitur prej shokëve të këtij rrethi, nuk është shënuar as titulli i raportit, as emri i institucionit që e dërgon. E lexova dy herë me kujdesin më të

madh raportin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Dibrës dhe nuk gjeta asnjë fjalë të shkruar se nga vjen. Po të mos e dija që më parë se duhet të ishte i këtij rrethi, nuk do ta kuptoja nga vinte, nga Saranda, nga Kruja, nga Gjirokastra apo nga Libohova. Mirë emrin e rrethit, po as atë të ndonjë kooperative bujqësore nuk gjen dot brenda, që, të paktën, të mund të orientohesh. Pastaj, të tëra ato që thuhën në këtë raport janë shkruar pa përgjegjësi dhe në hava. Raporti, përveç këtyre, nuk ka të shënuar as datën kur është bërë, ndërsa në fund i është vënë një firmë e palexueshme si ajo e bankierëve që firmosin çeqe.

Si e keni hallin ju shokët e Dibrës? Kujt ia dërgoni një material të hartuar në këtë mënyrë? Kështu lidheni ju me Komitetin Qendror të Partisë dhe me organet e tij? Si është e mundur t'i vijnë të tilla «dokumente» Sekretariatit të Komitetit Qendror ose Byrosë Politike?

Në këtë rreth vihet re se nuk janë bërë përpjekje të mjaftueshme për vënien në jetë si duhet të këshillove që jepen në Letrën e Komitetit Qendror për bujqësinë. Atje ekzistojnë të meta serioze, të cilat pasqyrohen sidomos në mosrealizimin e planeve në bujqësi. Kjo, sikundër e konstatojmë, nuk është diçka e rastit, pse nuk kemi të bëjmë me një vit, por ka disa vjet që mosrealizimet ndjekin njëri-tjetrin duke krijuar kështu atje një situatë të vështirë.

Anëtarët e kooperativave bujqësore të rrethit të Dibrës për ditë-punë kanë marrë të ardhura nën mesataren e republikës. Në rast se do të paguheshin nga kooperativa të këtij rrethi edhe detyrimet e kredisë

që ato i kanë shtetit, atëherë mesatarja e ditës së punës do të zbriste akoma. Në këto kushte shteti u detyrua t'ua shtyjë atyre edhe këtë vit kthimin e kredive.

Dihet nga të gjithë se rrethi i Dibrës ka qenë i dalluar në prodhimin e misrit, kurse tani ka rënie, ai ka qenë i dalluar, gjithashtu, për farën e jonxhës, por edhe në këtë drejtim ka rënë. Rënie atje ka edhe në blegtori.

Mendimi ynë është se faktorë për këtë gjendje nuk janë as populli, as organizata e Partisë e këtij rrethi, por disa nga kuadrot drejtues të Partisë dhe të pushtetit, janë edhe disa udhëheqës të mëparshëm.

Populli dhe komunistët e rrethit të Dibrës janë patriotë, të lidhur ngushtë me Partinë, ata janë të vendosur të punojnë dhe të luftojnë gjër në fund në vijën e Partisë. Populli dhe komunistët e rrethit të Dibrës kurdoherë kanë dhënë prova të vendosmërisë, të guximit dhe të unitetit të tyre me Partinë, ata kanë dhënë, gjithashtu, prova të zotësisë dhe të mençurisë së tyre krijuese. Nën udhëheqjen e Partisë, ata kanë kryer vepra të mëdha, kanë punuar me heroizëm. Partia çmon lart përpjekjet e tyre plot vetëmohim për kapërcimin e pasojave të rënda të tërmetit të vitit 1967, aksionet e tyre të guximshme për hapjen e kanaleve ujitëse dhe për ndërtimin e banesave me punë vullnetare, që u bënë shembull i madh frymëzimi për gjithë punonjësit e vendit tonë. Gatishmëria e tyre për punë ka qenë kurdoherë e lartë, vetëm se disa kuadro drejtues të rrethit, me disa metoda pune e drejtimi jo në frymë partie, i kanë penguar të zhvi-

llojnë akoma më shumë ato mundësi të mëdha që ekzistojnë atje.

Mësimet e Partisë, veçanërisht disa nga drejtuesit e këtij rrethi, nuk i kanë kuptuar thellë, gjë që ka penguar të mbahen kurdoherë marrëdhënie të drejta me popullin. Ju nuk keni arritur të spastroheni mirë nga ajo mbeturinë e dënueshme e punës fisnore, e punës prej bajraktari, që ka ekzistuar para Çlirimit në vendin tonë dhe në mënyrë të veçantë në rrethin e Dibrës. Ju jeni anëtarë të Partisë, jeni shokë besnikë që e doni popullin, për çështjen e tij dhe të Partisë ju keni luftuar me armë dhe keni merita edhe në luftën për ndërtimin e socializmit. Çështjen e kam në atë koncept të gabuar që ekziston akoma si mbeturinë te disa nga ju, sipas të cilit problemet mund të zgjidhen duke komanduar.

Në veprimtarinë tuaj të përditshme janë të zakonshme shprehje të tilla, si: «Ta bësh këtë, ndryshe nuk vij të pi kafe në shtëpinë tënde!», «Ta bësh këtë, ndryshe nuk të shkel te dera!», ose «Kryejeni këtë që po ju themi, ndryshe mos u ktheni gjallë në komitet!». Ç'metoda drejtimi janë këto, more shokë? Kjo tregon se, me gjithë punën e madhe të Partisë, ju nuk jeni shkëputur si duhet nga këto pikëpamje, nuk i keni braktisur të tilla qëndrime dhe, dashje pa dashje, keni arritur ta nënvleftësoni popullin e Dibrës. Këto koncepte dhe qëndrime në marrëdhëniet me popullin janë të rrezikshme dhe të dënueshme, prandaj duhet të marrin fund...

Veprime krejt të paligjshme dhe në kundërshtim me direktivat e udhëzimet e Partisë kanë bërë sido-

mos seksioni i tregtisë, seksioni i financave apo ai i bujqësisë. Artikulli i botuar në gazetën «Bashkimi» për disa çështje të bujqësisë në rrethin e Dibrës ngrë probleme të rëndësishme. Nga ky artikull del se në këtë rreth janë bërë mashtrime. Ç'do të thotë të mashtrosh shtetin dhe Partinë, duke dërguar nëpër kooperativa lista, të cilat pastaj korrigjohen për të shtuar firot, që të rritet kështu artificialisht plani i prodhimit? Ju me këtë doni të thoni se prodhimi gjoja ka ekzistuar, pra «ne kemi punuar mirë, por firot kanë qenë të mëdha, prandaj na jepni misër për të ngrënë». Po si mund t'ju jepet misër, pa bërë vetë përpjekje të mjaftueshme për të realizuar planin dhe pa u përgjigjur për mosrealizimet dhe mashtrimet që janë vërtetuar?

Metodat e urryera të bajraktarizmit duhen luftuar seriozisht, pse njerëzit që preken prej tyre, kur vishen me pushtet, abuzojnë me autoritetin, ata veprojnë keq me petkun e tij dhe të Partisë, abuzojnë në dashurinë që ka populli për Partinë dhe për pushtetin e tij. Këta njerëz i karakterizon një dozë e theksuar megalomanie, duan të duken në sytë e masave. Të tillë njerëz, me dashje ose pa dashje, janë bartës të një pune sektare dhe tarafi, qoftë në Parti, qoftë në organet e pushtetit. Duke qenë zakonisht mburravecë, arrogantë, sektarë, prepotentë, ata krijojnë rreth tyre një kategori njerëzish që i ndjekin, që aprovojnë çdo veprim të tyre, që nuk i kritikojnë kur bëjnë gabime, se kanë frikë, dhe i lavdërojnë, se nxjerrin përfitime personale në dëm të shoqërisë, të vijës së Partisë dhe të ligjeve të shtetit. Të tillë njerëz përpiqen dhe dinë ta

fshehin për shumë kohë punën e tyre të gabuar, dinë të maskohen prapa sukseseve të Partisë dhe të popullit, dinë të reklamojnë sikur këto suksese janë arritur «në sajë të drejtimt të tyre të mirë».

Partia nuk është as familje, as klan, ku çështjet mund të zgjidhen mbi bazën e lidhjeve fisnore apo krahinore. Ajo është një repart i organizuar që ndërtohet mbi parimin e centralizmit demokratik dhe që ka normat dhe rregullat e saj. Ajo nuk njeh as familjaritet dhe as lokalizëm. Çdo gjë në Parti zgjidhet në bazë të parimeve dhe të normave të saj që janë të përbashkëta e të njëjlojta për të gjitha organizatat-bazë. Ndërsa ju përpigjeni të gjeni andej-këtej ndonjë kuadër dibran, që punon gjetskë dhe ngulni këmbë që të vijë në Peshkopi, përpigjeni ta ktheni kështu rrethin «në një vazo të mbyllur» dhe t'i nxirrni një mijë e një kleçka ndonjë tjetri që s'është nga rrethi juaj. Shokun që botoi një artikull në gazetë, ku nxirrte në shesh disa dobësi të punës suaj, ju e atakuat, gjithashtu, se gjoja kishte thyer normat e Partisë, meqenëse nuk i paskësh ngritur këto çështje më parë në byro. Por, kur u pa çështja, doli se ai edhe në byro i kishte ngritur. Megjithatë, për faktin se ju kritikoi publikisht, ju iu sulët atij të gjithë nga të katër anët. Kjo do të thotë se ata që ju kritikojnë, ju i pritni me këmbët e para. Ku shkoni në këtë mënyrë? Do ta lejojmë ne atje një gjë të tillë? Në asnjë mënyrë nuk mund ta lejojmë!

Ju keni punuar në Peshkopi për bujë. Për ndërtimin e objekteve të shumta social-kulturore dhe për realizimin e aksioneve me goditje të përqendruar ju

morët flamurin, por rënduat kooperativat bujqësore me shpenzime të mëdha brenda një periudhe të shkurtër. Në rrethin e Dibrës ka kooperativa bujqësore të atilla që duhej të ishin në vijë të parë, nga më të përparuarat, edhe në të ardhurat për ditë-punë që marrin anëtarët e tyre. Ja pasojat e asaj pune që keni bërë, duke rënduar popullin me shpenzime të rënda para kohe, borxhet shtetit nuk po ia lani dhe jo vetëm kaq, por kooperativistët tuaj nuk realizojnë të ardhurat që pritëshin. Këto që kanë ndodhur në rrethin tuaj, shokë të Dibrës, duket që nuk i kuptoni si duhet dhe, në vend që të bëni diskutime pa fund në mbledhje të byrosë në frymën e justifikimit, thellohuni në përgjegjësinë që keni, pse të tilla qëndrime s'janë aspak serioze.

Është për të ardhur keq që shokë të mirë dhe me partishmëri të rrethit nuk kanë ndërhyrë më me forcë për t'i vënë menjëherë në vend disa qëndrime të palejueshme e veprime të jashtëligjshme që janë kryer nga ndonjë komunist apo kuadër. Përse është lejuar që të shkelen me kaq lehtësi në rrethin tuaj vendimet e Komitetit Qendror? Shokë, për këto qëndrime të gjithë keni shumë përgjegjësi, pse kanë shkaktuar një situatë të vështirë në rrethin tuaj.

Prandaj propozoj që këto çështje të analizohen thellë, së pari në plenumin e komitetit të Partisë, pastaj në këshillin popullor të rrethit, ku problemeve t'u shkohet deri në fund, duke vënë mirë në dukje përgjegjësinë e gjithë atyre që kanë gabuar dhe, sipas fajeve që kanë, të merren masat përkatëse për gjithsecilin. Pas kësaj pune të shkohet në popull, të cilit t'i thuhet çfarë ka ngjarë, si u diskutuan e si u zgji-

dhën këto çështje dhe ç'vendime u morën. Edhe shokët që kanë bërë faje, të dalin përpara masave, të flasin hapur për gabimet e tyre, për dëmin ekonomik dhe politik që u kanë shkaktuar popullit dhe shtetit.

. Përse duhet vepruar kështu? Sepse e tillë është vija e Partisë, por edhe për një arsye tjetër: metoda e gabuar e punës së këtyre shokëve në rrethin e Dibrës, siç thashë, i ka krijuar një situatë të vështirë Partisë.

Ne kemi marrë masa, shokë, edhe herë tjetër në rrethin e Dibrës. Edhe tani detyrohemi të marrim prapë dhe jemi të bindur se populli do t'i aprovojë, bile do të thotë: «I lumtë Partisë, për arsye se qëndrimet e mbajtura nga ana e këtyre shokëve kanë qenë të padrejta!». Mirëpo do të ketë njerëz të tjerë që do të thonë: «More, po ç'është kjo që po ndodh me drejtuesit e rrethit tonë, gjithnjë këtu në Dibër merren masa të tilla! Si është e mundur që këta shokë komunistë, që kanë bërë luftën dhe e kuptojnë vijën e Partisë, na kanë çuar ne në rrugë të gabuar?». Po, shokë, mund të thonë kështu. E shikoni ku të çon një metodë pune e tillë?

Partia jonë është e drejtë dhe, pse është e tillë, është edhe e rreptë. Në gjykimin e çështjeve dhe të njerëzve, ajo nuk udhëhiqet nga sentimentalizmat mikroborgjeshë, prej të cilëve burojnë konceptet: «I shkretë, është shok i mirë, t'ia falim». Udhëheqësit e mirë Partia dhe populli i duan, i mbrojnë, i respektojnë, ata që gabojnë i kritikojnë, i paralajmërojnë, kurse ata që bëjnë faje, që shkelin hapur normat e Partisë, ligjet e shtetit e marrin nëpër këmbë interesat e popullit, i shkarkojnë dhe i dënojnë. Partia e edukon po-

pullin në këtë frymë. Kjo është në interes të punës, të popullit dhe të vetë kuadrove, që të reflektojnë thellë për gabimet që kanë bërë dhe të nxjerrin mësimë prej tyre.

Ne kemi besim se kjo situatë do të kapërcehet, pse populli patriot i rrethit të Dibrës, i lidhur si mi-shi me thoin me Partinë, është në gjendje të gjejë drejt çdo gjë, prandaj kemi besim se do ta aprovojë drejtësinë e masave të Partisë. Ne kemi besim edhe tek organizata e Partisë e rrethit të Dibrës, sepse atje militojnë komunistë revolucionarë, të cilët kurdoherë i kanë kuptuar drejt gjërat që ka shtruar Partia dhe i kanë aprovuar ato plotësisht. Organizata e Partisë, me gjithë dobësitë dhe gabimet e udhëheqjes së saj, është në pozita të shëndosha. Ajo ka forca të mëdha për të kapërcyer vështirësitë e krijuara. Dhe ne kemi bindjen se ajo do ta tregojë edhe me vepra se ç'është në gjendje të bëjë. Komunistët dibranë, ashtu si gjithë komunistët shqiptarë, nuk dekurajohen nga gabimet, nuk thyhen nga vështirësitë, por nxjerrin mësimë, kështu mësojnë dhe do të ecin gjithnjë përpara në rrugën që tregon Partia.

Partia ka besim edhe te kuadrot e rrethit të Dibrës, se do të gjejnë në vete forca për të analizuar thellë ato që kanë ndodhur, për të zbuluar shkaqet e gabimeve, për të përcaktuar drejt përgjegjësinë e secilit dhe për të marrë të gjitha masat për shërimin e gjendjes së krijuar.

Si shokë që ju kemi, për arsye se jeni njerëz që keni luftuar, që në biografitë tuaja, krahas të metave, të cilat nuk mund as t'i fshehim, as t'i lejojmë të zhvi-

Ilohen më tej, keni edhe merita. Për të mirën e Partisë, në radhë të parë, po dhe tuajën, ju këshillojmë edhe një herë që, në frymë partie, të thelloheni mirë në këto çështje, shokë të rrethit të Dibrës. E theksoj këtë se, nga sa pashë në Sekretariat, ashtu siç është karakteristik materiali që na keni dërguar, pa farë personaliteti, edhe diskutimi ishte pa personalitet, autokritika jashtëzakonisht e zbehtë. Pse vjen kjo? Kjo vjen, sigurisht, edhe për shkak të tronditjes nga kjo kritikë e rëndë që ju bëhet. Mirëpo ja, kjo ngjau dhe medoemos duhet kapërcyer. Unë e kuptoj këtë, por është çështja që komunistët, kur dalin përpara Partisë, përpara popullit, përpara udhëheqjes, pavarësisht sa të rënda janë fajet që kanë bërë, të qëndrojnë drejt, të njohin ndershmërisht gabimet e të mos u kalojnë atyre përciptazi, të pranojnë kritikën që u bëhet dhe të bëjnë autokritikë.

Rekomandoj që këto çështje të shikohen mirë nga Partia në rreth dhe nga ju, në radhë të parë, sepse dëshirojmë që Partia të mos ju humbasë, përkuandrazi, t'ju fitojë. Partia dëshiron që të thelloheni të gjithë në gabimet që keni bërë, t'i spastroni dhe të ecni si duhet në vijën e saj.

Këtu e ka synimin kritika e saj e ashpër dhe e drejtë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

NË PËRCAKTIMIN E ORIGJINËS SHOQËRORE TË NJERËZVE TË MARRIM PARASYSH STADIN E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË SONË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 prill 1972

Te ne, aktualisht, ekzistojnë dy klasa mike: klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste. Gjithë grupet e tjera shoqërore janë shtresa. Prandaj ne duhet të udhëhiqemi nga orientimi i përgjithshëm që kemi dy klasa; kjo do të jetë baza për të përcaktuar gjendjen shoqërore të njerëzve.

Intelektualët, për shembull, përbëjnë një shtresë. Mendoj ta kemi të qartë se kush quhet dhe kush nuk mund të quhet intelektual. Në bazë të zhvillimit kulturor të shoqërisë sonë, nuk mund të quhen intelektualë ata që mbarojnë shkollën 8-vjeçare dhe të mesme. Arsimi 8-vjeçar te ne është i detyrueshëm për të

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth studimit mbi disa probleme të origjinës dhe të gjendjes shoqërore për efekt të pranimeve në Parti.

gjithë punëtorët dhe fshatarët. Më vonë kështu do të bëhet edhe arsimi i mesëm, prandaj fakti që punëtorët ose kooperativistët mbarojnë arsimin e mesëm, nuk është argument për t'i futur ata në një shtresë të veçantë dhe për t'i diferencuar nga klasa. Deri tash, ka pasur raste që edhe ata të cilët nuk kishin mbaruar plotësisht universitetin të ne, janë quajtur intelektualë. Por, me zhvillimin e madh që po marrin arsimi dhe kultura në vendin tonë, ky problem duhet parë lidhur me kohën. Jo tash, po në perspektivë do të ketë edhe nga ata që, pasi të mbarojnë shkollën e lartë, do të bëhen punëtorë, se do të punojnë drejtpërdrejt në prodhim. Pra, themelor është karakteri i punës. Intelektual, në përgjithësi, mund të quhet ai që ka mbaruar një shkollë të lartë dhe që merret me punë mendore pak a shumë të kualifikuar.

Për sa u përket nëpunësve si shtresë, në parim çështja është e qartë. Edhe në këtë drejtim të mos nisemi nga kritere thjesht sentimentale, ose vetëm nga arsimi, por nga përcaktimi që u ka bërë Marks i punëtorëve dhe ndihmësve të klasës punëtore, duke marrë për bazë karakterin e punës. Zhvillimi ynë socialist shkon në atë rrugë që mundësisht të gjithë, edhe nëpunësit, të dinë nga një ose më shumë zanate. Por mësimi i një zanati nga një nëpunës nuk e ndryshon shtresën e tij si nëpunës. Tash artizan nuk bëhet vetëm qytetari, por edhe kooperativisti. Me këtë yrull që ka marrë të ne mësimi i profesioneve të ndryshme, edhe një qytetar-nëpunës që i zë dora gjithçka, që ka mbaruar ose jo shkollë të mesme profesionale dhe nuk është nëpunës, mund të bëhet fare mirë mu-

rator, bile i kategorisë së lartë. E kam çështjen këtu që zhvillimi ynë i tanishëm po e zhduk nocionin e artizanit, sepse edhe ata që janë nëpunës ose intelektualë, pse kanë mbaruar universitetin, mund të dinë një zana siç ndodh edhe me një kooperativist në ishëm, që bëhet, për shembull, murator. Pra, po të veprimet siç propozohet në këtë studim që të përcaktojmë origjinën «kooperativistë-artizanë», vetëm pse kooperativisti ushtron një profesion në kooperativë, kjo nuk do të ishte e drejtë, pse do t'u bëhet njëfarë ringjalljeje artizanëve në ishëm. Këtë duhet ta shikojmë me kujdes.

Rigrupimi që propozohet, nuk më duket me vend. Gjendja shoqërore e prindërve përcakton origjinën tonë. Ndërtimi i Partisë ka krijuar premisa të tilla që për të ardhmen të bëhet më lehtë përcaktimi i origjinës. Për të përcaktuar origjinën e gjithsecilit, diferencimi do të bëhet në bazë të zhvillimit të shoqërisë. Këtu nuk ka të bëjë e drejta e pronësisë, por puna që bën secili, pra, fakti, nëse është punëtor, kooperativist apo nëpunës.

Këto ishin disa mendime të përgjithshme që kisha unë. Duke u nisur nga këto, them që në përcaktimin e origjinës është më i drejtë varianti që merr parasysh punën që bëjnë nëna dhe babai. Kur babai është punëtor dhe nëna shtëpiake, origjina e fëmijës, në këtë rast, më duket se duhet të jetë punëtor. Kur është punëtor njëri prind dhe nëpunës ose kooperativist prindi tjetër, mendoj se origjina duhet të përcaktohet duke marrë parasysh të dy prindërit, pra, në këtë rast «punëtor-nëpunës», «punëtor-kooperati-

vist». Ne themi që kur është punëtor prindi ndikon në edukimin e fëmijës. Por, punëtori mund të jetë i martuar me një nëpunëse të një niveli më të lartë, e cila, si grua me kulturë dhe si nënë, ndikon më shumë se babai për edukimin e fëmijëve.

Për sa i takon kohës së nevojshme të punës që duhet marrë për bazë, në përcaktimin e origjinës së të rinjve, ne pak a shumë e kemi të përcaktuar këtë. Kështu, për shembull, stazhi që duhet të bëjë punonjësi për t'u quajtur punëtor në industrinë e rëndë është tre vjet. Ose, kur kooperativisti e lë fshatin dhe vjen për të punuar në minierë, Partia, në bazë të rregullave që ka vënë, ka përcaktuar se po të punojë pesë vjet në këtë punë, gjendja e tij shoqërore konsiderohet punëtor. Atëherë, djali i tij, që është 20 vjeç, për shembull, do të konsiderohet me origjinë shoqërore punëtor dhe do të pranohet në Parti si i tillë, megjithëse ka lindur e ka jetuar në fshat, për rreth 15 vjet. Në bazë të parimit, siç thamë, origjina shoqërore e fëmijës përcaktohet nga gjendja shoqërore e prindërve, prandaj nuk mund të pranohet që prindërit të konsiderohen me gjendje punëtore dhe bijtë e bijat të quhen me origjinë shoqërore kooperativiste.

Kështu, pra, origjina e të riut, qoftë nga ana e babës, qoftë nga e nënës, më duket se është e përcaktuar. Çështja kryesore është që të kemi në radhët e Partisë të rinj me edukatë dhe origjinë punëtore. Ai djalë që u mor si shembull këtu, është i një punëtori, është rritur me frymën e klasës punëtore dhe ka arri- tur moshën 18 vjeç. Babai i tij kishte punuar 20 vjet punëtor, por ka dy vjet që u bë nëpunës. Tashti ne e

pranojmë në Parti dhe e quajmë me origjinë nëpunës. Ç'u prish këtu?! Mos vallë këtij djali iu prish karakteri ose biografia? Jo, sepse në biografinë e tij do të vihet që babai ka qenë 20 vjet punëtor. Megjithëse, sipas rregullave do të shënohet me origjinë nëpunës, ky është djalë punëtori, sepse babai i tij ka qenë për një kohë më të gjatë punëtor. Po sa janë punonjësit që kanë punuar 20 vjet si punëtorë dhe më vonë janë bërë nëpunës? Nuk e vlen fare të ndryshohen rregullat vetëm për ndonjë përjashtim të vogël.

Edhe për ata që do të pranohen në Parti nga shtëpia e fëmijës të mos e shikojmë çështjen vetëm nga ana sentimentale, po ta gjykojmë drejt nga ana teorike: cila origjinë shoqërore u përshtatet atyre më mirë? Unë them se është më mirë të konsiderohen me origjinë punëtores, sepse janë si bij punëtorësh, meqenëse rriten me frymën e klasës punëtores, të pushtetit popullor. Rëndësi ka edukata që marrin.

Për sa i përket gjendjes shoqërore mendoj se duhet të bëjmë një diferencim, sipas procesit të punës që kryen, pavarësisht se e quajmë mjeshtër apo diçka tjetër atë që merret me prodhimin e të mirave materiale. Kështu e kuptojmë ne nga ana praktike, por le ta diskutojmë një çikë nga ana teorike këtë çështje. Me gjendje punëtores janë ata që marrin pjesë drejtpërdrejt në prodhim, në transport, në shpërndarje dhe në shërbime. Në këtë vështrim, edhe ata të remontit për të cilët u fol këtu, janë punëtorë, për arsye se punojnë vetë në prodhim. Me gjendje nëpunës është ai që kryen detyrën e nëpunësit, puna bazë e të cilit është puna mendore; me gjendje shoqërore koo-

perativiste është ai që punon anëtar i kooperativës.

Diskutimi i këtyre çështjeve nuk është e thënë të mbarojë sot. Mendime mund të rrihen edhe herë të tjera e të arrihet në përfundime sa më të drejta.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proees-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

ZBATIMI I KONTRATAVE DUHET TË MBËSHTETET NË REALIZIMIN FAKTIK TË PLANIT TË PRODHIMIT BUJQËSOR E BLEGTORAL

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 prill 1972

Jam dakord me diskutimet dhe kritikën që bënë shokët. Konkluzionet e mbledhjes së Byrosë Politike dhe diskutimet që u bënë, na vënë detyra të mëdha përpara. Këto kërkojnë që ne të shkundemi fort për të përmirësuar në mënyrë të dukshme gjendjen në sektorin e bujqësisë. Të jemi realistë se në bujqësi kemi të meta serioze dhe shumë vështirësi për të kapërcyer, prandaj duhet të kontrollohet më mirë plotësimi i detyrave dhe të hiqet dorë nga metoda e vjetruar e punës.

Ju, Pirro [Dodbibë], keni kaq vjet me radhë që nuk po e realizoni planin, prandaj mos u kapni pas

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth raportit të paraqitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Financave për rezultatet ekonomiko-financiare në kooperativat bujqësore gjatë vitit 1971.

shembullit të Ndërmarrjes Bujqësore të Krumës, që sapo është krijuar. Unë nuk e kam fjalën as për këtë ndërmarrje dhe as për ndonjë tjetër të veçantë, por shtroj çështjen që përse duhet të punojnë disa ndërmarrje bujqësore që të mbulojnë vazhdimisht humbjet e disa ndërmarrjeve të tjera të të njëjtit profil? Ju vetë thatë se «një rritje të madhe ka vetëm në perime». Por mos na «bombardo» me perimet; në radhë të parë të shohim drithërat e bukës. Me shifra nuk duhet të luajmë, por të nxjerrim konkluzione të drejta e realiste. Nuk mjafton të na thuhet që «prodhimi i drithit çdo vit është rritur, por plani nuk është realizuar».

Çështja është t'i thuhet Byrosë Politike se sipërfaqet e tokave janë shtuar, mekanizmat janë shtuar, forcat e punës, gjithashtu, janë shtuar. Këta faktorë ndikojnë në realizimin e planit. Ne kemi vendosur që nga prodhimet bujqësore e blegtorale, si dhe nga prodhimet e veprimtarive ndihmëse, kooperativa bujqësore siguron farërat për mbjelljet, si dhe rezervën e nevojshme; heq fondin e drithit të domosdoshëm për bukën e anëtarëve, gjer në prodhimin e ri, dhe fondin rezervë të bukës etj., etj. Vetëm në fund, pasi të jenë bërë të gjitha këto, prodhimet e tjera i shiten shtetit. Prandaj nuk është e vërtetë ajo që the t¹ se gjoja nuk paska një vendim të tillë. Atëherë të gjendet ku qëndron përgjegjësia që nuk është zbatuar direktiva e Partisë.

Fakti është se po shkelen normat e Partisë dhe

1. I drejtohet ish-ministrit të Bujqësisë Pirro Dodbibës.

ligjet e shtetit për ndarjen e prodhimeve dhe të të ardhurave në të holla. Pavarësisht se nuk u realizua plani i prodhimit të drithit, nuk është aspak e drejtë që, për të plotësuar planin e grumbullimeve, t'i preket sasia që u takon kooperativistëve.

Është vendosur që tepricat kooperative me kontratë t'ia shesë shtetit, por duhet që edhe Partia të punojë për t'i bindur kooperativistët për shitjen e tyre shtetit. Këtu janë dy gjëra: e para është direktiva e dhënë, pastaj vjen çështja se si zbatohet ajo. Në qoftë se ti Pirro ngre në diskutim që direktivat e dhëna nuk janë zbatuar, atëherë le të nxjerrim kush duhet të përgjigjet për shkeljen e tyre. Ne edhe në praktikë duhet të zbatojmë me doemos ligjet, statutin e kooperativës, ndryshe nuk mund të shkohet.

Për furnizim jo të rregullt të kooperativistëve sigurisht që duhet të përgjigjet Ministria e Tregtisë. Por, në radhë të parë, Ministria e Bujqësisë ka përgjegjësi, për arsye se ajo nuk e ka bërë problem me kohë në Komitetin Qendror dhe në Qeveri çështjen e prekjës së kontingjentit të drithit për kooperativistët, por edhe për arsye se nuk ka luftuar si duhet për realizimin e planit të prodhimit. Sa herë janë bërë mbledhjet e Qeverisë, pse nuk e keni ngritur zërin në qiell dhe të thoshit: «Këtu po preket buka e kooperativistëve, po shkelen orientimet e Partisë dhe urdhëresat e Qeverisë!». Ti, Pirro, e di bilancin që tregon qartë sa bukë duhet të konsumojë fshatarësia kooperativiste.

Kooperativisti do të hajë çdo ditë. Atëherë ç'do me thënë: «Do t'i bëjmë llogaritë në fund» siç u tha

këtu. Fajin për shkeljen e kësaj direktive e kanë, gjithashtu, edhe organet e grumbullimit dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve në bazë. Planin e grumbullimit, më duket mua, ju nuk e ndiqni si duhet. Nuk jemi hiç në rregull në këtë drejtim. Merruni vesh të dyja ministritë: Ministria e Bujqësisë dhe e Tregtisë.

Shikoni ju, Pirro dhe Kiço! Jeni të dy anëtarë të Qeverisë dhe të Komitetit Qendror të Partisë dhe jeni përgjegjësit e bujqësisë dhe të tregtisë. Ti, Kiço, ke bërë dhe gabime të tjera, për të cilat je kritikuar. Të kemi thënë edhe herë të tjera që zbatimin e kontratave mos e kërkon në mënyrë mekanike, duke ngulur këmbë në ekzekutimin e detyrimit kontraktual edhe kur ai është i pamundur të realizohet për shkaqe objektive. Çështja është t'i njohim e t'i pranojmë të gjitha shkeljet e gabimet. Jo të hiqet ushqimi për blegtorinë dhe në fund të mbetet buka, kur kjo duhet të ishte e para.

Tepricat duhen rregulluar nëpërmjet kontratave mbështetur në realizimin e planeve. Në bazë të realizimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale, hiqet sasia e nevojshme për bukën, për farën dhe për blegtorinë.

Prodhimi mund të mos plotësohet për shumë arsye. Për shembull, kur nuk merret pjesë rregullisht në punë, nuk organizohet puna mirë, nuk shfrytëzohet koha e punës, mungon disiplina, nuk janë kushtet e favorshme të klimës etj. Forcimi i disiplinës duhet ndjekur sa është e mundur më shumë e më mirë. Partia dhe shteti kanë krijuar shumë mundësi

për realizimin e planit, por, kur ndodh që, me gjithë masat e marra dhe punën e bërë, përsëri plani nuk realizohet, në të dhe në kontratat duhet të bëhen korrigjime. Në praktikë këto korrigjime nuk bëhen, prandaj Ministria e Tregtisë në mënyrë burokratike i thotë kooperativës bujqësore: «Dua këtë prodhim në bazë të kontratës!» duke sjellë shtrëngime të padrejta për kooperativistët.

Për sa u përket kontraktimeve për shitjen e tepricave të drithërave, duhet pasur parasysh se kooperativat, parimisht, nuk janë të detyruara t'i shesin pa asnjë kusht. Kooperativistët kanë të drejtë të thonë: «Na sillni në fshat mallrat që duam ne, pastaj do t'jua shesim tepricat!». Prandaj, kontratat që lidhen për shitjen e tepricave në bujqësi kanë ndryshim nga ato që lidhen për furnizimin e detyruar të mallrave, në bazë të planit, në industri. Unë këto probleme po i ngre në parim, por kjo nuk do të thotë që ne të mos bëjmë të gjitha përpjekjet për t'i marrë tepricat në rrugë të ligjshme. Çështja është që kontratat dhe detyrimet ndërmjet palëve të ndryshme t'i kuptojmë dhe t'i zbatojmë drejt nga ana politike dhe juridike.

Me këtë rast doja të dija pak më konkretisht se çfarë keni bërë ju¹ brenda këtyre dy vjetëve, me qëllim që të nxiten kooperativat për të rritur prodhimet, për shembull, në rrethin e Dibrës, që të dalë nga prapambetja, që nuk shlyen dot as detyrimet ndaj shtetit?! A e keni vënë ju para përgjegjësisë

1. I drejtohet drejtorit të Bankës Bujqësore.

komitetin ekzekutiv të rrethit për ato llogari që nuk «ecin»? A u keni thënë se duhet të shlyeni borxhet me doemos, prandaj të realizoni planin e prodhimit? A keni bërë ju kontrole në fund ose në mes të vitit etj.? Kishit ju koncepte të qarta se nga cilat bimë si: misri, patatet, frutat etj. do të dilnin të ardhurat për shlyerjen e kredive të shtetit për vitet 1969, 1970, 1971 nga ana e atij rrethi? Keni ushtruar ju, si bankë e shtetit, kontrole financiare gjatë tremujorit, gjatë shtëmujorit ose në fund të vitit për gjendjen e të ardhurave lidhur me pagimin e kredive? A mund të ishte kontrolli juaj një nxitje për të shlyer detyrimet? E keni bërë ju këtë gjë në mënyrë pak a shumë të orientuar dhe të detajuar sipas bimëve apo keni punuar në përgjithësi?

Ju nuk duhet të bazoheni vetëm në planin financiar, të pritni që ky plan të realizohet në fund e pastaj t'u thoni: «Paguani kreditë!». Po vepruat kështu, kooperativat mund t'ju thonë: «S'kemi!». Në këto rrethana, Qeveria do të detyrohet të shtyjë afatet, se nuk ka çfarë të bëjë tjetër. Me planin financiar, që është rezultati i prodhimit, duhet t'u rrini ju si çekan prodhuesve. Unë kështu e kuptoj ndihmën e shumanshme që mund t'u jepni ju Ministrisë së Bujqësisë, komitetit ekzekutiv, komitetit të Partisë dhe vetë kooperativave. Mos veproni si tregtia, që kënaqet me lidhjen e kontratës dhe pret të marrë në fund prodhimet që janë kontraktuar.

Puna është që të ndikohet vazhdimisht e t'i dilet përpara mosrealizimit të planit. Në këtë drejtim duhet të mendoni ju se si ta organizoni akoma më mi-

rë kontrollin financiar e bankar. Puna e bankës duhet të priret nga kriteri i studimit, i kontrollit dhe i ndihmës efektive. Financa duhet të ushtrojë kontrollin me anë të lekut për çështje të shpenzimeve, të investimeve dhe kështu të nxitë plotësimin e planeve, rritjen e të ardhurave dhe shpërndarjen e drejtë të tyre.

Unë mendoj që efikasitetin e punës së organeve financiare dhe ekonomike në kooperativë duhet ta matim edhe me faktin se sa vihen ato në konflikt me veprimet e parregullta të drejtuesve dhe me mosrealizimin e planit. Llogaria dhe financa e kooperativës duhet të ndjekin shpenzimet që nevojiten për prodhimin dhe, për çdo veprim të parregullt, të thonë: «Ndal, nuk të jap më tepër, është vendosur kaq e jo më shumë!». Ato të mos lëkunden edhe sikur të hidhet përpjetë shkelësi i rregullave, cilido që të jetë. Në rast se këmbëngulet, për shembull, nga kryetari, atëherë le të venë në komitetin ekzekutiv për zgjidhjen e konfliktit, por të jepet llogari edhe në mbledhjen e përgjithshme të kooperativës. Për shembull, pse është tejkalar sasia e misrit për ushqimin e pulave, kur plani i prodhimit nga ato nuk është realizuar? Për shkeljet e ligjeve, kur është rasti, çështja të çohet edhe në gjyq. Kur llogaria e kooperativës urdhërohet të veprojë me vendim kolegjal të kryesisë së kooperativës, duhet ta zbatojë, por t'u thotë se vendimi është i gabuar dhe të bëjë denoncimin në organin kompetent. Këto gjëra duhen parë dhe nxitur, ndryshe nuk kemi kontroll financiar e bankar, por vetëm një regjistrim të thjeshtë të veprimeve financiare. Kontrolli financiar duhet të forcohet pa kompromis.

Për të realizuar detyrat e mëdha në fushën e bujqësisë, sipas mendimit tim, lypset të gjejmë organizatorë të shkathët, njerëz të veprimit dhe të mos mbetemi vetëm me disa kuadro, të cilët vërtet janë të mirë nga shumë pikëpamje, por metodën e punës e kanë shumë të vjetruar. Ka ardhur koha që edhe këta shokë të shkunden. Kjo duhet të bëhet nga lart dhe nga vetë baza.

Zbatimin e plotë, të drejtë dhe në kohën e duhur të vendimeve që merren, duhet ta ndjekim mirë edhe ne këtej nga aparati i Komitetit Qendror, edhe ju shokët e Qeverisë. Këtë çështje e kemi theksuar kurdoherë dhe natyrisht ka përmirësime të dukshme, por ja që prapë dalin disa gjëra jo të mira, që do të shmangeshin, po t'u kishim kushtuar më tepër vëmendje dhe t'i kishim vështruar me një sy më të mprehtë problemet e drejtimit dhe të kontrollit në prodhim e kudo gjetkë.

Duhet të përpiqemi që ne, punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë dhe ju shokë të Qeverisë në aparatit tuaj, t'i evitojmë sa të jetë e mundur më shumë raportet globale. Unë di që edhe në mbledhjet e Qeverisë bëhen kritika. Mirëpo, nga raportet e përgjithshme për shumë probleme, është zor të dalin detyra konkrete për drejtime të veçanta. Prandaj, kur vjen çështja për të vënë në jetë vendimet, udhëzimet ose orientimet e Qeverisë, vërehet se ato në mjaft raste nuk zbatohen dhe, si pa gjë të keq, raportohet: «Ja nuk e zbatuam!». A duhet të lejohet kjo gjendje?

Në statutin e kooperativave bujqësore të tipit të

lartë nuk thuhet që të thëret bagëtia personale e anëtarëve. Heqja e bagëtive personale në këto kooperativa është një çështje që i takon të ardhmes kur të jenë plotësuar kushtet që do ta bëjnë të panevojshme mbajtjen e tyre. Si është e mundur që kjo gjë të mos shpjegohej mirë në rrethe e në bazë për të parandaluar keqkuptimet e rastit dhe rreziqet që mund të lindnin prej tyre? Për këto keqkuptime që janë dukur në bazë, duhet të merrni përgjegjësinë ju, shokë të Ministrisë së Bujqësisë; ju, të parët, keni përgjegjësi të rëndë për këtë çështje.

Një nga karakteristikat e kooperativave bujqësore të tipit të lartë është pjesëmarrja e shtetit në to, nëpërmjet investimeve, fuqizimit të bazës materialo-teknike dhe përsosjes së drejtimit organizativo-ekonomik, me qëllim që t'i jepet një hov i mëtejshëm rritjes së prodhimit bujqësor, duke e intensifikuar atë në një shkallë më të madhe në kooperativat bujqësore të fuqishme. Kjo duhet të ishte çështja kryesore materiale që mbështet politikën e ngritjes së kooperativave bujqësore të tipit të lartë. Ndërmarrjet bujqësore janë në pronësi të shtetit, kurse krijimi i kooperativave bujqësore të tipit të lartë është një hap i rëndësishëm përpara drejt ngritjes së pronës së grupit në nivelin e pronës së të gjithë popullit, drejt ngushtimit të mëtejshëm të dallimeve esenciale midis fshatit e qytetit.

Fshatari nuk do të dijë aq shumë ç'kanë dhe ç'bëjnë ndërmarrjet bujqësore. Atij i intereson më tepër se çfarë do t'i jepet për zhvillimin e prodhimit me organizimin e kooperativave të tipit të lartë. Që

të mos kishte keqkuptime apo cektësi për këtë formë të re, ju, si ministri, duhej të sqaronit që në këtë ose në atë kooperativë, në vitin 1972 do të jepen këta mekanizma, në vitin 1973 kaq, se në vitin 1974 nga shteti do të investohen kaq, në vitin 1975 kaq e kështu me radhë, duke treguar për çdo kooperativë sa pajisje e makineri do të ketë secila gjer në fund të pesëvjeçarit. Ministria e Bujqësisë duhej të vepronte doemos kështu, se kjo ishte abëcëja e punës nëpërmjet së cilës kooperativistët do të kuptonin një ndryshim që do të bëhej në zhvillimin e ekonomisë së tyre. Atëherë ata do të mendojnë që me të vërtetë në kooperativën e tyre po bëhen ndryshime në të mirë të shoqërisë dhe të vetë anëtarëve. Në vend që të bënit këtë, që është kryesorja, ju të Ministrisë së Bujqësisë e filluat me oborrin dhe kështu nxitët veprime të parakohshme e të dëmshme.

E kemi thënë vazhdimisht se në kooperativat, në radhë të parë, duhet të pyetni vetë kooperativistët nëse i duan apo jo format e organizimit ose të punës që u rekomandohen. Jo të kënaqeni duke thënë: «I kanë pritur mirë». Duhet pyetur kooperativistët, se mua më kanë raportuar që për këto çështje ju jeni marrë vesh me komitetin ekzekutiv dhe me kryetarët e kooperativave bujqësore, po kooperativistët nuk dinë asgjë.

Shokë, në qoftë se direktivat nuk zbërthehen deri në hollësi, nga udhëheqja, nga ministrinë etj., duke parashikuar anët e mira, të metat dhe rreziqet që mund të lindin nga keqkuptimi dhe keqinterpretimi i tyre, atëherë nuk jemi para zbërthimit të vërtetë të direktivave, por vetëm para një transmetimi të thjeshtë

të tyre që mund të bëhet shkak për shumë gabime e deformime në praktikë. Nuk mund të themi në përgjithësi se «bujqësia ecën përpara, por planet nuk realizohen». Ndiham që i jepet bujqësisë aktualisht është mjaft e madhe. Ne kemi sjellë për të traktorë, farëra të zgjedhura etj. që i kemi blerë me valutë. Por, duke numëruar tërë këto mjete që do t'i shtohen bujqësisë, nuk na u tha se çfarë do të na japë dhe a do t'i marrim ato që kemi caktuar?

Unë kam folur kurdoherë hapur dhe hapur do të flas. Ne edhe më përpara kemi kaluar situata të vështira dhe shokët që kanë qenë në krye të punëve janë kritikuar haptazi e publikisht, bile e ka marrë vesh gjithë bota. Raporti që na paraqitët ju Pirro, dhe Ministria e Financave, por ju jeni kryesorët, lidhur me gjendjen ekonomiko-financiare të kooperativave, më duket se është sa për të shkuar radhën. Ndoshta gaboj, por unë kështu e gjykoj, sepse në të nuk ka një analizë të thellë të gjendjes, të përgjegjësisë e të masave që duhen marrë. Diskutimet që u bënë treguan me argumente dhe me fakte se bujqësia e blegtoria paraqiten dobët. Atëherë, në qoftë se Ministria e Bujqësisë nuk e shikon pasqyrën e bujqësisë sonë realisht në këto situata, mua më duket se nuk do të dalim mirë.

Njerëzit i kuptojnë gjërat më mirë nga ana teknike, prandaj duhet të shfrytëzojmë në maksimum të gjitha mundësitë e mëdha politike e morale që na janë krijuar. Në bazë të këtyre mundësive ne kemi një mbështetje të mirë për të ecur përpara. Në qoftë se nuk jemi në gjendje të drejtojmë si duhet ekonomi-

në tonë bujqësore, nuk do ta kryejmë si duhet detyrën përpara popullit.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

LUFTA HEROIKE E POPULLIT TË VIETNAMIT DHE INTRIGAT E SOCIALIMPERIALIZMIT SOVJETIK

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

29 prill 1972

Në Moskë e në Uashington u shpall njëkohësisht njoftimi mbi një vizitë pesëditore në kryeqytetin sovjetik të Henri Kisingerit, këshilltar i posaçëm personal i Niksonit. Në konferencën e shtypit që mbajti menjëherë pas kthimit të tij nga Bashkimi Sovjetik, Kisingeri vuri në dukje se objektivi i misionit ishte «që të parashtronte pikëpamjen dhe gjykimin e presidentit Nikson mbi problemet e aktualitetit ndërkombëtar», duke lënë qartë të kuptohet se çështja kryesore që ai diskutoi me udhëheqësit sovjetikë ka qenë zhvillimi i ngjarjeve të sotme në Vietnam.

Ofensiva e madhe e tanishme e forcave çlirimtare në Vietnamin e Jugut i ka vënë në pozita shumë të vështira si Pentagonin, ashtu edhe Shtëpinë e Bardhë. Patriotët vietnamezë kanë çliruar shumë qytete dhe kanë vënë nën kontrollin e tyre krahina të tëra në Vietnamin e Jugut. Ushtritë kukulla të Sajgonit

tërhiqen të shpartalluara, ndërsa forcat amerikane janë struktur në bazat e tyre të rrethuara nga të gjitha anët. Për agresorët amerikanë situata politike e ushtarake po bëhet gjithnjë e më e vështirë. Niksoni pati deklaruar se «vietnamizimi» kishte triumfuar dhe se ai do të linte vetëm Van Thieun të luftonte për amerikanët kundër vietnamezëve. Gjithashtu, ai i pati premtuar popullit amerikan se do t'i jepte fund luftës në Vietnam dhe se do t'i kthente në shtëpi ushtarët amerikanë. Mbarimi i luftës në Vietnam, si katër vjet më parë ashtu edhe tani, përbën boshtin themelor të propagandës së tij elektorale për fronin e presidentit të SHBA-së.

Por e gjithë kjo strategji, e fryrë dhe e reklamuar jashtë çdo mase, dështoi. Ngjarjet e këtyre ditëve të fundit treguan se vietnamizimi nuk qëndron dhe nuk do të qëndrojë kurrë në këmbë. Kukullat e Sajgonit nuk kanë asnjë mbështetje në popull dhe ato mund të mbahen gjallë vetëm me mbrojtjen e bajonetave amerikane. Agresionin në Vietnam e kanë bërë dhe e bëjnë imperialistët amerikanë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të largohen prej andej të mundura e të turpëruara. Sukseset e tanishme të luftëtarëve vietnamezë treguan se vullneti dhe vendosmëria e popullit vietnamez, për të jetuar i lirë e i pavarur, nuk mund të thyhen duke rihyrë në rrugën e vjetër të shkallëzimit të luftës e të ekspansionit, ose duke rifilluar bombardimet kriminale të Hanoit dhe të qyteteve të tjera të Vietnamit të Veriut.

Përballë aventurave të reja ushtarake të imperia-

lizmit amerikan, populli vietnamez, i Veriut dhe i Jugut, i shton edhe më shumë përpjekjet e tij këmbëngulëse duke ecur përpara me trimëri dhe duke kapërcyer me guxim të gjitha vështirësitë e pengesat. Është provuar se kur iniciativa në fushën e betejës ka kaluar në duart e forcave çlirimtare dhe kur armiqve u janë dhënë goditje të fuqishme, agresorët amerikanë i kanë ulur pendët, janë tërhequr dhe kanë filluar nga manovrimet e ndryshme për të evituar disfatën e plotë. Dhe janë pikërisht këto fitore ato që e detyrojnë Niksonin të ulet tani edhe në bisedimet e Parisit, megjithëse jo shumë ditë përpara me mjaft arrogancë kishte vënë si kusht ndalimin e ofensivës.

Rezistenca e paepur dhe lufta dhëmb për dhëmb e popullit vietnamez me agresorët amerikanë e kullat e tij kanë qenë dhe janë një burim i madh frymëzimi për të gjithë popujt që luftojnë për lirinë e pavarësinë kundër imperializmit amerikan, për të gjithë ata që kërcënohen e vuajnë nga presionet e ndërhyrjet brutale të Shteteve të Bashkuara e të imperialistëve të tjerë. Kjo luftë u ka mësuar atyre të luftojnë dhe të kenë besim në forcat e veta, të jenë të sigurt se asnjë fuqi agresive, sado e madhe dhe e armatosur që të jetë, nuk është në gjendje të mposhtë një popull që është i vendosur të luftojë dhe të bëjë çdo sakrificë për lirinë e pavarësinë e tij. Me popullin vietnamez dhe me luftën e tij heroike janë forcat më përparimtare të planetit tonë, shtresat më të gjera popullore të të gjitha kontinenteve.

Si përkrahës të popullit vietnamez hiqen edhe revizionistët sovjetikë, por realiteti tanimë ka dëshmu-

ar se në të gjitha momentet kryesore dhe vendimtare të luftës vietnameze, ata kanë mbajtur një qëndrim antimarksist, të disfavorshëm për çështjen e lirisë e të pavarësisë së popullit vietnamez dhe në dobi të imperializmit. Krerët e Bashkimit Sovjetik kanë qenë dhe janë për shuarjen e luftës në Vietnam, kanë bërë dhe bëjnë çmos, bashkë me amerikanët, në bisedime e komplete të fshehta me ta, për ta sabotuar këtë luftë.

Shumë kanë spekuluar udhëheqësit sovjetikë dhe vazhdojnë të spekulojnë me njëfarë ndihme të tyre në materiale për Vietnamin. Në realitet këtu kemi të bëjmë me një shpenzim të llogaritur, që është në dobi si të propagandës mashtruese revizioniste, ashtu edhe të planeve ekspansioniste të krerëve të Kremlinit. Me këtë «ndihmë» ata kanë kërkuar të manovrojnë në dy drejtime, edhe për t'u ruajtur nga demaskimi për intrigat që bënin bashkë me amerikanët në kurriz të popullit vietnamez, edhe për të krijuar mundësinë që të futeshin brenda e të frenonin luftën e popullit të Vietnamit.

Por ata kanë dështuar në këto plane e në këto orvatje. Populli vietnamez nuk ra në grackat e ngritura nga revizionistët sovjetikë, nuk e shuajti luftën e tij çlirimtare dhe as e la veten të bëhet pre e intrigave dhe e makinacioneve amerikano-sovjetike.

Tani që ofensiva fitimtare e luftëtarëve trima vietnamezë i ka vënë përpara agresorët amerikanë dhe kukullat e tyre të Sajgonit, revizionistët sovjetikë po bëjnë orvatje të hapëta e të fshehta për t'i përvetësuar këto fitore dhe për ta paraqitur veten si nxitësit dhe mbështetësit kryesorë të kësaj ofensive dhe të

këtyre fitoreve. Bile për t'i dhënë kredi kësaj ideje dhe për ta bërë disi të besueshme, jo pa qëllim, ata, në prag të ofensivës së tanishme të forcave çlirimtare, dërguan për vizitë në Hanoi zëvendësministrin e Mbrojtjes, mareshalin Baticki. Me këtë ata deshën t'i lënë të kuptojë opinionit publik ndërkombëtar se shtyllëse dhe organizatore e kësaj ofensive është Moskë. Një ndikim të drejtpërdrejtë për të imponuar këtë mendim u dha revizionistëve sovjetikë edhe Niksoni vetë me deklaratën e tij se gjoja ofensiva u bëka me ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe se vazhdimi ose ndërprerja e luftës në Vietnam qënka në duart e tij.

Por e gjithë kjo manovër është një blufë e njohur dhe i demaskuar, të cilin revizionistët sovjetikë, kur u shkon, e përdorin për të akaparuar fitoret e të tjerëve. Realiteti në Vietnam është krejt i kundërt me atë që pretendojnë krerët sovjetikë dhe me ison që u mban Uashingtoni. As opinioni publik botëror, e aq më pak populli heroik vietnamez, që lufton për jetë a vdekje me armikun më të madh dhe më të egër të të gjithë popujve, nuk mund ta lejojnë kurrë që të kalojë ky blufë i ulët. Kurrën e kurrës nuk mund të lejojë Vietnami që nga gjaku i tij të përfitojnë intrigantët dhe sabotatorët.

Qëndrimet politike të udhëheqësve sovjetikë ndaj ngjarjeve aktuale në Vietnam dhe zhurma e propagandës së tyre lidhur me problemin vietnamez në tërësi tregojnë qartë se ata duan që në tratativat që do të zhvillojnë së shpejti me Niksonin në Moskë të paraqiten jo vetëm si miq të Vietnamit, por edhe si të autorizuar të flasin në emër të tij, si të deleguar fu-

qiptotë për t'i zgjidhur çështjet në emër të vietnamezëve. Por, duke kërkuar të hiqen përpara Niksonit sikur ata janë shtylla kryesore e fitores së forcave patriotike çlirimtare në Vietnam, krerët e Kremlinit nënvleftësojnë dhe fyejnë hapur popullin vietnamez, cenojnë dinjitetin dhe personalitetin e tij, kërkojnë t'i rrëmbejnë të drejtat sovraane që i përkasin vetëm atij dhe që nuk mund të tjetërsohen kurrë.

Revizionistët sovjetikë nuk e ngrenë tani çështjen e Vietnamit as të nisur nga pikëpamje humanitare, as të nxitur nga parimet e marksizëm-leninizmit, të cilat, siç dihet, ata prej kohësh i kanë shkelur dhe i kanë flakur tej. Ata duan ta përdorin situatën e krijuar në Vietnam si atu në pazarllëqet e ndryshme që do të bëjnë në kurriz të paqes botërore me agresorin Nikson. Dhe qëllimi i mëtejshëm i sundimtarëve të Kremlinit është që të futin duart në Vietnam e në Indokinë, gjë që përputhet me planin e tyre të madh strategjik që fillon nga Afganistani, India, Pakistani Lindor etj. për rrethimin e Kinës dhe për shtypjen e revolucionit botëror.

Këto janë synimet imperialiste dhe përfitimet egoiste që revizionistët sovjetikë kërkojnë të nxjerrin nga lufta burrërore e popullit vietnamez dhe nga vërshtirësitë e krijuara për imperialistët amerikanë. Ata duan të përfitojnë në Vietnam ashtu siç përfitojnë në pellgun e Mesdheut nga lufta e popujve arabë, ku me kombinime të ndryshme dhe me dhënien e disa armëve mbytin frymën luftarake të vëllezërve arabë për të përgatitur terrenin për hapësira të reja imperialiste.

Por në Vietnam këto intriga e manovra nuk ka-

lojnë. Interesat e lartë të luftës së tij kundër imperializmit amerikan i diktojnë popullit vietnamez nevojën dhe domosdoshmërinë e kundërshtimit të planeve, ndërhyrjeve e intrigave të revizionistëve sovjetikë.

Kjo është jo vetëm një luftë për ruajtjen e lirisë e të pavarësisë në Vietnam, por edhe një kontribut i rëndësishëm në çështjen e revolucionit antiimperialist të popujve të të gjithë botës. Ne jemi të bindur se populli i Vietnamit heroik, siç e ka treguar me luftën e tij të gjatë kundër armiqsh shumë të egër e dinakë, është i vendosur të luftojë deri në fund për lirinë e pavarësinë e tij, për bashkimin e atdheut të tij të copëtuar dhe për plotësimin e gjithë aspiratave të tjera të ligjshme kombëtare e sociale. Ai me siguri do të zbatojë porositë e urta të udhëheqësit të tij të shquar, presidentit Ho Shi Min, për të dëbuar nga toka e Vietnamit të gjithë agresorët, pa marrë parasysh asnjë vuajtje e asnjë sakrificë, sado e gjatë dhe e vështirë që të jetë lufta.

Populli shqiptar, që me zemër të hapët ka qenë kurdoherë përkrah popullit vëlla e trim vietnamez, ka besim të patundur se ai do t'i shkatërrojë të gjitha planet ushtarake e politike të agresorëve amerikanë e të shërbëtorëve të tyre dhe do të arrijë fitore të reja të shkëlqyera mbi të gjithë armiqtë e tij.

Përballë ofensivës së re të forcave çlirimtare vietnamezjugore, e cila me siguri do të vazhdojë me një vrull akoma më të madh derisa të shkatërrohen të gjitha forcat e gjalla të armikut, përballë rezistencës së pamposhtur të të gjithë vietnamezëve dhe unitetit të pathyer të tyre luftarak, po bëhen pluhur e hi të

gjitha planet e pretendimet arrogante të Niksonit e të përkrahësve të tij. Në këtë rrugë është e sigurt se, në mos sot, nesër, agresorët amerikanë dhe kukullat e tyre të Sajgonit do të bien në gjunjë përpara kërkesave luftarake të popullit vietnamez, i cili kërkon që ushtarët amerikanë, bashkë me bazat e pajisjet e tyre, të shporren pa asnjë kusht e përfundimisht nga Vietnamit dhe ai të lihet i lirë dhe pa asnjë ndërhyrje të huaj të vendosë vetë për fatin e tij.

Masat punonjëse të vendit tonë, i gjithë populli ynë, si gjithnjë, do të jenë plotësisht dhe deri në fund solidarë me çështjen e drejtë për të cilën luftojnë populli vietnamez dhe popujt e tjerë të Indokinës dhe do ta përkrahin kurdoherë me të gjitha forcat luftën e tyre kundër armiqve të përbashkët, imperialistëve amerikanë, shërbëtorëve e përkrahësve të tjerë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 102 (7394), 29 prill 1972

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 244

LIRIA E FITUAR ME GJAK NUK KA MORTJE KURRË

Nga biseda me delegacionin e Federatës së Sindikatave të RD të Vietnamit dhe me delegacionin e Federatës së Sindikatave për Çlirimin e Vietnamit të Jugut

4 maj 1972

Pas përshëndetjeve të rastit, fjalën e mori shoku Enver Hoxha.

Ju faleminderit shumë që erdhët për të marrë pjesë në Kongresin e 7-të të Bashkimeve Profesionale¹ të klasës punëtore të vendit tonë. Ne u jemi mirënjohës partisë suaj dhe popullit heroik vietnamez që ju dërgoi. Këtë e çmojmë si një ndihmë të madhe në luftën që bën klasa jonë punëtore për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Kontributi juaj në punimet e Kongresit të 7-të të Bashkimeve tona Profesionale do të jetë i një rëndësie të veçantë, sepse me Vietnamin (dhe kur flasim për Vietnamin ne nuk bëjmë asnjë dallim midis Veriut dhe Jugut; edhe miku ynë

1. Kongresi i 7-të i BPSH i zhvilloi punimet nga data 8-11 maj 1972.

Ho Shi Min theksonte vazhdimisht se ekziston vetëm një Vietnam, prandaj si ju, si të gjithë miqtë tuaj në botë, edhe ne në Shqipëri dëshirojmë që vendi juaj të bashkohet), me popullin e tij ne jemi të lidhur në miqësi të singertë dhe e konsiderojmë luftën tuaj heroike njëkohësisht si luftë të popullit tonë. Ajo jo vetëm ka për qëllim çlirimin e Vietnamit të Jugut, por është edhe shembull për popujt e tjerë të botës që luftojnë kundër imperializmit amerikan. Shtetet e Bashkuara të Amerikës hiqen sikur janë një vend demokratik, por në realitet i ngjajnë një bishe të egër që, për të jetuar, nuk do tjetër ushqim veç gjakut të popujve. Prandaj imperialistët amerikanë e meritojnë plumbin kokës, ashtu siç po ua jepni ju, duke u qëndruar dhëmb për dhëmb e duke i luftuar deri në shkatërrimin e tyre të plotë.

Ne shqiptarët dhe gjithë popujt e botës luftën tuaj çlirimtare e konsiderojmë si një çështje me rëndësi të madhe që na përket të gjithëve ta mbrojmë dhe jemi plotësisht të bindur se ajo do të kurorëzohet me fitore të plotë për ju dhe me disfatë të turpshme për imperializmin amerikan dhe kukullat e tij të Sajgonit.

Populli ynë ka luftuar kundër fashistëve italianë dhe nazistëve gjermanë në Luftën e Dytë Botërore, por ka luftuar vazhdimisht edhe në kohët e kaluara. Ai ka një eksperiencë të gjatë në përpjekjet e tij të pareshtura kundër armiqve të ndryshëm për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut. Megjithatë ne përpiqemi kurdoherë të përfitojmë nga eksperiencia dhe ndihma e vëllezërve dhe e miqve, prandaj i më-

sojmë njerëzit tanë të marrin shembull nga Vietnami heroik që, për dhjetëra vjet me radhë, periudhë që përfshin një kohë prej rreth dy-tre brezash njeriu (për të mos shkuar akoma më larg), është duke luftuar me armiq shumë të egër. Kjo do të thotë se te ju luftuan dhe u vranë gjyshërit, luftën e vazhduan bijtë e tyre dhe tani është duke luftuar brezi i tretë. Edhe kalamanët në Vietnam janë mësuar të rezistojnë e të luftojnë. Populli juaj ka ditur ta bëjë me sukses një luftë të tillë të gjatë dhe u ka bërë ballë armiqve të egër e të shumtë. Ai asnjëherë nuk u ka kthyer kurrizin armiqve, asnjëherë nuk është dëshpëruar, asnjëherë nuk e ka njohur panikun, përkundrazi, kur është dashur, sipas nevojës e rrethanave, ka organizuar sulme dhe mbrojtje, derisa ka arritur në gjendjen e sotme, kur armikut më të egër, më të armatosur dhe më djallëzor të njerëzimit, siç është imperializmi amerikan, i ka shkaktuar disfata të turpshme. Vetëm nga kjo anë po ta marrim këtë si shembull, mund të përfytyrohet se çfarë ndihme të madhe përbën lufta juaj për të gjithë popujt që luftojnë për çlirim nga zgjedha imperialiste.

Rëndësi, shokë, ka çështja që ju vietnamezët jeni edhe trima, edhe të zotë, edhe të zgjuar, edhe të thjeshtë. Këto janë pikërisht ato cilësi të mira që u duhen njerëzve dhe popujve në punën dhe në luftën e tyre të drejtë për liri e pavarësi.

Ç'gëzim i madh është për të gjithë popujt, që aktualisht ndjekin me simpati ofensivën e madhe të popullit luftëtar të Vietnamit, kur shikojnë fitoret e tij mbi armiqët amerikanë dhe kukullat e Sajgonit në të

tëra frontet! Një ofensivë të tillë të gjithë e dëshironim dhe e pritnim. Aty ne shikojmë mençurinë dhe zotësinë taktike e strategjike të forcave tuaja çlirimtare, të cilat bënë që të merren Kuang Tria, të kërcënohet Sajgoni, të marshohet drejt Huesë dhe të vihen në rrezik Da Nangu, Bin Dini e të tjerë, ku tani janë struktur forcat imperialiste amerikane, duke i vënë ato dhe kriminelin Nikson në pozitë të mundurit.

Çfarë po bën tani Niksoni? Ai kërcënon Vietnamin, por kërcënimet nuk kalojnë te vietnamezët, të cilët as që duan të pyesin për to. Niksoni, si një armik i egër, mund të bëjë kërcënime, mund të urdhërojë për bombardime nga ajri edhe mbi Hanoi apo Hajfongun, por se mos janë këto bombardimet e para kundër vendit tuaj?! Ju e dini më mirë se kushdo, se vetë po luftoni dhe po mbronit atdheun tuaj me gjak e sakrificë të panumërta, që në Vietnam janë djegur e përvëlur fshatra e qytete të tëra, megjithatë populli juaj ka qëndruar burrisht, ushtria juaj nacionalçlirimtare ka qëndruar me heroizëm në luftën kundër bishës amerikane dhe reaksionarëve sajgonezë dhe tani është duke ecur përpara drejt çlirimit. Këtë e dimë edhe ne që ndjekim nga afër luftën tuaj.

Ne e kemi përshëndetur me entuziazëm të madh e të papërshkrueshëm popullin tuaj për fitoret e merituarat, të arritura me luftë dhe me gjak dhe jemi të bindur se, ashtu siç e keni thënë ju dhe siç e përsëritim vazhdimisht edhe ne, lufta e armatosur është faktori kryesor që do ta detyrojë Niksonin të bjerë në gjunjë. Lufta do ta bëjë imperializmin amerikan të pranojë si i mundur kushtet që i vihen nga ju. Sot

mësuar se përfaqësuesi i qeverisë amerikane, Porter, e pezulloi mbledhjen në Paris, për arsye se Vietnamit refuzoi kushtet që vunë amerikanët, sipas të cilave kërkohet që vietnamezët të ndalonin ofensivën. Ata duhet t'i pranojnë kushtet tuaja, sepse pikërisht ata janë agresorët, por tani të mundur e të thyer. Është fakt se ofensiva juaj nuk është ndalur, ajo po vazhdon me sukses.

Lufta juaj, të dashur shokë, u ka dhënë zemër gjithë popujve të botës, veçanërisht popullit shqiptar, që është i lidhur kurdoherë me ju. Ai në çdo moment ka qenë me ju kundër armiqve të Vietnamit, që janë njëkohësisht edhe armiq të e vendit tonë. Në çdo moment Partia dhe populli ynë kanë dhënë mendimin e tyre të qartë dhe çdo herë, në çdo kohë, kanë mbajtur qëndrim në mbrojtje të interesave të popullit heroik vietnamez, të luftës së tij çlirimtare.

Duke u bazuar në eksperiencën tonë, ne i gjykojmë njerëzit nga rruga që ndjekin dhe nga veprat që kryejnë. Populli ynë, si në kohën e luftës, ashtu edhe pas Çlirimit, ka kaluar momente të vështira, por ai kurdoherë i ka matur mirë veprimet që ka kryer dhe në mënyrë të veçantë gjithnjë ka dashur që në marrëdhëniet në mes vëllezërve asgjë e keqe të mos ndodhë. Por kundër kësaj dëshire të tij, disa herë ai ka vënë re se midis atyre që janë hequr si miq ka pasur edhe nga ata që nuk kanë qenë të tillë. Kjo e ka bërë atë të rritë edhe më shumë vigjilencën e t'i gjykojë njerëzit në bazë të veprave dhe jo të fjalëve. Këtë ia ka mësuar atij jeta. Pra, të përfitojmë nga eksperiencia e njëri-tjetrit për të mirën e popujve tanë dhe të çështjes sonë të përbashkët.

Ne urojmë që Vietnami të çlirohet sa më parë dhe kemi bindjen e madhe se ai do të çlirohet. Të jeni të sigurt, të dashur shokë, se te populli shqiptar dhe te Partia e Punës e Shqipërisë ju keni pasur dhe kurdoherë do të keni miq besnikë, miq për kokë. Populli ynë është një popull i vogël, gjeografikisht larg jush dhe materialisht nuk kemi mundësi t'ju ndihmojmë më tepër. Veç për një gjë ju sigurojmë: Zemrat tona gufojnë nga gëzimi i madh për triumfin tuaj, ndërsa vështirësitë, vuajtjet dhe martirizimet e popullit tuaj ne i kemi ndier në zemrat tona, ashtu si dhe ju.

Ne vazhdimisht kemi qenë të lidhur bashkë, shokë të Vietnamit të Veriut dhe të Jugut. Këtë e provon, midis të tjerash, edhe fakti që, me gjithë luftën e madhe që vazhdoni të bëni, me gjithë vështirësitë shumë të mëdha që keni, Shqipërinë asnjëherë nuk e keni harruar, kurdoherë që ne kemi pasur ngjarje të shënuara, midis miqve të shumtë kemi pasur edhe përfaqësuesit e popullit dhe të partisë suaj dhe për këtë ju jemi shumë mirënjohës. Edhe kësaj radhe partia ju dërgoi të merrni pjesë në Kongresin e 7-të të Bashkimeve tona Profesionale, prandaj në emër të Partisë dhe të popullit shqiptar, më lejoni t'ju falënderoj shumë për këtë ndihmë.

Me sa jemi njoftuar An Loku është duke u marrë nga luftëtarët tuaj. Ai është rrethuar dhe po bombardohet me artileri nga forcat çlirimtare. Imperialistët amerikanë i vënë rëndësi të madhe An Lokut, sepse ai ndodhet në rrugën kyç që të çon për Sajgon.

Duke e marrë fjalën, kryetari i delegacionit të

Federatës së Sindikatave për Çlirimin e Vietnamit të Jugut, bëri një ekspozitë të gjendjes së luftimeve në Vietnamin e Jugut dhe, pasi foli për sukseset e fitoret e arritura nga luftëtarët heroikë vietnamezë, falënderoi për përkrahjen që populli shqiptar dhe PPSH i kishin dhënë dhe i jepnin luftës çlirimtare të popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë. Pastaj e mori përsëri fjalën shoku Enver Hoxha:

Ju faleminderit shumë për këtë ekspozitë të qartë të gjendjes së luftës në Vietnamin e Jugut. Ekspozitja juaj na forcon akoma më shumë bindjen në fitoren tuaj. Duke dëgjuar atë, ne mësuam edhe më mirë se si ju e keni goditur armikun vazhdimisht me një pjekuri të madhe politike, ideologjike dhe strategjike, se si i keni shkaktuar atij humbje të rënda dhe se si pikërisht në momentin më të përshtatshëm politik ndërkombëtar, shpërthyet ofensivën e madhe që po vazhdon, për shpartallimin e strategjisë politike dhe ushtarake të imperializmit amerikan.

Niksoni dhe banda e tij e egër donin të tregonin sikur imperializmi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka ndryshuar fytyrë, sikur ai lufton në Vietnam për të shpëtuar demokracinë, për të bindur botën se agresionin nuk e bën ai, por populli vietnamez, që po lufton kukullat e Sajgonit. Pikërisht ju, me luftën tuaj të vazhdueshme, me sulmet tuaja të rrufeshme, mundët dhe arritët ta demaskoni krejtësisht politikën imperialiste të «vietnamizimit» të luftës, të ndjekur nga Niksoni dhe nga gjithë ata që i mbajnë ison këtë kriminelin të madh. Ju keni fituar politikisht, keni fituar, gjithashtu, ushtarakisht dhe i keni treguar gji-

thë botës se agresorët në Vietnam janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa qeveritarët e Sajgonit janë kukulla, kuislingë, që u shërbejnë agresorëve dhe që çojnë në kasaphanë bijtë dhe bijat e popullit të pafajshëm. Me luftën tuaj ju u treguat imperialistëve amerikanë dhe gjithë botës se këto kukulla tradhtarë nuk kanë asnjë mbështetje në popull, se po të mos ketë mbështetjen e imperializmit amerikan regjimi i kukullave të Sajgonit zhduket menjëherë. Populli vietnamez është i lidhur si mishi me thoin me Frontin Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut.

Në shohim në televizor se si ua mbathin me vrap e pa këpucë në këmbë ushtarët kukulla përpara sulmeve të luftëtarëve heroikë vietnamezë. I tillë është fundi i tyre, ata i pret vetëm disfata. Kjo do të thotë se lufta juaj është e madhe, fitorja gjithashtu e madhe, por edhe mësimet që duhet të nxirren prej saj janë të mëdha. Intrigat e imperialistëve amerikanë do të vazhdojnë me siguri edhe në të ardhmen. Siç e kanë zakon, ata do të vazhdojnë të ecin në këtë rrugë.

Së shpejti Niksoni do të shkojë në Moskë, me shpresë se atje do të gjejë njëfarë *modus vivendi* për të dalë jo si i mundur nga situata e vështirë që i është krijuar në Vietnam dhe ku është zhytur keqas. Lufta juaj nuk do ta lejojë të marrë frymë, prandaj ai do të dalë patjetër i mundur nga kjo luftë. Populli vietnamez ka derdhur gjak, prandaj fitorja është e do të jetë e tij. Ai vetë do ta arrijë këtë fitore me përpjekjet e sakrificat e veta.

Edhe miqtë, me aq sa kanë mundur, ju kanë ndihmuar. Lufta kaq e gjatë e me koston e sakrificave të

mëdha, që ka bërë populli juaj, ju ka bërë më shumë se cilindo të ndërgjegjshëm që të dalloni cili është mik i sinqertë dhe cili është mik i rremë. Popullin e Vietnamit, luftëtarët dhe komunistët e Jugut dhe të Veriut nuk mund t'i gënjejë asnjë farë demagogjie, dredhie apo dhëlpërie. E tillë është bindja jonë. Ju e keni vënë Niksonin në një situatë jashtëzakonisht të vështirë. Tani, para zgjedhjeve presidenciale, ai ka bërë dhe ka përsëritur deklaratën se do t'i tërheqë trupat nga Vietnam. Do ta mbajë vallë fjalën ai? Ne jemi të bindur që ai nuk do të tërhiqet vullnetarisht, sepse imperializmi amerikan është kokëfortë, është i etur për gjak, prandaj nuk kemi asnjë iluzion për të. Por çështja është që edhe në vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës është krijuar një situatë e vështirë për luftënxitësit, sepse vetë populli amerikan po revoltohet nga vazhdimi i ndërhyrjes barbare në Vietnam. Duke e parë në kompleks çështjen tuaj, fitoret që keni korrur janë të shumanshme dhe ato i kanë vënë imperialistët amerikanë në situata shumë të rënda. Prandaj, që të dalin nga rruga pa krye, ata duhet të largohen andej dhe të pranojnë 7 pikat që ka parashtruar Fronti Kombëtar i Çlirimit të Vietnamit të Jugut. Rrugë tjetër nuk ka për ta. Ne jemi të bindur se intrigat e Niksonit dhe të revizionistëve modernë ju i shikoni dhe i luftoni drejt.

Ne kemi eksperiencë të hidhur me revizionistët sovjetikë dhe këtë nuk ngurrojmë t'ua themi miqve tanë. Ata nuk janë në rrugë të drejtë. Ata përpiqen të përfitojnë nga sinqeriteti i popujve e i partive marksiste-leniniste dhe luajnë shumë intriga në rrugë anti-

leniniste. Unë nuk dëshiroj të futem në këto çështje, por dua të vë në dukje se, siç tregoi edhe pushtimi i Çekoslovakisë, ata që kryejnë vepra të tilla, mund të merret me mend se çfarë veprimesh të tjera barbare mund të bëjnë. Në kohën e Leninit dhe në kohën e Stalinit, Bashkimi Sovjetik nuk bënte akte të tilla të turpshme imperialiste, nuk sulmonte popujt e botës.

Nuk është koha, as rasti për të treguar ato që na kanë bërë neve revizionistët sovjetikë. Ato janë të gjitha të faktuara. Revizionistët sovjetikë janë intrigantë dhe dinakë të pashoq. Por ne për një gjë jemi të bindur: popullin heroik të Vietnamit, që lufton me armë në dorë, asnjë gënjeshtër dhe intrigë, nga cilado anë që t'i vijë, nuk mund ta mashtrojë.

Shqipëria është një vend shumë i vogël dhe i rrethuar nga armiq. Kështu kemi qenë që kur u çliroam dhe kështu vazhdojmë të jemi edhe sot. Në këto kushte, në rast se vija jonë nuk do të ishte dhe nuk vazhdon të jetë e drejtë, nuk mund ta ruanim dhe ta ruajmë lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Në qoftë se rruga që ndjek populli, qoftë në Vietnamin e Veriut, qoftë në Vietnamin e Jugut, nuk do të ishte dhe nuk është e drejtë, ju nuk mund të arrinit suksesese dhe të fitoni mbi armikun më të egër të njerëzimit, i cili ka provuar mbi ju të gjitha llojet e armëve, me përjashtim të bombës atomike. Ai ka dështuar në Vietnam në të gjitha drejtimet. Për ç'arsye? Sepse rruga e tij nuk është e drejtë, sepse e drejtë është rruga juaj. Prandaj çfarëdo që të bëjnë armiqtë tanë, e drejta do të çajë përpara. Hesapet me armiqtë

i lan vetëm lufta. Vallë tani imperialistët nuk vazhdojnë të bëjnë intriga? Të tërë imperialistët, amerikanë, sovjetikë, francezë e të tjerë bëjnë intriga, të gjithë përpiqen si e si të dështojë lufta heroike në Vietnam. Mirëpo intrigat e tyre do të dështojnë për arsye se liria e fituar me gjak, nuk ka mortje kurrë.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe i gjithë populli shqiptar, njëzëri dhe me zemër ju urojnë juve, të dashur shokë të Vietnamit të Jugut e të Veriut, suksese në mbrojtjen e Vietnamit të Veriut dhe në shkatërrimin e kukullave të Sajgonit, çlirim të plotë të Jugut, fitore të plotë për bashkimin e vendit.

Në bisedë e mori fjalën edhe kryetari i delegacionit të Federatës së Sindikatave të RD të Vietnamit, i cili ndër të tjera foli edhe për vendosmërinë e popullit vietnamez në luftë kundër imperializmit amerikan dhe për përkrahjen që popujt e botës dhe populli shqiptar i kishin dhënë dhe i jepnin kësaj lufte.

Pastaj shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Jam shumë i gëzuar që u takova sot me ju. Kongresi i 7-të i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë do t'ju përkrahë ju me të gjitha forcat, ai do të jetë shprehja më e lartë e vullnetit të klasës sonë punëtore, që do të shprehet nga delegatët.

Ju lutem në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, të popullit shqiptar dhe timin, t'u transmetoni të gjithë luftëtarëve të Vietnamit të Veriut dhe të Jugut, gjithë udhëheqësve të luftës çlirimtare, gjithë komunistëve, shtabit të ushtrisë nacionalçlirimtare, Komitetit Qendror dhe Byrosë

Politike të Partisë suaj të falat e të gjithë shokëve tanë dhe të miat, përshëndetjet dhe urimet tona për fitoren tuaj të plotë.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

TE LIDHJET E NGUSHTA ME POPULLIN, ATJE I KEMI RRËNJËT TONA

*Nga biseda me një drejtues marksist-leninist
nga Cejloni*

4 maj 1972

Pasi i uroi mirëseardhjen mysafirit, shoku Enver Hoxha e pyeti për shëndetin e tij dhe të shokëve, si dhe për gjendjen në Cejlon (Sri Lanka). Duke iu përgjigjur, miku foli për gjendjen e rëndë në vendin e tij si rezultat i veprimtarisë së regjimit borgjez në fuqi e të revizionistëve.

Pastaj e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Siç thatë edhe ju, revizionistët, si kudo e kurdoherë edhe në vendin tuaj, luajnë rolin e tyre të njohur, atë të largimit të masave nga revolucioni. Prandaj, jo vetëm në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, por edhe në kushtet e një zhvillimi relativisht paqësor të kapitalizmit, është e domosdoshme që në çdo vend, partia e proletariatit të përpiqet të vërë në jetë atë që na mëson teoria jonë marksiste-leniniste, kombinimin e punës legale me atë ilegale. Kjo është e domosdoshme të bëhet, sepse veprimtarinë tonë revolucionar-

re ne gjithmonë duhet t'ia përshtatim situatës. Por kryesorja është, sipas mendimit tonë, që partia të jetë e fortë, të ndjekë një vijë të drejtë, sepse kështu do të dijë të nxjerrë konkluzione të drejta për taktikën dhe strategjinë në çdo situatë.

Natyrisht, ju e njihni shumë më mirë situatën aktuale të vendit tuaj, se atje jetoni vetë, por mendimi im është se në këto momente, në gjendjen e vështirë që është krijuar tani në Cejlon, rëndësi të madhe ka ndjekja e taktikës së drejtë, luftë në të dy format, legale dhe ilegale, pra të kombinohet drejt puna ilegale me punën legale në masa.

Në situata të vështira ka gjithmonë rrezik të zhvillohet prirja për veprimtari shumë të kufizuar, të harrohen masat dhe partia të kthehet në një sekt, të mbyllet në vetvete. Kjo do ta bënte atë akoma më *vulnerabël* nga goditjet e armikut. Në rast se komunistët e vendeve kapitaliste mbyllen në guaskën e tyre, borgjezia dhe imperializmi do të orvaten të depërtojnë patjetër në ta dhe do t'i dëntojnë më lehtë nga brenda në momentin që do të dëshirojnë.

Duke e pasur mirë parasysh domosdoshmërinë e zhvillimit të punës ilegale, sidomos për ruajtjen e Partisë së klasës punëtore, futja e komunistëve në masa ka rëndësi të jashtëzakonshme. Jo vetëm te ju, por edhe te ne, ku Partia është në fuqi, zbatimi i vijës së masave është vendimtar për revolucionin. Ne bëjmë të gjitha përpjekjet që direktivat e Partisë, vija e saj, të zbatohen me përgjegjësi dhe drejt nga të gjithë, nga komunistët dhe nga masat. Për këtë njerëzit duhet të bëhen të ndërgjegjshëm dhe kjo arrihet

kur jemi kurdoherë nën kontrollin e klasës punëtore e të masave dhe të lidhur ngushtë me to.

Në kushtet kur partia është në fuqi, si tani në vendin tonë, vepron hapur. Ndryshe ishte gjatë kohës së luftës, kur ishim në ilegalitet të thellë. Atëherë ne ishim të detyruar të zhvillonim një punë shumë të shtrënguar konspirative për ruajtjen e komunistëve dhe të aktivistëve, për suksesin e luftës. Prandaj nuk lejohej që shokët, listat e emrave të tyre, bile edhe veprimtaria më e vogël që do të kryhej, të diheshin atëherë nga kushdo, që s'kishte të bënte me to; të gjitha mbaheshin rreptësisht sekret, sepse përpara kishim armikun, i cili përpiqej të mësonte çdo gjë rreth nesh, të zbulonte çdo plan, çdo vendim tonin për të na dëmtuar.

Kurse sot ne jemi të lirë, populli është i lidhur ngushtë me Partinë, prandaj ai duhet t'i shikojë, bile t'i njohë fill e për pe direktivat e saj, sepse kështu do të bëhet më i ndërgjegjshëm për zbatimin e tyre. Në kushtet tona, komunisti që punon në bazë u drejtohet drejtpërdrejt masave që e rrethojnë për zbatimin e direktivave të Partisë, me qëllim që ato të mobilizohen për zbatimin e tyre. Ne luftojmë t'i edukojmë punonjësit me tipare revolucionare dhe t'i bëjmë të ndërgjegjshëm, në mënyrë që direktivat e Partisë të mos i zbatojnë verbërisht, por ta ndiejnë se ato janë të domosdoshme për jetën e tyre, të kuptojnë qartë se duhet të shprehin kurdoherë mendimin e tyre për çdo problem dhe të thonë hapur nëse ky ose ai veprim është ose jo i drejtë. Vetëm kështu mbrohet dhe realizohet gjer në fund vija e Partisë.

Por kushtet për të vepruar në këtë mënyrë jo kudo dhe kurdoherë janë njëlloj. Në kohë rreziku, një parti me eksperiencë tendos menjëherë nervat e muskujt dhe hidhet në ilegalitet të plotë, por edhe në këto kushte ajo nuk harron të veprojë për ta goditur dhe për ta thyer armikun. Në rast se në vendin tonë vijnë përsëri kohë të vështira, Partia nuk do të gjen-det më si në kohën kur u krijua, mbasi atëherë ajo ishte pa eksperiencë dhe i duhej të bënte një punë kolosale për edukimin politik e ideologjik të masave dhe për të vënë në jetë parimet. Ajo i ka përgatitur e i përgatit masat vazhdimisht që, në rastin e një rreziku eventual, në kushtet e reja që mund të krijohen, të dinë të punojnë me nerva të tendosur.

Lidhur me disa çështje që shtruan në Kongresin e 6-të të Partisë, me aq sa mundëm, u përpoqëm të nxjerrim disa konkluzione. Kështu vepruam midis të tjerash, edhe për ato çështje që kanë të bëjnë me luftën që duhet zhvilluar kundër rrymave antimarksiste, të cilat janë bërë sot një rrezik shumë serioz për lëvizjen komuniste. Dihet se këto rryma e kanë buri-min në ideologjinë borgjeze dhe ushqehen, në mos drejtpërsëdrejti, tërthorazi nga revizionistët, sidomos nga ata sovjetikë. Në disa vende revizionistët veprojnë nëpërmjet agjenturave, që kanë mundur të futin, duke zhvilluar një veprimtari të gjithanshme jo vetëm politike e ideologjike, por edhe me mjete të tjera, pa lënë pas dore subvencionet financiare. Propaganda dhe përkrahja e paprincipitë që revizionistët sovjetikë u japin rrymave të ndryshme antimarksiste dhe udhë-heqjeve borgjeze të shumë vendeve kapitale, që hiqen

si demokrate, bëhen me qëllim që sovjetikët të futen në këto vende, të mbrojnë interesat dhe të realizojnë synimet e tyre, duke mashtruar masat punonjëse. Në këtë mënyrë ata luftojnë të forcojnë kudo pozitën e tyre.

Mendimet që kishim për këto probleme i shtruan në Kongresin e Partisë sonë, pavarësisht se shokët tanë komunistë revolucionarë të vendeve të ndryshme i njohin këto probleme, pasi ata i kanë provuar dhe i provojnë në kurriz të tyre rrjedhimet e veprimtarisë armiqësore të rrymave antimarksiste dhe terrorin e armikut, sepse janë në luftë të vazhdueshme me ta, futen në burgje, siç ju kanë futur ju dhe shokët tuaj. Udhëheqësit e këtyre rrymave përpiqen t'i futin masat e popullit në aventura, sigurisht me qëllim që ose të marrin fuqinë (dhe marrja e fuqisë nga ana e tyre asnjë ndryshim nuk i sjell gjendjes së vështirë të masave punonjëse, sepse ato nuk janë tjetër veçse korrente borgjeze të maskuara), ose të realizojnë qëllimin e përbashkët: të godasin vijën e drejtë të partive marksiste-leniniste.

Nga sa më kanë thënë shokët tanë, lëvizja e prillit të vitit 1971 në vendin tuaj ka krijuar vështirësi për punën që duhet të bëni për forcimin e unitetit revolucionar të radhëve të Partisë. Ju i demaskuat tradhtarët revizionistë të udhëhequr nga Lumba, prandaj qeveria e Bandaranajkes ju goditi dhe futi shokët tuaj nëpër burgje. Ngjarjet e zhvilluara patën rrjedhimet, ato bënë që sot në Cejlon të ketë terror, presion dhe shtypje për t'u futur njerëzve frikën. Por ne komunistët nuk frikësohemi. Sigurisht që kur armiku

godet, mund të ndodhin edhe dështime të përkohshme në veprimtarinë revolucionare, mund të ndihet njëfarë refluksi, njëfarë tërheqjeje nga ana e masave. Për ta ngritur lëvizjen përsëri, kërkohen përpjekje të mëdha nga ana e komunistëve revolucionarë, të cilët në veprimtarinë e tyre do të ndeshen patjetër me reaksionin e egër të borgjezisë kapitaliste, me revizionistët dhe me lloj-lloj rrymash që do të përpiqen të pengojnë krijimin e atyre situatave revolucionare për të cilat luftojnë partitë tona.

Sidoqoftë, situatat për imperialistët dhe për revizionistët modernë nuk janë të qëndrueshme. Të dyja palët janë në krizë të rëndë, sepse rreziqet që i kërcënojnë janë të mëdha. Cilat janë këto rreziqe? Masat, klasa punëtore, fshatarësia, të cilat janë në shpërthim. Pikërisht këtë shpërthim armiqtë e komunizmit, të cilët bëjnë vazhdimisht komplete, përpiqen ta shmangin e ta thyejnë ose me demagogji, duke u hequr sikur mbrojnë dëshirat e masave, ose me armë.

Detyra jonë e madhe është t'i demaskojmë pa hezitim rrymat armiqësore të rrezikshme dhe situatat për këtë është shumë e favorshme. Lufta kundër tyre është e domosdoshme dhe e pashmangshme, sidomos në frontin politik e ideologjik. Në këto situata, rëndësi të madhe kanë ndihma e pakursyer që duhet t'i japim në shoku-shokut dhe ruajtja nga gabimet, pasi në këtë turbullirë që ka krijuar në botë revizionizmi modern, një gabim yni, sado i vogël të jetë, ka pasoja të rënda.

Populli ynë thotë: «Armikun mos e duaj, por pjesën ia ruaj!». Me këtë dua të them që armikun du-

het ta urresh dhe ta luftosh, por në asnjë mënyrë të mos nënvleftësosh forcat e tij, ai duhet vlerësuar realisht, siç është. Prandaj ne kemi vazhdimisht kujdes të mos gabojmë në këtë drejtim. Kur shkojmë në luftë medocemos duhet të dimë se me cilin kemi të bëjmë. Vetëm kështu do të hartojmë si duhet planin e vendosjes së forcave. Ne duhet t'i llogaritim forcat e armikut, t'i kemi mirë parasysh ato, dhe, nga ana tjetër, kurrë të mos jemi pesimistë, por kurdoherë optimistë, sepse në shumë çështje, sidomos në ideologji, në qëllimet tona të larta, ne kemi epërsi mbi ta. Edhe pse armiqtë mund të kenë dhe kanë epërsi në armë, prapë ne qëndrojmë më lart se ata. Kështu ka ndodhur në vendin tonë. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, armiqtë tanë ishin të armatosur gjer në dhëmbë, ndërsa ne nuk patëm bile as pushkë, as fishekë, por këto ua rrëmbyem atyre dhe i mundëm.

Vietnami jep sot një shembull të shkëlqyer për të gjithë popujt, të mëdhenj dhe të vegjël. Populli heroik vietnamez ka më tepër se 30 vjet që po lufton kundër fuqive të mëdha imperialiste, si kundër Francës, Japonisë dhe sot kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Të gjithë këta agresorë kanë përdorur dhe po përdorin atje armë nga llojet më të ndryshme. Amerikanët e kanë bërë Vietnamin poligon qitjeje, vetëm bombën atomike nuk kanë përdorur gjer tani atje. Megjithatë, asgjë nuk i bënë dot popullit të këtij vendi, përkundrazi, ky e ka vënë në një gjendje shumë të vështirë fuqinë më të madhe imperialiste të botës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Shembulli i vendit tonë dhe i Vietnamit heroik

tregon se edhe një popull i vogël, kur është i vendosur të luftojë për lirinë e tij, kur manifeston vullnet të hekurt dhe organizim të shëndoshë, është në gjendje të përballojë çdo vështirësi që i del përpara.

Me rëndësi për fitoren dhe vendimtar për fatin e revolucionit botëror është gjithashtu uniteti revolucionar i të gjitha partive marksiste-leniniste. Për ne është i qartë dëmi kolosal që i solli lëvizjes komuniste ndërkombëtare tradhtia revizioniste. Megjithatë idetë tona, duke pasur si shtyllë kurrizore marksizëm-leninizmin, dhe lufta jonë e vendosur janë sot e vetmja garanci për ecjen përpara të çështjes së revolucionit dhe të socializmit. Kontradiktat që ekzistojnë në Cejlon midis borgjezisë vendëse dhe asaj indiane, mendoj unë, shërbejnë për të mos depërtuar dot ndikimi direkt i socialimperialistëve sovjetikë dhe i maharaxhave indianë në vendin tuaj. Situata atje është një çikë paradoksale, por kjo i jep mundësi mënjanimit të kolonizimit të vendit tuaj nga ana e imperialistëve amerikanë, indianë dhe e sovjetikëve.

Në vendin tonë, siç ju kanë thënë shokët, puna në përgjithësi shkon mirë. Natyrisht, kemi edhe vështirësi, por ne luftojmë t'i kapërcejmë ato. Përparime kemi kudo, në industri, në bujqësi, në arsim e në kulturë. Ajo që ka rëndësi dhe që është pozitive për popullin tonë në luftën e tij për ndërtimin e socializmit, është çështja se të gjithë tani e kanë të qartë se çdo gjë arrihet me përpjekje, me punë, me luftë në rrugë revolucionare. Kjo ndihmon për kalitjen e njerëzve, prandaj edhe vështirësitë që kemi pasur herë pas here, i kemi kapërcyer me sukses. Një frymë e

tillë revolucionare bën që asgjë të mos e dëshpërojë popullin, përkundrazi, ia shton akoma më tepër vendosmërinë për të ecur kurdoherë përpara në rrugën që i tregon Partia.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se në punë do të kemi të meta, mund të bëjmë edhe gabime. Nuk ka njeri në botë të mos gabojë. Rëndësi ka që kur bëhen gabime, sidomos kur këto ushtrojnë ndikim negativ në rrugën që ndjekim, të bëhen përpjekje për t'i njohur sa më parë ato, me qëllim që t'i ndreqim, pasi dëmtojnë popullin tonë dhe të tjerët. Kur veprohet kështu, do të thotë se kemi të bëjmë me një provë të qëndrimit serioz ndaj gabimeve. Ky është një parim jetik i njohur nga të gjithë. Prandaj kur shohim që diçka nuk shkon në rregull, ne bëjmë kritika e gjithashtu presim edhe nga të tjerët që të na bëjnë vërejtje e kritika. Populli ynë thotë: «Kush të do, të kritikon». Duke u mbështetur në këtë parim, ka ecur dhe do të ecë kurdoherë Partia jonë; duke u mbështetur në këtë parim, dëshirojmë që edhe të tjerët kështu t'i zhvillojnë marrëdhëniet me ne...

Në drejtim të përmirësimit të marrëdhënieve me shtetet e ndryshme, sidomos me fqinjët, si për shembull me Greqinë, janë bërë hapa përpara, dhe ne ata i kemi bërë duke u nisur nga pozita marksiste-leniniste, pa bërë lëshime në parime. Po kështu, në marrëdhëniet me Jugosllavinë nuk i kemi shkelur parimet. Ideologjikisht nuk jemi pajtuar dhe as do të pajtohemi kurrë me revizionistët titistë. Ne i kemi luftuar me të drejtë Titon dhe shokët e tij. Pati mjaft nga ata që ia hodhën fajin Stalinit, kur ai zbuloi dhe

demaskoi rrugën e renegatit Tito, por të gjitha ato që tha Stalini për Titon kanë dalë deri në një. Titoja e pati akuzuar Stalinin se ky gjoja po përgatitej të sulmonte Jugosllavinë, por ky trillim ishte një blufë trashë. Unë kam biseduar personalisht për këtë çështje me Stalinin, i cili më ka thënë se me jugosllavët duhet të tregohemi të kujdesshëm, se çështja e Jugosllavisë është çështja e vetë popujve të saj, se ne kemi për detyrë ta demaskojmë me argumente Titon, se ai është tradhtar, se asgjë tjetër nuk mund të bëjmë kundër tij etj. Tashmë është e qartë për të gjithë se Titoja e titizmi është me të vërtetë një agjunkturë në shërbim të imperializmit. Këtë e vërtetoi koha.

Prandaj, krahas përpjekjeve për përmirësimin e marrëdhënieve në rrugë shtetërore, ne vazhdimisht e demaskojmë ideologjikisht Titon dhe klikën e tij. Udhëheqësve jugosllavë nuk u vjen mirë për këtë qëndrim tonin, por ne ua kemi bërë të qartë se luftën ideologjike kundër tyre nuk do ta pushojmë asnjëherë, sepse asgjë e përbashkët politike dhe ideologjike nuk na bashkon me ta, pavarësisht se tregti jemi dakord të bëjmë dhe po bëjmë. Pikërisht pse kemi zgjeruar marrëdhëniet tregtare me Jugosllavinë, propaganda borgjeze, duke lënë me qëllim mënjanë luftën ideologjike që ne bëjmë kundër revizionizmit jugosllav, përpjetat të japë përshtypjen se Shqipëria po ndërton fytyrë. Marksistë-leninistët e vërtetë nuk ndërrojnë kurrë. Prandaj ka rëndësi që ne të mendohemi mirë për çdo veprim që bëjmë, sepse armiqtë e shfrytëzojnë çdo gjë për të na goditur e dëmtuar, kurse ne nuk i lëmë dhe nuk duhet t'i lëmë të na dëmtojnë asnjë majë thoi.

Partia jonë në çdo kongres të saj e ka përcaktuar qartë vijën që duhet të ndjekë dhe lufton me të gjitha forcat që atë ta zbatojë plotësisht. Disa mund të na akuzojnë për sektarë, por ne kjo s'na pengon të ndjekim me vendosmëri e pa u lëkundur rrugën që na mëson Partia, sepse rrugë tjetër nuk njohim. Ne nuk pajtohemi kurrë me oportunizmin. Mund të na quajnë «sektarë», por të gjithë duhet ta dinë se me parimet nuk kemi bërë dhe kurrë nuk do të bëjmë tregti. Të jesh në rrugë të drejtë nuk do të thotë të mos dish të bësh politikë të mirë, por, po të jesh oportunist. do të bësh medoemos politikë të gabuar.

Ne jemi të bindur se në Kongresin e 7-të të Bashkimeve tona Profesionale, që do të bëhet këto ditë, klasa jonë punëtore do të vërë në dukje edhe të mirat, edhe sukseset. Siç e ka zakon, ajo do të bëjë edhe kritika të drejta kundër të metave, dobësive e gabimeve që ndodhin në punë e sipër. Ne kemi shumë nevojë për këshillat dhe kritikën e klasës punëtore, prandaj Partia jonë e nxit atë vazhdimisht të flasë pa druajtje. Kjo është marksiste-leniniste. Kësaj çështjeje ne i vëmë një rëndësi të madhe, me qëllim që te ne të mos ngjasë si në Bashkimin Sovjetik, që në vendin tonë të zhvillohet e të forcohet vazhdimisht ajo demokraci e vërtetë siç na mëson Lenini, që njerëzit të mësohen të qeverisin, të thonë kurdoherë të vërtetën, të mos mbyllin gojën ose të flasin prapa krahëve, por të kritikojnë hapur ata që nuk punojnë mirë. Lenini na mëson se vetëm kjo është rruga e shëndoshë. Të mos e mësojmë popullin me parulla, se një veprim i tillë ka pasoja të hidhura, por ta lëmë t'i punojë koka,

të mësohet të shprehë pa druajtje mendimet e tij sepse mendimet e popullit janë një forcë e madhe, kolosale. Ç'rëndësi ka zotësia jonë, e udhëheqësve, në qoftë se na rritet mendja, përpara zotësisë dhe mençurisë së masave? Kush na i mësoi neve këto gjëra që dimë? Populli, klasa punëtore, lufta, vuajtjet, fitoret. Prandaj, siç na mëson Lenini, të mbështetemi kurdoherë te populli, te klasa punëtore, atje duhet t'i kemi ne kurdoherë rrënjët.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

KLASA PUNËTORE, ME PARTINË NË KRYE, DUHET TË JETË KURDOHERË NË BALLË

Nga biseda me delegacionin e punëtorëve kinezë

4 maj 1972

Pasi u uroi miqve mirëseardhjen, shoku Enver Hoxha mori fjalën:

Ne, punonjësit e Partisë, të Bashkimeve Profesionale dhe mbarë populli shqiptar jemi të gëzuar që ju kemi në gjirin tonë ju, përfaqësuesit e klasës punëtore kineze. Ne jemi, gjithashtu, shumë të gëzuar që na sillni përshëndetjet e sigërtë revolucionare të popullit kinez për komunistët dhe për popullin tonë.

Ne, shqiptarët dhe kinezët, jemi dy popuj të ndryshëm, por të lidhur me njëri-tjetrin. Partia jonë i edukon punonjësit me frymë revolucionare, i edukon që të forcojnë unitetin e çeliktë me të, të forcojnë miqësinë midis dy popujve tanë dhe dy vendeve tona, të forcojnë unitetin internacionalist në luftën e ashpër kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, për lirinë e popujve, për triumfin e revolucionit, për fitoren e socializmit e të komunizmit në të gjithë botën.

Popujt që luftojnë për çlirim kombëtar e shoqëror, i njohin mirë ata që qëndrojnë në krye dhe i qeverisin, prandaj nuk kanë besim dhe nuk i duan. Vetë ata do ta gjejnë mënyrën si të çlirohen e të sjellin në krye njerëzit e tyre, që i duan të mirën populit. Kjo është çështje që u përket popujve, të cilët i shikojnë me vëmendje dhe i kundërshtojnë veprimet e imperialistëve e të socialimperialistëve, prandaj shohim të ngushtohet sfera e ndikimit të tyre në masat punonjëse të vendeve të ndryshme të botës. Revolucioni do të sjellë medoemos në udhëheqje të çdo vendi njerëzit e popullit. Natyrisht, kjo nuk arrihet lehtë, por me luftë, me përpjekje, me diplomaci dhe jo me një, me dy ose me pesë vjet luftë, por me përpjekje për një kohë të gjatë, aq më tepër kur ka edhe zigzage.

Rëndësi ka të kuptohet thelbi i politikës që ndjekin shtetet e ndryshme në marrëdhëniet midis tyre dhe, në radhë të parë, të kuptohet nëse ndihmat që ofron njëri apo tjetri vend, janë për të mirën e popujve apo për interesin e atij që i jep.

Revizionistët sovjetikë vazhdojnë t'i mbajnë akoma edhe sot forcat e tyre ushtarake në disa vende të Evropës Lindore, si në Gjermaninë Lindore, Çekosllovakia e gjetkë, edhe pse kanë kaluar 27 vjet nga mbarimi i luftës. Këto forca u rrinë mbi zverk çekëve, gjermanëve, polakëve, hungarezëve, bullgarëve e mongolëve. Sipas tyre, ky veprim është i mirë, bile leninist. Por Leninin ata e kanë tradhtuar plotësisht dhe mësimet e tij i përdorin vetëm si maska. Jo vetëm kaq. Revizionistët sovjetikë kanë dërguar 40 divizione

të pajisura me raketa moderne në kufi me Kinën. Kjo do të thotë se me këtë ushtri ata po e kërcënojnë këtë vend. Dhe kush e bën këtë? Pikërisht ata që e heqin veten leninistë, por që s'janë gjë tjetër veçse socialimperialistë.

Bashkimi Sovjetik hiqet sikur e ka ndihmuar Vietnamin në fitoret e mëdha ushtarake që ai ka korrur, por ky është një mashtrim i hapët. Nëpërmjet të ashtuquajturave ndihma, Bashkimi Sovjetik revizionist ka për qëllim të futë këmbët në Vietnam dhe të shtojë më tej rrethimin kundër Kinës. Por këtij synimi ai nuk do t'ia arrijë dot kurrë, sepse milionat e masave punonjëse, që aspirojnë socializmin, do t'ia prishin planet.

Populli kinez dhe të gjithë ne duhet të jemi vigjilentë ndaj intrigave të shumta në shkallë ndërkombëtare, që thurin armiqtë imperialistë dhe revizionistë. Ne duhet t'i shpartallojmë këto intriga, t'i zhdukim rreziqet që na vijnë prej tyre dhe kjo arrihet duke qëndruar fort në parimet e marksizëm-leninizmit. Këtë po bëjmë ne dhe rezultatet e këtij qëndrimi po duken brenda vendit tonë dhe në arenën ndërkombëtare. Kjo ka rëndësi të madhe. Me luftën që bëjnë klasa jonë punëtore dhe mbarë populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, ne jemi në gjendje të përballojmë çfarëdo rreziku, sado i madh të jetë.

Ju, shokë, jeni njerëz të dalë nga klasa punëtore e Shangait, ku ka pasur një proletariat të zhvilluar e me tradita, e cila, së bashku me gjithë klasën punëtore dhe fshatarësinë kineze, ka luajtur një rol të rëndësishëm në luftën për çlirimin dhe ndërtimin e

Kinës, për përparimet e saj në bujqësi, në industri e në teknikë.

Një luftë e vendosur dhe e gjithanshme është zhvilluar e po zhvillohet edhe në vendin tonë për ndërtimin e socializmit, për zhvillimin e shpejtë të industrisë, të bujqësisë, të arsimit e të kulturës, për forcimin e ushtrisë dhe të mbrojtjes së atdheut, për forcimin e unitetit të çeliktë Parti-popull, për forcimin e diktaturës së proletariatit. Ne ecim përpara me një vijë politike dhe ideologjike të qartë që zbatohet në përputhje me detyrat e mëdha që kemi përpara për të zgjidhur, si dhe në përshtatje me rrethanat ndërkombëtare. Kjo krijon mundësi që i gjithë populli, nën udhëheqjen e Partisë, të marrë pjesë fuqimisht me mendje e me duar në këtë ndërtim kolosal të jetës së re dhe të njeriut të ri.

Duke ecur pa lëkundje në rrugën tonë revolucionare, ne jo vetëm ngremë ekonominë e përballojmë armiqtë e jashtëm, por përballojmë e zhdukim edhe një armik të padukshëm, mbeturinat e së kaluarës, të feudalizmit e të kapitalizmit, shfaqjet e sëmura që lindin gjatë ndërtimit të socializmit, të cilat e kanë burimin tek influencat borgjeze kapitaliste në ndërgjegjen e njerëzve, te puna intensive që bëjnë armiqtë për të helmuar ndërgjegjen e njerëzve tanë, për të na futur në labirintet e burokratizmit, të intelektualizmit, të teknokratizmit etj. Të gjitha këto shfaqje të sëmura Partia jonë lufton t'i zhdukë frontalisht dhe nuk i lejon të trashen. Pikërisht ashtu siç bën amvisa e mirë në shtëpi, që pastron çdo ditë pluhurat nga dhomat, ashtu edhe Partia jonë punon vazhdimisht për të zhdukur

mbeturinat e së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve tanë. Partia jonë mendon se, për të qëndruar shtëpia e pastër, duhet të punojë brenda saj jo vetëm gruaja, por edhe burri, plaku dhe i riu, të tërë pjesëtarët e familjes, pa përjashtim, dhe për t'ia arritur kësaj duhet të tërë të kuptojnë se ç'do të thotë pastërti. Që shtëpia të jetë shumë e pastër nuk do të thotë të heqësh vetëm plehrat që duken, por edhe ato që gjenden rrëzave e qosheve, t'i fshish mirë e mirë këto, të pastrosh dollapet e t'i hedhësh të gjitha mbeturinat në koshat e plehrave.

Kështu qëndron çështja edhe me pastërtinë politike dhe ideologjike të njerëzve tanë, të masave të popullit. Ne punojmë që njerëzit tanë t'i kuptojnë të metat dhe t'i luftojnë ato. Prandaj u japim rëndësi të madhe organizatave të masave si organizatës së Bashkimeve Profesionale, të Rinisë, të Gruas. Ne kemi edhe Frontin Demokratik, ku bëjnë pjesë të gjitha masat e popullit. Me këtë organizatë Partia punon me kujdes, vepron duke menduar më parë dhe jo në mënyrë kaotike. Në Front njerëzit janë të organizuar politikisht e ideologjikisht me disa forma pune shumë të përshtatshme. Qëllimi ynë është që ne të ndërtojmë shpejt socializmin, i cili është për të mirën e popullit, që njerëzit tanë të jenë të gjithë krah për krah njëri-tjetrit dhe me radhë të shtrënguara, që, po të vijnë shigjetat e armikut, të mos gjejnë asnjë arallëk, asnjë të çarë, ku të futen. Kështu ngjet, po të jemi të lidhur fort në mes nesh dhe njerëzit mund të lidhen fort kur mendojnë dhe veprojnë në bazë të ideologjisë sonë revolucionare. Ja, pra, ç'rëndësi të madhe ka edukimi i njerëzve tanë me marksizëm-leninizmin.

Ne po ndërtojmë kombinatin e metalurgjisë së zezë, të hekur-nikelit në Elbasan. Metalurgjia e zezë prodhon gizë e çelik, por veç këtyre produkteve kaq të vlefshme, atje do të ketë natyrisht edhe mbeturina, skorje. Kështu ndodh edhe në shoqërinë socialiste, ku ndërtohen gjëra kaq të bukura për njeriun, por ku ndeshim edhe shfaqje e mendime të këqija. Kush i mbart këto? Njerëzit që nuk janë të formuar e të kalitur fort ideologjikisht. Pikërisht me këta duhet të punojë Partia për t'i çelikosur, për t'i edukuar, për t'i bërë luftëtarë të vlefshëm për socializmin si gjithë të tjerët. Për këtë qëllim Partia jonë i ka vënë një rëndësi të madhe kontrollit punëtor, që është kontroll marksist-leninist, veprimtarisë së njerëzve dhe revolucionarizimit të mëtejshëm të Partisë dhe të pushtetit.

Me forcimin e kontrollit punëtor, marksist-leninist, Partia ka për qëllim të jetë sa më e fortë, që diktatura e proletariatit të jetë e patundur, që, kur gabojnë, njerëzit të ndreqen sa më shpejt. Këtë rol Partia ia ka dhënë, në radhë të parë, klasës punëtoare, shtyllës së pushtetit popullor, të diktaturës së proletariatit. Klasa punëtoare, me Partinë në krye, është dhe duhet të jetë kurdoherë në ballë të ne. T'i frymëzojë masat e tjera punonjëse në të gjitha drejtimit. Pararoja e saj, Partia, udhëheq tërë jetën e vendit dhe punon t'i kalitë njerëzit dita-ditës, t'i bëjë ata çdo ditë e më revolucionarë. Në këtë revolucion të pandalshëm Partia u jep rëndësi të madhe organizatave të masave, në radhë të parë, organizatës së Bashkimeve Profesionale. Kjo do të mbajë këto ditë Kongresin e saj të 7-të, ku punëtorët do të shfaqin pikëpamjet e tyre të drejta,

luftarake, do të flasin për sukseset e mëdha, do të bëjnë propozime shumë të vlefshme për ta çuar punën akoma më përpara, por njëkohësisht do të flasin edhe për të metat. Merita e veçantë e Partisë sonë qëndron në atë që edhe organizatën e Bashkimeve Profesionale e kalit në një frymë të tillë që kjo ta ndiejë udhëheqjen shpëtimtare të Partisë, të frymëzohet prej saj dhe të vihet në ballë të luftës për edukimin e masave dhe të kontrollit që ato ushtrojnë nën udhëheqjen e Partisë.

Kur flasim për kontroll, këtë ne e kuptojmë në frymën leniniste. Bashkimet Profesionale në vendin tonë nuk kanë kontradikta antagoniste me pushtetin, pasi ky është pushteti i tyre, i klasës punëtore, i gjithë masave punonjëse. Kontrolli i klasës punëtore vlen edhe për atë që thashë, për pastrimin e mbeturinave, të «skorjeve». Njerëzit tanë, klasa punëtore, me Partinë në krye, duhet t'i spastrojnë vazhdimisht e pa druajtje ato, duke kontrolluar veten e çdo gjë në mënyrë marksiste-leniniste dhe duke qenë gjithmonë vigjilentë. Partia jonë i vë rëndësi të madhe kësaj çështjeje dhe ka arritur suksese. Megjithatë ne vazhdojmë të kemi të meta dhe kjo është e natyrshme. Ashtu sikurse ndodh në metalurgji ku, duke punuar për të nxjerrë çelik, dalin skorje, ashtu ndodh edhe me ndërgjegjen e njerëzve, pastrimi i së cilës nga mbeturinat do të vazhdojë për një kohë të gjatë. Kur të shkojmë në komunizëm, është tjetër punë, por që të vemi deri atje duhet të përgatitemi që tani e të punojmë vazhdimisht për edukimin e njerëzve tanë, për forcimin e ndërgjegjes së tyre socialiste, pasi kjo është punë që kërkon kohë.

Pra, suksese kemi, por kemi edhe të meta në punë. Ne shqiptarët nuk trembemi kur të tjerët na kritikojnë, përkundrazi, duam dhe kërkojmë që shokët dhe vëllezërit tanë të na bëjnë kritika, se ato na shërbejnë për të mirë. Një praktikë e tillë bazohet në parimet tona dhe kjo është marksiste-leniniste. Partia na ka edukuar me këtë frymë, prandaj e kuptojmë kurdoherë drejt kritikën dhe autokritikën. Ndërsa ndryshe është me borgjezët dhe revizionistët. Po t'i kritikosh ata nuk durojnë dhe hidhen përpjetë nga zemërimi.

Pas falënderimeve të ngrohta që anëtarët e delegacionit të punëtorëve kinezë i bënë me këtë rast, në fund të kësaj bisede shoku Enver Hoxha u uroi atyre shëndet e punë të mbarë.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

TREGUESIT

TREGUESI I LËNDES

A

Aftësia prodhuese — 89-90, 152, 240-241, 273-275.

Aleanca dhe rivaliteti sovjetiko-amerikan — 224, 323, 420-423.

Arkitektura — 278-281, 283-284, 287-288, 290-291.

Arsimi. Politika e Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës — 1-21, 160-165, 199, 359-361.

Shih edhe: Shkollat, kurset; rëndësia e tyre.

B

Ballkani — synimet e socialimperialistëve sovjetikë ndaj Ballkanit — 321-324.

Banka Bujqësore — kontrolli bankar — 410-412.

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik — politika hegjemoniste dhe demagogjike e socialimperialistëve sovjetikë — 58-59, 60, 71, 72, 73-76, 214-215, 217-218, 230-236,

320-324, 420-423, 434-435, 451-452.

Bindja — metodë kryesore në fushën e edukimit — 202-203.

Blegtoria

— direktivat e Partisë për zhvillimin e blegtorisë. Studimet — 109, 114-116, 157-158;

— përmirësimi racor dhe rritja e rendimenteve. Specializimi në blegtori — 108-109, 114-117, 146, 158-159, 212;

— baza ushqimore — 110-111, 112-113, 139, 154-158;

— shërbimi veterinar dhe lufta kundër sëmundjeve — 109-110, 114, 159-160.

Botimet, shtypi — shfrytëzimi dhe propagandimi i tyre — 41-42.

Bujqësia

— politika e Partisë për zhvillimin e bujqësisë — 328-330, 406-417;

— zbatimi i agroteknikës

moderne dhe rritja e rendimenteve në prodhimet bujqësore. Studimet — 42-44, 123-124, 125-126, 141-145, 386-390;

- toka, trajtimi shkencor i saj — 154-155, 387-388;
- drithërat, patatja; pambuku — 42-43, 44, 123-124, 136-138, 147-149;
- perimet, frutat; përdorimi i tyre — 139-141.

Burokratizmi — lufta kundër shfaqjeve të tij — 88-89, 92-95, 148-149, 178-186, 192-193, 195-196, 204-205, 211-218, 302-303.

D

Demokracia socialiste — 199-203, 350-351, 361-383.

Disiplina proletare; disiplina e planit — 141-151, 295-313, 409-410.

E

Edukimi komunist dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja — 25-35, 83-85, 96-97, 149-151, 239-255, 256-271, 440-441, 453-457.

Efektiviteti ekonomik — 157, 281-282, 385-386, 389-390.

Ekonomia komunale — 245, 257-259, 292.

Ekonomia popullore — orga-

nizimi dhe drejtimi shkencor i punës në të — 256-271, 330.
Emulacioni socialist dhe përhapja e përvojës së përparuar — 36-46, 110-111, 124-126, 137-138, 146, 147-148.

Engels, Frederik — 61, 68, 177, 181, 220, 362.

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 325-326, 330-331, 333, 359.

Estetika — 278-280, 290-291.

Evropa, "sigurimi evropian" — 223, 229-230, 233.

F

Familja — roli i saj në edukimin e brezit të ri — 251-254, 330-331.

Financat, kontrolli financiar — 308-313, 410-412.

Fronti Demokratik i Shqipërisë — 346-350, 352.

Fuqia punëtore

— sigurimi dhe sistemimi i saj — 82-89, 96-98, 168-169;

— kualifikimi dhe kategorizimi i punonjësve — 1-21, 168-169, 310-311.

Furnizimi, zbatimi i kontratave — 298-299, 407-411.

G

Gruaja shqiptare — politika e Partisë për emancipimin e

saj — 130, 244-245, 253-254, 328, 329.

Grumbullimet — politika e Partisë në fushën e grumbullimere — 335-345, 408-409.

GJ

Gjykatat. Gjykata e Lartë — 244, 298-299.

I

Imperializmi — aleancat midis shteteve imperialiste; kriza, disfatat e tij — 222-223, 231, 418, 443, 444.

Investimet, përdorimi i tyre — 151-152, 300-301.

J

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav — 58, 60, 233-234, 322.

K

Kapitalizmi; kontradiktat, kriza në vendet kapitaliste — 223-224, 286, 289.

Këshillat popullorë, këshilltarët — 51, 115-117, 191-194, 201, 211, 273, 275-276;

— Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit të Burrelit — 191;

— Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rre-

thit të Elbasanit — 103, 115-116, 211;

— Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit të Korçës — 266-267.

Këshilli i Ministrave i RPSH (Qeveria) — 40, 41, 49, 111, 114, 116, 173, 264, 276, 298, 299-300, 307, 339, 341, 367, 369, 408, 411, 413.

Kina. Partia Komuniste (revizioniste) e Kinës — 59, 61, 71, 78-79, 423, 452-453.

Klasa punëtore — cilësitë, virtytet; roli udhëheqës i klasës punëtore në ndërtimin e socializmit; edukimi ideologjik, kulturor e tekniko-profesional i saj — 1-21, 81, 84-85, 91-95, 97-98, 105-106, 168-169, 177-180, 194-198, 216, 310-311, 448-449, 455-457.

Koha e punës, shfrytëzimi me efektivitet i saj — 149-150.

Komunisti — cilësitë, detyrat, lidhjet me masat — 105, 167-168, 177-178, 180, 181-182, 183-185, 187-191, 364-365, 371-376, 378-379.

Komunizmi — 179.

Kontrolli i Partisë, i klasës punëtore dhe i masave punonjëse në shoqërinë tonë socialiste

— kontrolli i Partisë — 174-175, 211, 216, 368;

- kontrolli shtetëror — 209-210, 267-268;
 - kontrolli i drejtpërdrejtë punëtor e fshatar — 194-196, 245-246, 267, 455-457.
- Kooperativat bujqësore*
- organizimi shkencor i punës. Metoda dhe stili në punë. Statuti i kooperativave bujqësore — 85, 87-88, 115, 143-151, 146-147, 149-150, 151-152, 168-169, 213, 273, 386-390, 413-415;
 - bashkimi i kooperativave bujqësore; të ardhurat në to — 124-126;
 - marrëdhëniet me shtetin — 336-342, 407-410;
 - organet e planifikimit në kooperativat bujqësore; kooperativistët — 82-84, 149-150, 154, 197, 412.
- Krimet — shfaqjet e kriminalitetit, shkaqet, parandalimi dhe dënimi i tyre* — 238-251.
- Kritika dhe autokritika* — 81-82, 92-94, 104-106, 216-217, 307, 351-352, 372-375, 446.
- Kuadrot*
- politika dhe puna e Partisë me kuadrin; vendosja, shpërndarja dhe ngritja në përgjegjësi — 14-17, 99-103, 161-165, 166-167, 181-186, 183, 199-203, 286;
 - kuadrot e Partisë — 181-191;
 - lidhjet e kuadrove me masat — 91-92, 93-95, 101-102, 104-106;
 - kuadrot e bujqësisë dhe të blegtorisë — 114-116, 121-123, 141-142, 143-146, 324-390.
- Kultura, zhvillimi i saj dhe ngritja e nivelit kulturor të masave* — 2-3, 6-7, 120, 129-130, 161.
- Kushtet e punës dhe të jetesës së punonjësve dhe përmirësimi i tyre* — 84-85, 96-99, 169.
- Kuvendi Popullor. Presidiumi i Kuvendit Popullor* — 47-48, 173, 186, 238, 248.

L

- Legjislacioni, ligjet; njohja, mbrojtja dhe zbatimi i tyre* — 47-54, 203-204, 209-210, 264-265, 295-300.
- Lenin, Vladimir Iliç* — 61, 68, 94, 104, 105, 106, 171, 176, 177, 179, 180, 181, 188-189, 195, 196-197, 220-221, 245, 246, 362, 435, 448-449, 451.
- Letrat; kërkesat dhe ankesat e popullit* — 103, 210-211.
- Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare*

- zgjerimi dhe konsolidimi i saj. Forcimi i unitetit të partive marksiste-leniniste — 61-68, 438-440, 441, 445;
 - partia marksiste-leniniste — tiparet, parimet dhe normat revolucionare të saj — 220-221;
 - partitë marksiste-leniniste në Amerikën Latine — 55-56, 64;
 - lufta kundër imperializmit, revizionizmit, dhe reaksionit — 70-71, 77-79, 218-219, 441-442, 443.
- Lidhjet e Partisë me masat*
- lidhjet me masat — marrëdhëniet Parti-klasë punëtore-masë — 82-83, 104-106, 176-180, 189-190, 194-195, 221-222, 351-352, 361-383, 439-440;
 - dëgjimi i zërit të komunistëve dhe të masave, tërheqja e mendimit të tyre — 85-86, 92-95, 96-99, 196-199, 263-271;
 - përmbajtja, metodat dhe format për forcimin e lidhjeve të Partisë me masat — 87-88, 93-95, 211-218, 448-449.
- Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar*
- 172, 232, 363, 364, 440.
- Lufta e klasave; karakteri objektiv i saj* — 49, 247-248.
- M**
- Marksizëm-leninizmi — përvetësimi, mbrojtja dhe zbatimi i tij* — 57, 61-63, 176-180, 181-182, 188-189, 207-208, 219, 221-222, 362, 452.
- Marks, Karl* — 61, 68, 177, 181, 220, 362, 401.
- Mbrojtja e atdheut — përgatitja e ushtrisë, e popullit dhe e vendit për mbrojtje* — 219, 314-319, 354-358, 443-444.
- Mekanizimi i proceseve të punës* — 86-87, 152-154, 329.
- Metoda dhe stili në punë* — 82-83, 89-90, 99-104, 105-106, 133-134, 148-149, 174, 197-199, 204-207, 275-277, 302-306, 329-330, 361-383, 406-417.
- Minierat* — 82-87, 127-128, 163-169.
- Ministritë — kompetencat dhe metoda e stili i punës së tyre* — 38-41, 45, 182-186, 273-274, 276-277, 301-307;
- Komisioni i Planit të Shtetit — 183, 265;
 - Ministria e Arsimit dhe e Kulturës — 12, 41;
 - Ministria e Bujqësisë — 44, 46, 108, 115, 153, 273,

- 302, 336, 341, 386, 403-409, 415, 416;
- Ministria e Ekonomisë Komunale — 302;
 - Ministria e Financave — 308, 312, 386, 416;
 - Ministria e Industrisë dhe e Minerave — 40-41, 265, 302;
 - Ministria e Komunikacioneve — 265, 302;
 - Ministria e Mbrojtjes — 90, 317-318;
 - Ministria e Ndërtimit — 99, 273-274, 302;
 - Ministria e Tregtisë — 97-98, 183, 302, 336-337, 338, 339, 341, 408-409, 410;
 - Ministria e Shëndetësisë — 182-183.
- Minoriteti grek — 225-228.

N

- Ndërmarrjet ekonomike — kompetencat, organizimi dhe drejtimi i punës* — 4-5, 12-13, 40, 81, 86, 87, 92-95, 262-263, 268-271, 272-274, 298-299;
- ndërmarrjet bujqësore — 146-147, 153, 156, 303, 305, 406-407;
 - ndërmarrjet komunale — 257-259, 292.
- Ndërtimet. Organizimi dhe drejtimi i punës. Perspektiva*

e zhvillimit të ndërtimeve — 129-130, 282, 284-287, 290-293, 333-334.

Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — 7-8, 117-118, 132-133, 164-166, 171-173, 176-180, 279-283, 289, 369, 445, 453-455.

Normat, normimi i punës — 308-309, 311.

O

Organizata-bazë e Partisë — roli udhëheqës; gjallërimi dhe revolucionarizimi i saj — 13, 93-94, 113, 200-201, 205-207, 365-379.

Organizatet e masave. Udhëheqja e tyre nga Partia — 185, 361-362, 368, 379-382, 454, 455-456.

P

- Paga — politika e Partisë në fushën e pagave. Shpërblimi i punës* — 100-103, 311-313.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- karakteristikat revolucionare marksiste-leniniste — 170-171, 175, 177-178, 188, 191, 207-209, 218, 219, 221-222, 395, 397-398;
 - vija politike, vendimet, direktivat; njohja dhe zbatimi i tyre — 37-38, 85-86, 88-89, 103-104, 111-

- 112, 114-116, 118-119, 133-134, 170-177, 205-210, 212-213, 216, 218, 221-222, 300-301, 351-352, 361-371, 407-408, 413, 415-416, 439-440, 448;
 - parimet dhe normat e Partisë — 208-210, 217-218, 407-408;
 - metoda dhe stili në punë — 20-21, 22-24, 27, 80-82, 85-86, 88-89, 299-300, 307;
 - përvoja dhe masat e saj për t'i prcrë rrugën revizionizmit në Shqipëri — 180-181, 204-218;
 - pranimet në Parti, kriteret e pranimit — 31-32, 187, 400-405;
 - informimi në Parti dhe informimi i masave — 204-207, 368-371, 372-374;
 - aktivi i Partisë — 382-383;
 - qëndrimi ndaj të meta-ve e gabimeve dhe ndaj njerëzve që gabojnë: përjashtimet nga Partia — 64-65, 219-220, 352, 391-399;
 - Letra e Komitetit Qendror të Partisë për Bujqësinë (janar 1971) — 136, 141, 145, 146-147, 149, 391.
- Shih edhe:* Lidhjet e Partisë me masat.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- *organet udhëheqëse të saj*
 - Kongresi i 6-të i PPSH — 25, 56, 65, 67, 173-174, 218, 222, 357, 441, 442;
 - Plenumi i 8-të i KQ të PPSH (26—28 tetor 1962) — 138;
 - Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati i Komitetit Qendror — 20-21, 23-24, 80, 81-82, 104, 106, 148, 173, 204, 256, 299-300, 307, 339, 352-353, 354, 355, 365-367, 369, 399, 406, 407, 413;
 - komitetet e Partisë në rrethe; metoda e punës, lidhjet me masat — 204-207, 365-370, 376-377;
 - Komiteti i Partisë i Rrethit të Dibrës — 339, 390-391, 392-399;
 - Komiteti i Partisë i Rrethit të Lushnjës — 90;
 - Komiteti i Partisë i Rrethit të Korçës — 261, 266-267, 390;
 - Komiteti i Partisë i Rrethit të Matit. Fjala në Plenumin e Komitetit të Partisë të këtij rrethi — 132-237, 362, 373;
 - Komiteti i Partisë i Rrethit të Shkodrës — 371-372;
 - Komiteti i Partisë i Rre-

thit të Tiranës — 261-262.

Partia Komuniste (b) e Bashkimit Sovjetik — shkaqet e degjenerimit revizionist të saj — 208-209, 213-215, 217-218.

Planet — realizimi dhe tejkalimi i tyre. Plani i pestë pesëvjeçar (1971-1975), arritje të tij — 36-46, 133-138, 172-175, 357.

Planifikimi në ekonomi

- metodologjia e planifikimit — 335-339;
- planifikimi në bujqësi dhe në blegtori — 113, 136-138, 141-151, 386-390, 409-410.

Politika e jashtme e RPSH

- parimet themelore m-l të politikës së jashtme dhe qëndrimi ndaj problemeve ndërkombëtare. Lufta kundër imperializmit dhe revizionizmit — 57-68, 76-79, 181-182, 222-225, 451-452;
- marrëdhëniet me RD të Vietnamit — 424-425, 426-427, 431-432, 435-436;
- marrëdhëniet me Kinën — 78-79, 452-453;
- marrëdhëniet me Greqinë — 225-227, 446, 450, 453;
- marrëdhëniet me Jugosllavinë — 234-236, 446-447;

- marrëdhëniet me Italinë — 60-61, 69-70;
- marrëdhënie me vende të Amerikës Latine — 55-56, 67-68;
- marrëdhëniet me Cejlonin — 438, 439;
- qëndrimi ndaj ShBA dhe Anglisë — 228-229.

Populli shqiptar; traditat patriotike — 63-64, 250, 392-393, 427, 430.

Popullsia (të dhëna demografike) — 281, 295-297, 400-405.

Prodhimi material; lufta kundër koncepteve artizanale në prodhim — 256-263, 409-410.

Prona dhe qëndrimi socialist ndaj pronës socialiste — 150-151, 209, 239-245;

- e grupit (kooperativiste) — 124-126, 150;

- oborri kooperativist — 103-104, 149-150, 210-211, 212-213, 340.

Propaganda e prodhimit — 36-46.

Psikologjia mikroborgjeze dhe lufta kundër saj — 25-29, 202-203.

Puna — edukimi me dashurinë për punën e profesionin; qëndrimi socialist ndaj punës — 90-91, 164-167, 261-262. 306.

Pushteti Popullor, karakteri

demokratik — 178-186, 195, 261.

R

Revizionizmi modern

- politika demagogjike dhe lufta e tij kundër marksizëm-leninizmit dhe lëvizjeve çlirimtare dhe revolucionare të popujve — 56-57, 71-72, 76-77, 220-221;
- alcancat, kontradiktat, kriza dhe disfatat e tij — 77-78, 222-223, 443;
- revizionistët italianë — 60-61, 69-76.

Rinia dhe BRPSH — politika e Partisë për edukimin komunist të brezit të ri — 19-20, 22-35, 248-249.

S

Socializmi — 150, 171, 176-180.

Stalin, Josif Visarionoviç — 59, 61, 68, 177, 181, 208, 210, 213-215, 217, 218, 221, 362, 446-447.

Stacionet e Makinave dhe të Traktorëve — 89, 153-154, 305.
Strehimi, ndërtimi i banesave — 281-282, 291-294.

SH

Shfaqjet e huaja dhe lufta kundër tyre — 17-19, 29-30,

90-91, 99-103, 160-168, 202-203, 219-220, 254-255, 256-271, 362, 453-457.

Shkenca

- roli i masave në zhvillimin e shkencës; masivizimi i saj — 117-119, 184-185;
- institucionet shkencore — puna e tyre për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë — 107-108, 111-115, 156.

Shkollat, kurset; rëndësia e tyre — 160-161;

- me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna — 1-8, 161-162;
- kurset për kualifikimin e punëtorëve — 8-12, 169.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme; kriza dhe disfatat e imperializmit amerikan — 60, 223, 224, 418-421, 427, 429-430, 432-433, 434, 444.

T

Teoria dhe praktika, uniteti dialektik i tyre — 91-92, 133-134.

Teoria e revizionistëve italianë për «rrugën italiane të socializmit» dhe kritika kundër saj — 71.

Teoritë revizioniste për parti-në politike të klasës punëto-re dhe kritika kundër tyre — 221.

Tregtia e brendshme; punonjësit — 245-246, 339-341, 343-344.

U

Uniteti Parti-popull — 350-351, 392-393.

Urbanistika — 279, 280-281, 283-284, 286, 287-289, 293-294.

Ushtria Popullore — *forcimi; bashkëpunimi ushtri-terren dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja në ushtri* — 98-99, 314-319, 357.

V

Vendet revizioniste — 71-72, 73-76, 230.

Vietnami

— *lufta e popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë* — 418-420, 421, 427-431, 433-434, 435-436, 444-445;

— *synimet dhe politika demagogjike e fuqive imperialiste kundër Vietnamit* — 418-425, 452.

Vija e masave — 85-86, 92-95, 172-222, 263-271, 351-352, 361-383, 439-440, 448-449.

ZII

Zhvillimi dialektik i shoqërisë sonë socialiste — 254-255, 400-402.

TREGUESI I EMRAVE

A

- Alia, Ramiz — 82, 346, 350,
365-366.
Agolli, Nasibi — 32, 35.

B

- Bata, Hašan — 131.
Baticki (mareshali) — 422.

Ç

- Çako, Hito — 98.
Çela, Aranit — 238, 240-241.

D

- Dodbiba, Pirro — 299, 406-407,
408, 409, 416.

F

- Fishta, Adriana — 24, 35.

G

- Gegprifti, Llambi — 127, 152.
Gradeci, Dhurata — 326, 331.
Gradeci, Liri — 326, 327, 328,
332.

- Gradeci, Sulo — 325-326, 328,
331, 332, 334.
Gradeci, Sherina — 325, 329,
331.
Greçko, Andrej — 320-321.

GJ

- Gjermani, Rrapi — 89-90.
Gjoka, Zile — 127.
Gjoni, Lutfie — 121, 122, 123,
124, 126.

H

- Hoxha, Nexhmije — 325-326,
327, 332.
Hasantari, Engjëllushe — 326,
331.
Hasantari, Safigje — 326.
Honeker, Erih — 233.
Ho Shi Min — 424, 426-427.
Hrushov, Nikita — 59, 60.

K

- Kapo, Hysni — 367.
Koleka, Spiro — 281, 300.
Kadar, Janosh — 232.
Karnij (admirali) — 60.
Kisinger, Henri — 418.

L

Lumba — 442.

MMyftiu, Manush — 102, 268,
294.Menzelxhiu, Jashar — 104,
304.

Mitrushi, Jeta — 331.

N

Nguyen Van Thieu — 419.

Ngjela, Kiço — 97, 299, 409.

Nikson, Riçard — 418, 419,
420, 422, 423, 429, 432, 433,
434.**P**Pajenga, Mustafa — 129, 130,
131, 317.Panarlti, Dhorì — 238, 240-
-241.

Pano, Vaso — 128.

Paredes, Saturnino — 55, 56,
67.

Pisli, Lezan — 126, 146, 158

Porter — 430.

S

Samara, Jani — 266.

Skura, Hane — 131.

Skura, Shkurte — 130.

Stralla, Naum — 184.

Strazimiri, Gani — 334.

SH

Shema, Dan — 124.

T

Toska, Haki — 302.

Tashko, Koço — 232.

Tito, Josip Broz — 233-234
446-447.

Treska, Nika — 127, 191.

Tripallo, Miha — 233.

TH

Theodhosi, Koço — 299, 344.

U

Ulbricht, Valter — 233.

XHXhani, Mustafa (Baba Faja)
— 126.**Z**

Ziçishti, Mihallaq — 266, 267.

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

- Angli — 229.
An Lok (Vietnam) — 431.
Arbitrazhi Shtetëror pranë
Këshillit të Ministrave të
RPSH — 298.

B

- «Bashkimi» (gazeta ~) —
394.
Beograd — 322.
Bin Din (Vietnam) — 429.
Bisedimet për Vietnamin në
Paris (prill 1972) — 420.
Bullgari — 321.

C

- Cejlon (Sri-Lanka) — 438,
439, 442-443, 445.
CIA — 60.

Ç

- Çekosllovakia — 74, 231, 435.

D

- Da Nang (Vietnam) — 429.

Dibër, Peshkopi — 156-157,
275, 391-399, 410.

Drejtoria e Përgjithshme e
Ekonomisë Komunale — 257-
-258.

Dropull (Gjirokastër) — 156,
227-228.

Durrës — 148, 250.

E

Elbasan — 117, 210.

F

Fabrika e Sodës Kaustike —
Vlorë — 345.

Fier — 148, 250.

Fronti Kombëtar i Çlirimit të
Vietnamin të Jugut — 433,
434.

G

Gestapo — 66.

Grecalli (Fier) — 267-268.

Greqi — 60.

GJ

Gjermania Lindore (RD Gjermane) — 230, 232-233.

Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 230-231, 233.
Gjirokastër — 156, 227, 250.

titulli ~, «Zëri i popullit», 2 mars 1969) — 70.
Itali — 61, 70.

H

Hanoi — 419, 422.
Hekurudha Elbasan—Përrer-
njas — 166.
Hekurudha Tiranë—Durrës —
166.
Hidrocentrali «Frederik En-
gels» — 330.
Hidrocentrali i Fierzës — 97,
300.
Hidrocentrali «Karl Marks»
— 330.
Holandë — 159-160.
Hue (Vietnam) — 429.
Hungari — 230, 232, 321.

I

Indokinë — 423.
Instituti i Kërkimeve Bujqë-
sore — Lushnjë — 107-108,
110-111.
Instituti i Kërkimeve Vete-
rinare — Tiranë — 107-108,
114.
Instituti i Kërkimeve Zootek-
nike — Shkodër — 107-108,
112, 114.
«Integrimi me borgjezinë —
kurs i ri i Kongresit të 12-të
të revizionistëve italianë» (ar-

K

«Kapedani» (filmi ~) — 327-
-328.
Këshilli i Përgjithshëm Anti-
fashist Nacionalçlirimtar —
186.
Këshilli i Përgjithshëm i
Frontit Demokratik të Shqipë-
risë — 346.
Këshilli Qendror i Bashkime-
ve Profesionale të Shqipëri-
së — 1, 20.
KNER — 75.
«Kolleksioni i Etlevës» (doku-
mentari ~) — 332.
Kombinati i Drurit — Laç —
265.
Kombinati Metalurgjik — El-
basan — 455.
Kombinati i tekstileve «Sta-
lin» — 10-12, 13, 269-270.
Komuna e Parisit — 95.
Konferenca e «sigurimit evropian»
— 229-230.
Kongresi i 7-të i Bashkimeve
Profesionale (8-11 maj 1972)
— 426, 431, 436, 448, 455-
-456.
Kongresi i 20-të i PK të BS
— 72.
Kongresi i 13-të i partisë ko-
muniste (revizioniste) italiane
(mars 1972) — 60, 69.

Kooperativa bujqësore e bashkuar «1 Maji» — Cërujë — Mat — 168.

Kooperativa Bujqësore e Pojanit — Korçë — 124.

Kooperativa Bujqësore e Shoshajt — Mat — 124-125, 126, 204, 206-207.

Korçë — 124, 158-159, 390.

Kroaci — 233.

Krujë — 217.

Kuang Tri (Vietnam) — 429.

L

«Lajmëtari i festivalit» (dokumentari ~) — 332, 333.

Lëvizja e prillit 1971 në Cejlon — 442.

Librazhd — 333.

Lidhja e Komunistëve (në periudhën e Marksit dhe të Engelsit) — 220.

Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë — 278.

Lindja e Mesme — 321.

Lushnjë — 89-90, 110, 148, 240.

M

Mat, Burrel — 87, 120, 124, 130-131, 132-138, 140-141, 145, 149-150, 152-153, 154, 157, 168, 170, 184-185, 236-237, 240, 362.

«Mbi tezat për Kongresin e 10-të të PK Italiane» (ar-

tikulli ~, «Zëri i popullit», 17-18 nëntor 1962) — 70.

Mbledhja e partive komuniste e punëtore në Bukuresht (qershor 1960) — 59.

Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë (10 nëntor — 1 dhjetor 1960) — 59, 72.

«Me çfarë shkojnë revizionistët italianë në Kongresin e tyre të 11-të (artikulli ~ «Zëri i popullit», 9 janar 1966) — 70.

Mesdhe (pellgu ~) — 321, 423.

Mëzez (Tiranë) — 286-287.

Miniera e Alarupit — Pogradec — 128.

Miniera e Kurbneshit — Mirditë — 80-81, 86-87.

Moskë — 418, 433.

N

NATO — 61.

Ndërmarrja Bujqësore e Kamzës — Tiranë — 342-343.

Ndërmarrja bujqësore «29 Nëntori» — Lushnjë — 110.

Ndërmarrja e Ndërtimeve e Laçit — Krujë — 80.

Ndërmarrja Industriale e Tullave — Korçë — 266.

O

OKB — 228.

P

Peshk (Mat) — 126.
 Pogradec — 354-358.
 Poloni — 230.

R

Radio Tirana — 226.
 Rumani — 230, 231-232.

S

Skrapar — 326-327.
 SMT — Lushnjë — 240.

SH

Shangai (Kinë) — 452.
 «Shënime për Kinën», vëll. I
 (Vepra ~, Enver Hoxha) —
 61.
 Shirgjan (Elbasan) — 103-
 -104, 116.
 Shkodër — 250.
 Shtëpia e Kulturës — Burrel
 — 129, 130.

T

«Testamenti» i P. Toliatit,
 kriza e revizionizmit modern

dhe lufta e marksistë-lenini-
 stëve (artikulli ~, «Zëri i
 popullit», 13 nëntor 1964) —
 70.

Tiranë — 48, 98, 140, 250, 281
 282-283, 285-287, 293, 294
 332-333.

Traktati i Varshavës — 75,
 230, 321.

Tregu i Përbashkët Evropian
 — 223.

U

Uashington — 418.
 Uzina «Traktori» (kombinati i
 autotraktorëve «Enver Hoxha»)
 — 40-41, 265.

V

Vinjoll (Mat) — 125.
 Vlorë — 250.
 Vorë (Tiranë) — 286.
 «Vorio-Epir» — 225-226.

Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~)
 — 37-38, 70.

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 48-TË V—X

1972

- NGRITJEN TEKNIKO-PROFESIONALE TË PUNËTORËVE E KËRKON VETË ZHVILLIMI I EKONOMISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 janar 1972) 1—21
- KUNDËR SHFAQJEVE TË PSIKOLOGJISË MIKROBORGJEZE TË LUFTOJMË FRONTALISHT NË TË GJITHA DREJTIMET — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 janar 1972) 22—35
- PROPAGANDA E PRODHIMIT TË KETË KARAKTER EDUKUES, MOBILIZUES DHE TË PËRHAPE EKSPERIENCËN E PËRPARUAR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (28 janar 1972) 36—46
- LIGJET TË INTERPRETOHEN E TË ZBATOHEN NË MËNYRË REVOLUCIONARE — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor (4 shkurt 1972) 47—54
- DEMAGOGJISË SË REVIZIONISTËVE I BËHET BALLË DUKE U BAZUAR NË PARIMET MARKSISTE-LENINISTE — Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste Peruane (7 shkurt 1972) 55—68

VIJA E DEMARKACIONIT MIDIS MARKSISTË-LE- NINISTËVE DHE REVIZIONISTËVE MODERNE NUK MUND TË SHLYHET — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (13 shkurt 1972)	69—79
UDHËHEQJA E PARTISË KA NEVOJË PËR MEN- DIMET E MASËS — Diskutim në mbledhjen e Se- kretariatit të KQ të PPSH (18 shkurt 1972)	80—95
NDAJ MASAVE PUNONJËSE NUK LEJOHET AS- NJË QËNDRIM MOSPËRFILLËS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 shkurt 1972)	96—106
DITURIA DHE SHKENCA TË PËRHAPEN GJERË- SISHT NË MASAT DHE TË PËRVETËSOHEN PREJ TYRE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 shkurt 1972)	107—119
PUNONJËSI DUHET TË MËSOJË MIRË DHE ME KËMBËNGULJE PËR PROFESIONIN QË USH- TRON — Nga biseda me anëtarë të plenumit të Ko- mitetit të Partisë të Rrethit të Matit (25 shkurt 1972)	120—128
TA GËZONI KËTË SHTËPI KULTURE — Nga bise- da me anëtarë të plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit (26 shkurt 1972)	129—131
SOCIALIZMIN E NDËRTOJNË MASAT, PARTIA I BËN KËTO TË NDËRGJEGJSHME — Fjala në ple- numin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit (26 shkurt 1972)	132—237
NË PUNËN PËR EDUKIMIN IDEOPOLITIK TË NJERËZVE NUK KA VEND PËR VETËKËNAQËSI — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (10 mars 1972)	238—255
KONCEPTET ARTIZANALE NË PRODHIM JANË TË PASHKËPUTURA NGA MBETURINAT E TJE- RA MIKROBORGJEZE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 mars 1972)	256—271

- KOMPETENCAT TË USHTROHEN NË PAJTIM ME INTERESIN E PËRGJITHSHËM — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 mars 1972) 272—277
- PROBLEMET E ARKITEKTURËS E TË URBANIS-TIKËS MUND TË ZGJIDHEN DREJT NESE TRAJ-TOHEN NË MËNYRË SHKENCORE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 mars 1972) 278—294
- NË PUNË DUHET TË KETË KËRKESE TË FORTË LLOGARIE DHE SHPËRBLIM TË MERITUAR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (27 mars 1972) 295—313
- TË FORCOHET MË TEJ BASHKËPUNIMI USHTRI-TERREN — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Po-litike të KQ të PPSH (27 mars 1972) 314—319
- LARG DUART NGA BALLKANI! — Artikull i bo-tuar në gazetën «Zëri i popullit» (29 mars 1972) 320—324
- TË GJITHË JEMI BIJ TË PARTISË. T'I SHËR-BEJMË ASAJ TËRË JETËN — Nga biseda në fami-ljen e shokut Sulo Gradeci me rastin e 50-vjetorit të lindjes së tij (11 prill 1972) 325—334
- PLANI I GRUMBULLIMIT TË TEPRICAVE NUK ËSHTË DETYRIM — Nga biseda me ministrin e Tregtisë (12 prill 1972) 335-345
- ORGANIZATA E FRONTIT ËSHTË ABSOLUTISHT NË FAVOR TË REVOLUCIONIT, TË SOCIALIZ-MIT, TË EDUKIMIT REVOLUCIONAR TË MASAVE — Fjala e mbylljes në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë (19 prill 1972) 346—353

- FORCIMI I LIDHJEVE TË SHËNDOSHA TË POPULLIT ME USHTRINË — GARANCI PËR MBROJTJEN E ATDHEUT** — Përshëndetje drejtuar Komitetit të Partisë të Rrethit të Pogradecit (20 prill 1972) 354—358
- DISA PROBLEME TË KUPTIMIT DHE TË ZBATIMIT NË PRAKTIKË TË DIREKTIVAVE PËR PUNËN E PARTISË ME MASAT** — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 prill 1972) 359—383
- METODAT E PUNËS E TË DREJTIMIT JO NË FRYMË PARTIE CENOJNË RËNDË LIDHJET ME MASAT** — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 prill 1972) 384—399
- NË PËRCAKTIMIN E ORIGJINËS SHOQËRORE TË NJERËZVE TË MARRIM PARASYSH STADIN E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË SONË** — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 prill 1972) 400—405
- ZBATIMI I KONTRATAVE DUHET TË MBËSHËTET NË REALIZIMIN FAKTIK TË PLANIT TË PRODHIMIT BUJQËSOR E BLEGTORAL** — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 prill 1972) 406—417
- LUFTA HEROIKE E POPULLIT TË VIETNAMIT DHE INTRIGAT E SOCIALIMPERIALIZMIT SOVJETIK** — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (29 prill 1972) 418—425
- LIRIA E FITUAR ME GJAK NUK KA MORTJE KURRË** — Nga biseda me delegacionin e Federatës së Sindikatave të RD të Vietnamit dhe me delegacionin e Federatës së Sindikatave për Çlirimin e Vietnamit të Jugut (4 maj 1972) 426—437

TE LIDHJET E NGUSHTA ME POPULLIN, ATJE I KEMI RRËNJËT TONA — Nga biseda me një drejtues marksist-leninist nga Cejloni (4 maj 1972)	436—449
KLASA PUNËTORE, ME PARTINË NË KRYE, DU- HET TË JETË KURDOHERË NË BALLË — Nga biseda me delegacionin e punëtorëve kinezë (4 maj 1972)	450—457
Treguesi i lëndës	461
Treguesi i emrave	471
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera	473